

ENVER HOXHA

VEPRA

47

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPERISE



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË QJ TË PPSH

ENVER HOXHA

VËLLIMI

47

SHTATOR 1971 – DHJETOR 1971

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1985

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 47-TË

Në këtë vëllim përfshihen materiale të periudhës shtator—dhjetor 1971, pjesa më e madhe e të cilave botohen për herë të parë.

Vendin kryesor në vëllim e zënë materialet që i kushtohen Kongresit të 6-të të PPSH, që kurorëzoi një periudhë të rëndësishme në historinë e Partisë dhe të popullit tonë, karakteristikë dalluese e së cilës është lufta për revolucionarizimin e mëtejshëm e të thellë të të gjithë jetës së vendit, të mobilizimit të përgjithshëm, plot vrull e entuziazëm, të masave punonjëse, të aksioneve e të lëvizjeve të fuqishme revolucionare.

Në raportin që shoku Enver Hoxha mbajti në Kongres bëhet një analizë e thellë shkencore e veprimtarisë së Partisë për një periudhë pesëvjeçare e, mbi këtë bazë, arrihen përgjithësime të rëndësishme, me vlerë përherë aktuale, teorike e praktike. Në të pasqyrohet lufta e madhe që udhëhoqi Partia për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit. Në këtë luftë u forcuan edhe më tepër roli udhëheqës i organizatave-bazë të Partisë dhe i organeve udhëheqëse të Partisë në rrethe. Duke u ndalur në këtë çështje të përhershme e jetike, Kongresi shtronte detyra të reja për ngritjen në një shkallë më të lartë të rolit drejtues, edukues, organizues e mobilizues të Partisë në të gjitha fushat e sektorët.

Si hallkën themelore e vendimtare për sigurimin e këtij roli, shoku Enver Hoxha përcakton organizatën-bazë dhe veprimtarinë revolucionare, shembullin personal të komunistëve, si luftëtarë pararojë, që frymëzojnë, edukojnë dhe mobilizojnë masat në luftën për socializëm.

Një gështje tjetër shumë e rëndësishme ku u ndal Kongresi e që trajtohet gjerësisht në raportin e shokut Enver Hoxha, është edhe forcimi e revolucionarizimi i diktaturës së proletariatit. Përvoja e vendit tonë tregon se, në kushtet e një udhëheqjeje të drejtë nga ana e Partisë, diktatura e proletariatit mund t'u qëndrojë të gjitha provave dhe të kryejë me sukses misionin e saj historik. Por, siç vuri në dukje Kongresi, diktaturën e proletariatit e kërcënojnë mjaft rreziqe; armiqtë e sulmojnë vazhdimisht atë, si teori dhe si praktikë. Në këto kushte është e domosdoshme të mbahet kurdoherë ndezur lufta për ruajtjen, forcimin e përsosjen e diktaturës së proletariatit, për rritjen e rolit aktiv të shtetit në të gjitha sferat e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Jetike këtu është lufta kundër burokratizmit, kësaj së keqeje të madhe e me rrënjë të thella. Si rrugë të përgjithshme për forcimin e diktaturës së proletariatit Kongresi përcaktoi zhvillimin e demokracisë socialiste. «Pa demokraci socialiste nuk ka diktaturë të proletariatit, ashtu siç nuk mund të ketë demokraci të vërtetë për punonjësit pa diktaturë të proletariatit», thekson shoku Enver Hoxha.

Për forcimin dhe përsosjen e sistemit të diktaturës së proletariatit, Kongresi vendosi që të hartohej Kushtetuta e re e shtetit shqiptar, masë kjo që diktohej nga kushtet e reja ekonomiko-shoqërore, kulturore e

ideologjike, të krijuara në Shqipëri, pas ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit.

Në raportin e Kongresit trajtohen në mënyrë shkencore edhe problemet e zhvillimit të pareshtur të revolucionit ideologjik e kulturor në vendin tonë, të luftës ideologjike për edukimin e njeriut të ri. Në të bëhen përgjithësime me vlerë të madhe nga përvoja e fituar prej lëvizjeve revolucionare me karakter ideologjik-shoqëror, që u zhvilluan pas Kongresit të 5-të, dhe nxirren mësimet të çmuara për të forcuar më tej ndërgjegjen socialiste të masave punonjëse në luftë me të gjitha mbeturinat dhe ndikimet e ideologjive të huaja, që jo vetëm pengojnë marshimin përpara të revolucionit, por përmbajnë në vetvete rrezikun e kthimit prapa: «Po të mos i hysh me të gjitha forcat thellimit të revolucionit ideologjik e kulturor, — nënvizohet në raport, — do të thotë ta lësh revolucionin socialist në mes të rrugës, të vësh në rrezik realizimet e tij në lëmin politik e ekonomik, t'i hapësh rrugën degjenerimit borgjez në të gjitha fushat».

Kongresi miratoi edhe direktivat e planit të pestë pesëvjeçar, të hartuara mbi bazën e orientimeve themelore të Partisë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. Ato ishin detyra të guximshme, të menduara thellë e drejt, plotësisht të realizueshme. Plotësimi i tyre do ta fuqizonte edhe më shumë Shqipërinë, do të rriste më tej mirëqenien e masave. Kongresi shtroi detyra të rëndësishme për përmirësimin e drejtimit të ekonomisë dhe të punës së Partisë për mobilizimin e masave.

Mbajtja e Kongresit të 6-të të Partisë përkoi me

një ngjarje tjetër të shënuar, 30-vjetorin e Themelimit të saj. Në raportin e shokut Enver Hoxha e në fjalime të tjera publike, kushtuar këtyre dy ngjarjeve të shënuara, pasqyrohet gjerësisht rruga 30-vjeçare e Partisë, që e ngriti Shqipërinë në lartësitë e socializmit, analizohen në mënyrë të thellë e shkencore edhe faktorët që e bënë të mundur këtë realitet madhështor. «Burimi i forcës dhe i urtësisë së Partisë sonë, — theksohet në vëllim, — ka qenë dhe është besnikëria ndaj mësimëve të marksizëm-leninizmit, zbatimi i tyre në mënyrë krijuese, pasurimi i tyre në praktikën shqiptare».

Interes të veçantë paraqitin në këtë vëllim edhe fjalimet e bisedat e ngrohta të shokut Enver Hoxha në rrethin e Skraparit, ku kishte shkuar për të festuar së bashku me popullin 27-vjetorin e Çlirimit të Atdheut. Këto takime të paharruara i përshkon si një fill i kuq dashuria e pakufishme dhe kujdesi i jashtëzakonshëm i Udhëheqësit të dashur e të shtrenjtë të Partisë e të popullit tonë për punonjësit e qytetit e të fshatit.

Në raportin e Kongresit, në fjalime publike, në bisedat me të huaj etj., pasqyrohet edhe lufta pa kompromis e Partisë sonë kundër imperializmit e revizionizmit modern, si dhe analizohet në mënyrë të gjithanshme e shkencore situata ndërkombëtare. Periudha e sotme, vë në dukje shoku Enver Hoxha, mund të krahasohet me periudhat më kritike që ka kaluar borgjezia e vendeve kapitaliste, si rezultat i përleshjeve të mëdha klasore midis punonjësve dhe kapitalit e pushtetit të tij. «Revolucioni, — nënvizon Ai, — po bëhet aspiratë e përgjithshme e popujve». Me interes të veçantë është diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike

më 15 tetor 1971, në të cilin shoku Enver Hoxha analizon shkaqet që e shtynë udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës të mos dërgonte delegacion të saj në Kongresin e 6-të të PPSH. Ndonëse udhëheqja kineze akoma nuk e kishte shpalosur krejt flamurin e revizionizmit, ajo nisej nga qëllime të ulëta dhe armiqësore ndaj Partisë e vendit tonë. Shokut Enver Hoxha i kishin rënë me kohë në sy simptomat revizioniste të udhëheqjes kineze, lëkundjet e paprincipita në vijën e PKK, pasojë direkte e të cilave, siç vihet në dukje në këtë diskutim, ishte edhe mosdërgimi nga ana e saj e një delegacioni për të marrë pjesë në Kongresin e 6-të të Partisë sonë.

Materialet e këtij vëllimi, ashtu si e gjithë Vepra e shokut Enver Hoxha, janë një kontribut i madh dhe një armë e fuqishme ideologjike në duart e komunistëve, të kuadrove e të punonjësve, të cilët do të udhëhiqen kurdoherë nga mësimet e pavarëshme të Tij në luftën dhe punën për ndërtimin e socializmit e të komunizmit.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

TE ZHVILLOJME ME GJERE REVOLUCIONIN TEKNIKO-SHKENCOR NE VENDIN TONE

*Fjala ne Konferencen e 18-te te Partise
te rrethit te Tiranës*

29 shtator 1971

Shoqe dhe shokë delegatë
te organizates se Partise te rrethit te Tiranës,

E ndiej veten te lumtur te marr pjesë si i deleguar i Komitetit Qendror te Partise ne zhvillimin e punimeve te konferencës suaj dhe t'ju sjell me këtë rast pershendetjet me te perzemertha te Komitetit Qendror te Partise per sukseset qe keni arritur qe nga konferenca e kaluar, si dhe t'u uroj gjithë komunistëve dhe punonjësve te Tiranës rezultate akoma me te mëdha ne të ardhmen.

Nga raporti qe mbajti shoku Manush [Myftiu]¹, si dhe nga diskutimet tuaja, unë mësova me nga afër per punën, përpjekjet dhe luftën qe kanë bërë komunistët,

1. Në atë kohë anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës.

klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjencia popullore e Tiranës për të vënë në jetë direktivat e Kongresit të 5-të të Partisë, vendimet e plenumeve të 9-të e të 10-të të Komitetit Qendror të PPSH, idetë e Letrës së Komitetit Qendror të Partisë për bujqësinë dhe të dokumenteve të tjera të rëndësishme. Sukseset që ka arritur organizata juaj në fushën politike, ideologjike, shoqërore dhe ekonomike, duke plotësuar me sukses detyrat e ngarkuara, si dhe niveli i zhvillimit të punimeve të kësaj konference, flasin qartë se e fortë, e gjallë, kompakte, luftarake dhe revolucionare është ajo. Këta tregues cilësorë të organizatës suaj, siç e kam theksuar edhe tjetër herë, kanë rëndësi të madhe, sepse puna juaj reflektohet në gjithë Partinë.

Zgjedhjet në Parti janë kurdoherë një aksion i madh politik, ideologjik, organizativ dhe ekonomik komunistëve dhe i punonjësve. Të tilla kanë qenë edhe këto të sivjetmet, që u zhvilluan në kuadrin e jubileut të madh, 30-vjetorit të Themelimit të Partisë e të Kongresit të 6-të të saj dhe që i shërbejnë shumë mobilizimit të gjithanshëm të komunistëve dhe të masave për të shkuar në këto dy ngjarje historike, ashtu siç na e do zemra të gjithëve.

Mbledhjet për dhënie llogari e zgjedhje u karakterizuan kudo nga një punë e madhe dhe optimizëm revolucionar, që mbështeten në vijën e drejtë të Partisë, në shpirtin praktik krijues të masave tona punonjëse, si dhe në përparimet e arritura dhe perspektivat e mëdha që na janë hapur.

Zgjedhjet e sivjetme, mbi bazën e eksperiencës së grumbulluar, thelluan më tej metodën e punës së Par-

tisë në zbatimin e vijës së masave, mendimi i të cilave u tërhoq nga komunistët si në përcaktimin e rrethave të ditës, ashtu edhe në përgatitjen e raporteve dhe të projektvendimeve. Kësaj here, më mirë se çdo herë tjetër, problemi i zgjedhjeve në Parti u bë problem i masave.

Sukseset e gjithanshme të punës së Partisë dhe të popullit, të materializuara në zbatimin e vendimeve historike të Kongresit të 5-të vërtetojnë më së miri se Partia jonë është forcuar më tej, është edukuar e kalitur më shumë nga pikëpamja politike, ideologjike dhe organizative.

Realizimi nga ana juaj i detyrave të caktuara nga Kongresi i 5-të për prodhimin e përgjithshëm industrial në 4 vjet e 4 muaj dhe për ndërtimet në 4 vjet e një muaj, provon me fakte se klasa punëtore e Tiranës, nën udhëheqjen e organizatës së Partisë, duke qenë e ndërgjegjshme për rolin e saj hëgjemon dhe përgjegjësinë e madhe që ka, i ka vënë gjoksin punës. Rikonstruksioni dhe ngritja e dhjetëra e dhjetëra fabrikave, reparteve, linjave e sektorëve të rinj gjatë pesë vjetëve të shkuar dëshmon qartë për përpjekjet e klasës punëtore në përvetësimin e shkencës dhe të teknikës së re, për futjen e tyre në prodhim, si dhe për luftën e saj të shquar në drejtim të transformimeve të thella revolucionare të botës materiale e shpirtërore të njerëzve.

Fshatarësia kooperativiste e rrethit tuaj ka korrur një sërë suksesesh të rëndësishme. Ajo realizoi detyrën e planit të katërt pesëvjeçar 100 për qind për drithërat e bukës, tejkaloi planin e prodhimit të mishit e të qumështit, zgjeroi sipërfaqen e mbjellë me 3 935 hek-

tarë më shumë, zgjeroi sipërfaqen e ujitshme, ngriti në një shkallë më të lartë zbatimin e agroteknikës etj. Këto suksese që janë arritur në fushën e bujqësisë, siç u përmend edhe në raport, kanë sjellë si rezultat që në vitin 1970 të ardhurat e kooperativistëve të rriten 155 për qind në krahasim me vitin 1967 dhe për ditë-punë nga 6,8 lekë në 10,7 lekë, për krahë pune nga 1 634 lekë në 2 821 dhe për frymë nga 543 në 781 lekë.

Edhe inteligjencia popullore e rrethit të Tiranës ka luftuar që të kryejë me nder të gjitha detyrat që i janë ngarkuar. Si një repart i fuqishëm, e ndriçuar kurdoherë nga mësimet e Partisë, ajo ka çarë përpara dhe ka shënuar suksese të reja në frontin e arsimit, të kulturës, të artit, të shkencës e të prodhimit.

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe në emrin tim, ju uroj nga zemra për këto suksese që keni arritur!

Suksese të mëdha, që u përmendën hollësisht në raportin që dëgjuam, janë arritur e po arrihen nga masat punonjëse të kryeqytetit edhe gjatë këtij viti. Ato kanë tash në dorë një dokument të madh programatik — projektdirektivat e pesëvjeçarit të pestë, të cilat me të drejtë u vunë në themel të punimeve të kësaj konference. Ky është një fillim i mirë dhe, siç thuhet, fillimi i mirë është gjysma e punës.

Ne jemi komunistë dhe rezultatet e arritura nuk na i marrin mendë që të gjykojmë si mikroborgjezë, se tash ne s'kemi arsye përse të vrasim shumë mendjen e të dërsijmë në të ardhmen. Partia na ka mësuar që në analizën dhe në vlerësimin e fitoreve të shohim njëkohësisht edhe të metat e gabimet në punë, duke

çmuar drejt e realisht faktorët objektivë dhe subjektivë që na kanë penguar për realizime më të mira. Si raporti që dëgjuam, edhe diskutimet tuaja shumë të mira, e kishin parasysh këtë mësim të madh të Partisë.

Organizatata-bazë të Partisë në sektorin e prodhimit bënë shumë mirë që, gjatë mbledhjeve për dhënie llogari e zgjedhje, u përqendruan kryesisht në realizimin e detyrave të shtruara nga plenumet e 9-të e të 10-të të Komitetit Qendror të Partisë për ngritjen në një shkallë më të lartë të drejtimit shkencor të problemeve të prodhimit, si dhe për organizimin socialist të punës. Gjatë këtyre analizave doli se ka shumë organizata-bazë që i drejtojnë mirë e mbi baza shkencore problemet e prodhimit. Në këtë fushë është fakt se tërë puna e Partisë ka mjaft përmirësime, por duhet pranuar se ka edhe organizata-bazë në ndërmarrjet ekonomike, e veçanërisht në kooperativat bujqësore, që i drejtojnë këto probleme në përgjithësi, që merren më shumë me çështjet e ditës sesa me ato të perspektivës, që bëjnë pak analiza e studime dhe nuk trajtojnë si duhet punën ideologjike dhe organizative të Partisë në funksion të problemeve ekonomike.

Jeta në vendin tonë ecën përpara, ekonomia sa vjen e rritet me ritme më të shpejta, zhvillohen shpejt forcat prodhuese dhe në të njëjtën kohë përsosen në rrugë revolucionare marrëdhëniet socialiste në prodhim. Ky zhvillim sjell probleme të reja, krijon kontradikta që duhen zgjidhur drejt e në kohën e duhur, prandaj ekonomia nuk mund të drejtohet me të njëjtat metoda e me të njëjtin stil dhe me po ato njohuri që mbase shumë vjet më parë ishin të mjaftueshme. Pikërisht

për këtë arsye është e domosdoshme të intensifikohet më tej puna studiuëse, analizuëse dhe përgjithësuese e organizatave-bazë të Partisë, që nga faktet e fenomenet e veçuara të nxjerrin konkluzione të thelluara për të rritur më tej aftësitë e Partisë në drejtimin e probleme ekonomike mbi baza shkencore, duke u mbështetur si gjithnjë në vijën e Partisë dhe në kërkesat e ligjeve objektive të socializmit shkencor.

Si refleksi i punës së mirë të Partisë, jeta e brendshme e organizatave-bazë është gjallëruar më shumë; tash ato më mirë shqyrtojnë, diskutojnë dhe vendosin për problemet më kryesore që shqetësojnë komunistët dhe punonjësit. Forcimi i jetës së brendshme ka dhënë frytet e veta, janë rritur iniciativa dhe vetëveprimi i organizatave-bazë, gjithnjë e më mirë zberthehen direktivat e Partisë dhe luftohet për të vënë në jetë vendimet që merren. Me gjithë hapat e mirë që janë bërë në këtë drejtim, mund të thuhet se në disa organizata-bazë ka akoma shfaqje të formalizmit dhe të zyrtarizmit, që pengojnë seriozisht mbarëvajtjen e punëve.

Siç ka dalë gjatë fushatës së zgjedhjeve, është bërë zakon, jo i rekomandueshëm, që mbledhjet, në të shumtat e rasteve, pa qenë nevoja, bëhen të gjata, me referate që kanë shumë ujë. Edhe diskutimet inkurajohet të bëhen me shkrim, pa menduar për ndikimin negativ që ushtrohet, duke vepruar kështu tek ata shokë që nuk ia thonë fort kalemit, të cilët, megjithëse mund të kenë gjëra të vlefshme për të thënë në organizatë, ngurrojnë të diskutojnë. Nganjëherë ndodh që sekretarit të organizatës-bazë, kur ky është punëtor, njeri

pa shumë fjalë, por revolucionar dhe që për punë nuk ia kalon njeri, i zgjedhin një zëvendës nga nëpunësit e administratës, vetëm sepse ky di «të qëndisë» mirë raportet që kërkohen! Partia nuk shtron çështjen që nëpunësit e intelektualët të mos zgjidhen në udhëheqje të organizatave-bazë, kur këta i kanë të gjitha meritat, por është e padrejtë të zgjidhet zëvendëssekretar një nëpunës vetëm sepse ai di të shkruajë mirë.

Puna politike, ideologjike dhe edukative e Partisë, përgjithësisht i ka shërbyer realizimit të detyrave të mëdha ekonomike të pesëvjeçarit të katërt dhe të vitit në vazhdim, por në këtë drejtim vërehen akoma shumë dobësi. Në edukimin politik dhe ideologjik të punonjësve, siç doli nga mbledhjet për dhënie llogari e zgjedhje, duket akoma tendenca e globalizmit, duke përdorur forma të përgjithshme propagandimi, pavarësisht nga veçoritë e detyrave, të kohës, njerëzve etj. Propaganda e Partisë nuk mund të ndërtohet njëlloj dhe në po ato forma për të gjitha kohët, për të gjitha problemet dhe për gjithë njerëzit, ajo nuk mund të zhvillohet me sukses pa pasur një objekt të caktuar, në funksion të të cilit ndërtohet gjithë puna edukative me komunistët, kuadrot dhe masat e tjera punonjëse.

Propaganda e Partisë duhet të përqendrohet veçanërisht në gjetjen e formave dhe të metodave të përshtatshme për edukimin e rinisë sonë, me qëllim që shpirti i saj i pastër dhe zemra plot vrull revolucionar të pasurohen më tej me vetitë e larta të moralit komunist në drejtim të punës, të mësimit dhe të mbrojtjes.

Globalizmi në propagandën dhe në punën politiko-ideologjike me njerëzit është reflektuar edhe në

realizimin e detyrave të disa ndërmarrjeve shtetërore, ku ekziston prirja për realizimin e planit në global në dëm të cilësisë dhe të asortimenteve të prodhimit. Kjo tendencë, si dhe disa të tjera, si mbajtja e rezervave, shikimi i problemeve nga prizmi i interesit të ngushtë dikasterial, shkelja e disiplinës financiare etj., që me të drejtë janë kritikuar nga komunistët, kuadrot dhe masat gjatë fushatës së zgjedhjeve në Parti, është e domosdoshme të luftohen pa hezitim, sepse bëhen pengesë në realizimin e detyrave për të ardhmen, frenojnë zhvillimin me ritme më të shpejta të ekonomisë dhe sjellin dëme të mëdha, për të cilat ka shumë kohë që po flitet.

Është e domosdoshme, gjithashtu, që organizatat-bazë të Partisë të qëndrojnë në lartësinë e detyrave edhe për sa u përket organizimit socialist të punës, shfrytëzimit të 8-orëshit, uljes së paaftësisë në punë dhe normimit të punës, sepse në këto drejtime vërehen akoma të meta e dobësi.

Në kushtet aktuale, kur shtrohet si detyrë serioze ngritja e rendimentit të punës dhe ulja e kostos, një rëndësi të veçantë merr problemi i mekanizimeve të nëntejshme të proceseve të punës në industri, në bujqësi, në ndërtim e kudo, pa lënë pas dore as ato më të thjeshtat. Kërkohet të bëhet një luftë e fortë nga ana e Partisë për kapërcimin e të gjitha koncepteve frenuese e të pengesave të tjera, me qëllim që puna e dorës, gradualisht, por pa humbur kohë, të zëvendësohet me punën e mekanizuar. Nga një gjë e tillë askush të mos mendojë se do të na shkaktohet papunësi, si në vendet kapitaliste e revizioniste, mbasi te ne të drejtën e pu-

nës e gëzon realisht çdo qytetar i republikës, kështu që asnjëri nuk mund të mbetet pa punë. Duke folur për rëndësinë e mekanizimeve, Stalini i madh ka thënë:

«Të mendosh se, me ritmin që ka marrë puna ndër ne dhe me përpjesëtimet e sotme të prodhimit, mund të bëhet edhe pa mekanizim, — do të thotë të shpresosh ta shterësh detin me lugë»¹.

Në kushtet e reja që janë krijuar në vendin tonë, organizatat-bazë të Partisë e kanë për detyrë që theksin e punës së tyre edukative ta vënë akoma më shumë në të gjitha drejtimet që përmenda më sipër.

Edukimi i njerëzve, shoqe dhe shokë, është një problem i madh dhe jo i lehtë, i gjithanshëm dhe i ndërlikuar. Ai kërkon një punë të diferencuar plot durim, përzemërsi e takt dhe që t'u përshtatet kërkesave e preokupacioneve të punonjësve. Puna individuale në këtë rast, pa ulur vlerën e formave të tjera të edukimit, është më e përshtatshme, por edhe më e lodhshme. Edukimi ideologjik dhe politik i masave, si dhe edukimi teknik i tyre, janë tri gjëra për të cilat duhet të reflektojë dhe të mobilizohet çdo komunist e patriot. Ky edukim duhet të bëhet me baza të shëndosha, në gjerësi dhe në thellësi, që të shërbejë si mjet për veprime aktive në dobi të socializmit dhe jo si një stoli, sa për t'i derdhur fjalët lumë nëpër mbledhje apo seminare.

1. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 13, f. 74.

Ka disa komunistë dhe kuadro që nuk e kuptojnë si duhet rëndësinë e madhe dhe vendimtare të edukimit të njeriut, prandaj, megjithëse me fjalë pretendojnë që punën e edukimit politiko-ideologjik e vënë në plan të parë, kur vjen çështja në praktikë, e kanë më të lehtë «t'i kryejnë punët» vetëm nëpërmjet urdhrash dhe, kur diçka nuk u shkon mirë, e teprojnë me përdorimin pa vend dhe të nxituar të masave administrative. Këta shokë akoma nuk janë të qartë sa duhet se edukimi dhe bindja e njerëzve për drejtësinë e vijës së Partisë i bëjnë ata që të çajnë malet.

Shteti ynë udhëhiqet nga vija e Partisë, e cila, për realizimin e detyrave të ndërtimit socialist, kërkon, në radhë të parë e mbi të gjitha, edukimin dhe bindjen e njerëzve. Populli ynë e ka përqaftuar gjithmonë vijën e Partisë, sepse ajo është bërë një me jetën e tij dhe ka shprehur vullnetin, dëshirat dhe kërkesat e tij. Ligjet, dekretet, vendimet dhe urdhëresat e organeve shtetërore, qofshin me karakter ekonomik, administrativ, penal etj., në shumicën dërrmuese të rasteve, zbatohen nga njerëzit jo për t'iu shmangur pasojave juridiko-administrative që mund të sjellë shkelja e tyre, por me bindje e ndërgjegje të plotë, duke qenë se ato mishërojnë në thelb vijën e Partisë, tek e cila populli ynë ka besim të madh, sepse drejtësinë e saj ai e ka provuar për tri dekada rresht, në ditë të mira e të vështira.

Detyrat shtetërore, qofshin këto në prodhim, në administratë etj., nuk mund të kuptohen të shkëputura nga detyrat e Partisë dhe nuk mund të zbatohen, në qoftë se çdo pjesëtar i shoqërisë sonë nuk e ndien thellë

përgjegjësinë që ka për vënien e tyre në jetë. Asnjëri nuk mund të pretendojë se është në rregull me vijën e Partisë, kur lë pas dore detyrat shtetërore, që s'janë gjë tjetër veçse pasqyrim i vijës dhe i politikës së Partisë. Vija e Partisë së Punës të Shqipërisë përcakton përmbajtjen, karakterin dhe drejtimin e gjithë jetës shoqërore dhe shtetërore. Praktika e ndërtimit të vendit tonë, përcaktimi i rrugëve nëpër të cilat ka kaluar ai, forcimi i rendit të tij është shprehja konkrete e rolit përcaktues të kësaj vije.

Partia dhe populli ynë, i udhëhequr prej saj, kanë arritur shumë suksese në luftën kundër mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja, përveç të tjerave edhe në drejtim të ruajtjes e të administrimit të pasurisë socialiste, por kjo luftë edhe paskëtaj nuk duhet të bjerë për asnjë çast. Konstatohen akoma qëndrime të pakujdeshme, shpërdorime e vjedhje të kësaj pasurie, që dëmtojnë drejtpërdrejt bazën ekonomike të rendit tonë socialist dhe prishin moralin e njerëzve. Për kryerjen e vjedhjeve, në radhë të parë, ka ndikuar mungesa e një pune të shëndoshë ideopolitike, por edhe disa faktorë të tjerë negativë, siç janë mbajtja në punë me përgjegjësi materiale e personave me përbërje të keqe politiko-shoqërore, e njerëzve jo të ndershëm apo të dënuar një herë për përvetësime, cektësia dhe kryerja me vonesë e kontroll-revizionimeve dhe e inventarizimeve fizike, kujdesi i pamjaftueshëm për ruajtjen e objekteve dhe të vlerave pasurore, vendosja si rojë e personave të paaftë fizikisht etj. Në dëmtimin e pasurisë socialiste, me dashje ose nga pakujdesia, sidomos në sektorët e tregtisë, bujqësisë dhe të industrisë, kanë ndi-

kuar edhe mosrealizimi i prodhimit sipas asortimenteve, shkelja e rregullave të magazinimit të mallrave, mosrespektimi i rregullave për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e makinerive, shkeljet e rregullave të sigurimit nga zjarri, mosevidencimi i saktë i debi-kredive etj.

Të gjithë këta faktorë që përmenda dihen, sepse Partia shumë herë na ka tërhequr vëmendjen për ta. Tash unë shtroj pyetjen: Ç'bëjnë disa organizata-bazë partie, komunistët dhe punonjësit e tjerë para këtyre shfaqjeve antisocialiste? Përse nënvleftësohen këto humbje, duke gjykuar me naivitet se nuk kanë shumë rëndësi para fuqisë ekonomike dhe politike të pushtetit tonë? Gjykime të tilla, që nuk thuhën hapur, por kuptohen nga qëndrimet nënvleftësuese dhe nga organizimi i dobët i punës, i sjellin dëme të mëdha Partisë dhe popullit, sepse ndikojnë dalngadalë dhe pa u kuptuar në prishjen e ndërgjegjes së disa njerëzve të paformuar mirë, bile ndonjëherë edhe të disa komunistëve, tek të cilët nuk ka bërë efektin e duhur puna edukative e Partisë.

Ka pastaj edhe raste që shkelen me dashje normat ligjore, me qëllim që «të realizohet» plani! Disa herë siguri i lëndës së parë ose i materialeve nga ana e ndërmarrjeve bëhet jo nga burimet e planifikuara në rrugë shtetërore sipas kontratave, por në rrugën e sëmurë të njohjes personale. Veprime të tilla çojnë në familjaritet, akroballëqe e shoqëri të sëmurë për të gjetur «shokë» ose «të njohur», që të rregullojnë ndonjë punë për blerjen e një malli deficitar, për kryerjen e ndonjë shërbimi sado të thjeshtë etj. Këto qëndrime të papajtueshme me vijën e Partisë dhe me natyrën e

shtetit tonë socialist, që sjellin dëme të pallogaritshme në botëkuptimin dhe konceptet e njerëzve, paraqiten nganjëherë si veprime «të shkathëta» të disa personave që dinë «të luajnë pjesën», që kanë «iniciativë» etj. dhe bile nga disa inkurajohen. Organizatat-bazë të Partisë dhe organet shtetërore të mos lejojnë asnjë veprim apo «iniciativë» të tillë, që bie në kundërshtim me ligjet e shtetit që mbrojnë ekonominë socialiste. Nuk ka asnjë arsye të ndiqen rrugë të tërthorta për realizimin e planit, në qoftë se çdo ndërmarrje lufton si duhet dhe e plotëson detyrën e vet, pa u bërë pengesë për të tjerat. Përse u dashkan njohur njerëzit për t'u kryer ato detyra që ligji, kontratat dhe aktet e tjera i kanë parashikuar drejt pa qenë nevoja për ndërmjetës?

Partia edhe herë të tjera ka kritikuar shfaqjet e huaja, që kanë zënë vend sidomos në disa punonjës të administratave e institucioneve qendrore dhe në rrethe, por nga të cilat nuk përjashtohet as baza. Te disa komunistë, kuadro e punonjës është krijuar një zakon i keq. Po t'i kritikosh e t'u drejtohesh me emër për ndonjë problem, fillojnë të lëvizin e të marrin masa për të ndryshuar gjendjen, por këtë nuk e bëjnë gjithnjë. Prandaj, kur Partia ngre një problem, cilitdo duhet t'i shkojë mendja menjëherë te puna e tij, të mendojë se ç'detyra i dalin në sektorin ku ai punon apo drejton dhe të veprojë me iniciativë për kryerjen e tyre.

Ka edhe ndonjë rast që persona me përgjegjësi të ndryshme, kur gabojnë vartësit janë të rreptë, por kur gabojnë vetë apo kritikohen nga ata për dobësi të tyre në punë, përpiqen t'i kalojnë çështjet lehtë, duke bërë ndonjë «autokritikë», si i thonë fjalës, sa për të kaluar

radhën dhe, po të guxojë ndokush të ngrihet kundër tyre, ata janë gati të marrin masa ndaj kritikuesit, duke përdorur për qëllimin e tyre të keq shumë «arsye justifikuese dhe bindëse». Me një qëndrim të tillë të shtrembër këta njerëz mundohen që me një gur të vrasin dy zogj: nga njëra anë të mbulojnë gabimet e dëbësitë e tyre, nga ana tjetër të frikësojnë vartësit, në mënyrë që, edhe sikur të gabojnë përsëri, këta të fundit të mos guxojnë të flasin më. Për raste të tilla dhe për të tjera që përmenda më parë, sado të rralla qofshin, duhet të veprojnë më energjikisht vetë organizatat-bazë të Partisë, në radhë të parë, por të aktivizohet më mirë edhe kontrolli punëtor e shtetëror, të mobilizohet kontrolli i masave.

Këto kontrole kanë dhënë fryte të mira në punë, por duhet të njohim se nuk kanë qenë kudo e kurdoherë sa duhet objektive e të rrepta, sidomos ndaj të metave, gabimeve e shkeljeve të kryera nga persona me përgjegjësi. Prandaj organizatat-bazë të Partisë dhe organet shtetërore të mos ngurrojnë aspak në marrjen e masave të drejta kundër cilitdo që, me gjithë këshillimet e vërejtjet që i janë bërë, prek normat e Partisë e të moralit të lartë proletar dhe shkel ligjet, vendimet e urdhëresat e organeve shtetërore në sferën e marrëdhënieve të punës, të prodhimit etj., ndryshe do t'i lëmë shteg përhapjes së degjenerimit të njerëzve, prishjes së ndërgjegjes së tyre, hatëreve e akrobllëqeve, shfaqje këto që rrezikojnë diktaturën e proletariatit. Në qoftë se komunistët, para, gjatë dhe pas mbledhjeve të organizatave-bazë ku ndodhin shfaqje të tilla, nuk i mbrojnë me forcë normat e Partisë dhe ligjet e shtetit,

do të na krijohet një gjendje e sëmurë dhe aktivitetit të gjallë, vrullit revolucionar, që ekziston te ne, do t'i vihen gurë në rrota.

Është e vërtetë se këto janë disa shfaqje të veçura dhe nuk janë karakteristikë e jetës dhe e punës sonë, por Partia jonë është mësuar të jetë e rreptë ndaj gabimeve dhe të metave që vërtetohen, sado të vogla qofshin, ajo gjithnjë u ka dalë dhe u del me kohë punëve përpara, prandaj vija e saj e drejtë ka shkëlqyer dhe shkëlqen kurdoherë si drita e diellit dhe sukseset rriten nga dita në ditë në tërë Shqipërinë.

Shokë dhe shoqe,

Tashmë, për të gjithë komunistët dhe mbarë popullin tonë janë të njohura projektdirektivat e Kongresit të 6-të të PPSH mbi planin e pestë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës së Republikës Popullore të Shqipërisë për vitet 1971-1975. Më lejoni të përmend disa nga shifrat më kryesore të këtij plani që kemi filluar, për të kuptuar më mirë madhësinë e tij, detyrat serioze që na dalin dhe punët e mëdha që na presin. Në vitin 1975 prodhimi i përgjithshëm industrial do të jetë 60-65 për qind më i madh kundrejt vitit 1970, me një ritëm mesatar vjetor prej 10,6 për qind. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor në pesëvjeçarin e pestë, kundrejt pesëvjeçarit të katërt, për të pesë vjetët të marrë së bashku, do të rritet 50-55 për qind. Në krahasim me pesëvjeçarin e katërt, në pesëvjeçarin e pestë vëllimi i investimeve do të rritet 70-75 për qind.

Për të pesë vjetët e pesëvjeçarit të pestë të marrë së bashku, investimet kapitale do të jenë më të mëdha se investimet e kryera gjatë dekadës së fundit 1960-1970. Në vitin 1975 kundrejt vitit 1970 të ardhurat kombëtare do të rriten 55-60 për qind.

Ngritja e rendimentit të punës, gjatë këtij pesëvjeçari, do të jetë faktori kryesor për rritjen e prodhimit shoqëror në të gjitha degët e ekonomisë. Nga kjo ngritje do të sigurohet rreth 70 për qind e rritjes së prodhimit shoqëror, rreth 56 për qind e rritjes së prodhimit industrial dhe rreth 90 për qind e rritjes së vëllimit të ndërtimeve. Në bujqësi rritja e rendimenteve do të jetë rruga kryesore për shtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale, nga e cila do të sigurohet rreth 80 për qind e rritjes së prodhimit të përgjithshëm bujqësor për të gjithë pesëvjeçarin e pestë.

Pesëvjeçari i pestë shtron detyra mjaft të ngjeshura, por plotësisht të realizueshme. Ekonomia jonë popullore po ecën pa ndërprerje drejt intensifikimit, gjë që do të thotë ritme të larta rritjeje, rendiment shoqëror më i lartë, efektivitet më i madh i prodhimit material, përdorim me nikoqirllëk i burimeve të punës, i vlerave materiale e financiare të riprodhimit të zgjeruar socialist. Ndryshimet e mëdha sasiore dhe cilësore që duam të arrijmë gjatë këtij pesëvjeçari, kërkojnë një mobilizim total të të gjithë popullit shqiptar. Ato kërkojnë të bëhet një kthesë në përmirësimin e mëtejshëm të metodës së drejtimit dhe të organizimit të ekonomisë e të kulturës popullore, të ngrihet në një shkallë më të lartë përvetësimi i ideologjisë sonë revolucionare, i shkencës dhe i teknikës. Në këtë varg detyrash,

një rëndësi të veçantë marrin problemet e kuptimit më të thellë e të gjithanshëm të revolucionit tekniko-shkencor dhe të zbatimit në një shkallë më të gjerë të detyrave që rrjedhin prej tij në stadin aktual të zhvillimit tonë. Lidhur me këto çështje, dëshiroj të ngre disa probleme që kanë dalë nga eksperiencia e punës së Partisë sonë dhe e masave punonjëse në këtë revolucion tekniko-shkencor.

Ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit bazohet në zhvillimin e vazhdueshëm, të pandërprerë, progresiv, koherent të ekonomisë, të kulturës, të shkencës dhe kuptohet në lidhjen e tyre të ngushtë të bazuar në filozofinë marksiste, në dialektikën materialiste të zhvillimit.

Në vendin tonë, nën udhëheqjen e Partisë, janë bërë hapa të mëdhenj në shkencë, në zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës. Këtë e provojnë rezultatet e arritura. Duke u mbështetur mbi këto rezultate, ne do të vazhdojmë më me vrull e me suksese akoma më të mëdha në punën tonë, për arsye se gjatë viteve të kaluara në luftën për kapërcimin e prapambetjes së madhe, e mungesave të panumërta, subjektive dhe objektive, kemi fituar një eksperiencë të pasur, për arsye se tash gjendja jonë është më e mirë se më parë, kemi kuadro të shumtë aktivë e të ngritur, ku mund të mbështetet fort e gjithë puna jonë. Këta kuadro kanë fituar dituri dhe përvojë në punë, në prodhim, në organizim, në shkencë, në ekonomi e në kulturë dhe në drejtimin e tyre.

Problem i madh për Partinë është që masat t'i bëjë të ndërgjegjshme, se ajo çka është fituar duhet të

zhvillohet më tej, duhet thelluar e perfeksionuar akoma dhe të mos qëndrohet në vend numëro, duke u mbuar me një vetëkënaqësi të sëmurë mikroborgjeze. Ajo çka është fituar e thelluar çdo ditë duhet të shërbejë për të krijuar të mira materiale për popullin dhe e gjithë kjo të krijojë, të brumosë dhe të çelikosë në popull brez pas brezi traditën se në jetë duhet punuar, duhet mësuar, duhet krijuar, por jeta gjithashtu duhet gëzuar.

Në të gjitha këto drejtime Partia duhet të punojë fort e në mënyrë të organizuar. Asnjë sukses nuk duhet të na dehë për të mos parë të metat dhe gabimet, ose për të qëndruar në vend. Programet e punëve, planet e studimeve, që shtron Partia dhe Komiteti Qendror përpara popullit dhe që kërkojnë zgjidhje të drejtë, janë shumë të mëdha. Ato janë probleme imediate dhe me perspektivë që lypin një mobilizim total të forcave njerëzore, fizike, mendore dhe materiale.

Puna shkencore dhe zhvillimi i teknikës në vendin tonë, ose me fjalë të tjera revolucioni tekniko-shkencor përparon në rrugë të drejtë, për arsye se teknika dhe shkenca te ne është rezultati i revolucionit proletar të armatosur që rrëzoi pushtetin e vjetër shfrytëzues borgjez, kapitalist dhe vendosi diktaturën e proletariatit. Pra, populli ynë e ka plotësisht të qartë se nuk është ndonjëfarë revolucioni tekniko-shkencor, siç pretendojnë kapitalistët dhe revizionistët modernë, ai që do të shërojë plagët e kapitalizmit, që do ta reformojë atë, që do të zhdukë klasat dhe antagonizmat klasorë në botën kapitaliste, apo kontradiktat e thella antagoniste në vendet ku janë në fuqi klikat revizioniste. Ai që do ta shkatërrojë pushtetin e borgjezisë kapitaliste dhe të

revizionistëve modernë, për të vendosur socializmin, është dhe mbetet revolucioni proletar dhe jo revolucioni tekniko-shkencor.

Çështja e dytë e rëndësishme është që populli shqiptar, duke dalë nga një prapambetje e madhe, me punën e vet këmbëngulëse dhe nën udhëheqjen e drejtë të Partisë, arriti rezultate shumë të mëdha në zhvillimin e tij të gjithanshëm. Gjatë këtij zhvillimi ai pa dhe u bind vetë se feudalët e borgjezia, që e shtypnin më parë, se aleatët e tyre, që gjoja e ndihmonin dhe që më vonë pushtuan vendin tonë, përparimet në shkencë e në teknikë që kishin arritur në vendet e tyre kapitaliste i përdorën për shfrytëzimin e tij më të egër. Ai në eksperiencën e vet pa sa të vërteta janë tezat e Marksit, sipas të cilit këto përparime u shërbejnë kapitalistëve për të kolonizuar e robëruar popujt, për të shtypur e shfrytëzuar deri në palcë punëtorët dhe punonjësit. Të njëjtin fenomen konstatoi populli shqiptar edhe kur revizionistët sovjetikë morën fuqinë në Bashkimin Sovjetik dhe filluan sabotimet në vendin tonë, për të mos folur për revizionistët jugosllavë, të cilët ishin prapa për vete në fushën e shkencës e të teknikës, ndërsa genë të zotë në sabotime.

Të mos marrim, për shembull, arsimin dhe kulturën, fusha në të cilat populli shqiptar me forcat e veta ka bërë kaq përparime kolosale, të mos marrim bujqësinë tonë socialiste, ku janë vërtetuar kaq ndryshime të mëdha pozitive nga e kaluara, por le të marrim vetëm çështjen e zhvillimit të minierave dhe të nxjerrjes së mineraleve në vendin tonë. Vetëm po të krahasojmë shfrytëzimin barbar, sasinë e cilësinë e pu-

nës dhe metodat që përdorte Italia fashiste, që kishte pushtuar vendin tonë, me sasinë e cilësinë e punës dhe metodat e klasës sonë punëtore pas Çlirimit, del qartë forca revolucionare e popullit. Por le të bëjmë krahasimin e po asaj periudhe, gjatë së cilës revizionistët sovjetikë pretendojnë se na ndihmuan aq shumë, me periudhën e mëvonshme, kur ne i shporrëm ata nga vendi ynë, dhe do të shohim çfarë hovi të madh morën nxjerrja e mineraleve, çfarë zhvillimi morën kërkimet gjeologjike dhe minierat në vendin tonë.

Çështja e tretë e rëndësishme është që Partia lëshoi kushtrimin dhe mori masat qysh në fillim që arsimit dhe kultura të bëheshin të masave, që shkencat dhe teknikat të bëheshin të masave dhe jo të bëheshin e të mbeteshin pronë e disave, «e korifejve të shkencës e të diturisë», siç quhen ata nga kapitalistët dhe revizionistët.

Masat e popullit tonë që fituan revolucionin, krijuan besimin në vetvete se ato do të fitonin në çdo betejë që do të ndërmerreshin, se ato do ta ndërtonin vetë Shqipërinë socialiste dhe për këtë atyre u duhej të mësonin, t'i futeshin shkencës dhe teknikës, të bënin revolucion në çdo fushë, pse ishin ata vetë ndërtuesit e fateve të tyre. Masat e gjera të popullit tonë, të udhëhequra dhe të edukuara nga Partia jonë marksiste-leniniste, luftojnë tash në të gjitha frontet për të mbushur boshllëqet që na ka lënë e kaluara, për të arritur dhe për të tejkaluar nivelet botërore në të gjitha ato të dhëna, ku vendi ynë duhet të japë dhe njëkohësisht t'u tregojë popujve drejtësinë, vitalitetin revolucionar të marksizëm-leninizmit dhe epërsinë e sistemit socialist mbi atë kapitalist.

Karakteristikë dalluese e njerëzve tanë është se, përpara gjendjes së vajtueshme të trashëguar nga e kaluara në shkencë e në teknikë, ata nuk i mbuloi pesimizmi, ata nuk lidhën duart dhe të thoshin se s'mësojmë dot, se vetë s'bëjmë dot gjë dhe të ngjallej e të zhvillohej kështu kulti i nënshtrimit tek «i huaji i mësuar». Njeriu ynë iu përvesh punës dhe mësimit, ai kapërceu shumë pengesa, «të huajin e mësuar» e trajtoi me xhentileci si mik e vëlla, kur ai ishte i tillë, e shih-te me mosbesim, kur i sillej me mosbesim dhe i tregoi vendin kur ai u soll si armik.

Ne jemi marksistë-leninistë dhe si të tillë kemi etje dhe respekt të madh për diturinë dhe shkencën përparimtare botërore, për teknikën e përparuar botërore dhe do të përpiqemi me të gjitha mjetet që atë ta marrim, ta përvetësojmë dhe ta vëmë në shërbim të popullit. Ne nuk kemi qenë dhe nuk jemi kundër shkencës dhe teknikës moderne botërore, po jemi dhe do të luftojmë pa mëshirë kundër ideologjisë borgjeze që i shpërdoron shpikjet e shkencës dhe të teknikës, që shkencën dhe teknikën i përdor për skllavërimin e popujve, për luftëra barbare e grabitqare imperialiste, për shantazhe e kërcënime.

Ne e dimë se shkenca është një fushë jashtëzakonisht e gjerë që nuk mund të përvetësohet dot aq shpejt, në atë thellësi dhe në atë gjerësi të përpjesëtimeve që ajo ka marrë. Për këtë qëllim duhet shumë luftë e përpjekje. Ne e shtrojmë dhe e kuptojmë çështjen që punën shkencore të mos e shohim si diçka në vetvete, por të lidhur ngushtë me praktikën tonë revolucionare dhe është pikërisht për këtë që roli i masave

bëhet vendimtar në përparimin frontal të shkencës e të teknikës.

Rritja e besimit në kuadrot dhe në punonjësit për vlerën e asaj që dinë dhe, duke u mbështetur në të, përpjekjet që bëjnë ata për të vazhduar të mësojnë, të punojnë, të eksperimentojnë dhe të përgjithësojnë, bëjnë që të shtohen gjithnjë e më shumë dijet e tyre shkencore e kulturore, që në vend të zgjidhen shumë probleme me forcat tona, pavarësisht se në vendet e tjera ato probleme mund të jenë zgjidhur dhe janë zgjidhur më parë, kurse ne, duke qenë të detyruar nga bojkotimi i egër kapitalisto-revizionist që na është bërë dhe po na bëhet, nuk mund të përfitojmë nga to. Shtetet kapitalisto-revizioniste nuk të japin as gjënë më të vogël pa llogaritur fitime të mëdha materiale dhe politike për veten e tyre.

Kuptimi i drejtë i zhvillimit të vendit, ndërtimi me sukses i socializmit dhe nevojat e mëdha që kemi, kanë qenë një preokupacion i madh i të gjithëve, që u shndërrua në një fenomen masiv kudo ku punohej. U çelën horizonte të gjera për njerëzit, horizonte pune e mësimi, u krijuan mundësitë teknike dhe materiale për një zhvillim të tillë të gjerë e të kombinuar. Vazhdimisht u krijuan detyra të reja për t'u zgjidhur në situata të reja. Ekonomia jonë zgjerohet vazhdimisht, kërkojnë zgjidhje të reja struktura dhe organizimi i saj, kërkohet vendosja e metodave të përparuara shkencore e teknologjike, kërkohen, gjithashtu, kurdoherë forma pune të përshtatshme për të ulur shpenzimet dhe për të arritur rendimente më të larta.

Të gjitha këto kërkesa dhe nevoja i detyrojnë nje-

rëzit tanë t'i futen shkencës. Për ta konceptet «hekur» ose «çelik» nuk janë fjalë të thjeshta, ata janë të detyruar të mësojnë përbërjen e tyre, cilësitë e ndryshme të tyre dhe si arrihen këto cilësi, ku përdoren këto metale me të tilla cilësi dhe ku nuk përdoren. Dhe kështu ndodh për çdo gjë e për çdo punë. Njerëzit po thellohen në mendime, ata u përvishen fushave të ndryshme të diturisë e të shkencës. Por nga një zhvillim i tillë i forcave prodhuese lindin e zhvillohen marrëdhënie ekonomiko-shoqërore të reja që duhen studiuar e sqaruar, që kërkojnë marrjen e masave të përshtatshme me këto ndryshime për të kapërcyer kontradiktat dhe anomalitë që krijon zhvillimi, për të kontrolluar proporcionet e rregullta që duhet të ndjekë ky zhvillim.

Është e qartë se këto ndryshime ngrenë ndërgjegjen socialiste të punonjësve, por kjo, natyrisht, ngrihet më me vonesë se ndryshimet materiale, prandaj, në këtë çështje kaq të madhe, këto pluse të mëdha duhet të shërbejnë njëkohësisht për të revolucionarizuar ndërgjegjen dhe jo për ta borgjezuar dhe për ta lënë që ta mbulojë pluhuri i vetëkënaqësisë mikroborgjeze, i fodullëkut, i burokracisë, i rutinës dhe i dembelizmit.

Është për këto arsye që ne duhet të thellohemi më tej në revolucionin tonë ideologjik e kulturor, në revolucionin tekniko-shkencor. Atë që kemi arritur ta perfeksionojmë, ta zhvillojmë: të nxjerrim qartë detyrat që duhet të shtrojmë, të përcaktojmë qartë objektivat e mëtejshëm, imediatë dhe të perspektivës, që dëshirojmë të arrijmë, të përcaktojmë metodat më të drejta të punës shkencore që duhet të përdorim për zgjidhjen e

problemeve dhe të përcaktojmë mjetet kryesore e vendimtare që nevojiten. Ne duhet të bëjmë mobilizimin e madh të forcave që do të punojnë, në mënyrë që cilido të vërë gurin e vet në ngritjen e kësaj vepre të madhe dhe ta ndiejë veten përgjegjës për atë çka jep. Dhe ajo që jep, qoftë kjo edhe e vogël, ka rëndësinë e vet, prandaj detyra e tij është ta shtojë dhe ta kualifikojë çdo ditë e më mirë kontributin e tij tekniko-shkencor.

Por rezultatet dhe përparimet nuk arrihen pa punë, pa përpjekje, pa sakrifica, pa mësuar. Duhet të njohim se te ne studiohet akoma pak, nuk bëhen përpjekje për gjetjen e metodave më të mira për studim, nuk shfrytëzohet racionalisht koha në dispozicion, mjetet në dispozicion nuk përdoren si duhet «për t'u nxjerrë vaj», siç thotë populli. Shumë njerëz mendojnë se, duke qenë në regjimin socialist, jo vetëm 8-orëshin e detyruar mund të mos e plotësojnë me rendiment të plotë, por edhe ligjin mund ta thyejnë e të punojnë më pak, se mund të ecet me shumë pak lexim ose aspak, duke u mjaftuar me ato njohuri të kufizuara që arsyetojnë qenien në punë dhe marrjen e rrogës.

Ka njerëz, në qytete e në fshatra, që pak libra zënë me dorë pas punës, ata lënë t'u kalojë koha e lirë me llafe të kota, në vend që t'i caktojnë vetes detyra studimi. Them studimi, pse çështjen nuk e kuptoj vetëm, siç mendojnë disa, që duke kënduar gazetën o ndonjë roman, e quajnë këtë diçka të jashtëzakonshme. Disa japin arsye jo të bazuara: jemi të lodhur, thonë, kemi familje, s'kemi vend ku të punojmë e të mësojmë. Njerëzit që i vënë vetes detyra për t'i shërbyer atdheut, për të punuar, për të mësuar, për të eksperi-

mentuar, për ta vlerësuar minutën flori, gjejnë edhe kohën, edhe formën, edhe metodën, edhe vendin për t'i kryer këto detyra. Jo vetëm në vendin tonë që i kanë të gjitha mundësitë për të studiuar, po në çfarëdo kushtesh të vështira njerëzit me vullnet të fortë punojnë me durim të madh në këtë drejtim. Le të kujtojmë këtu punën kolosale e këmbëngulëse dhe vullnetin e çeliktë në studim të mësuesit tonë të madh, Karl Marksit, i cili, me gjithë kushtet e vështira ekonomike dhe pengesat e shumëllojshme në punën e tij, krijoi dhe i la njerëzimit një thesar të madh zbulimesh e dijes për transformimin e shoqërisë, për përmbysjen e kapitalizmit, për zhdukjen e shfrytëzimit, për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit. Le të kujtojmë tash edhe të famshmit Pier dhe Mari Kyri që zbuluan radiumin për njerëzimin. Ata vetë, duke u përpjekur natë e ditë, kur ngrënë e kur pa ngrënë, se s'i ndihmonte njeri, me një këmbëngulje të jashtëzakonshme, punuan katër vjet me radhë pa pushim në një garazh, ku ç'frynte dhe binte jashtë futej brenda, me mjete e lëndë primitive, për të përpunuar me qindra tonelata peshchland, nga të cilat arritën të nxirrnin atë që donin, radiumin, dhe sa? Vetëm një të dhjetën e gramit.

Prandaj jo të shikohet orë e çast sahati për të lënë sa më parë tornon, laboratorin, shkollën, parcelën, siç bën ndonjëri, por të mendohet më shumë për rezultatet e punës, pse në socializëm njerëzit nuk duhet të bëjnë një punë shkel e shko, ose të studiojnë në mënyrë primitive, duke i mbështetur studimet e veta në horizonte shkencore të ngushta.

Te ne janë bërë dhe po bëhen kërkime shkencore,

të cilat, natyrisht, do të vazhdohen dhe do të dalin akoma më të përsosura, sepse niveli i njerëzve tanë që merren me shkencën dhe me kulturën po ngrihet. Ne kemi njerëz të talentuar në të gjitha disiplinat, por nuk mund të themi se kërkimet shkencore të ne janë të shumta dhe të gjitha të kualifikuara. Mundësitë janë që ato të bëhen me shumicë të tilla për vendin tonë, që të mos qëndrojnë prapa atyre të botës shkencore të jashtme.

Neve na vihet detyrë e madhe të bëjmë studime dhe kërkime shkencore të shumta në lëmin e bujqësisë, në të gjitha degët e saj. Këto studime dhe kërkime lypin nga ana e shkencëtarëve tanë njohjen e fitoreve të arritura nga shkenca botërore në këtë lëmë të gjerë. Por kjo nuk është as e mjaftueshme, as e zbatueshme, në rast se nuk u futemi thellë të fshehtave karakteristike të botës sonë bujqësore në kompleksitetin e tyre, në qoftë se nuk i studiojmë këto karakteristika nëpërmjet një eksperimentimi të gjerë e shkencor, nga i cili të nxjerrim konkluzione që mund të krahasohen e të ballafaqohen me të dhënat e shkencës e të agroteknikës moderne. Kjo do të na bëjë ne që, në kushtet shumë të favorshme të një ekonomie socialiste, të krijojmë dhe të zhvillojmë një bujqësi të atillë, ku të gjejnë zbatim të plotë dhe të gërshetohen në mënyrë të harmonishme politika, organizimi modern socialist i punës, agroteknika e lartë bujqësore dhe raportet shoqërore nga më të përparuarat. Thellimi në shkencat bujqësore, si në të gjitha shkencat e tjera, nuk është një qëllim në vetvete, por bëhet për të marrë nga toka dhe nga bagëtitë sa më shumë prodhime bujqësore e blegtorale për ushqij-

min e njerëzve tanë, për ushqimin e bagëtive dhe lëndë të parë për fabrikat, për të marrë nga kafshët sa më shumë qumësht dhe nënprodukte të tij, mish, lesh e lëkurë dhe forcë të punës e forcë tërheqëse etj.

Prandaj, krahas me tendosjen fuqimisht të forcave tona në prodhimin bujqësor, në tematikën për bujqësinë ne duhet të bëjmë njëkohësisht studime të mëtjeshme shkencore të thella, për sot dhe për nesër, për organizimin e përsosur të punës në kooperativat bujqësore, në lëmin e agroteknikës, të kulturave të ndryshme, të zooteknisë, të frutikuturës, të ujitjes etj., etj. Ne duhet të bëjmë, gjithashtu, studime të mëtjeshme për organizimin më të mirë të sistemit financiar, për marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore që krijohen dhe do të krijohen në kooperativat me zhvillimin e tyre të pandërprerë ekonomik, teknik, kulturor në gjirin e përgjithshëm të ekonomisë sonë socialiste, në marrëdhëniet me shtetin etj., etj.

Ngritja e industrisë moderne te ne dhe zhvillimi i madh që kanë marrë dhe që po vazhdojnë të marrin pa ndërprerje të gjitha degët e saj, i ka dhënë dhe do t'i japë një hov të madh sasiore e cilësor zhvillimit teorik dhe aplikimit të shkencës e të teknikës në vendin tonë. Punëtorët, mjeshtret dhe kuadrot e lartë të talentuar kanë dhënë dhe po japin prova të një zotësie e pjekurie të madhe, ata kanë ngritur gjithë këto objekte me duart dhe me zotësinë e tyre, kanë përvetësuar proceset moderne të prodhimit, kanë bërë një sërë përmirësimesh pozitive në to. Fusha të gjera studimi, eksperimentimi dhe aplikimi u janë hapur edhe gjithë punonjësve të tjerë të vendit tonë.

Këto ditë të gjithë mësuam me hidhërim se në ballë të luftës për ndërtimin e socializmit ranë dy punëtorë të shquar, dy heronj të punës socialiste të vendit tonë, dy komunistë dhe luftëtarë besnikë të ideve të mëdha të socializmit, minatori nga Mirdita Frrok Kolë Kaçorri dhe shoku kinez, brigadieri i montimit të antenave Çan Pao Y, i cili si internacionalist punoi pa u lodhur derisa dha jetën për ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Prandaj për të nderuar kujtimin e tyre propozoj të ngrihemi të gjithë në këmbë dhe të mbajmë një minutë heshtje. . .

I paharruar do të mbetet për ne kujtimi i tyre!

Por me gjithë këto suksese dhe këtë gjendje të favorshme për çështjen e studimit e të aplikimit të shkencës dhe të teknikës, prapë ne duhet të jemi realistë dhe të njohim se njerëzit tanë të shkencave teoretike dhe ata të aplikimit punën e tyre në këto drejtime nuk e gërshetojnë si duhet, nuk janë si duhet e kurdoherë të azhurnuar me zhvillimin e shkencës moderne në disiplinat e tyre dhe në ato të lidhura me to, nuk bëjnë sa duhet përpjekje për një kualifikim më të madh e të vazhdueshëm. Është e vërtetë se atje ku ka përpjekje ne shohim edhe iniciativa të lavdërueshme, por shumë herë vazhdohet metoda dhe fryma artizanale nga punonjësit që nuk shkojnë as me ambientin, as me kohën, as me kërkesat e nevojat që na paraqiten. Ne kemi forca shkencore, teknike dhe materiale të mira që, po t'i gjallërojmë më tej, t'i organizojmë dhe t'i udhëheqim si duhet, t'i dëgjojmë dhe t'i ndihmojmë më shumë, do të na japin mundësi të bëjmë hapa më të mëdhenj përpara. Prandaj t'i përvishemi punës me

besim dhe me forca të shumëfishuara, në mënyrë masive dua të them.

Ne të kemi kurdoherë parasysh se duhet të bëhet dhe të ekzistojë gjithnjë lidhja dhe vartësia reciproke e shkencës dhe e teknikës me prodhimin dhe e gjithë kjo lidhur ngushtë me politikën dhe ideologjinë e Partisë, duhet të ekzistojë, pra, kurdoherë bashkëveprimi i ngushtë i tyre, harmonizimi, kushtëzimi nga njëri-tjetri dhe jo të shkëputen.

Ne duhet të kemi parasysh që të ekzistojnë kurdoherë lidhjet e ngushta të teorisë dhe të eksperimentimit shkencor dhe lidhjet e këtyre me prodhimin, me zgjidhjen e problemeve dhe të kërkesave imediate që i dalin këtij, por edhe me zgjidhjen e problemeve të perspektivës që nuk duhen lënë pas dore, por, përkundrazi, duhen aktivizuar.

Partia dhe të gjithë punonjësit e shkencave të ndryshme, në zbatimin dhe në zhvillimin e shkencave dhe të teknikës duhet të dinë çka hyn në sferën e studimit dhe të zhvillimit dhe çka nevojitet në atë të aplikimit e të zbatimit, për t'u parë atyre frytet sa më shpejt. Kjo është e domosdoshme, mbasi ekziston rreziku i studimeve të cekëta, i moskoordinimit e i mosdhënies së ndihmës reciproke qendrave të ndryshme të një sektori ose të sektorëve të ndryshëm, moskomunikimi i organizuar dhe në kohën e duhur i studimeve dhe i përfundimeve të eksperimenteve. Këto sjellin me vete humbje kohe dhe materiale në një punë nganjëherë të panevojshme, nganjëherë paralele, ku realizimet nuk shfrytëzohen me shpejtësi në të gjithë sektorët ku duhet, që krijon ndjenjën e konservatorizmit, të një-

farë monopolizimi dhe kryelartësie tek ata kuadro shkencorë që arrijnë rezultate shkencore.

Sa më të përcaktuara të jenë problemet shkencore, aq më mirë do të jetë. Kjo duhet t'u përshtatet nevojave të ekonomisë dhe të kulturës, tash dhe në perspektivë, kjo duhet të jetë dhe të bëhet e koordinuar. Forcat shkencore dhe mjetet financiare të mos harxhohen pa kritere të shëndosha, pa rentabilitet për ekonominë dhe për kulturën socialiste, të mos lejohen paralelizma në tema, në studime dhe në eksperimente (sidomos në ato të kushtueshmet). Prandaj çdo gjë na imponon dhe lyp forcimin e lidhjes së ngushtë dhe koordinimin e planeve, të punëve, të studimeve dhe të eksperimentimeve, të shkollave të larta, të laboratorëve të ndryshëm, të institucioneve etj., me prodhimin, me byrotë teknologjike, projektuese, me këshillat shkencorë në uzina, në kooperativa e ferma bujqësore. Këtu duhet një organizim i madh, një harmonizim, një punë që mund të quhet me forca të përqendruara, por në shumë drejtime që synojnë në një pikë: ndërtimin me sukses të socializmit në të gjitha pjesët e tij përbërëse.

Byrotë teknike, projektuese, këshillat shkencorë dhe të gjitha bërthamat e tjera të këtyre llojeve që ngrihen, të mos mendohet se janë organizma që «duhen ngritur për t'u ngritur» dhe të fillojmë kështu të ngremë të tillë pa kritere të shëndosha dhe ku nuk është e nevojshme. Ata, gjithashtu, të mos mendohet për t'i mufatur me një mori kuadrosh të zotë, për të cilët ka nevojë prodhimi, zbatimi dhe eksperimentimi, gjoja për të zhvilluar në to një punë shkencore. Në këtë çështje duhet të jemi kurdoherë shumë të kujdesshëm.

Këta organizma që po ngremë nuk duhet të jenë formalë. Ngritjen e tyre e kërkon zhvillimi dhe ata duhet të shtrojnë dhe të zgjidhin probleme jo të vogla, të mos merren me zgjidhjen e cikërrimave, të cilat i ka për detyrë dhe është e mundur t'i bëjë vetë punëtori, kolektivi punonjës, reparti ose brigada, pa kaluar fare nga byroja teknike.

Puna në këta organizma shkencorë jo vetëm duhet të bëhet e planëzuar dhe me plot përgjegjësi nga ata njerëz që marrin pjesë në ta, por këta duhet t'i vënë detyra të mëdha vetes, të ngrenë kurdoherë e më shumë dijet e tyre, të azhurnohen me të dhënat e shkencës teorike dhe të aplikimit, të jenë të përpiktë shkencërisht me rezultatet që dalin nga duart e tyre dhe të qëndrojnë kurdoherë në radhë të parë si pionierë të shkencës, për ta përhapur këtë në masat e punonjësve të kolektivit ku punojnë, të nxitin te këta punonjës interesimin për të lexuar, studiuar e kuptuar punën shkencore, që të mund ta aplikojnë atë drejt dhe ta zhvillojnë më tutje. Prandaj njerëzit e këtyre organizmave shkencorë këta nuk duhet t'i konsiderojnë si kullat e tyre të fildishta.

Organizatat e Partisë dhe çdo komunist veç e veç duhet të kuptojnë thellë direktivat e Komitetit Qendror ose ato të komitetit të Partisë të rrethit, të kuptojnë se këto direktiva nuk mund të zbatohen si duhet pa u zbërthyer dhe pa u kuptuar nga masat, duke filluar nga punëtori i thjeshtë e deri te specialisti më i lartë. Komunisti, në radhë të parë, e ka për detyrë partie ta kuptojë thellë direktivën dhe të përgatitet fort për ta zbatuar atë. Por zbatimi i mirë lyp zbërthim,

organizim e marrje masash. Ka nga ata komunistë që nuk u bëhet shumë vonë dhe thonë «ka kush mendon», «unë jam vetëm komunist, «portier» në kombinat dhe aq më bën puna shkencore». Partia mund t'i thotë në çdo rast atij komunisti «portier»: shko në byronë teknike, ashtu sikundër i tha në kohën e luftës një të tilli portier 18-vjeçar të merrte komandën e një batalioni. Natyrisht në rast se komunisti ynë aktual portier ka rënë në gjumë dhe më tund derën, ai nuk bën as për portier, pa lëre të jetë komunist.

E prura këtë shembull për të theksuar se komunisti duhet të dallojë nga masa për shumë cilësi, ai duhet të jetë në ballë të punës, të luftës, të organizimit, të krijimit, të sakrificës, ai të dijë të bashkëpunojë ngushtë, të nxitë, të inkurajojë, të shtyjë përpara njerëzit e përparuar, njerëzit pa Parti, njerëzit që zotërojnë teknikën dhe specialitetin që atij komunisti i mungojnë. Po të veprojnë në mënyrë të tillë plot gjallëri dhe dinamizëm, plot takt e dashamirësi, komunisti edhe sikur të mos jetë shumë i mësuar fiton zemrat e njerëzve, masat do ta duan, do ta ndjekin dhe do të krijojnë një besim të madh te Partia, sepse kjo përbëhet prej anëtarëve të saj.

Kur t'i kryejnë kështu detyrat komunistët, atëherë mund të thuhet se në krye të punëve qëndron Partia. Partia nuk qëndron në krye vetëm për arsye se bën një mbledhje një herë në muaj, por se mbledhjet marrin vendime, këto zbërthehen dhe zbërthehen deri në fund në fushat e praktikës e të teorisë dhe se anëtarët e saj janë në ballë të luftës, në ballë të masave, në ballë të sakrificave për t'i zbatuar plotësisht këto vendime në jetë.

Nga ana tjetër, të gjitha udhëheqjet e çdo grade, qofshin ato të Partisë, të pushtetit apo të ndërmarrjeve ekonomike, duhet t'u vënë mirë veshin dhe të diskutjnë vendimet e problemet me komunistët e bazës dhe me punonjësit, pse disa herë nuk vlerësohen si duhet mendimet, studimet, sugjerimet, vërejtjet e tyre etj., lidhur me gjithë aktivitetin tekniko-organizativ të ndërmarrjes e të kooperativës, nuk vlerësohen si të dhëna nga më të rëndësishmet që ndikojnë në progresin, në fitimin ose, sipas rastit, në humbjen e në çorganizimin e ndërmarrjes.

Prandaj del problemi i rëndësishëm që gjithsecili të kryejë detyrën që i përket me kompetencë të plotë por edhe me përgjegjësi të plota. Të mbajë përgjegjësi për punën e tij dhe të japë llogari për të, por të kërkojë, gjithashtu, llogari për punën e të tjerëve, sepse ai ka përgjegjësi edhe për atë. Këto të drejta dhe detyra është e nevojshme të përcaktohen si duhet në njerëzit e punës dhe të kontrollohet vazhdimisht zbatimi i tyre i drejtë. Ata njerëz që përpara vështirësive e pengësive orvaten t'ua lëshojnë fajet dhe përgjegjësinë të tjerëve, ndërsa, kur është rasti për të marrë lavdërime, janë nga të parët që dalin mbi ujë, nuk duhet të lejohen.

Shokë dhe shoqe,

Sot kur në botë revolucioni është në ngjitje, popujt, duke luftuar me armë, me greva, me demonstrata e me të gjitha mënyrat kundër shtypësve, imperialistëve, socialimperialistëve dhe reaksionit botëror, janë bërë e po bëhen çdo ditë e më të ndërgjegjshëm për të

njohur e për të kuptuar se ku qëndrojnë armiqtë e tyre dhe cilët janë miqtë që i ndihmojnë. Republika Popullore e Shqipërisë bën një luftë të ashpër e të pamposhtur kundër imperializmit amerikan, revizionizmit modern sovjetik dhe satelitëve të tyre. Lufta për socializmin dhe revolucionin, përkrahja e vendosur e luftës së popujve të botës e ka ngritur shumë prestigjin e Shqipërisë socialiste, të Partisë dhe të Qeverisë së saj.

Republika Popullore e Shqipërisë në botë nuk llogaritet si një fuqi e madhe, por ajo llogaritet si një shtet me një politikë të madhe nga urtësia, nga tejpa-mja, nga guximi dhe drejtësia, nga konsekuenca dhe vendosmëria. Kjo politikë e Republikës Popullore të Shqipërisë, që është politika e Partisë së saj marksiste-leniniste ka ngjallur simpati e dashuri të madhe në popujt dhe në revolucionarët, ka ngjallur respekt në të gjithë njerëzit demokratë e përparimtarë. Ajo ka shkaktuar, njëkohësisht, urrejtje tek armiqtë tanë.

Kjo është shumë pozitive për atdheun dhe popullin tonë. Është pozitive sepse, krahas forcimit dhe konsolidimit të pareshtur të gjendjes së brendshme të Shqipërisë socialiste, po forcohen edhe pozitat e saj ndërkombëtare. Sa më të fortë të jemi brenda, aq më të fortë do të jemi edhe jashtë. Politika e drejtë forcon kurdoherë pozitat e brendshme dhe të jashtme njëkohësisht. Këtë politikë ka ndjekur dhe do të vazhdojë kurdoherë të ndjekë Partia. Ne nuk rrojmë dhe as që mund të rrojmë të izoluar. Ne kemi dhe do të vazhdojmë të kemi edhe detyra internacionaliste.

Politika botërore nuk mund të diktohet nga dy superfuqitë. Popujt nuk mund të lejojnë që të shtypen

e të shfrytëzohen nga ana e imperialistëve, e social-imperialistëve dhe e reaksionit botëror. Monopoli i tyre i dikurshëm në politikën botërore është tronditur dhe, çdo ditë që kalon, po goditet nga të katër anët nga valla revolucionare e popujve.

Ne jemi para Kongresit, ku do t'i bëjmë një analizë të hollësishme gjendjes ndërkombëtare, prandaj e kuptoni se s'është aq e ngutshme të zgjatem në ngjarjet e jashtme. Kjo edhe për arsyen tjetër se ju dhe gjithë populli i ndiqni me kujdesin më të madh zhvillimin e politikës ndërkombëtare dhe vijën e qëndrimit e Partisë sonë.

Megjithatë, dëshiroj të theksoj se aktualisht në gjirin e kapitalizmit botëror, dhe veçanërisht në gjirin e imperializmit amerikan, ka shpërthyer kriza më e madhe që është parë pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo ka marrë emrin «kriza e dollarit», por s'është e plotë ta quash krizë vetëm të dollarit dhe as të monedhave të shteteve të tjera kapitaliste që ndikohen nga inflacioni i dollarit. Kjo është një krizë e përgjithshme ekonomike, politike, ideologjike dhe ushtarake e të gjitha shteteve kapitaliste, e strukturave dhe e superstrukturave të tyre, është kriza e regjimeve dhe e aleancave të tyre. Dhe kjo krizë e madhe sapo ka filluar, katastrofikja do të vijë paskëtaj.

Për të dalë nga darta e kësaj krize, oligarkitë kapitaliste do të përpiqen që konsekuencat e rënda t'ua ngarkojnë punëtorëve, popujve, duke i rënduar më tej me taksat e rënda, duke ngritur koston e jetesës, duke hedhur me miliona të tjerë të papunë në rrugë. Kjo do të bëjë që të thellohet akoma më shumë konkurrenca

kapitaliste dhe lufta e egër për akaparim tregjesh, të shoqëruara këto me komplete, me ndërhyrje ushtarake dhe me luftëra lokale, që përgatitin rrezikun e madh të një lufte botërore.

Kriza e tashme nuk është shkaktuar nga malli, por nga halli i madh që e ka mbërthyer për gryke imperia- lizmin dhe revizionizmin. Ata i ka kapur për gryke re- volucioni, popujt që luftojnë e korrin suksese, disfatat në Vietnam e në vende të tjera, shpenzimet kolosale për luftërat grabitqare. Dhe zhvillimi i krizës do ta thellojë akoma më shumë luftën e popujve dhe ecjen përpara të revolucionit.

Në këto situata neve na bie detyra të konsolidojmë fitoret e arritura, të ndërtojmë, të edukojmë, të vigji- lojmë dhe të luftojmë brenda e jashtë vendit. Pa shke- lur parimet marksiste-leniniste të politikës sonë të jashtme, ne duhet të dimë të përfitojmë realisht dhe në mënyrë të zgjuar e të vendosur nga zhvillimi i si- tuatave. Në këto momente të krizës së madhe të impe- rializmit dhe të revizionizmit modern ne duhet ta ash- përsojmë luftën kundër tyre, t'i shfrytëzojmë si duhet dhe drejt në favorin tonë, të shteteve socialiste dhe të popujve që ngrihen në revolucion, kontradiktat e mëdha midis armiqve, t'i demaskojmë ata pareshtur dhe të mos kënaqemi me ato të ashtuquajtura lëshime ose zbutje që bëjnë imperialistët dhe revizionistët nga zori, derisa të kalojnë rrezikun, për të marrë pastaj revan- shin. Prandaj, ne duhet ta mbajmë kurdoherë hekurin të nxehtë dhe t'i godasim ata vazhdimisht.

Taktikat duhet t'i përdorin vazhdimisht vendet to- na socialiste, por këto duhet të përputhen kurdoherë

me ideologjinë tonë, ato duhet t'i shërbejnë strategjisë, në interes të vendeve tona socialiste dhe të revolucionit.

Imperializmi amerikan aktualisht, duke qenë në krizë të rëndë, në vështirësi dhe në konflikt me aleatët e tij, në kontradikta që po shtohen vazhdimisht me mikun dhe me bashkëpunëtorin e tij, Bashkimin Sovjetik në ndarjen e sferave të influencës, është i detyruar të buzëqeshë idhët nga zori dhe të përpiqet të gënjejë, të mashtrojë, të gjejë kundërpesha për aleatët e tij që lëvizin. Detyra jonë si revolucionarë është që t'i godasim në të dy krahët, t'i detyrojmë t'i thellojnë akoma më shumë kontradiktat, për të krijuar terrene të favorshme për goditje më të ashpra kundër tyre nga ana e popujve.

Ne duhet të demaskojmë iluzionet pacifiste dhe demagogjinë e revizionistëve modernë sovjetikë, që thërrasin e bërtasin sikur janë antiimperialistë, por nga ana tjetër punojnë për të shtrirë «imperatorinë» e tyre, punojnë kundër socializmit, kundër luftës çlirimtare të popujve, kundër Republikës Popullore të Kinës dhe Republikës Popullore të Shqipërisë.

Politika e jashtme e revizionistëve të Moskës dallohet për agresivitet në të gjitha anët e botës, njëlloj si dhe ajo e imperializmit amerikan. Socialimperialistët sovjetikë grumbullojnë ushtri në kufijtë e Kinës, lidhin aleanca ushtarake me Indinë kundër Kinës, tok me amerikanët komplotojnë po në këtë drejtim me Japoninë militariste. Flotat e të dyja superfuqive bashkëjetojnë në Mesdhe. Socialimperialistët sovjetikë, gjithashtu, manipulojnë gjithfarë planesh në Lindjen Arabe, bëjnë presione ushtarake kundër Rumanisë e Jugoslla-

visë dhe, tash, së fundi, zhvillojnë një politikë të hapët miqësic e afrimi me revanshistët e Bonit. Kjo politikë synon larg dhe përbën një rrezik të madh për Evropën dhe për gjithë botën.

Këto ditët e fundit Brandi dhe Brezhnjevi u takuan dhe biseduan në Krime me njëri-tjetrin jo vetëm si dy burra shteti, por më shumë si dy shefa partie. U takua shefi i revizionizmit sovjetik me atë të socialdemokracisë gjermane dhe së bashku ranë dakord për ato që keni lexuar në shtyp, por edhe për ato që nuk janë thënë botërisht. Në fakt revizionizmi sovjetik u puq me socialdemokracinë gjermane për të bërë ligjin në Evropë. Kurhani i kësaj feste janë interesat e Republikës Demokratike Gjermane, të cilat, në mos sot, nesër do të sakrifikohen nga carët e Kremlinit për hir të bashkimit të të dy shteteve gjermane sipas dëshirave të Bonit, për hir të një aliance akoma më të thellë se Traktati Moskë-Bon. Boni e fitoi davanë e Berlinit Perëndimor që Moska ia solli në pjatë. Tash u vjen radha ratifikimeve të traktateve dhe më vonë prishjes së murit të Berlinit.

Udhëheqja e Republikës Demokratike Gjermane është bërë krejt raja e Moskës. Përpjekjet për konferencën e «sigurimit evropian», në qoftë se do t'i lënë të tjerët, sovjetikët mund t'i gjejë krah për krah me Bonin për të ndërtuar planin komplotues të përbashkët, për të dominuar në Evropë, ku Republika Federale e Gjermanisë tani është bërë shteti më i fuqishëm kapitalist perëndimor, që sfidon në kontinentin evropian influencën amerikane dhe errëson fuqinë e Francës e të Anglisë, për të mos folur për partnerët e tjerë të NATO-s.

Pra, siç po shihet, intrigat sovjetike, amerikane, ato të revanshistëve të Bonit dhe të aleatëve të të dyja palëve janë të mëdha e plot rreziqe jo vetëm për popujt e kontinentit tonë, por edhe për kontinentet e tjera. Prandaj duhet të luftojmë me guxim të madh si kurdoherë, të mos e flemë asnjëherë mendjen, të mos na mbulojë vetëkënaqësia.

Pa u zgjatur më shumë në këto probleme, po i jap fund fjalës sime, duke u uruar shumë suksese komunistëve dhe punonjësve të organizatës së Partisë të rrethit të Tiranës, duke i thënë gjithë Partisë sonë të lavdishme, që mbush sivjet 30 vjet, të jetë kurdoherë në ballë të luftës revolucionare, e qartë dhe e vendosur në parimet e saj marksiste-leniniste, e dashur me popullin dhe e sakrificës, e denjë për klasën e saj punëtore, të meritojë me punë dhe me luftë, me thjeshtësinë dhe me qartësinë politike, që duhet ta karakterizojë kurdoherë, besimin e madh që kanë populli dhe klasa punëtore e vendit tonë për të.

Rroftë Partia!

Botuar për herë të parë në broshurën: «Të zhvillojmë më gjerë revolucionin tekniko-shkencor në vendin tonë». Tiranë, 1971.

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1970-1971», Tiranë, 1972.
f. 425*

GJENDJA NË ARENËN NDËRKOMBËTARE PO BËHET MË E FAVORSHME PËR REVOLUCIONIN

*Nga biseda në pritjen e dhënë nga ambasadori
i RP të Kinës në Tiranë*

30 shtator 1971

Me rastin e 22-vjetorit të shpalljes së RP të Kinës, shoku Enver Hoxha, i shoqëruar nga udhëheqës të tjerë të Partisë e të shtetit, mori pjesë në pritjen që bëri ambasadori kinez. Gjatë bisedës që u zhvillua në këtë pritje, shoku Enver Hoxha ndër të tjera tha:

Ju faleminderit shumë për ftesën që na bëtë për të marrë pjesë në këtë pritje për nder të kësaj ngjarjeje të shënuar të popullit kinez.

Para disa ditësh pashë një shfaqje të trupës së baletit tuaj. Ardhja e kësaj trupe i shërben forcimit të miqësisë midis dy vendeve tona. Pjesët e bukura të këtij baleti, mjeshtëria e madhe e interpretimit të tyre në skenë nga artistët kinezë, kanë entuziazmuar punonjësit e vendit tonë. Artistët tuaj i këndojnë bukur edhe këngët shqiptare, të cilave u kanë mësuar mirë edhe fjalët, pa lëre pastaj meloditë, që i zotërojnë mirë.

Turneu i trupës suaj të baletit në Evropë do të bë-

jë të mundur që popujt e vendeve evropiane të njihen me artin dhe kulturën kineze. Kjo, si dhe vajtja për vizitë në Francë e delegacionit qeveritar kinez, të kryesuar nga ministri juaj i Tregtisë së Jashtme, kanë rëndësi jo vetëm për njohjen e popujve të tjerë me kulturën kineze dhe për zhvillimin e tregtisë suaj të jashtme, por edhe për zgjerimin e marrëdhënieve të Kinës me shtetet e tjera.

Vizitën e delegacionit tuaj qeveritar radiot e ndryshme e komentojnë si një ngjarje me rëndësi. Delegacioni juaj vete në Francë pikërisht në momentin kur ka shpërthyer kriza e dollarit, që në të vërtetë është krizë e tërë strukturës ekonomike dhe politike të imperializmit në përgjithësi dhe të imperializmit amerikan në veçanti. Franca është një nga shtetet kapitaliste që ka shumë kontradikta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Delegacioni tregtar kinez shkon në Paris në një kohë kur në mes Francës, nga njëra anë, dhe Gjermanisë Perëndimore e Bashkimit Sovjetik, nga ana tjetër, kanë lindur dhe janë thelluar shumë kontradikta. Afrimi i revizionistëve sovjetikë me revanshistët e Bonit e ka alarmuar së tepërmi Francën, si politikisht, ashtu edhe ekonomikisht. Kjo bashkë me Anglinë nuk e pëlqejnë këtë afrim.

Kohët e fundit në Angli kanë dëbuar si persona të padëshirueshëm 105 diplomatë sovjetikë, të cilët punonin në përfaqësitë diplomatike, tregtare etj. sovjetike në këtë vend. Anglezët, që janë të famshëm për spiunazh, e zbuluan veprimtarinë e këtyre njerëzve në vendin e tyre dhe morën masa që i thellojnë kontraktat ndërmjet Anglisë e Bashkimit Sovjetik.

Sipas gjykimit tonë, tendenca aktuale e revizionistëve sovjetikë është afrimi dhe lidhja sa më e ngushtë me Gjermaninë Perëndimore në kurriz të Gjermanisë Lindore. Ky afrim u shërben synimeve të Gjermanisë Federale për të gëlltitur Republikën Demokratike Gjermane dhe për të realizuar kështu bashkimin e të gjithë Gjermanisë. Kjo nuk i pëlqen as Francës dhe as Anglisë, ndërsa Bashkimit Sovjetik afrimi me Gjermaninë Perëndimore i intereson për të siguruar krahët në Evropë, për t'i pasur duart të lira në Lindje.

Partia jonë demaskon pazarllëqet e Bashkimit Sovjetik me Gjermaninë Perëndimore, «sigurimin evropian» dhe e dënon politikën revizioniste të Çausheskut si një politikë koniunkturash. Ky hiqet sikur i kundërshton sovjetikët, por në fakt mbron «sigurimin evropian». Edhe kur atyre u reziston në disa çështje, këtë nuk e bën nga pozita të drejta e të vendosura. Të jesh për atë «sigurim evropian» për të cilin bëhet zhurmë sot, do të thotë të mbrosh interesat sovjetikë në Evropë. Në të njëjtën kohë Çaushesku i bën qejfin Gjermanisë Perëndimore për të marrë kredi prej saj. Kjo nuk është një politikë marksiste-leniniste.

Titoja është një politikan dinak, i cili, për shkak të aleancës që ka me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, deklaroi se në përgjithësi është për këtë lloj «sigurimi», por jo tani, pse, sipas tij, kushtet nuk janë përgatitur mirë. Këto manovrime Titoja i bën se nuk do që në Evropë të sundojnë as sovjetikët, as gjermanët, por amerikanët.

Është interesant qëndrimi i disa përfaqësuesve të qeverive kapitaliste. të cilët i pyesin shokët tanë që

shërbejnë në përfaqësitë diplomatike jashtë: «Për ç'arsye ju shqiptarët nuk jeni për «sigurimin evropian»?». Pasi shokët tanë u japin shpjegimet e duhura, duke u thënë se ne jemi kundër sepse ky nuk është sigurim, por sundim i Evropës nga superfuqitë, ata në përgjithësi e kuptojnë qëndrimin tonë.

Kriza e thellë e dollarit që e ka pllakosur imperializmin amerikan, do t'i shkaktojë vështirësi jashtëzakonisht të mëdha kapitalizmit botëror. Në Uashington tani janë mbledhur përfaqësuesit e 20 shteteve kryesore kapitaliste për të diskutuar rreth gjendjes së dollarit dhe për vendosjen e një monedhe të re ndërkombëtare. Duke folur mbrëmë, Niksoni përsëri kërcënoi «aleatët», të cilëve, në një mënyrë ose në një tjetër, u bën presion që të kenë parasysh se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk kanë ndër mend të izoloohen për shkak të krizës së dollarit dhe të vazhdojnë të mbajnë në kurriz të tyre shpenzimet për bazat ushtarake që kanë në vendet e tjera.

Tani kriza e madhe e dollarit do të shkaktojë shumë pasoja për të gjitha ato vende që po preken prej saj, sepse do të ngrihen çmimet dhe taksat, do të shtohet papunësia, do të shpërthejnë grevat e demonstratat, pra popujt do të ngrihen në revolta.

Kudo në botë kapitalistët po i ngrenë çmimet e mallrave të konsumit të gjerë. Edhe vendet përreth Shqipërisë, dua të them Italia e Jugosllavia, janë në ethe, në konfuzion ekonomik, kurse në vendin tonë çmimet jo vetëm nuk ngrihen, por, përkundrazi, ulen.

Para ca kohe ishte te ne një shkencëtar dhe gazetar borgjez francez, i cili ka shkruar një artikull për

vendin tonë. Në Shqipëri, — nënvizon ai, — po ndërtohet socializmi i vërtetë, ato që janë realizuar atje nuk mund t'i bëjnë dot kapitalistët dhe propozon që nga Shqipëria të merret shembull. Natyrisht, vendet e tjera nuk mund ta përvetësojnë eksperiencën tonë, përderisa nuk kanë përmbysur kapitalizmin, por është fakt, të cilin nuk mund ta mohojnë as borgjezët, që kriza sistemin tonë nuk mund ta prekë. Kjo nuk mund të thuhet për vendet revizioniste, ku shenjat e kësaj krize duken hapur. Këto vende, nëpërmjet marrëdhënieve ekonomike, monetare etj. që kanë me vendet kapitaliste, janë mjaft të pleksura me to, me kapitalin amerikan, gjerman, japonez etj. Tregjet botërore, për shkak të krizës, sigurisht, tani do të ngushtohen. Kështu, Bullgarisë, për shembull, tani nuk do t'ia blejë dot njeri mallrat, gjë që do të krijojë vështirësi, të cilat do t'i heqë në kurriz populli bullgar. Prandaj ne u themi këtij dhe popujve të vendeve të tjera revizioniste të luftojnë revizionizmin dhe klikat sunduese.

Si imperialistët amerikanë edhe revizionistët sovjetikë gjenden në vështirësi të mëdha. Podgorni, sigurisht për të intriguar dhe për të komplotuar, u nis sot për në Vietnam. Gjatë këtij udhëtimit ai do të qëndrojë më parë në Delhi dhe në Rangun për të zhvilluar bisedime me qeveritarët indianë dhe birmanezë. Qëllimi kryesor i udhëtimit të tij në Vietnam, me sa duket, do të jetë puna intriguese e minuese kundër popullit të këtij vendi. Premtimet e Podgornit për «ndihmë» do të jenë të mëdha, por udhëheqësit e Vietnamit nuk duhet t'ua vënë veshin premtimeve të Brezhnjev-it, Kosiginit dhe Podgornit. Vlera e ndihmës nuk

mund të gjykohet vetëm nga ana materiale. Në këtë çështje ka shumë rëndësi të shikohet se për çfarë qëllimi jepet ndihma, si shprehje e dashurisë dhe e ndjenjave të forta të zemrës, të shpirtit apo me synime të tjera.

Ne mendojmë se uniteti i popujve të Indokinës në luftë kundër armiqve të përbashkët është në dobi të luftës së tyre.

Revizionistët sovjetikë futin hundët ku të mundin. Ata intrigojnë jo vetëm në Orientin e Largët, por kanë gisht edhe në Sudan, ndoshta mund të kenë gisht edhe në Libi, Marok dhe Irak, se atje tani po bëhet një katrahurë. Këtë politikë të revizionistëve sovjetikë, megjithëse ata përpiqen ta mbulojnë me shumë demagogji, të gjithë e shikojnë dhe e kuptojnë gjithnjë e më qartë.

Pavarësisht nga intrigat që kurdisin e do të kurdisin imperialistët e revizionistët, gjendja në arenën ndërkombëtare sa vjen e po bëhet më e favorshme për ne, për revolucionin dhe për të gjithë popujt e botës.

Këto ditë ne jetuam ngjarjen e dhimbshme të vdekjes në krye të detyrës të montatorit kinez të antenave Çan Pao Y. Akti i tij simbolizon ndjenjën e heroizmit, të sakrificës e të vetëmohimit. Ai është shprehje e dashurisë së madhe të popullit kinez për popullin shqiptar, shprehje e ndjenjave internacionaliste.

Siç mora vesh. Çan Pao Y paska lënë gruan dhe dy fëmijë. U thoni atyre se Shqipëria do të jetë atdheu i tyre i dytë dhe dëshirojmë që ata të vijnë këtu për të parë varrin e babait dhe bashkëshortit të vet, i cili do të mbetet kurdoherë i gjallë këtu në Shqipëri. Te ne që tani i është ngritur këngë Çan Pao Ysë, sepse

populli shqiptar i do dhe i respekton trimat, prandaj i përjetëson ata në këngë dhe melodi.

Edhe një herë ju falënderojmë për pritjen e ngrohtë që na bëtë, shoku ambasador, dhe tani na lejoni të shkojmë. Mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

SHKËMBIMET NË FUSHËN E ARTIT DHE TË KULTURËS I SHËRBEJNË FORCIMIT TË MIQËSISË NDËRMJET POPUJVE

Nga biseda me trupën e baletit të RP të Kinës

2 tetor 1971

Pasi u përshëndet me miqtë dhe i përgëzoi për nivelin e lartë artistik dhe suksesin e shfaqjeve të tyre, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Shokët e mi dhe unë jemi të gëzuar që takohemi sot me ju, përfaqësuesit e denjë të kulturës kineze. Ardhja juaj në Shqipëri është për ne një ngjarje e rëndësishme, jo vetëm artistike, por në radhë të parë politike, pse ajo i shërben forcimit të mëtejshëm të miqësisë ndërmjet popullit shqiptar e popullit kinez. Kjo është kryesorja për ne dhe mbi këtë bazë zhvillohet e tërë veprimtaria e përbashkët e të dy vendeve tona.

Nga ana tjetër, ardhja juaj në Shqipëri i shërben jo vetëm zhvillimit të mëtejshëm të lidhjeve midis dy vendeve tona, por ka, gjithashtu, një vlerë të veçantë artistike e kulturore, pse popujt tanë, shqiptar e kinezë, punojnë, luftojnë dhe njëkohësisht gëzojnë. Pikërisht ju, të dashura vajza dhe djem të Kinës, erdhët në Shqi-

përi që të njiheni me popullin tonë, me njerëzit e artit e të kulturës sonë dhe t'u tregoni masave të popullit tonë artin, muzikën dhe këngët e bukura kineze.

Shfaqjet e baletit tuaj që i ekzekutuat me aq mjeshtëri na kanë kënaqur dhe entuziazmuar. Si tematika e pjesëve, ashtu edhe loja e artistëve, skenat, muzika, kostumet, koret u pëlqyen nga masat e gjera të popullit shqiptar. Personalisht edhe mua më bëri përshtypje interpretimi i baletëve dhe i muzikës suaj.

Turneu që do të bëni ju në shumë vende të Evropës ka rëndësi, pse popujt e këtyre vendeve me këtë rast do të njihen edhe me artin e kulturën tuaj. Ne, marksistë-leninistët, vlerësojmë dashurinë e popujve dhe jo «dashurinë» e udhëheqësve revizionistë e kapitalistë, të cilët në të vërtetë janë armiq të popujve, të socializmit e të komunizmit. Këtë gjë ne e bëjmë dhe është e domosdoshme të bëhet sepse duhet t'u kundërvihemi armiqve të socializmit e të komunizmit edhe në fushën e artit. Kur ata përdorin armët kundër nesh, ne jemi në gjendje t'u përgjigjemi përnjëherësh me armë, por, përveç armës së fortë politike e ideologjike, ne kemi edhe një armë tjetër të shëndoshë, armën artistike.

Arti dhe kultura borgjeze e revizioniste janë në dekadencë, ata reklamojnë diçka që jep shpirt, që vdes e kalbet. Dalja në skenat e vendeve të ndryshme të botës e trupave të baletit, e grupeve të artistëve, e muzikantëve, e këngëtarëve etj. të vendeve tona ka një rëndësi të madhe, sepse demaskon artin dekadent borgjez e revizionist dhe gjallëron shpirtrat e popujve, i bën ata të gëzuar e optimistë për jetën. Pjesëtarët e grupeve artistike të vendeve tona, që kanë dalë dhe do

të dalin jashtë edhe në të ardhmen për të përfaqësuar artin e kulturën e popullit të tyre, e kuptojnë fare mirë këtë mision të madh e të rëndësishëm. Prandaj ata në këto shfaqje, të ndërgjegjshëm për detyrën që kanë, shumëfishojnë energjitë, perfeksionojnë talentet e tyre dhe lënë te spektatorët mbresa të pashlyeshme.

Në Festivalin Ndërkombëtar të vjeshtës që u bë vjet në Dizhon të Francës, me pjesëmarrjen e ansambleve folkloristike nga shumë vende të botës, mori pjesë edhe Ansambli ynë i Këngëve dhe i Valleve Popullore. Franca është një vend borgjez me kulturë të gjerë, me tradita të lashta në fushën e artit e të muzikës. Por, megjithatë, Ansambli ynë i Këngëve dhe i Valleve fitoi medaljen e artë të festivalit, duke lënë prapa të gjitha ansamblet artistike të vendeve të tjera. Opinioni shoqëror përparimtar i vendeve të ndryshme kërkon që ansambli ynë të shkojë për të dhënë shfaqje në këto vende, por ka udhëheqje të këtyre vendeve që nuk para ua ka qejfi. Pse ndodh një gjë e tillë? Sepse nëpërmjet këngëve, valleve dhe pjesëve të ndryshme të grupeve tona, të pastra ideologjikisht e politikisht nga përmbajtja, masat e gjera të popujve, duke i shikuar këto, bëjnë krahasimin ndërmjet kulturës e artit borgjez në vendet e tyre dhe kulturës e artit tonë socialist.

Gjatë qëndrimit tuaj në Shqipëri edhe koha ka qenë e bukur. Zakonisht te ne muajt shtator-tetor, kur bën kohë e mirë, i quajmë si një pranverë të dytë. Sivjet, si me realizimin e planit në industri dhe në bujqësi jemi mirë. Kjo do të thotë se ndërtimi i socializmit te ne marshon përpara me sukses. Në vendin tonë

niveli i jetesës së masave ngrihet vazhdimisht, çmimet ulen, krizat dhe papunësia nuk njihen. Kjo ka rëndësi shumë të madhe. Ndryshe është situata në vendet kapitaliste e revizioniste që po kalojnë tani një krizë të thellë ekonomike, politike dhe krizë aleancash. Atje po ngrihen vazhdimisht çmimet, ulet niveli i jetesës së punonjësve, shtohet papunësia.

Tani në vendin tonë po zhvillojmë një luftë të ashpër kundër mbeturinave dhe njollave të shoqërisë së vjetër. Në këtë drejtim po luftojmë edhe për emancipimin e mëtejshëm të gruas, për rritjen e pozitës së saj në familje e në shoqëri, prandaj, meqë është rasti, më lejoni t'u ofroj shoqeve të baletit kinez ëmbëlsirat që janë në tavolinë dhe nuk besoj që burrave t'u vijë keq për këtë.

Gruaja te ne është futur në punë, ekonomikisht është bërë e pavarur, ajo merr vazhdimisht arsim, kulturë, përvetëson teknikën dhe, të mos zemërohem! ne burrat, ato, në çdo drejtim, janë treguar kudo shumë të zonjat. Te ne, përpara, reaksionarët thoshin: «Gruaja ka flokë të gjatë e mendje të shkurtër», po nuk ishte ashtu. Praktika e ka hedhur poshtë këtë shprehje. Tani në Evropë «ka dalë moda» që gratë të mbajnë flokë të shkurtër dhe burrat të gjatë. Në Anglinë konservatore tashti ka nga këta që dekorohen nga mbretëresha e Anglisë. Kuptohet vetiu në ç'dekadencë ka rënë monarkia angleze, arti dhe muzika e saj si dhe e vendeve të tjera kapitaliste.

Shpresoj të jeni kënaqur gjatë qëndrimit tuaj në Shqipëri dhe shokët tanë kanë qenë të preokupuar për t'ju krijuar kushte sa më të mira.

Ju falënderojmë përzemërsisht dhe, në emër të popullit e të Partisë si dhe në emër të artistëve tanë, ju shprehim edhe një herë mirënjohjen e thellë dhe uringet më të mira për suksese të mëtejshme në të ardhmen.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

UDHËHEQJA DUHET T'U PËRSHTATET NEVOJAVE OBJEKTIVE TË PARTISË E ZHVILLIMIT TË VENDIT

Nga fjala në Plenumin e 13-të të KQ të PPSH¹

12 tetor 1971

Sikundër e dimë të gjithë, pas rreth dy javësh do të hapet në Tiranë Kongresi i 6-të i Partisë. Kuptohet që kjo është mbledhja e fundit e Plenumit të Komitetit Qendror për periudhën që nga Kongresi i 5-të e këtej. Komiteti ynë Qendror nëpërmjet Kongresit do t'i paraqitë mbarë Partisë veprimtarinë plot suksese të arritura pas Kongresit të 5-të. Megjithatë, në veprimtarinë e Partisë ka pasur edhe të meta. Prandaj, detyrat e mëdha që vuri Kongresi i kaluar, në të gjitha fushat e veprimtarisë së Partisë, do të gjykohen në Kongresin e ri se si janë realizuar. Aty do të bëhet vlerësimi i gjithë kësaj pune të madhe të kryer, me të mirat dhe

1. Në këtë Plenum u shqyrtuan dy raportet që do t'i paraqiteshin Kongresit të 6-të të Partisë: «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të PPSH» dhe «Mbi direktivat e Kongresit të 6-të të PPSH për planin e pestë pesëvjeçar (1971-1975) të zhvillimit ekonomik e kulturor të RPSH».

boshllëqet e saj; aty do të diskutohen e do të aprovohen, gjithashtu, edhe direktivat e planit të ri pesëvjeçar që u hapin Partisë dhe popullit një perspektivë të shkëlqyer.

Natyrisht, në gjithë këtë punë të madhe që kanë bërë Partia dhe populli ynë, edhe udhëheqja, Komiteti Qendror, ka dhënë kontributin e vet. Po t'i hedhim një sy veprimtarisë së Plenumit të Komitetit Qendror gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare, mund të themi se ajo në përgjithësi ka qenë pozitive. Komiteti Qendror ka luftuar për të zbatuar me vendosmëri revolucionare vendimet e marra në Kongresin e 5-të. Asnjë nga anëtarët dhe kandidatët e Plenumit nuk ka kursyer forcat e trupit dhe të mendjes, bile, të gjithë kanë qenë dhe janë të vendosur që, po të jetë nevoja, edhe sakrificën më të lartë janë gati të bëjnë për çështjen e madhe të Partisë dhe të popullit.

Është shumë pozitiv fakti se të gjithë ne, të frymëzuar nga Partia dhe populli, kemi luftuar dhe kemi arritur të ruajmë e të kalitim më tej, në mënyrë revolucionare, unitetin e çeliktë Parti—popull; të mbrojmë me vendosmëri të madhe vijën politike dhe ideologjike të Partisë, që është shtylla kurrizore e të gjitha suksesteve të realizuara deri tash dhe që përbën sigurinë vendimtare për të ardhmen. . .

Është detyra jonë, e gjithë komunistëve, që Partinë ta mbajmë kurdoherë të mobilizuar, të shkathët, revolucionare e me frymë të lartë iniciative. Për të qenë e tillë, ajo duhet të jetë kurdoherë e re. E marrë në këtë kuptim është e domosdoshme që eksperiencia e madhe e kuadrove të vjetër të gërshetohet me eksperiencën,

me vrullin dhe me hovin e madh të gjakut të ri, që del pareshtur nga gjiri i popullit tonë luftëtar dhe hyn në Parti, ku tregon një pjekuri dhe vendosmëri të jashtëzakonshme. Të mbash vazhdimisht frymën rinore në Parti do të thotë të ruash kurdoherë në radhët e saj karakterin revolucionar, si në mendime dhe në kuptimin e drejtë të problemeve, ashtu edhe në hovin e në zgjidhjen e tyre gjer në fund.

Partia jonë ndjek një vijë të drejtë, e cila është zbatuar me sukses gjatë gjithë veprimtarisë së saj 30-vjeçare. Gjatë periudhës në mes dy kongreseve, sikundër e keni parë vetë, në përbërjen e Partisë sonë ka ardhur një kontingjent shumë i madh kuadrosh me origjinë, me përbërje e me gjendje punëtore. Edhe në udhëheqje, duke filluar nga baza e deri në komitetet e Partisë të rretheve, kanë ardhur, gjithashtu, komunistë të rinj nga mosha, por të pjekur nga ana ideologjike e politike dhe me një hov të madh në punë. Është e natyrshme që kjo gjendje duhet të reflektohet edhe në udhëheqjen kryesore të Partisë.

Çdo kongres ka sjellë në udhëheqje të Partisë sonë kuadro të rinj. Prandaj, edhe Kongresi i 6-të nuk ka përse të mos sjellë kuadro të rinj në Komitetin Qendror, për arsyet që thashë. si edhe për arsyen e madhe që të tërë së bashku dhe gjithsecili nga ne, e ndiejmë dhe e dëshirojmë në mënyrë imperative që në Plenum të vijnë shokë dhe shoqe të reja, mbasi duhen kalitur me kohë. Ata Partia do t'i edukojë në udhëheqje, e cila nuk duhet të vjetrohet, siç nuk lejojmë të vjetrohet gjithë Partia, në shembullin e së cilës lypset të shkojë edhe udhëheqja.

Natyrisht, këtë punë do ta bëjë përfaqësia që ka zgjedhur Partia dhe në fund do të vendosë Kongresi. Ne jemi të bindur që kandidatët që do të diskutohen, do të kalojnë nëpër një shoshë të fortë marksiste-leniniste.

Por, mund të ketë disa shokë të këtij Plenumi që gjatë veprimtarisë së madhe të Partisë nuk janë treguar në lartësinë e detyrës. Këtë ta kuptojmë drejt si komunistë që jemi. Disa, për arsye të ndryshme si sëmundje etj., nuk kanë mundur ta përballojnë dot si duhet barrën që u është ngarkuar. Partia e ka parasysh këtë, prandaj, si kurdoherë, ajo do të veprojë me drejtësi, duke i shoshitur me kujdes kandidaturat për të cilat do të vendosë Kongresi.

Ne jemi komunistë dhe si marksistë-leninistë e kemi të qartë se ndonjëri, që ka qenë anëtar i Komitetit Qendror (nder ky shumë i madh për të), dhe që deri sot ka punuar me të gjitha forcat, duke i dhënë Partisë me aq sa ka mundur, mund të mos jetë më. Partia tash ka shokë të tjerë të rinj, edhe më të aftë, që e lyp nevoja të vijë në udhëheqje, sepse kanë treguar zotësi në luftën për zbatimin e vijës dhe paraqitin sigurinë se do ta çojnë punën më tej. Këtë e kërkon interesi i Partisë dhe kjo masë komunistin e vjetër nuk e ul; meritat këtij nuk i humbasin aspak. Të gjithë e kuptojmë se çdonjërit prej nesh do t'i vijë momenti të plakët, ose, dikush, për një arsye ose një tjetër, ndien se nuk jep dot më. Atëherë ai edhe vetë mund të propozojë që në vend të tij të vijë në Plenum një tjetër i ri. Megjithatë, ai, si komunist, prapë e kurdoherë do të qëndrojë afër dhe duhet të punojë me të gjitha forcat. Këtij jo vetëm Partia, komunistët, po asnjëri nuk ka si t'i thotë: «Çfarë

bëre që s'të zgjodhën në Plenum?». «Asgjë s'kam bërë, — do të përgjigjet ai me kryet lart, — unë kam punuar dhe do të punoj derisa të vdes për Partinë, por arsyeja e largimit tim është se në udhëheqje e do nevojta të vij në kuadro të rinj, për të kombinuar eksperiencën e gjatë me hovin e ri në punë». Këto, natyrisht, janë çështje të Kongresit, por unë i ngrita ato në parim dhe jam i bindur se s'ka asnjë nga ne që ta kuptojë ndryshe këtë problem jo vetëm si organ kolegjial, por as edhe në mënyrë individuale.

Në studimet që po bëjmë ka disa caqe dhe proporcione, që është e domosdoshme të ruhen, prandaj udhëheqja kryesore e Partisë nuk duhet t'i kalojë këto caqe e proporcione që ka marrë zgjerimi i Partisë, në kuptimin që t'i vihet asaj një kokë e madhe nga ana numerike. Nga kjo pikëpamje udhëheqja edhe në numër duhet t'u përshtatet nevojave objektive të Partisë dhe zhvillimit të vendit, sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, të kulturës, të ushtrisë etj. Duke e parë problemin kështu, të gjithë sektorët duhet të mbulohen me një numër të nevojshëm shokësh që të mundin, gjatë gjithë periudhave të një veprimtarie të madhe e intensive, të jenë në krye të punëve. Edhe këto caqe e proporcione e detyrojnë Partinë të ketë parasysh nevojën e sjelljes së gjakut të ri në udhëheqje. Kjo e detyron, gjithashtu, Partinë që disa shokë pa asnjë gabim politik ose ideologjik, të pastër, të kulluar e të vendosur gjer në fund për Partinë, por që gjatë veprimtarisë së tyre nuk kanë qenë shumë të shquar, t'i lërë jashtë udhëheqjes. Natyrisht, edhe në këtë drejtim, ne e kemi për detyrë ta orientojmë drejt Kongresin. Kjo nuk është

të ndonjë gjë e re në praktikën tonë, se ne, në të vërtetë kështu veprojmë në të gjithë Partinë. Fakt është që nga Komiteti ynë Qendror disa shokë të pastër politikisht dhe ideologjikisht janë larguar edhe më përpara nga ky forum i lartë për t'u lënë vendin të rinjve më të zotë, për arsye se ata vetë nuk janë treguar në lartësinë e duhur. Megjithatë, asnjëri prej tyre nuk ka as më të voglin pretendim ose pakënaqësi, përkundrazi, vazhdimisht bëjnë përpjekje dhe luftojnë në radhët e para për realizimin e detyrave të ngarkuara. Disa prej tyre Partia i ka zgjedhur prapë me përgjegjësi të ndryshme; ndonjërin sekretar komiteti partie rrethi ose sekretar organizate-bazë; ndonjë tjetër zëvendëskryetar komiteti ekzekutiv etj. Me një fjalë të gjithë vazhdojnë normalisht jetën e Partisë.

Për raportet, sikundër i studiuat këto ditë, të gjithë jemi në gjendje të diskutojmë dhe të bëjmë vërejtjet përkatëse, në rast se ka. Megjithatë, më duket se raportet janë përgatitur mirë, çdo problem është trajtuar qartë.

Problemet që shtrihen në raportet janë të njohura nga Plenumi ynë, pse janë rezultat i gjithë punës që kemi bërë të tërë së bashku. Analiza që i bëhet në to veprimtarisë së Komitetit Qendror, përfshin gjithë periudhën e kaluar dhe për të tëra problemet, prandaj në raportet është sintetizuar plotësisht veprimtaria pesëvjeçare e Partisë.

Në pjesën e dytë të raportit të parë flitet për realizimin e planit të katërt pesëvjeçar, si dhe për projekt-direktivat e zhvillimit ekonomik për pesëvjeçarin e ri. Edhe këto çështje janë bërë objekt shqyrtimi kushedi

sa herë nga ana e Komitetit Qendror, prandaj asgjë nuk është e panjohur për ne as në këtë drejtim. E ardhmja, puna për përgatitjen e projektdirektivave lidhur me perspektivat e zhvillimit ekonomik të vendit tonë, e ka preokupuar Partinë vazhdimisht. Partia dhe shteti kanë menduar me kohë për këtë perspektivë, kështu që dalja e projektdirektivave nuk është një punë e bërë në një vit. Projektdirektivat janë rrahur e stërrahur në Parti, në masat e popullit, në komitetet ekzekutive e në organet qendrore dhe pastaj janë kthyer e rikthyer përsëri në bazë etj. Në Kongres mbetet që të bëhen vetëm konkluzionet përfundimtare të të gjithë kësaj pune. Tash, për këto probleme duhet të japim edhe ne mendimin ose të themi vërejtjet tona, që të mund të bëjmë me kohë korrigjimet e nevojshme, me qëllim që çdo gjë të dalë sa më mirë dhe sa më reale.

Në kapitullin e fundit të raportit të parë për veprimtarinë e Komitetit Qendror, janë trajtuar disa probleme teorike që kanë të bëjnë me vijën që Komiteti Qendror ka përpunuar e zbatuar dhe për të cilën ka luftuar tërë jetën gjithë Partia. Komiteti ynë Qendror këtë e bën sepse për këtë vijë Partia jonë ka luftuar, lufton dhe do të luftojë edhe paskëtaj. Prandaj, është e arsyeshme dhe plotësisht me vend t'i bëjmë me këtë rast një përmbledhje vijës në drejtimin sa më konkret, që jo vetëm anëtarët e Partisë, po edhe marksistë-leninistët në botë ta kenë të qartë, në qoftë se dëshirojnë, mendimin që ka Partia e Punës e Shqipërisë për lëvizjen marksiste-leniniste dhe revolucionare në botë: të dinë ç'mendon ajo; të gjykojnë nëse e ka drejt, apo s'e ka drejt. Pastaj, është puna e tyre se si do të veprojnë.

Problemi është që ne t'u tregojmë atyre vijën që kemi, të cilën e mbrojmë dhe e zbatojmë dhe kemi plotësisht të drejtë ta shtrojmë në Kongresin tonë. Byroja Politike ka gjykuar se është e domosdoshme t'i trajtojmë këto çështje në Kongres, pse do të bëjnë efektin e tyre.

Atëherë fjalën e keni ju, shokë. Kush dëshiron të diskutojë?

Pasi u shfaqën disa mendime, raportet u hodhën në votë. Të gjithë shokët e Plenumit i aprovuan njëzëri të dy raportet që do të paraqiteshin në Kongresin e 6-të të Partisë. Pastaj shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Duke ju uruar suksese të mëdha në punë dhe sidomos gjatë zhvillimit të punimeve të Kongresit tonë historik të ardhshëm, i cili duhet të bëhet me të vërtetë një tribunë e shkollë e madhe për të armatosur komunistët dhe popullin me mësimet e Partisë, me qëllim që në të ardhmen t'i kryejmë edhe më mirë se deri sot detyrat që na vihen përpara, jam i mendimit të merrni masa me kohë që diskutimet tuaja të jenë të plota, të ngjeshura, pa qenë nevoja të jenë të gjata, po revolucionare dhe edukuese, me një fjalë në nivelin që presim të jetë Kongresi.

Mbledhjen e Plenumit të 13-të të Komitetit Qendror të Partisë, më e shkurtra që kemi bërë, po e mbylлим.

Rroftë Partia!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

KASOLLET DHE SHTËPITË TUAJA TË VARFRA U BËNË PISHTARË TË LUFTËS PËR LIRI

*Nga biseda me një grup veteranësh dhe pjesëtarë
të familjeve që kanë qenë baza strehimi gjatë
Luftës Nacionalçlirimtare¹*

13 tetor 1971

Mirë se na erdhët! Si jeni nga shëndeti, mirë?

Bashkë me gëzimin që ndiejmë, të gjithë ne, jemi shumë të prekur për mundimin që morët për të ardhur e për t'u pjekur së bashku në këto ditë të shënuara në prag të festave të mëdha. Çdo vit në nëntor, ne festojmë jo vetëm çlirimin e atdheut, po edhe disa data të tjera historike, siç është dhe dita e Themelimit të Partisë. Në mënyrë të veçantë në nëntorin e këtij viti do të kemi dy festa të mëdha: 30-vjetorin e Partisë dhe mbajtjen e Kongresit të 6-të të saj. Prandaj, ideja juaj për të ardhur në këtë takim është kaq mirë e goditur.

Populli, idetë dhe mendimet, i ka kurdoherë të mrekullueshme, ashtu siç janë të mrekullueshme edhe ndjenjat e trimëria e tij, tek të cilat u mbështetën ko-

1. Kjo bisedë u bë në selinë e Komitetit Qendror të PPSH.

munistët kur themeluan Partinë, që udhëhoqi me sukses Luftën e madhe heroike Nacionalçlirimtare, çliroi atdheun nga robëria dhe sot i ka ndërruar faqen Shqipërisë. Të gjitha të mirat që gëzojmë sot kanë ardhur nga Partia, nga populli i udhëhequr prej saj, nga ju prindër, motra e vëllezër të dashur, që jeni mbledhur tash këtu.

Gjatë kohës së luftës unë kam jetuar e kam luftuar me ju; bashkë i kemi qarë edhe hallet. Por as ju që jeni sot këtu, as unë, nuk kemi qenë të vetmit në Luftën e lavdishme Nacionalçlirimtare. Si ne kanë qenë qindra e mijëra shokë të tjerë, gjithë partizanët dhe partizanet trime, bijtë dhe bijat e popullit, bijtë dhe bijat tuaja dhe që së bashku me ju, të udhëhequr nga Partia, luftuan dhe fituan.

Fitorja që gëzojmë sot u arrit në sajë të gjakut të djemve e vajzave, të burrave e grave, të vëllezërve e motrave tuaja që luftuan e çliruan Shqipërinë dhe e bënë zonjë, kështu siç është tash. Pasuria e popullit, pasuria juaj u shkatërrua në kohën e luftës, pse ju nuk kursyet asgjë për fitoren, për lirinë, për partizanët dhe partizanet, duke menduar se duheshin bërë medoemos ato sakrifica, duke pasur besim të patundur se do të vinte dita që ato do të viheshin në vend. Kështu, kasollet dhe shtëpitë tuaja të varfra, që u dogjën atëherë nga armiqtë, u bënë pishtarë të luftës për liri dhe krijuan mundësinë të hidhen themelet e kësaj Shqipërie të bukur. Sot në vend të kasolleve prej kashte, populli, nën udhëheqjen e Partisë, ka ngritur shtëpi të bukura e të rehatshme, në fshatra e në qytete.

Unë kam një vajzë akoma të re që, si të gjitha vaj-

zat e popullit, shkoi për të marrë pjesë në ndërtimin e hekurudhës Elbasan—Përrenjas. Gjatë kohës që punoi atje i shkrova një letër, në të cilën e këshilloja t'i binte kazmës fort dhe të djersinte shumë për ndërtimin e kësaj vepre. Më poshtë i thosha, që, kur të fshinte djersët, të kthente sytë lart nga maja e malit të Shmilit, se atje, si kudo, në të gjitha anët e Shqipërisë, kanë luftuar partizanët. Më kujtohet se atje lart, në dushk, në kohën e luftës kam rrojtur për disa ditë me radhë në kasollen e varfër të një katundari që e quanin Ramë Karagjozi. Kemi fjetur vetëm, ngrënë e pa ngrënë, me të dhe me qenin e tij. Ditën unë merresha me punët e Partisë, kurse ai vente priste dushk. Natën, kur ishim në errësirë, i thosha Ramës të merrte pushkën e të dilte në majë për të ndjekur me sy kolonat e gjermanëve që kalonin në Xibrakë. «Tash, hëpërhë, i kanë ata në duar ato vende, po malet i kemi ne», i thosha Ramës kur uleshim e bisedonim së bashku.

Ka ndonjë djalë Rama? (*Ngrihet një burrë dhe shokut Enver i thonë se është i vëllai.*) A, qenka vëllai. I flisja Ramë Karagjozit për luftën dhe të ardhmen e Shqipërisë. Ai ishte një fshatar i thjeshtë; ca gjëra i kuptonte, për ca të tjera nuk ia merrte mendja që të bëheshin ashtu siç janë bërë sot. Unë e kuptoja këtë se thoshte vetëm «ishallah», «ishallah». Por, në dritën e zjarrit, shikoja sytë e tij që ndritnin si yjet. Pastaj, ma priste nganjëherë fjalën e më thosh: «Shoku Enver, po gjëmon Babja», pse dëgjoheshin të kërcitnin mitralozat. «Luftojnë partizanët me gjermanët», i thosha unë. «Gjermanët i kanë frikë partizanët, ata e kanë frikë natën, ne do të fitojmë».

Ramë Karagjozi, ai fshatar i thjeshtë, tash ka vdekur. Por, në mënyrë figurative, siç thoshin përpara të vjetrit, më ngjan se ai edhe tash më thotë: «Enver, po gjëmon Babja». Por tash s'kam si t'i them atij se Babja gjëmon vërtet, gjëmojnë grykat e Librazhdit. Po këto janë gjëmime të një lloji tjetër, ato gjëmojnë nga minat e rinisë sonë heroike që çajnë shkëmbinjtë e Mirakës e të Murrashit, ku për nja dy javë treni do të gjendet në Librazhd¹.

Përpara thuhej: «O, ky është njeri që rron vetëm me kujtime», që donte të thoshte me ëndrra. Jo, ne nuk rrojmë me kujtime, por më të mirat e tyre, siç janë ato të Luftës Nacionalçlirimtare, ne i ruajmë si thesarin më të shtrenjtë, pse ato janë për ne një armë shumë e fuqishme që na jep forca të ndërrojmë jo vetëm pamjen e jashtme të atdheut, po edhe botën tonë të brendshme. Kujtimet na ndihmojnë dhe na japin forca që atdheun ta lulëzojmë, që jetën e popullit ta bëjmë të lumtur e të begatshme.

Nëna e baballarë, motra e vëllezër! Sa rëndësi kanë ato kohë, kujtimet e të cilave kanë mbetur të pashlyeshme në mendjen dhe në zemrat tona! E kam fjalën për kohët e lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare dhe për këto të pasçlirimit, të luftës dhe punës për ndërtimin e socializmit. Ju, që keni qenë pionierë të Luftës Nacionalçlirimtare, që keni bërë gjithë ato sakrifica të panumërta dhe sot vazhdoni të punoni me zjarr të madh për ndërtimin e Shqipërisë së re socialiste, që kjo të bëhet çdo ditë më e pasur, më e fortë

1. Treni i parë në Librazhd mbërriti më 3 nëntor 1971.

dhe më e çeliktë, që të mos i ngjasë kurrë asnjë e keqe, ju lumtë për atë që keni bërë dhe po bëni për të mbajtur gjallë në zemrat e rinisë sonë atë të kaluar heroike aq të pasur me ngjarje të mëdha. Armiqve nuk ua merrte mendja dhe nuk e besonin kurrë që të bëhej kështu si sot Shqipëria, po këtë e besonte populli.

Armiqve nuk ua merrte mendja që shtëpia e Bije Vokshit të bëhej kala në Tiranë. Armiku e dinte që nipi i saj, djali i vëllait, Asim Vokshi, ra heroikisht në Spanjë, por mendonin se çfarë do të bëjë kjo grua? Mirëpo në shtëpinë e saj u gatuan punë të mëdha. Ajo na shikoi, na mbajti, na ndihmoi dhe na inkurajoi në luftën për çlirim.

Më kujtohen si të gjalla shumë nga ngjarjet e asaj kohe, me secilin nga ju, po më duhet të rri jo me orë, po me ditë të tëra që t'i kujtoj të gjitha dhe t'i përsëris. Megjithatë, dëshiroj t'ju tregoj shkurt disa prej tyre.

Një natë të errët, Partia kishte përgatitur traktet për t'i shpërndarë. Unë isha në dhomën e zjarrit në mes të së cilës ishte dhe mëmë Bija. E mban mend mëmë Bije? Mëmë Bija kishte marrë pakot me trakte dhe ua jepte shokëve që rrinin në radhë. Bashkë me traktet u jepte njëkohësisht edhe nga një kobure ose nga një thikë. Kur erdhi më në fund radha e nipit të saj, koburet dhe thikat i qenë mbaruar, prandaj atij i dha vetëm trakte. Kur ai i kërkoi armë, si të tjerët, ajo iu përgjigj se s'kishte për të. Pastaj mori një dru nga zjarri dhe i tha: «Ja arma për ty». «Po të tjerët pse morën», kundërshtoi nipi, kurse ajo ia preu shkurt,

duke e urdhëruar: «Hajt, shko përpara, ik ndaj traktet ku të kanë ngarkuar!».

Me këtë dua të them se në ato momente aq revolucionare puna e Partisë e ngriti botën e brendshme të njerëzve tanë në një shkallë të lartë; njerëzit e thjeshtë të popullit, të edukuar nga Partia, vunë interesin e përgjithshëm të atdheut mbi atë të tyrin. Në ato kohë s'kishte për ju bir, djalë, vajzë, shtëpi, pasuri përpara atdheut, Partisë, popullit.

Në Vlorë, ku luftonin shokët tanë të shquar si Hysni Kapo e të tjerë, u ngrit kundër Partisë një tradhtar, Sadik Premtja, të cilit duhej t'i bënim varrin, ndryshe rrezikohej çështja e Partisë dhe e popullit. Me këtë rast, vajta atje edhe unë për t'u bashkuar me shokët. Këtë e di nëna e Ymer Veshit, ajo trimëresha aty pranë që mbase nuk ta zë syri. Hipëm me të në automobil, mirëpo s'ishte punë e lehtë, se në çdo qoshe, si në qafën e Koshovicës e gjetkë, bëhej kontroll. Në këto udhëtime ne edhe mund të vriteshim, se ndodhte që të mos mbanim armë. Policët ndaluan automobilin, po ajo dhe unë mundëm të kalonim vetëm në sajë të gjakftohtësisë. Shoku Hysni Kapo¹, e mban mend, kur kaluam njëherë te xha Sherifi, në Mazhar. Të kujtohet xha Sherif ajo kohë, se na ke pritur më mirë nga djemtë e fëmijët e tu. E mbaj mend si tani sa mirë ishin lyer shkallët me gëlqere, deri edhe kamarret. Pastaj zbritëm në Tragjas ku filluam luftën kundër fraksionistëve të Partisë. Një zë ushtoi në atë kohë

1. Shoku Hysni Kapo shoqëronte shokun Enver në këtë takim.

nga populli i Tragjasit dhe i gjithë Vlorës «Partia mbi të gjitha». Popull e Parti, në unitet të plotë, e likuiduan fraksionin.

Adivije Agolli një djalë të vetëm kishte, i cili çdo ditë mund të pushkatohej nga armiqtë; vajzat, gjithashtu, mund t'i vriteshin, mund t'i digjej edhe shtëpia, po ajo s'u përkul, u tregua trimëreshë; shtëpinë e saj, ku kemi bërë mbledhje të panumërta, ajo e vuri në dispozicion të Partisë.

Tërt s'ia bëri syri Ije Farkës. Edhe kjo, si trimëreshë, e bëri shtëpinë kështjellë. Atje, tok me Vojo Kushin, Sadik Stavalecin, Xhoxhi Martinin e të tjerë, ne venim e vinim si në shtëpinë tonë. Megjithatë Ija nuk trembej. Përse? Se çështja e Partisë për çlirimin e atdheut ishte për të mbi të gjitha! Dhe kështu siç vepronte Ija vepronte populli në gjithë Tiranën.

Të gjithë e njohin barakën e Gogo Nushit, plakun dhe plakën trime të Sabaudin Gabranit, plakën e dashur e të afërt të Lym Shyrit. Sa herë venim atje, kur punonim në ilegalitet, me kokë në torbë, ato na pritnin me ngrohtësi. Të gjithë ne, që Partia na kishte caktuar të punonim në Tiranë, i kishim kudo portat të hapura. E çfarë mund të themi pastaj për plakun Riza Dashi? Ka njeri sot këtu nga kjo familje, mbasi di që plaku ka vdekur? (*Ngrihet plaka*). Si je nënë? Trimëreshë ke qenë, ashtu siç ka qenë trim dhe i dashur plaku. Në shtëpinë tuaj jam pjekur për herë të fundit me Qemal Stafën që ra heroikisht për çështjen e madhe të atdheut.

Partia e filloi veprimtarinë e saj në Tiranë, po lufta mori përnjëherë zjarr në të gjitha anët e Shqi-

përisë, në qytete e fshatra. Komunistët u vunë në ballë të luftës dhe e udhëhoqën popullin gjër në fitore. Unë kam pasur rastin të shkoja gjatë luftës në shumë rrethe. Në Elbasan kam qenë në shtëpinë e Ali Myftiut, mësues, luftëtar, komunist dhe partizan. Ja ku e kemi akoma! I moshuar, por i ri është nga zemra. Edhe File Musai me leshra të bardha është tani, por si djalë i ri mbahet. Shtëpia e tij ishte bazë e sigurt për ne. Apo jo shoku Spiro [Moisiu]? Ç'kemi hequr kur vajtëm atje, i dinë të gjithë, se janë shkruar. Po Tare Dyrmishi rron apo ka vdekur? Unë dëshiroja të rronte, po ja, ka ardhur i biri! Kishe një baba shumë të urtë dhe shumë të dashur.

Edhe nga Shmili kam kujtime të mira. Atje kam qenë tek Ali Disha. Këtu, nga sa shikoj, kemi nusen e Zenel Dishës, Kadifenë. Ali Disha ishte plak trim. Mban mend, shoku Spiro, kur na thanë se mbërritën ballistët në Shmil? «Na jep pushkën», — i thamë Aliut, dhe shkuam zumë grykat, kurse Zenelin e dërguam të shikonte. «Ti, — i thamë Aliut, — rri këtu në shtëpi, me plakën, mos lëviz, ruaj Abazin» (*i biri i Zenelit dhe i Kadifesë, që atëherë ishte kalama i vogël*). Aliu i thoshte atij vazhdimisht: «Abaz, mos na mërzit!». Kurse Abazi i varfër, afrohej tek unë dhe më fërkonte koburen. «Ç'do, more Abaz», — i thosha unë. «Thuaj nënës të më japë një dardhë», — më thoshte në vesh djali. Ai i ziu donte një kokërr dardhë. Atëherë unë i lutesha plakës që t'i jepte një kokërr dardhë Abazit.

Të gjithë e dini jetën e Zyhra Koçit! Para tre vjetësh u poqëm edhe një herë me të në Labinot ku

vajtëm për festë. Zyhraja rrinte afër meje, si nëna me djalin. Mirëpo pashë që po vinte drejt meje një djalë i ri. Ishte Abaz Disha; kisha 20 e ca vjet pa e parë. Sa vjet u bënë moj Kadife që nuk e kisha parë Abazin, se ishte fare i vogël në kohën e luftës? Po, më 1968 Abazi ishte bërë 30 vjeç, kishte mbaruar ushtrinë. Ai m'u qas të më ngalasë duke qarë. «Kush je ti, more djalë», — i thashë. «Jam Abazi», — u përgjigj ai. «U», i thashë dhe e ngalasa. Po nënë Zyhraja, së cilës i janë shteruar çezmat e lotëve, pse ka vuajtur shumë në jetë e zeza, — i tha: «Mos qaj, Abaz, se je përpara Komandantit».

Po Çekajt në Shmil si janë? Sherifi ishte burrë i pjekur dhe i urtë, kurdoherë i vendosur për Partinë. Rama e di që vdiq, ai ishte më i hedhur, brenda gjysmë ore kishte borxh të gjendej tek Ura e Haxhi Beqarrit, në shtëpinë e Myftar Hoxhës, si pendë. Kurse Sherifi, të kujtohet Spiro, ishte i matur, i pjekur.

Plakun e Bozhiqit e gjithë të tjerët të tërë me radhë i kujtojmë ngaherë.

E si mund t'i harrojmë miqtë, shokët e luftëtarët nga Vlora?

Midis fshatrave që përshkuam me Hysninë, kaluam edhe nga Hysoverdha, i ramë Mavrovës mes për mes dhe më në fund, më kujtohet, po nuk e kam ekzaktësisht të qartë, u futëm në një kasolle. «Duam një çikë bukë», — i tha Hysniu. «Ju jap unë, të kegen, — tha e zonja e shtëpisë, — po nuk kam gjë tjetër, veç t'ju tiganis një çikë djathë?». «Po ku je, — i thashë unë, — ku ma ke gjetur këtë djathë, që unë e dua kaq shumë». Mua, të ma shtrosh sofrën me ç'të

duash dhe asgjë tjetër nuk dua përpara djathit, se plaka më ka rritur me bukë kallamboqi e djathë hirre. Po ajo i fuste shumë kripë djathit, që ta hanim nga pak. E po «gjirokastritë» ne, ishim një çikë të kursyer. Kujtime, kujtime të bukura, të paharruara!

Nga Shpati kaluam te File Musai dhe Tare Dyrmishi.

Në Helmës kemi ndenjur gjatë me xha Mehmetin, plak trim, i lidhur ngushtë me ne ditë e natë. Kështu ishte edhe Nuri Bilimani, kunati i Nurihanit. Rron vallë Novruzi?

SHOQJA NURIHANE BILIMANI: Novruzi është në Helmës, kurse unë tani jam në Lushnjë.

SHOKU ENVER HOXHA: Nurihani kishte ca kalamanë, njëri prej të cilëve ishte një çikë zeshkan nga fytyra; mbante veshur një këmishë po ecte zbathur, pa këpucë. Ishin të këputur, të zinjte. Ky zeshkani më qepej pas si manar. Unë ia kisha vënë emrin «Negus». Ai më thoshte se donte të bëhej partizan, ama më rokanisi. «Mirë, — i thashë, — do të bëhesh partizan, por ama në qoftë se do të kalosh provimin, ndryshe s'të marr». «Po», më thoshte djali, që ishte katër vjeç atëherë. Ja pra, provimi është ky: «E para, — i thashë, — unë do të shtie me kobure, por, po mbylle sytë, nuk kalon». Ashtu e konceptonte ky fëmijë partizanin, me kobure dhe cigare. «Prandaj kur të hedh pushkë, mos i mbyll sytë. E dyta, kur të të jap cigarin ta pish si partizanët, të mos kollitësh». «Mirë», pranoi ai. Atëherë, një ditë, qita me kobure dhe «Negusi», tëk, mbylli sytë. Kjo ishte e natyrshme për të, se ai ishte fare i

vogël. «Atëherë, «Negus», i thashë, — provën e parë nuk e kalove. Pa le të fillojmë me të dytën».

SHOQJA NURIHANE BILIMANI: Ke shumë të fala prej tij.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu, faleminderit! Tani ai është bërë burrë. «Tani, — i thashë pas kësaj, — le të provojmë cigaren». Ja vura në gojë. Sa e thithi, filloi të kollitej. Kur po bënim këto biseda me «Negusin», një shok na mori në fotografi. I kam akoma fotografitë që kam dalë me Novruzin.

SHOQJA NURIHANE BILIMANI: Po kur i thoshe «mbyll sytë dhe hap gojën», të kujtohet? Ai të gjitha i mban mend, megjithëqë ishte i vogël.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, po, më kujtohet. Kam shumë gjëra të paharrueshme nga ajo kohë. Tani, unë nuk e kam parë të rritur, por më kanë thënë se është bërë djalë i mirë dhe ka vajtur në Shkollën e Partisë.

Kam qenë edhe te Pasho Hysi, nga Vërzhezha, te xha Hyseni i Zaloshnjës. Hyseni kishte plakun, një burrë i vjetër nga ata të 1912-s. Mbaj mend që na thoshte: «Luftoni djema, luftoni, se kështu ka luftuar edhe Ismail Qemali. Unë kam qenë vetë në Vlorë, në atë kohë dhe kam parë që ai gëzohej shumë kur mbli-dhej rinia».

Edhe nga Korça kam plot kujtime të dashura. Atje unë kam punuar e kam qëndruar në ilegalitet gjatë luftës. Në rrethin e Pogradecit kam qenë në Mokrën e paharruar ku u poqëm edhe me Heroin e Popullit Reshit Çollakun, me vëllanë e tij Muharrem Çollakun, si edhe me Liko Gjonin e Zyko Kalivaçin. Të kujto-

het Zyko? Ti i mban mend të gjitha këto, se ke luftuar krah për krah me Reshitin. E shikoni, ai ka qenë një nga luftëtarët më të shquar të Pogradecit, komunist, bolshevik, i fortë, i kulluar si populli, si Partia. Zyko Kalivaçi e quajnë. Si të gjithë ju edhe ai ka një emër të thjeshtë.

Pra, siç thashë, kujtimet na mbajnë të gjallë, na japin forca, prandaj bëjmë shumë mirë kur i përsëritim. Bëtë jashtëzakonisht mirë, motra dhe vëllezër, që erdhët të piqemi pikërisht në pragun e Kongresit, pse na shumëfishuat forcat.

Ne u themi kurdoherë shokëve që në luftën për ndërtimin e socializmit, sikundër e dini, ka edhe vështirësi subjektive, edhe objektive. Ka shokë që sikur ndrydhen kur shohin që s'erdhi kjo ose s'erdhi ajo. Atëherë, për t'i shtyrë përpara me hov, argumenti ynë më i fortë është kur u themi të mendojnë se ç'ka bërë populli në kohë jashtëzakonisht të vështira, kur vihej në teps, me sot me nesër, orë e çast, koka. Cilido mund të vritej, megjithatë nuk donte t'ia dinte, po shkonte pa u trembur në luftë. Dhe cili ishte rezultati? Ja, fituam kundër armiqve aq të shumtë e të fortë. Po tash? Tash që i kemi të gjitha ç'na duhen, pse na dalin disa pengesa e të tërhiqemi? Në asnjë mënyrë! Prandaj, hajt të mobilizohemi dhe t'i kapërcejmë, na mëson Partia.

Dhe, në fakt, çfarë ngjet? Ngjet që populli dhe Partia, komunistët dhe ata që nuk janë në Parti, gjithë patriotët, janë ngritur me një hov të madh në luftën gjigante për të ndërtuar socializmin, që nuk është parë kurrë në historinë e Shqipërisë. Në kohën e luftës vi-

hej me të vërtetë në balancë jeta e njeriut, pse në çdo qoshe komunistët dhe patriotët mund të vriteshin apo t'u digjej shtëpia. Ky është fakt. Po edhe vështirësitë për ndërtimin e socializmit kanë qenë dhe janë jashtëzakonisht të mëdha. Megjithatë Partia dhe populli kurrë nuk u përkulën, por i kapërcyen ato në mënyrë shembullore. Kjo ngjau se vija e Partisë ishte e drejtë, ishte për popullin, se ajo përfaqësonte dëshirat e tij, dëshirat tuaja, dëshirat e atyre që u vranë dhe u dogjën. Pikërisht këtë vijë populli e pa qartë si në pasqyrë dhe e përqafoi, e mbrojti, e zbatoi, pa marrë parasysh asnjë sakrificë e vështirësi. Kështu u kapërcyen të gjitha pengesat që na dolën.

E ç'nuk bëri populli nën udhëheqjen e Partisë! Ai nga hiçi ndërtoi vepra të mëdha me duar, me krahë, me vullnet, me tru, me mësim, me gjykim. Porosia e Partisë për çdo njeri ishte: «Mëso, ndërto, lufto, vigjillo!». Kështu po ndërtohet me sukses socializmi, respektohet Shqipëria në botë, duke u bërë një vend për të cilin miq dhe armiq kanë respekt të madh.

Aktualisht, në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, lufta më kryesore bëhet në mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të cilën flet hapur gjithë shtypi botëror dhe diplomatët. Në këtë ndeshje vihet çështja se kush do të fitojë votat më të shumta për pranimin e Republikës Popullore të Kinës: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vend shumë i madh kapitalist, imperialist, apo Shqipëria e vogël që përfaqëson socializmin e pamposhtur? Dhe Shqipëria, me punën që ka bërë, me pjekurinë dhe luftën e saj, me politikën e drejtë që ka ndjekur po arrin të thycejë shu-

më pengesa dhe ka bërë që numri i atyre që votojnë për vijën e saj, për të pranuar Kinën në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, të rritet vazhdimisht e më shumë.

Edhe fqinjët tanë, të tërë, i njihni kush janë, prandaj s'ka nevojë të zgjatem për t'jua bërë të qartë këtë çështje. Ç'nuk ka bërë Jugosllavia për të na mposhtur, po s'na bën dot gjë. Ne jemi të fortë. Po të mos jesh i fortë, të marrin nëpër këmbë të tjerët. Jugosllavia është bërë një vend kapitalist, ku vetëm kohët e fundit janë ngritur çmimet deri në 40 për qind. Atje është zhvlehtësuar monedha deri në 25 për qind. E gjithë ekonomia jugosllave varet nga kreditë e imperialistëve. Kjo ndodh se Titoja është një renegat, ai i ka rrjepur e i ka dërrmuar popujt e Jugosllavisë.

SHOQJA BIJE VOKSHI: Ne shqiptarët krenohemi për çka Ti je tu i premtu popullit! Ti na ke dhanë mundësi me rucjtë bujarinë. Pleqtë e moçëm në Kosovë veç për popullin e Shqipërisë mendojnë.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë. Ju lumtë!

SHOQJA BIJE VOKSHI: Gjithmonë ne kemi luftue, po nuk kemi pasë udhëheqës, ashtu sikur dite Ti për të udhëheqë popullin shqiptar. Edhe unë që jam mysafire, ma shumë kam luftue këtej, se në Kosovë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po Bije, kështu si thua ti ka qenë.

SHOQJA BIJE VOKSHI: Njeriun asht kollaj me e njoftë në luftë, se në luftë asht ja vdek, ja gjallë. Enveri u jepte kurajë partizanëve për me dalë malit. I kanë pushkatue partizanët dhe nuk e kanë qitë shokun. Ne jemi krenarë për luftën, ne punuem e luftuem.

SHOKU ENVER HOXHA: Me Jugosllavinë vazhdimisht kemi dashur të kemi marrëdhënie të mira e të rregullta dhe për këtë i ngritëm përfaqësitë në rang ambasadash. Edhe Greqia lidhi marrëdhënie diplomatike me ne. Kjo ndodh se autoriteti i vendit tonë, i Republikës Popullore të Shqipërisë, i socializmit, që përfaqëson vendi ynë i udhëhequr nga Partia, ka krijuar respekt të madh në botë. Kjo i detyrohet luftës së popullit, luftës së Partisë. Kjo luftë nuk bëhet vetëm me fjalë, nuk është luftë vetëm në fushën ideologjike dhe politike, por është një luftë konkrete që ka krijuar mundësi të zhvillohet me shpejtësi ekonomia e vendit tonë, industria, bujqësia, arsimit e kultura. Forca ekonomike luan një rol të madh në fatet e një populli dhe të një shteti. Ne zhvilluam dhe vazhdojmë ta zhvillojmë ekonominë tonë me hapa të mëdhenj dhe të sigurt, njëkohësisht marrim masa të forcojmë edhe mbrojtjen e atdheut, ushtrinë tonë, armët e diktaturës së proletariatit. Këtë e bëjmë për të qenë të gatshëm në çdo moment.

Kongresi i 6-të i Partisë do të jetë një nga ngjarjet historike më të mëdha të Partisë dhe të popullit. pse ai do të aprovojë programin për zhvillimin akoma më tej të ekonomisë sonë. Bujqësia në Shqipëri do të përparojë shumë e më shumë nga sa ka përparuar deri më sot, pse do të marrim masa të gjithanshme për përmirësimin e mëtejshëm të tokave, në shtimin e mekanizimeve, të traktorëve, të ujitjes, të farërave të zgjedhura, të kafshëve, sidomos lopëve të racës që japin më shumë qumësht dhe mish. Në këto drejtime do të arrihen kështu rezultate të mëdha jo vetëm në

fushë, por sidomos në malësi, ku do të ngulim këmbë në mënyrë të veçantë për një zhvillim më të shpejtë të forcave prodhuese.

Me këtë rast dëshiroj të theksoj heroizmin e fshatarëve të fushave e të maleve. Mësimet që u ka dhënë dhe u jep atyre Partia jo vetëm nuk kanë shkuar kot, por ato janë bërë armë të forta në duart e tyre për ta çuar bujqësinë me hapa të shpejtë përpara. Dhe në fakt ne shikojmë tani se ngritja e rendimenteve të prodhimeve bujqësore, qoftë të drithërave, qoftë të bimëve të tjera, si edhe të prodhimeve blegtorale, është rritur. Bile, tash, ka sektorë në kooperativa, ku rritja e prodhimit është bërë shembullore. Në këtë rrugë po ecin tash në bllok të gjitha kooperativat bujqësore. Kjo do të thotë se fshatarësia i ka kuptuar thellë mësimet e Partisë që bujqësia të zhvillohet me ritme të shpejta. Po për t'u zhvilluar më tej bujqësia në këtë rrugë duhet disiplinë në punë, duhet edhe dituri. Prandaj bijat dhe bijtë e fshatarëve kanë mësuar e vazhdojnë të mësojnë. Këtë e tutje ata duhet të mësojnë akoma më shumë që të bëhen specialistë të vërtetë të bujqësisë, jo me një, dy e tre veta, po me qindra e mijëra. Për këtë qëllim janë hapur shkolla nga të katër anët e Shqipërisë, të cilat do të shtohen e do të forcohen edhe më tej në këtë pesëvjeçar.

Zbatimi i të gjitha këtyre detyrave, vëllezër dhe motra, do të bëjë që vlera e ditës së punës në kooperativat bujqësore të rritet, që kooperativistët të kenë më shumë të ardhura, më shumë drithëra buke, më shumë qumësht, më shumë yndyrna, mish etj. Partia mendon se bujqësia është baza e shëndoshë e ekonomisë sonë

socialiste dhe punon që prodhime bujqësore e blegto-rale të ketë me bollëk kudo; të ketë jo vetëm fshati, po edhe klasa punëtore dhe gjithë punonjësit e qyteteve, të cilët punojnë në industri e në gjithë sektorët e tjerë në mënyrë shembullore.

Edhe prodhimi industrial këtë pesëvjeçar do të rritet. Industria jonë e rëndë do të shtohet me elemente të tjera të rëndësishme, siç është përpunimi në vend deri në fund i mineraleve tona. Të marrim për shembull naftën. Ne do të ngremë rafineri të atilla nga të cilat do të nxjerrim një sërë lëndësh me rëndësi që përmban ajo, të cilat tash i sjellim nga jashtë. Kur flasim për naftën nuk keni parasysh vetëm vajgurin dhe benzinën. Ajo ka edhe nënprodukte të tjera. Me naftën ne, në një të ardhme të largët, do të zhvillojmë edhe industrinë kimike, petrokiminë. Kështu, pasi të ndërtohet rafineria, do të ngrihen me radhë një sërë fabrikash të tjera për nënproduktet e saj.

Për këtë qëllim dhe për këtë perspektivë punojnë djemtë dhe vajzat tuaja gjeologe, për të cilat kanë respekt të madh populli dhe Partia, pse punojnë me zell të madh për të zbuluar nën tokë, me mijëra metra thellë, më shumë naftë, më shumë hekur, më shumë krom e minerale të tjera që mban në gjirin e vet vendi ynë i begatshëm.

Përpara, njerëzit tanë, ngaqë nuk dinin, qaheshin nga varfëria e sëmundjet dhe thoshin: «Si e bëri «perëndia» këtë punë kështu? të tëra të mirat i hodhi andej-këtej, po kur i erdhi radha Shqipërisë, në këtë vend, lëshoi shpellat». Mirëpo nën këto shpella paska ç'paska! Dhe këto pasuri nuk i ka bërë «perëndia», siç

thoshin të vjetrit. Nën këto shpella djemtë dhe vajzat e popullit po zbulojnë thesare të vërteta. Ata po ngrenë fabrika, po çojnë përpara bujqësinë, arsimin, kulturën, përgatitin jetën e lumtur e të begatshme.

Këto janë arsytet që gjithë popullin e ka pushtuar një gëzim i madh e besim i papërshekruar për të ardhmen. Ky besim dhe ky gëzim për Partinë e tij të shtrenjtë që e çliroi për tërë jetën nga prangat, që i siguron të ardhmen, jetën e lumtur dhe me të cilën është i lidhur ngushtë si mishi me thoin, është real. Nuk ka sot njeri në Shqipëri që të jetojë e të marrë frymë, që nuk bisedon e gjykon punën e tij çdo ditë e çdo orë me matësen e Partisë. Kushdo, kur bën një punë, pyet veten: «Kjo që bëj, është në interesin e Partisë apo jo?». Në rast se gjykon që është në interes të Partisë, ai vazhdon. Në rast se sheh që nuk është, përpiqet të gjejë rrugën e Partisë.

Të gjithë sot marrin pjesë vazhdimisht nëpër mbledhje nga më të ndryshmet në lagje, në fabrika, në ara e kooperativa, për të diskutuar dhe për të zgjidhur sa më mirë problemet që na vihen përpara. Njerëzit flasin, kuvendojnë, diskutojnë, vendosin e kritikojnë. Po pse e bëjmë kritikën e autokritikën? Mos vallë se nuk e duam shoqi-shoqin? Jo! Në asnjë mënyrë! Përkundrazi, këto i bëjmë pikërisht se ia duam të mirën shoqi-shoqit, prandaj veprojmë kështu, se e keqja e njërit është e të gjithëve, e mira e njërit është edhe për kolektivin. Partia përpiqet që të gjithë të jenë mirë, pse mirësia në këtë rast është shumë e madhe. Duke e parë me këtë sy kritikën dhe autokritikën, ato bëhen armë të fuqishme në duart e Partisë dhe të punonjësve tanë.

Kritika e drejtë nuk i fyen njerëzit. Mund që ndonjërit t'i vijë pak hidhur në fillim, po Partia i mëson njerëzit që gabojnë që, kur kthehen në shtëpi, të mendojnë përse iu bë kritika. Duke reflektuar me gjakftohtësi ata do të kuptojnë avash-avash se duhet të ecin drejt. Ka edhe raste kur kritika bëhet pa të drejtë. Atëherë vetë i kritikuari duhet të ngulë këmbë që t'i vihet në vend padrejtësia e bërë. Po edhe Partia, edhe opinioni, duhet përnjëherë ta mbrojnë me këmbëngulje atë, të cilit i është bërë padrejtësia.

E tillë është vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë, ndaj së cilës nuk mund të ketë sukses asnjë punë armiqësore. Partia përpiket t'ia bëjë të njohur këtë vijë çdo njeriu, kështu i ka mbrujtur dhe i mbrun ajo njerëzit tanë. Kundër ndonjërit mund të qëllojë që të bëhet edhe ndonjë veprim i gabuar apo i padrejtë, por mund të ketë jetë vetëm për pak kohë, pse padrejtësia i ka kurdoherë këmbët të shkurtra. Vjen koha që ajo pëlçet si flluska e sapunit, pse Partia sapo i zbulon ata që bëjnë padrejtësi, i ndëshkon rreptë. Këto qëndrime të drejta të Partisë, edukimi i njerëzve në nivel të lartë politik, ideologjik dhe luftarak, e bëjnë vendin tonë të fortë, pse ato ngrenë lart moralin dhe besimin e popullit, të rinisë dhe të grave tona, me klasën punëtore në krye, dhe i kalitin e i bëjnë të gatshëm për heroizma. Është për këto arsye që Partia jonë merr vendime kaq të guximshme e që shumë njerëzve nuk ua merr mendja se si mund të bëhen brenda një kohe të shkurtër gjithfarë veprash madhështore. Këtë e bën vetëm heroizmi i popullit.

Po nga dalin gjithë këta miliardë, gjithë këto fon-

de kolosale materiale, me të cilat ndërtohen uzina e fabrika, hidrocentrale, rrugë e hekurudha, kanale ujitëse e kulluese e të tjera e të tjera, kur në vendin tonë, popullit nuk i merret asnjë taksë, ndërsa çmimet e mallrave nuk ngrihen? Nga populli dalin, nga puna juaj, po pa ju shqetësuar fare, përkundrazi, jeta e masave ecën çdo vit gjithnjë e më përpara. Me djersën e këtyre bëhen investime për ndërtimin e një hidrocentrale, dy hidrocentraleve, tre, të 10 fabrikave apo uzinave, të cilat prapë u sjellin masave të mira. Partia punon si një nikoqire e mirë që di ta kullandrisë si duhet ekonominë familjare me të ardhurat që merr, duke siguruar familjen si me ushqim, ashtu edhe me veshje e me të gjitha sendet e tjera të nevojshme. Partia, të ardhurat e ekonomisë popullore i administron për të mirën e të gjithëve, ndërsa atyre që prekin interesat e popullit, që dëmtojnë pasurinë e përbashkët i korrigjon dhe, kur s'dëgjojnë, «u pret duart», i çon për riedukim.

Rruga që ndjek Partia jonë është ajo që na mëson në Marks, Engels, Lenini e Stalini, prandaj populli e mbron atë me të gjitha forcat e shpirtit, duke punuar, duke luftuar dhe duke mësuar. Kështu duhet kuptuar kjo çështje.

Unë nuk dua t'ju mërzit më gjatë, se jeni të lodhur. Siç ju thashë, dëshira ime është të rri me ditë të tëra me ju, që të çmallen.

SHOQJA NIMETE VESHI: Të lumtë goja dhe të na rrosh përjetë!

SHOKU ENVER HOXHA: Prandaj, edhe një herë, në emër të Partisë, të Komitetit Qendror, në emër

të Qeverisë dhe timin, ju falemnderit nga zemra për ardhjen në këtë takim. Me këtë rast unë dëshiroj t'ju shpreh nga ana e Partisë dhe imja veçanërisht mirënjohjen e thellë që, pa më njohur në ato kohë aq të vështira, më keni mbrojtur, më keni ushqyer, më keni larë e ndihmuar, duke rrezikuar edhe jetën, njëlloj sikur këtë ta kishit bërë për djemtë dhe vajzat tuaja. Në ato kohë nuk njiheshim me njëri-tjetrin, si tani; atëherë ishim njëlloj të tërë, partizanë, por zemra juaj rrihte si vullkan nga dashuria e fortë për atdheun e për Partinë.

Unë veçanërisht jam shumë i prekur nga ky takim, prandaj ju falënderoj nga zemra dhe dëshiroj t'ju theksoj se nuk do t'ju harroj kurrë për atë që keni bërë. Partia, gjithashtu, nuk do t'ju harrojë kurrë ju dhe gjithë popullin për atë që keni bërë për Partinë. Pa popull nuk mund të kishte Parti, nuk mund të kishite fitore; po edhe populli pa Partinë nuk mund të çlirohej dhe të ndërtonte socializmin, nuk mund të rronte ashtu si sot, i lirë dhe në begati. Të dy, Parti dhe popull, janë lidhur si mishi me kockën me njëri-tjetrin, prandaj të luftojmë që të çelikoset më tej ky unitet i fortë në mes tyre.

Le ta pimë këtë gotë për shëndetin tuaj! Qofshi të gëzuar me të gjithë të dashurit e zemrës! Të rrojë Partia jonë!

SHOQJA ADIVIJE AGOLLI: Ta ngremë dollinë për Partinë dhe shokun Enver. Gjithë këta shokë e këto shoqe që janë këtu, kishte kush i udhëhiqte gjatë luftës, ishte shoku Enver që ka qenë gjithmonë pranë nesh.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju falemnderit! Të rrojë Partia!

Hajde ti, e shoqja e Ymer Cohës, ta tokim bashkë njëherë. Të na rrojë Partia! Kasollen ku kam ndenjtur te ju, e keni?

Pa merrnani, shokë, njëherë në fotografi me nënë Hurmanë! Afrohu dhe ti Zyhra.

Pastaj shoku Enver Hoxha takohet, interesohet, pyet e bisedon me pjesëmarrës të ndryshëm në këtë takim:

SHOQJA NURIHANE BILIMANI: Të na rrosh sa malet shoku Enver! Ne të kemi djalë, po të themi edhe shok. Sa malet të na rrosh! Na udhëhoqe dhe po na udhëheq në rrugë të drejtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa djem ke nënë Hurma?

SHOQJA HURMA COHA: Kam tre djem.

SHOKU ENVER HOXHA: Të rrojnë! Kanë kalamanë?

SHOQJA HURMA COHA: Po, kanë.

SHOKU ENVER HOXHA: Më ka marrë malli për Galigalin. Po nga Muço Boduri kush rron?

SHOKU DHIMITËR BODURI: Jam unë, djali i tij.

SHOKU ENVER HOXHA: Po hajde mor djalë të të shoh një çikë. Si je more Dhimitër? Ti ke qenë i vogël atëherë. Muçoja ka vdekur?

SHOKU DHIMITËR BODURI: Po, ka vdekur.

SHOKU ENVER HOXHA: *(Duke iu drejtuar Hurma Cohës)* Ymer Cohë, burri yt, kur ngjiteshim rripave në pyje, më zuri njëherë nga krahu dhe më tha: «More shoku Enver, ma ka qejfi ta shoh njëherë atë

major Spiron». «Po, do ta shohësh, — i thashë unë, — edhe major Spiron». Ne ishim atëherë ilegalë, megjithatë, ia dhashë fjalën se do t'ia tregoja. Kështu, kur erdhëm në kasollen ku ti na bërë darkën i thashë Ymerit: «Ja ku është major Spiroja». «Ku je, o major Spiro?», i tha Ymeri dhe ne me Spiron e ngalasëm atë. E kishe burrë të mirë Ymer Cohën, të urtë e patriot. Edhe Belul Bicaj ishte burrë shumë i mirë, po edhe ky ka vdekur.

SHOQJA HURMA COHA: Ka pesë vjet që ka vdekur Ymeri.

SHOQJA KATERINA DEDJA: Unë jam e bija e Belulit.

SHOKU ENVER HOXHA: Si je, mirë? E kishim shok shumë të mirë Belulin. Ishte njeri i urtë. Ja, o Spiro, kjo është çupa e Belulit.

Xha Sherif, te shtëpia e vjetër rri zotrote? Kur kemi zbritur poshtë nga Qafa e Mazharit, Hysniu ishte i ri dhe ecte si era atëherë, kurse unë isha një çikë i rëndë nga këmbët. Prandaj, kur ngjitëm Qafën e Mazharit, sikur u lodha ca. Mirëpo kur vajtëm sipër, Arif Beluli na gostiti me dhallë, që sikur na çlodhi, sikur u shëruam nga një sëmundje.

Bujqësia, andej nga ju si është tash? Morët mirë grurë? Keni ndërtuar kanale për ujilje?

SHOKU SHERIF HASANI: Grurë morëm mirë, po për ujilje akoma nuk kemi bërë gjë.

SHOKU ENVER HOXHA: Xha Mehmet, do të vij ndonjëherë andej nga ju dhe besoj që do të ma japësh filxhanin e rakisë.

Më erdhi një herë vjet xha Mehmeti¹ në zyrë me gjithë djalin që të piqej me mua. Djali është i ri akoma, po sa fola pak me xha Mehmetin, kur s'kishte kaluar akoma as pesë minuta, m'u drejtua e më tha: «Na falni tani shoku Enver, se mos të të bezdisim». Unë i thashë të birit të xha Mehmetit: «Po të duash shko ti, unë do të rri me plakun tënd». Donte të mbante etiketën djali i xha Mehmetit: «Po rri mor djalë, — i thashë, — ç'janë këto që thua, xha Mehmetin unë e kam si plakun tim!».

SHOKU FILE MUSAI: Të kujtohet, shoku Enver, kur na erdhe atëherë?

SHOKU ENVER HOXHA: Djemtë i kishe të mirë. Kur erdha në shtëpinë tuaj rronte edhe plaku. Ai na mori pushkët dhe na i vari në mur, pastaj dolëm sipër në papafingo dhe pamë vendin së larti.

Nga sa më kanë thënë, ti File banon tani në Elbasan. Kur të vij ndonjëherë, do të të bëj një vizitë në shtëpi. I thuaj Kadriut se nuk kishte të drejtë që të kritikoi për letrën që më dërgove. Ti kishe të drejtë. Shokët, kur erdha në Elbasan, duhet të më kishin treguar që banoje aty dhe unë me siguri do të të kisha ardhur për një vizitë. U kuptuam tani? Ja, kështu i thuaj Kadriut.

Ç'fëmijë ka lënë Sherifi?

SHOQJA SELIME ÇEKA: Ka lënë dy çuna dhe pesë goca.

SHOKU ENVER HOXHA: Punojnë në kooperativë?

1. Mehmet Myslimi. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 44, f. 281.

SHOQJA SELIME ÇEKA: Ne jemi në ndërmarrje bujqësore, njëri prej tyre është shofer, tjetri ka shkuar ushtar.

SHOKU ENVER HOXHA: Të të rrojnë!

Abazin e ke martuar ti Kadife?

SHOQJA KADIFE DISHA: Po, e martova.

SHOKU ENVER HOXHA: I gjete ndonjë nuse të mirë? Është i kënaqur dhe ka bërë ndonjë fëmijë?

SHOQJA KADIFE DISHA: Ka katër kalamaj.

SHOKU ENVER HOXHA: A m'i lumtë, kështu më tha Enveri, — i thuaj atij. Ashtu do Partia. Përveç atyre katër që ka, të bëjë edhe të tjerë. I thuaj edhe gruas së tij se kush bën 10 fëmijë te ne, merr titullin: «Nënë heroinë». Partia do dhe ka nevojë për trima dhe trimëresha.

Po nga Bozhiqët ka njeri këtu?

SHOQJA KADIFE DISHA: Është Veliu, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Po si je more Veli, je mirë? Unë me plakun tënd e kisha mirë atëherë. Ishte burrë i mirë.

SHOKU VELI BOZHIQI: Mbani mend kur rritit bashkë me Ali Dishën dhe me plakun, shoku Enver. Kur ju sollën Ju tek Ali Disha filloi të bjerë borë, pastaj kaluam.

SHOKU ENVER HOXHA: Po Ali Gjura ku është?

SHOKU ALI GJURA: Ja, këtu jam, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Si, qenke këtu dhe nuk ndihesh fare! Po çohu bre burrë të të shoh! Si je? Ku je more Ali Gjura? Tani në pension je?

SHOKU ALI GJURA: Po, në pension. Të urojmë

shoku Enver shëndet të plotë me gjithë Partinë, me gjithë popullin.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa fëmijë ke?

SHOKU ALI GJURA: Kam katër.

SHOKU ENVER HOXHA: E ke mirë me shëndet plakën?

SHOKU ALI GJURA: Po, mirë është.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu si këshillon Partia duhet të silleni të gjithë me gratë.

SHOKU ALI GJURA: Po, po, shoku Enver.

SHOKU HASAN KARAGJOZI: Unë jam vëllai i Ramës.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë! Si je, burrë i fortë? Gëzohem shumë!

SHOQJA SABRIJE OSMANI: Të urojmë shëndet të plotë, të rrojë Partia!

SHOKU ENVER HOXHA: Tani, si thoni, vemi të bëjmë edhe një fotografi të tërë së bashku, që ta kemi kujtim?

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

MOSDËRGIMI I DELEGACIONIT TË PKK — KONSEKUENCË E VIJËS REVIZIONISTE KINEZE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

15 tetor 1971

Unë jam dakord me të gjitha sa thatë ju, shokë. Natyrisht, ky qëndrim i udhëheqësve kinezë, me të drejtë të revoltton dhe ne i kuptojmë manovrat e tyre dhe ku e kanë ato qëllimin. Përse them që i kuptojmë? Sepse vija e partisë së tyre prej kohësh ka qenë e qartë për ne, prandaj asgjë nuk na gjen në befasi. Ne kemi gjykuar se vija e Partisë Komuniste të Kinës jo vetëm ka pasur një lëkundshmëri të vazhdueshme nga pozitat marksiste-leniniste, por ajo vazhdimisht ka qenë një vijë e theksuar oportuniste, liberale dhe revizioniste. Megjithatë, përgjigjen që na dërguan udhëheqësit e Partisë Komuniste të Kinës për të mos dërguar delegacion në Kongresin e 6-të të Partisë

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për përgjigjen që udhëheqja kineze i dha Partisë sonë lidhur me thesën që i ishte bërë PKK për të marrë pjesë me një delegacion partie në punimet e Kongresit të 6-të të PPSH.

sonë, ne nuk e pritnim, nuk na e merrte mendja që ata të arrinin deri këtu. Po ne nuk çuditemi për këtë qëndrim; ai është konsekuencë e vijës revizioniste që ndjekin ata.

Kuptohet se elementët e vendosur revizionistë aktualisht kanë marrë fuqinë në Partinë Komuniste të Kinës. Ata nuk janë aspak dakord jo vetëm me vijën marksiste-leniniste të Partisë sonë, por as me vetë njëri-tjetrin. Ne gjykojmë se, sikurse e kanë deklaruar kurdoherë kinezët, bile vetë Maoja ka thënë vazhdimisht që në Partinë Komuniste të Kinës është e natyreshme të ekzistojnë shumë vija. Tash, në mos 22 vija, atje ekzistojnë dy vija. Kështu, një herë shohim të dalë në partinë e tyre Liu Shao Çia, një herë tjetër Pin De Huaja, pastaj Çu En Lai e kështu të tjerë me radhë. Dikur thuhej që Çu En Lai do t'i pritnin kokën; tash del Lin Biaoja dhe kështu pas tij mund të dalë një tjetër e të tjerë, e të tjerë. Me një fjalë, atje ka një kaos në këtë drejtim.

Nga sa po shohim në Partinë Komuniste të Kinës tash po bëhet revizionimi i vijës që u ndoq gjatë Revolucionit Kulturor. Nga të dhënat copa-copa që lëshojnë vetë kinezët, del se në Kinë është duke u bërë organizimi i partisë. Mirëpo deri ku ka arritur ky organizim, deri ku është stabilizuar gjendja në parti, deri ku janë bërë zgjedhjet, deri ku janë zgjedhur komitetet e partisë të të tëra instancave e të tjera çështje si këto, ne nuk kemi dijeni. Dhe është në vijën e udhëheqjes kineze që Partinë e Punës të Shqipërisë, aleaten e vetme që kanë, mbrojtësen e tyre, nuk e informojnë

farc. Po përse nuk e informojnë? Sepse të tilla janë korrentet në Partinë Komuniste të Kinës. Elementët e korrentit të mirë (dhe të tillë atje ka pasur dhe ka shumë) shpesh na kanë thënë vetë: «Nuk ka si Partia juaj», «vetëm Partia juaj është në rrugë të drejtë» etj. Këta, pra, që janë deri anëtarë të udhëheqjes së partisë, bile deri anëtarë të Byrosë Politike, kanë qenë dakord me Partinë e Punës të Shqipërisë. Për sa kohë kanë dominuar këta elementë, përfaqësuesit e korrentit revizionist nuk kanë mundur dot të pengojnë dashurinë e madhe që ushqejnë masat e komunistëve dhe të popullit kinez për Partinë e Punës të Shqipërisë.

Ndërsa aktualisht, siç konstatojmë, atje ka filluar të mbisundojë korrenti revizionist. Shumë fjalë thuhën në shtypin botëror që nuk po konfirmohen akoma, prandaj për ne mbeten supozime. Vetëm çështja e Çen Po Tasë është konfirmuar që është «tradhtar», pse kjo na është komunikuar zyrtarisht. Për Kan She-nin na thuhet se qenka «i sëmurë», por, me sa duket, edhe ky është mënjeluar nga udhëheqja. Tani flitet sikur edhe Lin Biaoja është eliminuar e tok me të nuk po përmenden as disa udhëheqës të tjerë kryesorë, sidomos të ushtrisë.

Lidhur me këto sinjalizime, kudo, në të gjithë botën, po bëhen spekulime. Natyrisht ne nuk mund të bazohemi në këto spekulime, po në vijën dhe në strategjinë e madhe që na paraqiti Çu En Lai në lidhje me marrëdhëniet që ka filluar të zhvillojë Kina me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me vizitën që

pritet të bëjë atje Niksoni. Vajtja e Niksonit në Pëkin dhe «strategjia e madhe» që na paraqiti Çu En Lai, aktualisht, janë vërtetim i predominimit të vijës revizioniste në Partinë Komuniste të Kinës. Ato tregojnë prirjen për një afrim (natyrisht akoma jo puqje, pse kjo mund të vijë më vonë) me Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj., prandaj tani nuk mund të prononcohemi për këtë. Çështja është që tek udhëheqësit kinezë shohim të duken ndryshime në vijë.

Ku duken këto ndryshime? Ato duken në largimin gradual nga pozitat e Kongresit të 9-të të Partisë Komuniste të Kinës, nga vija që u parashtua në raportin që u mbajt atje në emër të Komitetit Qendror, ku çështjet u shtruan në këtë mënyrë: luftë kundër revizionizmit modern, me revizionizmin sovjetik në krye, dhe kundër imperializmit botëror, me imperializmin amerikan në krye. Konstatojmë se kjo strategji tashmë është përmbysur dhe nuk ekziston më. Udhëheqësit kinezë me fjalë mund të thonë sa të duan se kjo vijë vazhdon të ekzistojë. Ata kanë deklaruar që luftën kundër revizionizmit do ta vazhdojnë edhe pesë mijë vjet; që luftën kundër imperializmit amerikan do ta vazhdojnë deri në kapitullimin e tij të plotë, por për ne ka dy lloj luftërash: me armë dhe me muhabetë.

Po a ka vallë mundësi që në Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Kinës të jenë përplasur idetë, të jenë paraqitur për shqyrtim tezat për këtë ndryshim rrënjësor, për ndjekjen e kësaj strategjie të re? Me sa dimë ne, Komiteti Qendror i Partisë atje nuk është mbledhur për të vendosur një strategji të re. Këtë e them vetëm me supozim, mbasi nuk jemi infor-

muar se çfarë janë duke bërë kinezët brenda partisë së tyre. Por, sikur të supozojmë se mbledhja e Komitetit Qendror është bërë një çikë me vonesë, kur ka arritur atje letra jonë¹ (natyrisht ne atë e bëmë pa ditur gjë se çfarë po ndodhte në Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Kinës midis këtyre korrenteve), dhe me këtë rast është vendosur të bëhet kjo kthesë. Ne mund të supozojmë, gjithashtu, se, kur është shtruar çështja e Vietnamit në Komitetin Qendror, për të cilën ishin në kundërshtim pasuesit e korrentit të qëndrimit të fortë, ky qëndrim është kundërshtuar. Por, siç e kanë zakon kinezët, në Komitetin Qendror të Partisë së tyre do të jetë ngritur Maoja për t'i kritikuar mbështetësit e këtij korrenti, duke thënë se nuk kanë të drejtë dhe në këtë mënyrë ka marrë frerët në dhëmbë korrenti revizionist, ndërsa kundërshtarët janë mënjnuar ose përjashtuar si të majtë.

Udhëheqësit kinezë nuk i përjashtojnë për fare nga udhëheqja, pa lëre t'i përjashtojnë nga partia dhe as nuk i futin në burg kundërshtarët ideologjikë, po i lënë bile deri në Komitetin Qendror. Kështu, atje janë krijuar dy vija të kundërta, njëra nga të cilat ka marrë frerët në duar dhe ajo e përfaqësuesve të vijës tjetër, argumentimet dhe pikëpamjet e të cilëve mund të jenë edhe të drejta, po që nuk pyeten më. Këta mund të jenë mbështetur ndoshta edhe në letrën që i dërguam ne partisë së tyre, në vijën e Partisë së Punës të

1. Është fjala për letrën që Komiteti Qendror i PPSH i dërgoi më 6 gusht 1971 KQ të PKK lidhur me vizitën e Niksonit në Kinë.

Shqipërisë. «Kjo parti, — mund të kenë thënë ata me këtë rast, — kurdoherë na ka mbrojtur; vetë ne e kemi quajtur atë marksiste-leniniste etj., etj. Edhe argumentimet që ka shtruar para nesh, në letrën që na ka drejtuar Partia e Punës e Shqipërisë janë plotësisht të drejta, ashtu si edhe për çështjen e vietnamezëve». Për këtë arsye këta do të jenë lënë mënjanë, kurse elementët e korrentit revizionist kanë marrë vendime, megjithëse asgjë nuk dimë se çfarë vendimesh janë këto.

Tash Lin Biaoja nuk dëgjohet më, vetëm flitet se fotografitë e tij janë hequr nga çarkullimi. Edhe raporti që mbajti ai në Kongresin e 9-të, në emër të Komitetit Qendror, nuk po përmendet. Në gjithë ushtrinë tash nuk mësohen më materialet e Kongresit të 9-të, po ato të Kongresit të 7-të, të 5-të, të 4-t etj., ku flitet për bisedime e diplomaci me Guomindanin, me Çan Kai Shinë, me këtë dhe me atë etj., ndërsa Kongresi i 9-të asgjëkundi nuk zihet në gojë. Edhe ajo që është caktuar në statutin e partisë, sipas së cilës Lin Biaoja është zgjedhur nënkryetar i partisë për tërë jetën, nuk po përmendet më.

Të mos zgjatemi më për këtë çështje, puna është që në këto situata udhëheqësit kinezë nuk iu përgjigjën fare letrës sonë. Është e qartë se Çu En Lait (që ka qenë dhe është akoma në krye të të gjithë kësaj veprimtarie, me të cilin ne jemi ndeshur vazhdimisht për çështje politike, ideologjike dhe ekonomike, pse edhe këto të fundit kanë karakter politik; mbasi ai mund të na pengojë dhënien e kredive), ne ia kemi kundërshtuar politikisht ato që na ka parashtruar dhe

që nuk kanë asnjë bazë. Ne, siç e dini, jemi ndeshur disa herë me Çu En Lain për çështje të tilla e shumë të tjera që na kanë forcuar mendimin se në vijën e Partisë Komuniste të Kinës ka doza të theksuara oportuniste dhe revizioniste.

Në situatat aktuale pasuesit e korrentit revizionist duhet të kenë thënë se Partia e Punës e Shqipërisë po na hap shumë telashe. Ata shohin se vija e Partisë sonë është jo vetëm e palëkundshme, por edhe taktikat i ka shumë të zgjuara dhe mendojnë t'i ruajnë taktikat e tyre. Edhe strategjinë që shqiptarët përmendin në letrën e tyre, ku vihet theksi se e kemi të përbashkët, Çu En Lai dhe shokët e tij e kuptojnë dhe mendojnë se nuk e kemi aspak të njëjtë. Ne e dimë që ai me pasuesit e tij e ka me lesh në bark luftën në dy fronte, si kundër revizionizmit, ashtu edhe kundër imperializmit njëkohësisht, dhe arsyeja tash, kur ai po bën përpjekje të puqet me Niksonin, duket qartë. Nga ana taktike ne nuk jemi që kinezët të mos bisedojnë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, po ama jo në këto kushte. Udhëheqësit kinezë nuk mund të na akuzojnë ne për këtë se jemi sektarë, se jemi kështu apo ashtu, mbasi parimet duhet të ruhen edhe në strategji, edhe në taktikë.

Udhëheqësit kinezë e gjykojnë se Partia jonë nuk është naive në taktika, prandaj nga ana e tyre edhe ata përpiqen të përdorin ndaj nesh taktika të zgjuara. Kështu, me qëndrimin që kanë vendosur për të mos dërguar delegacion në Kongresin tonë të 6-të, ata bëjnë përpjekje t'i japin një bërryl Partisë së Punës të Shqipërisë, orvaten t'i japin të kuptojë se ajo ka nevojë

për Kinën, mendojnë «ta shkundin ca» në këtë drejtim. Ideologjikisht kinezët janë të bindur se Partia e Punës e Shqipërisë nuk ka nevojë për mbështetjen e tyre, sepse vijën ajo e ka të drejtë; bile, për qëndrimin që ata po mbajnë ndaj amerikanëve, u ka bërë edhe një letër, ku ka shfaqur hapur pikëpamjet e saj. Por, si revizionistë që janë, mendojnë se shqiptarët kanë nevojë të madhe për ndihmën e tyre ekonomike, pavarësisht se me fjalë deklarojnë që «ndihmat e tyre nuk janë gjë hiç», se «shqiptarët e ndërtojnë socializmin me forcat e veta» etj. Në fakt, ata mendojnë se përkrahja e tyre në fushën ekonomike është vendimtare, bile faktori kryesor që ne qëndrojmë në këmbë dhe politikisht.

Po ç'synojnë udhëheqësit kinezë me qëndrimin që po mbajnë ndaj nesh? Ata, me manovrën e tyre, mendojnë të arrijnë që në opinionin shqiptar të krijohet një amulli, që komunistët dhe masat tona punonjëse të thonë: «Përse nuk erdhën kinezët në Kongresin tonë?». Kjo do të bëjë që të mendohet se nga ana e udhëheqjes sonë ekziston një pasiguri te kinezët, të cilët janë treguar aq bujarë, aq të mirë dhe këtë shqiptarët e kanë thënë vetë, prandaj njerëzit në Shqipëri, kujtojnë ata, do të thonë: «Cilat janë arsyet që Mao Ce Duni nuk dërgoi një delegacion në Kongresin e 6-të të PPSH?». Kinezët duan të spekulojnë kështu në opinionin tonë të brendshëm, plus pastaj në arenën ndërkombëtare, ku vija revizioniste e tyre tash po del gjithnjë e më hapur. Me këtë qëndrim, pa u shprehur, ata duan të desolidarizohen me vijën e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Qeverisë Shqiptare. Shprehimisht

ata nuk thonë që s'janë me Partinë e Punës të Shqipërisë dhe me Qeverinë Shqiptare, po këto konkluzione le të nxirren, thonë ata dhe, në fakt, këto konkluzione një mëngjes do t'i nxjerrin patjetër të gjitha agjencitë borgjeze të lajmeve, sipas të cilave «kinezët, duke mos dërguar delegacion në Kongresin e 6-të, nuk janë dakord me shqiptarët». I kuptoni qëllimet e tyre?

Nga ana tjetër, Partia e Punës e Shqipërisë ka fituar një autoritet marksist-leninist dhe revolucionar në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Me këtë udhëheqësit kinezë, duke menduar si revizionistë, dhe, duke u bazuar në fuqinë e «shtetit të madh» dhe «të partisë së madhe», përpiqen ta diskreditojnë këtë autoritet. Ata mendojnë se po të mos marrin pjesë në Kongresin tonë, të tjerët do të thonë se Kina e ka braktisur Shqipërinë. Sipas tyre, partitë marksiste-leniniste dhe grupet revolucionare do të fillojnë të mendojnë që partia e madhe e Mao Ce Dunit, citatet e të cilit po i shkruajnë nga të katër anët në mure dhe në gazeta, se çfarë ka me Shqipërinë. Ata kërkojnë kështu që edhe në këtë drejtim të fitojnë.

Çështja tjetër ka lidhje me vijën e tyre revizioniste. Është pikërisht kjo vijë revizioniste që i shtyn udhëheqësit kinezë të pajtohen në mos sot, mot, dalngadalë e me mënyra të maskuara, me gjithë klanin revizionist. Këtë kurs afrimi ata e filluan me Çaushekuo, pastaj me Titon dhe me siguri do ta vazhdojnë me Longon, me revizionistët polakë dhe me gjithë të tjerët, derisa të arrijnë pajtimin edhe me revizionistët sovjetikë, me të cilët mendojnë të ndajnë pastaj botën.

Edhe një qëllim tjetër kanë ndjekur udhëheqësit

kinezë me këtë komunikim: që Partia e Punës e Shqipërisë të bjerë në provokim, të na japë neve shkak që të bëjmë hapin e parë për prishjen e marrëdhënieve me partinë dhe qeverinë kineze. Prandaj, unë mendoj që ne ta ruajmë gjakftohtësinë, të mos biem në provokimin e tyre. Ne tani po i njohim mirë ata, i kemi si në pasqyrë qëndrimet e tyre. Kjo çështje nuk ka si zgjidhet me një ditë, ca më tepër me një të thënë. Që t'u flasim atyre haptazi, edhe këtë mund ta bëjmë, po ne u kemi rrokullisur atyre gjëra shumë më të mëdha se këto që po themi sot.

Gjithçka për ne, pra, është e qartë. Prandaj mendoj që, në një mënyrë ose në një tjetër, të gjejmë formën e t'u themi se ne e kuptojmë vijën e tyre, por në provokacion nuk biem dhe jemi të bindur se vija që po ndjekin, do t'i demaskojë ata.

Për demaskimin e tyre ka rëndësi të madhe edhe qëndrimi që do të mbajmë ne, vija jonë e patundur, të cilën ata më në fund do ta atakojnë. Mirëpo tani këtë ata nuk e bëjnë dot, sepse për këtë akoma nuk janë dakord të gjithë në udhëheqje. Vija jonë do të bëjë përparime; ata do të takohen me Niksonin, me të cilin do të bëjnë pazarllëqe; më pas do të afrohen edhe me sovjetikët etj. Marksistë-leninistët dhe revolucionarët në botë, aktualisht dhe më vonë, do të vazhdojnë të thonë me të drejtë që s'ka si Shqipëria dhe Partia e Punës e Shqipërisë, s'ka si politika e Qeverisë Shqiptare, s'ka vend tjetër me një gjendje aq të mirë dhe të qëndrueshme si ajo që është krijuar në Shqipëri, ku ka ndershmeri, bëhen heroizma etj.

Kongresi i 6-të i Partisë duhet të tregojë forcën

tonë të madhe revolucionare, unitetin e pathyeshëm të popullit me Partinë dhe të Partisë me udhëheqjen, në atë shkallë sa këto t'u japin të kuptojnë qartë kinezëve se asgjë s'u shkon dhe s'do t'u shkojë në Partinë tonë. Kjo të vlejë për të kuptuar se orvatjet me qëllime të fshehta që bëjnë kundër nesh, asgjë s'na bënë, përkundrazi, të shohin çfarë do të tregojë Kongresi i 6-të i PPSH, 20 ditë para të cilit ata morën këtë qëndrim jomiqësor. Megjithatë, raportet qëndruan siç ishin, lufta jonë kundër armiqve të socializmit vazhdon si dhe përpara në të dyja anët; në Shqipëri askujt nuk i bën tërt veshi, ndërsa në radhët e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të popullit shqiptar mbretëron si asnjëherë tjetër një frymë e lartë revolucionare dhe një unitet i pathyeshëm.

Unë mendoj që për këto çështje të vëmë në dijeni delegatët e Kongresit, porsa ata të vijnë në Tiranë, lidhur me Partinë Komuniste të Kinës etj., etj. dhe t'u lexojmë përgjigjen që na është dhënë nga ana e kinezëve. Delegatëve t'u thuhet se udhëheqja jonë, këtë qëndrim të shokëve kinezë, nuk e gjykon të drejtë, marksist, pse të gjitha arsyet e tyre nuk qëndrojnë. Se çfarë ngjet në Kinë, ne nuk e dimë, po çështja qëndron në atë që ne, siç e dini (dhe delegatët për këtë janë në dijeni, se janë të informuar me kohë), nuk kemi qenë dakord me ta për vizitën që do të bëjë Niksoni në Pekin. Ky qëndrim nuk i tremb Partinë dhe popullin tonë, përkundrazi ai do të bëjë që të gjithë të shkojmë në Kongres me një entuziazëm më të madh se kurrë.

Veç të kemi kujdes e të jemi edhe takticienë;

këtë çështje ta gjykojmë mirë në pasqyrën e të gjitha problemeve, pavarësisht se dimë me kë kemi të bëjmë. Rreziku është kur nuk di me kë ke të bësh, por kur e njuh tjetrin kush është, atëherë je në gjendje të marrësh vendimin se sa duhet ta hedhësh çapin. Edhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare ka interes të vepruhet kështu me durim e gjakftohtësi nga ana jonë.

Ne e kemi parasysh, pse në këtë drejtim kemi eksperiencë që, kush është revizionist, në mos sot, nesër, do të dalë me veprime konkrete, do të marrë edhe masa kundër marksistë-leninistëve. Kështu ka ngjarë me Shqipërinë tonë që ka qëndruar dhe u qëndron armiqve ballë për ballë, pa frikë. Në mënyrë dialektike këto masa do të merren patjetër kundër nesh, pse ai që largohet nga pozitat marksiste-leniniste, vjen koha që rrëshqet në llum deri në pozitat e revizionistit tradhtar Mikojan, që e mbani mend si na kërcënoi¹. Mirëpo, ka mundësi që tani për tani, kinezët, të mos e bëjnë një gjë të tillë. Megjithatë, duke i ditur ç'janë këta njerëz ne duhet të gjykojmë si realistë, me qëllim që ata të mos na dëmtojnë as ekonomikisht. Dhe kur themi kështu, prapë gjykojmë si marksistë-leninistë dhe nuk u përulemi aspak atyre. Ne e dimë ku shkojnë udhëheqësit kinezë, megjithatë ata do të detyrohen të na dërgojnë edhe përshëndetje në Kongres, përmbajtjen e së cilës e marrim me mend se si do të jetë. Në atë përshëndetje mund të ketë hosanara sa të

1. Shih: Enver Hoxha, «Hrushovianët» — Kujtime, botim i dytë, Tiranë, 1982, f. 423.

duash, mund të flitet për «unitetin», se «nc do të jemi bashkë deri në vdekje» e të tilla të tjera si këto, ndaj të cilave ne do të bëjmë veshin e shurdhër.

Hapat që do të bëjmë në drejtim të tyre, t'i matim mirë. Ne nuk e vëmë çështjen që «po na i prenë kreditë kinezët, mbaruam», pse jemi në gjendje të bëjmë edhe pa to. Puna është që të luftojmë deri në fund, pa u bërë lëshime as në parime, as në vijë dhe as të ulim kurrizin që të na marrin nëpër këmbë. Ne kurrë nuk kemi lejuar njeri të na marrë nëpër këmbë dhe kur themi kështu nuk jemi fodullë, pse ky është një qëndrim marksist-leninist. Për ato që nuk jemi dakord ne ia themi haptas kujtdo qoftë. Dhe, në fakt, pikëpamjet tona ua thamë edhe kinezëve, bile në atë rrugë saqë as ata nuk kanë guxuar të na i thonë.

Po le të marrim edhe anën tjetër. Mund të jenë të tëra këto që thashë arsyet e qëndrimit të tyre, po mundet që në Kongresin tonë s'guxojnë të dërgojnë njeri, pse kur të takohemi drejtpërsëdrejti me përfaqësuesit e tyre, nuk do të dinë ç'përgjigje të na japin për letrën që u bëmë në gusht. Nuk është çështja vetëm te përgjigjja e letrës, po tek ajo që thashë se, në gjirin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës mund të jetë eliminuar grupi i Lin Biaos. Delegacioni që do të vinte në Kongresin tonë, do të qe i detyruar të na e thoshte këtë. Mirëpo, ata mund të na thonë që «me Partinë e Punës të Shqipërisë ka qenë i një mendimi një grup i tërë në udhëheqjen tonë, grup që ne e kemi dënuar. Kjo do të thotë që ne, kinezët, jemi në luftë me ju shqiptarët», gjë që nuk do të kenë si ta thonë.

Atëherë, në qoftë se është siç e gjukojmë ne, udhëheqësit kinezë kanë zgjedhur rrugën që të mos dërgojnë fare ndonjë delegacion në Kongresin tonë, ndryshe, vetvetiu, ata do të detyroheshin të na i thoshin këto hapur.

Pastaj, ata mund të gjukojnë edhe kështu: «Po sikur të na thonë shqiptarët se në raportin e Kongresit të 9-të të Partisë suaj flitet për luftë në të dy frontet, kurse ju tash veproni ndryshe?! Nësër do të dalë çështja e Lin Biaos, atëherë, si do t'i gënjejnë shqiptarët, si të mos i themi asnjë fjalë kësaj Partie, për të cilën po bëjmë kaq shumë propagandë, se jemi miq e vëllezër? Po të na pyesin, atëherë, duhet t'u themi haptazi se me ju shqiptarët nuk jemi dakord». Por, ata janë të detyruar të mos na e thonë një gjë të tillë, mbasi hëpërhë nuk dëshirojnë të futen në luftë me ne, siç gjukojnë ata, se nuk ka ardhur akoma koha ta bëjnë këtë. Në këto kushte, mendoj unë, edhe ne duhet të jemi gjakftohtë me ta.

Tani çfarë mund t'u themi ne atyre? T'u bëjmë një letër, me anën e së cilës t'u lëmë të kuptojnë se ne i kemi marrë vesh të gjitha këto gjëra. Ne mund t'u themi atyre që udhëheqja jonë e mori njoftimin, dhe i ka ardhur shumë keq që në Kongresin e 6-të të PPSH nuk do të marrë pjesë një delegacion i Partisë Komuniste të Kinës që ka marrëdhënie kaq të ngushta me Partinë e Punës të Shqipërisë, gjë që do të qe në interes të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të miqësisë midis dy popujve tanë.

Mbi të gjitha, për ne ka rëndësi entuziazmi i Kon-

gresit, shprehja e unitetit të tij, që të kuptojnë kështu kinezët se ne nuk pyesim fare për qëndrimet e tyre.

Sidoqoftë, me këtë veprim ata duan t'i bëjnë një sfidë Partisë sonë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
e cila gjendet në AQP*

HISTORIA E POPULLIT ËSHTË HISTORI E MADHE

*Nga biseda me ambasadorin e RP të Kinës
në Tiranë*

16 tetor 1971

Shoku Enver Hoxha priti ambasadorin kinez, i cili me rastin e 63-vjetorit të lindjes, i uroi ditëlindjen. Pas shkëmbimit të përshëndetjeve të rastit, shoku Enver Hoxha, duke iu drejtuar ambasadorit kinez, që kishte qenë në Elbasan për të marrë pjesë në përu-rimin e ndërtimit të kombinatit metalurgjik, vazhdoi:

Gjatë vizitës suaj të solme në Elbasan, me siguri që do të ketë pasur shi, pse koha as këtu në Tiranë s'ka qenë e mirë. Tani është stina e shirave, megjithatë në vendin tonë rënia e tyre nuk ka rregullaritet. Ka vite kur ato në vjeshtë fillojnë që tani, por ka edhe raste që në këtë periudhë bën kohë e mirë. Kohë pa shira nganjëherë bën te ne edhe në nëntor. Prognoza parashikon se mund të kemi akoma për ca kohë mot të mirë, pas dy ditësh qielli mund të kthjellohet prapë. E vërteta është se na duhet akoma kohë e mirë, sidomos për bujqësinë, për mbjelljen e grurit dhe për vjelljen e pambukut. Sigurisht, shiu është i dobishëm edhe

për ushqimin e bagëtisë, pse ndihmon të rritet bari, bën mirë edhe për hasëllet. Kur bie në kohën dhe në masën e duhur ai është një faktor i rëndësishëm për bujqësinë dhe ndihmon në rritjen e rendimenteve. E kundërta ndodh kur bën thatësi ose lagështirë e madhe. Rendimentet sivjet i parashikuam të larta dhe, pavarësisht nga koha, bëmë përpjekje të mëdha për t'i realizuar. Për këtë arsye, si me grurin ashtu dhe me misrin, nuk dolëm keq, kurse planin e pambukut akoma nuk po e realizojmë. Realizimi i planit në këtë bimë ka rëndësi të madhe për industrinë tonë tekstile, sepse kombinatet tona aktualisht punojnë dhe kërkojnë një sasi të madhe pambuku, prandaj, veç atij që prodhojmë në vend, jemi të detyruar edhe të importojmë diçka, pse nuk na mjafton yni.

Me punën këmbëngulëse të Partisë tani është arritur që fshatarët tanë të mësojnë si ta kultivojnë pambukun, që më përpara nuk e mbillnin fare, dhe në disa rajone të veçanta kanë arritur rezultate të mira.

Për këtë bimë në mënyrë të veçantë ka shumë rëndësi periudha e shirave. Delegacioni ynë bujqësor që ishte para pak kohe në Kinë gjeti atje disa farëra pambuku me cikël më të shpejtë zhvillimi. Këto ne do t'i prodhojmë e zhvillojmë në vend dhe do të luftojmë që të fitojmë sa më shumë kohë për të siguruar një prodhim të qëndrueshëm pambuku.

Partia jonë i kushton rëndësi të madhe edhe zhvillimit të industrisë. Sot, krahas inaugurimit të punimeve për ndërtimin e kombinatit të metalurgjisë së zezë në Elbasan, u inauguruan edhe punimet e uzinës së polivinilkloridit në Vlorë, që do të ngrihet afër

Fabrikës së Sodës Kaustike. Kudo që të shkosh në vendin tonë do të shikosh medoemos vepra të reja që janë ndërtuar ose po ndërtohen. Me punën dhe me djersën tonë po e zbukurojmë çdo ditë Shqipërinë.

Ju thatë se gjatë vizitave nëpër vendin tonë, ju ka bërë veçanërisht përshtypje Gjirokastra, që është një qytet origjinal. Në Shqipëri ka disa qytete të tilla si Gjirokastra, ku shtëpitë janë ndërtuar me stil të veçantë. Kështu një pjesë e Beratit, sidomos Lagjja Kala, ka një arkitekturë karakteristike. Edhe Kruja ruan karakteristikat tradicionale të ndërtimit. Ndërtimi i shtëpive të Gjirokastrës ruan natyrën arkitekturore të kështjellave, shtëpitë kanë penxhere të vogla. Veç atyre, ato kanë penxhere të tjera edhe më të vogla që u duheshin përpara banorëve për të nxjerrë andej armët dhe për të qëlluar armiqët. Në shtëpitë e vjetra banohej vetëm në katin e dytë, me qëllim që edhe po të hynte armiku, të mos gjente njeri në katin e parë.

Pas Çlirimit ne kishim interes t'i rindërtonim të gjitha shtëpitë e këtij lloji që kanë qenë prishur, ose t'i riparonim, duke u ruajtur karakteristikat e atyre që ishin dëmtuar gjatë kohës. Një pjesë të tyre, më të vjetrat, i kemi rregulluar pa prishur gjë brenda, në një pjesë tjetër ruajmë fasadat, kurse brenda, meqenëse kanë divane të mëdha, i ndajmë në apartamente, e kështu me radhë. Ndërtesat e reja nuk i futim në blloqet e shtëpive të vjetra, në mënyrë që të mos prishim harmoninë e tyre, prandaj qytetin e ri e ndërtojmë veç.

Diçka e bukur që mendoj ta shikoni është Kalaja e Beratit, se qytetin besoj e keni parë. Kalaja është

një objekt interesant. Atje, nën një kishë, kemi gjetur një dokument të vjetër. Disa thonë se ai është i shekullit të gjashtë, dhe mund të besohet se ndoshta është i këtij shekulli, për arsye se është shkruar në pergamen. Ky dokument kërkohet shumë, vetëm katër të tilla ka në botë. Ai quhet *Codex purpureus Beratinus*. Kur kanë ardhur pushtuesit e ndryshëm në Shqipëri, qoftë ata të përparshmit, si: turqit, austriakët e të tjerë, ashtu edhe italianët e gjermanët në Luftën e Dytë Botërore, e kanë kërkuar shumë këtë kodeks, por priftërinjtë e fshihnin kodeksin e Beratit në gropën e kishës, prandaj armiqtë nuk e shtinë dot në dorë atë, pse mbahej i fshehur.

Pas Çlirimit ne i pyetëm priftërinjtë ku ndodhej ky kodeks, mirëpo ata, duke qenë armiqtë tanë ideologjikë, deklaruan se gjoja nuk dinin gjë. Kur filloi lufta për revolucionarizimin e mëtejshëm të ndërgjegjes, për pastrimin e saj nga mbeturinat borgjeze, mikroborgjeze e fetare, kur u prishën kishat e xhamitë, një prift patriot plak i tregoi Partisë gropën e kishës ku qe vendosur kodeksi qysh në kohën e pushtesve italianë, më 1939...

Në vendin tonë u është vënë rëndësi e madhe zbulimeve arkeologjike. Përpara ne nuk kishim kuadro në këtë fushë të diturive. Më vonë, pas Çlirimit përgatitëm nëpër shkolla edhe arkeologë, prandaj tash janë bërë shumë zbulime. Aktualisht kemi dhënë orientimin për të punuar dhe thelluar njohuritë për ilirët, stërgjyshërit tanë. Deri më sot janë zbuluar mjaft monumente të panjohura më parë dhe qytete me karakteristikat e tyre. Për shembull, tani kemi mjaft të dhëna materiale

që provojnë se gjithë Durrësi i sotëm është ndërtuar mbi rrënimet e një qyteti të vjetër. Durrësi i vjetër fillon që atje ku është sot qyteti i ri dhe arrin deri në Porto Romano. Edhe në Pogradec kemi zbuluar një shpellë ku ndodhet një varr i mbuluar me gurë. Për të shkuar atje do të ecni deri në njëfarë vendi me automobil, pastaj në këmbë. Në të do të shikoni veç varrit edhe armatura e objekte të tjera mjaft interesante të së kaluarës. Ashtu siç thatë edhe ju, ne, kur gjatë hapjes së kanaleve e themeleve të veprave e të ndërtesave të reja, zbulojmë monumente me rëndësi historike, i ndërpresim punimet. Ne kemi nxjerrë ligj që të mos prishen monumentet e vjetra, përkundrazi, ato të ruhen me kujdesin më të madh. Disa nga këto i mbajmë brenda të mbyllura, se i prish ajri, temperatura, shiu etj. derisa të vijë koha që të krijojmë mundësi për t'i ekspozuar jashtë të mbyllura në xhame.

Çfarë nuk bëjnë Partia dhe socializmi! Gjëra të mrekullueshme bëhen te ne! Gjersa ne mbajmë fort vijën e drejtë marksiste-leniniste, realizimet tona do të ecin me siguri vazhdimisht përpara.

Para disa ditësh mora pjesë në takimin e veteranëve të luftës. Ai ishte shumë emocionues si për mua edhe për ata. Në të takova shumë shokë të luftës. Midis tyre ishte edhe një plakë¹, që në kohën e luftës i kishte djemtë partizanë, një dhi dhe kasollen. Një nga djemtë e saj² u vra në luftë dhe ajo, në mes të dimrit të madh, nëpër dëborë, vajti vetë në vend dhe e mori

1. Zyhra Koçi.

2. Beqir Koçi, dëshmor.

në duar të vdekur. Në kohën e operacionit të një dimri të ftohtë na rastisi të shkojmë në shtëpinë e plakës. Sa u futëm në kasolle pamë gjendjen e saj të mjeruar. Megjithëse i thamë sikur gjoja kishim ngrënë, ajo e kuptoi që ne ishim të uritur, shkoi përjashta, mori dru e shkarpa, ndezi një zjarr të madh dhe, pa rënë në sy, theri dhinë e na e solli brenda për t'i rrjepur lëkurën. E qortuam që theri dhinë e vetme, por ajo tha: «Partisë do t'ia jap të gjitha, djalin ia dhashë luftës, dhinë gjithashtu». Edhe kasollen që i mbeti, më pas ia dogjën gjermanët sapo ikëm ne. Me gjithë këto vuajtje e sakrifica plaka kishte thënë: «Rroftë Partia! Fitoftë Shqipëria!». Ishte një takim shumë i prekshëm ai që bëra me këta njerëz të dashur.

Disa djem që në kohën e luftës ishin nga 2-3 vjeç, tani kanë hyrë në të tridhjetat. Njërin prej tyre që kur ishte i vogël nuk e kisha parë më. Kur vajta në një zonë të thellë në Labinot më 10 korrik 1968, me rastin e 25-vjetorit të krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, shoh të dalë nga turma e popullit një djalë i ri rreth 30 vjeç, që m'u hodh në qafë, më shtrëngoi e filloi të qante. Nënë Zyhraja i thoshte: «Mos qaj, çuno, se je përpara Komandantit». «Kush je ti»!, — e pyeta djalin. «Jam Abazi, — tha ai, — Abazi i vogël». Në kohën e luftës Abazi i vogël vetëm një këmishë kishte në trup dhe asgjë tjetër. Tani kishte mbaruar ushtrinë, ishte kooperativist i dalluar, qe martuar dhe kishte katër fëmijë. Historia e popullit është histori e madhe, shoku ambasador.

Gjatë luftës, pushtuesit, për të thyer rezistencën e

popullit, kanë persekutuar njerëz dhe kanë djegur jo vetëm kasolle, shtëpi e fshatra të veçuara, por krahina të tëra. Por populli nuk mernte parasysh asgjë dhe prindërit për fitoren, për popullin, për Partinë ishin gati që djali, vajza, fëmija e vogël të shkonin në plumb, ishin gati t'u digjej shtëpia e pasuria. Shumë prej tyre u sakrifikuan, u vranë për lirinë e pavarësinë e atdheut, për socializmin. Njerëzit e thjeshtë të popullit mua më kanë dashur e më kanë dhënë krahë në ato kohë të vështira, pavarësisht se shumë nga ata atëherë nuk e dinin fare kush isha unë. Çështja nuk ishte që hajt ta pres sot Enverin, udhëheqësin e Shtabit të Përgjithshëm, se nesër do të më bëjë ndonjë të mirë, do të më ndihmojë për ndonjë nevojë. Ndhimën dhe përkrahjen masat ma jepnin pa u kursyer për dashurinë e madhe që ushqenin për Partinë. Populli bënte sakrifica për Partinë e tij, pse shihte që ajo e udhëhiqte atë në rrugë të drejtë. Edhe sot ai lufton me vetëmohim për ndërtimin e socializmit, sepse ka besim të madh në udhëheqjen e Partisë.

Pasi ambasadori kinez shprehu falënderimet për këtë takim miqësor, shoku Enver Hoxha në përfundim të bisedës së tij tha:

Ju falënderoj për vizitën tuaj. Ajo i vlen miqësisë sonë të cilën duhet ta forcojmë në interes të të dy vendeve tona. Të tilla janë dëshirat dhe vullneti i dy popujve tanë. Prandaj marksistë-leninistët, dëshirat, vullnetin dhe aspiratat e popujve i ruajnë si sytë e ballit, i zhvillojnë më tej që miqësia ndërmjet popujve të kalitet e të forcohet vazhdimisht. Marksistë-leninistët ne i konsiderojmë si vëllezërit tanë, pse na bash-

kon e njëjta ideologji dhe ideali i përbashkët. Lufta e përbashkët kundër imperializmit botëror dhe revizionizmit modern për triumfin e revolucionit e ndërtimin e socializmit i lidh marksistë-leninistët njëri me tjetrin si mishi me thuan.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

PËR PARTITË TONA UNITETI MARKSIST-LENINIST ËSHTË JETIK

*Fjala para delegacioneve të huaja të ftuara
në Kongresin e 6-të të PPSH*

31 tetor 1971

Të dashur shokë dhe shoqe,

Nesër fillojnë punimet e Kongresit të 6-të të Partisë së Punës të Shqipërisë. Kjo do të jetë një datë me shumë rëndësi në jetën e Partisë dhe të popullit tonë.

Veçanërisht, ne jemi shumë të lumtur e të gëzuar që në gjirin tonë, në këtë ngjarje të shënuar, kemi përfaqësuesit e partive motra marksiste-leniniste dhe të grupeve revolucionare nga të gjitha anët e botës.

Më lejoni, të dashur shokë dhe miq, që në emër të Partisë sonë dhe të Komitetit të saj Qendror, në emër të të gjithë popullit shqiptar, të falënderoj nxehësisht nga zemra dhe në mënyrë revolucionare partitë motra marksiste-leniniste që ju përfaqësoni, komitetet qendrore të tyre dhe ju personalisht.

Ardhja e delegacioneve të partive motra në Kongresin tonë është një ndihmë jashtëzakonisht e madhe

që i jepet Partisë së Punës të Shqipërisë nga partitë tuaja, ajo është shprehja më e zjarrtë e internacionalizmit proletar që na bashkon në kohë të mira e në furtuna, e unitetit të bazuar në marksizëm-leninizmin, që na ka brumosur, që na ndriçon rrugën, që na kalit e na çelikos në luftëra e në beteja klasore kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye, kundër borgjezisë reaksionare, për triumfin e revolucionit, të socializmit e të komunizmit.

Për partitë tona uniteti në baza marksiste-leniniste e revolucionare është jetik si drita dhe si ajri që thithim orë e çast. Ne kemi nevojë për këtë unitet, i cili ekziston dhe kalitet çdo ditë në beteja kundër tradhtarëve të marksizëm-leninizmit, revizionistëve modernë dhe të gjitha rrymave të tjera përçarëse të borgjezisë dhe të kapitalizmit. Ne duhet ta forcojmë këtë unitet marksist-leninist dhe ta bëjmë gjithnjë e më militant për triumfin e revolucionit proletar dhe për shkatërrimin e kapitalizmit. Ne nuk jemi as të paktë, as të dobët, po jemi të shumtë dhe të fortë, sepse jemi marksistë-leninistë. Armiqtë tanë janë të paktë dhe të dobët, sepse ata e kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin.

Partitë tona do të ccin përpara në unitet të plotë duke luftuar dhe duke fituar. Ne dëshironim të kishim në mes nesh, me këtë rast, edhe përfaqësuesit e Partisë Komuniste të Kinës dhe na vjen keq që kjo nuk do të dërgojë në Kongresin tonë të 6-të delegacionin e saj, për arsye të vendimit që kanë marrë udhëheqësit kinëzë që të mos thërresin delegacione të partive motra

në kongresin e partisë së tyre dhe as të dërgojnë delegacione të PKK në kongreset e partive motra¹.

S'kam pse t'ju them juve, të shtrenjtë shokë, që ta ndieni veten plotësisht si në vendin tuaj, si në kongresin tuaj, si në gjirin e popullit tuaj. Ju do të ndihenin kështu sepse ju e doni Shqipërinë socialiste, popullin shqiptar dhe Partinë e Punës të Shqipërisë si vendin, popullin dhe partinë tuaj. Unë ju siguroj se edhe ne ju duam me gjithë zemër.

Ju ftoj të ngremë gotat për partitë tuaja marksiste-leniniste, për komitetet qendrore të partive tuaja, për shëndetin tuaj, të dashur shokë, shoqë dhe miq, për unitetin tonë marksist-leninist, për internacionalizmin proletar, për lavdinë në shekuj të marksizëm-leninizmit!

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», Tiranë, 1980, f. 93

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», Tiranë, 1980, f. 93

1. Lidhur me këtë çështje, në librin «Shënime për Kinën», vëll. I, f. 591, shoku Enver Hoxha shkruan: «Mosdërgimi nga ana e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës të delegacionit të saj në Kongresin e 6-të të Partisë sonë nuk është «për arsye të vendimit që kanë marrë në Kongresin e tyre të 9-të». Kjo nuk është e vërtetë, është një gënjeshtër e qepur me pe të bardhë. Një vendim të tillë nuk mund ta marrë një kongres që respekton mësimet e Marksit dhe të Leninit. Një vendim i tillë do të ishte antimarksist. Ne e dimë që këtë vendim Kongresi i 9-të i Partisë Komuniste të Kinës nuk e ka marrë dhe udhëheqja kineze që gënjen, tregohet dyfish antimarksiste ndaj kongresit të vet dhe ndaj nesh».

MBI VEPRIMTARINË E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Raport në Kongresin e 6-të të PPSH

1 nëntor 1971

Të dashur shokë e shoqe delegatë,

Kongresi i 6-të i Partisë është thirrur të bëjë bilancin e punës vetëmohuese e heroike, që komunistët dhe gjithë populli ynë kanë kryer në këta pesë vjet për zhvillimin e pandalshëm të revolucionit dhe për ndërtimin me sukses të socializmit në Shqipëri. Duke qenë forumi më i lartë i Partisë, atij i takon nderi dhe përgjegjësia e madhe të caktojë objektivat themelore për periudhën e ardhshme, detyrat e Partisë dhe rrugët për realizimin e tyre.

Kongresi i 6-të, ashtu si edhe kongreset e tjera të Partisë, do të shënojë një etapë të re në marshimin tonë fitimtar, një shkallë tjetër më të lartë ngjitjeje e përparimi të gjithanshëm të shoqërisë sonë socialiste.

Sytë dhe zemrat e gjithë popullit punonjës të Shqipërisë janë drejtuar tani te Kongresi ynë, sepse jeta, aspiratat dhe e ardhmja e popullit janë të lidhu-

ra ngushtë me Partinë e Punës, me vijën dhe veprimtarinë e saj, sepse interesat e Partisë, të popullit dhe të atdheut tonë socialist janë një e të pandarë.

Me punën e tij Kongresi ynë do t'i justifikojë plotësisht besimin dhe dashurinë e patundur që kanë klasa punëtore dhe gjithë punonjësit të Partia e tyre, tek e cila ata shohin udhëheqësen e sprovuar, garancinë e fitoreve të arritura dhe të së ardhmes komuniste.

Kongresi i 6-të mblidhet në pragun e një feste të madhe, tridhjetëvjetorit të Themelimit të Partisë heroike të Punës. Tridhjetë vjet jetë të Partisë janë 30 vjet beteja e fitore të lavdishme, 30 vjet luftë e punë titanike për krijimin dhe ndërtimin e Shqipërisë së re. Kjo është periudha më e ndritur dhe më e madhërishme në historinë shumëshekullore të popullit tonë, kur ai, i udhëhequr nga Partia, kaloi nga errësira në dritë, tregoi me një forcë të paparë vitalitetin, trimërinë dhe shpirtin e tij të pamposhtur liridashës, kur, si asnjëherë tjetër, shpërthyen talenti, aftësitë dhe energjitë e tij krijuese, kur Shqipëria i doli zot vetes në arenën ndërkombëtare dhe me dinjitet e meritë qëndron në radhët e popujve dhe të kombeve të përparuara të botës.

Lavdia e të gjitha këtyre fitoreve u takon bijve dhe bijave heroikë që bënë fli jetën e tyre për idealet fisnike të Partisë e të popullit, u takon atyre që kanë shkrirë të gjitha forcat fizike e mendore për fuqizimin dhe lulëzimin e atdheut socialist, klasës punëtore, fshatarësisë punonjëse, inteligjencies popullore, gjithë popullit tonë, që me guxim e frymë të lartë revolucionare çojnë përpara çështjen e socializmit në Shqipëri.

Në të gjitha fitoret e arritura në këta 30 vjet është mishëruar vija konsekuente e parimore e Partisë. Në themel të saj kanë qëndruar e qëndrojnë mësimet jetëdhënëse të marksizëm-leninizmit, të cilat Partia jonë i ka zbatuar në mënyrë krijuese dhe i ka mbrojtur me vendosmëri. Këto mësimet kanë qenë busulla që na ka udhëhequr në të gjitha betejat, janë ato që kanë ndriçuar dhe ndriçojnë rrugën tonë revolucionare.

Partia e Punës e Shqipërisë u krijua për të çliruar Shqipërinë, për të bërë revolucionin, për të vendosur diktaturën e proletariatit dhe për të ndërtuar socializmin në Shqipëri. Sot, në tridhjetëvjetorin e Partisë, ne jemi krenarë që këtë mision historik, të cilin komunistët shqiptarë e morën përsipër qysh në ato ditë të vështira të Nëntorit 1941, e shohim të realizuar me sukses. Shqipëria është e lirë dhe e pavarur, klasa punëtore mban fort në duart e saj pushtetin e diktaturës së proletariatit, socializmi ka triumfuar në të gjitha fushat.

Filli i kuq që përshkon tërë jetën e veprimtarinë e Partisë është lufta e saj e ashpër dhe e vendosur kundër të gjithë armiqve të klasës, është besimi i pakufishëm në popull dhe mbështetja e patundur në forcat e tij të pashtershme, është besnikëria ndaj idealeve të internacionalizmit proletar.

Dallgë të egra janë vërsulur në këto vite kundër Partisë dhe Shqipërisë socialiste. Imperialistët, revizionistët dhe gjithë armiqtë e tjerë të brendshëm e të jashtëm, me një mijë mënyra janë përpjekur të na largojnë nga rruga e drejtë, të ndalin marshimin tonë fitimtar. Por Partia dhe populli ynë kanë qëndruar si

shkëmb graniti dhe i kanë shpartalluar orvatjet e tyre për të na mposhtur e gjunjësuar.

Populli ynë ka dalë gjithnjë fitimtar, sepse ka pasur dhe ka një Parti të fortë e revolucionare, e cila e ka mbajtur gjithnjë të mprehtë vigjilencën dhe tehun e luftës klasore, sepse te ne është farkëtuar një unitet i çeliktë dhe i palëkundshëm i Partisë me popullin. Në luftën tonë nuk kemi qenë kurrë të izoluar dhe të vetëm. Populli dhe Partia kanë pasur dhe kanë ndier kurdoherë nga afër ndihmën e përkrahjen e fuqishme dhe solidaritetin e partive marksiste-leniniste, të popujve të vendeve socialiste, të të gjithë revolucionarëve e njerëzve përparimtarë të botës.

Si në ditët e para të jetës së saj, Partia jonë është gjithnjë e re e dinamike. Tridhjetë vjetët që kaluan i dhanë asaj pjekurinë e luftëtarit të sprovuar në beteja, e kalitën politikisht e ideologjikisht, e formuan si një Parti të vërtetë revolucionare me rrënjë të thella në klasën punëtore e në popullin shqiptar, e bënë atë një brigadë sulmuese të komunizmit ndërkombëtar.

Procesi i madh i revolucionarizimit të gjithanshëm, që u zhvillua me vrull veçanërisht pas Kongresit të 5-të, forcoi edhe më tej pozitën e socializmit në Shqipëri, rriti shpirtin luftarak dhe gjallëroi tërë jetën e veprimtarinë e Partisë, i dha një nxitje të paparë iniciativës e krijimtarisë së masave, zhvillimit të hovshëm të ekonomisë e të kulturës popullore.

Kjo ka qenë një luftë e madhe klasore për t'i prerë rrugën çdo mundësie të lindjes së revizionizmit dhe të kthimit prapa të shoqërisë, një luftë për të çuar për-

para dhe në mënyrë të pandërprerë revolucionin dhe ndërtimin e socializmit.

Në këtë Kongres Partia jonë vjen me një përvojë të pasur e me rezultate të mëdha, me një unitet të pathyeshëm të radhëve të saj, e gatshme të marrë përsipër barrë të reja edhe më të rënda për të mirën e lumturinë e popullit, e vendosur për të çuar deri në fund çështjen e socializmit e të revolucionit.

Punimet dhe vendimet e Kongresit të 6-të me siguri do t'i japin një shtytje të re e të fuqishme gjithë punës dhe luftës sonë revolucionare, zhvillimit të gjithanshëm të ekonomisë, kulturës dhe ngritjes së mirëqenies së popullit, që atdheu ynë të qëndrojë gjithnjë kështjellë e pamposhtur e socializmit, që Partia jonë të mbajë si kurdoherë lart e të pastër flamurin ngadhënjimtar të marksizëm-leninizmit.

I

GJENDJA NDËRKOMBËTARE DHE POLITIKA E JASHTME E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

Kongresi ynë i 6-të mbledhet në një kohë kur ekzistojnë kontradikta dhe ballafaqime të mëdha në shkallë botërore, kur, si asnjëherë tjetër, janë grumbulluar e janë vënë kundrejt njëra-tjetrës forca të mëdha klasore, politike, ekonomike e ushtarake që përfshijnë tërë globin.

Nga njëra anë e barrikadës qëndrojnë forcat e imperializmit, revizionizmit e reaksionit dhe nga ana tjetër forcat e socializmit, fronti i popujve, me klasën punëtore ndërkombëtare në krye. Vija e demarkacionit midis tyre po bëhet gjithnjë e më e qartë në të gjitha fushat.

Kuptimi i drejtë i këtyre kontradiktave, shqyrtimi realist e objektiv i raportit të forcave që veprojnë në arenën ndërkombëtare, njohja e tendencave themelore të zhvillimit të sotëm botëror përbëjnë një moment me rëndësi vendimtare në luftën kundër imperializmit e revizionizmit, në luftën për fitoren e revolucionit.

Tendenca e zhvillimit të sotëm botëror është revolucionit dhe fitorja e socializmit

Ngjarjet që kanë ndodhur në botë gjatë këtyre pesë vjetëve të fundit vërtetojnë vlerësimin e drejtë që u bëri Partia jonë në Kongresin e saj të 5-të gjendjes dhe prirjeve të zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare. Duke analizuar tani situatën në botë, ne mund të theksojmë se jo vetëm ajo është në favor të revolucionit, por edhe se revolucionit po bëhet aspiratë e përgjithshme e popujve.

Ky vlerësim i situatës nuk është një deklaratë e thjeshtë optimiste, por shpreh realitetin objektiv, procesin historik të zhvillimit të sotëm botëror, ku duken qartë acarimi i antagonizmave socialë dhe rritja e forcimi i pandërprerë i luftës revolucionare të popujve, të cilat po tronditin nga themelet botën imperialiste e revizioniste dhe po thellojnë më tej krizën e gjithanshme të saj.

Ne sot jemi dëshmitarë të përleshjeve të mëdha klasore midis punonjësve dhe kapitalit e pushtetit të tij. Lufta klasore e proletariatit dhe e shtresave të tjera shoqërore të shfrytëzuara ka marrë të tilla përpjesëtime, si për sa i përket numrit të pjesëmarrësve, ashtu edhe mprehtësisë së saj, saqë periudha e sotme mund të krahasohet me periudhat më kritike që ka kaluar borgjezia e vendeve kapitaliste. Betejat e shkëlqyera të punonjësve francezë, italianë, spanjollë, anglezë, belgjianë e të tjerë, përvoja pozitive e negative e fituar, do të lënë gjurmë të pashlyeshme në ndërgjegjen

e tyre. Edhe në ato vende që propaganda borgjeze i paraqiste si zona të «paqes klasore» të përrjetshme po zhvillohen beteja të fuqishme midis punonjësve e kapitalit. U thye edhe këtu miti i përrallave socialdemokrate të «evolucionit shoqëror» për krijimin e mirëqenies së përgjithshme nën sistemin kapitalist.

Shumë janë acaruar kontradiktat sociale në vetë Shtetet e Bashkuara. Si rezultat i dështimeve në politikën e jashtme e të brendshme është thelluar edhe më tepër kriza politike, ekonomike e shoqërore e imperializmit janki, është zgjeruar edhe më shumë lufta revolucionare e popullit amerikan. Kështjella e imperializmit po tronditet nga revolta e gjerë e zezakëve amerikanë për barazi e të drejta civile dhe e gjithë popullit kundër luftës në Vietnam.

E rëndësishme në këto beteja të reja klasore që zhvillohen në vendet kapitaliste është dalja në plan të parë e kërkesave politike, rritja e ndërgjegjes revolucionare të punonjësve, shkëputja gjithnjë e më e madhe nga ndikimi i oportunizmit socialdemokrat e revizionist.

Një tjetër veçori e luftës klasore kundër sistemit shfrytëzues kapitalist dhe politikës imperialiste është shpërthimi kudo i lëvizjes së rinisë e të studentëve, e cila po shndërrohet në një forcë të fuqishme revolucionare të kohës sonë. Rinia e botës kapitaliste nuk është e kënaqur as me gjendjen e saj sociale, as me sistemin që i ka mbyllur të gjitha shtigjet e perspektivës. Ajo tani është në kërkim të së vërtetës dhe e vërteta po e çon dhe do ta çojë me siguri drejt bashkimit me klasën punëtore, drejt revolucionit.

Imperializmi botëror po merr goditje gjithnjë e më të rënda nga lufta çlirimtare e popujve të Azisë, Afrikës e Amerikës Latine, e cila po zhvillohet kudo me vrull. Një shembull i shkëlqyer i hovit të madh të saj dhe një nxitje e fuqishme për të është lufta e vendosur antiimperialiste e popullit të Vietnamit dhe e popujve të tjerë të Indokinës, të cilët e rrëzuan një herë e përgjithmonë mitin e pathyeshmërisë së superfuqisë amerikane, të makinës së saj ushtarake dhe të armëve moderne.

Përpjesëtime të reja edhe më të mëdha ka marrë lufta e armatosur antiimperialiste e popujve të Tajlandës, të Birmanisë, të Malezisë e të Indonezisë në Azi. Zhvillim të gjerë ka marrë lufta revolucionare e popujve të Brazilit e të Kolumbisë, të Kilit e të Perusë, të Bolivisë, të Argjentinës e të vendeve të tjera në Amerikën Latine kundër imperializmit amerikan dhe oligarkive vendëse për mbrojtjen e sovranitetit e të pavarësisë kombëtare, për zhvillimin demokratik e të pavarur, për përparimin shoqëror. Një situatë e re revolucionare ka filluar të krijohet edhe në Afrikë. Popujt janë përfshirë kudo nga vala e luftës kundër kolonializmit të vjetër e të ri, kundër forcave shtypëse e reaksionare për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së tyre. As politika e diktatit, as mashtrimet, as dhuna e armatosur e imperializmit nuk mund të mposhtin vullnetin e popujve për të luftuar dhe për të marrë në duart e veta fatin e tyre.

Imperializmi dhe revizionizmi po tërheqin mbi vete urrejtjen e popujve, të cilët te politika amerikane dhe ajo e revizionistëve sovjetikë shohin rrezikun e lirisë e të pavarësisë së tyre. Popujt duan lirinë, janë

kundër ndërhyrjes brutale të imperialistëve e të revizionistëve, dënojnë politikën e tyre të hegjemonisë e të shantazhit. Kudo rritet e forcohet ndjenja e antiamerikanizmit, ashtu siç po rritet e forcohet kundërshtimi ndaj socialimperializmit sovjetik.

Ngjarje e rëndësishme në lëvizjen revolucionare të viteve të fundit është rritja e partive të reja marksiste-leniniste. Sot thuajse në të gjitha vendet e botës janë krijuar parti ose organizata marksiste-leniniste, të cilat gjithnjë e më me sukses po vihen në radhët e para të luftës revolucionare e çlirimtare. Kjo është një ngjarje e madhe historike që dëshmon për vitalitetin e ideve të marksizëm-leninizmit, që provon se perspektiva e revolucionit dhe e fitores së socializmit po bëhen gjithnjë e më të qarta.

Rritja e forcave revolucionare dhe e hovit revolucionar në botë tregon se, me gjithë përpjekjet e mëdha e të ethshme për të kthyer prapa rrotën e historisë, imperializmi dhe revizionizmi nuk kanë mundur dhe nuk do të mundin kurrë të ndryshojnë raportin e përgjithshëm të forcave që anon gjithnjë e më shumë nga revolucionit. Iniciativa historike ka kaluar përfundimisht në duart e klasës punëtore e të popujve. Rrugën e zhvillimit të shoqërisë së sotme njerëzore e hap dhe e përcakton revolucionit.

Zhvillimi e zgjerimi plot sukses i lëvizjes revolucionare botërore dhe i luftës së popujve është prova më e qartë e thellimit të krizës së rëndë, në të cilën gjenden armiqtë më të urryer të popujve, imperializmi e revizionizmi.

Tradhtia e revizionistëve modernë hrushovianë, që

i solli një dëm të madh lëvizjes revolucionare, qe një avantazh i përkohshëm për sistemin kapitalist në përgjithësi. Por ajo nuk e shpëtoi dot kapitalizmin nga kriza e përgjithshme, ashtu si nuk ndryshoi dot kursin e historisë, tendencën e zhvillimit të saj drejt revolucionit e fitores së socializmit.

Në planin e vetë sistemit të tij shfrytëzues, imperializmi synonte të zhdukte krizat ekonomike dhe të mënjanonte kontradiktat e thella midis vendeve kapitaliste. Edhe këtu ai ka pësuar disfatë. Vendet e mëdha kapitaliste, pa përmendur të voglat, tani ndodhen në një fazë kur fenomenet e krizës janë bërë kronike dhe kanë krijuar vështirësi të reja për tërë ekonominë e tyre. Kriza e sistemit financiar-valutor është bërë këto vitet e fundit një sëmundje e pashërueshme. Rriten me hapa të shpejtë inflacioni e shtrenjtësia e jetesës, me miliona numërohen të papunët. Tronditjet e thella të pozitive sunduese të dollarit amerikan dhe masat shtrënguese të Niksonit kanë shkaktuar një çoroditje e rrëmujë të madhe në tërë botën kapitaliste. Kriza e dollarit nuk është vetëm krizë e monedhës amerikane dhe as e monedhave të shteteve të tjera kapitaliste. Kjo është një shprehje e dukshme e krizës së përgjithshme ekonomike, politike, ushtarake e ideologjike e të gjithë sistemit kapitalist, e strukturave dhe e superstrukturave të tij, e regjimeve dhe e aleancave kapitaliste e imperialiste.

Të gjitha këto fenomene i kanë shtuar e acaruar edhe më shumë kontradiktat midis vendeve të ndryshme borgjeze e sidomos kontradiktat me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Lufta ekonomike e politike midis vendeve kapitaliste po merr proporcione gjithnjë e më të mëdha. Integrimet ekonomike dhe formimi i blloqeve ushtarake e kanë shtuar edhe më tepër konkurrencën e pamëshirshme midis tyre. Tregu i Përbashkët Evropian kërkon tani të sfidojë supremacinë amerikane në tregun botëror, ndërsa fuqia e re ekonomike e Japonisë me ndërhyrjen e saj po e shtrëngon mjaft ekspansionin e monopoleve amerikane në Azi. Grindje të mëdha kanë shpërthyer në gjirin e NATO-s dhe të aleancave të tjera të imperializmit. Tendenca e këtyre rivaliteteve dhe e kontradiktave midis vendeve imperialiste shkon drejt thellimit të mëtejshëm.

Për të konsoliduar pozitat e tij, për të shmangur vështirësitë ekonomike, kontradiktat politike dhe konfliktet sociale, imperializmi është përpjekur dhe përpjetet t'u përshtatet kushteve të reja të luftës klasore si brenda, ashtu dhe jashtë vendit. Por as zhvillimi i kapitalizmit monopolist shtetëror, as koncentrimi në shkallë kombëtare e ndërkombëtare i prodhimit dhe i kapitaleve, as militarizimi i ekonomisë dhe as revolucioni tekniko-shkencor nuk e kanë shpëtuar dhe nuk mund ta shpëtojnë kurrë atë nga disfatat dhe shembja e tij e pashmangshme. Zgjidhjet e pjesshme e të përkohshme që ato mund të japin, janë të mbarsura me kontradikta e konflikte të reja akoma më të ashpra, me një krizë akoma më të thellë e më tronditëse të tërë sistemit kapitalist botëror.

Një situatë po kaq e rëndë sundon tani edhe në kampin revizionist. Partia jonë, e ndriçuar nga teoria marksiste-leniniste, parashikoi drejt se ku do t'i çonte

revizionistët rruga e tyre e tradhtisë, parashikoi rënien dhe degjenerimin e tyre të gjithanshëm. Kriza që po kalon revizionizmi është edhe ideologjike, edhe politike, edhe ekonomike. Krerët e Moskës jo vetëm që dështuan në përpjekjet për të vendosur sundimin e tyre mbi lëvizjen komuniste dhe për të kontrolluar atë nacionalçlirimtare, por ata tani nuk janë në gjendje të bëjnë zap as edhe aleatët më të afërt, klikat revizioniste në vendet satelite.

Midis reparteve të ndryshme të revizionizmit nuk ka as unitet ideologjik, as unitet veprimi. Konfliktet dhe grindjet midis klikave revizioniste në fuqi përbëjnë një fenomen të zakonshëm dhe kanë arritur në pika të larta tensioni, që mund të shpërthejnë në çdo moment. Në radhët e partive revizioniste janë krijuar fraksione e rryma nga më të ndryshmet. Tradhtia ndaj marksizëm-leninizmit futi në radhët e këtyre partive konfuzionin dhe shturjen.

Vendet revizioniste dhe vetë kreu i tyre Bashkimi Sovjetik kanë filluar të vuajnë nga plagët kronike të shoqërisë borgjeze. Pakënaqësia që ka shkaktuar në masat vija revizioniste po shndërrohet në një revoltë të hapët. Ngjarjet e vitit të kaluar në Poloni treguan se klasa punëtore iu kundërvu ballë për ballë pushtetit revizionist. Shembulli i punëtorëve polakë që zbritën në fushën e betejës është frymëzues për gjithë punonjësit e popujt e vendeve ku sundojnë revizionistët. Ai është një kushtim lufte për përmbysjen e tradhtisë revizioniste.

Imperializmi dhe revizionizmi në stadin e tyre të tanishëm, me gjithë pamjen e jashtme të fuqishme,

janë të dobët, kalbëzohen dhe degjencrohen përditë e më shumë. Ata sot nuk janë në gjendje të zgjidhin asnjë problem themelor të brendshëm dhe të realizojnë asnjë qëllim kryesor të tyre të jashtëm.

Imperializmit, revizionizmit dhe gjithë reaksionarëve të tjerë po u dridhet toka nën këmbë. Në epokën tonë s'ka asnjë forcë në botë që mund të ndalë marshimin fitimtar të revolucionit dhe të socializmit.

Ne, komunistët shqiptarë, ashtu si edhe gjithë marksistë-leninistët kudo që ndodhen, e shikojmë të ardhmen e botës me optimizëm, të bindur se ajo i takon lirisë e pavarësisë së popujve, i takon socializmit. Por optimizmi ynë revolucionar nuk na ndalon të shohim në të njëjtën kohë edhe kërcënimet e rreziqet për vendin tonë dhe për të gjithë popujt, që vijnë nga imperializmi amerikan e politika e tij agresive dhe nga imperializmi i ri revizionist sovjetik, të cilët së bashku pretendojnë për hegjemoninë dhe sundimin botëror.

Me gjithë ndryshimet që janë bërë e po bëhen në botë, imperializmi amerikan ka qenë dhe mbetet armiku kryesor i të gjithë popujve, shtypësi dhe shfrytëzuesi më i madh i vendeve të tjera, bastioni i reaksionit ndërkombëtar. Përderisa ai qëndron në këmbë, mbetet e pandryshuar edhe natyra e tij reaksionare, mbetet politika e strategjia e tij agresive e luftënxitëse, që buron nga vetë thelbi i sistemit të tij shfrytëzues. Imperializmi amerikan nuk mund të jetojë pa ekspanzion ekonomik, pa ndërhyrje politike e agresione ushtarake, pa shtypur e pa shfrytëzuar popujt e tjerë. Ndryshe ai vdes, hapet rruga për revolta e revolucione.

Ngjarjet e viteve të fundit vërtetojnë më së miri

se imperializmi i SHBA-së jo vetëm nuk ka hequr dorë, por bën çmos për ta minuar lirinë e pavarësinë e shteteve të tjera dhe për të vendosur sundimin e tij botëror. Kudo ai vringëllon armët, kudo ai kërcënon me luftë.

Imperialistët amerikanë po vazhdojnë luftën e tyre barbare në Vietnam. Ata e shtrinë agresionin e tyre edhe në Kamboxhia e Laos, duke u shkaktuar kështu gjithë popujve heroikë të Indokinës shkatërrim, vrasje e plagë të rënda. Me nxitjen dhe me ndihmën aktive të drejtpërdrejtë të SHBA-së, Izraeli shpërtheu agresionin kundër vendeve arabe dhe mban të pushtuara tokat e tyre. Komplotet, aktet e subversionit, ndërhyrjet e dhuna e armatosur në Libi, në RP të Kongos ose në Somali, në Guine ose në shumë vende të Azisë e të Amerikës Latine kanë qenë dhe janë vepër e imperialistëve amerikanë. Shtetet e Bashkuara janë aleatët dhe garantët e të gjitha regjimeve reaksionare e fashiste, janë mbrojtësit kryesorë të sistemit ndërkombëtar të shfrytëzimit kapitalist.

Agresioni i hapët gjithnjë e më tepër po del si mjet kryesor për sigurimin e pozitave të sundimit ekonomik, politik e ushtarak të SHBA-së në vendet e tjera. Realizimin e kësaj strategjie imperialistët amerikanë përpiqen ta arrijnë edhe me anë të politikës së neokolonializmit e të përpjekjeve për ruajtjen e monopolit teknik e shkencor si mjet ndërhyrjeje, shtypjeje e shfrytëzimi.

Mund të thuhet se praktikisht sot nuk ka vend të lirë e të pavarur, që në këtë ose në atë formë të mos jetë i kërcënuar nga imperializmi amerikan, të mos

ndiejë presionet e shantazhet e tij, të mos preket nga ndërhyrjet e tij brutale.

Përballë popujve qëndron një armik i madh, i pangopur e barbar. Për këtë arsye edhe lufta kundër imperializmit amerikan është bërë një detyrë supreme për të gjitha forcat revolucionare të kohës sonë, për të gjithë popujt. Kontradikta e thellë që ekziston midis imperializmit amerikan e politikës së tij agresive nga njëra anë dhe popujve e luftës së tyre antiimperialiste, nga ana tjetër, do të vijë gjithnjë duke u ashpërsuar dhe duke u bërë më e mprehtë. Në përleshjen midis tyre nuk mund të ketë as periudha qetësie, as lëshime dhe as tërheqje, siç predikojnë revizionistët. Çdo lëkundje në luftën kundër imperializmit është e mbarsur me pasoja shumë të rrezikshme.

Por imperializmi amerikan nuk është i vetmi armik i popujve; as duhen konsideruar si aleatë të tij vetëm kukullat reaksionare të lidhura drejtpërdrejt politikisht, ushtarakisht e financiarisht me Uashingtonin. Anglia, Gjermania Perëndimore, Japonia e vendet e tjera imperialiste, me gjithë kontradiktat që kanë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbeten partneret kryesore të tyre, ndjekin, gjithashtu, politikën e ekspansionit ekonomik e të neokolonializmit ndaj vendeve të tjera, kërkojnë të krijojnë sfera influence dhe kurdoherë dalin në përkrahje të reaksionit botëror. «Evropa e Bashkuar», që po kurdis kapitali i Evropës Perëndimore, synon të bëhet një superfuqi e re imperialiste me pretendime hegjemoniste e sunduese të njëllajta me ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të Bashkimit Sovjetik. Lufta kundër imperializmit ameri-

kan do të ishte joefikase, në qoftë se nuk luftohet edhe kundër miqve e aleatëve të tij, gjithë fuqive imperia-
liste.

Qëndrimi ndaj imperializmit, e në radhë të parë ndaj atij amerikan, përbën «gurin e provës» për të gjitha forcat politike të botës. Kjo nuk është një çështje e thjeshtë taktike, as edhe një zgjidhje e përkohshme koniunkturale. Qëndrimi ndaj imperializmit është çështje përmbajtjeje e vijës politike, ai është masë vlerësimi e veprimeve praktike, është më në fund një vijë demarkacioni që ndan dy kampet në luftë, që ndan ata të cilët mbrojnë interesat jetikë të popujve dhe të së ardhmes së njerëzimit, nga ata që i marrin këto nëpër këmbë, që ndan revolucionarët nga reaksionarët e tradhtarët.

Lufta antiimperialiste nuk ka kudo dhe nuk mund të ketë të njëjtën shtrirje dhe të njëjtin intensitet. Por e rëndësishme është që popujt të ngrihen në luftë çlirimtare kundër imperializmit, jo vetëm për t'ia bërë jetën të pamundur, por edhe për t'ia shkurtuar. Vetëm rezistenca e vendosur, lufta e hapët e dhëmb për dhëmb, mostërheqja përpara vështirësive e sakrificave mund ta detyrojnë atë të zbrapset e të mposhtet. Detyra e revolucionarëve është që t'i sqarojnë politikisht e ideologjikisht masat e popujve, të rritin vigjilencën, t'u tregojnë atyre ku është armiku e si vepron ai, si duhet të organizohen dhe si të luftojnë kundër tij.

Për popujt e revolucionin një armik, po aq i rrezikshëm, po aq dinak e agresiv si imperializmi amerikan është edhe imperializmi i ri revizionist sovjetik.

Partia jonë, që kur revizionizmi modern rrëmbeu

pushtetin në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera socialiste, e vlerësoi drejt situatën dhe theksoi se në botë po hapej një «front i dytë» kundër socializmit dhe komunizmit.

Sot të gjithë jemi dëshmitarë se Bashkimi Sovjetik revizionist është shndërruar në një shtet shovinist e neokolonialist. Politika e jashtme e revizionistëve sovjetikë është politika rusomadhe e carëve të vjetër, janë po ato synime ekspansioniste, janë po ata objektiva nënshtrimi e skllavërimi të popujve. Oreksi i imperializmit të ri revizionist sovjetik është i madh. Ashtu si Shtetet e Bashkuara, krerët e Kremlinit i kanë mbushur qiejt me aeroplanë dhe oqeanet me nëndetëse, krijojnë ku mundin baza ushtarake, tregje ekonomike për të thithur pasuritë e popujve dhe rekrutojnë agjentë në të katër anët. Rublat e tanket, korrupsioni e shantazhet ecin paralel. S'ka zonë të botës ku revizionistët sovjetikë të mos kërkojnë të shtrijnë influencën e tyre imperialiste, s'ka çështje ndërkombëtare ku ata të mos përzihen për të nxjerrë përfitime në dobi të vet. Në gjurmët e imperialistëve amerikanë, ata janë bërë nga tregtarët më të mëdhenj të armëve, fajdexhinj të pangopur, frymëzues të kompleteve kundërrevolucionare dhe nxitës të konflikteve midis kombeve.

Kronologjia e veprimeve të revizionistëve sovjetikë gjatë këtyre viteve të fundit tregon se ky kurs agresiv vjen gjithnjë e duke u thelluar. Sa më shumë shtohen kontradiktat brenda Bashkimit Sovjetik, sa më shumë rriten grindjet e kundërshtimet brenda kampit revizionist dhe, më në fund, sa më tepër rritet konkurrenca me rivalin dhe aleatin e tij, imperializmin

amerikan, aq më tepër në plan të parë të aksionit të revizionistëve sovjetikë del aventura ushtarake.

Agresioni barbar kundër Çekoslovakisë nuk ishte një gjë e rastit, një situatë e jashtëzakonshme dhe e papërsëritshme, por kulmi i një politike agresive e shoviniste të ngritur në vijë zyrtare, fillimi i një sulmi të madh të drejtuar kundër lirisë e pavarësisë së shumë vendeve e popujve. Fakt është se në një kohë me pushtimin e hapët të Çekoslovakisë u forcua edhe pushtimi i heshtur ushtarak i Polonisë, Gjermanisë Demokratike, Hungarisë, Bullgarisë e i Mongolisë. Këto vende praktikisht janë kthyer në guberna ushtarake të perandorisë së Moskës, ku gjeneralët sovjetikë mbajnë aty jo vetëm «qetësinë», por bëjnë edhe politikën, edhe ligjin.

Ironia e tërë kësaj politike shoviniste, e tërë përpjekjeve për të sunduar popujt është se revizionistët sovjetikë këtë politikë mundohen ta përlligjin edhe «teorikisht», ta quajnë «proletare», bile edhe «leniniste». Brezhnjevi nxori teorinë famëkeqe të «sovrانيتit të kufizuar» dhe propagandistët e tij të zellshëm po përpiqen ta bindin botën se Bashkimi Sovjetik nuk dërgoi në Pragë tanket, por «ndihmën e tij internacionaliste», se ai nuk po i shtyp vendet satelite, por «forcon bashkësinë socialiste», se nuk po i shfrytëzon ata, por shpejton «integrimin socialist» të tyre etj.

Teoria e «sovrانيتit të kufizuar» është teoria e shovinizmit dhe e ekspansionit të fuqisë së madhe, teoria me anën e së cilës imperialistët e rinj sovjetikë kërkojnë të shuajnë çdo sovranitet të popujve të tjerë dhe t'i krijojnë vetes të «drejtën sovrane» për të ndër-

hyrë ku të duan e kur të duan. Duke u mohuar të tjerëve sovranitetin, ata kërkojnë t'u mohojnë kombeve e shteteve atë çfarë kanë më të shtrenjtë — lirinë e pavarësinë, t'u mohojnë individualitetin e tyre kombëtar, të drejtën e pamohueshme të vetëvendosjes e të zhvillimit të pavarur, të drejtën e barazisë në jetën ndërkombëtare dhe të pjesëmarrjes aktive në marrëdhëniet botërore. Me «sovranitetin e kufizuar», ata kërkojnë të ligjërojnë të drejtën e më të fortit për të mbytur të dobëtin, të më të madhit për të gllabëruar të voglin. Ajo është teoria e justifikimit të agresionit imperialist.

Një përmbajtje të tillë reaksionare ka edhe «internacionalizmi proletar» i revizionistëve sovjetikë. Sundimtarët e Kremlinit kërkojnë të spekulojnë dhe t'u imponojnë forcave revolucionare e antiimperialiste konceptin e shtrembër se gjoja kriter bazë i internacionalizmit proletar, «gur i provës» është qëndrimi ndaj Bashkimit Sovjetik, se e gjithë lufta dhe veprimet revolucionare u duhen nënshtruar interesave të Bashkimit Sovjetik dhe politikës së tij.

Spekulimet me të kaluarën dhe përdorimi i tezave që dikur kanë qenë të drejta, sot, kur revizionistët sovjetikë e tradhtuan marksizëm-leninizmin dhe e shndërruan Bashkimin Sovjetik në një vend imperialist, nuk bindin njeri. Sot qëndron përsëri si një kriter i internacionalizmit proletar qëndrimi ndaj Bashkimit Sovjetik, por, në kuptimin e kundërt nga ai që kishte në kohën e Leninit e të Stalinit, kur ai ishte qendër e revolucionit botëror dhe bazë e tij. Revolucionar e internationalist sot është ai që lufton revizionistët sovje-

tikë, që demaskon tradhtinë e tyre, që kundërshton me të gjitha forcat politikën dhe vijën e tyre antimarksiste e imperialiste.

Kalimi i revizionizmit sovjetik në socialimperializëm, intensifikimi i politikës dhe i veprimtarisë së tij ekspansioniste kanë shtruar edhe detyra të reja përpara forcave revolucionare e antiimperialiste. Lufta ideologjike kundër revizionizmit mbetet gjithnjë aktuale dhe një detyrë e dorës së parë që duhet çuar deri në fund, deri në shkatërrimin e tij të plotë. Por sot kjo do të ishte e pamjaftueshme dhe nuk do të përfundonte me sukses, në qoftë se Bashkimi i sotëm Sovjetik nuk konsiderohet e trajtohet edhe si një fuqi shtetërore imperialiste.

Forca më e madhe kundërrevolucionare që i kundërvihet luftës së popujve për liri e socializëm është aleanca sovjeto-amerikane. Në të gjitha fushat — ekonomike, politike e ushtarake — kurset imperialiste të SHBA-së dhe të Bashkimit Sovjetik po afrohen e po puqen pa ndërprerje. Për të realizuar qëllimet e tyre hegjemoniste e sunduese të dyja superfuqitë ia kanë nevojën njëra-tjetrës, prandaj edhe rregullojnë së bashku orët, koordinojnë vazhdimisht planet dhe bashkërendojnë veprimtarinë konkrete.

Pesha e kësaj aleance reaksionare është e pranishme në të gjitha konfliktet e problemet ndërkombëtare. Që kur ka mbaruar Lufta e Dytë Botërore kanë kaluar më se 26 vjet, megjithatë Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik mbajnë akoma të dislokuara në vende të tjera ushtri të tyre. Të dyja superfuqitë kanë njohur dhe pranuar si fakt të kryer zonat përkatëse të

influncës dhe përpiqen të mos e pengojnë njëra-tjetrën në sundimin dhe në shfrytëzimin e tyre.

Nëpërmjet diplomacisë së fshehtë dhe në përputhje të plotë me praktikën imperialiste, amerikanët dhe revizionistët sovjetikë po bëjnë tani pazarllëqe në prapaskenë për të ndarë midis tyre ish-zonat e influencës, nga të cilat u shporrën fuqitë e vjetra imperialiste, për të mbushur, siç thonë ata, «boshllëqet». Këto «fryte» të alcancës sovjeto-amerikane duken mjaft qartë në Lindjen e Mesme, në bregun verior të Afrikës, në detin Mesdhe, në Oqeanin Indian etj.

Të dyja superfuqitë përpiqen që për çështjet e mëdha ndërkombëtare të dalin me një politikë të koordinuar dhe me një qëndrim të përbashkët ndaj të tretëve, siç po ndodh në bisedimet për çarmatimin në Gjenevë, në ato për Lindjen e Mesme në Nju-Jork etj. Akoma më qartë duket ky koordinim e ky qëndrim në veprimtarinë e OKB-së, e cila është shndërruar në një instrument të politikës së tyre hegjemoniste. Në praktikë, në OKB asnjë vendim nuk merret, asnjë sugjerim nuk pranohet, po nuk u pëlqeu të dyja fuqive të mëdha. Ajo që kërkojnë e synojnë Shtetet e Bashkuara e Bashkimi Sovjetik është t'i detyrojnë shtetet e tjera t'ua besojnë fatet e tyre të dyja superfuqive, që këto të bëhen arbitra jo vetëm për punët e jashtme të vendeve të tjera, por edhe për punët e brendshme. Të dyja superfuqitë kërkojnë që pranimi i vullnetit dhe i diktatit të tyre të ngrihet në ligj e normë të jetës ndërkombëtare.

Përpjekje të mëdha bëjnë imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë për ruajtjen e ekuilibrit të

fuqisë midis tyre dhe për mbajtjen e një distance të caktuar ndaj të tjerëve. Të gjitha marrëveshjet që ata kanë përfunduar në fushën e armëve atomike, të hapësirës kozmike, të fundit të detrave etj., synojnë të ruajnë të paprekura këto raporte të reja strategjike, të cilat përcaktojnë edhe politikën e përbashkët të superfuqive. Ata duan sidomos të ruajnë të paprekur monopolin e armëve të reja dhe epërsinë tekniko-shkencore në degët kryesore të zhvillimit, me qëllim që t'i mbajnë vendet e tjera të varura dhe të ushtrojnë mbi to një presion të vazhdueshëm politik, ekonomik e ushtarak. Asnjë nuk dyshon se takimet tepër të fshehta të SALT-it, nga të cilat janë përjashtuar edhe aleatët më të ngushtë, janë shndërruar në një institucion ku jo vetëm bashkërendohen çështjet ushtarake, por përcaktohen edhe qëndrimet konkrete politike, edhe strategjia e përbashkët me afat të gjatë.

Sigurisht, do të ishte e pakuptueshme dhe jo reale sikur në aleancën sovjeto-amerikane të shihnim vetëm afrimin e bashkëpunimit e dy superfuqive, interesat dhe veprimet e përbashkëta. Si fuqi imperialiste që janë, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik revizionist kanë edhe grindje, rivalitete e kontradikta të thella midis tyre, të cilat i pengojnë të veprojnë kurdoherë e kudo në harmoni e unitet të plotë. Ekzistenca dhe ashpërsimi i kontradiktave qëndrojnë në vetë bazën e kësaj aleance, në sistemin shoqëror kapitalist të të dy vendeve, në synimet imperialiste të tyre. Të dyja palët, duke u përgatitur për luftë, planifikojnë t'i hanë kokën edhe njëra-tjetrës.

Duke spekuluar me kontradiktat që kanë me

SHBA-në dhe me qëllim që të fshehin tradhtinë e tyre, revizionistët sovjetikë kërkojnë të hiqen si antiimperialistë, sikur edhe ata e kundërshtojnë politikën e agresionit e të luftës të imperializmit amerikan. Por «antiimperializmi» i revizionistëve është një parullë false, një taktikë për të mashtruar popujt, për të përçarë unitetin e tyre antiimperialist, për të sabotuar revolucionin. Çdo iluzion mbi «antiimperializmin» e revizionistëve sovjetikë do të ishte shumë i rrezikshëm dhe me pasoja të rënda për luftën revolucionare të popujve.

Përderisa imperializmi amerikan dhe ai revizionist janë dy superfuqi imperialiste dhe kanë dalë me një strategji të përbashkët kundërrevolucionare, atëherë nuk është e mundur që edhe lufta e popujve kundër tyre të mos shkrihet në një rrymë të vetme. Nuk mund të mbështetesh te njëri imperializëm për të kundërshtuar tjetrin.

Imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë përpiqen të ruajnë qetësinë, statukuonë dhe aleancat. Ata kërkojnë nga popujt të rrinë urtë, të aprovojnë politikën dhe veprimet e tyre. Por popujt, revolucionarët dhe gjithë njerëzit përparimtarë të botës e urrejnë me gjithë shpirt shtypjen e shfrytëzimin, që janë njëlloj të padurueshëm qoftë kur ushtrohen nga imperialistët amerikanë, qoftë kur ushtrohen nga revizionistët sovjetikë.

Ata nuk e duan «qetësinë» e «paqen» imperialiste, nuk duan as statukuonë e tanishme reaksionare, që predikojnë imperialistët e revizionistët. Revolucionin, lufta për çlirimin kombëtar e shoqëror nuk është

«shkatërrimi i njerëzimit», siç predikojnë imperialistët e revizionistët, por shkatërrimi i shtypjes e i shfrytëzimit, ai është shpëtimi i njerëzimit.

Revolucioni patjetër nuk do të shpërthejë në të njëjtën kohë në të gjitha vendet dhe nuk do të fitojë në të njëjtën ditë. Ai do të ketë zigzaget e tij, ngritjet e uljet e veta. Por kudo ku ka shtypje e shfrytëzim, ka edhe do të ketë luftë klasore, ka edhe do të ketë revolucion. Marksizëm-leninizmi frymëzon tani çdo ditë e më shumë proletariatin botëror, u ndriçon gjithë masave të shtypura rrugën drejt fitores.

Paqja e vërtetë dhe sigurimi i popujve arrihen me luftë kundër imperializmit amerikan e socialimperializmit sovjetik

Një vëmendje të posaçme Partia dhe Qeveria jonë u kanë kushtuar disa problemeve të veçanta, të rëndësishme e të mprehta të jetës ndërkombëtare, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti mbi fatet dhe të ardhmen e popujve në një plan të gjerë.

Po bëhen tani 12 vjet që populli heroik vietnamez zhvillon një luftë për jetë a vdekje kundër agresionit imperialist të Shteteve të Bashkuara dhe kukullave të tij të Sajgonit. Edhe pse imperialistët amerikanë e kanë humbur luftën në fushën e betejës, edhe pse asnjë shpresë nuk kanë që situata të ndryshojë në dobi të tyre, ata vazhdojnë me kokëfortësi të dëshpëruar agresionin dhe përpjekjet për të përkulur dhe për të shtypur popullin vietnamez. Për më tepër, kohët e fun-

dit, imperialistët amerikanë e shtrinë agresionin e tyre edhe në Kamboxhia e Laos. Por edhe zgjerimi i agresionit tregoi se, ashtu si dje, edhe sot dhuna e armatosur, terrori e barbarizmat nuk mund t'u ofrojnë imperialistëve amerikanë një rrugëdalje nga qorrrokaku ku janë futur. Në sajë të luftës së bashkuar të popujve të Indokinës, të unitetit dhe të vendosmërisë së tyre, dështuan plotësisht planet strategjike e taktike të qeverisë së Niksonit.

Indokina është bërë tani fusha kryesore e luftës çlirimtare të popujve kundër imperializmit amerikan, prandaj edhe fitoret e popullit të Vietnamit, Laosit e Kamboxhias kanë qenë një frymëzim i madh revolucionar për të gjithë ata që kundërshtojnë imperializmin, që luftojnë për lirinë e pavarësinë kombëtare, për demokraci e drejtësi shoqërore. Sidomos ato kanë ngritur lart moralin, frymën luftarake të popujve të vegjël, kanë rritur besimin në forcat e veta dhe në të ardhmen e tyre.

Mësimi historik që vjen nga Vietnamit është se agresionit të fuqisë së madhe imperialiste mund t'i kundërvihet me shumë sukses lufta popullore, se në kushtet e sotme edhe një vend i vogël mund të mposhtë një superfuqi, kur ai është i vendosur të bëjë çdo sakrificë dhe të ecë me guxim në rrugën e lirisë e të revolucionit.

Doktrina e re e Niksonit e ashtuquajtur «vietnamizim i luftës» dhe manovrat e tij për «bisedime paqësore» etj. nuk mund të kenë asnjë sukses. «Vietnamizim» do të thotë zgjerim dhe vazhdim i agresionit imperialist, që vietnamezët të vihen kundër vietname-

zëve, aziatikët kundër aziatikëve dhe imperialistët amerikanë t'i sundojnë, t'i shtypin, t'i shfrytëzojnë e t'i përdorin si mish për top në politikën e tyre agresive e hegjemoniste. Por plani i Niksonit për «vietnamizimin» e luftës në Vietnam dështoi përballë qëndresës heroike të popujve të Indokinës dhe nuk mund t'i çojë autorët e tij asgjëkundi tjetër përveçse në disfata të reja edhe më të mëdha. Nga katastrofa në Vietnam imperialistët amerikanë nuk mund t'i shpëtojnë as miqtë e tyre, revizionistët sovjetikë, të cilët për vite me radhë kanë sabotuar përpjekjet e popullit vietnamez dhe kanë bërë presione që ai ta shuajë luftën antiamerikane.

Në Vietnam dhe në gjithë Indokinën nuk mund të ketë paqe të vërtetë, gjersa të mos tërhiqen përfundimisht të gjitha forcat amerikane nga ky rajon dhe gjersa të mos prishen atje të gjitha bazat e instalimet ushtarake amerikane. Populli vietnamez do të fitojë me siguri dhe kjo fitore do të arrihet në fushën e betejës nga populli vietnamez që lufton e derdh gjak. Atij dhe vetëm atij i takon e drejta të vendosë vetë dhe në mënyrë të pavarur për fatet e veta.

Populli shqiptar ka qenë e do të jetë kurdoherë me mish e me shpirt me popullin vëlla vietnamez dhe me popujt e tjerë të Indokinës, ai është plotësisht solidar me luftën e tyre të drejtë e heroike kundër imperializmit amerikan e alcatëve të tij. Ne u japim gjithë përkrahjen tonë qëndrimeve të drejta të qeverisë së Republikës Demokratike të Vietnamit dhe të qeverisë së përkohshme revolucionare të Republikës së Vietnamit të Jugut për largimin e trupave amerikane dhe zgjidhjen e konfliktit vietnamez.

Në vatër tensioni është shndërruar edhe Lindja e Mesme. Prej kohe vazhdon agresioni imperialisto-izraelit që synon të nënshtrojë dhe të skllavërojë të gjithë popujt arabë. Gjendjen e ka rënduar edhe përzierja në këtë zonë e revizionistëve sovjetikë, të cilët, duke u hequr si miq të shteteve arabe, kërkojnë të zënë pozita strategjike dhe të shtrijnë atje hegjemoninë e tyre.

Sionistët, imperialistët dhe revizionistët sovjetikë përpiqen tani t'i përçajjnë arabët dhe t'i vënë në grindje njëri me tjetrin, me qëllim që të dobësojnë frontin e tyre të përbashkët çlirimtar antiimperialist dhe t'u imponojnë një paqe në kundërshtim me interesat e tyre jetikë. Synimi i dy superfuqive, të cilat kërkojnë të marrin fatet e Lindjes së Mesme në duart e veta dhe të luajnë rolin e arbitrit, është ta ndajnë atë në zona të influencës dhe mbi jetën e kokallat e popujve arabë të ndërtojnë plasdarme të reja, nga ku të nisen për pushtime imperialiste në kontinentet e Azisë dhe të Afrikës.

Por popujt arabë nuk kanë luftuar me shekuj për lirinë e pavarësinë, për mbrojtjen e nderit dhe të pasurive të tyre që tani t'i bëjnë fli për interesat imperialistë të fuqive të mëdha. Çmimi i «paqes» që u ofrojnë imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë është shumë i madh. Për më tepër ai është ofendues dhe prek thellë traditat e lavdishme, dinjitetin dhe krenarinë e gjithë popujve arabë. Popujt arabë e kanë bërë të qartë se nuk do të heqin dorë as nga një pëllëmbë tokë arabe dhe nuk do të bëjnë asnjë pazarllëk me çështjen palestineze. Ata janë ngritur kundër dhunës së reaksionarëve jordancëzë për shtypjen e

forcave partizane të Palestinës, që qëndrojnë në pararojë të luftës çlirimtare të popujve arabë dhe kanë hedhur poshtë komplotin imperialist, i cili ka për qëllim të likuidojë tërësisht e përfundimisht revolucionin palestinez.

Populli ynë i ka miq tradicionalë e vëllezër popujt arabë dhe është plotësisht solidar me çështjen e tyre të drejtë, ai ka qenë dhe do të jetë kurdoherë përkrah tyre. Ne jemi të bindur se popujt arabë do ta ngrenë lart flamurin e luftës çlirimtare kundër imperialistëve e sionistëve, kundër ndërhyrjeve të revizionistëve sovjetikë dhe mashtrimeve të gjithë atyre që u hiqen si miq, por që kërkojnë t'u futin thikën pas shpine. Tokat arabe u takojnë arabëve, çështja për të cilën lufton populli palestinez është e pamposhtshme.

Republika Popullore e Shqipërisë është e interesuar për një paqe dhe sigurim të vërtetë në Evropë, për një zgjidhje reale e të drejtë të problemeve të mbetura pezull që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, e, në radhë të parë, të problemit gjerman.

Por situata në Evropë nuk është ashtu, siç kërkojnë ta paraqesin revizionistët sovjetikë, sikur tensioni ka rënë dhe gjendja është qetësuar, sepse u nënshkrua Traktati Moskë-Bon, sepse Bashkimi Sovjetik dhe Gjermania Federale paskan garantuar paprekshmërinë e kufijve të shteteve evropiane.

Përkundrazi. përfundimi i Traktatit Sovjeto-Gjerman krijoi një tension të ri në Evropë, që vjen nga kërcënimet reale të revizionizmit sovjetik dhe të revanshizmit gjerman kundër interesave, sovranitetit dhe të drejtave të vendeve evropiane, nga synimi i tyre

për hegjemoni e sundim në kontinentin tonë. Që tani Republika Federale e Gjermanisë është bërë shteti më i fuqishëm kapitalist në Evropën Perëndimore, që sfidon ndikimin amerikan dhe përpiqet të errësojë fuqinë e Francës e të Anglisë, pa mos përmendur partnerët e tjerë të NATO-s. Në vend që të ndihmojë për ndonjë zgjidhje, Traktati Sovjeto-Gjerman krijon kontradikta, rivalitete e ndërlikime të reja imperialiste me pasoja të rrezikshme për të gjitha vendet e Evropës.

Me anë të kësaj marrëveshjeje kërkohet të lihet mënjane Traktati i Paqes me Gjermaninë dhe të shkelen e të mohohen të drejtat e ligjshme të popujve që luftuan kundër Gjermanisë hitleriane dhe fituan. Por ata që derdhën gjak në luftën kundër nazizmit nuk mund të pranojnë kurrë që militarizmit dhe revanshizmit gjerman t'u lihen duart të lira dhe t'u krijohen premisat që ta hedhin përsëri Evropën e botën në një kasaphanë të re. Përfundimi i Traktatit të Paqes me Gjermaninë është një e drejtë që u takon të gjitha vendeve të koalicionit antifashist dhe këtë nuk mund t'ua rrëmbejë e mohojë njeri. Marrëveshja sovjeto-gjermane, duke e lënë mënjane këtë çështje, shkeli interesat e lartë të Republikës Demokratike Gjermane, të cilët janë vënë tani në tryezën e pazarllëqeve që bëhen prapa shpinës së saj nga diplomacitë e katër fuqive të mëdha e të Bonit. Këtë e vërtetoi fare qartë edhe marrëveshja për Berlinin, ku lëshimet e kompromiset e krerëve të Kremlinit e vunë Republikën Demokratike Gjermane në një pozitë shumë mospërfillëse e poshtëruese.

Është e vërtetë se popujt e Evropës aspirojnë

dhe kanë nevojë për sigurimin e lirisë, të pavarësisë dhe të zhvillimit normal të tyre. Por sigurimi, për të cilin kohët e fundit revizionistët sovjetikë po bëjnë një zhurmë të madhe, është një sigurim i rremë. Popujt e Evropës nuk mund të pranojnë të bëhen bashkë-fajtorë të të dyja fuqive të mëdha imperialiste kundër vetë interesave të tyre supremë, nuk mund të pranojnë të bëjnë lojën e dy superfuqive, që mendojnë vetëm për sigurimin e sferave të tyre të influencës dhe nënshtrimin e sundimin e vendeve evropiane. Sigurimin e vërtetë popujt nuk e presin nga dy fuqitë e mëdha imperialiste që janë autorët e agresioneve në Vietnam, në Lindjen e Mesme, në Çekosllovakë e gjetkë, që mbajnë bazat dhe ushtritë e tyre pushtuese në shumë vende të Evropës dhe që marrin nëpër këmbë lirinë e pavarësinë e popujve e të vendeve sovraane.

Në Evropë ekziston blloku i NATO-s që është një alcancë agresive e sunduar nga imperialistët amerikanë dhe ku revanshistët e Gjermanisë Perëndimore luajnë një rol kryesor. Qëllimi i tij ka qenë dhe mbetet lufta kundër komunizmit, shtypja e revolucionit në Evropë dhe sigurimi i interesave imperialistë amerikanë. Ekziston, gjithashtu, Traktati i Varshavës, i cili është shndërruar në një makinë për mbajtjen e sundimit të revizionistëve sovjetikë në vendet që bëjnë pjesë në të dhe në një forcë agresive e kërcënuese kundër pavarësisë së vendeve të tjera. Për çfarë sigurimi evropian mund të bëhet fjalë, kur këto dy blloqe mbajnë nën thundrën e tyre popujt e kësaj e të asaj ane të Evropës, kur ato janë shtyllat themelore të sundimit të dy superfuqive e të diktatit të tyre? Është e qartë

se, përderisa të ekzistojnë në Evropë këto dy blloqe, bazat e ushtrisë amerikane e sovjetike në vendet evropiane, nuk mund të ketë kurrë sigurim të vërtetë evropian.

Vendi ynë doli nga Traktati i Varshavës dhe e denoncoi botërisht politikën e veprimtarinë e tij agresive. Me këtë akt të drejtë ne mbrojtëm jo vetëm lirinë e pavarësinë e atdheut tonë, por edhe treguam se rruga për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë, rruga e paqes dhe e sigurimit ndërkombëtar është kundërshtimi i vendosur ndaj politikës hegjemoniste e skllavëruese të imperializmit e të revizionizmit.

Ne mendojmë se sigurimin e tyre popujt e Evropës mund ta arrijnë dhe do ta arrijnë vetëm duke forcuar pavarësinë e sovranitetin e tyre kombëtar, në luftë të vendosur kundër politikës hegjemoniste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, kundër përpjekjeve të tyre për konservimin e bazave ushtarake e të zonave të influencës në Evropë, kundër përpjekjeve për ruajtjen e kësaj statukuoje dhe drejtimin e tehut të luftës në Azi.

Republika Popullore e Shqipërisë, si vend mesdhetar, është e interesuar dhe lufton që pellgu i Mesdheut të jetë një zonë paqeje e bashkëpunimi të frytshëm. Ajo dënon me vendosmëri politikën agresive të fuqive imperialiste, e në radhë të parë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të Bashkimit Sovjetik, të cilat me flotat e tyre të luftës kërcënojnë seriozisht lirinë e pavarësinë e vendeve mesdhetare. Është detyrë e vendeve lirisdashëse dhe e gjithë forcave përparimtare të Mesdheut të kërkojnë largimin e këtyre flotave dhe të

luftojnë për këtë, të kundërshtojnë çdo politikë hegje-moniste në këtë pjesë të botës. Mesdheu u përket vetëm popujve dhe vendeve mesdhetare.

Një zhurmë e madhe po bëhet prej kohe në të gjithë botën rreth problemit të çarmatimit. Kjo është ngritur me qëllim nga imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë për të vënë në gjumë popujt dhe për të intensifikuar planet e tyre agresive. Faktet tregojnë se ndërsa të dyja superfuqitë flasin shumë për çarmatimin, ndërsa kanë bërë me qindra e mijëra mbledhje, kanë krijuar komitete e komisione që nuk numërohen, ato vazhdojnë garën e shfrenuar të armatimeve. Si kurrë ndonjëherë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik kanë rritur buxhetet ushtarake, kanë zgjeruar në të gjitha kontinentet e detet bazat ushtarake dhe dislokimin e trupave sulmuese, kanë përqendruar forcat e tyre më të mëdha e më të mira teknike e shkencore për përsosjen e armëve të shfarosjes në masë etj.

Armatimi i vazhdueshëm është kusht i ekzistencës së imperializmit, që buron nga vetë karakteri i rendit ekonomik dhe nga politika e tij agresive. Prandaj, përdërisa ekzistojnë shtete imperialiste e socialimperialiste, nuk do të ketë kurrë çarmatim në botë. Imperialistët e revizionistët armatosen dhe rritin forcat sulmuese për të pushtuar dhe rindarë botën midis tyre, për t'i shtypur revolucionet, për të shkatërruar shtetet socialiste dhe për të robëruar popujt. «Përpjekjet për çarmatim» të tyre synojnë të çarmatosin popujt dhe t'u imponojnë atyre më lehtë sundimin e vet. Nga ana tjetër, kjo propagandë është një ushqim për teoricien-

nët pacifistë dhe gjithë naivët që rrojnë me shpresa dhe jashtë realitetit objektiv.

Gara e armatimeve, të cilën të dyja superfuqitë përpiqen ta zhvillojnë në mënyrë të ekuilibruar midis tyre, është e mbarsur me pasoja njëjtë të rrezikshme. Ato përgatiten për luftëra agresive, të cilat mund t'i shpërthejnë veç e veç ose së bashku kundër vendeve të tjera, ose edhe kundër njëri-tjetrit. Në këto kushte nuk përjashtohen jo vetëm luftërat lokale, që imperialistët e revizionistët i shpërthejnë vazhdimisht, por as edhe luftërat në shkallë botërore. Bile, luftërat lokale i përgatitin terrenin cilitdo agresor për luftëra në një shkallë më të gjerë, janë avancime taktike të agresivitetit të imperialistëve në strategjinë e tyre të një lufte imperialiste globale. Këtij synimi i shërbejnë edhe komplotet e puçet e kurdisura nga agjenturat e fuqive imperialiste e revizioniste në shtetet e ndryshme pa ndërhyrje ushtarake të jashtme.

Përderisa imperialistët dhe socialimperialistët armatosen e përgatiten për luftëra agresive, shtetet socialiste nuk mund të rrinë duarlidhur. Armatimi i tyre ka për qëllim mbrojtjen e atdheut socialist, kundërshtimin e politikës së ndërhyrjeve, presioneve e shantazheve të imperializmit e socialimperializmit. Ai drejtohet kundër orvatjeve të tyre për të cenuar të drejtat e lirinë e popujve dhe ndihmon popujt e tjerë që të ruajnë ose të fitojnë lirinë e pavarësinë e tyre kombëtare.

Popujt nuk mund të mos shohin se grupimet ushtarake agresive të NATO-s, ku sundojnë imperialistët amerikanë dhe ato të Traktatit të Varshavës, ku sun-

dojnë socialimperialistët sovjetikë, përbëjnë sot kërcënimin kryesor për paqen dhe sigurimin ndërkombëtar. Nën pretextin se mbrohen nga njëra-tjetra dy superfuqitë janë ato që bëjnë ligjin në këto pakte, që ndajnë zonat e influencës, që bëjnë agresione të veçuara ose ndihmojnë agresorë të tjerë në shërbim të tyre. Duke përfitur nga fuqia e grupimit, ato edhe më tepër rrezikojnë lirinë, jetën e njerëzve e të shteteve. Popujt në të katër anët e botës duhet ta shikojnë drejt në sy situatën, ta demaskojnë këtë gjendje alarmante dhe të vënë përpara përgjegjësisë të gjitha ato qeveri që bëjnë lodrën e dy superfuqive.

Për veprimet agresive të dy superfuqive mbajnë përgjegjësi jo vetëm qeveritë, por edhe popujt e tyre, ashtu siç mbajnë përgjegjësi edhe qeveritë e popujt e partnerëve në aleancat ushtarake përkatëse. Lidhur me agresionin kundër Çekoslovakisë, për shembull, nuk mbajnë përgjegjësi vetëm socialimperialistët sovjetikë që e organizuan, por edhe qeveritë e shteteve anëtare të Traktatit të Varshavës, pjesëmarrëse në këtë agresion, mbajnë edhe popujt e Bashkimit Sovjetik, Polonisë, Gjermanisë Demokratike, Bullgarisë e të Hungarisë, që qëndruan pasivë dhe e lejuan këtë akt barbar. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për ndihmën e drejtpërdrejtë e të tërthortë që partnerët e Shteteve të Bashkuara u japin agresorëve amerikanë në Vietnam. Pjesëmarrjen në NATO ose në Traktatin e Varshavës, aleancën e miqësinë me Shtetet e Bashkuara ose me Bashkimin Sovjetik partnerët e tyre e justifikojnë me nevojën e mbrojtjes. Por me këtë ata forcojnë superfuqitë, i ndihmojnë këto të ruajnë dhe të

ndajnë zonat e influencës, të zbatojnë politikën e hegjemonisë, të diktatit e të agresionit.

Sa më e organizuar, e gjerë dhe e fuqishme të jetë rezistenca e lufta e popujve të vendeve të NATO-s dhe të Traktatit të Varshavës ndaj veprimeve agresive të dy superfuqive dhe të qeverive të tyre që i përkrahin ato, aq më vështirë do ta kenë agresorët për të kryer aventurat e tyre ushtarake kundër popujve.

Manovra të panumërta ushtarake bëhen në kufijtë e Jugosllavisë e të Rumanisë nga Bashkimi Sovjetik, Hungaria, Bullgaria e Çekosllovakia. Është e qartë se këtu kemi të bëjmë me presione, shantazhe e kërcënime, që në mos sot nesër mund të shndërrohen në agresione të hapëta. A nuk e shohin e nuk e ndiejnë popujt e vendeve pjesëmarrëse në këto manovra se ç'plane e komplete të rrezikshme po kurdisen? Historia do t'i dënojë rëndë, në qoftë se ata rrinë të qetë dhe ua lënë duart të lira agresorëve.

Politika e jashtme e Republikës Popullore të Shqipërisë është një politikë konsekuente e parimore në të gjitha drejtimet e saj

Shokë e shoqe,

Republika Popullore e Shqipërisë zë sot një vend të nderuar në arenën ndërkombëtare. ajo gëzon respektin e admirimin e popujve liridashës dhe të të gjitha forcave përparimtare. Shqipëria socialiste nuk u izolua, siç predikonin e dëshironin armiqtë e saj, por i

forcoi edhe më shumë lidhjet ndërkombëtare, autoritetin dhe pozitën e saj në botë.

Simpatia e respekti që gëzon tek të gjitha vendet përparimtare e popujt e botës, pesha dhe influenca e vendit tonë nuk janë pasojë as e madhësisë së popullsisë, as e fuqisë ekonomike ose ushtarake të tij. Forca dhe influenca e Shqipërisë socialiste qëndrojnë në idetë marksiste-leniniste që e frymëzojnë, që i mbrojnë të pastra dhe i përhap në të gjithë botën. Ato qëndrojnë në shoqërinë e vërtetë socialiste që ndërtohet në Shqipëri, në luftën e guximshme, parimore e konsekuente kundër imperializmit, revizionizmit dhe gjithë reaksionarëve.

Vendi ynë ka me qindra e qindra milionë shokë e miq në gjithë botën, pse ai është një shtet që respektton vetveten dhe gjithë popujt, pse ashtu si ruan me vendosmëri lirinë e pavarësinë e tij, u do të mirën e të ardhmen e lumtur dhe gjithë vendeve të tjera.

Pikërisht sepse ndjekim këtë politikë dhe gëzojmë këtë respekt, armiq të na urrejnë, na shajnë dhe na luftojnë. Por kjo nuk na bën të ndryshojmë rrugë, as t'i fshehim pikëpamjet e veprimet tona. Kuraja civile në arenën ndërkombëtare nuk i ka munguar kurrë Partisë sonë dhe nuk do t'i mungojë në asnjë kohë dhe në asnjë rrethanë.

Partia e Punës dhe Republika Popullore e Shqipërisë janë dhe do të jenë armiq të betuar të imperializmit dhe të revizionizmit. Duke e quajtur luftën e tyre si pjesë të pandarë të luftës së përgjithshme revolucionare të popujve, ato kanë zhvilluar një luftë aktive kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, dhe

kundër revizionizmit, me udhëheqjen sovjetike në krye, kanë dënuar dhe demaskuar me vendosmëri politikën dhe veprimtarinë e tyre agresive, qëllimet për të shtypur popujt, për të mbytur revolucionin dhe për të sunduar botën. Eksperienca e gjertanishme e vendit tonë na ka bindur edhe më shumë se liria e pavarësia e fituar, si dje ashtu edhe sot, mbrohen e garantohen vetëm me një luftë të vazhdueshme kundër imperializmit e revizionizmit, pa kompromis, kudo dhe në të gjitha aspektet.

Drejtësinë e vijës së Partisë sonë në luftën kundër imperializmit e revizionizmit e vërtetoi plotësisht jeta, e vërtetojnë fitoret e arritura.

E ndërgjegjshme për përgjegjësinë e lartë përpara popullit të vet e socializmit, Partia jonë nuk do të ndalet kurrë në mes të rrugës, ajo do të luftojë me vendosmëri e me të gjitha forcat kundër imperializmit dhe socialimperializmit, deri në shkatërrimin e tyre të plotë dhe triumfin e revolucionit botëror. Këtë luftë populli dhe Partia jonë e shikojnë si një e të pandarë, sepse nuk mund të kundërshtohet me sukses imperializmi pa luftuar njëkohësisht edhe socialimperializmin sovjetik ose anasjelltas.

Politika e jashtme e Partisë dhe e Qeverisë sonë ka qenë dhe është parimore e konsekuente në të gjitha drejtimitet dhe komponentet e saj. Bazë themelore dhe e patundur e politikës sonë të jashtme ka qenë dhe do të jetë forcimi i miqësisë, i ndihmës reciproke, bashkëpunimi vëllazëror dhe uniteti luftarak me vendet socialiste, me të cilat na bashkojnë idealet e socializ-

mit e të komunizmit, lufta e përbashkët kundër imperializmit, revizionizmit dhe reaksionit.

Partia dhe populli ynë janë të lidhur me një miqësi dhe një solidaritet të fuqishëm socialist me popullin vietnamez, Republikën Demokratike të Vietnamit. Ashtu si përkrahim përpjekjet e saj për ndërtimin e socializmit, ne i japim të gjithë përkrahjen e mbështetjen tonë kundërshtimit të vendosur që ajo i bën agresionit imperialist. Ne përkrahim, gjithashtu, Republikën e Vietnamit të Jugut dhe qeverinë e përkohshme revolucionare të Vietnamit të Jugut, të cilat janë përfaqësueset e vetme dhe të pakundërshtueshme të të gjithë vietnamezëve që banojnë në jug të paralelit 17.

Republika Popullore e Shqipërisë, ashtu si edhe në të kaluarën, është për zhvillimin e forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore me Republikën Demokratike Popullore të Koresë në bazë të parimeve të marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar, në interes të ndërtimit të socializmit në dy vendet tona. Populli shqiptar përkrah me vendosmëri luftën e drejtë që zhvillon populli korean kundër imperializmit amerikan dhe shërbëtorëve të tij për mbrojtjen e Republikës Demokratike Popullore të Koresë dhe ribashkimin e atdheut. Ne dënojmë politikën agresive të imperialistëve japonezë kundër Republikës Demokratike Popullore të Koresë, si dhe manovrat e revizionistëve sovjetikë që inkurajojnë politikën e tyre ekspansioniste.

Partia dhe Qeveria jonë kanë përkrahur dhe do të përkrahin kurdoherë pa rezerva luftën e popujve të

Azisë, Afrikës dhe të Amerikës Latine për çlirimin kombëtar e shoqëror, kundër imperializmit, dallimit racial, shtypjes e shfrytëzimit kolonial.

Marrëdhënie miqësore ekzistojnë midis Shqipërisë dhe Republikës Arabe të Egjiptit, të Algjerisë, të Sirisë, të Libisë e vendeve të tjera arabe. Edhe në të ardhmen ne do të përpiqemi që marrëdhëniet e mira dhe bashkëpunimi reciprok të zhvillohen e të forcohen më tej në të mirë të popujve tanë.

Vendi ynë ka treguar gjithnjë vullnet të mirë dhe ka ndërmarrë hapa konstruktivë për të mbajtur e për të zhvilluar marrëdhënie normale me të gjitha vendet me sisteme të ndryshme shoqërore në bazë të parimeve të bashkekzistencës paqësore, të barazisë, të respektimit të sovranitetit shtetëror e të integritetit territorial, të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit e të leverdisë reciproke.

Duke luftuar kundër imperializmit e revizionizmit, ne i përmbahemi me rreptësi parimit se çështjet e brendshme të çdo vendi janë çështje që duhet të zgjidhen nga ai vetë pa asnjë imponim ose ndërhyrje nga jashtë. Ne mbrojmë, gjithashtu, pikëpamjen se të gjitha marrëdhëniet midis vendeve, qofshin këto të vogla ose të mëdha, mund dhe duhet të ndërtohen vetëm mbi bazën e barazisë e të mosndërhyrjes në punët e brendshme. Mbi këto baza i kemi vendosur dhe i zhvillojmë ne marrëdhëniet me të gjitha shtetet. Lidhjet e marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me një numër vendesh, që u përfunduan gjatë këtij viti të fundit, janë një sukses i dukshëm i politikës sonë të jashtme dhe dëshmojnë për forcimin e pozitës ndërkombëtare

të Republikës Popullore të Shqipërisë. Ato përputhen me interesat e përbashkët dhe i shërbejnë forcimit të mirëkuptimit e të bashkëpunimit midis popujve.

Marrëdhëniet e vendit tonë me shtetet fqinje Partia dhe Qeveria u kanë kushtuar një kujdes të veçantë. Po zhvillohen normalisht marrëdhëniet miqësore midis Shqipërisë e Rumanisë, që janë në dobinë reciproke të të dy vendeve dhe u përgjigjen interesave të popujve tanë. Populli shqiptar do të përkrahë gjithnjë luftën e drejtë të popullit rumun për të mbrojtur pavarësinë e sovranitetin e atdheut të tij nga çdo kërcënim i jashtëm.

Në frymën e fqinjësisë së mirë po zhvillohen marrëdhëniet edhe me Jugosllavinë. Me gjithë divergjencat e njohura ideologjike, ne jemi për përmirësimin e vazhdueshëm të marrëdhëniet shtetërore në të gjitha ato fusha ku ekzistojnë interesa reciproke. Me popujt e Jugosllavisë jemi miq e vëllezër. Ne dëshirojmë që ndjenjat e miqësisë, të kalitura në luftën antifashiste, të zhvillohen në rrugë të drejtë në të mirën e përbashkët të popujve tanë. Në popullin shqiptar popujt e Jugosllavisë do të kenë kurdoherë një mik që dëshiron t'i shikojë të lirë, të pavarur e sovranë, që kundërshton me vendosmëri të gjitha manovrat, shantazhet e kërcënimet e fuqive imperialiste ndaj Jugosllavisë fqinje.

Marrëdhënie të mira ekzistojnë midis vendit tonë dhe Italisë e Turqisë. Ruajtja dhe zhvillimi i tyre u përgjigjet interesave të përbashkët. Këtë vit u vendosën edhe marrëdhënie diplomatike midis Shqipërisë e Greqisë. Kjo është një ngjarje e rëndësishme që i dha fund një gjendjeje anormale dhe që i shërben forcimit të paqes e sigurisë në Ballkan.

Republika Popullore e Shqipërisë është për atë që edhe në të ardhmen marrëdhëniet midis vendit tonë dhe atyre fqinje të zhvillohen në drejtim pozitiv dhe në ato fusha që paraqesin interes reciprok në luftën kundër ndërhyrjeve e intrigave të fuqive të mëdha imperialiste.

Miqësia dhe mirëkuptimi midis vendeve ballkanike duhet t'i kenë bazat në popull. Ne nuk kemi ndër mend as të parashtrijmë, as të pranojmë propozime për të formuar blloqe e aleanca ballkanike. Republika Popullore e Shqipërisë dëshiron e do të luftojë të kalitë miqësinë me popujt e Ballkanit në bazë të parimeve të bashkekzistencës paqësore. Regjimi i çdo vendi është gështje e popullit të vet. Ne nuk përzihem në punët e brendshme të askujt, por as edhe të tjerët nuk duhet të përzihen në tonat. Kjo nuk përjashton kritikën e polemikën reciproke. Shqipëria socialiste nuk do t'i lejojë kurrë vetes të cenojë lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e vendeve të tjera. Këtë nuk e ka bërë asnjëherë populli shqiptar gjatë historisë së vet, por ai nuk do të lejojë as të tjerët t'i prekin lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e tij.

Kohët për ne shqiptarët kanë ndryshuar. Në rast se carët e rinj të Kremlinit, si carët e vjetër, imperialistët e ndryshëm ose klikat shoviniste të Ballkanit do të orvaten të prekin kufijtë e Republikës Popullore të Shqipërisë, shqiptarët si një bllok i tërë, nuk do t'i gjejnë më as si më 1878, as si më 1914 dhe as si në kohën e Musolinit e të Hitlerit. Llogaritë e qarta bëjnë miq të mirë.

Populli shqiptar që ka vuajtur në shekuj nga pushtues barbarë, që e fitoi lirinë duke derdhur shumë

gjak, u thotë popujve vëllezër të Ballkanit të ruhen nga intrigat e imperialistëve të çdo ngjyre, së bashku t'u themi larg duart nga vendet tona, të mos lejojmë kërrkënd të shpërdorjës miqësinë tonë.

Popujt e Ballkanit janë plotësisht në gjendje të vendosin vetë e në mënyrë sovrane për marrëdhëniet midis tyre. «Fuçi baruti» Ballkani nuk ka qenë nga vetja e tij. Të tillë në të kaluarën atë e kanë bërë të huajt, imperialistët, që mbanin në duart e tyre të gjithë detonatorët. Kështu e duan ata të jetë edhe sot. Detyra e popujve të Ballkanit është t'ua presin me shpatë të gjitha fitilat, që paqja dhe siguria të vendosen me të vërtetë në Ballkan.

Është e natyrshme se popujt tanë kanë nevojë për miq. Por asnjëherë ata nuk duhet të bëhen vegla të të huajve në dëm të interesave të çdo populli në veçanti dhe të gjithë popujve tanë së bashku. Kjo është aleanca më e sigurtë dhe më e çeliktë që mund t'u propozohet popujve të Ballkanit.

Në rast se ndonjë shtet ballkanik, i shtyrë nga fuqitë imperialiste, ndërmerret një agresion kundër një shteti tjetër ballkanik, duhet të jetë e qartë se nuk do të mund të evitohet ndërhyrja e shteteve të tjera të Ballkanit. Kjo nuk do të mbetet një luftë lokale, por do të bëhet shkak për një konflikt botëror.

Të gjitha shtetet që respektojnë të drejtat e larta të Shqipërisë socialiste, që zbatojnë parimet e njohura, mbi të cilat mbështeten marrëdhëniet midis shteteve sovrane dhe që duan të mbajnë me ne marrëdhënie normale, do të gjejnë në Republikën Popullore të Shqipërisë mirëkuptim e reciprocitet.

Marrëdhëniet e vendit tonë me vendet e Evropës Lindore, pjesëtare të Traktatit të Varshavës, janë të një niveli të ulët. Kjo nuk është për fajin tonë. Udhëheqjet e tyre, duke qenë të nënshtruara plotësisht ndaj Moskës dhe duke iu bindur verbërisht politikës së saj të jashtme, kanë ndjekur ndaj vendit tonë një politikë armiqësore, e cila, siç dihet, i ka shkaktuar dëme të mëdha Shqipërisë. Edhe pse kanë dështuar në përpjekjet e tyre për të na frikësuar e përkulur, ata vazhdojnë të jenë kokëfortë në qëndrimin e tyre anti-shqiptar. Aq më keq për ta.

Për sa u përket popujve të këtyre vendeve, të cilët nuk janë fajtorë për situatën e krijuar, ne kemi qenë, jemi dhe do të jemi miq me ta, u kemi dashur dhe do t'u duam kurdoherë të mirën. Partia dhe populli shqiptar, ashtu siç dënuan agresionin e gushtit 1968, me të njëjtën vendosmëri përkrahin rezistencën e popullit çekoslovak kundër pushtuesve revizionistë sovjetikë e tradhtarëve vendës për liri e pavarësi kombëtare, luftën e popullit polak e të popujve të vendeve të tjera ku janë në fuqi klikat revizioniste kundër sundimit revizionist dhe politikës së diktatit e të shovinizmit të shtetit të madh të socialimperialistëve sovjetikë.

Mjaft herë Partia jonë u është drejtuar popullit dhe komunistëve të Bashkimit Sovjetik, duke u shpjeguar hollësisht dhe në mënyrë të dokumentuar shkaqet e vërteta të prishjes së marrëdhënieve sovjetoshqiptare. Populli e Partia jonë janë në dijeni për gjithë zhvillimin e ngjarjeve dhe do të ishte e tepërt t'i përsëritnim.

Kohët e fundit udhëheqësit sovjetikë hiqen sikur

dëshirojnë «normalizimin» e marrëdhënieve me vendin tonë. Kjo është fund e krye demagogji dhe një përpjekje për ta pasur si një certifikatë shfajësimi. Por ne nuk biem në kurthet e tyre. Ashtu siç nuk u jemi trembur kërcënimeve me armë, nuk gënjehemi as nga tundja e degës së ullirit. Ata i kanë borxhe të mëdha politike, ideologjike dhe ekonomike Shqipërisë. Normalizim mund të ketë dhe do të ketë me siguri, kur popujt sovjetikë dhe bolshevikët e vërtetë do të ndërhyjnë për të vendosur drejtësinë revolucionare marksiste-leniniste për këto çështje.

Populli ynë e kupton, e mbron dhe e zbaton me konsekuencë e deri në fund politikën e jashtme të Partisë e të Qeverisë sonë, sepse ajo është një politikë e qartë, e drejtë dhe parimore. Shqipëria e re socialiste ka mundur të përballojë furtunat e tërbuara imperialiste e revizioniste, të rritë autoritetin e prestigjin e saj ndërkombëtar, të sigurojë miq të fuqishëm dhe përkrahës në gjithë botën, sepse Partia, Qeveria dhe populli kanë vepruar në unitet të plotë, si në analizën e situatave, ashtu edhe në konkluzionet e nxjerra e në qëndrimet e mbajtura.

Ky unitet i pathyeshëm, vigjilenca e pashuar revolucionare, qëndrimet e shëndosha marksiste-leniniste ndaj ngjarjeve ndërkombëtare dhe përgjithësisht ndaj zhvillimit të sotëm botëror janë një garanci e madhe se Republika Popullore e Shqipërisë do të ecë në rrugë të sigurt dhe do të qëndrojë kurdoherë ballëllart në radhët e para të frontit antiimperialist e antirevizionist, luftëtare e paepur për çështjen e shenjtë të revolucionit dhe të çlirimit të popujve.

ZHVILLIMI I EKONOMISË DHE DETYRAT E PARTISË

Shokë dhe shoqe,

Kongresi i 5-të shtroi detyra të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës dhe për rritjen e mirëqenies së popullit. Klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe inteligjencia popullore, nën udhëheqjen e Partisë e me një ndërgjegje të lartë revolucionare, i plotësuan me nder ato detyra kolosale. U krye kështu një hap tjetër i rëndësishëm drejt ndërtimit të plotë të socializmit në vendin tonë.

Plani i katërt pesëvjeçar për prodhimin e përgjithshëm industrial dhe për investimet u plotësua në 4 vjet e 7 muaj, ndërsa punonjësit e qytetit të Tiranës e realizuan atë në 4 vjet e 4 muaj. Niveli i prodhimit industrial, i parashikuar për vitin 1970, u arrit që në vitin 1968. Ekonomisë sonë iu shtuan vepra të tilla madhështore si Hidrocentrali i Vaut të Dejës mbi lumin Drin, vendburimet e reja naftëmbajtëse, uzinat e plehrave kimike, Hekurudha Rrogozhinë—Fier etj. Gjithsej u ndërtuan dhe u vunë në shfrytëzim mbi 200 vepra të mëdha për industrinë, bujqësinë, transportin dhe

degët e tjera të ekonomisë. Të gjitha këto e rritën potencialin e ekonomisë sonë, forcuan edhe më tej bazën materialo-teknike të socializmit.

Të rëndësishme janë edhe sukseset e arritura në zhvillimin socialist të fshatit dhe të bujqësisë. Duke ecur në rrugën e intensifikimit, bujqësia jonë shtoi nga njëri vit në tjetrin prodhimin dhe sidomos rendimentet e drithërave të bukës. Më 1970 rendimenti mesatar i drithërave ishte 17,3 kuintalë për hektar. Një rendiment i tillë nuk ishte arritur kurrë ndonjëherë më parë edhe në vitet me kushte më të mira atmosferike. Një hop i madh përpara u bë për zgjerimin e sipërfaqes së ujitshme, për rritjen e shkallës së mekanizimit, si edhe të përdorimit të plehrave kimike e të farërave të zgjedhura.

Kongresi i 5-të bëri thirrjen «T'u qepemi kodrave e maleve, t'i zbukurojmë e t'i bëjmë ato pjellore si edhe fushat». Kjo direktivë çeli horizonte të reja për zhvillimin e bujqësisë dhe lulëzimin e jetës edhe në zonat e thella malore. Brenda një kohe të shkurtër përfundoi me sukses edhe këtu kolektivizimi. Plani i hapjes së tokave të reja nga fshatarësia kooperativiste në pesëvjeçarin që kaloi u plotësua para afatit dhe u tejkalua. Vënia në shfrytëzim e këtyre tokave u lejoi shumë fshatrave malore që të shtojnë prodhimin e drithërave, të sigurojnë bukën me forcat e tyre dhe t'i shesin teprica shtetit. Kjo ishte fitorja e parë në rrugën për ta kthyer në realitet perspektivën e re që hapi Partia për këto zona.

Gjatë pesëvjeçarit të katërt u morën shumë masa për të forcuar natyrën socialiste të marrëdhënieve eko-

nomiko-shoqërore. U përmirësua i gjithë sistemi i drejtimit dhe i planifikimit të ekonomisë. Në fshat, me anën e bashkimit vullnetar të kooperativave të vogla në kooperativa të zmadhuara, u ngrit në një nivel më të lartë shoqërizimi i pronës dhe i punës. Oborri kooperativist u zvogëlua, duke harmonizuar më drejt interesin e përgjithshëm me interesin personal të kooperativistëve. Pagat e larta të kuadrove të Partisë e të shtetit u ulën dhe diferencat e tyre me pagat e punonjësve të tjerë dhe të punëtorëve u ngushtuan në përputhje me parimet e socializmit. Interesi material u vunë në raport më të drejtë me stimujt moralë, ndërsa shumë stimuj materialë, që u kishte kaluar koha ose ishin të tepruar, u hoqën fare.

Lufta dhe puna vetëmohuese e masave punonjëse për zhvillimin e ekonomisë siguruan atë bazë të domoshme, që lejoi të plotësohen me sukses edhe detyrat e caktuara në pesëvjeçarin e katërt për ngritjen e mirëqenies dhe të nivelit kulturor të popullit. Në vitin 1970 të ardhurat kombëtare ishin 55 për qind më të mëdha se në vitin 1965, ndërsa të ardhurat reale për frymë të popullsisë u shtuan 17 për qind. Popullsia u furnizua më mirë dhe pa ndërprerje me mallrat e nevojshme. Pothuajse në çdo kooperativë u ngrit një rrjet i gjerë i shërbimeve social-kulturore. U përmirësua jetesa e përditshme e çdo familjeje qytetare e fshatare.

Në të gjithë vendin përfundoi shtrirja e arsimit të detyrueshëm tetëvjeçar, duke krijuar kështu mundësinë për të ngritur në një shkallë më të lartë përgatitjen e përgjithshme arsimore e kulturore të rinisë. Por

fitorja më e shquar që u shënua në lëmin e arsimit ishte programi që shtroi Partia për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës. Zbatimi i këtij programi ka një rëndësi të jashtëzakonshme për edukimin e shëndoshë revolucionar të brezit të ri dhe për fatet e socializmit në Shqipëri.

Realizimi një vit para afatit i aksionit të madh, elektrifikimit të të gjitha fshatrave, është një fitore e shkëlqyer e me të vërtetë historike e rendit tonë socialist, një dëshmi tjetër e kujdesit të vazhdueshëm të Partisë e të pushtetit popullor për ngritjen dhe emancipimin e gjithanshëm të fshatit tonë kooperativist.

Mjete të shumta u investuan nga shteti gjatë pesëvjeçarit të katërt për ndërtimin e shtëpive të banimit. Por një faktor shumë i rëndësishëm që çeli perspektiva të reja për të bërë një kthesë në plotësimin e nevojave për strehim të punonjësve të qytetit dhe të qendrave punëtore ishte shpërthimi i iniciativës revolucionare të masave për ndërtim banesash me kontribut vullnetar të vetë punonjësve. Gjatë pesë vjetëve u ndërtuan, në qytet dhe në fshat, rreth 73 mijë apartamente. Një punë e madhe ndërtuese, ku u shpreh uniteti i shkëlqyer dhe solidariteti socialist i popullit tonë, u krye për përballimin e pasojave të rënda, të shkaktuara nga tërmeti në rrethet e Dibrës dhe të Tepelenës. Me ndihmën e pushtetit dhe kontributin e gjithë popullit u ndërtuan brenda një afati rekord 1 600 shtëpi të reja dhe u meremetuan rreth 11 000 të tjera.

Vendi ynë është vendi i vetëm në botë ku popullsia nuk paguan asnjë lloj tatimi e takse të drejtpërdrejtë. Heqja e plotë e taksave nga popullsia është një

epërsi që duket sheshit e rendit tonë socialist mbi atë kapitalist.

Rezultatet e arritura në zhvillimin e ekonomisë e të kulturës, në ngritjen e mirëqenies së popullit dhe forcimin e rendit tonë shoqëror janë fitore të shquara të ndërtimit tonë socialist, që gëzojnë me të drejtë Partinë e popullin, që u japin atyre energji e guxim të ri revolucionar për të ecur kurdoherë përpara. Ato flasin qartë për drejtësinë e vijës dhe të politikës konsekuente marksiste-leniniste që ka zbatuar Partia, për atë entuziazëm, mobilizim në punë dhe frymë të lartë revolucionare, që karakterizojnë masat tona punonjëse.

Pesëvjeçari që u mbyll do të hyjë në histori si periudha e iniciativave të mëdha popullore dhe e heroizmit masiv, kur forca e bashkuar e popullit, nën udhëheqjen e Partisë, bëri të tunden malet e fushat. Kjo është koha kur i madh e i vogël u ngritën në këmbë, kur entuziazmi dhe hovi revolucionar pushtoi fabrikat e fshatrat, shkollat e minierat. Është koha e heronjve të vetëdijshëm që asnjë pengesë, asnjë vësh-tirësi, asnjë furtunë nuk i kthen prapa, për të cilët zbatimi i detyrës, përmbushja e porosisë së popullit është ligj suprem e i shenjtë. Kjo periudhë e lavdi-shme lindi heronj të tillë si: cucën malësore Shkurte Pal Vata, punëtorin Adem Reka, inxhinierin Muhamet Shehu, mësuesin Ismet Sali Bruçaj, ushtarin Agron Elezi e shumë të tjerë, që dhanë jetën në krye të detyrës për idealet e Partisë dhe interesat e popullit. Shembulli e figura e tyre u bënë pishtarë të qëndrim-it burrëror dhe të devocionit të pakufishëm, që ngritën peshë mbarë popullin.

Në këto valë të papërmbajtura revolucionare shpërthyen iniciativat e mrekullueshme të masave dhe fryma e aksionit, që i dhanë një përmbajtje e shtytje të re punës në të tërë sektorët, që treguan se ç'forca kolosale akoma të panjohura e të pashfrytëzuara ruajnë në gjirin e tyre Partia, klasa punëtore e fshatarësia, rinia e gruaja, ç'forca të pashtershme ka rendi socialist.

Populli ynë është modest, por ai ka të drejtë të krenohet për bijtë e bijat e tij që ngrenë e montojnë vetë fabrikat e fjalës së fundit të teknikës botërore, që drejtojnë anijet moderne nëpër oqeane, që aq shpëjt e aq mirë ndërtojnë vepra të tilla të komplikuar teknike si Hidrocentralin e Vaut të Dejës. Ai ka të drejtë të krenohet për njerëzit e tij të rinj, që me guxim të pashembullt sulmojnë shkencën e teknikën, përmbysin normat akademike e lënë prapa edhe parashikimet më optimiste.

Ky entuziazëm i paparë revolucionar, ky heroizëm masiv dhe kjo frymë e lartë initiative nuk ranë nga qielli. Ato e kanë burimin në atë luftë heroike e të pashembullt që Partia e populli kanë bërë për shpartallimin e bllokadave imperialiste e revizioniste, në patriotizmin e pashuar dhe besimin e patundur që populli ynë ka në forcat e veta, në sigurinë e së ardhmes që farkëton socializmi, në nxitjen jetëdhënëse që frymëzojnë mësimet e Partisë. Vetëm një perspektivë e madhe lind guximin e madh, vetëm bindjet e rrënjosura ideologjike mund të bëjnë çudira. T'i ruajmë e t'i zhvillojmë më tej këto cilësi të mëdha morale të fituara, të vëmë të gjitha forcat për t'i mbajtur kur-

doherë të gjalla e të pastra, t'i bëjmë ato një forcë lëvizëse për të zgjidhur me sukses detyrat madhështore që kemi përpara.

Fitoret e mëdha të arritura në të gjitha fushat e ndërtimit socialist, përvoja e grumbulluar dhe entuziazmi e fryma e lartë revolucionare e masave punonjëse përbëjnë atë bazë të fuqishme, mbi të cilën do të mbështetet i gjithë zhvillimi ekonomik e shoqëror i vendit në pesëvjeçarin e pestë. Detyrat kryesore të planit që do të aprovojë ky Kongres rrjedhin nga vazhdimi i ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, nga stadi i arritur dhe perspektivat e zhvillimit të ekonomisë.

Ekonomia jonë ka arritur një nivel të ri më të lartë sasior e cilësor. Zhvillimi i mëtejshëm i industrisë karakterizohet nga një vëllim i madh prodhimi dhe sidomos nga krijimi i degëve të reja të industrisë së rëndë përpunuese. Janë ngritur ndërmarrje të mëdha e komplekse, me teknikë e teknologji të përparuar. Kudo ku akoma prodhohet me metoda artizanale është shtruar detyra që të kalohet në metodat industriale të prodhimit. Shkenca dhe teknika e re po futen gradualisht në të gjitha degët e ekonomisë. Bujqësia po ecën gjithnjë e më shumë në rrugën e intensifikimit.

Të gjitha këto tregojnë se ekonomia jonë po hyn në një etapë të re, se zhvillimi i saj i mëtejshëm kërkon një harmonizim më të mirë të rrugës ekstensive me atë intensive, si dhe zgjidhjen e problemeve që lindin nga ky harmonizim. Në këto kushte del e domosdoshme që i gjithë zhvillimi i ekonomisë, drejtimi dhe organizimi i saj të vihen mbi baza më të shëndosha shkencore.

Në përputhje me orientimet themelore të politikës së Partisë për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, si detyrë kryesore e zhvillimit të ekonomisë në pesë-vjeçarin e pestë do të jetë:

Të sigurohet fuqizimi i përgjithshëm i ekonomisë popullore në rrugën e kthimit të Shqipërisë nga një vend bujqësor-industrial në një vend industrial-bujqësor, me qëllim që të rritet shkalla e vetëveprimit të ekonomisë, të forcohet më tej rendi socialist, të ngrihet mirëqenia materiale e kulturore e popullit, duke ngushtuar sidomos dallimet esenciale midis fshatit e qytetit dhe të rritet aftësia mbrojtëse e vendit.

Për këtë:

Të luftohet për një zhvillim të mëtejshëm të industrisë, duke përmirësuar strukturën e saj me degë e prodhime të reja, sidomos të industrisë së rëndë përpunuese, për të zgjeruar bazën energjetike dhe të lëndëve të para dhe për të shfrytëzuar më racionalisht burimet dhe pasuritë e vendit;

Të arrihet një rritje më e madhe e prodhimit bujqësor nëpërmjet intensifikimit të mëtejshëm të tij, duke u mbështetur në forcimin e organizimit e të drejtimit shkencor të prodhimit dhe në fuqizimin e bazës materiale-teknike të bujqësisë;

Të zhvillohet me vull përparimi tekniko-shkencor në të gjitha degët e ekonomisë popullore, të përsosën pa ndërprerje marrëdhëniet socialiste në prodhim, të thellohet revolucioni socialist në fushën e ideologjisë e të kulturës, të zbatohet me vendosmëri parimi i mbështetjes në forcat e veta.

Planin e ri pesëvjeçar e hartuan vetë masat pu-

nonjëse, duke u mbështetur në direktivat e orientimet e Partisë e të Qeverisë. Klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste, specialistët e teknikët, kuadrot e bazës e të qendrës, të gjithë së bashku diskutuan gjallërisht si asnjëherë tjetër dhe caktuan detyrat e pesëvjeçarit të pestë. Fryma e lartë revolucionare, mendimi krijues, përvoja e tyre e pasur, mbështetja në forcat e veta, ndjenja e thellë e përgjegjësisë për fatet e atdheut e të socializmit qëndrojnë në themel të projekt-direktivave që i paraqiten këtij Kongresi për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës për vitet 1971-1975.

Edhe në pesëvjeçarin e pestë industria do të luajë si gjithnjë rolin pararojë për zhvillimin e forcave prodhuese. Prodhimi i përgjithshëm industrial parashikohet që më 1975 të rritet 61-66 për qind në krahasim me vitin 1970. Kjo do të thotë se vetëm në vitin 1975 prodhimi industrial do të jetë 12 për qind më i madh sesa ai i realizuar gjatë gjithë pesëvjeçarit të dytë, 1956-1960. Vetëm ky fakt mjafton për të hedhur poshtë shpifjet banale të revizionistëve sovjetikë, se ekonomia jonë ka ngecur gjoja në vend që kur u pranë ndihmat e tyre.

Gjatë këtij pesëvjeçari do të synohet që industria, sidomos ajo nxjerrëse dhe e rëndë përpunuese, të forcohet, të modernizohet më tej dhe të ngrihet në një shkallë më të lartë. Për këtë arsye do të ndërtohen një varg veprash të reja me procese teknologjike e përpjesëtime prodhimi të papara për ekonominë tonë. Të tilla do të jenë: kombinati i metalurgjisë së zezë me cikël të mbyllur, uzina për përpunimin e thellë të naftës, minierat e mëdha për nxjerrjen e hekur-nikelit,

kromit, qymyrgurit, hidrocentrali i Fierzës, fabrikat për pasurimin e mineraleve etj. Do të prodhohen për herë të parë çelique dhe gizë, nikel, kobalt, llamarinë, tuba, karburante të cilësive të larta, gaz i lëngët, ure, acid klorhidrik etj. Si rrjedhim i këtij zhvillimi do të shtohet klasa punëtore, do të rritet niveli tekniko-profesional dhe roli i saj udhëheqës në të gjithë jetën e vendit.

Perspektiva të mëdha hapen në planin e ri pesëvjeçar edhe për zhvillimin e bujqësisë sonë socialiste. Në vitin 1975 prodhimi i përgjithshëm bujqësor do të jetë 65-69 për qind më i madh se ai i vitit 1970 ose rreth 3 herë më i lartë se ai i vitit 1960. Do të shtohet shumë prodhimi i drithërave, i qumështit, i mishit, i vezëve, i perimeve dhe i bimëve industriale. Numri i pemëve frutore do të rritet rreth 28 për qind. Duke ndërtuar vepra të rëndësishme bonifikimi e ujitjeje, sidomos në zonat malore, aftësia ujitëse do të përfshijë rreth 58 për qind të sipërfaqes së tokës arë të vendit. Numri i traktorëve në shfrytëzim, të kthyer në 15 kuaj fuqi më 1975, në krahasim me vitin 1970, do të rritet rreth 40 për qind, ose 3,5 herë më shumë nga sa kishte në vitin 1960. Është parashikuar që nevojat e bujqësisë për plehra kimike e mekanizma, për farëra e kafshë race të llojeve me prodhimtari të lartë të plotësohen si asnjëherë më parë. Gjatë këtij pesëvjeçari do të përgatiten me mijëra specialistë të mesëm e të lartë për këtë sektor kaq të rëndësishëm të ekonomisë sonë.

Një program madhështor ndërtimesh kapitale do të përfshijë të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore.

Investimet e caktuara për pesëvjeçarin e pestë janë të barabarta me të gjitha investimet që janë bërë gjatë 11 vjetëve të fundit të marrë së bashku (1960-1970). Vetëm vlefta e ndërtim-montimit për dy objektet e mëdha, për kombinatin metalurgjik e hidrocentralin e Fierzës, janë gati të barabarta me investimet e kryera në gjithë pesëvjeçarin e parë ose rreth 50 për qind të gjithë investimeve të pesëvjeçarit të dytë. Gjithsej do të ndërtohen rreth 270 vepra ekonomike e socialkulturore.

Revolucionarizimi i shkollës do të shoqërohet me zgjerimin e mëtejshëm të arsimit të mesëm e të lartë. Në çdo tre veta të popullsisë në të gjitha kategoritë e arsimit një do të mësojë në bankat e shkollës. Në pesë vjetët e ardhshëm do të përgatiten rreth 20 000 specialistë me arsim të lartë, ose 33 për qind më shumë sesa u përgatitën gjatë 26 vjetëve të fundit, që nga vendosja e pushtetit popullor e gjer në vitin 1970. Gjithë ndërtimi ynë socialist në çdo fushë të jetës do të intensifikohet nën shenjën e një përdorimi më të gjerë të dijeve dhe të kërkimeve shkencore.

Zhvillimi kompleks e dinamik që do të kryhet në ekonominë tonë, do të sjellë si gjithnjë ngritjen e mirëqenies materiale e kulturore të punonjësve të qytetit dhe të fshatit. Jeta e popullit tonë trim e punëtor do të zbukurohet edhe më shumë, do të bëhet më e lumtur dhe më e gëzuar. Mjafton të përmendim se në apartamentet e shtëpitë që do të ndërtohen gjatë pesëvjeçarit të pestë do të strehohet një popullsi e barabartë me atë që kanë sot qytetet Korçë, Elbasan, Shkodër, Durrës, Vlorë, Berat, Fier e Lushnjë të marra së bashku.

I tillë është në vija të përgjithshme programi i zhvillimit ekonomik-shoqëror të vendit gjatë pesë-vjeçarit të pestë dhe që shtrohet për aprovim para Kongresit. Këtu do të ndalemi në disa nga çështjet më kryesore të politikës ekonomike të Partisë për pesë vjetët e ardhshëm.

Të përmirësohet struktura e prodhimit industrial dhe të fuqizohet baza materialo-teknike e tij

Gjatë periudhës së ndërtimit socialist vendi ynë ka përshkuar një rrugë industrializimi më shumë se 20-vjeçare. Sukseset e arritura i kanë dhënë fund prapambetjes ekonomike shekullore të trashëguar nga e kaluara. Perspektiva të reja të ndritura janë çelur për zhvillimin e kësaj dege jetike për ekonominë tonë. Shqipëria e dikurshme thellësisht agrare sot ecën e sigurt përpara në rrugën e kthimit në një vend industrialo-bujqësor. Potenciali prodhues ekzistues i industrisë dhe bashkë me të klasa punëtore e kuadrot teknike përbëjnë atë bazë, e cila lejon tani që industrializimi i vendit të ngrihet në një stad të ri.

Duke ndjekur me vazhdimësi politikën e drejtë të krijimit të një industrie të fuqishme kombëtare pikësynimi kryesor i industrializimit në këtë periudhë do të jetë shfrytëzimi më i gjerë dhe me efekt ekonomik më të madh i pasurive natyrore të vendit, me qëllim që të arrihet plotësimi i nevojave më të mëdha e më të ngutshme të riprodhimit të zgjeruar. Në përputhje me këtë orientim do të vazhdojnë të zhvillohen një-

kohësisht, në përpjesëtimet e duhura sipas nevojave e mundësive, industria e rëndë dhe e lehtë, nxjerrëse e përpunuese, të harmonizuar kurdoherë me zhvillimin sidomos të bujqësisë dhe të degëve të tjera të ekonomisë.

Për zbatimin në jetë me etapa të këtij orientimi të përgjithshëm si detyrë kryesore e industrializimit tonë mbetet zgjerimi dhe përmirësimi i strukturës së prodhimit industrial. Është pikërisht për këtë arsye që gjatë pesëvjeçarit të pestë industrializimi do të vazhdojë në rrugën e zhvillimit të degëve ekzistuese dhe të krijimit të degëve të reja të industrisë së rëndë përpunuese.

Me rëndësi të jashtëzakonshme për tërë ekonominë tonë është ndërtimi për të parën herë i metalurgjisë së zezë. Kombinati metalurgjik që do të ngrihet në Elbasan është një vepër gjigante, e cila do të fuqizojë pavarësinë e vetëveprimin e ekonomisë sonë, do të sigurojë në vend lëndën e parë të domosdoshme për zhvillimin e industrisë mekanike dhe për kalimin në të ardhmen në atë të prodhimit të makinave, do të forcojë shumë bazën materiale të ndërtimeve.

Në zhvillimin kompleks të industrisë edhe në këtë pesëvjeçar prioriteti do t'u jepet degëve të industrisë nxjerrëse të mineraleve dhe të lëndëve djegëse. Kjo bëhet me qëllim që të zgjerohet baza e lëndës së parë për metalurgjinë dhe për industrinë kimike, që të shtohet eksportimi i mineraleve dhe të forcohet baza energjetike aq shumë e nevojshme për vetë industrinë dhe gjithë ekonominë popullore. Prandaj është e nevojshme që organet e Partisë, të shtetit dhe të ekono-

misë, punëtorët, teknikët dhe specialistët e këtij fronti jetik për çështjen e industrializimit të vënë tërë forcat e aftësitë për realizimin dhe tejkalimin e tyre.

Për të realizuar me sukses planin në degët e industrisë nxjerrëse, duhet që mjetet dhe forcat kryesore të përqendrohen në radhë të parë në minierat ekzistuese, duke siguruar prej tyre shumicën dërrmuese të shtesës së prodhimit. Arritja e këtij objektiivi kërkon që në këto miniera të rriten rezervat e njohura dhe të intensifikohet shfrytëzimi i tyre racional.

Garantimi i realizimit të detyrave për nxjerrjen e mineraleve dhe të lëndëve djegëse varet shumë edhe nga roli i posaçëm që ka luajtur dhe luan gjeologjia për zhvillimin e industrisë nxjerrëse. Ajo duhet të sigurojë nevojat gjithnjë më të mëdha për lëndë të parë të industrisë përpunuese për sot dhe për një perspektivë të gjatë e të qëndrueshme. Për këtë arsye zgjerimi i njohjes së pasurive të nëntokës që sot shfrytëzohen, zbulimi e përvetësimi i pasurive të reja të çmueshme, ngritja e rezervave të zbuluara në kategori industriale, si edhe shfrytëzimi racional i teknikës ekzistuese të konsiderohen ndër detyrat më të rëndësishme të punonjësve të gjeologjisë. Realizimi i planit të shpim-kërkimeve të mos shihet kurrë si një qëllim në vetvete, por të vlerësohet kurdoherë me sasinë e rezervave të gjendura për mineralet që nxirren ose që zbulohen për herë të parë.

Si edhe në të kaluarën, një kujdes i madh do t'i kushtohet shtimit të prodhimit të energjisë elektrike. Industria elektrike duhet t'i paraprijë industrisë dhe gjithë degëve të tjera të ekonomisë. Prandaj ritmet e

zhvillimit të saj duhet të jenë më të larta se ritmet e shtimit të prodhimit të përgjithshëm industrial. Eca në këtë rrugë diktohet nga nevoja për të ngritur shkallën e pajimit energjetik të punës, si kusht i domosdoshëm për të zbatuar teknikën e re, për të lehtësuar punën dhe për të rritur rendimentin e saj në të gjitha degët e ekonomisë. Për këtë qëllim është parashikuar që në vitin 1975 prodhimi i energjisë elektrike të arrijë në mbi 2 miliardë kilovat-orë, domethënë të jetë mbi 2 herë më i madh se në vitin 1970. Me këtë sasi përballohen nevojat korente të ekonomisë dhe të popullsisë.

Për fuqizimin e bazës teknike të vetë industrisë dhe të degëve të tjera të ekonomisë një rol të posaçëm duhet të luajë industria mekanike. Detyra e saj e parë ka qenë dhe mbetet sigurimi i gatishmërisë teknike, i shfrytëzimit pa ndërprerje dhe me rendiment të lartë të makinave dhe pajisjeve që ka ekonomia. Si anë tjetër, po aq e rëndësishme dhe shumë e ngutshme e detyrës kryesore të industrisë mekanike, mbetet që ajo të përmirësojë shumë dhe pa pushim cilësinë e prodhimit të pjesëve të ndërrimit. Pa e ngritur në një shkallë më të lartë cilësinë, sado që të shtohet prodhimi i kësaj dege, ekonomia jonë nuk do të lehtësohet nga importimi i pjesëve të ndërrimit.

Në kushtet kur do të prodhohen në vend çelique, prokate dhe gizë, kur shtrohet çështja që përparimit tekniko-shkencor t'i jepet një hov i mëtejshëm, për këtë degë të industrisë çeliet një perspektivë e re e madhe. Ajo nuk mund të kufizohet më vetëm me prodhimin e pjesëve të ndërrimit, por ka ardhur koha që

t'i futet më me guxim edhe prodhimet të makinave. Kjo është bërë një nevojë e ngutshme për ekonominë tonë, që duhet zgjidhur hap pas hapi, por me vendosmëri, sipas mundësive të reja që do të krijohen. Në këtë çështje kaq të rëndësishme, por edhe të ndërlikuar, të fillohet, në radhë të parë, nga ato makina mekanizma e pajisje, që i nevojiten më shumë ekonomisë sonë, që mund të prodhohen në seri dhe që lehtësojnë barrën e importit.

Që industria mekanike t'u përgjigjet më mirë detyrave të sotme e në perspektivë është e nevojshme të thellohet më tej specializimi dhe kooperimi i prodhimit. Për këtë problem është hartuar në Plenumin e 3-të të KQ një program i hollësishëm dhe me afat të gjatë veprimi. Mirëpo gjer më sot vihet re se në zbatimin e këtij programi ka javashllëk, se shumë detyra që rrjedhin prej tij kanë mbetur ende të pazgjidhura. Në të ardhmen është e nevojshme që për t'i dhënë rrugë këtij problemi kaq të rëndësishëm të bëhet një punë e bashkërenduar më mirë në shkallë rrethi e kombëtare, duke kapërcyer çdo interes të ngushtë lokal ose dikasterial, çdo pengesë burokratike.

Zhvillimi dhe struktura e industrisë janë lidhur kurdoherë ngushtë me nevojat e degëve të tjera të ekonomisë. Kjo ka bërë të mundur që të ruhet ekuilibri midis zhvillimit të industrisë dhe të bujqësisë, që industria t'i shërbejë drejtpërdrejt edhe zhvillimit të bujqësisë. Duke ecur në këtë rrugë të drejtë e të sprovuar, në pesëvjeçarin e pestë zhvillimi i industrisë do të lidhet më shumë me nevojat që ka bujqësia për

intensifikimin dhe modernizimin e mëtejshëm të saj. Për këtë qëllim është parashikuar që prodhimi i plehrave kimike të rritet, gjithashtu të zgjerohet shumë prodhimi i lëndëve kimike për të luftuar dëmtuesit dhe sëmundjet e bimëve. Krahas me këtë do të dyfishohet prodhimi i pjesëve të ndërrimit për traktorë, do të përvetësohet prodhimi i makinerive e i pajisjeve të reja bujqësore, do të merren masa për të përgatitur më shumë ushqime të përpunuara për blegtorinë, për të shtuar mjetet e transportit dhe materiale të tjera të riprodhimit që i duhen bujqësisë. Të tëra këto do të jenë një kontribut i madh që do të japë industria jonë socialiste për zhvillimin e bujqësisë.

Megjithëse forcat njerëzore, burimet financiare dhe mjetet materiale kryesore do të përdoren edhe gjatë këtij pesëvjeçari për zhvillimin e industrisë së rëndë, nuk do të lejohet asnjë teprim që të rëndojë ose të ngadalësojë zhvillimin e industrisë së lehtë. Në vendosjen e përpjesëtimeve midis industrisë së rëndë e të lehtë prioriteti do t'i jepet industrisë së rëndë. Ky ka qenë dhe mbetet një parim i drejtë e i patundur për zhvillimin e industrisë sonë.

Sot te ne nuk përputhet kurdoherë dhe sa duhet prodhimi i mallrave të përdorimit të gjerë me fuqinë blerëse të popullsisë. Për zgjidhjen e kësaj kontradikte në pesëvjeçarit e pestë prodhimi i mallrave të përdorimit të gjerë do të shtohet me ritme më të shpejta sesa do të shtohen të ardhurat në para të popullsisë. Rritja e parashikuar për mallrat e përdorimit të gjerë lypset të konsiderohet si një cak i domosdoshëm për

t'u realizuar, por jo si një detyrë maksimale. Prandaj organet e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë të nxitin e të përkrahin me të gjitha mënyrat çdo iniciativë të punonjësve për të shtuar prodhimin e mallrave të përdorimit të gjerë, sidomos duke krijuar reparte e linja të reja për ato mallra, për të cilat ka kërkesa më shumë. Në këtë drejtim duhet të japin një ndihmë më të madhe se gjer më sot edhe kolektivat e ndërmarrjeve të industrisë së rëndë.

Prodhuesit e mallrave të përdorimit të gjerë të marrin të gjitha masat e nevojshme që plani të realizohet medoemos sipas asortimenteve dhe cilësisë dhe t'u afrohen sa më shumë kërkesave reale të tregut. Tani është arritur një gjendje e tillë, kur, pa dobësuar për asnjë çast luftën për sasi, duhen bërë përpjekje të pareshtura që mallrat e prodhuara për popullin të jenë më të larmishme, më të forta, më të bukura e të lira.

Këto detyra të industrisë së lehtë kanë një kuptim dhe rëndësi të madhe, sa ekonomike, aq edhe politike. Ato kanë të bëjnë me plotësimin e nevojave të përditshme të popullit. Nga sasia, struktura dhe cilësia e mallrave varet përballimi i kërkesave të punonjësve, qarkullimi i shpejtë i parasë dhe rritja e fuqisë blerëse të saj.

Komiteti Qendror i Partisë ka besim të plotë se punonjësit e kësaj dege do të vënë tërë forcat dhe dijet e tyre për të bërë një kthesë rrënjësore në këtë drejtim, për të realizuar me sukses dhe për të tejkaluar detyrat që u shtron plani i pestë pesëvjeçar.

Drejtimit kryesore të politikës së Partisë për zhvillimin e bujqësisë

Megjithëse Shqipëria socialiste synon të kthet në një vend industrial, bujqësia mbetet përsëri dega bazë e ekonomisë sonë. Mbështetja fort e ekonomisë kombëtare si në industrinë ashtu edhe në bujqësinë është një parim i përhershëm, një kusht i domosdoshëm për zhvillimin e saj të shpejtë e të harmonizuar, për të rritur shkallën e vetëveprimit të saj. Për këtë arsye politika e Partisë për zhvillimin e bujqësisë ka synuar kurdoherë që thellimi i revolucionit socialist në fshat të çojë me domosdoshmëri edhe në zhvillimin e forcave prodhuese në bujqësi.

Dhe në të vërtetë çdo vit që kalon dëshmon gjithnjë e më shumë për drejtësinë e politikës marksiste-leniniste të Partisë edhe në këtë fushë. Rendi socialist në fshatin tonë tashmë ka fituar plotësisht dhe e gjithë jeta e fshatarësisë, marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore, mentaliteti e psikologjia e saj transformohen pa pushim mbi baza revolucionare. Bujqësia ka bërë përparime të mëdha e të gjithanshme.

Suksese të mëtejshme shënoi bujqësia jonë edhe gjatë pesëvjeçarit të katërt. Në vitin 1970 prodhimi i përgjithshëm bujqësor ishte 33 për qind më i madh se më 1965. Megjithëkëtë, për shkak të një vargu faktorësh subjektivë e objektivë, bujqësia nuk i plotësoi sipas parashikimeve të gjitha detyrat e caktuara në pesëvjeçarin e katërt. Kjo krijoi edhe vështirësi e shpërpjesëtime të përkohshme për ekonominë popullore, që

duhet të kapërcehen patjetër për të mos penguar zhvillimin e përgjithshëm e të shpejtë të vendit.

Gjatë pesëvjeçarit të pestë kërkesat e popullsisë dhe të ekonomisë për prodhime bujqësore e blegtorale shtohen në përpjesëtime më të mëdha se në të kaluarën. Kjo shtron përpara bujqësisë nevojën e ngutshme të zhvillimit të vrullshëm të saj. Për këtë arsye bujqësia duhet parë si hallkë vendimtare për plotësimin me sukses të planit të pestë pesëvjeçar.

Objektivi kryesor, detyra themelore e bujqësisë edhe në pesëvjeçarin e pestë mbetet shtimi i prodhimit të drithërave të bukës. Për këtë qëllim është e domosdoshme të arrihet që prodhimi i drithit të bëhet sa më i qëndrueshëm dhe të shtohet me ritme të larta nga njëri vit në tjetrin. Në vitin 1975, në krahasim me vitin 1970, është parashikuar që prodhimi i drithërave të rritet 50-55 për qind. Me këtë shtim sigurohen kërkesat e popullsisë e të ekonomisë për drithë, përballohen në një shkallë më të madhe nevojat e blegtorisë për ushqime të koncentruara dhe shtohen më tej rezervat e sigurimit. Realizimi i kësaj detyre do të jetë një fitore e madhe.

Duke i përqendruar forcat dhe mjetet për shtimin e drithërave të bukës, jo më pak duhet të luftohet për të zhvilluar edhe degët e tjera të bujqësisë, bimët industriale e blegtorinë, perimet e frutikulturën. Në vitin 1975, në krahasim me vitin 1970, është parashikuar që prodhimi i bimëve industriale në tërësi të shtohet 80-85 për qind, nga i cili ai i lulediellit rreth 145 për qind. Përpjekje të mëdha do të bëhen edhe për zhvi-

Ilimin e blegtorisë, sidomos për të shtuar prodhimin e qumështit 68-72 për qind.

Ne flasim gjithnjë për të ndryshuar strukturën e ushqimit të popullit, për ta bërë atë më të shuman-shme e të pasur në përputhje me nevojat fiziologjike të njeriut. Për këtë duhet të shtohen prodhimi e rendimentet e të gjitha llojeve të perimeve dhe të frutave, duke synuar që punonjësit të sigurohen me to gjatë tërë vitit dhe në sasi të bollshme. Kështu jo vetëm do t'i jepen popullit më shumë prodhime me vlerë të madhe ushqyese, por do të shtohet edhe mundësia për të përdorur më shumë drithë në dobi të blegtorisë.

Për të plotësuar me sukses detyrat e mëdha që i shtohen përpara bujqësisë është e domosdoshme të vazhdojë kursi i drejtë për intensifikimin e mëtejshëm të saj. Për këtë qëllim gjatë pesëvjeçarit të pestë do të bëhen investime të mëdha e të gjithan-shme jo vetëm në fushë, por edhe në zonat malore. Qëllimi i tyre është që në bimët e arave dhe në blegtori të arrihen rendimente të tilla, të cilat të sigurojnë pjesën dërrmuese të shtesës që do të shënojë prodhimi i përgjithshëm bujqësor gjatë pesëvjeçarit.

Zhvillimi dhe intensifikimi i bujqësisë, natyrisht, do të jetë më i madh në fushat. Në të njëjtën kohë do të shtohen kujdesi dhe përpjekjet për ta çuar përpara zhvillimin e bujqësisë edhe në zonat malore. Krahas intensifikimit të bujqësisë, hapja e tokave të reja është për ne një detyrë e përhershme, gjersa të ketë sipërfaqe që mund të punohet dhe të prodhojë.

Përvetësimi i tokave të reja dhe intensifikimi i

bujqësisë kërkojnë në radhë të parë që të rritet shkalla e mekanizimit të punimeve. Pa mekanizim kompleks të punës kudo, në fushë dhe në malësi, bujqësia jonë nuk mund të arrijë ato rezultate që kërkojnë prej saj dhe kooperativistët nuk mund të revolucionarizojnë plotësisht konceptet e tyre për punën dhe bujqësinë moderne. Për këtë qëllim ne duhet të përqijemi për një mekanizim sa më të madh të punimeve në bujqësi.

Bujqësia jonë do të ketë gjithçka i duhet për të plotësuar detyrat e mëdha që shtrohen para saj në këtë pesëvjeçar. Baza materialo-teknike e prodhimit bujqësor po zgjerohet dita-ditës. Rendi kooperativist është forcuar, duke kaluar nga prona e vogël dhe e kufizuar e grupit në kooperativat e zmadhuara. Fshatarësia jonë është patriote dhe revolucionare, e gatshme kurdoherë të luftojë e të punojë për socializmin, për të vënë në jetë mësimet e Partisë. Punonjësit dhe kuadrot e bujqësisë kanë fituar një përvojë të madhe shumëvjeçare.

Por diskutimi i gjerë popullor i Letrës së Komitetit Qendror të Partisë «Mbi nevojën e një kthese rrënjësore në përsosjen e organizimit dhe forcimin e disiplinës së punës në bujqësi»¹ nxori në shesh se, me gjithë fitoret e arritura, në veprimtarinë e kooperativave dhe të ndërmarrjeve bujqësore ekzistojnë të meta të rëndësishme. Këto të meta e kanë burimin në pikëpamjet e vjetra konservatore për bujqësinë, në

1. Shih: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. VI, Tiranë, 1973, f. 9.

konceptet, format dhe praktikat e vjetra të drejtimit, të organizimit të punës dhe të planifikimit. Diskutimi tregoi, gjithashtu, në mënyrë bindëse se ekzistojnë të gjitha mundësitë dhe kushtet e favorshme shoqërore-ekonomike që ndërmarrjet bujqësore shtetërore dhe kooperativat të kthehen brenda një kohe të shkurtër në ekonomi të zhvilluara dhe me rendimente të larta.

Që të zgjidhen detyrat e ngritjes së kooperativave në nivelin e ekonomive moderne është e domosdoshme të thellohet më tej specializimi i tyre. Bujqësia jonë nuk mund të zhvillohet me sukses me ekonomi «mozaike» që të mbjellin të gjitha llojet e bimëve ose të rritin të gjitha llojet e bagëtisë. Asaj nuk i duhet as një specializim i ngushtë e i njëanshëm. Ajo ka nevojë për një specializim të tillë, i cili të lejojë një përqendrim e shpërndarje më të drejtë e më racionale të bimëve bujqësore e të blegtorisë, si midis rretheve të ndryshme, ashtu edhe midis kooperativave të të njëjtit rreth. Qëllimi i fundit i specializimit në bujqësinë tonë është rritja e prodhimit bujqësor e blegtoral në përpjesëtime gjithnjë më të mëdha, duke ulur vazhdimisht shpenzimet shoqërore për njësi prodhimi. Specializimi për çdo kooperativë bujqësore ose rreth duhet të argumentohet ekonomikisht, të përgatitet nga të gjitha anët dhe të mos bëhet i shpejtuar.

Në kuadrin e specializimit një vëmendje të posaçme kërkon zgjidhja e problemeve që lidhen me modernizimin e blegtorisë. Prandaj shtrohet detyra që, brenda një kohe relativisht të shkurtër, në strukturën e blegtorisë sonë të shënohet një kthesë rrënjësore. Nga ana tjetër, përpjekjet për të intensifikuar blegto-

rinë lypset të shoqërohen medoemos me sigurimin e një baze reale ushqimore, si për lopët e sektorit socialist, ashtu edhe për ato të oborrit kooperativist. Që të ecet me ritme më të shpejta në këtë drejtim është e nevojshme të luftohen pikëpamjet konservatore, të cilat janë rrënjosur te fshatarësia jonë në kushtet e mbisundimit për një kohë shumë të gjatë të blegtorisë ekstensive.

Detyrat komplekse që shtrohen për t'i kthyer kooperativat në ekonomi të rendimenteve të larta nuk mund të realizohen me sukses pa e vënë tërë bujqësinë tonë mbi baza të gjera e më të thella shkencore. Ka ardhur koha që puna e kooperativistëve të bashkohet më mirë e më ngushtë me dijet shkencore, që në të gjitha degët e bujqësisë të futet më shumë shkenca dhe të forcohet disiplina agroteknike për zbatimin e përpiktë e në kohën e duhur të kërkesave të saj në çdo proces të prodhimit. Prandaj Partia u bën thirrje punëtorëve, kooperativistëve, specialistëve dhe gjithë drejtuesve të ekonomive bujqësore që të studiojnë me ngulm dhe të zbatojnë me zell rezultatet e shkencës dhe të teknikës bujqësore.

Zgjidhja e detyrave të shumta e të mëdha në bujqësi kërkon medoemos që tërë forcat e afta në fshat, burra e gra, të rinj e të reja, të hidhen në punë gjatë gjithë vitit, dimër e verë, në kohë të keqe e të mirë. Është e domosdoshme, gjithashtu, që në çdo punë të bujqësisë të punohet me disiplinë të fortë socialiste dhe të mos lejohet të humbasë asnjë orë pune. Kudo dhe kurdoherë të punohet me norma pune të përcaktuara mirë, të mbështetura në kritere shkencore dhe

në përvojën e përparuar, të cilat të shërbejnë për matjen e punës po me aq saktësi, sa edhe në industri.

Në stadin e sotëm të zhvillimit bujqësia jonë ka shumë nevojë për kuadro e specialistë, për mjeshtër të kualifikuar, që ta duan bujqësinë me gjithë shpirt dhe të jenë të lidhur ngushtë me fshatin. Për plotësimin sa më shpejt të këtyre nevojave do të merren masa që në të gjithë vendin të ngrihet një rrjet i gjerë shkollash tekniko-profesionale, ku të mësojnë të rinjtë dhe të rejat e fshatit, kooperativistët, të gjithë ata që duan t'i vënë forcat dhe mendjen e tyre në shërbim të bujqësisë. Krahas me këtë është e nevojshme që për punonjësit e bujqësisë të gjenden forma më të përshtatshme shpërblimi, të cilat të nxitin shtimin e prodhimit dhe punën me cilësi të mirë, të marrin parasysh përvojën në punë, shkallën e kualifikimit, vështirësitë e punës etj.

Në etapën e sotme të ndërtimit të plotë të socializmit ne duhet të forcojmë edhe më shumë punën për ngushtimin e dallimeve esenciale midis fshatit dhe qytetit. Rezultatet e arritura në këtë drejtim janë të mëdha, por ato duhet të çohen përpara duke u mbështetur fort në gjendjen reale të fshatit tonë, në karakteristikat e veçanta kombëtare dhe mundësitë e ekonomisë.

Komiteti Qendror i Partisë ka arritur në përfundimin që kooperativat e sotme të forta ekonomikisht të zonës fushore të kthehen në kooperativa të një tipi më të lartë, duke marrë pjesë në to drejtpërdrejt shteti me mjete shoqërore të pakthyeshme. Këto kooperativa do të vazhdojnë të jenë pronë kolektive e grupit, ndër-

sa shteti do t'i ndihmojë për të bërë investime kapitale në përpjesëtime më të mëdha nga sa u lejon fondi i tyre i pandashëm dhe do t'u sigurojë më shumë mjete teknike, kafshë të racës, farëra të zgjedhura etj. Ndonëse në këto kooperativa do të ruhen marrëdhëniet e shpërndarjes që rrjedhin nga prona e grupit dhe do të mbetet oborri kooperativist, format e drejtimit, të organizimit të punës e të shpërblimit do të jenë të përafërta ose të njëjlojta me ato të ndërmarrjeve bujqësore shtetërore. Kooperativistët do të shpërblehen sipas punës me pagë të garantuar në bazë të të ardhurave të kooperativës.

Krijimi i kooperativave të tipit më të lartë ka një rëndësi të madhe teorike dhe praktike, për të tashmen dhe të ardhmen e bujqësisë sonë socialiste, të ndërtimit të plotë të socializmit në fshat. Qëllimi më i afërt i kësaj mase është që në fushat më pjellore të vendit tonë bujqësia të zhvillohet me ritme më të shpejta dhe të sigurohet në mënyrë të stabilizuar shtimi i prodhimit të atyre prodhimeve bujqësore e blegtorale, për të cilat ka nevojë më shumë ekonomia popullore. Nga ana tjetër, këto kooperativa do të përfaqësojnë një shkallë më të lartë shoqërizimi të pronës së grupit në rrugën e afrimit të saj me pronën e të gjithë popullit. Jeta, praktika revolucionare e ndërtimit tonë socialist do të tregojnë pastaj fazat e tjera nëpër të cilat duhet kaluar në këtë proces, do të tregojnë masat që duhen marrë për të shuar dalngadalë ato dallime që ekzistojnë sot midis dy formave të pronës socialiste.

Përmirësimin e jetesës në fshat Partia e ka vlerësuar gjithnjë si një çështje parimore të dorës së parë

për forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë, për ngushtimin e dallimeve midis fshatit e qytetit, për ngritjen e mirëqenies së përgjithshme të popullit. Çdo qëndrim që nuk mban parasysh nevojat dhe interesat e fshatarësisë ajo e ka parë dhe e shikon si mbeturinë të heshtur në ndërgjegje të nënvlerësimit të fshatit, si një shfaqje të ideologjisë borgjeze.

Duke vazhduar me vendosmëri rrugën e drejtë marksiste-leniniste të lidhjeve ekonomike midis shtetit dhe kooperativave bujqësore, u hoq sistemi i grumbullimit të detyrueshëm të drithit dhe u kalua në grumbullimin e lirë me çmime të diferencuara për zonat mallore dhe fushore. Është vendosur, gjithashtu, që mallrat industriale, të cilat përdoren për riprodhim në bujqësi, t'u shiten kooperativave me të njëjtin çmim që u shiten edhe ndërmarrjeve shtetërore. Për të afruar kushtet e jetesës në fshat me ato të qytetit do të përmirësohet furnizimi i fshatit me artikuj industrialë e ushqimorë. Nevojat e fshatit në fushën e arsimit, të kulturës e të shëndetësisë do të përballohen më shumë se gjer më sot me fondet shoqërore. Një fitore e madhe e rendit tonë socialist është vendosja e sistemit të pensioneve për të gjithë kooperativistët me mjetet e shtetit dhe të vetë kooperativave. Kjo masë ka një rëndësi të madhe politike, ekonomike e shoqërore për fshatarësinë tonë punonjëse. Ajo përbën një hap tjetër përpara për përmirësimin e mirëqenies së punonjësve kooperativistë, për afrimin e kushteve të jetesës së fshatit me ato të qytetit dhe do të shërbejë si një nxitje e fuqishme për përparimin e bujqësisë e të fshatit tonë socialist.

Detyrat që i shtrohen bujqësisë në planin e pestë pesëvjeçar janë të mëdha e të vështira, por reale dhe frymëzuese. Ato synojnë që fushat, arat, livadhet, malet tona të kthehen në kopshte të lulëzuara, nga të cilat të marrim prodhime të bollshme, për ta bërë jetën e popullit më të pasur e më të begatshme. Ne duhet të shfrytëzojmë me dije e nikoqirllëk çdo gjë. Syrit, mendjes së mprehtë dhe dorës së palodhur të kooperativistit tonë nuk duhet t'u shpëtojë asgjë, që nga toka e deri te prodhimi, që nga kafshët e deri te bari, që nga bletët e deri te lulet.

Komiteti Qendror i Partisë ka bindje të plotë se detyrat që na vihen përpara do të kthehen në një program luftarak pune për fshatarësinë kooperativiste dhe për gjithë punonjësit e bujqësisë. Çështja e bujqësisë, e zhvillimit dhe e modernizimit të shpejtë të saj duhet të bëhet çdo ditë e më shumë çështje e të gjithë popullit, e të gjithë ekonomisë sonë kombëtare.

Të rritim efektivitetin e investimeve dhe të ndërtimeve kapitale

Vënia në jetë e programit madhështor për zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit gjatë pesëvjeçarit të pestë kërkon që të sigurohen mjetet përkatëse financiare e materiale për investimet dhe ndërtimet kapitale. Edhe në këtë pesëvjeçar shumica dërrmuese e këtyre mjeteve do të përballohen nga burimet e brendshme, duke ndjekur si kurdoherë kursin e drejtë revolucionar të mbështetjes në forcat e veta. Në këto rre-

thana një rëndësi e kuptim të veçantë merr rritja e efektivitetit ekonomik të këtyre investimeve, si edhe forcimi i regjimit të kursimit.

Në pesëvjeçarin e pestë, kundrejt pesëvjeçarit të katërt, është parashikuar që investimet kapitale të rriten 70-75 për qind. Vëllimi i investimeve në këtë pesëvjeçar do të jetë më i madh se investimet e kryera gjatë 21 vjetëve 1946-1966. Vetëm investimet për zhvillimin e industrisë janë afro 2,5 herë më të mëdha se në pesëvjeçarin e katërt dhe përfaqësojnë afër 66 për qind të investimeve të përgjithshme që do të përdoren për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës.

Këto janë investime të pashembullta për ekonominë tonë dhe dëshmojnë për fuqinë gjithnjë në rritje të saj. Përballimi i tyre nga ekonomia jonë është një sukses i madh. Në të njëjtën kohë ne jemi të vetëdijshëm se ato përbëjnë një barrë jo të vogël për nivelin e sotëm të të ardhurave kombëtare dhe kërkojnë një shtim të ndjeshëm të fondit të akumulimit, duke e rritur normën e tij 34-37 për qind. Mbajtja e normës së akumulimit në një nivel të tillë të lartë diktohet nga një varg faktorësh ekonomikë e politikë, të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët bëjnë të domosdoshëm realizimin brenda këtij pesëvjeçari të atij programi madhështor që është menduar për zhvillimin e ekonomisë dhe sidomos të industrisë, për të krijuar një ekonomi të fortë e të qëndrueshme, të aftë për vetëveprim, pavarësisht nga të papriturat që mund të ndodhin.

Me qëllim që me investimet e parashikuara të plotësohen sa më shumë nevojat e ekonomisë, na shtrohet detyra që për çdo vepër, fabrikë, repart, linjë të re ose

rikonstrukcion ato të planifikohen e të shpenzohen me shumë kursim, të luftohet çdo kërkesë mbi planin dhe të zbatohet një regjim i rreptë kursimi për lëndët e para, energjinë elektrike dhe materialet e tjera. Me këtë sy të shikohen të gjitha projektet që hartohen për ndërtime kapitale. Një kujdes shumë më i madh se gjer më sot për të kursyer mjete financiare e materiale u duhet kushtuar sidomos investimeve nën limit. Të merren të gjitha masat organizative, teknike dhe projektuese që veprat të ndërtohen në kohë dhe të vihen në shfrytëzim me faza, pa pritur përfundimin e tyre të plotë. Çdo zvarritje ose zgjatje e afatit të përfundimit bllokton mjetet dhe krijon pasoja të tjera të padëshirueshme.

Punonjësit e ndërtimit kanë në këtë pesëvjeçar një detyrë të madhe. Për realizimin e saj ata duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të futur në ndërtim më gjerësisht metodat industriale dhe për të shtuar mekanizimin e punimeve, nga më të thjeshtat e gjer te më të komplikuarat, sidomos të punimeve voluminoze, për të kursyer sa më shumë fuqinë punëtore. Organizimi i punës dhe disiplina teknike të ngrihen në një shkallë të tillë që kantieret dhe sheshet e ndërtimit të kthehen në sheshe montimi për të vënë në jetë parullën luftarake të Partisë «Të ndërtojmë më shpejt, më mirë dhe më lirë».

Përvoja ka treguar se efektiviteti i ndërtimeve kapitale nuk mund të rritet pa përmirësuar punën e projektimit. Me gjithë përmirësimet e bëra, duhen marrë masa që projektet të thjeshtohen, duke luftuar çdo prije për ndërtime të rënda dhe duke përhapur struktura

sa më të lehta ndërtimi. Një kujdes më i madh duhet t'u kushtohet edhe problemeve të arkitekturës, me qëllim që ajo të bëhet më tërheqëse dhe më e larmishme, që qytetet dhe fshatrat tona të ndërtohen më të bukura dhe sa më të përshtatshme për një jetesë të kulturuar të punonjësve.

Që të realizohet me sukses programi i madh i ndërtimeve kapitale një rol të veçantë duhet të luajë industria e materialeve të ndërtimit, zhvillimi dhe modernizimi i së cilës janë bazë e domosdoshme për të përballuar të gjithë frontin e ndërtimeve në qytet dhe në fshat. Ka ardhur koha që kjo degë e industrisë të zgjerohet shumë prodhimin e parafabrikateve në përgjithësi dhe atyre më të lehta në veçanti, të fillojë prodhimin e atyre materialeve që mund të zëvendësojnë ato deficitare.

Për të përballuar vëllimin e madh të lëvizjes së produktit shoqëror dhe të ndërtimeve kapitale të pesëvjeçarit të pestë një zhvillim të mëtejshëm do të marrin llojet e ndryshme të transportit. Në mënyrë të veçantë do të intensifikohet transporti hekurudhor, i cili për kushtet tona paraqit leverdinë më të madhe ekonomike. Për këtë qëllim do të zgjerohet rrjeti hekurudhor dhe do të lidhen me linja hekurudhore objektet industriale më të rëndësishme. Si përfundim, transporti hekurudhor do të shtohet rreth 3 herë më shumë dhe do të përfaqësojë rreth 41 për qind të vëllimit të përgjithshëm të transportit të planifikuar për sistemin e Ministrisë së Komunikacionit. Në përputhje me kushtet territoriale të vendit do të zgjerohen më tej edhe transporti automobilistik e detar.

Të rritet pa ndërprerje e me ritme më të larta rendimenti i punës

Me përpjesëtimet e sotme që ka marrë prodhimi shoqëror te ne, ruajtja e ritmeve të larta të zhvillimit të tij nuk mund të mendohet pa rritur në të njëjtën kohë edhe rendimentin e punës. Prandaj për zhvillimin e ekonomisë, si deri më sot, do të ndiqet kursi që harmonizon shtimin e numrit të punëtorëve të rinj me rritjen e rendimentit të punës shoqërore. Kjo mbetet një çështje parimore për riprodhimin e zgjeruar socialist. Në analizë të fundit kjo ka të bëjë me zgjidhjen e drejtë të problemeve të tilla ekonomiko-shoqërore, siç janë: rritja e pagës nominale të punonjësve, ulja e kostos dhe shtimi i akumulimit, mënjanimi i tërheqjes me shumicë të fuqisë punëtore nga fshati në qytet etj. Për këtë arsye rritja e pandërprerë e rendimentit të punës duhet të bëhet gjithnjë më shumë rruga kryesore nëpër të cilën të ecë zhvillimi i industrisë dhe i gjithë ekonomisë. Mendja e punëtorëve dhe e kooperativistëve, e specialistëve dhe e kuadrove të punojë kurdoherë e pa pushim për të rritur rendimentin, për të kursyer dhe për të lehtësuar sa më shumë punën e njeriut.

Sukseset e arritura gjer më sot për rritjen e rendimentit të punës në ekonominë tonë s'janë të pakta. Por gjatë pesëvjeçarit të katërt pati edhe boshllëqe, detyra e caktuar në plan për rritjen e rendimentit nuk u plotësua. Si pasojë e ritmeve të ngadalta të rritjes së rendimentit të punës, shtimi i prodhimit industrial gja-

të pesëvjeçarit të katërt u arrit pothuajse tërësisht nga shtimi i numrit të punëtorëve edhe mbi kufirin e parashikuar. Kjo shkaktoi shpërpjesëtime midis rritjes së prodhimit dhe të fondit të pagave. Natyrisht ky duhet parë si një fenomen i përkohshëm në ekonominë tonë, por që duhet kapërcyer me doemos dhe sa më parë.

Mundësitë dhe rezervat për rritjen me ritme më të shpejta të rendimentit në ekonominë tonë janë të mëdha, të shumanshme e të pashtershme. Duke u nisur nga gjendja reale e tyre, shtrohet detyra që në pesëvjeçarin e pestë nga rritja e rendimentit të punës të sigurohen rreth 70 për qind të shtesës së prodhimit shoqëror, — 56 për qind të shtesës së prodhimit industrial, — 90 për qind të shtesës së vëllimit të ndërtimeve dhe rreth 80 për qind e rritjes së prodhimit bujqësor do të sigurohet nga rritja e rendimenteve të prodhimeve bujqësore e blegtorale. Kjo është një nga detyrat më të rëndësishme të planit, e cila duhet të vlerësohet shumë seriozisht nga organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë, nga klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe nga të gjithë kuadrot e specialistët.

Për të plotësuar detyrën lidhur me rritjen e përdërprerë e me ritme më të larta të rendimentit të punës, përpjekjet kryesore duhet të përqendrohen në thellimin e revolucionit tekniko-shkencor. Përparimi teknik tashmë është vënë te ne në rendin e ditës dhe është shndërruar në një lëvizje të gjerë të masave punonjëse, në qytet dhe në fshat. Detyra jonë është që këtë lëvizje ta zgjerojmë e ta çojmë vazhdimisht përpara, duke luftuar me vendosmëri konceptet konservatore, praktikat burokratike dhe çdo gjë tjetër që pen-

gon përparimin e saj. Fjala është që përparimi tekniko-shkencor të përfshijë të gjithë ata faktorë materialë nga të cilët varet rritja e rendimentit të punës shoqërore dhe, në radhë të parë, mjetet e punës, makineritë, pajisjet dhe instrumentet, me qëllim që të kalohet kudo e sa më parë në një mekanizim më të lartë e kompleks të punës dhe në një teknologji e organizim më të përsosur të prodhimit.

Që nga Plenumi i 3-të i KQ të Partisë¹ dhe në luftën për të vënë në jetë vendimet e tij janë arritur rezultate të mira për mekanizimin e proceseve të punës. Megjithatë për zgjidhjen e këtij problemi është ecur shumë ngadalë dhe jemi akoma larg atyre objektivave që caktoi edhe Plenumi i 9-të i KQ të Partisë². Prandaj është e domosdoshme që organet e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë ta marrin mirë në dorë këtë punë dhe në çdo ministri, ndërmarrje, uzinë, fabrikë, minierë, kooperativë dhe fermë bujqësore të hartohen plane të veçanta për mekanizim, sepse puna e thjeshtë e krahut zë akoma një vend të madh në të gjithë sektorët e ekonomisë.

Sjellja nga jashtë e makinave dhe e mekanizmave me rendiment të lartë do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm për mekanizimin, por kjo do të bëhet kurdoherë brenda mundësive të ekonomisë. Çështja shtrohet që mekanizimi në front të gjerë të bëhet me rezervat dhe mundësitë e mëdha të brendshme, me

1. Shih: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. V, Tiranë, 1974, f. 349.

2. Po aty, f. 647.

fondet që disponohen dhe me njerëzit tanë të mrekullueshëm, duke filluar nga mekanizmat e vegjël e të thjeshtë masivë dhe gjer te modernizimi i fabrikave e i reparteve të tëra, siç po veprohet në mjaft raste.

Një rezervë e brendshme e madhe për rritjen e rendimentit të punës ekziston edhe në përsosjen e vazhdueshme të proceseve teknologjike. Për të përmirësuar ose ndryshuar në mënyrë rrënjësore teknologjinë ekzistuese një barrë e madhe u bie byrove teknike, teknologjike, të konstruksionit dhe laboratorëve, të cilat duhet të bëjnë një punë të programuar e me perspektivë. Në këtë drejtim është e nevojshme të zgjerohet më shumë ndihma dhe pjesëmarrja e gjithanshme edhe e institucioneve kërkimore-shkencore, projektuese e mësimore.

Por që çdo ndryshim në faktorët materialë të rendimentit të japë një efekt sa më të madh, është e domosdoshme që ai të shoqërohet edhe me rritjen e rolit të njeriut punonjës si faktori vendimtar i prodhimit. Mundësitë e rezervat tona më imediate për rritjen e rendimentit të punës duhen kërkuar e gjetur në përmirësimin e shfrytëzimit të kohës së punës, në vendosjen e një disipline të shëndoshë proletare në punë, duke rritur e forcuar si kontrollin shtetëror ashtu edhe kontrollin e drejtpërdrejtë të klasës punëtore.

Për ta vënë në rrugë të mbarë këtë problem organet e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë të marrin të gjitha masat konkrete organizative që nevojiten për të forcuar organizimin e madh e të vogël socialist të punës. Një shembull të madh organizimi të përsosur pune dhe disipline të ndërgegjeshme revolucionare na

dhanë aksionet me goditje të përqendruar. Përvojën e tyre të mirë ta shtrijmë në çdo ndërmarrje e kooperative, në repart e brigadë, në çdo vend pune.

Zhvillimi i vrullshëm i ekonomisë, futja me shpejtësi e teknikës dhe e teknologjisë së përparuar, zbatimimi i metodave të reja dhe më efektive në punë e në prodhim, shtrojnë gjithnjë e më shumë kërkesa të reja ndaj normimit dhe shpërblimit të punës. Duke i ballafaquar këto kërkesa me gjendjen e sotme në këtë fushë shtrohen disa çështje të ngutshme për t'i zgjidhur. Në radhë të parë, shtrohet çështja që normat e punës të shtrihen kudo dhe të pakësohet në minimum numri i punonjësve që punojnë pa norma. Të merren, gjithashtu, të gjitha masat e nevojshme për t'i dhënë rrugë dhe për të zgjidhur sa më parë normimin teknik të punës mbi baza shkencore. Për sa i përket shpërblimit të punës, është e nevojshme të përsosen më tej format e tij, duke mbajtur parasysh kurdoherë parimin socialist «sipas punës», diferencimin sipas kualifikimit dhe nxitjen për të rritur rendimentin e prodhimit pa dëmtuar cilësinë.

Detyrat e mëdha që shtrohen për rritjen me ritme më të shpejta të rendimentit të punës nuk mund të zgjidhen me sukses pa ngritur kualifikimin, nivelin tekniko-profesional të klasës punëtore, të fshatarësisë dhe të të gjitha masave punonjëse. Këtë e kërkon, nga ana tjetër, edhe vetë rritja e nivelit të bazës materialo-teknike të prodhimit, vënia në shfrytëzim e makinave dhe e uzinave moderne, të cilat pa fuqi punëtore të kualifikuar nuk mund të japin rezultatet e dëshiruara në sasi dhe në cilësi.

Të ngrihet në mënyrë të vazhdueshme mirëqenia e popullit

I gjithë zhvillimi ynë ekonomik, politik dhe shoqëror ka pasur kurdoherë si pikësynim që t'u shërbejë interesave të popullit, t'i sigurojë atij një jetë të lumtur e të begatshme, të lirë, demokratike e të pavarur. Prandaj edhe gjatë pesëvjeçarit të pestë do të bëhen të gjitha përpjekjet që kërkesat gjithnjë më të mëdha materiale e kulturore të popullit të plotësohen sa më shumë e sa më mirë.

Partia do të ndjekë edhe në të ardhmen politikën e saj të drejtë për ngritjen e mirëqenies: të arrihet një mirëqenie e përgjithshme për tërë popullin; të plotësohen nevojat më të ngutshme e më masive ekonomike, kulturore e shoqërore të punonjësve; të ngushtohen me vazhdimësi dallimet në nivelin e të ardhurave e të jetesës midis qytetit dhe fshatit, midis grupeve të ndryshme të popullsisë.

Zbatimi në jetë i kësaj politike gjatë pesëvjeçarit të pestë mishërohet në shtimin e të ardhurave kombëtare dhe në përdorimin përfundimtar të tyre. Në vitin 1975, në krahasim me vitin 1970, të ardhurat kombëtare do të shtohen 55-60 për qind, fondi i konsumit — 50-55 për qind, të ardhurat reale për frymë të popullsisë do të rriten 14-17 për qind, ndërsa vëllimi i qarkullimit të mallrave të tregtisë me pakicë do të shtohet 36-39 për qind.

Fondi i konsumit shoqëror është parashikuar në një nivel të tillë, i cili lejon të përballohen nevojat

e punonjësve për arsim, kulturë, shëndetësi, sigurime shoqërore dhe disa kërkesa të tjera sociale të tyre. Në vitin 1975, shpenzimet e shtetit për këto nevoja për frymë të popullsisë do të rriten rreth 60 për qind kundrejt vitit 1970, dhe do të përfaqësojnë 22-27 për qind të fondit të përgjithshëm të konsumit. Këto janë shpenzime shumë të mëdha, që shprehin jo vetëm fuqinë tonë ekonomike gjithnjë në rritje, por edhe epërsinë e rendit tonë shoqëror socialist mbi atë kapitalist e revizionist. Vetëm rendi socialist i çliron plotësisht punonjësit nga ai shqetësim i vazhdueshëm dhe nga ato vështirësi që ata hasin për plotësimin e nevojave të arsimit, të kulturës e të shëndetësisë në vendet kapitaliste.

Në luftën për të plotësuar sa më mirë detyrat në fushën e ngritjes së mirëqenies një rol i madh i takon tregtisë sonë socialiste. E gjithë veprimtaria e tregtisë duhet t'i nënshtrohet drejtpërdrejt furnizimit të rregullt e pa ndërprerje të popullit me mallrat që atij i nevojiten dhe që i kërkon më shumë, shpërndarjes dhe çuarjes në kohën e duhur te konsumatori të çdo gjëje që prodhon industria e bujqësia dhe që plotëson nevojat e popullit, shërbimit të punonjësve në mënyrë sa më të kulturuar. Tregtia ka si mision ekonomik-shoqëror të luajë një rol më të madh dhe të ushtrojë një ndikim më aktiv se gjer më sot për të nxitur prodhimin e mallrave me cilësi të mirë, për të zgjeruar asortimentet e tyre dhe për të parandaluar prodhimin e atyre mallrave që janë me cilësi të dobët ose që nuk tërhiqen nga populli. Prandaj organet e tregtisë dhe gjithë punonjësit e saj duhet të studiojnë në mënyrë

të vazhdueshme dhe të njohin me hollësi kërkesat e konsumatorëve, ndryshimet që këto pësojnë në kohë, sipas grupeve të punonjësve dhe krahinave.

Ka një rëndësi të madhe parimore e praktike që të krijohet një kuptim i drejtë e i gjithanshëm për jetesën e punonjësve, për lehtësimin e saj, për shërbimet që duhet t'u kryhen punonjësve në mënyrë kolektive dhe individuale. Në këtë kuadër duhet të bëhen përpjekje më shumë se gjer më sot për të zgjeruar dhe përmirësuar ushqimin social e shërbimet komunale, si në qytet ashtu edhe në fshat, për të krijuar kushte më të mira për kalimin e kulturuar të kohës së lirë etj. Mbi të gjitha, të merren masa për të ngritur më lart kulturën e shërbimeve, për të përmirësuar cilësinë dhe për të shkurtuar sa më shumë kohën e kryerjes së tyre.

Përpjekje të veçanta duhet të bëhen për të përmirësuar furnizimin e fshatrave me ujë të pijshëm dhe lidhjen e tyre me rrugë automobilistike. Për këto dy probleme të ngrihet në këmbë e gjithë fshatarësia jonë kooperativiste, shteti të ndihmojë shumë më tepër se gjer më sot me mjete financiare e materiale, me kua-dro specialistësh e teknikësh, ndërsa qyteti të japë tërë ndihmën e tij të mundshme. Përvoja e madhe revolucionare, që u grumbullua gjatë aksionit popullor për elektrifikimin e gjithë fshatrave të përdoret e të pasurohet më tej edhe për zgjidhjen e problemeve të lart-përmendura.

Kthesa që ka filluar në ndërtimin e shtëpive të banimit do të bëhet edhe më e dukshme në këtë pesë-veçar. Me investimet shoqërore dhe me kontributin e

drejtpërdrejtë e vullnetar të punonjësve gjatë pesëvjeçarit të pestë vetëm në qytete e qendra pune do të ndërtohen rreth 40 mijë apartamente të reja, nga rreth 29 mijë që u ndërtuan në pesëvjeçarin e katërt. Kjo sasi do të ndihmojë shumë për të normalizuar në përgjithësi problemin e strehimit për punonjësit e qytetit. Kjo është një ndërmarrje e guximshme që dëshmon për epërsinë e rendit socialist mbi atë kapitalist, për kujdesin e Partisë sonë për të zgjidhur këtë problem të mprehtë për jetesën e punonjësve.

Jeta e lumtur, gëzimi i njeriut tonë nuk mund të kuptohen dhe të arrihen pa ruajtjen e shëndetit të tij. Prandaj kujdesi për shëndetin e popullit, për zgjatjen e jetës së tij ka qenë dhe mbetet pjesë e pandarë e politikës së Partisë për ngritjen e mirëqenies. Objekt i një vëmendjeje të veçantë për tërë shoqërinë tonë, për Partinë dhe për shtetin do të jetë kujdesi i gjithanshëm për të mbrojtur shëndetin e nënës dhe të fëmijës, duke përmirësuar rrënjësisht, sidomos në fshat, trajtimin ushqimor dhe shëndetësor të tyre.

Të përmirësojmë më tej drejtimin e ekonomisë

Stadi i arritur në ndërtimin socialist dhe detyrat e reja që kemi përpara kërkojnë që të përmirësohet më tej organizimi dhe drejtimi i ekonomisë, duke e vënë në baza më të shëndosha shkencore. Ndonëse ky problem nuk është as i ri, as edhe i panjohur, ai përbën sot një ndër hallkat themelore nga duhet të kapemi

për t'i dhënë një shtytje të re të fuqishme gjithë zhvillimit të ekonomisë.

Përpjekjet tona për të përmirësuar drejtimin e ekonomisë nisen nga parimet e shëndosha marksiste-leniniste, ato janë krejt në kundërshtim me konceptet dhe praktikat revizioniste. Përvoja e derisotme tregon se i ashtuquajtimi vetadministrim punëtor apo reformat ekonomike të revizionistëve hrushovianë çojnë në degjenerimin kapitalist të ekonomisë socialiste, në rivendosjen e kapitalizmit. Pasojat negative të koncepteve revizioniste për organizimin dhe drejtimin e ekonomisë sot i njeh mirë e gjithë bota. Ato janë një demaskim i pakontestueshëm publik për teorinë dhe praktikën revizioniste të zhvillimit ekonomiko-shoqëror.

Shumë çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e drejtimit të ekonomisë u shtruan drejt në Plenumin e 10-të të Komitetit Qendror¹ dhe tani mjaft prej tyre po vihen me sukses në jetë. Për të mënjeluar shfaqjet e theksuara të një centralizmi të tepruar e të tutelës burokratike u zgjeruan kompetencat e bazës. Komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë dhe ndërmarrjeve ekonomike u janë dhënë më shumë kompetenca financiare dhe materiale, si për hartimin, ashtu edhe për zbatimin e planit. Drejtimi i ekonomisë është bërë më i zhdërvjellët dhe më vetëveprues, është rritur përgjegjësia e bazës, e ndërmarrjes. Megjithatë, për forcimin e mëtejshëm të tij është e domosdoshme që jo

1. Shih: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. V, Tiranë, 1974, f. 663.

vetëm të zbatohen në frymë krijuese masat e marra, por edhe të gjenden rrugë e forma të reja, më të mira, më efikase.

Cilat janë problemet kryesore që duhet të tërheqin më shumë vëmendjen tonë për një drejtim më të mirë të ekonomisë në stadin e ri të zhvillimit të saj? Të tilla janë: ngritja e nivelit të punës drejtuese të organeve ekonomike, duke e vënë mbi baza më të shëndosha shkencore; përsosja e metodave të drejtimit të prodhimit në bazë të njohjes më të thellë të ligjeve ekonomike; zgjerimi i mëtejshëm i pjesëmarrjes së masave punonjëse në administrimin e ekonomisë.

Përmirësimi i mëtejshëm i drejtimit të ekonomisë kërkon, në radhë të parë, të forcohet në nivelin e detyrave të reja roli organizues i shtetit. Detyrat e organeve shtetërore të drejtimit të ekonomisë sot janë shtuar, janë bërë më të ndërlikuara e më komplekse. Çdo reduktim i tyre, siç ndodh nganjëherë, në drejtimin vetëm të çështjeve operative është i njëanshëm dhe me pasoja të dëmshme.

Organet e shtetit dhe kuadrot e tyre nuk mund ta drejtojnë ekonominë me efikasitet pa u marrë më shumë dhe më mirë me zbërthimin e politikës ekonomike të Partisë, të direktivave e të orientimeve të saj, pa kërkuar e gjetur rrugët më të drejta dhe më të efektshme për t'i vënë ato në jetë. Është e domosdoshme që në punën e tyre ato të kujdesen më shumë se gjer më sot për studimin e problemeve themelore, të ngutshme e të perspektivës, që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit.

Përmirësimi i drejtimit të ekonomisë ka shtruar

si një çështje të mprehtë aktuale forcimin e karakterit shkencor të planifikimit. Zgjidhja e mjaft detyrave ekonomiko-shoqërore në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste kërkon më shumë se një plan pesëvjeçar. Prandaj, krahas planifikimit pesëvjeçar, të kalohet edhe në hartimin e planeve prognozë me afat më të gjatë. Pikësynimi kryesor i këtyre planeve lypset të jetë parashikimi i drejtimeve kryesore të zhvillimit të ekonomisë në tërësi, i degëve të veçanta të saj, i llojeve më të rëndësishme të prodhimeve industriale e bujqësore, i drejtimeve të zhvillimit të arsimit, të kulturës, të shkencës etj.

Që planet e zhvillimit të ekonomisë, qofshin këto pesëvjeçare ose me afat më të gjatë, të jenë sa më reale, duhet që nevojat shoqërore të llogariten sa më mirë, duke u mbështetur në vrojtime, studime, analiza dhe përgjithësime sistematike, të hollësishme e të gjithanshme, në variante të ndryshme dhe në përlllogaritje teknike, ekonomike dhe financiare. E gjithë kjo të ketë si qëllim që t'u japë mundësi organeve të Partisë dhe të shtetit të zgjedhin variantin më optimal.

Forcimi i karakterit shkencor të planifikimit dikton nevojën që të përdoren më gjerësisht se deri më sot metodat e njohura analitike të krahasimit, normimit dhe balancimit. Krahas këtyre të bëhen përpjekje që në praktikën e planifikimit dhe të përlllogaritjeve ekonomike të futet edhe përdorimi i metodave të reja që mbështeten në matematikën, programimin dhe teknikën moderne llogaritëse.

Niveli i sotëm i zhvillimit të ndërmarrjeve ekonomike shtron detyrën që metodat e drejtimit adminis-

trativ të prodhimit të kombinohen më mirë edhe me metodat e drejtimit ekonomik. Kjo kërkon medoemos që të njihen dhe të zbatohen në mënyrë të vetëdijshme ligjet ekonomike objektive të socializmit. Rritja e përpjesëtimeve të prodhimit në çdo degë të ekonomisë, nevojat për t'i kthyer më shumë sytë nga cilësia, për të zbatuar teknikën e re e teknologjinë moderne, po nxjerrin kohë pas kohe në shesh të meta e boshllëqe në drejtimin e prodhimit. Për të kapërcyer këto të meta rëndësi ka që të rritet iniciativa dhe vetëveprimi i bazës, të forcohet hozrashoti, përdorimi i levave ekonomike dhe disiplina e planit e financiare. Llogaritja e shpenzimeve dhe e leverdisë, krahasimi i punës së harxhuar me rezultatet e arritura të bëhen kriter i domosdoshëm për të vlerësuar caktimin e detyrave me plan dhe realizimin e tyre. Nevoja për të kombinuar më shumë drejtimin administrativ të prodhimit me metodat ekonomike, ka shtruar problemin që të përputhet më mirë me këtë kombinim edhe vetë struktura e organizimit dhe e drejtimit të ndërmarrjes.

Përmirësimi i drejtimit të ekonomisë sonë nuk mund as të kuptohet, as edhe të arrihet pa pjesëmarrjen e masave, të klasës punëtore, të kooperativistëve dhe të gjithë punonjësve, pa kontrollin e tyre mbi veprimtarinë e organeve ekonomike. Kjo nuk është një çështje dëshire, por rrjedhim logjik i asaj vije të masave që zbatohet me besnikëri te ne, është garanci që të shtohet prodhimi dhe baza shoqërore e socializmit të mos ndryshojë kurrë natyrën. Në të ardhmen duhet të nxitet më shumë, t'i lihet fushë më e lirë pjesëmarrjes, kontrollit, iniciativës e mendimit krijues të ma-

save për të hartuar e zbatuar planet ekonomike, për të caktuar e vendosur treguesit tekniko-ekonomikë të planit, rendimentin, normat e punës e të harxhimit të materialeve, për të forcuar disiplinën dhe rregullin në punë, për të rritur prodhimin e përmirësuar cilësinë që nga gjërat më të vogla dhe deri te më të mëdhatë.

Rritja e pjesëmarrjes dhe e kontrollit të masave, sidomos të klasës punëtore, duhet të shkojnë kurdoherë paralel me shtimin e përgjegjësisë morale e financiare të secilit për fatet e prodhimit, të ndërmarrjes dhe të kooperativës, me zbatimin e përpiktë dhe në kohë të vendimeve e direktivave të organeve shtetërore, të disiplinës dhe të rregullit në punë.

Shokë,

Detyrat e planit të pestë pesëvjeçar janë një hap tjetër i madh e i rëndësishëm në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Ato janë të guximshme, por të menduara thellë, të peshuara mirë e drejt. Ne jemi optimistë dhe të sigurt se ato do të realizohen me sukses.

Kur shikon realizimet e tejkalimet e shifrave të planit të katërt pesëvjeçar, që edhe ato ishin shumë të ngjeshura e të guximshme, nuk mund të mos mahni-tesh me forcën kolosale që kanë Partia dhe populli ynë.

Ne po i hyjmë realizimit të planit të ri pesëvjeçar me një entuziazëm të madh, i cili e ka bazën e tij në sigurinë që na japin rezultatet madhështore të së kaluarës dhe në frymëzimin që na ngjall perspektiva jonë e ndritur.

Heroizmi, pjekuria dhe dituria e njerëzve tanë, të pleksur me optimizmin dhe entuziazmin realist të tyre, do t'i shndërrojnë edhe shifrat e këtij pesëvjeçari në të mira materiale për popullin, atdheun e socializmin, do të bëjnë çudira të reja e më të mëdha që do ta ngrenë edhe më lart emrin e Partisë sonë heroike dhe lavdinë e Shqipërisë socialiste.

III

FORCIMI I DIKTATURËS SË PROLETARIATIT DHE ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I DEMOKRACISË SOCIALISTE

Shokë dhe shoqe,

Problem kyç i revolucionit ka qenë dhe do të mbetet gjer në arritjen e fitores së komunizmit problemi i pushtetit shtetëror, i diktaturës së proletariatit. Në çfarëdo fushe që të zhvillohet lufta klasore midis dy rrugëve, socialiste e kapitaliste, në fushën politike ose ekonomike, ideologjike, kulturore ose ushtarake, ajo është, në fund të fundit, luftë për çështjen nëse do të ruhet e do të forcohet diktatura e proletariatit, apo kjo do të degjenerojë e do të përmbysset, siç ndodhi në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera. Këtë mësim jetik të marksizëm-leninizmit, të vërtetuar plotësisht nga jeta, Partia jonë e ka kurdoherë parasysht.

Vitet që kanë kaluar nga Kongresi i 5-të i Partisë janë vite të një lufte të gjithanshme të Partisë, të klasës punëtore e të mbarë popullit për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit socialist edhe në fushën politike. Kjo ka qenë luftë për ruajtjen, forcimin dhe përsosjen e diktaturës së proletariatit, për spastrimin e saj

nga gjurmët e ndikimet e shoqërisë së vjetër, për shmangien e rrezikut të degjenerimit revizionist-borgjez të saj, për rritjen e rolit aktiv të shtetit në të gjitha sferat e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Tehu i gjithë kësaj lufte është drejtuar kundër burokratizmit, për zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë socialiste. Rezultatet e saj shihen e ndihen në të gjitha fushat e jetës së vendit. Janë forcuar e zgjeruar më tej lidhjet e pushtetit me masat. Aparati shtetëror është çliruar nga mjaft barrë burokratike dhe është bërë më i zhdërvjellët e më operativ, u është afruar më tepër bazës dhe problemeve të saj. Si kurrë ndonjëherë është rritur iniciativa e vetëveprimi i masave, interesimi dhe pjesëmarrja aktive e tyre në çështjet shtetërore. Kontrolli i punonjësve, në radhë të parë i klasës punëtore, mbi aparatet e drejtuesit, mbi tërë jetën e vendit, është bërë një mjet i fuqishëm dhe efektiv për përmirësimin e punëve në të gjitha drejtimet. Në një raport më të drejtë janë vendosur marrëdhëniet midis kuadrove dhe masave, gjë që ka forcuar më tej besimin reciprok dhe bashkëpunimin e ngushtë midis tyre. Në të gjitha nivelet është gjallëruar mjaft puna e organeve të zgjedhura të pushtetit, të cilat gjithnjë më mirë i ushtrojnë kompetencat dhe kontrollin e tyre mbi organet ekzekutive e administratat. Është krijuar kështu një kuptim më i drejtë për këto çështje dhe u është dhënë një goditje e fortë koncepteve e praktikave burokratike, intelektualiste e teknokratike.

Përvoja jonë dhe veçanërisht ajo e grumbulluar në këto vitet e fundit të një jete politike të gjallë e plot

origjinalitet, tregoi se në kushtet e një udhëheqjeje të drejtë nga ana e Partisë, diktatura e proletariatit mund t'u qëndrojë të gjitha provave dhe të kryejë me sukses misionin e saj historik.

Por ne jemi të ndërgjegjshëm se rezultatet e arritura në zbatimin e orientimeve dhe të masave që ka marrë Partia nuk i kanë zhdukur të gjitha rreziqet një herë e përgjithmonë. Lufta kundër burokratizmit dhe të gjitha shfaqjeve të tij, si një ndër shprehjet më të rëndësishme të luftës së klasave në kushtet e socializmit, mbetet një detyrë e përhershme e Partisë, e shtetit socialist dhe e gjithë punonjësve. Duhet thënë se në praktikë, në mjaft raste, nuk kuptohet me të gjithë seriozitetin kjo çështje. Këtu e ka burimin fakti që në luftën për zbatimin e orientimeve të Partisë jemi ndeshur e ndeshemi me koncepte frenuese, me konservatorizëm e rezistencë burokratike, jemi ndeshur e ndeshemi në formalizëm, gjë që tregon se nuk është kuptuar në tërë thellësinë e vet thelbi i shtrembërimeve burokratike dhe shpesh lufta kundër tyre thjeshtësohet e reduktohet në goditjen e disa shfaqjeve të pjesshme e anësore.

Prandaj organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit duhet ta kenë në qendër të vëmendjes luftën kundër burokratizmit, të forcojnë punën edukuese dhe të jenë në kërkim të vazhdueshëm të masave dhe të rrugëve që duhen zbatuar për ta çuar këtë luftë deri në fund, duke thyer me vendosmëri pengesat e prirjet frenuese në çdo kohë e formë që të paraqiten.

Kjo luftë është me rëndësi jetike për të ardhmen e diktaturës së proletariatit, sepse burokratizmi është

një e keqe e madhe dhe me rrënjë të thella. Ai, siç e tregoi edhe eksperiencia negative e Bashkimit Sovjetik dhe e disa vendeve të tjera, çon në shkëputjen e pushtetit nga masat e popullit, në vënien e organeve drejtuese e të kuadrove mbi masat e jashtë kontrollit të tyre, në venitjen e demokracisë socialiste, në krijimin e centralizmit burokratik, në degjenerimin e diktaturës së proletariatit.

Rruga e përgjithshme për forcimin e diktaturës së proletariatit, të tërë rendit socialist, është zhvillimi i demokracisë së masave. Pa demokraci socialiste nuk ka diktaturë të proletariatit, ashtu siç nuk mund të ketë demokraci të vërtetë për punonjësit pa diktaturë të proletariatit. Revizionistët hrushovianë, nën maskën e zgjerimit të demokracisë, likuiduan diktaturën e proletariatit dhe në vend të saj kanë vendosur diktaturën e tyre burokratike, si armë të sundimit të klasës së re borgjeze mbi masat punonjëse. E ashtuquajtura demokraci në vendet e sunduara nga revizionistët është, po ashtu si në vendet borgjeze klasike, një privilegj i pakicës shfrytëzuese dhe një mashtrim i paturpshëm për masat e popullit.

Tërheqja sa më e gjerë e masave në qeverisjen e vendit ka qenë dhe mbetet vija e patundur në tërë veprimtarinë e Partisë sonë të Punës e të shtetit tonë proletar për ndërtimin e socializmit. Këtë pjesëmarrje ne e konsiderojmë si drejtimin kryesor të thellimit të demokracisë socialiste në veprim, si kusht të domosdoshëm për të siguruar eksperiencën e masave të gjera punonjëse në ndërtimin e socializmit, për të shumëfishuar forcën e aparatit shtetëror të diktaturës së pro-

letariatit, për t'i bërë punonjësit gjithnjë më të ndër-gjegjshëm se ata vetë janë zotërit e plotfuqishëm të vendit, që duhet të thonë për çdo gjë fjalën e tyre vendimtare.

Armatoja e gjithë qytetarëve me një kuptim të tillë të rolit e të vendit të tyre në jetën politiko-shoqërore, përgatitja për ta luajtur si duhet këtë rol, ka kërkuar e kërkon, veç një pune të madhe edukuese e sqaruese nga ana e Partisë, shumë masa praktike për t'u krijuar kushtet e nevojshme punonjësve që të marrin pjesë sa më gjerë në ushtrimin e pushtetit, që marrja dhe zbatimi i vendimeve të vihet gjithnjë e më mirë nën gjykimin dhe kontrollin e drejtpërdrejtë të tyre.

Nga kjo pikëpamje zbatimi i metodës së konsultimit me masat, dëgjimi i zërit të tyre, mbështetja në to, që tashmë është bërë pjesë e pandarë e praktikës sonë, duhen zhvilluar e thelluar pa ndërprerje. Do të ishte gabim të binim në vetëkënaqësi dhe të mbeteshim në atë që është arritur. Është e domosdoshme të vazhdojmë akoma më me këmbëngulje përpjekjet tona për të thyer çdo pengesë që kufizon pjesëmarrjen efektive të masave në drejtimin e punëve të shoqërisë, që frenon iniciativën e tyre krijuese, të gjallërojmë e të pashurojmë më tej format e demokracisë, të rritim sidomos rolin e organizatave të masave si qendra të rëndësishme të organizimit të punonjësve, si tribuna të zërit dhe të vetëveprimit revolucionar të tyre.

Rëndësi të veçantë ka mbështetja e fuqishme te masat për verifikimin e drejtësisë së vendimeve në praktikën e gjallë të jetës. Verifikimi i vazhdueshëm,

rishikimi i pandërprerë kritik e autokritik i tërë punës dhe përvojës së mëparshme në të gjitha sferat e veprimtarisë, me qëllim që të ruhet e të zhvillohet ajo që qëndron mbi një bazë të shëndoshë, të ndryshohet ajo që nuk justifikohet nga praktika ose që është kapërcyer nga jeta, të gjenden rrugë e mënyra të reja për zgjidhjen e problemeve, kjo përbën një ligj të revolucionit socialist, që, siç thoshte Karl Marksi, është i pamposhtur, sepse kritikon vazhdimisht vetveten.

Kjo metodë është e papajtueshme me prirjet burokratike e konservatore për të fetishizuar çdo gjë që del nga aparatet, me skemat dhe praktikat e ngurosurat, që nuk u përgjigjen më detyrave e kushteve të reja, që nuk përputhen me idetë e mëdha revolucionarizuese të Partisë dhe bëhen pengesë për vënien e tyre në jetë. Kjo çështje duhet të na tërheqë seriozisht vëmendjen, sepse, siç na mëson Lenini, në këtë fushë shfaqen me një forcë të veçantë dhe ruhen për një kohë të gjatë kontradiktat midis së resë e së vjetrës në zhvillimin e revolucionit.

«Në të gjithë fushën e marrëdhënieve shoqërore, ekonomike dhe politike, — shkruante ai, — ne jemi «tmerrësisht» revolucionarë. Por në fushën e hierarkisë, të respektimit të formave e të procedurës administrative «revolucionizmi ynë» zëvendësohet pothuaj gjithnjë nga rutina më e mykur. Këtu mund të vihet re shpeshherë një fenomen shumë interesant: në jetën shoqërore kërcimi më i madh përpara shoqëro-

het me frikën më të përbindshme nga ndryshimet më të vogla»¹.

Organizatat e Partisë, kuadrot e gjithë punonjësit duhet të jenë kurdoherë revolucionarë dialektikë, ta shohin në sy realitetin në zhvillimin e tij të pandërprerë, të mos kanunizojnë asgjë, të mos kenë frikë nga ndryshimet, por me guxim të kapërcejnë çdo gjë të vjetruar në konceptet, metodat, ligjet, format e organizimit e të drejtimit.

Kontrolli i masave nga poshtë, si çështje me rëndësi parimore dhe një ndër aspektet kryesore të zhvillimit të demokracisë socialiste, ka qenë vazhdimisht në qendër të vëmendjes së Partisë. Por thellimi dhe përsosja e tij në forma sa më të përshtatshme mbetet një detyrë gjithnjë aktuale e dorës së parë.

Vendimtar këtu është kontrolli i drejtpërdrejtë i klasës punëtore. Kontrolli punëtor nga poshtë është një domosdoshmëri e një parim bazë i jetës shoqërore gjatë tërë periudhës historike të socializmit. Ky kontroll, që kryhet nën udhëheqjen e Partisë, është një ndër shprehjet konkrete të rolit udhëheqës të klasës punëtore dhe të demokracisë proletare në veprim. Ai përbën një armë të mprehtë në luftën kundër burokratizmit dhe ndikimeve të huaja në jetën shoqërore e në ndërgjegjen e punonjësve, një formë shumë të efektshme të edukimit proletar të vetë klasës punëtore, është një nxitje e fuqishme për të çuar përpara ndërti-

1. V. I. Lenin, Vepra të zgjedhura, vëll. III, Tiranë, 1979, f. 902.

min socialist. Në kontrollin punëtor shohim një ndër garancitë themelore për të shmangur rrezikun e revizionizmit e të kthimit prapa në kapitalizëm.

Praktika jonë mbi kontrollin e drejtpërdrejtë të klasës punëtore po vërtetohet në jetë. Në periudhën pas Kongresit të 5-të të Partisë zbatimi i kontrollit punëtor ka çuar në një rritje e gjallërim të mëtejshëm të veprimtarisë revolucionare të klasës punëtore në të gjitha fushat. Është rritur në mënyrë të dukshme roli i masave punëtore në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, është shtuar shumë interesimi dhe ndjenja e tyre e përgjegjësisë për punët e ndërmarrjes dhe përgjithësisht për jetën e vendit, është forcuar fryma kritike e autokritike ndaj shfaqjeve të huaja.

Kontrolli punëtor është një proces i gjatë lufte kundër prirjeve të ndryshme burokratike, që përpiqen ta kufizojnë, ta frenojnë e ta vënë nën tutelë, kundër frikës, dyshimeve, ekuivoqeve në zbatimin e tij. Përsosja e mëtejshme e tij kërkon që ai të kuptohet nga kushdo si një e drejtë e pamohueshme e klasës punëtore për të ruajtur e forcuar diktaturën e proletariatit dhe rendin socialist. Ai është kontroll i klasës punëtore mbi tërë veprimtarinë e organeve dhe të organizatave të Partisë, të atyre shtetërore dhe ekonomike, të aparateve e të kuadrove, që shtrihen mbi çdo gjë e mbi këdo, si në qytet ashtu edhe në fshat. Kontrolli punëtor nuk është një kontroll administrativ për çështje të vogla, korente e të sipërfaqshme. Ai është shprehje e opinionit dhe e qëndrimit të klasës punëtore për problemet kyç, politike, ekonomike e shoqërore.

Organizatave të Partisë, bashkimet profesionale, vetë

punëtorët duhet të jenë në kërkim të vazhdueshëm për të gjallëruar format ekzistuese dhe për të gjetur forma të reja, të zhdërvjellëta dhe efikase në ushtrimin e kontrollit punëtor. Kornizat dhe format e ngurosurat e gjytojnë dhe e paralizojnë atë.

Qëllimi i kontrollit punëtor është jo vetëm të vrojtojë e të konstatojë, por t'i zgjidhë e t'i çojë gjer në fund çështjet që ngre. Është detyrë e të gjithëve, e organizatave të Partisë, e organeve të pushtetit dhe e organizatave të masave të luftojnë me këmbëngulje që të zbatohen vërejtjet dhe propozimet që bëjnë punëtorët, të zgjidhen me shpejtësi e me seriozitetin më të madh problemet që dalin nga kontrolli punëtor. Kjo është e domosdoshme për vetë zhvillimin e mendimit, të veprimit revolucionar e të pjesëmarrjes aktive të punëtorëve në punët e shtetit, për inkurajimin e iniciativës së tyre dhe për vetë zhvillimin e mëtejshëm të kontrollit punëtor.

Për klasën punëtore ka rëndësi të veçantë që ajo të kuptojë vetë, në radhë të parë, jo vetëm rolin e saj si forca prodhuese vendimtare, por edhe rolin e saj politik si klasa pararojë në shoqërinë tonë. Me luftën, qëndrimet dhe shembullin e saj ajo tërheq pas vetes gjithë masën tjetër të popullsisë, fut tek të gjithë frymën, disiplinën dhe kulturën proletare në punë e në jetë. Për të qëndruar në lartësinë e këtij misioni është e domosdoshme që kontrolli punëtor të zhvillohet edhe si vetëkontroll i klasës punëtore, si kritikë e autokritikë në radhët e saj, si një luftë këmbëngulëse kundër shfaqjeve të vetëkënaqësisë, indiferentizmit e të tërheqjes pas interesit të ngushtë personal, kundër çdo fry-

me të pajtimit me fenomenet që pengojnë ecjen tonë përpara.

Kontrolli punëtor është pjesë përbërëse dhe e pandarë e kontrollit të masave mbi veprimtarinë e organeve të pushtetit, organizatave ekonomike e kulturoro-arsimore të qytetit e të fshatit. Ushtrimi i këtij kontrolli është një e drejtë dhe detyrë për të gjithë: për fshatarin në kooperativë, për studentin në shkollë, për intelektualin në sferën e veprimtarisë së tij, për çdo qytetar në tërë jetën shoqërore.

Me qëllim që kontrollit të masave t'i hapet horizont i gjerë e t'i krijohen kushte sa më të përshtatshme, është e nevojshme që punonjësit të informohen vazhdimisht për veprimtarinë e organizmave dhe të institucioneve shtetërore e shoqërore. Kontrolli i masave bëhet i mundshëm e lehtësohet sa më shumë luftohet kundër prirjeve për forma të mbyllura të punës së aparateve e organeve shtetërore e shoqërore, sa më shumë i jepet publicitet veprimtarisë së tyre, e cila duhet të jetë sa më e hapët dhe lehtësisht e kontrollueshme nga punonjësit. Njohja gjithnjë më e mirë e masave të gjera të punonjësve me mekanizmat e jetës shoqërore socialiste, me ligjet e shtetit, ballafaqimi dhe dhënia llogari para masave, si metodë e përhershme e funksionimit të gjithë sistemit tonë të diktaturës së proletariatit, përbëjnë, gjithashtu, kushte të domosdoshme për ushtrimin e kontrollit të masave. Një rol më aktiv në këtë drejtim duhet të luajë edhe shtypi, i cili ka për detyrë t'u bëjë të njohura më mirë masave gjendjen e problemet, të forcojë kritikën, të bëhet në një shkallë më të theksuar tribunë e rrahjes

së gjallë të mendimeve, e pasqyrimit dhe e përgjithësimit të thellë të përvojës së masave në ndërtimin socialist.

Në luftën kundër burokratizmit dhe për forcimin e diktaturës së proletariatit rëndësi të dorës së parë kanë raportet midis kuadrove dhe masave. Eksperiencia negative e vendeve revizioniste tregon se kur midis kuadrove e masave vendosen marrëdhënie jo të drejta, kur kuadrot shkëputen nga masat, nga jeta dhe lufta e tyre, kur ata nuk i nënshtrohen kontrollit të masave, kur kuadrove u jepen privilegje e favorizime të jashtëligjshme, ata burokratizohen e degjenerohen, marrëdhëniet e tyre me masat shndërrohen në marrëdhënie sundimi e nënshttrimi.

Partia dhe pushteti ynë popullor, të ndriçuar nga mësimet e marksizëm-leninizmit, sidomos në periudhën pas Kongresit të 5-të, kanë marrë një varg masash rrënjësore politike, ideologjike dhe ekonomike për përmirësimin e marrëdhënieve midis kuadrove dhe masave, me qëllim që kuadrot të mbeten kurdoherë revolucionarë konsekuentë e shërbëtorë të devotshëm të popullit. U vu në zbatim qarkullimi sistematik i kuadrove nga postet drejtuese në bazë e nga administratat në prodhim dhe anasjelltas. Tani rreth 56 për qind e kuadrove kryesorë të aparateve qendrore e lokale dhe 50 për qind e të gjithë kuadrove të aparateve e të administratave në funksionet aktuale kanë një stazh më pak se 5 vjet. U zbatua me kritere më të shëndosha pjesëmarrja e kuadrove dhe e gjithë njerëzve të punës mendore në punën fizike. Në të njëjtën kohë, u bënë rregullime në pagat e kuadrove, për të

mos lejuar shpërpjesëtime në nivelin e tyre të jetesës në krahasim me masat punonjëse. Përpjekjet tona kanë synuar, gjithashtu, që përgatitja ideopolitike, arsimore-kulturore e tekniko-profesionale e kuadrove të bëhet jo e shkëputur nga ngritja e pandërprerë e nivelit të gjithanshëm të shtresave të gjera punonjëse. Këto masa, krahas punës së gjerë edukuese që zhvillon Partia, shërbejnë për të luftuar në kuadrot shfaqjet e burokratizmit e të karrierizmit, për të forcuar e thelluar lidhjet e tyre me punëtorët e fshatarët, për të luftuar e çrrënjësuar ndikimet e koncepteve intelektualiste të nënvlerësimit e të mospërfilljes së masave, për t'i mbyllur shtigjet gjallërimit të ndjenjës së rrezikshme të mendjemadhësisë, subjektivizmit etj.

Për Partinë tonë ka qenë dhe mbetet një preokupacion i vazhdueshëm problemi që të gjithë kuadrot të rriten e të kaliten si revolucionarë, të mendojnë e të punojnë si të tillë deri në fund të jetës së tyre. Socializmi nuk ka nevojë për burokratë e teknokratë që t'i besojnë vetëm «gjenisë» së tyre, teknikës, fuqisë së dekretit, por për kuadro që të shkrihen e të jetojnë me masat, të mendojnë e të ndiejnë njëlloj si klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste. Në vijën e Partisë, në veprën madhështore dhe në botën shpirtërore të klasës punëtore e të kooperativistëve, kuadrot do të gjejnë kurdoherë forcë e frymëzim të vazhdueshëm.

Që ta çojmë më tej përvojën e fituar në marrëdhëniet midis kuadrove dhe masave është e nevojshme të luftohet kundër çdo pozite subjektiviste, dikasteriale e lokaliste, si dhe kundër qëndrimeve mikroborgjeze nga

vetë disa kuadro, në mënyrë që qarkullimi dhe puna drejtpërdrejt në prodhim të kuptohen si një masë me rëndësi edukuese e idcologjike dhe jo si një qëllim në vetvete, të kuptohen si një masë për revolucionarizimin e vazhdueshëm të vetë kuadrove dhe të organeve e të aparateve të ndryshme.

Partia i kushton një vëmendje të veçantë parimit që kuadrot, të çdo hallke e niveli qofshin, të jenë në vartësi të dyfishtë: si prej organeve të Partisë e të shtetit proletar nga lart, ashtu edhe nga poshtë drejtpërdrejt prej masave punonjëse. Duke iu përmbajtur këtij parimi, është e nevojshme që në të ardhmen të luftojmë çdo prirje për fetishizimin e nomenklaturave dhe punën e mbyllur, në mënyrë që zëri, mendimi dhe vlerësimi i masave për kuadrot e veprimtarinë e tyre të dëgjohen gjithnjë e më shumë.

Për thellimin e mëtejshëm të demokracisë dhe rritjen e rolit të masave në periudhën midis dy kongreseve një kujdes i veçantë u është kushtuar forcimit e përmirësimit të punës së organeve të zgjedhura të pushtetit popullor. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm luajtën zgjedhjet e fundit për Kuvendin Popullor dhe për këshillat popullorë, që në një shkallë të konsiderueshme u përtëritën me njerëz të rinj, revolucionarë e të aftë, të lidhur ngushtë me masat.

Me gjithë rezultatet e arritura, na mbetet akoma shumë për të bërë që këshillat popullorë të çdo shkalle, si përfaqësues të drejtpërdrejtë të popullit punonjës në pushtet, të kryejnë funksionet që u janë besuar, të mënjanojnë çdo shfaqje të formalizmit në punën e vet, të mos lejojnë kurrfarë spostimi të rolit

të tyre nga organet ekzekutive, administratat ose organizatat ekonomike. Të mos lejojmë asnjë qëndrim mospërfillës nga kushdo qoftë ndaj përfaqësuesve të zgjedhur të popullit dhe problemeve që ngrenë ata. Fjala e deputetit ose e këshilltarit duhet të dëgjohet me vëmendje e respekt.

Përsosja e mëtejshme e punës së organeve ekzekutive është e lidhur me luftën e ashpër kundër shfaqjeve të burokratizmit, të teknokratizmit e të praktikizmit të cekët në stilin dhe metodën e veprimtarisë së tyre, me forcimin e vazhdueshëm të lidhjeve me masat. Të mos harrojmë për asnjë çast se e keqja e burokratizmit zë vend në radhë të parë e mbi të gjitha në organet ekzekutive e në aparatet administrative. Vëgjilënca e organizatave të Partisë, e vetë kuadrove që punojnë këtu dhe e masave punonjëse është një armë e mprehtë për të luftuar me sukses e që në embrion çdo prirje e shtrembërim burokratik.

Masat që janë marrë kohët e fundit për një shpërndarje më të drejtë të kompetencave kanë çliruar organet e qendrës nga ngarkesa të tepërta dhe nga një përqendrim i panevojshëm i shumë punëve në duart e tyre. Në mënyrë të veçantë kjo ka rritur përgjegjësinë dhe iniciativën e pushtetit në bazë.

Duke marrë parasysh zhvillimin e hovshëm në gjerësi e në thellësi të ekonomisë e të kulturës, shtimin dhe ngritjen e vazhdueshme të nivelit të kuadrove, rritjen e pjesëmarrjes së masave në tërë jetën shoqërore dhe ekonomike, do të ishin anakronike dhe të dëmshme tendencat për të kodifikuar çdo gjë nga lart, për tutelë mbi organet më të ulëta. Centralizmi proletar në

vendin tonë qëndron mbi baza të patundura, sepse mbështetet në vijën e vetme marksiste-leniniste të Partisë, në ligjet unike që rregullojnë të gjitha marrëdhëniet shoqërore e shtetërore, në planin unik të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës socialiste, në përdorimin e centralizuar të mjeteve financiare nëpërmjet buxhetit të shtetit, në politikën unike të çmimeve, në sistemin unik të centralizuar të pagave, në monopolin e shtetit mbi tregtinë e jashtme etj. Prandaj nuk ka vend për asnjë druajtje se mos me zhvillimin e iniciativës e të vetëveprimit të bazës, me zgjerimin e kompetencave të saj, cenohet centralizmi.

Shokë,

Ndërtimi i socializmit në vendin tonë bëhet në kushtet e rrethimit imperialisto-revizionist. Prandaj mbrojtjen e atdheut, të lirisë e të pavarësisë kombëtare, pa të cilën nuk ka as pushtet popullor e as socializëm, Partia jonë gjithnjë e ka konsideruar dhe e konsideron si detyrë të saj të lartë e të përhershme. Në qoftë se Shqipëria e vogël ka qëndruar dhe qëndron e fortë dhe e patundur si shkëmb graniti, kjo para së gjithash, ka ndodhur sepse armiqtë e njohin mirë unitetin, forcën dhe vendosmërinë e popullit tonë për të mbrojtur gjer në fund fitoret e revolucionit, për t'i bërë ballë me sukses çdo rreziku.

Përgatitja për mbrojtjen e atdheut është një detyrë e përhershme dhe e vazhdueshme që bëhet si në kohë të mira. ashtu edhe të këqija, pavarësisht nga ngjarjet që ndodhin në botë. Mbrojtjen e vendit ne

e mbështetim jo në koniunkturat politike ndërkombëtare por kryesisht në faktorin e brendshëm, që e konsiderojmë si vendimtarin, e mbështetim në forcën, heroizmin dhe qëndresën e hekurt të popullit, të udhëhequr me guxim nga Partia e Punës, në gatishmërinë luftarake të vendit për të përballuar çdo situatë e agresor.

Për të kryer me sukses këtë detyrë të lartë historike, i tërë populli, i madh e i vogël, i bashkuar si një trup i vetëm rreth Partisë, duhet të ngrihet në një nivel të lartë ideopolitik dhe të kuptojë qartë vijën e Partisë, taktikat dhe strategjinë e saj, t'i zbatojë ato në jetë me ndërgjegje e disiplinë të çeliktë, me një patriotizëm të zjarrtë në çdo moment e në çdo rrethanë, pa marrë parasysh asnjë sakrificë.

Atdheu dhe socializmi, jeta dhe puna e popullit mbrohen me armë në dorë, duke e pajisur ushtrinë e popullin me mjete moderne, duke i stërvitur ata vazhdimisht që të dinë t'i përdorin ato në mënyrë të përsosur e me efikasitetin më të madh. Atdheu është i të gjithë popullit, prandaj dhe mbrohet jo vetëm nga ushtria e rregullt, e veshur me uniformë, por nga i tërë populli i armatosur, i organizuar dhe i përgatitur ushtarakisht.

Duke u udhëhequr nga porosia e Leninit për ta bërë «çdo qytetar ushtar dhe çdo ushtar qytetar», ne përpiqemi që çdo njeri njëkohësisht të punojë, të mësojë dhe të përgatitet për mbrojtje. Tërë vendi është një kantier i madh pune ndërtimore, një shkollë e madhe e edukimit komunist dhe një fortesë ushtarake e pathyeshme.

Partia dhe Qeveria u kanë kushtuar kurdoherë

kujdesin më të madh rritjes, edukimit dhe kalitjes së forcave të armatosura. Ushtria jonë Popullore është e gatshme që në çdo kohë e situatë, sado e vështirë goftë, të kryejë me nder detyrën e lartë të mbrojtjes së atdheut socialist.

Ushtria jonë është ushtri e tipit të ri, ushtri e popullit, ushtri e revolucionit. Duke ruajtur fort traditat e lavdishme të ushtrisë partizane, ajo ndryshon rrënjësisht nga ushtritë e vendeve borgjeze e revizioniste. Ajo nuk është një ushtri kazerme, një kastë e mbyllur që qëndron e shkëputur nga populli e mbi popullin, por një ushtri e shkrirë në një të vetme me tërë popullin e armatosur. Për kuadrot e saj, që janë bij të popullit, janë të huaja pikëpamjet reaksionare borgjeze e revizioniste mbi ushtrinë, shfaqjet e arrogancës, fodullëkut, prepotencës, qëndrimi larg ushtarëve etj.

Në rrugën e revolucionarizimit të mëtejshëm të ushtrisë, si rezultat i masave të marra nga Partia për spastrimin e saj nga shumë forma e struktura organizative, nga shumë rregullore të huaja, të papërshtatshme për një ushtri si jona, e kanë bërë atë një ushtri të vërtetë të diktaturës së proletariatit, të aftë të përmbushë me nder misionin e saj në përshtatje me kushtet dhe detyrat e mbrojtjes së vendit.

Në të gjithë jetën e ushtrisë ne i jemi përmbajtur me konsekuencë parimit të prioritetit të punës ideopolitike mbi atë ushtarake, të prioritetit të njeriut, si faktori vendimtar në krahasim me armën. Është puna politike ajo që, duke ngritur ndërgjegjen e njerëzve, i jep jetë gjithë punës tjetër që bëhet në ushtri dhe e aftëson atë. Puna politike e bën ushtrinë të qëndrojë

kurdoherë armë besnike e diktaturës së proletariatit, rojë vigjilente e fitoreve të popullit.

Partia u ka kushtuar e do t'u kushtojë edhe në të ardhmen tërë kujdesin, pa lejuar kurrfarë qëndrimesh simpliste, përgatitjes së shëndoshë ushtarake, përvetësimit të thellë të artit ushtarak të luftës popullore, zotërimin të përsosur të armëve dhe të teknikës moderne nga luftëtarët, forcimit të rregullit e të disiplinës ushtarake proletare.

Partia ka qenë dhe mbetet shpirti i ushtrisë, truri që e drejton atë në rrugë të drejtë, forca jetëdhënëse që e bën atë të pathyeshme. Në ushtrinë tonë, në krye të mbrojtjes sonë, në komandë është Partia.

Komitetet dhe organizatat e Partisë në terren në çdo veprim që bëjnë, në çdo problem që zgjidhin të mos harrojnë kurrë detyrat lidhur me forcimin e mbrojtjes së atdheut. Ato duhet të zhvillojnë një punë të dendur ideopolitike për edukimin e gjithë punonjësve në frymën e vigjilencës, të gatishmërisë së lartë e të seriozitetit më të madh në përgatitjen ushtarake, duke mbajtur parasysh sa më realisht kushtet dhe kërkesat e luftës së sotme.

Organet e Partisë në ushtri dhe komandat ushtarake, nga ana e tyre, duhet të përmirësojnë stilin e punës për rritjen e përgatitjes politike dhe të gatishmërisë luftarake të forcave të armatosura, të forcojnë e të përsosin sidomos format e metodat e edukimit dhe të përgatitjes ushtarake të të gjithë popullit në përshtatje me strukturat e sotme organizative të ushtrisë.

Duke qenë se problemet e mbrojtjes, të ushtrisë

dhe të stërvitjes ushtarake janë probleme të të gjithëve, është e nevojshme të forcohet e të përmirësohet më tej bashkëpunimi e bashkërendimi i punës midis organizatave të Partisë e komandave në ushtri dhe organizatave të Partisë e organeve të pushtetit e të ekonomisë në terren.

Nën kujdesin e vazhdueshëm të Partisë janë zhvilluar e forcuar organet e sigurimit të shtetit, të policisë popullore e të kufirit. Në tërë veprimtarinë e tyre ato janë mbështetur gjithmonë e më shumë në ndihmën dhe përkrahjen aktive të masave punonjëse, kanë zbatuar me përpikëri mësimet e Partisë, kanë luftuar me guxim për të mbrojtur ligjshmërinë socialiste, interesat e shtetit e të popullit.

Forcimi i mëtejshëm i organeve të sigurimit të shtetit, të policisë popullore e të kufirit kërkon ngritjen në një shkallë më të lartë të punës ideopolitike e profesionale, rritjen e vigjilencës revolucionare e të disiplinës së ndërgjegjshme për zbatimin me rreptësi të normave të përcaktuara, zgjerimin e mëtejshëm të lidhjeve me masat. Sigurimi i vazhdueshëm i rolit udhëheqës e kontrollues të Partisë në të gjithë veprimtarinë e tyre është kusht i domosdoshëm dhe një garanci e shëndoshë që këto organe të dashura të Partisë e të popullit të kryejnë me nder misionin e tyre.

Në forcimin dhe përsosjen e diktaturës së proletariatit një rol shumë të rëndësishëm luan legjislacioni ynë revolucionar. Sipas orientimeve të Kongresit të 5-të, me pjesëmarrjen aktive të masave, u bë një punë e madhe për rishikimin e gjithë legjislacionit të shtetit, për thjeshtimin e tij, për t'ua përshtatur atë kush-

teve të sotme. Kjo, krahas riorganizimit të organeve të drejtësisë, duke i afruar ato me masat e duke i vënë më mirë nën kontrollin e masave, ka ndikuar në mënyrë të dukshme në revolucionarizimin e punës së tyre. Përsosja e vazhdueshme e legjislacionit, njohja e ligjeve nga ana e masave të popullit, për t'i bërë ato sa më të ndërgjegjshme për zbatimin e tyre, forcimi i mëtejshëm i lidhjeve të organeve të drejtësisë me punonjësit dhe mbështetja në ta për mbrojtjen e ligjeve është një detyrë e madhe partie.

Shokë dhe shoqe,

Kanë kaluar 27 vjet nga koha kur populli ynë, nën udhëheqjen e patundur marksiste-leniniste të Partisë së Punës, përmbysi me luftë të armatosur pushtetin e urryer të imperialistëve të huaj e të klasave shfrytëzuese reaksionare vendëse dhe, për herë të parë në historinë e vet shumëshekullore, vendosi në Shqipëri pushtetin popullor. Pas zgjedhjeve të para të lira, të përgjithshme e demokratike të dhjetorit 1945, nga të cilat doli Asambleja Kushtetuese, përfaqësuese e vërtetë e aspiratave dhe e interesave të popullit, u aprovua ligji themeltar i shtetit të ri, Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë.

Atëherë vendi ynë sapo kishte dalë nga Lufta e madhe Nacionalçlirimtare dhe po bënte hapat e parë në rrugën e ndërtimit socialist. Në ato rrethana aprovimi i Kushtetutës ishte një ngjarje e shënuar historike dhe një fitore tjetër e madhe politike e popullit. Rëndësia e saj qëndronte në faktin se ajo ligjëroi atë

përmbysje të thellë e rrënjësore që u bë në jetën e shoqërisë sonë si rezultat i triumfit të revolucionit popullor, sanksionoi nga pikëpamja juridike të gjitha ato fitore të mëdha politike, ekonomike e shoqërore që populli kishte arritur me luftën e vet heroike dhe hapi perspektiva të qarta për transformime të tjera revolucionare në të gjitha fushat e jetës mbi baza socialiste.

Kushtetuta u bë mbështetja dhe burimi i gjithë legjislacionit të shtetit tonë të ri demokratik popullor, që shprehte vullnetin e popullit dhe mbronte interesat e tij. Ajo luajti një rol të madh jo vetëm për mbrojtjen e konsolidimin e pushtetit dhe të të gjitha fitoreve të tjera të revolucionit, por edhe për zhvillimin e gjithëanshëm të rendit shoqëror-ekonomik në rrugën e socializmit.

Që nga ajo kohë ka kaluar një çerek shekulli. Kjo është periudha e transformimeve të mëdha revolucionare për të hedhur dhe konsoliduar themelet e rendit të ri në të gjitha fushat. Idetë e mëdha të marksizëm-leninizmit mbi shoqërinë e re, të lirë nga çdo shtypje e shfrytëzim dhe programi i Partisë sonë për ndërtimin e bazave të socializmit u bënë realitet. Pushteti popullor, i lindur nga pushka partizane, u konsolidua si pushtet i diktaturës së proletariatit, nën udhëheqjen e pandarë të Partisë së Punës. Mjetet e prodhimit, që më parë ndodheshin në duart e kapitalistëve vendës e të imperialistëve të huaj, u bënë pronë e përbashkët e popullit. U likuidua plotësisht sektori kapitalist i ekonomisë. Një revolucion rrënjësor u krye në fshat, kolektivizimi i bujqësisë e transformoi nga themelet

prodhimin e vogël fshatar dhe e vuri atë mbi baza socialiste. Vendin e ekonomisë shumëformëshe e zuri sistemi i vetëm i ekonomisë socialiste. Bashkë me pronën private u zhdukën edhe klasat shfrytëzuese dhe të gjithë antagonistat e tjerë midis qytetit e fshatit, punës mendore e fizike, që ngrihen mbi bazën e shfrytëzimit kapitalist. Marrëdhënie krejt të reja, të aleancës mbi bazën e socializmit, të përkrahjes e të ndihmës reciproke, janë vendosur midis klasës punëtore, fshatarësisë punonjëse dhe inteligjencies popullore. Dallimet midis tyre shkojnë duke u ngushtuar. Mbi këto baza është çelikorur çdo ditë e më tepër uniteti social, ekonomik e ideopolitik i popullit.

Me ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, që është fitorja e dytë më e madhe pas vendosjes së pushtetit popullor, vendi ynë hyri në një etapë të re historike, në atë të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Në luftë për zbatimin e detyrave të kësaj etape janë arritur fitore të reja të mëdha. Kjo luftë u ngrit në një shkallë më të lartë pas Kongresit të 5-të të Partisë. Procesi i madh i revolucionarizimit të të gjithë jetës së vendit, që ngriti peshë mbarë popullin, ka çuar në konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të transformimeve të thella ekonomike, shoqërore, politike e ideologjike, në forcimin dhe përsosjen e bazës ekonomike e të gjithë superstrukturës së shoqërisë. Është grumbulluar një eksperiencë e re me vlerë të madhe se si t'i pritet rruga revizionizmit e restaurimit të kapitalizmit, si të sigurohet marshimi gjithnjë përpara i revolucionit deri në fitoren e tij të plotë e përfundimtare.

E parë në prizmin e këtyre ndryshimeve të thella revolucionare, Kushtetuta në fuqi, me gjithë korrigjimet e shtesat e mëvonshme që i janë bërë, në shumë aspekte themelore është kapërcyer dhe nuk pasqyron më realitetin socialist të sotëm në Shqipëri. Prandaj Komiteti Qendror i Partisë propozon hartimin e një Kushtetute të re, e cila t'i përshtatet etapës së sotme të zhvillimit të vendit, realitetit të ri, në mënyrë që, si pjesë përbërëse e superstrukturës politike, ajo t'i shërbejë më mirë bazës ekonomike, gjithë zhvillimit socialist të shoqërisë.

Ripunimi i Kushtetutës do të jetë një hap me rëndësi të madhe teorike e praktike për forcimin dhe përsosjen e mëtejshme të shtetit të diktaturës së proletariatit në vendin tonë. Kushtetuta e re do të shërbejë si bazë juridike për organizimin dhe legjislacionin shtetëror që kërkon faza e sotme e ndërtimit tonë socialist. Ajo duhet të jetë një dokument juridik, politik e ideologjik që të pasqyrojë plotësisht vijën e Partisë, të mishëruar në praktikën tonë revolucionare dhe t'i frymëzojë punonjësit në luftën për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

Hartimi i Kushtetutës së re është një punë me përgjegjësi të madhe. Ajo do të jetë Kushtetuta e Shqipërisë socialiste, e një vendi që u qëndron besnik parimeve të socializmit shkencor dhe që i zbaton e i zhvillon ato në mënyrë krijuese. Në hartimin e saj duhet të mbajmë parasysh si përvojën tonë të pasur revolucionare, ashtu edhe eksperiencën e socializmit botëror. Kjo Kushtetutë duhet të paraqitë tiparet e vërteta të socializmit që e dallojnë atë nga të gjitha

shtrembërimet e deformimet që i kanë bërë atij revizionistët modernë. Ajo do të jetë pasqyrimi i një rruge dhe eksperience të tërë të lavdishme, nën udhëheqjen e urtë të Partisë së Punës, që do të na frymëzojë, do të na mbushë me optimizëm e do të na nxitë për beteja e fitore të reja.

IV

LUFTA IDEOLOGJIKE DHE EDUKIMI I NJERIUT TË RI

Zhvillimi i revolucionit në fushën e ideologjisë e të kulturës vitet e fundit është karakterizuar nga një luftë frontale klasore kundër të gjitha formave të ideologjisë së huaj, duke filluar që nga mbeturinat e vjetra, që vijnë nga thellësitë e shekujve, e deri te ndikimet e sotme të ideologjisë borgjeze e revizioniste. Qëllimi themelor i kësaj luftime është revolucionarizimi i mendjes dhe i ndërgjegjes së njerëzve, i gjithë botës shpirtërore të tyre për të afirmuar ideologjinë marksiste-leniniste, moralin proletar, kulturën socialiste. Kjo është një luftë e gjerë masive, që zhvillohet me pjesëmarrjen aktive të të gjitha shtresave të popullsisë, që realizohet në praktikë nëpërmjet lëvizjeve dhe aksioneve revolucionare, diskutimeve të gjera popullore, debatit dhe kritikës së hapët publike, ku ballafaqohen mendimet dhe zakonet e vjetra reaksionare me idetë dhe moralin e ri revolucionar.

Lufta për thellimin e revolucionit ideologjik e kulturor, si pjesë përbërëse e procesit të revolucionarizimit të gjithanshëm të jetës së vendit, u përgatit nga tërë puna 30-vjeçare e Partisë. Duke u mbështetur në rezultatet e arritura, Partia jonë lufton për ta

guar përpara pa ndërprerje punën për formimin e njeriut të ri të shoqërisë së re socialiste, të pajisur me bindje të thella marksiste-leniniste, me veti morale të larta revolucionare komuniste, me horizont të gjerë kulturor e botë të pasur shpirtërore.

Të forcojmë më tej ndërgjegjen socialiste të masave punonjëse në luftë me të gjitha mbeturinat dhe ndikimet e ideologjive të huaja

Megjithëse revolucionin ynë përmbysi marrëdhëniet e vjetra në prodhim, pra likuidoi atë bazë materiale, e cila lind, mban gjallë e ushqen format e ndryshme të ideologjisë së klasave shfrytëzuese, përsëri vazhdojmë të ndeshemi me ndikime e gjurmë të shumta të tyre. Shoqëria e re socialiste dhe zhvillimi i mëtejshëm i saj nuk mund të pajtohen më me këto mbeturina të huaja. Ato jo vetëm pengojnë marshimin përpara të revolucionit, por përmbajnë në vetvete rrezikun e kthimit prapa. Përvoja e hidhur e shfaqjes së revizionizmit në Bashkimin Sovjetik e vende të tjera vërtetoi se, po të mos i hysh me të gjitha forcat thellimit të revolucionit ideologjik e kulturor, do të thotë ta lësh revolucionin socialist në mes të rrugës, të vësh në rrezik realizimet e tij në lëmin politik e ekonomik, t'i hapësh rrugën degjenerimit borgjez në të gjitha fushat.

Intensifikimi i luftës klasore ideologjike diktohet edhe nga nevoja për emancipimin e gjithanshëm të energjive fizike, mendore e shpirtërore të të gjithë

punonjësve dhe veçanërisht të grave e të rinjve, për t'i çliruar ata nga barra e rëndë e paragjykimeve të vjetra, për t'i dhënë mundësi vrullit revolucionar të tyre që të shpërthejë furishëm e i papërmbajtur në të gjitha fushat e jetës. Ideali i socializmit është t'i çlirojë punonjësit jo vetëm nga zgjedha sociale dhe ekonomike, por edhe nga skllavëria shpirtërore e ideologjive të huaja. Socializmi është rendi i vetëm që krijon të gjitha kushtet dhe që është në gjendje të realizojë këtë emancipim të gjithanshëm të njerëzve.

Lufta që zhvillon Partia për edukimin e njeriut të ri është e gjerë dhe komplekse. Ky edukim nuk bëhet vetëm me anë të propagandës e të agjitacionit, nuk mbetet në luftën kundër ideve e koncepteve të vjetra në plan akademik. Ai arrihet edhe nëpërmjet krijimit të kushteve të atilla ekonomike, sociale e politike, që kultivojnë në njerëzit konceptet e normat socialiste. Ai realizohet në procesin e veprimtarisë praktike të njerëzve, në luftën e punën e tyre për ndërtimin e socializmit. Gjatë viteve të fundit me një guxim të rrallë, Partia po lufton për të përpunuar orientimet marksiste-leniniste në të gjitha këto fusha dhe për të hedhur masat në aksione revolucionare. Në procesin e thellimit të revolucionit socialist Partia ka grumbulluar tani një përvojë të vlefshme teorike e praktike.

Një sulm i paparë ndonjëherë po zhvillohet sidomos kundër formave më të vjetra të ideologjisë së klasave shfrytëzuese, patriarkalizmit e konservatorizmit, fesë e zakoneve prapanike, të cilat, për arsyt e njohura të prapambetjes së rëndë që trashëguam nga e kaluara, kanë akoma rrënjë dhe nuk janë shkallëmuar përfundimisht.

Një aksion me rezultate të mëdha është lufta për shpartallimin e ndikimit të fesë. Brenda një kohe shumë të shkurtër, u arrit që t'u hiqeshin përfundimisht funksionet e tyre gjithë institucioneve dhe predikuesve të fesë, të cilët përhapnin e mbanin gjallë idealizmin e misticizmin më obskurantist dhe më anakronik. Shqipëria u bë një vend pa kisha e xhami, pa priftërinj e hoxhallarë.

Natyrisht kjo nuk do të thotë se u arrit çlirimi i plotë i punonjësve nga ndikimi i opiumit fetar, përkundrazi për këtë do të duhet një proces i gjatë riedukimi dhe edukimi. Por kjo ishte një goditje dhe fitore vendimtare, e cila krijon një premisë të re e të fuqishme për emancipimin e mëtejshëm të ndërgjegjes së njerëzve, për çlirimin e plotë të tyre nga besimet e paragjykimet fetare.

Kjo fitore nuk erdhi vetvetiu dhe as u arrit me masa administrative. Për këto u poqën të gjitha kushtet dhe punonjësit me vullnetin e tyre të lirë vendosën për fatin e institucioneve fetare që kanë qenë kurdoherë në pozita antikombëtare, u kanë shërbyer feudalëve, borgjezisë e pushtuesve të huaj, pavarësisht se ka pasur edhe klerikë patriotë nga të gjitha besimet që kanë luftuar për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë. Ky qëndrim antikombëtar e anti-popullor i fesë dhe i institucioneve të saj kishte rënë prej kohësh në kundërshtim me ndjenjat patriotike e liridashëse të popullit shqiptar. Këtë kontradiktë Lufta Nacionalçlirimtare e thelloi akoma më shumë. Transformimet e mëdha socialiste në tërë jetën e vendit dhe puna e gjithanshme dhe e pandërprerë pro-

pagandistike e Partisë i bënë edhe më të ndërgjegjshme masat për kotësinë e besimeve fetare dhe për papajtueshmërinë e realitetit të ri socialist me institucionet dhe predikuesit e fesë.

Partia jonë nuk ka lejuar kurrë të luhet me ndjenjat e popullit. Por, si Parti marksiste-leniniste, ajo e ka të qartë se revolucioni socialist, gjatë marshimit të tij fitimtar, nuk mund të mos presë e të mos shkulë nga rrënjët, kur piqen të gjitha kushtet objektive e subjektive, të gjitha ato fije që i mbajnë masat të lidhura me botën e vjetër dhe që i pengojnë ato të ecin përpara.

Shikoni se ç'ngjet në vendet ku janë në fuqi revizionistët! Në truallin e përgjithshëm të degjenerimit borgjez, për hir të koniunkturave politike të brendshme e të jashtme, bile duke e përdorur kishën edhe për qëllime socialimperialiste, atje po zgjerohet propaganda fetare, po shtohen kishat e kleri, po gjallërohen vjetërsirat reaksionare dhe obskurantiste të mesjetës.

Në etapën e sotme të revolucionit jeta shtroi me forcë në rendin e ditës si një problem shumë të mprehtë të emancipimit e plotë të gruas. Gratë dhe të rejat kanë qenë ato forca të shoqërisë sonë që mbaheshin më shumë se kushdo tjetër të shtypura e të ndrydhura, si nga ligjet e fesë, ashtu edhe nga normat, kanunet e zakonet e patriarkalizmit.

Me vendosjen e pushtetit popullor dhe me krijimin e bazës ekonomike të socializmit gruaja shqiptare, krahas gjithë punonjësve, shpëtoi nga shfrytëzimi kapitalist, fitoi liritë dhe të drejtat politike të barabarta me

burrin, asaj iu krijuan mundësitë që të hidhej me të gjitha forcat në frontin e madh të ndërtimit socialist të vendit. Sot nuk ka aktivitet në vendin tonë ku të mos militojnë dhe gratë, nuk ka vepër të re ku të mos mishërohet dhe puna fizike e mendore e tyre. Ato përbëjnë rreth 45 për qind të të gjithë njerëzve të zonë me punë në qytet e fshat.

Në vendin ku gratë dhe vajzat ishin masat më të prapambetura, që përçmoheshin nga shoqëria e nga burrat, sot me qindra e mijëra prej tyre drejtojnë punët e pushtetit në të gjitha instancat deri në Kuvendin Popullor, kryejnë funksione të rëndësishme në organizatat e masave dhe të Partisë, drejtojnë prodhimin e sektorë të tjerë të jetës së vendit. Partia dhe gjithë populli ndiejnë gëzim dhe krenari të vërtetë për gratë dhe vajzat tona heroike, të cilat, megjithëse akoma në kushte më të rënda se burrat, me zgjuarsin, me guxim dhe trimëri, punojnë e luftojnë jo më keq se shokët e tyre.

Me gjithë rezultatet e arritura në luftën për emancipimin e gruas, mbetet problem shqetësues sigurimi i barazisë së plotë e të vërtetë të gruas me burrin në jetën shoqërore e familjare. Pengesë kryesore këtu ishin dhe mbeten konceptet prapanike, feudale e patriarkale të vlerësimit të gruas si një qenie inferiore. Pa thyer këto koncepte që shtypnin e ndrydhnin personalitetin dhe energjitë e gruas, pa kapërcyer këtë mur nuk mund të sigurohej përparimi i saj dhe i gjithë shoqërisë sonë në rrugën e socializmit.

Ja përse Partia jonë t'han e luftës së saj për emancipimin e plotë të gruas e drejtoi kryesisht në

frontin ideologjik, në luftën kundër konservatorizmit, normave e zakoneve skllavëruese, koncepteve denigruese e ofenduese për gratë.

Sukseset janë të mëdha. Por emancipimi i plotë i gruas mbetet edhe për të ardhmen një nga detyrat më të rëndësishme për Partinë. Dhe emancipimi i gruas do të thotë jo vetëm një grua e çliruar, por dhe një shoqëri e tërë e çliruar përfundimisht nga paragjykimet e konceptet e huaja për gruan. Ky emancipim nënkupton, gjithashtu, edhe krijimin e të gjitha kushteve materiale e shpirtërore për vendosjen e barazisë efektive e të plotë të burrit e të gruas në të gjitha fushat e jetës. Prandaj aq sa duhet punuar me ngulm për ngritjen ideologjike dhe të nivelit kulturor, arsimor e tekniko-profesional të vetë grave, që të kenë të njëjtin zhvillim si shokët e tyre e ta thonë kudo e me kompetencë mendimin për të gjitha problemet, po me aq ngulm duhet punuar për t'u krijuar atyre nga shoqëria në përgjithësi e nga pjesëtarët e tjerë të familjes, në veçanti nga burrat, kushte të barabarta zhvillimi, për t'u dhënë mundësi të mësojnë e të krijojnë. Puna e veprimtaria shoqërore të mos u ndërpritet nga punët e përditshme, të lodhshme e drobitëse të shtëpisë, të cilat zakonisht përballohen vetëm prej tyre. Ne kemi sot mundësi, dhe përherë e më tepër do të kemi, që shumë nga punët e shtëpisë shkallë-shkallë t'i shoqërizojmë.

Këtu del përpara një çështje tjetër shumë e rëndësishme: krijimi i një jete të vërtetë demokratike në familje. Lufta për zgjerimin dhe thellimin e demokracisë socialiste në jetën tonë shoqërore depërtoi edhe

në familje, ku shfaqjet e pabarazisë janë më të forta. Para syve tanë po tronditen e po rrëzohen themelet e jetës patriarkale dhe në familje po futen gjithnjë e më gjerë parimet e moralit komunist, fryma e ideologjisë socialiste. Motive të reja demokratike dhe socialiste kanë filluar të veprojnë tani më shumë në lidhjet martesore dhe në marrëdhëniet familjare. Por këto motive të reja nuk janë bërë akoma dominuese. Është i njohur fakti se familja mbetet relativisht më prapa zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë. Prandaj duhet të luftojmë që edhe kjo prapambetje të zvogëlohet nga dita në ditë, duke bërë që edhe jeta në familje të ecë me ritmin e kohës e krahas ndryshimeve të mëdha që bëhen në jetën e vendit. Familja shqiptare si vatër edukimi ka kultivuar veti të çmueshme patriotike dhe morale. Por mjaft tradita të punës edukuese të saj nuk mund të plotësojnë kërkesat tona, bile në disa drejtime ato i kundërvihen realitetit të sotëm. Për revolucionarizimin e jetës në familje duhet punuar më aktivisht, që ajo të zhvishet gradualisht nga mbeturinat konservatore e nga mentaliteti patriarkal dhe të bëhet vatër e edukimit të njerëzve në frymën e ideologjisë së Partisë.

Shoqëria jonë nuk mund të qëndrojë indiferente ndaj problemeve të familjes, duke i quajtur ato vetjake e të mbyllura. Përkundrazi, ajo do të kërkojë kurdoherë format e përshtatshme për të ndikuar mbi të, duke dënuar në të njëjtën kohë, si të huaja, ndërhyrjet vulgare e pa takt, me vend e pa vend në çështjet intime familjare.

Një luftë të vazhdueshme ka bërë Partia edhe ku-

ndër mentalitetit e psikologjisë mikroborgjeze. Por tani ka ardhur koha ta mprehim më shumë tchun e goditjes sonë kundër tyre. Ideologjia mikroborgjeze ka rrënjë të thella në ndërgjegjen e njerëzve. Kjo lidhet me faktin se në vendin tonë në të kaluarën kanë mbizotëruar prona e vogël e fshatarit dhe puna private e zanatçiu, mbi bazën e të cilave ndërtoheshin të gjitha llojet e marrëdhënieve midis njerëzve dhe kryhej formimi i pikëpamjeve të tyre. S'ka dyshim se transformimet e mëdha ekonomiko-shoqërore dhe puna e gjithanshme për edukimin e masave i kanë dhënë goditje të forta edhe ideologjisë mikroborgjeze, kanë ngushtuar sferën e veprimit të saj në punë dhe në jetën e njerëzve tanë.

Por e vërteta duhet parë në sy. Konceptet e pri-rjet mikroborgjeze ruhen dhe mbahen akoma gjallë. Ato shfaqen jo vetëm në fshat, por edhe në qytet, në këtë ose atë masë në të gjitha shtresat e popullsisë. Mbeturinat mikroborgjeze pleksten me të gjitha format e ideologjisë së klasave shfrytëzuese, si me zakonet prapanike e patriarkale, ashtu edhe me ndikimet borgjeze e revizioniste.

Ideologjia mikroborgjeze ka karakter konservator, influenca e saj shërben si një nga burimet kryesore të oportunitizmit dhe aventurizmit në lëvizjen punëtore. Është fakt se vala mikroborgjeze, e pleksur me burokratizmin dhe me presionin e gjithanshëm të ideologjisë borgjeze e revizioniste, që një nga faktorët kryesorë që bëri të mundur procesin e degjenerimit kapitalist në Bashkimin Sovjetik.

Këtej del akoma më qartë se lufta kundër ideolo-

gjisë mikroborgjeze dhe shfaqjeve të saj është një nga detyrat më të rëndësishme të punës së gjithanshme të Partisë e veçanërisht të punës së saj ideologjike.

Në radhë të parë duhet të luftojmë për forcimin e disiplinës proletare në punë, kundër të kënaqurit me pak dhe mentalitetit fshatar e artizan, për rritjen e kërkesave ndaj rendimentit të çdo pune shoqërore. Por ky nuk është një problem thjesht edukimi. Ai është një problem kompleks social dhe ekonomik. Vetëm mbi bazën e përcaktimit të kriterëve të drejta socialiste në fushën e organizimit, normimit, shpërblimit dhe kontrollit të punës, të sasisë dhe cilësisë së saj mund të zhvillohet me sukses puna edukuese për rrënjosjen e vetive socialiste të domosdoshme për kryerjen me ndër-gjegje, në kohën e duhur dhe me rendiment të lartë të çdo punë shoqërore.

Një luftë e vendosur duhet bërë kundër individualizmit mikroborgjez që shprehet në shikimin e ngushtë e tepër të ngushtë të çështjeve, në kapjen fort pas interesave vetjakë që u kundërvihen interesave të përbashkët të shoqërisë, në mbylljen brenda guaskës së një bote të vogël e meskine, që të largon nga idealet e mëdha të kohës, që zhvillon indiferentizmin dhe apatinë ndaj çdo gjëje që nuk ka të bëjë me interesin e ngushtë personal dhe familjar, që e bën njeriun të rendë pas interesit material e rehatisë personale.

Tërheqja pas interesit të ngushtë personal është shprehje jo vetëm e ideologjisë mikroborgjeze, por e të gjitha ideologjive të klasave shfrytëzuese që buron nga vetë prona private, mbi të cilën mbështeten këto ideologji. Kjo prirje, që shfaqet në format më të ndry-

shme, është një nga plagët më të rënda që kemi trashëguar nga e kaluara dhe një nga rreziqet më të mëdha për fatet e socializmit. Prandaj luftën kundër çdo shfaqjeje të vënies së interesit personal mbi interesin e përgjithshëm duhet ta shohim si një çështje themelore në gjithë punën ideologjike të Partisë.

Në luftën kundër ideologjisë mikroborgjeze duhet të kemi parasysh se shfaqjet e saj pleksen me qëndrimet e ndryshme konservatore e liberale dhe ushqejnë mungesën e principialitetit dhe kalimin nga njëri ekstrem në tjetrin. Ato kanë një rreze të gjerë veprimi në qëndrimin ndaj punës e pronës shoqërore, dhe sidomos në mënyrën e jetesës, në shprehjet e në zakonet e ndryshme, veçanërisht në familje.

Forcimi dhe kalitja e pareshtur e ndërgjegjes socialiste të njerëzve tanë bëhet jo vetëm duke luftuar kundër mbeturinave të ideologjive të vjetra patriarkale, konservatore e mikroborgjeze, por edhe në luftë të vazhdueshme e të papajtueshme kundër ndikimeve të rrymave të sotme ideologjike borgjeze e revizioniste. Vendi ynë nuk jeton i izoluar nga bota kapitaliste e revizioniste që na rrethon, e cila, siç na mëson Lenini, duke u dekompozuar, lëshon në ajër gjithfarë mikro-besh vdekjeprurëse.

Si revolucionarë dhe marksistë, ne e kuptojmë rrezikun e zëvendësimit të një ideologjie të vjetër skllavëruese me një ideologji të re skllavëruese, të një helmi të vjetër me një helm të ri, i cili, sado i sheqërosur që mund të jepet, nën çdo maskë «modernizimi» e «liberalizmi», është gjithmonë vdekjeprurës. Në kushtet e tanishme ai përfaqëson një rrezik të madh.

Duke shkallmuar ndikimet e ideologjisë së huaj që vijnë nga thellësitë e shekujve, duke zhdukur plagët e vjetra sociale dhe ideologjike të trashëguara nga shoqëria e vjetër feudalo-borgjeze, Partia jonë lufton për të mos lejuar krijimin e plagëve të reja sociale dhe ideologjike, që janë karakteristike për botën e sotme kapitaliste e revizioniste.

Gjithë lufta jonë e viteve të fundit, i tërë procesi i revolucionarizimit të jetës së vendit janë në të njëjtën kohë goditje të forta kundër ideologjisë borgjeze dhe revizioniste. Ato synojnë t'i bëhen barrierë aktive depërtimit të kësaj ideologjie. Por do të ishte e pafalshme po të mendohej se në të ardhmen ne jemi të garantuar nga çdo ndikim i ideologjisë borgjeze e revizioniste, se njerëzit tanë tashmë janë të imunizuar. Një nga drejtimet kryesore të strategjisë armiqësore imperialiste dhe revizioniste kundër vendit tonë është pikërisht presioni ideologjik, të cilin ata kanë mundësi ta ushtrojnë duke shfrytëzuar kanalet e shumta të informacionit të sotëm dhe veçanërisht të ndikimit kulturor, i cili merr forma të shumëllojta. Prandaj është detyrë e dorës së parë që edhe në të ardhmen të organizojmë një luftë të vazhdueshme kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste, duke mbajtur gjithmonë lart vigjilencën tonë ideologjike dhe frymën luftarake revolucionare.

Lufta në frontin ideologjik, siç ka theksuar vazhdimisht Partia, është pjesë përbërëse dhe shumë e rëndësishme e luftës së klasave, e cila vazhdon e pandërprerë në të gjitha fushat, politike, ekonomike, ideologjike e kulturore. Nga kjo luftë varet zhvillimi

me sukses i revolucionit, mbrojtja dhe konsolidimi i fitoreve të tij. Jeta tashmë ka vërtetuar katërcipërisht se çdo largim nga lufta e klasave, çdo dobësim i kësaj lufte, çdo keqkuptim dhe shtrembërim i saj është i mbarsur me pasoja tepër serioze. Këtu duhet të shohim e të kërkojmë një nga shkaqet më të rëndësishme të asaj që ndodhi në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera, vetë thelbin e tradhtisë revizioniste.

E rëndësishme është që jo vetëm të pranojmë luftën e klasave, por edhe të kemi për të një kuptim të drejtë e të gjerë, si një luftë që vazhdon gjatë gjithë periudhës historike të kalimit nga kapitalizmi në komunizëm, si një luftë që zhvillohet jo vetëm kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, por edhe në gjirin e popullit e të Partisë, si një luftë që duhet bërë vazhdimisht, kudo e nga të gjithë.

Përderisa vazhdon lufta e klasave, e cila nuk nxitet artificialisht, por ekziston objektivisht si luftë midis dy rrugëve të zhvillimit, socialiste e kapitaliste, nuk ka vend për asnjë frymë qetësie, vetëkënaqësie e liberalizmi, se gjoja ne i kemi zhdukur të gjitha të këqijat dhe kemi shpëtuar nga çdo rrezik. Përkundrazi, tehu i luftës së klasave duhet mbajtur kurdoherë i mprehtë, sepse ajo është arma jonë e fuqishme që na mbron nga armiqtë, që na spastron nga të këqijat, që na farkëton si revolucionarë proletarë. Këtë luftë ne duhet ta zhvillojmë me konsekuencë, duke bërë gjithnjë të qartë karakterin e kontradiktave antagonistë e joantagoniste dhe duke u mbështetur fort në masat.

Te ne në fuqi është klasa punëtore, e cila nëpërmjet Partisë dhe shtetit proletar udhëheq tërë jetën e

vendit. Roli i saj drejtues e kontrollues është vendimtar. Pa këtë rol nuk ka diktaturë të proletariatit, nuk ka socializëm. Për këtë arsye Partia i ka kushtuar dhe i kushton tërë kujdesin e saj edukimit të gjithanshëm të klasës punëtore, rritjes së ndërgjegjes politike dhe aftësimit të saj për ta bërë atë plotësisht në gjendje jo vetëm të kuptojë misionin e vet si klasë udhëheqëse në fuqi, por dhe që ta realizojë atë në praktikë.

Vitet që kanë kaluar kanë shënuar suksese të rëndësishme në këtë drejtim, të cilat duken qartë në rritjen e frymës luftarake të klasës punëtore, në rezultatet e mrekullueshme në punë, në shpërthimin e iniciativave dhe krijimtarisë revolucionare, në forcimin e në zgjerimin e kontrollit punëtor të drejtpërdrejtë, në ngritjen e nivelit ideologjik, kulturor e tekniko-profesional, në faktin se klasa punëtore me shembullin dhe veprën e saj po i jep gjithnjë e më shumë tonin tërë jetës së vendit.

Këto rezultate janë një bazë e shëndoshë për ta çuar vazhdimisht përpara edukimin e klasës punëtore. Në këtë punë vendin e parë e kryesor, si kurdoherë, duhet ta zërë edukimi ideopolitik, armatosja e klasës punëtore me teorinë marksiste-leniniste dhe me mësimet e Partisë, të lidhura ngushtë me jetën dhe luftën e përditshme. Jo më pak e rëndësishme është edhe puna për edukimin e saj profesional, arsimor e kulturor.

Këto dy anë të edukimit komunist të klasës punëtore dhe të të gjithë punonjësve janë të lidhura ngushtë. Por Partia i ka dhënë e do t'i japë prioritet edukimit ideologjik, politik e moral, sepse klasën punëtore ne nuk e shohim siç e shohin atë borgjezët e revizio-

nistët, si një forcë thjesht prodhuese, që duhet vetëm të punojë e të prodhojë, kurse burokratët e teknokratët të sundojnë, të bëjnë ligjin, të shtypin e të shfrytëzojnë klasën punëtore në interes të borgjezisë kapitaliste e revizioniste.

Për ne janë krejt të huaja teoritë borgjeze teknokratike që përpiqen të mohojnë nevojën e domosdoshme të revolucionit social të proletariatit dhe ta zëvendësojnë atë me revolucionin tekniko-shkencor, që synojnë të hedhin poshtë karakterin konsekuent revolucionar dhe misionin historik të klasës punëtore. Revolucioni tekniko-shkencor nuk mund të ndryshojë kurrë natyrën as të kapitalizmit, as të socializmit, nuk mund të ndryshojë ligjet objektive të zhvillimit të shoqërisë. Te ne revolucioni tekniko-shkencor zhvillohet nën udhëheqjen e diktaturës së proletariatit. Burokratët e teknokratët nuk mund të jenë dhe nuk do të jenë kurrë në fuqi, por do të sundojë klasa punëtore dhe ligjet e diktaturës së proletariatit deri në shuarjen e shtetit, deri në fitoren e plotë të komunizmit.

Në vendin tonë specialistët, teknikët, intelektualët përgjithësisht, të dalë nga gjiri i klasës punëtore e i masave punonjëse, të edukuar në frymën e socializmit nga Partia, kanë një vend të merituar dhe luajnë një rol të madh në të gjitha fushat e veprimtarisë si ndihmës të klasës punëtore, si shërbëtorë të popullit. Duke luftuar konceptet burokratike, teknokratike e intelektualiste, Partia lufton në të njëjtën kohë edhe kundër koncepteve vulgare që mohojnë e përçmojnë punën e rolin e inteligjencies. Qëllimi i Partisë është ta ruajë inteligjencien të pastër e revolucionare, ta lidhë atë

ngushtë me punëtorët e fshatarët, ta bëjë atë të aftë të përballojë vetë ndikimet e huaja borgjeze e revizioniste, që të luftojë, ashtu si deri më sot, me vendosmëri për çështjen e madhe të klasës punëtore e të popullit.

Në luftë për edukimin e njeriut të ri Partia ka bërë një punë të frytshme sidomos për edukimin komunist të rinisë. Rinia jonë është e lidhur ngushtë me Partinë, e qartë politikisht dhe e pastër moralisht, e orientuar drejt dhe e sigurt në jetë, luftëtare e guximshme dhe sypatrembur, që i derdh energjitë e saj të vlefshme në dobi të revolucionit socialist dhe të përparimit të gjithanshëm të popullit.

Një pamje krejt të kundërt shohim në botën kapitaliste e revizioniste. Atje problemi i rinisë sot është nga më shqetësuesit. Rinia e ndien krizën e kësaj shoqërie të kalbur dhe kërkon rrugëdalje. Në këtë luftë ajo herë pas here hidhet në aksione të ndryshme revolucionare. Por atë e trullosin, e ushqejnë me ndjenjën e boshllëkut e të kotësisë shpirtërore, e futin në rrugën e shturjes e të degjenerimit, asaj ia konsumojnë energjitë në një jetë pa ideale e pa perspektivë. Borgjezia përdor të gjitha mjetet, që nga lojnat e fëmijëve e gjer te shtypi e literatura, që nga shkolla e gjer te kisha, për t'i korruptuar masat e rinisë dhe të popullit, për t'i dhënë këtij korruptimi pamjen e një jete gjoja të lirë e moderne, për t'i larguar të rinjtë nga politika, nga lufta për të ardhmen, nga revolucioni.

Ndershmëria, jeta në thjeshtësi dhe me dinjitet, morali i lartë dhe i pastër, besnikëria ndaj popullit punonjës dhe atdheut, të gjitha virtytet e larta dhe revolucionare të popujve, nga borgjezia dhe makina e saç

propagandistike konsiderohen anakronike dhe arkaike. Ato luftohen haptazi dhe tërthorazi, shtrembërohen e përshtaten në mënyrë demagogjike për interesat e borgjezisë dhe në dëm të interesave të punonjësve, për të shuar revoltën revolucionare, për të përballuar ndikimin e marksizëm-leninizmit që është mbrojtësi i këtij thesari të madh shpirtëror të popullit.

Ideologët borgjezë e revizionistë përpiqen t'u mbushin mendjen rinisë dhe masave se është e kotë të luftosh për të kërkuar rrugëdalje nga kontradiktat e thella që brejnë shoqërinë e tyre. E vetmja alternativë që propozojnë ata është zhytja në pesimizëm dhe korrupsion. Këtu e ka burimin nxitja e paskrupull dhe me pasoja katastrofale shoqërore e alkoolizmit, narkotizmit, seksualizmit dhe shumë instinkteve të ulëta e shtazarake që janë bërë modë në botën kapitaliste e revizioniste.

Te ne, në kundërshtim të plotë me këtë gjendje, brezi i ri, i grumbulluar në organizatën e vet luftarake të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, nën drejtimin e Partisë ka dalë në arenën e luftës klasore ideologjike si një iniciator i guximshëm dhe luftëtar i paepur, si një forcë revolucionarizuese, shtytëse dhe goditëse në lëmin e transformimeve sociale, ideologjike e kulturore. Rinia jonë heroike, duke u ruajtur nga ndikimet e ideologjisë borgjeze e revizioniste, në të njëjtën kohë ka çarë e çan me guxim në radhët e para në luftë kundër të gjitha atyre traditave të botës së vjetër, të cilave u ka shkuar koha, kundër çdo gjëje të huaj që pengon ecjen tonë përpara. Në këtë luftë është rritur dhe rritet çdo ditë personaliteti i rinisë,

shtohen guximi dhe iniciativa e saj revolucionare, pa-
surohet përvoja e saj.

Por rininë tonë duhet ta shikojmë e ta kuptojmë gjithmonë në zhvillimin e saj të vrullshëm. Ky zhvillim shoqërohet me vështirësi të rritjes e me kontradikta. Një pengesë e madhe që rinia e ndesh gjithnjë në punë e kudo janë shfaqjet e konservatorizmit, të cilat frenojnë hovin revolucionar të rinisë, nënvlerësojnë energjitë dhe aftësitë e saj krijuese, e mbajnë atë të ndrydhur, sidomos në fushën e marrëdhënieve shoqërore, etike, veçanërisht në familje e në një masë të ndjeshme edhe në shkollë. Krahas kësaj, rinia ndeshet edhe me ndikime të liberalizmit e të njëfarë indiferentizmi të opinionit shoqëror e, në disa raste, edhe të familjes. Nuk duhet të harrojmë se tehu i ideologjisë revizioniste e borgjeze drejtohet në radhë të parë te rinia, e cila për mungesë përvoje mund të bëhet më e prekshme. Prandaj Partia do të luftojë që edhe në të ardhmen ta hedhë rininë në luftë kundër çdo lloj ndikimi të ideologjisë së huaj, ta ushqejë atë në mënyrë konsekuente me idealet revolucionare marksiste-leniniste, t'u hapë terren dhe horizont në çdo fushë energjive të pashtershme të saj, të nxitë gjerësisht iniciativën e vetëveprimin e saj.

Kjo kërkon të gjallërohet në mënyrë të gjithanshme jeta e rinisë, të zgjerohet rrethi i interesave dhe i veprimtarisë së saj, të njihen kërkesat dhe dëshirat e saj, të vlerësohen mundësitë dhe forcat që ajo ka. Në këtë drejtim duhet të bëhet një punë më e kualifikuar, duke luftuar kundër çdo shfaqjeje të formalizmit e të burokratizmit, të diktatit e të tutelës, që nuk

merr parasysh interesat dhe nevojat e rinisë, që nuk përfill veçoritë psikologjike të moshës etj. Të tilla shfaqje në mjaft raste vihen re jo vetëm në prindërit e mësuesit, por edhe në organizata partie, bile edhe në kuadro që punojnë me rininë. Traditat e vjetra konservatore e burokratike bëhen pengesë sidomos për demokratizimin e mëtejshëm të jetës shkollore dhe krijimin e mundësive që rinia të marrë pjesë efektivisht në revolucionarizimin e gjithanshëm të kësaj jete.

Detyra jonë është t'i japim mundësi rinisë që vetë ta organizojë në mënyrë të gjallë dhe dinamike jetën e saj, ta ndihmojmë në këtë rrugë me mjeshtëri. Për këtë një rol të veçantë duhet të luajë organizata e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë. Ajo duhet ta gjallërojë jetën e saj duke marrë parasysh ndryshimet e vrullshme që sjell zhvillimi i jetës së vendit dhe i vetë rinisë, duke ua përshtatur edhe format e punës, këtyre ndryshimeve, si edhe nevojave e kërkesave të reja që ato sjellin te rinia.

Shoqëria jonë është në një periudhë ngjitjeje të vrullshme. Po përmbysen tradita, norma e zakone shekullore, sulmohen ideologjitë e të tëra klasave që u kapërcyeshin ylli, lindin norma e zakone të reja që çlirojnë mendjen e ndërgjegjen e punonjësve, po triumfon ideologjia e proletariatit ngadhënjimtar. Revolucionarizimi i gjithanshëm i jetës së vendit dhe lufta e mprehtë ideologjike e zhvilluar gjatë viteve të fundit kanë krijuar një raport të ri, më të përshtatshëm, midis kërkesave të socializmit dhe ndërgjegjes së njerëzve. Por, natyrisht, do të ishte gabim të mendohej se tashmë janë shkalluar krejtësisht të gjitha format,

dhe shfaqjet e ideologjive të vjetra, se janë zgjidhur të gjitha kontradiktat në këtë fushë. Sado e fortë që të jetë goditja jonë, ajo nuk mund të jetë, dhe në fakt nuk është, përfundimtare. Pozitat e fituara nga ideologjia socialiste kanë nevojë të përfordohen e të thellohen më tej, gjersa të sundojnë kudo, në tërë shoqërinë tonë.

Duke luftuar me ngulm për revolucionarizimin e gjithanshëm të superstrukturës sonë shoqërore, duke e vënë theksin me forcë te nevoja e intensifikimit të luftës ideologjike, ne kemi gjithmonë parasysh se faktori vendimtar që përcakton ecjen tonë përpara është rritja e pandërprerë e prodhimit socialist dhe transformimi i vrullshëm i gjithanshëm i shoqërisë sonë. Vetëm mbi këtë bazë mund të bëhet revolucionarizimi i mendjes dhe i ndërgjegjes së njerëzve. Prandaj lufta jonë ideologjike mund të zhvillohet me sukses duke çuar përpara prodhimin socialist dhe duke kombinuar revolucionarizimin e mekanizmave të jetës shoqërore, ekonomike e politike me edukimin komunist të masave punonjëse, me hedhjen e tyre në aksione dhe lëvizje revolucionare të vazhdueshme.

Lufta ideologjike, si një nga format më të ndërlikuar e më të mprehta të luftës së klasave, është një luftë për jetë a vdekje midis ideologjisë sonë dhe ideologjisë së huaj armike, midis së resë dhe së vjetrës, midis revolucionares e reaksionares.

Në këtë luftë së vjetrës që e mohojmë dhe duam ta shpartallojmë ne i kundërvëmë gjithmonë të rene që lind e afirmohet. Koncepteve dhe ideve borgjeze e revizioniste u kundërvëmë pikëpamjet tona marksiste-

-leniniste. Psikologjisë së vjetër mikroborgjeze i kundërvëmë psikologjinë e re socialiste. Shfaqjeve të individualizmit dhe të indiferentizmit borgjez e mikroborgjez u kundërvëmë kolektivizmin dhe solidaritetin socialist. Liberalizmit borgjez dhe konservatorizmit patriarkal u kundërvëmë frymën tonë të shëndoshë përparimtare. Tendencave të rehatisë e të mendjemadhësisë u kundërvëmë frymën e sakrificës e të aksionit, shpirtin praktik, modestinë dhe ekzigjencën ndaj vetes.

Në thellimin e luftës klasore ideologjike një rëndësi të dorës së parë merr formimi i botëkuptimit marksist-leninist. Tani janë krijuar kushte të reja objektive e subjektive që na japin mundësi për ta ngritur në një nivel më të lartë gjithë punën për përvetësimin krijues të marksizëm-leninizmit nga komunistët dhe masat punonjëse, për ta mbështetur në baza akoma më shkencore luftën kundër koncepteve idealiste e metafizike, për ta realizuar përvetësimin e teorisë marksiste-leniniste në lidhje akoma më të ngushtë me praktikën revolucionare. Një punë e madhe është bërë vitet e fundit për studimin e historisë së Partisë sonë dhe të dokumenteve themelore të saj. Në këtë studim vëmendja është përqendruar në gjënë themelore, në parimet nga të cilat është nisur dhe në metodën e rrugët që ka përdorur Partia për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, në rrethanat konkrete të vendit tonë; bëhen përpjekje që nga kjo të mësojmë të zgjidhim problemet e sotme në kushte të reja historike. Edhe zhvillimi i aksioneve e i lëvizjeve të shumta revolucionare, sidomos i atyre ideologjike, po shoqërohet me studimin e

marksizëm-leninizmit dhe me përpunimin teorik të problemeve përkatëse. Në këtë fushë është gjallëruar edhe puna e shtypit dhe e mjeteve të tjera të propagandës e të kulturës masive.

Këto rezultate janë një bazë e shëndoshë për të punuar më me ngulm e në mënyrë më të kualifikuar për zotërimin e teorisë marksiste-leniniste nga gjithë komunistët e punonjësit. Për këtë kërkohet që të studiohen thellë e vazhdimisht veprat gjithnjë aktuale të klasikëve tanë të mëdhenj, Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, dokumentet e Partisë sonë dhe materialet, në të cilat përgjithësohet eksperiencia e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Ky studim nuk është e nuk mund të jetë qëllim në vetvete, por i lidhur ngushtë me praktikën e sotme revolucionare dhe duhet t'i shërbejë kësaj praktike. Të studiojmë jo çdo gjë që na bie në dorë, por me një pikësynim të caktuar, duke zgjedhur për këtë qëllim edhe literaturën përkatëse. Studimi i teorisë marksiste-leniniste duhet të na shërbejë për të njohur thellë e për të zbatuar drejt politikën e Partisë në çdo fushë të veprimtarisë, për të kuptuar e për të zhvilluar me sukses luftën kundër imperializmit e revizionizmit modern, për të njohur ligjet e luftës së klasave, të marrëdhënieve midis kushteve të jetës materiale dhe ndërgjegjes së njerëzve, të ekonomisë e të politikës, për të kuptuar e zgjidhur drejt kontradiktat e problemet që shtron zhvillimi i jetës së vendit.

Kjo arrihet vetëm atëherë kur nuk mësohen përmendsh disa formula e teza, por kur zotërohen parimet themelore, metodologjia marksiste-leniniste, kur përvetësohet mënyra materialiste-dialektike e interpre-

timit të fenomeneve dhe e zgjidhjes së çështjeve, kur luftohet si kundër qëndrimeve dogmatike, ashtu edhe kundër pikëpamjeve subjektiviste.

Marksizëm-leninizmi është një teori gjer në fund revolucionare. Duke ndriçuar problemet e reja që nxjerr jeta, ai zhvillohet në luftë me pikëpamjet e kundërshtarëve të tij ideologjikë. Vetëm në procesin e kësaj lufte ai mund të përvetësohet thellë, mund të rrënjosen ide të gjalla marksiste-leniniste dhe mund të shndërrohen ato në bindje të ndërgjegjshme dhe luftarake. Ballafaqimi i pikëpamjeve dhe debati duhet të përdoren gjerësisht edhe në gjirin e Partisë e të gjithë shoqërisë, në luftë me çdo shfaqje të konformizmit dhe me prirjet për mbulimin e kontradiktave. Vetëm në këtë rrugë mund të hidhen bazat e një imuniteti aktiv ndaj ideologjisë së huaj, mund të realizohet një edukim i vërtetë revolucionar.

Por në metodat tona të edukimit ka rutinë e struktura të vjetra pune që e pengojnë realizimin e këtyre qëllimeve. Në shtypin dhe botimet tona, në radio, në leksionet e konferencat e ndryshme që zhvillohen ka akoma shumë formalizëm e zyrtarizëm. Në to nuk ndihet siç duhet fryma e ballafaqimit të mendimeve dhe nuk përdoret gjerësisht metoda e debatit, përdoren metoda standarde e të konsumuara, ka pak krijimtari. Metoda të tilla pengojnë propagandimin e frytshëm dhe përvetësimin krijues të marksizëm-leninizmit dhe të politikës së Partisë. Prandaj lufta jonë kundër tyre duhet të jetë shumë më e vendosur. Të mos ngurrojmë që të heqim dorë me guxim nga të gjitha ato forma të vjetruara pune që nuk u përgjigjen më nivelit të

sotëm të zhvillimit politik, ideologjik e kulturor të njerëzve tanë, kërkesave që kanë lindur mbi bazën e këtij niveli, nevojës për ta ngritur atë gjithnjë e më lart.

T'i vëmë gjithnjë më mirë arsimin, kulturën dhe artin në shërbim të socializmit e të popullit

Gjatë periudhës së fundit është zhvilluar një punë kolosale për të revolucionarizuar më tej arsimin e kulturën, letërsinë e artet, për t'i vënë ato gjithnjë e më mirë në shërbim të çështjes së socializmit e të popullit.

Revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës është një ndër aksionet më të mëdha që ka ndërmarrë Partia. Diskutimi i gjerë popullor që u zhvillua për këtë çështje kontribuoi shumë në luftimin e koncepteve e të ndikimeve borgjeze e revizioniste dhe në përpunimin e koncepteve marksiste-leniniste për shkollën. Tani po luftohet frontalisht për t'i zbatuar orientimet e Partisë në këtë fushë dhe jeta po vërteton çdo ditë drejtësinë e tyre. Programet e reja mësimore po zbatohen me sukses. Një punë e madhe, në të cilën janë aktivizuar mijëra arsimtarë e pedagogë, po bëhet për hartimin e teksteve të reja shkollore. Po punohet, gjithashtu, për revolucionarizimin e strukturave, të metodave e të formave mësimore dhe edukative. Këto masa synojnë realizimin e boshtit ideologjik marksist-leninist në të gjithë punën mësimore-edukative të shkollës, zbatimin në unitet të komponentëve themelorë të saj, mësimin, punës prodhuese dhe edukimit fizik e ushtarak, lidh-

jen e saj të ngushtë e të gjithanshme me praktikën revolucionare.

Masat për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës prekin në themel të gjithë jetën e saj. Krahas zhvillimit të mëtejshëm në gjerësi të arsimit, vëmendjen e Partisë e tërhoqi në mënyrë të veçantë zhvillimi në thellësi i tij, forcimi i gjithanshëm i përmbajtjes socialiste të shkollës. Sigurisht, edhe në të ardhmen do të kemi zgjerim dhe masivizim të mëtejshëm të shkollës në rrugë të shumëllojta, sidomos në arsimin e mesëm e të lartë. Por çështjet e përmbajtjes mbeten gjithnjë më themeloret. Prandaj zbatimi i plotë e me ritme sa më të shpejta i detyrave që kemi shtruar, përpunimi i mëtejshëm teorik, mbi bazën e përvojës praktike, i çështjeve ideologjike, shkencore e pedagogjike, të brendisë së punës mësimore-edukative, sidomos të programeve dhe teksteve shkollore, përbën preokupacionin tonë kryesor.

Tani që përfundoi shtrirja dhe zgjerimi i shkollës 8-vjeçare në të gjithë vendin del akoma më e mprehtë nevoja e konsolidimit dhe e forcimit të gjithanshëm cilësor të saj. Kjo është një premisë themelore për një nivel e cilësi më të lartë pune në të gjitha kategoritë e shkollave. Para shkollës sonë qëndron sot detyra e rëndësishme e modernizimit shkencor-pedagogjik të të gjithë procesit të mësimin, të brendisë dhe të metodës së tij. Ajo nuk mund të realizohet pa pasqyruar në mësim në mënyrë të përshtatshme proceset aktuale dhe prirjet e zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor, pa u thelluar në studimin e shkencës dhe të teknikës moderne, pa përdorur metoda pedagogjike moderne. Për

këtë kërkohet të bëhen ndryshime të rëndësishme dhe më të shpejta jo vetëm në programe e tekste, por sidomos në bazën mësimore-didaktike, në futjen graduale të teknikës moderne në mësim, në kualifikimin e mësuesve, në sigurimin e literaturës për nxënës e pedagogë, në rritjen e kërkesave ndaj tyre. Një problem i dorës së parë është përdorimi i metodave aktive që stimulojnë punën e pavarur të nxënësve e të studentëve, si edhe zhvillimin e aftësive, të prirjeve e të talenteve të tyre.

Në shkollën tonë socialiste ngritja e nivelit shkencor dhe metodik të dhënies së mësimin po realizohet edhe si lidhje e ngushtë e teorisë me praktikën e me punën prodhuese. Me gjithë problemet e ndërlikuara organizative e pedagogjike, pjesëmarrja e rinisë shkollore dhe e studentëve në punë prodhuese në fabrika e kooperativa, në aksione lokale e kombëtare po realizohet me sukses. Por akoma ka mjaft vështirësi që rrjedhin nga moskuptimet dhe pengesat që dalin në organizimin e zbatimin praktik të saj, si nga drejtuesit e shkollave, ashtu dhe nga ata të ndërmarrjeve ekonomike.

Një kujdes i veçantë duhet treguar edhe për zbatimin e programeve të përgatitjes ushtarake të rinisë si një komponent tjetër tepër i rëndësishëm i shkollës sonë të re. Kjo përgatitje duhet bërë me tërë seriozitetin e saj, në përshtatje me moshën, duke luftuar çdo shfaqje të nënvlerësimit të kësaj detyre që ka të bëjë me forcimin e mbrojtjes së lirisë e të pavarësisë së atdheut.

Është e kuptueshme se lufta për revolucionarizimin

e shkollës kërkon ngritjen e gjithë punës në një nivel më shkencor. Pa iu futur seriozisht studimeve, pa zhvilluar shkencat pedagogjike nuk mund të plotësohen me sukses gjithë detyrat që qëndrojnë përpara shkollës sonë.

Programet e reja të edukimit fizik e ushtarak në shkolla, të cilat po vihen në jetë me sukses, dhanë shkas për një gjallërim të mëtejshëm të kulturës fizike e të sportit. Megjithëkëtë ky është një sektor akoma i prapambetur i punës sonë. Parimet e përcaktuara, sipas të cilave themelore është lëvizja masive fizikulturale, kultura e përgjithshme fizike dhe sportet bazë që e sigurojnë atë, nuk po zbatohen në mënyrë konsekuente dhe në praktikë ka shumë njëanshmëri. Lëvizja fizikulturale e rinisë dhe e masave është e kufizuar dhe nuk është në qendër të vëmendjes të organeve të Partisë e të pushtetit, të arsimit e të fizikulturës, të rinisë e të bashkimeve profesionale. Kryesore këtu nuk janë pengesat e mungesat materiale, megjithëse edhe të tilla ka dhe ato mund të zgjidhen. Themelore është të luftohen konceptet e shtrembra që shprehen në nënvlerësimin e lëvizjes masive fizikulturale dhe të sporteve bazë. Për ne që duam një rini e popull të fortë, të shëndetshëm e të kalitur, është e domosdoshme të bëjmë kthesë edhe në këtë fushë dhe ta shtrojmë këtë si një detyrë të rëndësishme partie.

Më shumë duhet të kujdesemi edhe për jetën e rinisë e të punonjësve, për kulturën e tyre të gjithanshme, për çlodhjen e dëfrimin e tyre, për lojnat, për bazat sportive, për botimin e librave, lëvizjen artistike etj. Harmonizimi më i mirë i punës së shkollës me

gjithë sistemin e edukatës jashtëshkollore dhe të kulturës masive, si edhe formimi i një koncepti të drejtë për gjerësinë e brendisë dhe të mjeteve të punës kulturore, janë një problem shumë i rëndësishëm e aktual. Botimi dhe përhapja në ç'gjerë ç'librit, zgjerimi dhe shtrirja e qendrave kulturore e artistike në të gjithë vendin, rritja e madhe e lëvizjes artistike amatore, tani së fundi ngritja e televizionit, si edhe revolucionarizimi i brendisë së gjithë kësaj pune janë tregues të rëndësishëm të hopit sasior e cilësor të saj. Në këtë lëmë ne jemi angazhuar në një luftë intensive për theksimin e tipareve socialiste të kulturës sonë dhe për shkallmimin e ndikimeve të huaja e të vjetruara. Por kërkesat gjithnjë në rritje të masave për kulturë janë shumë të mëdha dhe plotësimi i tyre nuk ecën me ritmin e duhur. Mjetet e shumëllojshme të kulturës masive nuk kanë depërtuar akoma siç duhet brenda në familje dhe nuk janë vënë akoma në shkallë të gjerë në përdorim të përditshëm të individit në punë dhe në kohën e lirë. Prandaj, në shumë raste, njohuritë e fituara në shkollë nuk plotësohen, nuk zhvillohen e nuk përforcohen. Detyra jonë është të marrim masa për të mos lejuar thellimin e mëtejshëm të kësaj kontradikte.

Jeta jonë socialiste është e duhet të jetë kulturë. Kjo do të thotë se, krahas shkollës, librit, veprimtarisë artistike etj., e tërë jeta dhe prodhimi, edhe mënyra e jetesës dhe e sjelljes, edhe krijimi i ambienteve në uzinë, në shkollë ose në fshat, edhe mënyra se si ne i ndërtojmë e i rregullojmë qytetet e fshatrat tona, arkitektura dhe urbanistika jonë, mirëmbajtja e rrugëve, edhe mënyra se si i shërbehet popullit, të

gjitha, çdo gjë te ne, duhet t'i shërbejnë formimit kulturor të njeriut të ri. Qëllon që ka kuptime të ngushta ose nënvlerësime për njërën dhe tjetrën fushë të kulturës. Sidomos më pak tregohet vëmendje për kulturën e jetës. Tërë kujdesi përqendrohet në çështjet e prodhimit dhe kjo është e kuptueshme, por duhet më shumë vëmendje edhe për kushtet e punës, për çlodhjen dhe kohën e lirë të punonjësve, për shfrytëzimin racional të të gjitha mjeteve të informacionit e të komunikimit social nga ana e tyre, për zhvillimin e gjithanshëm kulturor të tyre.

Në luftë për kapërcimin e këtyre dobësive është e domosdoshme të rritet interesimi i gjithanshëm shtetëror e shoqëror për punën edukuese kulturore, për përsosjen e metodës së kësaj pune, për shfrytëzimin e plotë racional të mjeteve ekzistuese, si edhe për krijimin e mundësive e sigurimin e mjeteve të nevojshme materiale.

Të ndjeshme dhe me një vlerë të çmuar edukuese janë rezultatet e viteve të fundit edhe në zhvillimin e letërsisë e të arteve. Lufta heroike e Partisë dhe e popullit kundër bllokadës imperialiste e revizioniste, revolucionarizimi i gjithanshëm i jetës së vendit, kërkesat e Partisë për një kulturë militante me frymë revolucionare aktuale dhe kombëtare, si edhe kuptimi e qëndrimi më i drejtë ndaj botimeve e repertorëve nga letërsia dhe arti i huaj, i dhanë nxitje të fuqishme zhvillimit të letërsisë dhe artit tonë. Ata fituan pjekuri më të madhe ideopolitike dhe nivel më të lartë artistik. Si kurrë ndonjëherë është rritur krijimtaria artistike dhe janë zhvilluar me sukses të gjitha gjinitë e artit e

të letërsisë, si proza ashtu edhe poezia, si muzika ashtu edhe artet figurative, teatri, kinematografia etj. Talenteve të njohura iu shtuan e po u shtohen çdo ditë talente të reja. Krahas ngritjes cilësore të krijimtarisë profesioniste, shpërtheu një hov i paparë i krijimtarisë popullore dhe i lëvizjes artistike amatore. Arti ynë socialist po ecën kështu i fuqishëm me të dyja këmbët. Duke ndjekur në mënyrë konsekuente parimet e realizmit socialist, në të ardhmen, letërsia dhe arti ynë revolucionar do të njohin me siguri zhvillime të reja, edhe më të mëdha.

Partia, në krye të masave, lufton me këmbëngulje për afirmimin e asaj që është socialiste dhe për heqjen e çdo pengese që frenon ecjen tonë përpara, ajo zbulon me guxim kontradiktat dhe lufton për kapërcimin e tyre, kritikon të metat dhe nuk e humbet kurrë perspektivën, kryen përditë atë proces të njohur të ndërtimit të së resë dhe të shkatërrimit të së vjetrës, transformon jetën e njerëzve, formon njeriun e ri. Këto qëllime duhet të kenë kurdoherë parasysh edhe letërsia e arti ynë, këtë vulë të mbajnë edhe ato. Pasqyrimi i realitetit të ri socialist në zhvillimin e tij revolucionar dhe me kontradiktat e kohës, që i japin letërsisë dhe artit dramaticitetin dhe konfliktet e nevojshme — këtu qëndron përmbajtja e re që i jep forcën letërsisë e artit tonë të realizmit socialist. Dhe një përmbajtje e tillë patjetër çon edhe në kërkime e në gjetje formash të reja. Të gjitha këto, si edhe mbështetja fort në truallin kombëtar, në krijimtarinë e trashëgiminë kulturore përparimtare të popullit tonë, i japin letërsisë dhe artit socialist atë origjinalitet dhe atë novato-

rizëm që e dallojnë nga të tjerët, jo vetëm si krijimtari e një populli dhe e një kombi të caktuar, por edhe për tiparet që fiton kjo krijimtari përmes kushteve të luftës kundër imperializmit e revizionizmit modern dhe për revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit.

Pikërisht karakterin militant revolucionar të letërsisë dhe të artit mohojnë revizionistët. Pasi i shpallën «të ngushtë» ose i hodhën poshtë realizmin socialist si metodë krijuese dhe parimin e partishmërisë proletare, ata u hapën portën rrymave më të ndryshme reaksionare dhe dekadente, të cilat çuan në degjenerimin e letërsisë dhe të artit, duke i kthyer ato në mjete avanguardiste për restaurimin kapitalist. Kur arti mbart idetë dhe synimet e kundërrevolucionit, kur ai bëhet zëdhënës i elementëve ose i shtresave të burokratizuara e të borgjezuar, kur u kundërvihet aspiratave dhe luftës së masave, ai nuk mund të jetë kurrë art i vërtetë.

Lulëzimi i mëtejshëm i artit të realizmit socialist do të arrihet duke përforcuar pozitën e fituara në luftë me çdo ndikim të huaj, që nuk pajtohet me ideologjinë tonë socialiste, në luftë si me modernizmin, ashtu edhe me konservatorizmin, duke i pasqyruar akoma më thellë nga ana ideoartistike jetën dhe luftën e gjithanshme të popullit për ndërtimin e socializmit, duke vënë në qendër të krijimtarisë heronjtë e kohës sonë, duke forcuar partishmërinë proletare dhe karakterin popullor të artit tonë, në luftë me çdo ndikim të objektivizmit borgjez dhe të humanizmit abstrakt, duke e rritur pa ndërprerje rolin edukues të letërsisë dhe të arteve.

Të zgjerojmë punën shkencore, të ngremë nivelin e organizimit e të drejtimit të saj

Ka ardhur koha që t'u kushtojmë një kujdes shumë më të madh se gjer tani zgjerimit dhe zhvillimit të kërkimeve e të veprimtarisë shkencore, organizimit e drejtimit të tyre. Kjo nevojë diktohet si nga rëndësia e madhe e shkencës në epokën e tanishme, ashtu edhe nga kushtet objektive e detyrat e zhvillimit të vendit tonë në etapën që kalojmë. Shkenca është bërë sot një faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e prodhimit dhe të gjithë sektorëve të tjerë të veprimtarisë shoqërore. Ajo është shndërruar në një forcë të drejtpërdrejtë prodhuese, nga rezultatet e së cilës varet në një masë shumë të madhe rritja e fuqisë ekonomike të vendit. Përparimet e shkencës së sotme janë kolosale dhe çdo neglizhencë në këtë fushë do të pasqyrohet negativisht në ritmin e përgjithshëm të ndërtimit të vendit. Zhvillimi gjithnjë e më intensiv i ekonomisë e i kulturës mund të thellohet më tej vetëm duke u mbështetur në shkencën e teknikën moderne, duke nxitur revolucionin tekniko-shkencor. Në stadin që ka arritur tani vendi ynë në asnjë fushë nuk mund të ecet përpara me shpejtësi pa studime të thella shkencore aktuale e perspektive, të cilat sqarojnë objektivat që duam të arrijmë dhe rrugët për realizimin e tyre. Kjo kërkese për ngritjen e drejtimit të të gjitha punëve në një nivel gjithnjë e më të lartë shkencor mund të realizohet me sukses në qoftë se do të

mbështetemi fuqimisht në shkencën dhe do të shfrytëzojmë intensivisht rezultatet e saj.

Detyrat e reja në fushën e shkencës ne i shtrojmë duke u mbështetur edhe në mundësitë e rezultatet tona. Baza materialo-teknike e ekonomisë po përsoset e modernizohet gjithnjë. Niveli arsimor e kulturor i masave po ngrihet pareshtur. Është krijuar tashmë sistemi i shkollave të larta, si dhe i disa institutëve të posaçme ku kryhet një punë e organizuar shkencore. Vitet e fundit është zhvilluar një lëvizje e gjerë për eksperimentimin shkencor masiv. Si rezultat i saj janë bashkuar përpjekjet e punonjësve shkencorë e të gjithë inteligjencies krijuese me ato të masave. Mbi këto baza janë zgjidhur mjaft probleme të rëndësishme dhe jetike për vendin, për ekonominë dhe kulturën. Detyra jonë është që këto suksese t'i përforcojmë dhe ta çojmë këtë punë përpara pa ndërprerje.

Për t'ia arritur këtij qëllimi është e domosdoshme të hidhen poshtë të gjitha ato koncepte vulgare e primitive që e nënvlerësojnë rolin e shkencës, të institucioneve e të punonjësve shkencorë, të cilat e kanë burimin në mungesën e përvojës së mjaftueshme në këtë fushë dhe në moskuptimin e thellë të rolit të madh që përgjithësisht luan sot shkenca. Në të njëjtën kohë ne duhet të thellojmë luftën që po zhvillohet kundër të gjitha koncepteve intelektualiste, të cilat synojnë ta mbyllin hermetikisht punën shkencore, t'i japin asaj një karakter akademik të shkëputur nga praktika prodhuese revolucionare e masave punonjëse, të nënvlerësojnë rolin e masave në zhvillimin

e eksperimentimit shkencor dhe të shkencës në përgjithësi.

Duke u nisur nga koncepte të drejta, ne do të mund të kapërcejmë atë prapambetje relative që vihet re sot në fushën e studimeve e të kërkimeve shkencore në krahasim me synimet e objektivat e caktuar për zhvillimin e shpejtë dhe intensiv të ekonomisë e të kulturës socialiste. Në këtë mënyrë do të mund të njohim, të zotërojmë dhe të zbatojmë më mirë rezultatet e përparuara të shkencës e të teknikës botërore në prodhim e në kërkimet shkencore. Kështu do të shpejtohet ritmi i luftës për të kaluar nga konceptet dhe metodat e ngushta artizanale të organizimit e të drejtimit të prodhimit në koncepte e metoda moderne industriale.

Në periudhën e ardhshme është e domosdoshme t'u japim prioritet dhe t'u kushtojmë më shumë kujdes, mjete e forca atyre degëve të shkencës që janë më vendimtare për përparimin e gjithanshëm të vendit si sot ashtu edhe në perspektivë, që i paraprijnë këtij përparimi. Në këtë vështrim, në organizimin e përgjithshëm të punës shkencore vendin e parë duhet ta kenë shkencat e ndryshme teknike dhe bujqësore, që lidhen drejtpërsëdrejti me zhvillimin intensiv të degëve kryesore të ekonomisë. Sidomos ngritja e një bujqësie moderne kërkon studime të organizuara e komplekse, jo vetëm nga specialistët e bujqësisë, por edhe nga punonjësit e shkencave biologjike, kimike, fizike, mekanike etj.

Në të njëjtën kohë do të ecin përpara edhe kërkimet në lëmin e shkencave ekonomike e shoqërore.

Një vëmendje të posaçme kërkojnë studimet për përsosjen e marrëdhënieve socialiste në prodhim, si edhe për problemet e tjera të zhvillimit të ekonomisë. Vitet e fundit janë masivizuar mjaft studimet për rrugët e zhvillimit të revolucionit tonë e përvojën e tij në fusha të ndryshme, si edhe për probleme të shumta sociologjike, të cilat e kanë gjallëruar e pasuruar mendimin tonë teorik marksist-leninist dhe kanë krijuar premisa për një organizim më të shëndoshë të të gjithë kësaj veprimtarie. Krahas kësaj, në shkencat që merren me studimin e historisë së popullit tonë, të kulturës së tij materiale e shpirtërore, traditat tashmë të krijuara janë konsoliduar dhe janë hapur horizonte të reja për intensifikimin e këtyre studimeve dhe thellimin e tyre në problemet më themelore të së kaluarës dhe në problemet më të mprehta të aktualitetit.

Këto detyra që na shtrohen në lëmin e shkencës kërkojnë një përmirësim rrënjësor të organizimit e të drejtimit të tërë punës shkencore në të gjitha nivelet e në të gjitha fushat, që nga planifikimi i zhvillimit e gjer te zbatimi i organizuar i rezultateve dhe i rekomandimeve të saj në praktikë. Duke punuar për forcimin e qendrave studimore të bazës, të byrove teknike, teknologjike e projektuese, të parcelave eksperimentale, të laboratorëve të ndryshëm, të rretheve e të komisioneve shkencore, si mjete të rëndësishme të masivizimit të mëtejshëm të punës shkencore, në të njëjtën kohë, shkallë-shkallë duhet të ecim më shpejt në rritjen dhe në fuqizimin e institucioneve të posaçme shkencore ekzistuese, si dhe në krijimin e institu-

cioneve të reja të nevojshme, duke marrë njëkohësisht masa për një organizim dhe drejtim më të koordinuar e të përqendruar të të gjithë punës e të jetës shkencore në shkallë republike, në përshtatje me mundësitë e sotme dhe detyrat perspektive.

Një zhvillim i tillë i shkencës kuptohet se kërkon edhe zgjerimin gradual të bazës së nevojshme materiale për këtë punë. Akoma më i ngutshëm është problemi i përgatitjes dhe i specializimit të kuadrit. Ky specializim duhet të jetë i gjithanshëm dhe i shumëllojshëm. Ai pjesërisht duhet të fillojë që në shkollën e lartë, të thellohet në punë, të realizohet nëpërmjet studimeve pasuniversitare, nëpërmjet zgjidhjes së detyrave të ndryshme shkencore dhe, kur është e domosdoshme, të bëhet edhe jashtë vendit. Zvarritjet dhe neglizhencat në zgjidhjen e këtij problemi sjellin pasoja negative në të ardhmen.

Organet e Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë duhet të përkrahin e të mbështetin më aktivisht mendimin shkencor të specialistëve e të punonjësve tanë, të vlerësojnë çdo përvojë pozitive dhe të inkurajojnë çdo propozim të vlefshëm, duke i hapur rrugë me guxim së resë, duke hequr dorë nga rutina dhe mënyra e vjetër e punës, duke u çelur shtigje energjive të vrullshme krijuese dhe shpirtit novator të njerëzve tanë.

TË FORCOJMË E TË REVOLUCIONARIZOJMË PARESHTUR PARTINË

E ndërgjegjshme për misionin e vet historik si udhëheqëse e luftës së gjithë popullit për socializëm, në Kongresin e 5-të Partia shtroi detyra të rëndësishme për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës e të veprimtarisë së saj. Për këtë qëllim Komiteti Qendror ka marrë një sërë masash konkrete për edukimin dhe kalitjen politike e ideologjike të komunistëve e të kuadrove, për kuptimin e drejtë dhe zbatimin revolucionar të parimeve e të normave të Partisë, për forcimin e karakterit proletar të radhëve të saj e të organeve udhëheqëse, për thellimin e mëtejshëm të vijës së masave në veprimtarinë e Partisë.

Partia vjen në këtë Kongres më e fortë se kurrë, me një unitet të çeliktë marksist-leninist të radhëve të saj, e lidhur ngushtë si mishi me kockën me klasën punëtore dhe me masat punonjëse, e gatshme për të marrë përsipër detyra edhe më të mëdha dhe e vendosur për t'i realizuar ato me nder si gjithnjë.

Pa një parti revolucionare të klasës punëtore, besnike të marksizëm-leninizmit, të organizuar dhe në gjendje të udhëheqë e të mobilizojë masat punonjë-

se, nuk mund të mendohet as për fitoren e proletariatit mbi borgjezinë, as për ndërtimin me sukses të socializmit. Pikërisht sepse e kemi mbajtur gjithnjë parasysh këtë parim dhe i kemi qëndruar kurdoherë besnikë, te ne nuk ndodhi ai proces regresiv që ndodhi në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera, ku lindja e revizionizmit dhe rivendosja e kapitalizmit filloi me degjenerimin e partisë, me ndryshimin e karakterit klasor, me humbjen e cilësive dhe të frymës së saj revolucionare. Pikërisht sepse ndoqëm me konsekuencë mësimet leniniste për partinë dhe luftuam vazhdimisht për kalitjen dhe revolucionarizimin e saj të pandërprerë, te ne diktatura e proletariatit qëndron e çeliktë dhe e pamposhtur, socializmi marshon përpara gjithnjë fitimtar.

Partia e Punës e Shqipërisë është një Parti e fortë dhe e organizuar, e sprovuar në beteja, një Parti e pastër ideologjikisht e politikisht, e vendosur dhe e aftë për të çuar përpara me sukses kauzën e klasës punëtore. Ne jemi krenarë për Partinë tonë heroike, për luftën e fitoret e saj, për guximin, qartësinë e vitalitetin e saj. Por nuk duhet të harrojmë kurrë se lufta e klasave vazhdon si brenda ashtu edhe jashtë vendit, se ekziston presioni i ideologjisë borgjeze e revizioniste. Ne duhet t'i kushtojmë gjithë kujdesin, përpjekjet dhe aftësitë tona punës për forcimin e vazhdueshëm të Partisë, për edukimin e saj revolucionar, për rritjen e rolit të saj udhëheqës në të gjithë jetën e vendit.

Kjo bëhet akoma më e domosdoshme po të kemi parasysh detyrat madhështore, shumë të rëndësishme

që shtron ky Kongres përpara Partisë e gjithë popullit. Realizimi me sukses i këtyre detyrave, zhvillimi i hovshëm i gjithë ekonomisë, transformimet në gjithë jetën e vendit, kërkojnë angazhimin total të energjive mendore e fizike të të gjithë komunistëve e kuadrove, kërkojnë ngritjen e gjithë punës së Partisë në një nivel më të lartë.

Roli udhëheqës i Partisë sigurohet nëpërmjet veprimtarisë së gjithë komunistëve dhe shembullit të tyre pararojë

Partia jonë i përmbahet parimit marksist-leninist se me zhvillimin e konsolidimin e socializmit roli udhëheqës i Partisë jo vetëm nuk vjen duke u dobësuar, por përkundrazi forcohet e përsoset gjithnjë e më shumë. Kjo diktohet nga fakti se procesi i ndërtimit socialist zgjerohet e bëhet gjithnjë e më kompleks. Në këtë proces roli udhëheqës i klasës punëtore rritet vazhdimisht. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e masave në ndërtimin socialist të vendit, në gjithë jetën shoqërore, ekonomike e shtetërore bëhet gjithnjë e më aktive. Të gjitha këto bëjnë të domosdoshme ngritjen në një shkallë më të lartë të rolit drejtues, edukues, organizues e mobilizues të Partisë, e cila me ideologjinë e vet qartëson objektivat dhe ndriçon rrugën për arritjen e tyre.

Në vendin tonë roli udhëheqës i Partisë në të gjithë jetën e vendit ka qenë dhe është i padiskutueshëm. Të gjitha fitoret historike që ka arritur populli

ynë në këta 30 vjet, çlirimi i atdheut, vendosja e pushetit popullor, ndërtimi i shoqërisë së re socialiste janë të lidhura në mënyrë të pandarë me Partinë dhe udhëheqjen e saj të urtë e largpamëse.

Forcimi dhe përsosja e rolit udhëheqës të Partisë është një detyrë e përhershme dhe jetike. Kuptimi i thellë dhe sidomos zbatimi i tij i drejtë në praktikë kanë rëndësi të veçantë.

Roli udhëheqës i Partisë, si forca drejtuese e gjithë jetës së vendit, shtrihet në të gjitha fushat — ideologjike, politike, organizative, ekonomike, arsimore, ushtarake etj. Këta sektorë të jetës së vendit, që përbëjnë të gjithë së bashku një të tërë, Partia i drejton nëpërmjet gjithë anëtarëve të saj, kudo ku punojnë, qoftë në aparatet e Partisë ose të pushtetit, në organizatat e masave, në prodhim ose në institucionet shkencore-kulturore.

Puna e komunistëve të çdo sektori ka specifikën e vet, por ajo ka edhe një gjë të përbashkët, çdo komunist atje ku punon duhet të luftojë për zbatimin e vijës së Partisë dhe sigurimin e rolit udhëheqës të saj. Mjaft nga të metat e dobësitë që vihen re në punën tonë i kanë rrënjët në ngatërrimin e asaj çka është specifike dhe çka është e përbashkët.

Komunistët që punojnë në organet e Partisë duhet t'i njohin problemet ekonomike, të bujqësisë e të industrisë, problemet e arsimit, të kulturës e të ushtrisë pavarësisht se me ato merren drejtpërdrejt shokët që punojnë në aparatet përkatëse shtetërore. Të gjitha problemet, natyrisht jo në hollësi, duhet t'i dinë shokët e organeve drejtuese të Partisë, sepse pa këtë

ata nuk mund të orientojnë drejt organet shtetërore dhe ekonomike për kryerjen e detyrave dhe organizatat e Partisë për mobilizimin e masave.

Kur themi që organet dhe aparatet e Partisë duhet t'i njohin të gjitha problemet e jetës së vendit e të merren me to, këtë duhet ta bëjnë duke i parë këto në specifikën e punës së Partisë, pa u futur në vogëlima teknike e materiale të çështjeve të ditës dhe pa dubluar punën e organeve shtetërore dhe ekonomike. Themelore në punën e tyre është edukimi e mobilizimi i komunistëve dhe i masave që punojnë në sektorë të ndryshëm për të realizuar gjer në fund detyrat e ngarkuara, është vënia në pozita luftarake e organizatave të Partisë dhe nëpërmjet tyre e të gjithë organizmave të tjerë shtetërorë, ekonomikë e shoqërorë për zbatimin kudo e me konsekuencë të politikës së Partisë.

Komunistët e kuadrot e ngarkuar nga Partia të punojnë në organet shtetërore dhe ekonomike, edhe pse mund të jenë teknikë e specialistë, në radhë të parë janë njerëz politikë. Duke u marrë me drejtimin shtetëror të çështjeve, me organizimin e prodhimit, me sigurimin e masave tekniko-ekonomike për realizimin e planit, që përbën për ta detyrën kryesore, nuk i shohin dhe nuk duhet t'i shohin këto me syrin e teknokratit. Si komunistë, që përgjigjen përpara Partisë për zbatimin e vijës së saj në sektorin e tyre, ata duhet të punojnë pa u lodhur për kuptimin politik e ideologjik të detyrave nga punonjësit, për organizimin e mobilizimin e plotë të tyre.

Kështu realizohet në praktikë roli udhëheqës i Partisë në të gjithë jetën e vendit, kështu Partia drej-

ton në bllok, në mënyrë të organizuar e të centralizuar.

Roli udhëheqës i Partisë nuk arrihet as me dekrete, as imponohet me masa administrative. Ai fitohet me vijën e saj të drejtë që shpreh e mbron interesat jetikë të klasës punëtore e të gjithë punonjësve dhe me luftën e saj të vendosur për zbatimin e kësaj vije në jetë. Ky rol sigurohet nëpërmjet veprimtarisë revolucionare të çdo komunisti, i cili me shembullin e aksionin e tij i frymëzon, i edukon dhe i mobilizon masat në luftën për socializëm. Partia përbëhet nga anëtarët e saj dhe roli pararojë i Partisë nuk mund të kuptohet e të realizohet pa rolin pararojë të çdo komunisti.

Por a janë të gjithë komunistët në pozitat pararojë të Partisë? Këtë pyetje duhet t'ia bëjë gjithnjë vetes çdo anëtar i Partisë, kjo çështje duhet të shqetësojë çdo organizatë partie. Është fakt se në radhët tona gjenden edhe të tillë anëtarë partie, megjithëse të paktë, që janë të mefshtë e pa iniciativë, që kanë koncepte të prapambetura në punë e në jetë, që jo vetëm nuk janë shembull e në pararojë, por shpesh qëndrojnë në bisht të masave, ashtu siç ka edhe të tillë që zhvillimi i vrullshëm i jetës sonë i ka lënë prapa.

Njerëz të tillë stonojnë midis masës dërrmuese të anëtarëve të Partisë sonë të lavdishme, të cilët kanë mbajtur e mbajnë mbi supe barrë të rënda, kanë kryer e kryejnë vepra të mëdha, kanë luftuar e luftojnë me heroizëm e vetëmohim për përparimin e gjithanshëm të atdheut socialist, kanë qëndruar e qëndrojnë me meritë në ballë të masave dhe kanë pasur e kanë respektin e besimin e pakufishëm të tyre.

Partia duhet të punojë, që edhe komunistët që

kanë mbetur prapa t'i edukojë, t'i vërë në pozita luftarake, që të ecin me hapin e kohës e të revolucionit, që të mund ta meritojnë e ta mbajnë titullin e anëtarit të Partisë sonë heroike.

Në vendin tonë tërë atmosfera është e tillë që i shtyn njerëzit përrpara. Te ne çdo gjë është në lëvizje, në zhvillim. Jeta jonë është e gjallë, dinamike, që nuk duron qetësinë e rutinën, të cilat i bëjnë njerëzit të ngecin në vend. Një nga detyrat më të rëndësishme të organizatave të Partisë është të gjejnë rrugët, metodat dhe atë stil revolucionar pune, që tërë komunistët t'i vënë në pozita pararojë, t'i hedhin në luftë, në aksione, që me shembullin e tyre të tërheqin pas vetes të gjitha masat punonjëse.

Hallka themelore e vendimtare, që siguron rolin udhëheqës të Partisë në çdo qelizë të jetës sonë, është organizata-bazë. Nëpërmjet saj zërthehen e zbatohen në jetë të gjitha udhëzimet e direktivat e Partisë, sigurohen lidhjet e drejtpërdrejta të Partisë me masat dhe kryhet mobilizimi i tyre për arritjen e objektivave të caktuar, ushtrohet kontrolli mbi veprimtarinë e çdo komunisti, pavarësisht nga vendi ku punon e posti që mban.

Që të luajnë rolin e tyre udhëheqës, frymëzues e organizues në sektorët ku veprojnë, organizatat-bazë të Partisë duhet të thellohen në problemet kryesore e të mos mbyten në gjërat e vogla të ditës, të nxitin e të vënë në lëvizje të gjitha organizatat e të mos shndërrohen në leva të organeve ekonomike e shtetërore, të mos interesohen vetëm për shifrat e planit, por në radhë të parë për zbatimin e politikës së Partisë në çdo

pushë. Ato duhet të luftojnë burokratizmin, indiferentizmin e çdo shfaqje të huaj dhe të forcojnë sidomos punën e tyre me njerëzit, sepse janë këta që vënë në jetë direktivat e Partisë dhe planet e shtetit.

Përbërja proletare dhe cilësia e komunistëve — kusht themelor që Partia të mbetet gjithnjë revolucionare

Partia, si një organizëm i gjallë politik, rritet e forcohet në luftë e revolucion, pasqyron në gjirin e saj ndryshimet që bëhen në sferën ekonomiko-shoqërore, në strukturën klasore dhe në jetën shpirtërore të shoqërisë.

Ky është një proces i pandërprerë, por jo spontan. Ai organizohet e drejtohet në mënyrë të ndërgjegjshme nga vetë Partia në përshtatje me etapat e revolucionit dhe me detyrat që ka për të zgjidhur, duke u mbështetur kurdoherë në mësimet e marksizëm-leninizmit.

Gjatë këtyre pesë vjetëve të fundit, në sajë të punës së madhe e të gjithanshme politike, ideologjike e organizative për revolucionarizimin e mëtejshëm të të gjithë jetës së vendit dhe të vetes së saj, në Parti janë bërë ndryshime të rëndësishme sasiore e cilësore.

Për këtë flet qartë rritja e ndjeshme e efektivitetit të Partisë dhe sidomos përmirësimi i përbërjes klasore të radhëve të saj. Më 1 tetor 1971 në Parti milionin 86 985 komunistë, prej të cilëve 18 127 kandidatë, nga 66 327 komunistë që ishin në kohën e Kongresit të

5-të të Partisë. Kështu gjatë kësaj periudhe Partia është rritur me 20 658 komunistë.

Është një gëzim e fitore e madhe për Partinë dhe gjithë popullin që tani, për herë të parë në historinë e Partisë sonë, komunistët punëtorë zënë vendin e parë në efektivin e Partisë. Ata përbëjnë sot 36,41 për qind të të gjithë komunistëve.

Ky fakt dëshmon për dashurinë e madhe të klasës punëtore për Partinë e saj marksiste-leniniste dhe për besimin e pakufishëm ndaj saj. Ai dëshmon për vijën e drejtë organizative, të ndjekur me këmbëngulje e konsekuencë nga Partia, e cila i është përmbajtur me vendosmëri parimit se partia e klasës punëtore duhet të jetë proletare jo vetëm nga ideologjia, por edhe nga përbërja klasore e radhëve të saj.

Klasa punëtore ka dërguar në Partinë e saj bijtë e vet më të mirë, ata që janë dalluar e kalitur në aksionet e betejat revolucionare. Ky gjak i ri ka sjellë në Parti vendosmërinë, vullnetin e hekurt, urtësinë, disiplinën dhe hovin revolucionar të klasës punëtore.

Me qëllim që të ruhet e të forcohet vazhdimisht karakteri i saj klasor e proletar, Partia i ka kushtuar kujdes të posaçëm sidomos përmirësimit të përbërjes së organeve udhëheqëse me punëtorë. Sot 55 për qind e anëtarëve të plenumëve të komiteteve të Partisë në rrethe, 85,2 për qind e anëtarëve të byrove të organizatave-bazë në ndërmarrjet ekonomike dhe 86,3 për qind e sekretarëve të tyre janë me gjendje, origjinë ose që vetë kanë qenë më parë punëtorë. Shumë pozitiv e kuptimplotë është fakti që sot në organet udhëheqëse të Partisë bëjnë pjesë shumë punëtorë, të cilët:

edhe pasi janë zgjedhur në këto organe, vazhdojnë të punojnë si punëtorë në prodhim. Kjo ka një rëndësi të madhe parimore. E keqja që ndodhi në shumë parti komuniste që degjeneruan në revizioniste erdhi edhe nga fakti se, ndërsa në radhët e anëtarëve të tyre kishte mjaft punëtorë, organet udhëheqëse u deproletarizuan, u mbushën me specialistë teknokratë, intelektualë e nëpunës burokratë.

Duke u hapur rrugën punëtorëve për të hyrë në Parti, për të marrë pjesë aktive në organet udhëheqëse të saj, Partia jonë ka hedhur rrënjë të thella në gjirin e klasës më revolucionare dhe më të përparuar të shoqërisë, së cilës i takon misioni historik për të qenë në pararojë të luftës për socializëm e komunizëm.

Edhe në të ardhmen ne duhet të luftojmë për rritjen e radhëve të Partisë me punëtorë, të cilët duhet të kenë prioritet mbi gjithë ata që vijnë nga klasat dhe shtresat e tjera. Për këtë tani ekzistojnë mundësitë reale, pasi klasa punëtore rritet e zhvillohet me shpejtësi krahas me zhvillimin e ekonomisë e veçanërisht të industrisë. Kujdes të veçantë duhet të tregojnë disa rrethe, ku, megjithëse ka një klasë punëtore relativisht të zhvilluar, numri i punëtorëve në Parti është nën mesataren si republikë. Një e metë tjetër është se nuk ka një raport të drejtë midis numrit të komunistëve që punojnë në repartet kryesore e në makineri dhe atyre që punojnë në repartet ndihmëse.

Pranimet e punëtorëve të rinj në Parti duhet të bëhen sidomos në degët më të rëndësishme të ekonomisë, në industrinë minerale, nxjerrëse e përpunuese, në atë metalurgjike, mekanike e kimike, në objektet

e mëdha dhe në degët e reja të industrisë, kudo ku ndihet më tepër nevoja, si për gjendjen e sotme, ashtu edhe për perspektivën.

Krahas pranimet të më shumë punëtorëve në Parti, Komiteti Qendror u ka kushtuar një vëmendje të veçantë pranimet dhe shtrirjes së Partisë në gjithë sektorët e ekonomisë e të kulturës. Pranimet e reja dhe shtrirja e Partisë është bërë në bazë të nevojave, lidhur ngushtë me madhësinë e territorit, rëndësinë e problemeve ideopolitike e ekonomike që duhen zgjidhur, me çështjet që kërkojnë të drejtohen e të organizohen nga Partia.

Rritja e Partisë në kooperativat bujqësore, nga Kongresi i 5-të e këtej, ka shkuar normalisht në përputhje me detyrat që shtron ndërtimi i socializmit në fshat. Komunistët kooperativistë zënë 29,70 për qind të efektivit të Partisë. Sot nuk kemi asnjë fshat pa komunistë dhe në gjithë sektorët e kooperativave bujqësore kemi organizata-bazë partie. Por akoma kemi brigada pa grupe partie, bile ka edhe të tilla ku nuk kemi asnjë komunist.

Detyrat e mëdha që shtrohen para bujqësisë për shtimin e prodhimit dhe modernizimin e saj, roli i madh që ajo luan në gjithë ekonominë tonë, si edhe fakti që në fshat jeton pjesa më e madhe e popullsisë, kërkojnë që të pranohen në Parti më shumë kooperativistë, me qëllim që të forcohet më tej Partia në fshat dhe të përmirësohet drejtimi i saj në kooperativat bujqësore, duke iu afruar sa më shumë njësisë bazë të prodhimit, brigadës.

Në mënyrë të suksesshme është pasqyruar në

përbërjen e Partisë lufta e madhe revolucionare që është zhvilluar, sidomos këto vitet e fundit, për emancipimin e plotë të gruas, për çlirimin e energjive të saj të pashtershme krijuese. Të entuziazmon shumë fakti që gratë zënë sot 22,05 për qind të të gjithë efektivit të Partisë nga 12,47 për qind që zinin në Kongresin e mëparshëm.

Gratë përbëjnë një forcë kolosale dhe luajnë një rol me shumë rëndësi në zhvillimin e gjithanshëm të vendit. Ato kanë kryer tani me shumicë shkollat 8-vjeçare, janë edukuar në frymën e Partisë e janë kalitur në kudhrën e aksioneve dhe lëvizjeve të ndryshme revolucionare. Sot në vendin tonë po krijohet një opinion i drejtë e i shëndoshë për pozitën dhe rolin e gruas në shoqëri. Të gjitha këto krijojnë mundësitë dhe diktojnë nevojën që edhe në të ardhmen të ecim me guxim përpara për pranimin me ritëm të shpejtë të grave në Parti.

Për Partinë tonë, siç e vërteton gjithë historia e saj, rëndësi vendimtare ka pasur e ka cilësia e anëtarëve, vetitë e tyre politike e morale, formimi ideologjik dhe kalitja revolucionare, vendosmëria për ta mbrojtur e për ta zbatuar vijën e Partisë kurdoherë e në çdo rrethanë. Numri i madh nuk flet gjithnjë për forcën e Partisë. Por kur ky numër shoqërohet dhe me cilësi të lartë, kur në Parti hyjnë gjithnjë e më shumë elementë të ndërgjegjshëm, të gatshëm për zbatimin e të gjitha detyrave që shtron Partia, që vënë kurdoherë e mbi çdo gjë interesin e përgjithshëm, atëherë ai kthehet në një forcë kolosale. Njerëz të

tillë e bëjnë Partinë të pamposhtur, e mbajnë atë gjithnjë revolucionare, pararojë e forcë udhëheqëse të të gjithë shoqërisë.

Kërkesat që shtron Partia ndaj komunistëve vijnë gjithnjë duke u rritur krahas zhvillimit të socializmit dhe daljes në rendin e ditës të problemeve e detyrave të reja, më të vështira e më të ndërlikuara. Çdo etapë e revolucionit kërkon cilësi e virtyte të reja nga të gjithë punonjësit, të cilat duhet të mishërohen në radhë të parë te komunistët. Krahas besnikërisë politike dhe devotshmërisë për çështjen e Partisë, krahas punës së palodhur për të mirën e popullit, krahas bindjeve internacionaliste dhe urrejtjes për armiqtë, nga komunistët sot kërkohet më tepër se kurrë të jenë njerëz të përparuar, me koncepte të reja për punën, jetën, familjen, shoqërinë, njerëz që dashurojnë dijen e kulturën, që thellohen në profesionin e tyre dhe përkrahin me të gjitha forcat progresin tekniko-shkencor, që nuk durojnë rutinën e injorancën, që luftojnë me guxim çdo gjë që bëhet pengesë e frenon marshimin e vrullshëm të shoqërisë socialiste.

Përbërja e shëndoshë dhe cilësitë e mira të atyre që pranohen në Parti nuk janë gjithçka. Që Partia të jetë e fortë, revolucionare, e aftë të luajë rolin e saj pararojë çshtë e domosdoshme që gjithë anëtarët e saj të edukohen vazhdimisht me ideologjinë marksiste-leniniste dhe politikën e mësimet e Partisë, të kaliten përndërprerë në zjarrin e luftës e të punës revolucionare. Kjo është një domosdoshmëri jetike që komunistët kurrë të mos sklerozohen, të mos burokratizohen dhe të

mos degjenerojnë, ashtu siç ndodhi në Bashkimin Sovjetik e gjetkë, por të mbeten kurdoherë luftëtarë të vendosur e konsekuentë për çështjen e komunizmit.

Për këtë edukim e kalitje kanë nevojë të gjithë, jo vetëm komunistët e rinj, por edhe ata me stazh të vjetër në Parti, jo vetëm njerëzit e prodhimit, por edhe të punës mendore, jo vetëm ata që kanë një nivel relativisht të ulët ideopolitik e arsimor, por edhe ata që kanë mbaruar shkolla. Komunistët, ndonëse janë pjesa më e zgjedhur, më revolucionare dhe më përparimtare e shoqërisë, nuk janë të zhveshur nga mbeburinat e ideologjive të huaja, ashtu siç nuk janë të garantuar nga rreziku i infektimit borgjez e revizionist.

Puna edukuese e Partisë duhet të synojë jo vetëm t'i armatosë komunistët me ligjet e zhvillimit të shoqërisë, t'i pajisë me botëkuptimin marksist-leninist, por dhe t'u kalitë atyre ndërgjegjen, të mbajë kurdoherë lart frymën revolucionare, figurën morale të anëtarit të Partisë, me qëllim që mendimi e veprimi të përbëjnë një unitet të pandarë, që komunistët të mendojnë, të jetojnë e të veprojnë kudo e kurdoherë si revolucionarë. Ajo duhet t'i bëjë ata të zotë që të orientohen shpejt dhe drejt në çdo situatë, të kuptojnë mirë realitetin, në të cilin veprojnë, të njohin thellë problemet që lindin nga zhvillimi i brendshëm i vendit tonë ose nga situatat ndërkombëtare dhe t'u përgjigjen si duhet detyrave që qëndrojnë para tyre dhe masave të popullit.

Nga Kongresi i 5-të e këtej puna për edukimin e komunistëve është gjallëruar, është lidhur më ngu-

shtë me problemet e detyrat që ka pasur vendi e Partia. Janë përdorur forma më të larmishme e më të zhdërvjellëta, është zhvilluar më tej iniciativa e komiteteve dhe e organizatave-bazë, të cilat e kanë marrë më mirë në dorë këtë punë. Edukimi teorik është shoqëruar në mënyrë më organike me hedhjen e komunistëve në aksione e lëvizje revolucionare.

Edukimi i komunistëve nuk ka qenë dhe nuk është një qëllim dhe një çështje në vetvete. Këtë edukim Partia nuk e ka parë dhe nuk e sheh të shkëputur nga ai i masave, si edukim të një elite, por si edukim të pararojës, për ta bërë këtë të aftë që të edukojë masat. Çdo shkëputje e edukimit të Partisë nga ai i masave, siç e tregon eksperiencia e hidhur e Bashkimit Sovjetik, çon në kultivimin e koncepteve intelektualiste në Parti dhe në indiferentizëm ndaj çështjeve politike e ideologjike në punonjësit, çon në fund të fundit në dobësimin dhe minimin e lidhjeve të Partisë me popullin.

Në Parti bëhet një punë e madhe për studimin e teorisë marksiste-leniniste dhe të dokumenteve të Partisë sonë. Kjo punë duhet të vazhdojë e të përsoset, me qëllim që ajo t'i ndihmojë komunistët jo vetëm t'i kuptojnë drejt, por edhe t'i zbatojnë si duhet në jetë direktivat e Partisë e ligjet e shtetit, normat e shoqërisë sonë socialiste. Dijet marksiste nuk duhet të mbeten si një zbukurim intelektual, por nga to të udhëhiqen komunistët në çdo hap të jetës së tyre. Këtë punë ne mund ta bëjmë edhe më mirë, sepse tani mundësitë janë më të mëdha, Partia ka fituar një përvojë të pasur

dhe ka përgatitur një armatë të madhe kuadrosh që janë në gjendje të zhvillojnë një punë të kualifikuar për edukimin e komunistëve e të punonjësve.

Një kujdes të veçantë Partia duhet të tregojë për edukimin e kandidatëve, të cilët tani përbëjnë një të pestën e efektivit të Partisë. Këta janë komunistë të rinj, energjikë e të vullnetshëm, njerëz të dalluar që kanë dalë nga valët e luftës për revolucionarizimin e jetës së vendit, sidomos të reja e gra, që kanë nevojë të edukohen e të formohen si militantë, të fitojnë dije marksiste dhe cilësitë e anëtarit të Partisë sonë heroike.

Ndryshime të ndjeshme janë bërë edhe në rritjen e nivelit arsimor e kulturor të Partisë. Tani rreth 70 për qind e komunistëve janë me shkollë 8-vjeçare, të mesme e të lartë. Ky është një tregues shumë i mirë, që dëshmon për përpjekjet këmbëngulëse të komunistëve për të fituar kulturë dhe për t'u aftësuar gjithnjë e më shumë. Por këto përpjekje duhet të jenë të vazhdueshme, sepse dijet nuk kanë fund. Me gjithë sukseset, të tërheq vëmendjen fakti që rreth 30 për qind e komunistëve kanë vetëm arsimin fillor ose 8-vjeçar të pambaruar. Këtu përfshihet një numër i madh komunistësh me moshë të kaluar dhe të zonave të thella malore, ku shkollat 8-vjeçare janë shtrirë vetëm vitet e fundit. Duke nxitur këta komunistë që të ngrënë nivelin e tyre kulturor, tani që arsimi 8-vjeçar është bërë kudo i detyrueshëm, është e mundshme që në të ardhmen, si rregull, të pranohen në Parti njerëz që të paktën të kenë arsimin 8-vjeçar.

Të gjallërojmë jetën e brendshme dhe të rritim iniciativën e vetëveprimin e organizatave të Partisë

Rritja e rolit udhëheqës dhe revolucionarizimi i pandërprerë i Partisë nuk mund të kuptohen e të arrihen pa gjallërimin e jetës së brendshme të organizatave të Partisë, pa iniciativën e pjesëmarrjen aktive të të gjithë komunistëve në luftën për përpunimin dhe zbatimin e vijës së saj.

Partia e Punës e Shqipërisë lindi, u rrit dhe u zhvillua në valën e veprimit revolucionar të klasës punëtore dhe të masave. Në luftën e ashpër klasore me armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm, në aksionet e guximshme dhe në lëvizjet e thella revolucionare që transformojnë botën materiale e shpirtërore të njerëzve, është revolucionarizuar vazhdimisht çdo komunist e organizatë-bazë, çdo organ udhëheqës partie.

Gjatë periudhës për të cilën raportojmë iniciativa dhe vetëveprimi, shpirti novator dhe vrulli revolucionar për të çarë përpara morën një zhvillim të gjerë dhe përmbajtje të re në të gjithë sektorët, në ekonomi e kulturë, në shkencë e teknikë. Këto sollën një stil të ri më të zhdërvjellët, forma pune më origjinale në përshtatje me detyrat e kohës. Sot jetën e organizatave të Partisë dhe të komunistëve e përshkon një frymë e lartë luftarake, mobilizimi e përgjegjësie.

Këtë frymë revolucionare duhet ta mbajmë gjallë e ta forcojmë vazhdimisht, me qëllim që organizatat e Partisë t'i bëjmë gjithnjë e më mirë organizma vetëve-

prues, që me iniciativë e përgjegjësi të plotë të zbërthejnë, të zbatojnë e të kontrollojnë direktivat e vendimet e Partisë, të kapin me shkathtësi problemet e reja që nxjerr jeta dhe t'u japin rrugë atyre.

Iniciativa dhe vetëveprimi janë koncepte revolucionare të të menduarit e të të vepruarit. Ato nuk lindin vetiu dhe as jepen të gatshme nga të tjerët, por vijnë si rezultat i njohjes së thellë dhe i depërtimit në thelbin ideopolitik të direktivave të Partisë, i studimit e i vlerësimit të drejtë të realitetit, të opinionit dhe të përvojës së masave, i guximit për të marrë përgjegjësi të plotë për veprimin që kryen.

Për zhvillimin e iniciativës e të vetëveprimit të organizatave të Partisë është e nevojshme të luftojmë me vendosmëri kundër rutinës dhe formave të vjetruara të punës, kundër metodave administrative dhe tutelës burokratike, që, me gjithë përmirësimet e bëra, vihen re akoma në punën e Partisë. Këtu ka kuadro dhe organe drejtuese të Partisë që në mjaft raste janë të prirur të ndërhyjnë e të vendosin për gjithçka ose që, nën pretekstin për të mbajtur lidhje ose për të «mbuluar» të gjitha organizatat-bazë, vendosin një tutelë të palejueshme me anë të instruktorëve, duke harruar se kështu u kufizojnë iniciativën organizatave e komunistëve dhe i bëjnë që të presin çdo gjë nga lart. Kjo është një nga shfaqjet e burokratizmit në Parti. Iniciativa e vetëveprimi kufizohen edhe atëherë kur organet drejtuese i ngarkojnë organizatat-bazë me orientime, udhëzime e vendime të shumta, të cilat shpesh janë të gjata, të ndërlikuara e të përgjithshme. Kjo bën që organizatat-bazë të mos jenë në gjendje

t'i kuptojnë, t'i zbërthejnë e t'i zbatojnë ato, por të kërkojnë vazhdimisht sqarime e interpretime nga instancat eprorë. Këtu kemi të bëjmë me një shfaqje tjetër të burokratizmit e të intelektualizmit.

Të gjitha format e punës e të organizimit duhet t'i shërbejnë vënies në lëvizje të organizatave-bazë e të komunistëve, nxitjes së iniciativës së tyre, forcimit të përgjegjësisë individuale e kolektive. Këtë duhet ta kuptojnë mirë sidomos kuadrot e organet udhëheqëse të Partisë. Por për këtë është e domosdoshme të luftojnë vetë organizatat-bazë. Këto duhet të jenë më të shkathëta e më të guximshme, të mos presin zgjidhje të gatshme nga lart për problemet që i preokupojnë, të mos veprojnë në mënyrë mekanike pa pasur parasysh karakterin e direktivës dhe kushtet e ndërmarrjes, të kooperativës ose të institucionit ku veprojnë. Mendimi dhe iniciativa krijuese nuk janë për zhurmë, ato duhet të shpërthejnë lidhur ngushtë me detyrat aktuale e konkrete dhe t'i shërbejnë zgjidhjes së tyre.

Iniciativa dhe vetëveprimi nuk kanë të bëjnë vetëm me organizatën si forum, por në shembullin e saj, në këtë frymë, duhet të veprojnë përditë dhe për çdo gjë, secili anëtar ose kandidat i saj. Pa komunistë revolucionarë nuk mund të ketë organizata partie revolucionare. Në këtë kuptim për çdo komunist shfaqja e iniciativës nuk kufizohet me pjesëmarrjen aktive gjatë shqyrtimit të problemeve brenda në organizatë. Organizata-bazë s'është vetëm mbledhja e saj, por tërësia e veprimtarisë së komunistëve veç e veç e së toku, para, gjatë dhe mbas mbledhjes, për të përpunuar e

zbatuar vijën dhe vendimet e Partisë kudo ku ata jetojnë e punojnë.

Detyrat për ndërtimin e socializmit dhe problemet që shtron jeta janë kaq të shumta sa që nuk ka mundësi praktike të bëhen të gjitha objekt shqyrtimi në organizatën e Partisë. Prandaj kërkohet që çdo komunist t'i njohë thellë e në hollësi direktivat e vendimet e Partisë dhe, sipas kushteve e vendit të punës ku militon, t'i vërë në jetë me iniciativë, duke punuar si agjikator, propagandist e organizator, por kurdoherë të luajë rolin e pararojës. Ata nuk duhet të jenë zbatues mekanikë dhe as konformistë, por të mbajnë përgjegjësi të plotë për zberthimin dhe realizimin krijues të direktivave dhe të orientimeve, të tregojnë më guxim kur vendimet, urdhrat e udhëzimet e ndryshme bien në kundërshtim me politikën e drejtë të Partisë ose nuk u përgjigjen kushteve të veçanta reale.

Iniciativa e vetëveprimi si tipare dalluese të komunistëve formohen dhe kaliten në luftë e në punë, në veprimtarinë e përditshme praktike shoqërore. Në aksione e lëvizje shkrihet në një të vetme vrulli revolucionar i komunistëve me krijimtarinë e masave dhe u jepet kështu një goditje e fortë metodave burokratike e teknokratizmit, dembellëkut e formalizmit. Është detyrë e gjithë komunistëve, e organizatave-bazë dhe e komiteteve të Partisë që ta shtrijnë metodën e aksionit në të gjitha fushat e jetës, sepse kështu puna e Partisë do të gjallërohet dhe do t'u përgjigjet më mirë hovit dhe entuziazmit të klasës punëtore e të gjithë punonjësve.

Për forcimin e Partisë rëndësi të veçantë ka kup-

timi i thellë ideologjik dhe zbatimi këmbëngulës i normave që rregullojnë jetën e brendshme të saj. Këto norma janë ato që e çelikosin Partinë, forcojnë unitetin e mendimit dhe të veprimit të saj, që sigurojnë vitalitetin dhe suksesin e veprimtarisë së Partisë.

Çdo kuptim i shtrembër, çdo zbatim formal i tyre çon në pasoja të rënda, ndrydh jetën e brendshme të Partisë, mbyty frymën e hovin revolucionar të komunistëve, i hap rrugën burokratizmit dhe degjenerimit të Partisë. Këtu qëndron edhe një nga burimet kryesore të asaj tragjedie të madhe që ndodhi në Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Atje tani normat e partisë, megjithëse paraqiten si komuniste, përdoren si leva për nënshtrimin e partisë dhe zbatimin e vullnetit të klikës revizioniste në fuqi. Centralizmi demokratik është shndërruar në centralizëm burokratik, me anën e të cilit i imponohet partisë diktati i grupit sundues të borgjezisë së re sovjetike. Kritika dhe autokritika është shndërruar në një mjet për të goditur e diskriminuar kundërshtarët e vijës revizioniste, disiplina e ndër-gjegjshme është zëvendësuar me nënshtrimin e verbër ndaj autoriteteve burokratike. Etika komuniste e anëtarit të partisë i ka lënë vendin moralit borgjez të karrieristëve, servilëve e hipokritëve.

Partia jonë gjatë gjithë jetës së saj ka luftuar pandërprerë që normat e Partisë të ruhen të pastra dhe të bëhen pjesë e pandarë e jetës së përditshme të organizatave e të komunistëve. Kjo e ka bërë Partinë tonë të pathyeshme, të aftë për t'u bërë ballë armiqve të ndryshëm dhe për ta udhëhequr popullin shqiptar me sukses në rrugën e ndritur të socializmit.

Duke pasur parasysh si eksperiencën pozitive të Partisë sonë, ashtu edhe atë negative të partive revizioniste, ne duhet t'i kushtojmë tërë vëmendjen kësaj çështjeje të madhe jetike, të luftojmë me vendosmëri çdo shfaqje të formalizmit në kuptimin dhe zbatimin e normave leniniste të jetës së Partisë.

Këto norma nuk janë një qëllim në vetvete, as rregulla administrimi. Kështu, demokracia e brendshme, si një normë shumë e rëndësishme në jetën e Partisë, nuk reduktohet vetëm në procedurën demokratike të zhvillimit të mbledhjeve, për të marrë vendime me shumicë votash etj. Demokracia në Parti ka një kuptim e përmbajtje të thellë ideologjike e praktike. Thelbi i saj është që çdo komunist të marrë pjesë aktive në përpunimin dhe zbatimin e vijës së Partisë, të shfaqë lirisht mendimet e tij për punën dhe njerëzit, të kritikojë hapur të metat dhe të bëjë autokritikë për dobësitë e veta. E kuptuar dhe e zbatuar në këtë mënyrë, demokracia u shërben forcimit të Partisë, edukimit dhe kalitjes së komunistëve, gjallërimit të organizatave dhe kompaktësisë së radhëve të Partisë, mbi bazën e parimit themelor të ndërtimit e funksionimit të saj, centralizmit demokratik.

Demokracia forcohet nëpërmjet debatit, ndeshjes së mendimeve dhe pikëpamjeve, parashtrimit dhe kapërcimit të kontradiktave. Lufta në rrugë të drejtë e mendimeve nuk është shprehja e mungesës së unitetit, por mjet efektiv për forcimin e tij. Atje ku mungojnë debatet, ku ka «qetësi» dhe «harmoni», atje ka amulli, demokracia dhe uniteti kanë karakter formal. Frika nga debati nuk është karakteristikë e komunistëve, por

e mikroborgjezëve dhe e burokratëve, që nuk duan telashe e kokëçarje.

Por demokracia do të mbetet prapë formale, në qoftë se ajo do të kufizohet vetëm në diskutime e debate. Ajo bëhet efektive dhe i shërben forcimit të Partisë, kur komunistët i zbatojnë me konsekuencë e deri në fund vendimet që merren, kur veprojnë si një trup i vetëm e karakterizohen nga një vullnet i përbashkët. Kështu realizohet në praktikë uniteti i mendimit e i veprimit.

Dihet rëndësia e madhe parimore që ka kushti leninist se për të qenë anëtar partie duhet të pranosh statutin e programin e partisë, të bësh pjesë në një organizatë të saj dhe të paguash rregullisht kuotizacionin. Por kjo normë mbetet formale në qoftë se komunisti nuk është luftëtar aktiv për zbatimin e vijës së partisë, nuk mishëron në jetë e në punë cilësitë e komunistit që përcaktohen në statut, nuk është njeri i pararojës dhe nuk qëndron në ballë të masave në luftën për socializëm. Komunistët shqiptarë nuk janë komunistë për vota, siç i kërkojnë partitë revizioniste, por luftëtarë të frontit të parë, njerëz që s'i zë gjumi as natën, as ditën për punët e Partisë dhe fatet e popullit.

Partia nuk mund të jetë në ballë të luftës dhe të ecë përpara pa mobilizuar masat, pa u mbështetur në to, sepse puna e Partisë është e gjerë, pa kufi dhe atë nuk mund ta bëjnë kurrë një numër i kufizuar komunistësh. Lidhja me masat është një parim dhe normë tjetër e rëndësishme e Partisë.

Problemet e Partisë janë probleme që preokupojnë

masat, prandaj ato t'i kërkojmë e t'i gjejmë te masat, t'i diskutojmë e t'i zgjidhim bashkë me to, sepse janë pikërisht masat e gjera ato që krijojnë, që ndërtojnë dhe transformojnë botën, shoqërinë. Vënia në jetë e këtij parimi të madh marksist-leninist përbën atë hallkë të zinxhirit, nga e cila duhet kapur për të çuar përpara tërë punën tonë. Vija e masave qindfishon forcat e Partisë, thëllon më tej demokracinë në jetën e brendshme të saj, forcon lidhjet e Partisë me popullin.

Sukseset në këtë drejtim janë të dukshme, por ndeshemi akoma me koncepte formaliste e sektare. Vihen re raste kur konsultimi me masat bëhet sa për të kaluar radhën, kur, edhe pasi për një çështje merret mendimi i tyre, në vendimet nuk pasqyrohen si duhet vërejtjet dhe propozimet e drejta të masave. Formalizëm është edhe ai kur pyeten vetëm disa njerëz dhe kjo quhet si dëgjim i zërit të masave. Nuk janë, gjithashtu, të rralla rastet kur nën parullën e vijës së masave mbledhen njerëzit vend e pa vend e për çështje fare të parëndësishme.

Nga ana tjetër, disa organizata-bazë me vështirësi po dalin nga kuadratet e ngushta të një pune të mbyllur e pa perspektivë. Ç'të keqe ka nëse për çdo problem të rëndësishëm që shtrohet për diskutim në organizatën-bazë ose në forumet e Partisë jo vetëm të merret mendimi i masës, por pas çdo mbledhjeje partie punonjësit të vihen në dijeni për çështje që atyre u interesojnë dhe bashkë me ta të gjenden format e mjetet më të përshtatshme për zbatimin e tyre? Ç'normë organizative shkelet që organizata-bazë të dalë herë pas here para kolektivit dhe të njoftojë se si janë zba-

tuar vendimet, si kanë punuar komunistët, anëtarët e byrove deri tek anëtarët e plenumeve të rretheve ose të bëhen mbledhje të hapëta të organizatës-bazë, bile edhe kur diskutohen gabime të komunistëve? Këtu nuk shkelet asnjë normë, asnjë parim organizativ, por vetëm thyhen konceptet burokratike që nënvlerësojnë mendimin dhe kontrollin e masave, thellohet më tej demokracia në jetën e brendshme të Partisë, zbatohen parimet e normat e Partisë në mënyrë revolucionare.

Vënia e gjithë veprimtarisë së organizatave të Partisë e të komunistëve nën kontrollin e klasës punëtore dhe të masave punonjëse është një çështje me rëndësi të madhe parimore që Partia të mos shkëputet nga klasa e masat, të mbetet deri në fund revolucionare dhe t'u shërbejë me besnikëri interesave të popullit. Mungesa e këtyre raporteve, largimi nga vija e masave, kthimi i punës së Partisë në diçka të mbyllur, jashtë kontrollit të klasës e të punonjësve, bëri që revizionistët t'i kapin në befasi masat dhe t'i vënë ato para faktit të kryer.

Këtë mësim të hidhur ta kemi kurdoherë parasysh dhe të thellojmë më tej përvojën e pasur të Partisë sonë në rrugën e madhe drejt demokratizimit të mëtejshëm të jetës së Partisë, zbatimit në frymë revolucionare të normave të saj, forcimit të lidhjeve të Partisë me masat. Kështu Partia do të jetë gjithnjë e fortë si çeliku, e pamposhtur, e zonja të orientohet drejt në çdo situatë dhe të zgjidhë me sukses çdo detyrë.

Thellimi i vijës së masave nuk mund të kuptohet pa përmirësuar më tej punën e Partisë me organiza-

tat e masave dhe udhëheqjen e saj në këto organizata. Roli i organizatës së bashkimeve profesionale, të rinisë, të gruas dhe të Frontit Demokratik është i madh për forcimin e lidhjeve të Partisë me masat, për edukimin revolucionar dhe mobilizimin e punonjësve në luftë për kryerjen e detyrave të ndërtimit socialist. Ato çojnë në masa vijën e Partisë dhe shtrojnë para Partisë e shtetit problemet që preokupojnë masat, jo vetëm i edukojnë punonjësit, por edhe i organizojnë ata për të marrë pjesë aktive në drejtimin e punëve shtetërore e shoqërore dhe për të ushtruar kontrollin e tyre të drejt-përdrejtë mbi këdo si zotër të plotfuqishëm të vendit.

Partia e ka vlerësuar kurdoherë lart këtë rol të madh që luajnë organizatat e masave në sistemin e diktaturës së proletariatit, prandaj ajo u ka kushtuar e u kushton atyre tërë vëmendjen e saj. Ky kujdes nuk duhet të pakësohet në asnjë mënyrë edhe në të ardhmen. Përkundrazi, ai duhet të rritet duke luftuar çdo shfaqje të nënvlerësimit të organizatave të masave, që vihet re aty-këtu në ndonjë organizatë partie, kuadër e komunist.

Udhëheqja e Partisë në organizatat e masave është ai kusht që siguron një orientim të drejtë politik, ideologjik e organizativ për bashkimin e forcave popullore në luftë për idealet e larta të socializmit. Partia jonë shprehet si kundër pikëpamjeve të revizionistëve modernë që predikojnë pavarësinë e organizatave të masave nga partia revolucionare e klasës punëtore, për t'i vënë kështu ato në vartësinë e partive borgjeze, ashtu edhe kundër koncepteve burokratike, sipas të cilave organizatat e masave duhet të jenë shtojca të apara-

teve shtetërore, duke u mohuar kështu atyre çdo iniciativë e vetëveprim me qëllim që t'u diktohet çdo gjë nga lart.

Udhëheqja e Partisë është udhëheqje politike e ideologjike, që do të thotë se në themel të veprimtarisë së organizatave të masave qëndron ideologjia dhe vija e përgjithshme politike e Partisë, se direktivat e vendimet e saj përbëjnë burimin e vetëm që i frymëzon e i udhëheq ato në të tërë punën e tyre. Këtë del edhe detyra që këtë vijë e këto direktiva komitetet dhe organizatat e Partisë t'ua bëjnë të qarta organizatave të masave në përshtatje me specifikën dhe funksionet e tyre, duke u lënë në të njëjtën kohë iniciativë të plotë që ato të mendojnë e të punojnë edhe vetë për zbërthimin dhe zbatimin e tyre.

Në këtë kuptim është krejt e huaj dhe e dëmshme ajo praktikë që vihet re jo rrallë, kur çdo gjë duhet ta shohin më parë organizatat e Partisë dhe pastaj të veprojnë organizatat e masave.

Praktikat burokratike, të cilat shpesh mbulohen me «nevojën e ndihmës konkrete» për organizatat e masave, me «mungesën e përvojës» së tyre, në fakt dëshmojnë se disa organizata partie nuk janë zhveshur akoma nga disa forma e metoda pune të vjetruara.

Në kushtet kur niveli ideopolitik dhe kulturor-arsimor i masave është rritur dhe kur organizatat e tyre kanë fituar një eksperiencë të pasur, është e nevojshme të përsosen edhe format e metodat e udhëheqjes së Partisë, të cilat duhet të synojnë jo në ndrydhjen, por në zhvillimin e gjerë të iniciativës e të vetëveprimit të organizatave të masave, ashtu si vetë këto

të fundit duhet të përsosin më tej stilin e metodën e tyre, të gjejnë forma pune më të lira, më të shkathëta e më të larmishme.

Me një kujdes të veçantë është punuar për edukimin e aktivitetit të organizatave të masave, i cili përbën një forcë të madhe dhe një burim të pashtershëm për rritjen e radhëve të Partisë dhe për kuadro për të gjithë sektorët. Ky aktiv nuk përbëhet vetëm nga funksionarët, as vetëm nga ata që janë zgjedhur në forumet e organizatave të masave, por edhe nga dhjetëra mijë aktivistë shoqërorë, që punojnë me një ndërgjegje të lartë si propagandistë, agjitorë dhe organizatorë të masave. Punës për rritjen, aftësimin e kalitjen e këtij aktiviteti Partia si dhe vetë organizatat e masave duhet t'i kushtojnë tërë kujdesin e tyre.

Disa çështje të politikës së kuadrit dhe të metodës e stilit në punë

Partia me punën e saj të kujdesshme për vite me radhë ka krijuar një armatë kuadrosh të aftë e besnikë, të cilët, të kalitur në luftë me vështirësitë e pengesat, të ndriçuar nga vija marksiste-leniniste e Partisë, punojnë si revolucionarë në të gjithë sektorët.

Masat e rëndësishme që ka marrë Partia për revolucionarizimin e mëtejshëm të tyre, duke filluar që nga qarkullimi e puna në prodhim dhe deri te përmirësimi i përbërjes sociale të forumeve të Partisë, të organizatave të masave dhe të gjitha aparateve, kanë bërë që, pavarësisht nga mosha ose stazhi në punë,

kuadrot të kaliten më tej si militantë të Partisë dhe bij të devotshëm të popullit.

Sot rreth 44 për qind e të gjitha kategorive të kuadrove janë të moshës deri në 30 vjeç, ndërsa mbi 50 për qind janë në moshën nga 30 deri 50 vjeç. Këta tregues janë shumë pozitivë. Ata dëshmojnë se Partia ka ndjekur një politikë të drejtë në ngritjen e kuadrit, duke kombinuar në harmoni të plotë kuadrot e vjetër me të rinjtë, duke përgatitur dhe edukuar një brez të ri kuadrosh për të përtërirë në mënyrë graduale e të vazhdueshme organet udhëheqëse të Partisë, të shtetit, të ekonomisë e të kulturës.

Këtë politikë të drejtë Partia do ta ndjekë edhe në të ardhmen. Përtëritja dhe zëvendësimi i kuadrove është një domosdoshmëri jetike, prandaj ai duhet të jetë një preokupacion i vazhdueshëm, për atë duhet menduar seriozisht dhe me kohë.

Kuadrot, veçanërisht ata drejtues, nuk përgatiten lehtë, për një ditë ose për një vit, duhet njaft kohë për t'i rritur e formuar si të tillë. Emërimet bëhen shpejt, por transmetimi i përvojës nuk mund të bëhet me një të rënë të shkopit. Ky është një proces i vazhdueshëm që e udhëheq me kujdes Partia. Në punën e përbashkët të kuadrove të vjetër dhe të rinj trashëgohet e pasurohet përvoja e mirë, rriten të rinjtë e freskohen të moshuarit, realizohet ai harmonizim i plotë i kuadrove dhe i eksperiencave të ndryshme.

Partia duhet të luftojë me guxim kundër pengesave që dalin në rrugën e ngritjes së kuadrove të rinj, sidomos kundër koncepteve konservatore e sektare, që janë shprehje të mosbesimit tek aftësitë krijuese të

masave, të egoizmit profesional dhe intelektualizmit. Këto shfaqen në forma, doza e në njerëz të ndryshëm dhe për kategori të ndryshme punonjësish.

Tani kemi një bazë të shëndoshë dhe janë krijuar të gjitha kushtet për të avancuar më me guxim kuadro të rinj në të gjitha fushat. Të tillë ka me mijëra e mijëra në radhët e klasës sonë punëtore, të fshatarësisë kooperativiste, të rinisë sonë të mrekullueshme. Njerëzit tanë të rinj kanë një nivel arsimor e kulturor të ngritur, janë pajisur qysh në fëmijëri e vazhdimisht me edukatën e Partisë, janë kalitur e kaliten përditë në jetën tonë revolucionare. Ata janë plotësisht të dënjë dhe të aftë për t'u besuar çdo detyrë. Të mos e shohësh këtë realitet do të thotë të mbetesh prapa jetës, të dëmtosh punën e Partisë, të pengosh zhvillimin e vendit.

Kuadrot e rinj kanë nevojë të ndihmohen e të udhëhiqen me kujdes, por pa i mbajtur nën tutelë, në rolin e ndihmësit ose të çirakut. Kuadrot me stazh të gjatë pune, me ndjenjën e përgjegjësisë së lartë për të tashmen dhe të ardhmen e vendit, ta shohin këtë si detyrë partie, t'i ndihmojnë ata me pasion, t'i inkurajojnë, t'i mësojnë, por dhe të mësojnë prej tyre dhe të besojnë sinqerisht se kanë çfarë të mësojnë. Ata të mos harrojnë se edhe ata vetë dikur kanë qenë të rinj dhe megjithatë Partia u ngarkoi përgjegjësi të mëdha, i rriti, i edukoi, i mësoi të luftojnë e të fitojnë, ajo u ka qëndruar gjithnjë pranë dhe i ka ndihmuar të ecin përpara.

Respekti në baza revolucionare e josentimentale për kuadrot e vjetër, që kanë dhënë një kontribut të

madh në luftën e çlirimit dhe për ndërtimin e socializmit, që kanë mbajtur mbi supet e tyre detyra të vështira, është një gjë e domosdoshme, sepse ky është respekti për veprën dhe eksperiencën e tyre, për të cilën ata janë e duhet të jenë kurdoherë modestë. Detyra e Partisë është të punojë që të gjithë kuadrot, pavarësisht nga mosha dhe stazhi në punë, të kuptojnë drejt vendin e rolin e tyre, dialektikën e zhvillimit të jetës, të ecin me kohën dhe të japin tërë kontributin e tyre të vlefshëm për të mirën e Partisë e të popullit.

Kuadrot duhet të jenë gjithnjë revolucionarë të devotshëm dhe në shërbim të popullit punonjës. Prandaj është e domosdoshme ta thellojmë punën për kalitjen e revolucionarizimin e vazhdueshëm të tyre, të inkurajojmë dhe të forcojmë lidhjet e kuadrit me masat, të kërkojmë e të gjejmë gjithnjë forma e mjete të reja që i shërbejnë edukimit të kuadrove të Partisë, të pushtetit dhe të gjithë sektorëve të tjerë.

Përmirësimi i metodës dhe i stilit të punës së kuadrove, është një problem tjetër me rëndësi të dorës së parë, që ata të kryejnë me sukses detyrat e mëdha e me përgjegjësi.

Me planin e ri pesëvjeçar para nesh shtrohen detyra të mëdha në fushën e industrisë, bujqësisë, ndërtimeve, kulturës dhe të gjithë sektorëve të tjerë. Këto detyra janë mjaft komplekse, kanë anën e tyre politike, ekonomike, teknike e organizative. Prandaj edhe masat për realizimin e tyre duhet të jenë të gjithanshme, kuadrot duhet të thellohen në tërë këtë kompleks, t'i trajtojnë dhe t'i zgjidhin problemet, duke i parë në unitet dhe në lidhjen e vartësinë e tyre reci-

proke. Ata duhet të kombinojnë dhe të harmonizojnë me zgjuarsi punën sgaruese e edukuese me atë ekonomike, punën teknike me atë organizuese.

Vetëm mbi këtë bazë mund të zhvillohet me sukses veprimtaria praktike revolucionare e masave, të ngrihet në një shkallë më të lartë mobilizimi i tyre dhe të arrihen rezultate më të mëdha si në prodhimin e të mirave materiale, ashtu edhe në kalitjen e ndërgjegjes së njerëzve.

Si në gjithë sektorët e tjerë, edhe në punën e Partisë sot kërkohet që drejtimi të ngrihet në një nivel më të lartë, në baza shkencore. Nga kuadrot tanë kërkohet që tani të reflektojnë më shumë mbi përmbajtjen politike e ideologjike të direktivave, të përgjithësojnë më mirë teorikisht përvojën e masave dhe të Partisë, të kapen pas çështjeve themelore dhe të dinë t'i hapin perspektivë punës në të gjithë sektorët. Për këtë është e domosdoshme që kuadrot tanë të të gjitha niveleve të studiojnë shkencën revolucionare të Partisë, të përvetësojnë botëkuptimin materialist dialektik, në lidhje të ngushtë me praktikën, me problemet që kanë për të zgjidhur. Ata duhet të bëjnë një luftë të vendosur kundër çdo shfaqjeje të subjektivizmit, empirizmit e praktikizmit, kundër çdo gjëje që kultivon rutinën, që të gozhdon pas gjërave të vogla të ditës, të ushqen frymën e komandimit dhe të largon nga njohja e realitetit.

Stili dhe metoda e punës nuk janë të dhëna një herë e përgjithmonë. Ato ndryshojnë, zhvillohen e pashurohen në përputhje me kushtet dhe detyrat e reja. Çdo gjë duhet t'i nënshtrohet verifikimit në jetë. Për

këtë ka rëndësi që kuadrot të shohin dhe të kuptojnë mirë realitetin në transformimin e tij revolucionar, të renë që lind e zhvillohet, të njohin thellë kërkesat e kohës. Kështu ata do të jenë në gjendje të luftojnë më me efikasitet kundër çdo shfaqjeje të konservatorizmit, çdo tendence që kërkon të kapet pas formave e metodave të vjetruara, të cilat vetë jeta i ka kapërcyer.

Partia jonë është Parti e progresit, Parti e së ardhmes. Ajo është e papajtueshme me çdo gjë të vjetër, konservatore e regresive. Ajo lufton për të zhdukur të gjitha pengesat, për t'i hapur rrugën e gjerë së resë, emancipimit dhe zhvillimit të energjive krijuese të masave, përparimit të gjithanshëm të shoqërisë sonë socialiste.

VI

MARKSIZËM-LENINIZMI – DOKTRINË GJITHMONË E RE DHE SHKENCORE

Lufta kundër rrymës më të rrezikshme antimarksiste, revizionizmit modern me atë sovjetik në krye, ka qenë vazhdimisht në qendër të vëmendjes së Partisë. E ndërgjegjshme për nevojën historike të kësaj lufte, Partia jonë ka demaskuar pikëpamjet e tezave antimarksiste dhe veprimtarinë kundërrevolucionare, demagogjinë dhe taktikat mashtruese të revizionistëve hrushovianë. Ajo ka luftuar me vendosmëri për t'u grisur atyre njërën maskë pas tjetrës, për të zbuluar fytyrën e tyre tradhtarë e socialimperialiste.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe marksistë-leninistët e vërtetë patën paralajmëruar që në fillim të polemikës së madhe me revizionistët modernë se largimi nga pozitat parimore të marksizëm-leninizmit do t'i çonte ata në prehrin e borgjezisë e të kapitalizmit, në barrikadën e kundërrevolucionit. Jeta e vërtetoi plotësisht këtë parashikim.

Revizionizmi, që lindi si një rrymë oportuniste e antimarksiste në gjirin e lëvizjes komuniste, si rezultat i vetë zhvillimit logjik të tradhtisë, është shndërruar tani në një rrymë borgjeze në lëvizjen punëtore, rry-

më që është e njëlojtë me socialdemokracinë. Vendet, ku në fuqi erdhën revizionistët, u kthyen në shtete borgjeze që shtypin e shfrytëzojnë punonjësit njëloj si edhe borgjezia në vendet kapitaliste. Kreu i revizionizmit, Bashkimi Sovjetik, u shndërrua në një fuqi imperialiste, që ndjek një politikë ekspansioniste e agresive, që lufton për hegjemoni e sundim botëror.

Të vënë me shpatulla për muri nga demaskimi i forcave marksiste-leniniste, të tronditur nga dështimet e disfatat që pësojnë vazhdimisht, të mbërthyer nga kontradiktat dhe kriza e thellë, në të cilën janë futur, revizionistët modernë përpiqen të manovrojnë, të përdorin taktika të ndryshme për të mashtruar komunistët e popujt, për të zgjatur sundimin e tyre.

Megjithëse këto përpjekje dhe këto manovra që u përsëritën edhe një herë me ngulm në Kongresin e 24-t të PK të BS, tashmë janë bërë bajate, ato nuk duhen nënvlerësuar. Revizionistët vazhdojnë të mbajnë nën influencën e tyre dhe të mashtrojnë shtresa të gjera të punonjësve, sidomos në vendet ku janë në fuqi. Ata vazhdojnë t'i sjellin dëme të mëdha çështjes së komunizmit. Për marksistë-leninistët, për revolucionarët konsekuentë revizionizmi mbetet një armik i madh jo më pak i rrezikshëm se borgjezia imperialiste. Asnjë iluzion nuk duhet ushqyer në këtë çështje për asnjë arsye. Lufta kundër revizionizmit modern, me udhëheqësit sovjetikë në krye, duhet vazhduar e forcuar, duhet çuar deri në fund. Ata nuk mund t'i ndreqë asgjë, përveç revolucionit që do t'i fshijë nga faqja e dheut.

Partia e Punës e Shqipërisë, ashtu si deri më sot, do të luftojë me të gjitha forcat e saj kundër tradhtisë

revizioniste, e bindur se kështu kryen detyrën e saj para popullit të vet dhe para komunizmit ndërkombëtar. Luftën ideologjike kundër revizionizmit modern ne e shohim si pjesë përbërëse e të pandarë të luftës për mbrojtjen dhe ndërtimin e socializmit në Shqipëri, për fitoren e lirisë së popujve dhe të revolucionit kudo në botë.

Situata e sotme e bën edhe më imperative nevojën e forcimit të kësaj lufte me rëndësi historike. Jetojmë në një periudhë të ngritjes së hovit revolucionar. Lufta kundër imperializmit e reaksionit po merr përpjesëtime gjithnjë e më të mëdha. Të gjitha kontinentet ziejnë nga lëvizjet revolucionare, të cilat po tronditin nga themelet botën e vjetër të shtypjes e të shfrytëzimit. Kjo është shprehja më e qartë e acarimit të të gjitha kontradiktave klasore e nacionale, të brendshme e të jashtme, të sistemit kapitalist botëror, e thellimit të mëtejshëm të krizës së tij të përgjithshme.

Zhvillimi i procesit revolucionar botëror është bërë sot shumë i larmishëm. Repartet e ndryshme të lëvizjes revolucionare botërore luftojnë e veprojnë jo në të njëjtat kushte, ndodhen në etapa të ndryshme të zhvillimit shoqëror, shtrojnë para tyre detyra të ndryshme, kanë specifikën e praktikës së tyre historike. Po zgjerohet edhe baza sociale klasore e revolucionit botëror. Përveç klasës punëtore, në lëvizjet e ndryshme revolucionare po marrin pjesë gjithnjë e më aktivisht shtresa të gjera shoqërore si fshatarësia e borgjezia e vogël e qytetit, inteligjencia e studentët, rinia e gratë, të cilat sjellin në lëvizje gjithë bagazhin ideologjik të shtresave që përfaqësojnë, me të mirat e të këqijat e tyre.

Por, ndërsa ka një ngritje të fuqishme të masave e të popujve në luftë e revolucion, dobësia e lëvizjes revolucionare në shumë vende e zona qëndron pikërisht në mungesën e një strategjie e taktike shkencore që t'u hapë masave perspektivën revolucionare dhe t'i orientojë drejt në rrugën për arritjen e qëllimeve të tyre. Situata është e tillë që lëvizja praktike e masave ka ecur e po ecën përpara, kurse faktori subjektiv, ndërgjegjja, organizimi dhe drejtimi i tyre në mjaft vende kanë mbetur prapa, nuk u përgjigjen detyrave të kohës. Këtu një rol të drejtpërdrejtë minues e sabotues luajnë revizionistët modernë, të cilët, pasi braktisën idealet revolucionare, janë shndërruar në grevëthyes e zjarrfikës të revolucionit dhe me pikëpamjet e veprimtarinë e tyre oportuniste e antimarksiste përpiqen të çarmatosin klasën punëtore dhe të çoroditin ideologjikisht e politikisht radhët e revolucionit. Ky është shërbimi më i madh që ata i bëjnë borgjezisë dhe reaksionit, është dëmi më i madh që ata i sjellin çështjes së çlirimit të popujve e të socializmit.

Me tezat e tij të shuarjes së luftës së klasave dhe të bashkëpunimit klasor nën maskën e bashkekzistencës paqësore, me iluzionet mbi ndryshimin e natyrës së imperializmit dhe mbi botën pa armë e pa luftëra, me frikën nga armët atomike dhe nga lufta termobërthamore, me predikimet për kalimin në socializëm në rrugë paqësore etj., etj., revizionizmi hrushovian u puq me socialdemokracinë dhe u shndërrua në një rrymë të vetme kundërrevolucionare në shërbim të borgjezisë.

Kjo platformë oportuniste e reformiste që u shtrua

në Kongresin e 20-të të PK të BS dhe që u zhvillua e u plotësua më vonë në kongreset e tjera që pasuan, u paraqit nga revizionistët si një platformë që gjoja mbronte leninizmin nga të ashtuquajturat deformime staliniste. Në fakt u provua shumë shpejt se rryma që doli me parullat e antistalinizmit ishte një rrymë e huaj, e papajtueshme dhe në luftë me marksizëm-leninizmin.

Revizionistët hrushovianë trumbetuan e vazhdojnë të trumbetojnë me të madhe se me pikëpamjet e tezave të tyre teorike hodhën «bazat» e luftës dhe të rrugës së «drejtë» për socializëm. Në të vërtetë kjo ishte një rrugë e luftë për të shuar luftën për socializëm, për t'i larguar masat nga rruga e revolucionit, për të përjetësuar rendin kapitalist dhe për të minuar kudo fitoret e socializmit.

Teoritë e praktikat kundërrevolucionare të revizionistëve shërbejnë si ushqim për rrymat më të ndryshme ideologjike armiqësore, që nga ato më reaksionaret borgjeze, deri tek ato trockiste e mikroborgjeze. Ideologët borgjezë përpiqen qëllimisht ta paraqitin tradhtinë revizioniste si dështim të socializmit e të marksizëm-leninizmit, sikur komunizmi nuk është i aftë të japë një alternativë pozitive për zgjidhjen e problemeve të botës së sotme. Duke bërë apologjinë e rendit kapitalist, ata pretendojnë se ky është bërë sot i aftë për të kapërcyer kontradiktat dhe konfliktet sociale, të krijojë një shoqëri të «mirëqenies së përgjithshme», se gjoja revolucioni i sotëm tekniko-shkencor po zëvendëson revolucionin social, po e afron kapitalizmin me socializmin dhe po i shkrin gjoja në një

shoqëri të re e të vetme «industriale» ose «pasindustriale». Ky është krahu më reaksionar, krahu i hapët antikomunist në luftën e sotme ideologjike.

Janë gjallëruar si kurrë ndonjëherë më parë rrymat e ndryshme antimarksiste të trockistëve e të anarkistëve, të cilët, duke depërtuar në lëvizjet e ndryshme masive, sidomos të rinisë e të intelektualëve, përpiqen të peshkojnë në ujë të turbullt, me qëllim që t'i largojnë masat nga rruga e drejtë dhe t'i hedhin ato në aventura të rrezikshme që çojnë në disfata e deziluzione të rënda. Megjithëse këta shpesh dalin me parulla ultrarevolucionare dhe antirevizioniste, në fakt bëjnë lojën e revizionistëve dhe së bashku minojnë çështjen e revolucionit.

Ka edhe disa ideologë mikroborgjezë e njerëz me prirje të sinqerta revolucionare, që, të deziluzionuar nga tradhtia revizioniste, vënë në dyshim parimet themelore të marksizëm-leninizmit dhe përpiqen të krijojnë teori të reja ose të ringjallin të vjetrat. Ata predikojnë se marksizëm-leninizmi nuk është i plotë e i saktë, se ai gjoja nuk u përgjigjet më kushteve të reja historike të vendeve ose kontinenteve të ndryshme.

Në këtë situatë, kur është thelluar çoroditja ideologjike, që shkaktuan dhe që përpiqen ta mbajnë të gjallë revizionistët modernë, del qartë se ç'rëndësi të madhe merr lufta e të gjithë marksistë-leninistëve për çlirimin e klasës punëtore e të masave punonjëse nga të gjitha ndikimet e ideologjisë borgjeze, revizioniste dhe të rrymave të ndryshme mikroborgjeze, armatosja e tyre me ideologjinë e vetme shkencore, marksizëm-leninizmin.

«Një nga kushtet e domosdoshme për ta përgatitur proletariatin për fitoren e tij, — ka thënë Lenini, — është lufta e vazhdueshme dhe këmbëngulëse, lufta e pamëshirshme kundër oportunizmit, reformizmit, socialshovinizmit dhe kundër influencave dhe rrymave borgjeze të këtij lloji, që janë të pashmangshme derisa proletariati vepron në kushtet kapitaliste. Pa një luftë të tillë, pa fitoren e plotë paraprake mbi oportunizmin në lëvizjen punëtore, as që mund të flitet për diktaturë të proletariatit»¹.

Lufta ideologjike që zhvillohet sot në botë është mjaft e gjerë e shumë komplekse. Por problemet më themelore, për të cilat diskutohet janë ato mbi hegemoninë në lëvizjen revolucionare, mbi thelbin dhe rrugët e zhvillimit të revolucionit dhe mbi kuptimin e ndërtimin e shoqërisë socialiste.

Udhëheqja e klasës punëtore dhe e Partisë së saj marksiste-leniniste — kusht themelor për mposhtjen e borgjezisë dhe të imperializmit

Kundërshtarët ideologjikë të marksizëm-leninizmit, që nga ata borgjezë e revizionistë, radikalë e mikro-borgjezë, me fjalë dhe me vepra orvaten të mohojnë misionin historik botëror të klasës punëtore, rolin dhe

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 30, f. 308.

hegemoninë e saj në revolucion. Të gjithë së bashku, në këtë ose në atë mënyrë, përpiqen të vërtetojnë se idetë e marksizëm-leninizmit për këtë çështje janë vjetruar.

Duke spekuluar me fenomenet e reja të kapitalizmit të sotëm, sidomos me pasojat e zhvillimit të kapitalizmit monopolist shtetëror dhe të revolucionit tekniko-shkencor, ideologët borgjezë si Markuze me shokë, me teoritë e tyre teknokratike kërkojnë të vërtetojnë se gjoja shoqëria kapitaliste po deproletarizohet, klasa punëtore po shndërrohet në «bashkëpronare e bashkëdrejtuese» e ndërmarrjeve kapitaliste, se ajo nuk është më e interesuar për transformimin revolucionar të shoqërisë, pasi është «integruar» në sistemin kapitalist. Edhe kur ndonjëri nga këta shikon ndonjë forcë revolucionare, atë e gjen në shtresat që ndodhen në «kufi të klasave», në lumpenproletarët, në getot e qyteteve të mëdha, në emigrantët ose në studentët e intelektualët.

Revizionistët, nga ana tjetër, duke mbivlerësuar shtytjen objektive drejt socializmit që vjen nga zhvillimi i forcave të reja prodhuese dhe që forcohet nga ndikimi i raportit të ri të forcave në arenën ndërkombëtare në dobi të socializmit, përhapin pikëpamjet se luftën për socializëm mund ta udhëheqin edhe klasa e forca të tjera shoqërore joproletare që nga borgjezia kombëtare e mikroborgjezia e deri tek inteligjencia përparimtare e patriotike.

Këto pikëpamje i sjellin një dëm të madh lëvizjes revolucionare, krijojnë konfuzion në disa militantë të pakalitur dhe në shtresa të ndryshme të popullsisë,

sidomos në rininë studenteske dhe intelektualët e rinj, të cilët përpiqen ta paraqitin veten si forca të pavarura dhe kryesore të revolucionit, që nuk ndiejnë nevojën e hegjemonisë së klasës punëtore dhe të udhëheqjes politike të Partisë së saj marksiste-leniniste.

Çështja e hegjemonisë në revolucion ka rëndësi të madhe parimore, sepse nga fakti se kush është në krye të tij, se kush e udhëheq atë varen drejtimi, zhvillimi konsekuent dhe vetë fati i tij. Qëndrimi ndaj klasës punëtore dhe rolit të saj udhëheqës është një gur prove për gjithë revolucionarët. Heqja dorë nga ideja e hegjemonisë së proletariatit në lëvizjen e sotme revolucionare, siç theksonte Lenini, është pamja më vulgare e reformizmit.

Kushtet që e bëjnë klasën punëtore forcën vendimtare të zhvillimit të sotëm shoqëror, forcën drejtuese të luftës për transformimin revolucionar të botës kapitaliste nuk kanë ndryshuar aspak.

Klasa punëtore, me gjithë ndryshimet që ka pësuar bota e sotme kapitaliste, është e zhveshur nga çdo lloj prone mbi mjetet e prodhimit, nga drejtimi, organizimi e qëllimi i tij. E ashtuquajtura «shoqëri e konsumit» nuk është krijuar për të plotësuar nevojat e punonjësve, por për të intensifikuar shfrytëzimin e tyre dhe për të rritur fitimet e kapitalistëve. Është fakt se fitimet e monopoleve, trusteeve e koncerneve kanë arritur shifra astronomike, ashtu siç është fakt që vitet e fundit dhe pikërisht në vendet më të zhvilluara kapitaliste kanë shpërthyer me një forcë të paparë beteja të ashpra midis klasës punëtore dhe borgjezisë. Punëtorët e Francës, Italisë, Anglisë e Amerikës janë ngri-

tur në greva, kanë dalë në rrugë dhe pushtojnë fabrikat jo nga e mira, por sepse jeta e tyre është e rëndë, sepse makina kapitaliste i shtyp, i kthen në instrumente të thjeshta, i çnjerëzon.

Në kundërshtim me predikimet e ideologëve borgjezë e revizionistë, shoqëria kapitaliste nuk deproletarizohet, por proletarizohet vazhdimisht, pesha dhe roli i klasës punëtore në prodhim po bëhen gjithnjë e më vendimtarë, ajo mbetet forca kryesore prodhuese e shoqërisë. Jeta tregon se vetëm kur lëviz klasa punëtore, kur ajo ndërpret punën qoftë edhe për një ditë, tronditet e tërë borgjezia dhe vihen në gjendje alarmi të gjitha institucionet e saj. Klasa punëtore është klasa me tradita të pasura lufte e organizimi, ajo ka Partinë dhe teorinë e saj shkencore që e udhëheqin në luftën klasore.

Të gjitha forcat revolucionare që luftojnë për përmbysjen e rendit borgjez mund të arrijnë në fitore, vetëm në qoftë se shkrihen me luftën e klasës punëtore, nëse njohin e pranojnë rolin udhëheqës të saj dhe të partisë proletare marksiste-leniniste. Kjo është një domosdoshmëri objektive. Çdo alternativë tjetër çon në aventurizëm e disfatë. Këtij bashkimi të madh të të gjitha forcave të majta revolucionare me klasën punëtore borgjezia dhe revizionistët i tremben më shumë se çdo gjëje tjetër.

Veçanërisht i dëmshëm është në këtë çështje roli i socialdemokracisë dhe i revizionistëve modernë, të cilët, duke e inkuadruar klasën punëtore në sindikatat e tyre reformiste, orvaten të frenojnë hovin e saj revolucionar, të paralizojnë frymën luftarake, ta shndë-

rrojnë atë në një klasë raja, të bindur e të nënshtruar ndaj padronëve kapitalistë. Në këto kushte zgjimi i klasës punëtore dhe dalja e saj në krye të luftës revolucionare nuk mund të arrihen pa bërë një luftë të vendosur edhe në gjirin e vetë sindikatave reformiste kundër vijës e qëndrimeve të krerëve të tyre borgjezë, për demaskimin dhe izolimin e tyre nga masa e punëtorëve.

Në lëvizjen e sotme revolucionare një vend të rëndësishëm zënë rinia, studentët dhe shtresa të ndryshme të inteligjencies. Në shumë vende si në Francë e Itali, SHBA e Japoni, në Spanjë e në Amerikën Latine ata janë treguar mjaft aktivë dhe kanë dhënë prova guximi, vetëmohimi e fryme revolucionare. Por duhet pranuar se në lëvizjet e majta të intelektualëve e të studentëve vihet re një konfuzion i madh ideologjik e politik. Karakteri shpeshherë utopik i programeve dhe i parullave të tyre, mungesa e durimit dhe shpërthimet spontane e kanë burimin në ndikimin e ideologjive të huaja dhe në vetë natyrën klasore heterogjene të përbërjes së këtyre lëvizjeve.

Marksistë-leninistët u kushtojnë tërë vëmendjen lëvizjeve të majta të rinisë e të inteligjencies dhe pa i fshehur dobësitë që kanë këto lëvizje, luftojnë për t'i tërhequr ato në pozita të drejta revolucionare, për t'i çliruar nga ndikimet e ideologjisë borgjeze, mikroborgjeze e revizioniste.

Me gjithë rritjen e peshës së inteligjencies në shoqërinë e sotme, me gjithë ndryshimet që pëson pozita, karakteri dhe roli i punës së saj, si dhe përbërja klasore e kësaj shtrese, ajo nuk është një klasë më vetë. Inteligjencia është një shtresë që qëndron në mes të

klasave të ndryshme të shoqërisë dhe që vjen nga klasa të ndryshme. Për vetë këtë natyrë të saj ajo karakterizohet nga lëkundje të ndryshme politike e ideologjike. Këto lëkundje shtohen edhe më tepër, për shkak se borgjezia përpiket me të gjitha mënyrat ta korruptojë inteligjencien e ta vërë në shërbim të saj.

Inteligjencia, siç ka treguar Lenini dhe siç e vërteton jeta, asnjëherë nuk ka qenë dhe nuk mund të jetë një forcë sociale e politike e pavarur. Roli dhe vendi i saj në shoqëri janë në vartësi me prejardhjen klasore e gjendjen ekonomiko-shoqërore, me aleancën e reparteve të ndryshme të saj me këto ose ato klasa. Prandaj inteligjencia nuk mund të zëvendësojë kurrë rolin udhëheqës të klasës punëtore në revolucion.

Rinia, studentët, pjesa përparimtare e inteligjencies janë aleatë të afërt të klasës punëtore, por jo të vetmit. Hegjemonia e klasës punëtore shtrihet edhe mbi shtresa të tjera të popullsisë, të interesuara për revolucion, sidomos mbi fshatarësinë, e cila në shumicën dërrmuese të vendeve dhe të rajoneve të botës përfaqëson aleatet kryesore, më të fuqishme e më të vendosur të saj.

Revizionistët e sotëm përpiqen të mohojnë rëndësinë e madhe të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë nën pretekstin se fshatarësia nuk luan ndonjë rol të veçantë, sidomos në vendet e zhvilluara kapitaliste dhe në vend të saj nxjerrin në plan të parë aleancën e klasës punëtore me inteligjencien. Në disa vende të tjera revizionistët e zëvendësojnë aleancën midis klasës punëtore dhe fshatarësisë me aleancën e klasës punëtore me shtresat mikroborgjeze të qytetit e të periferisë së tij. Me këto teori e praktika ata synojnë t'i

shkëputin klasës punëtore aleaten më të afërt dhe më të vendosur në luftë. Teza leniniste se aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë është forca sociale e aftë të përmbysë borgjezinë dhe të ndërtojë socializmin është plotësisht e vlefshme edhe në kohën tonë.

Ashtu si fati i revolucionit në çdo vend të veçantë varet nga aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë, edhe në arenën ndërkombëtare fati i revolucionit botëror varet po nga i njëjti kusht, i cili në këtë rast shprehet si aleancë e vendeve socialiste dhe e lëvizjes punëtore në vendet e zhvilluara kapitaliste me lëvizjen anticolonialiste, çlirimtare e demokratike të popujve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine. Çdo qëndrim mospërfillës e denigrues ndaj luftës së popujve të këtyre kontinenteve, që përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë së botës dhe ku imperializmit i jepen sot goditjet më të forta e më të drejtpërdrejta, është në thelb një aspekt tjetër i mohimit të rolit të fshatarësisë, që i sjell një dëm shumë të madh çështjes së revolucionit.

Baza e aleancave zgjerohet edhe më tepër, kur është fjala për revolucione demokratike antiimperialiste, në të cilat mund të marrë pjesë, përveç fshatarësisë e mikroborgjezisë së qytetit, edhe borgjezia kombëtare. Por, cilado që të jetë pesha e tyre në çdo revolucion, ato nuk mund të luajnë dot atë rol hegjemon e udhëheqës që luan klasa punëtore. Borgjezia kombëtare, e lidhur me shfrytëzimin kapitalist, karakterizohet nga lëkundje e prirje për kompromis me imperializmin e jashtëm e reaksionin e brendshëm. Si e tillë, ajo nuk është e aftë ta çojë me konsekuencë e

deri në fund luftën çlirimtare e revolucionin demokratik. Edhe përfaqësuesit e fshatarësisë e të shtresave të tjera mikroborgjeze kanë kërkesa të kufizuara, janë nën ndikimin e ideologjisë borgjeze dhe shpeshherë lëkunden, sa nga e majta aq nga e djathta, duke shkarë herë në oportunizëm e herë në aventurizëm.

Prandaj klasa punëtore, si klasa më revolucionare e shoqërisë, mund dhe duhet të dalë në krye e të udhëheqë jo vetëm luftën për socializëm, por edhe luftën për demokraci e pavarësi kombëtare. Lenini e ka argumentuar këtë më se gjysmëshekulli më parë. Kjo është aq shumë e vërtetë sot kur klasa punëtore është rritur, kalitur, edukuar e organizuar në një shkallë më të lartë dhe kur detyrat demokratike e socialiste janë afruar e pleksur akoma më tepër. Në kushtet e sotme klasa punëtore është klasa më e interesuar se kushdo tjetër për të çuar deri në fund revolucionin demokratik e antiimperialist.

Numri i vogël i klasës punëtore në ndonjë vend nuk është argument për të mohuar rolin e saj udhëheqës, sepse forca dhe roli i klasës nuk varen nga numri. Rolin udhëheqës klasa punëtore e luan nëpërmjet partisë së saj, e cila, siç tregon edhe shembulli i vendit tonë, mund të krijohet e të dalë në krye të luftës revolucionare edhe kur klasa punëtore është e vogël në numër dhe e paorganizuar.

Sot janë gjallëruar teoritë e ndryshme që predikojnë spontaneitetin në lëvizjen revolucionare, që përçmojnë rolin e faktorit të ndërjegjshëm, që mohojnë rolin e teorisë dhe të Partisë së proletariatit. Degjenerimi i partive revizioniste, shndërrimi i tyre në parti

reformiste të padëmshme për borgjezinë dhe tezat anti-marksiste të revizionistëve modernë sovjetikë, jugosllavë, italianë e të tjerë, se «kapitalizmi po integrohet në socializëm në mënyrë të ndërgjegjshme ose të pandërgjegjshme, graduale ose rrënjësore», se «bartës të idealeve të socializmit dhe udhëheqës të luftës për realizimin e tyre mund të bëhen edhe parti e organizata politike joproletare», se «drejt socializmit ecin edhe disa vende ku në fuqi është borgjezia e re nacionale» etj., janë bërë bazë për përhapjen e pikëpamjeve më ekstremiste që mohojnë krejtësisht rolin e teorisë dhe nevojën e partisë së klasës punëtore. Ka edhe të tillë njerëz që hiqen si revolucionarë të kulluar, të cilët arrijnë deri atje sa të thonë se «në teorinë e Marksit mbi revolucionin nuk ekziston as vendi, as nevoja mbi partinë» se «pararoja e revolucionit socialist nuk mund të barazohet me partinë marksiste-leniniste», se rolin e partisë mund ta luajë «pakica aktive» që del si «ferment» në lëvizjen spontane, se nga «vetë aksioni revolucionar lind edhe ndërgjegjja e organizimi revolucionar».

Të gjitha këto «teori» i sjellin një dëm të pallogaritshëm lëvizjes revolucionare, pasi e trullosin dhe e lënë klasën punëtore të çarmatosur përpara sulmit të borgjezisë, e cila nga ana e saj ka perfeksionuar në kulm metodat e mjetet e propagandës, organizimin e luftës kundër revolucionit e komunizmit.

Tashmë është provuar historikisht se pa partinë e saj klasa punëtore, në çfarëdo kushtesh që të jetojë e të veprojë, nuk bëhet vetvetiu e ndërgjegjshme. Ajo që e shndërron klasën punëtore nga një «klasë më ve-

te» në një «klasë për vete» është partia. Natyrisht lufta, aksioni i kalitin e i sprovovjnë klasën, masat dhe revolucionarët, u mësojnë atyre shumë gjëra. Por, po mungoi partia politike me një program të qartë, me strategji e taktikë shkencore, lufta ose mbetet në mes të rrugës, ose dështon. Këtë na mëson edhe përvoja e lëvizjes së sotme revolucionare dhe e luftërave të shumta të popujve të kontinenteve të ndryshme.

Edhe kur disa nga revizionistët e oportunistët e ndryshëm e pranojnë nevojën e ekzistencës së partisë, shtrembërojnë keq rolin dhe parimet organizative të ndërtimit të saj. Ata i shpallin të vjetruara e të kapërcyera idetë e Leninit për këto çështje. Në mënyrë të veçantë ata sulmojnë parimin sipas të cilit partia është jo vetëm pararoja e ndërgjegjshme e klasës, por edhe forma më e lartë e organizimit të saj, që karakterizohet nga një unitet mendimi e veprimi dhe së cilës i përket roli udhëheqës në tërë veprimtarinë revolucionare në çdo fushë që ajo zhvillohet. Disa prej tyre e reduktojnë rolin e partisë në një organizatë orientimi e edukimi politik e ideologjik, ose në një qendër koordinuese e informacioni. Të tjerë e identifikojnë atë me gueriljen, ose shprehen për «partneritetin» e barabartë të partisë marksite-leniniste me partitë dhe organizatat e tjera të klasës punëtore e të masave punonjëse.

Roli udhëheqës i partisë së klasës punëtore në luftën për socializëm, si në kushtet e ekzistencës së një partie, ashtu edhe në kushtet e ekzistencës së shumë partive, është një ligj objektiv. Transformimi revolucionar i shoqërisë kapitaliste mbi baza socialiste është

një luftë e gjerë e shumë e ndërlikuar që zhvillohet në forma të shumta dhe në të gjitha fushat — ekonomike, politike, ideologjike e ushtarake. Në këtë luftë klasa punëtore hyn në aleanca me forca shoqërore e politike të ndryshme. Të gjitha format e luftës e të organizimit, të gjitha repartet e lëvizjes revolucionare duhet t'i shërbejnë një qëllimi. Këtej del nevoja e partisë si një qendër e vetme drejtuese, udhëheqëse e organizuese.

Lufta për socializëm ka si bazë teorike ideologjinë e klasës punëtore, marksizëm-leninizmin, i cili është doktrina shkencore që jep kuptimin e vetëm të drejtë të socializmit dhe të rrugëve për realizimin e tij. Bartëse e kësaj teorie, përpunuesja e zbatuesja e saj në jetë nuk mund të jetë asnjë parti e organizatë tjetër veç partisë komuniste të proletariatit, partisë së asaj klase që i përket e ardhmja socialiste e komuniste, që mbron interesat rrënjësorë të punonjësve e të të gjitha forcave përparimtare të shoqërisë e që lufton për to, partia e klasës, që, siç ka thënë Marksi, nuk mund të çlirojë vetveten pa çliruar gjithë njerëzimin. Në qoftë se fati i revolucionit i lihet një qendre orientimi të përgjithshme, një organizatë thjesht koordinuese ose gueriljes, ai do të futet në qorrrokak dhe do të pësojë disfatë.

Përmbajtja objektive e të gjitha «teorive», që mohojnë nevojën e rolit udhëheqës të klasës punëtore dhe të partisë së saj, është në fakt mohimi i revolucionit, i socializmit dhe i marksizëm-leninizmit. Këto koncepte çojnë ujë vetëm në mullirin e borgjezisë e të kundërrevolucionit. Prandaj demaskimi i tyre dhe

mbrojtja e vendosur e mësimëve leniniste mbi hegjemoninë e klasës punëtore, mbi rolin udhëheqës të partisë së proletariatit dhe e parimeve të ndërtimit e të organizimit të saj — përbëjnë sot një detyrë shumë të rëndësishme e aktuale për të zhdukur konfuzionin dhe çoroditjen që kanë krijuar revizionistët në këtë fushë, për të çuar përpara revolucionin, luftën për socializëm e komunizëm.

Revolucioni — rruga e çlirimit të njerëzimit

Ideja se revolucioni është i vetmi mjet për transformimin e botës, e vetmja rrugë për shpëtimin nga zgjedha kombëtare e shoqërore ka pushtuar mendjet e miliona njerëzve në të gjitha kontinentet. Për revolucionin tani flasin të gjithë. Por konceptet mbi përmbajtjen, forcat lëvizëse, rrugët e format e zhvillimit të tij, janë nga më të ndryshmet. Të gjitha këto janë objekt i një lufte dhe polemike të madhe ideologjike.

Edhe në këtë çështje me rëndësi jetike revizionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, kanë dalë në mbrojtje të interesave të borgjezisë dhe u shërbejnë atyre. Ata përpiqen të mbjellin konfuzion në radhët e revolucionarëve dhe t'i vënë minat revolucionit. Megjithëse për demagogji hiqen sikur janë për revolucionin, me pikëpamjet dhe veprimet e tyre revizionistët përpiqen ta mbytin që në embrion ose ta sabotojnë kur ai shpërthen. Tërë teorinë e praktikën e revolucionit ata e kanë reduktuar në reformat brenda rendit kapitalist. Ata mundohen t'u mbushin mendjen punonjësve

se gjoja në kohën tonë kufiri midis revolucionit e reformave është fshirë plotësisht. Me të madhe ata propagandojnë se klasa punëtore ka mundësi të realizojë transformime rrënjësore në bazën ekonomike të kapitalizmit, të zërë pozita të rëndësishme, të shtjerë në dorë të gjithë pushtetin dhe të realizojë socializmin pa revolucionin me dhunë, pa thyer makinën e shtetit borgjez dhe pa vendosur diktaturën e proletariatit.

Në praktikën e tyre revizionistët kapen vetëm pas kërkesave të ditës. Tërë përpjekjet ata i kanë përqendruar në zgjerimin e demokracisë borgjeze, në perfeksionimin e institucioneve të saj dhe për hir të tyre bëjnë fli qëllimin e fundit. Këtë e tregojnë sot më së miri gjithë veprimtaria e revizionistëve italianë, francezë e të tjerë, të cilët janë kthyer në bisht të borgjezisë, në mburojë të rendit të saj, kanë tradhtuar interesat jetikë të klasës punëtore dhe kanë shkuar aq larg sa të dënojnë me egërsi çdo veprim revolucionar të masave që prek sundimin e borgjezisë. Revizionistët modernë, megjithëse shprehen kundër dhunës revolucionare të masave dhe justifikojnë dhunën e borgjezisë, atje ku janë vetë në fuqi zbatojnë dhunën kundërrevolucionare, siç ndodhi në Çekoslovaki e Poloni, ku me zjarr e hekur shtypën popullin çekoslovak dhe revoltën e klasës punëtore polake. Këtu duket edhe më qartë tradhtia e degjenerimi i plotë i tyre.

Dështimi i teorive evolucioniste e paqësore të revizionistëve modernë vërtetohet edhe nga zhvillimi i ngjarjeve të sotme në botë. Luftërat antiimperialiste e çlirimtare që kanë shpërthyer në Azi, në Afrikë e në Amerikën Latine, revoltat e punëtorëve e të masave

punonjëse në vetë vendet e zhvilluara kapitaliste dëshmojnë se alternativa reformiste revizioniste nuk u përgjigjet realitetit dhe aspiratave të masave. Në fakt veprimtaria e sotme revolucionare zhvillohet pa revizionistët dhe kundër vullnetit të tyre. Megjithëkëtë nuk duhet të nënvlerësohet rreziku dhe dëmi i teorive dhe i praktikave revizioniste. Shumë njerëz, ndër të cilët ka edhe revolucionarë të sigurtë, duke hedhur poshtë rrugën reformiste të revizionistëve dhe duke e kritikuar atë, kanë përqafuar disa koncepte të tjera të gabuara për revolucionin dhe për rrugët e zhvillimit të tij. Kjo lidhet me pozitën klasore mikroborgjeze, me mungesën e formimit të tyre ideologjik marksist-leninist dhe me ndikimet që ushtrojnë mbi ta pikëpamjet anarkiste, trockiste e puçiste. Disa prej tyre revolucionin e konceptojnë si një grusht ushtarak, si vepër të disa «heronjve». Ata mbivlerësojnë e absolutizojnë rolin e «aktivitetit subjektiv» dhe mendojnë se situata revolucionare, si kusht për shpërthimin e revolucionit, mund të krijohet artificialisht nga «veprimet aktive» të një grupi luftarak, i cili shërben si «motor i vogël», që vë në lëvizje «motorin e madh» të masave. Sipas tyre potenciali revolucionar i masave në shoqërinë kapitaliste është kurdoherë gati të shpërthejë, mjafton një shtytje nga jashtë, mjafton të krijohet një vatër gueriljeje dhe masat do ta ndjekin atë automatikisht.

Lufta e armatosur e grupit të revolucionarëve profesionistë mund të ushtrojë ndikim në hovin e masave vetëm atëherë kur ajo bashkërendohet me faktorë të tjerë objektivë politikë, socialë e psikologjikë që përcaktojnë lindjen e situatës revolucionare, kur ajo

mbështetet në masat e gjera të popullit dhe gëzon simpatinë e përkrahjen e tyre aktive. Ndryshe, siç tregon praktika tragjike e disa vendeve të Amerikës Latine, veprimi i pakicës së armatosur, sado heroik dhe vetëmohues të jetë, ndesh në moskuptimin e masave, izolohet nga masat dhe pëson disfatë.

Revolucionet pihen nga vetë situata, kurse fitorja ose disfata e tyre varen nga gjendja dhe roli i faktorit subjektiv. Këtë faktor nuk mund ta përfaqësojnë vetëm një grup njerëzish, sado të ndërgjegjshëm që të jenë ata për nevojën e revolucionit. Revolucioni është vepër e masave. Pa bindjen, përgatitjen, mobilizimin dhe organizimin e tyre asnjë revolucion nuk mund të fitojë. Faktori subjektiv nuk përgatitet vetëm nga aksionet e «vatrës» guerile, as vetëm me agjitacion e propagandë. Për këtë, siç na mëson Lenini dhe vetë jeta, është e domosdoshme që masat të binden nëpërmjet eksperiencës së tyre praktike.

Koncepti për rolin vendimtar të pakicës së armatosur shoqërohet edhe me pikëpamjet e zhvillimit të luftës vetëm në fshat ose vetëm në qytet, se duhet kapur vetëm pas luftës së armatosur dhe vetëm pas veprimtarisë ilegale. Përhapje të gjerë ka marrë edhe teza trockiste që e sheh revolucionin si një akt të menjëhershëm dhe grevën e përgjithshme politike si të vetmen formë të kryerjes së tij. Të orientohesh nga lufta e armatosur, nuk do të thotë aspak të heqësh dorë nga të gjitha format e tjera të luftës, nuk do të thotë të përqendrohesh në fshat e të braktisësh luftën në qytet ose anasjelltas, të kapesh vetëm pas objektivit final — marrjes së pushtetit e të lësh pas dore «luf-

tën e vogël» për kërkesat e ngutshme ekonomike, politike e sociale të punonjësve, nuk do të thotë të merrsh vetëm me organizimin e forcave të armatosura e të mos përfillësh punën me masat dhe në organizatat e tyre, të punosh e të luftosh vetëm në ilegalitet e të heqësh dorë nga shfrytëzimi i mundësive legale e gjysmëlegale etj. Përgatitja e revolucionit nuk është çështje e një dite, por është një punë e gjithanshme e komplekse. Për të duhet punuar e luftuar në të gjitha drejtimet e me të gjitha format, duke i kombinuar ato drejt e duke i ndryshuar kur ndryshojnë situatat, por kurdoherë duke ia nënshtruar arritjes së qëllimit të fundit.

Revolucioni nuk bëhet vetëm nga klasa punëtore dhe aq më pak vetëm nga partia e saj pararojë. Për kryerjen e tij klasa punëtore, sipas karakterit dhe etapave të revolucionit, hyn në aleanca me forca të tjera shoqërore, me të cilat ka interesa themelore të përbashkët, krijon fronte të gjera popullore me programe të caktuara politike, në të cilat partia e klasës punëtore nuk shkrihet, por ruan kurdoherë pavarësinë e saj organizative e politike. Elementët e ngushtë e sektarë i quajnë të gjitha këto taktika të gabuara që i hapin gjoja dyert rrugës paqësore e reformiste. Sipas tyre, programet, frontet, aleancat janë vetëm makinacione artificiale që kanë për qëllim të tërheqin vëmendjen dhe të pengojnë luftën e armatosur. Këto pikëpamje janë jehonë e tezave të njohura të trockistëve, të cilët çdo aleancë e shohin si pajtim klasor, mohojnë etapat e revolucionit dhe janë për revolucionin proletar «të kulluar» e të drejtpërdrejtë.

Revolucioni ka ligjet e tij që janë të përgjithshme

e të domosdoshme për çdo vend. Mohimi i këtyre ligjeve të çon në revizionizëm. Duke spekuluar me ndryshimet që bëhen në botë dhe me kushtet e veçanta kombëtare, revizionistët të vërtetat universale të marksizëm-leninizmit i kanë zëvendësuar me tezat e konkluzionet e tyre antimarksiste e kundërrevolucionare. Por jo më pak të dëmshme janë edhe konceptet dogmatike të atyre që nuk përfillin veçoritë kombëtare, largohen nga analiza e gjendjes reale, ndërtojnë skema, në të cilat përpiqen të futin realitetin e vendeve të ndryshme, absolutizojnë eksperiencën e një vendi dhe e japin atë si universale, flasin për një revolucion kontinental dhe mohojnë mundësinë e fitores së revolucionit në një ose disa vende të veçanta.

Në ditët tona, kur vala e revolucionit është në ngjijtje, kur në mjaft vende e zona revolucionit qëndron në rend të ditës, kuptimi i drejtë i përmbajtjes, i rrugëve dhe i formave të zhvillimit të tij është vendimtar. Lufta kundër koncepteve revizioniste e antimarksiste të djathta e të majta, lufta për zbatimin krijues të mësimëve themelore të marksizëm-leninizmit për këtë çështje është pjesë përbërëse e luftës klasore, kusht i domosdoshëm për fitoren e revolucionit.

Socializmi mund të ndërtohet vetëm mbi bazën e teorisë marksiste-leniniste

Triumfi i Revolucionit të Tetorit në Rusi shënoi fillimin e epokës së madhe në historinë e njerëzimit, atë të kalimit nga kapitalizmi në socializëm. Që nga

ajo kohë socializmi u shndërrua nga një teori shkencore në një realitet të gjallë, i cili, me gjithë tradhtinë revizioniste, ka treguar plotësisht epërsitë e tij të padiskutueshme në të tëra fushat mbi rendin kapitalist. Të gjitha fitoret e socializmit janë arritur mbi bazën e teorisë shkencore të marksizëm-leninizmit.

Si një rend i ri shoqëror, që ndërtohet në kushtet e një lufte të ashpër klasore midis proletariatit dhe borgjezisë në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, socializmi nuk mund të zhvillohet qetë, pa vështirësi e kontradikta. Lufta midis dy rrugëve të zhvillimit, rrugës socialiste e kapitaliste, është një luftë e gjatë dhe përderisa vazhdon ajo, ekziston kurdoherë rreziku i restaurimit të kapitalizmit. Por ky rrezik nuk është fatal, siç përpiqen ta paraqitin ideologët borgjezë. Ai është plotësisht i shmangshëm, në qoftë se partia komuniste u qëndron besnike mësimëve të marksizëm-leninizmit, zhvillon me vendosmëri e konsekuencë luftën e klasave kundër ndikimeve e presioneve të botës së vjetër, di të zgjidhë me sukses vështirësitë e kontradiktat që lindin, në qoftë se i mbyll të gjitha shtigjet mundësisë së degjenerimit borgjez.

Kthimi prapa i Bashkimit Sovjetik dhe i disa vendeve të tjera lidhet pikërisht me faktin se atje u braktisën mësimet e marksizëm-leninizmit dhe u hoq dorë nga parimet themelore të ndërtimit socialist, iu vu kazona fitoreve të revolucionit dhe iu hap rruga rivendosjes së kapitalizmit. Por nuk është ky dëmi i vetëm i madh që revizionistët i sollën socializmit. Për t'i hapur rrugë tradhtisë së tyre ata sulmuan me tërbim vijën revolucionare të ndjekur nga Partia Komu-

niste Bolshevike, me Stalinin në krye, dhe tërë eksperiencën historike të diktaturës së proletariatit, vunë në dyshim vitalitetin e shkencës marksiste-leniniste për zgjidhjen e problemeve të kohës së sotme, aftësinë e klasës punëtore për transformimin revolucionar të shoqërisë dhe rolin udhëheqës të partisë komuniste. Me të gjitha këto revizionistët hrushovianë u dhanë armë të fuqishme ideologëve borgjezë për propagandën e tyre antikomuniste. Ata u bënë burim i përhapjes së gjithfarë koncepteve antimarksiste mbi socializmin.

Konfuzioni shtohet edhe më shumë ngaqë revizionistët hrushovianë restaurimin e kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik e gjetkë përpiqen ta shesin për socializëm. Nga kjo demagogji ngatërrohen edhe shumë njerëz të ndershëm, të cilët, duke kritikuar me të drejtë shumë fenomene negative në jetën e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera revizioniste, e identifikojnë rendin e tyre me socializmin dhe pasojat e rivendosjes së kapitalizmit ia veshin socializmit. Rrymat e tjera revizioniste, që kanë kontradikta me udhëheqjen sovjetike, kritikojnë «modelin sovjetik të socializmit» si burokratik e totalitar dhe propagandojnë modelin e tyre «demokratik e humanitar», që nuk është veçse një variant tjetër i kapitalizmit. Degjenerimin borgjez të socializmit në vendet ku në fuqi janë revizionistët përpiqen ta shfrytëzojnë edhe elementët e grupet trockiste për të përhapur shpifjet e tyre kundër socializmit, të cilat i kanë inkurajuar vetë revizionistët me teoritë e praktikat e tyre antimarksiste.

Në këto kushte mbrojtja e teorisë dhe e praktikës së socializmit shkencor nga sulmet e deformimet e re-

vizionistëve modernë të ngjyrave e nuancave të ndryshme dhe të rrymave të tjera borgjeze e mikroborgjeze është një nga detyrat më të rëndësishme në luftën e sotme ideologjike. Para së gjithash duhet grisur deri në fund maska socialiste që i kanë vënë vetes revizionistët që janë në fuqi, sidomos krerët sovjetikë.

Në Bashkimin Sovjetik janë likuiduar diktatura e proletariatit dhe partia e proletariatit, në fuqi nuk është më klasa punëtore, por borgjezia e re revizioniste. Shteti dhe partia janë shndërruar në vegla në duart e revizionistëve për të mbrojtur e konsoliduar sundimin e tyre politik e ekonomik. Maskat socialiste dhe komuniste që ata u vënë shtetit dhe partisë së tyre janë vetëm për të mashtruar njerëzit, sepse karakteri i shtetit dhe i partisë nuk përcaktohet nga emrat dhe as vetëm nga përbërja e tyre shoqërore, por në radhë të parë e mbi të gjitha nga politika që ndjekin, kujt i shërben dhe në dobi të kujt është ajo.

Ndryshimi i karakterit të partisë e të shtetit, transformimi kundërrevolucionar në fushën e superstrukturës politike e ideologjike nuk mund të mos çonte në ndryshimin edhe të bazës ekonomike të socializmit. Reformat ekonomike që kanë ndërmarrë hrushovianët, në përputhje me konceptet e tyre ideologjike anti-marksiste, çuan në ndryshimin rrënjësor të marrëdhënieve në prodhim. Ata futën në ekonominë sovjetike një sistem të tillë organizimi e drejtimi ku qëllimi i prodhimit u bë nxjerrja e fitimit kapitalist. Shteti i sotëm sovjetik si një kapitalist kolektiv administron mjetet e prodhimit në emër dhe në interes të borgjezisë

së re sovjetike. Prona e përbashkët socialiste u shndërrua në një kapitalizëm shtetëror të një tipi të ri.

Duke shtënë në dorë frenat e shtetit e të ekonomisë, borgjezia e re sovjetike, e përbërë nga burokratët dhe teknokratët, i përdor ato për të siguruar për vete privilegje dhe të ardhura të mëdha. Po thellohet gjithnjë më shumë hendeku midis saj dhe klasës punëtore e masave punonjëse. Ajo ka zëvendësuar shpërblimin sipas punës me një sistem të tërë të ndarjes së të ardhurave, që i jep mundësi të përvetësojë punën dhe djersën e masave punonjëse, të sigurojë në rrugë nga më të ndryshmet të ardhura me dhjetëra herë më të mëdha nga ato të punëtorëve e të fshatarëve.

Në Bashkimin Sovjetik po zhvillohet një proces i thellë shturjeje, dekadence e degjenerimi në të gjitha fushat — të ideologjisë, moralit, arsimit e kulturës. Po shkallmohen të gjitha vlerat morale e shpirtërore të socializmit. Ideologjia borgjeze me të gjitha pasojat e saj po bëhet ideologjia sunduese. Vendin e normave të moralit komunist për t'i shërbyer me devocion çështjes së popullit po e zë rendja pas interesit personal, individualizmi e karrierizmi. Përpjesëtime të gjera ka marrë mënyra borgjeze e jetesës. Janë braktisur fryma revolucionare dhe partishmëria proletare në art e në kulturë. Shkolla sovjetike kultivon teknokratizmin e intelektualizmin, përgatit kontingjente të reja për revizionistët.

Rivendosja e kapitalizmit brenda në Bashkimin Sovjetik nuk mund të mos çonte në ndryshimin rrënjësor të politikës së tij të jashtme. Udhëheqësit e sotëm sovjetikë e kanë zëvendësuar internacionalizmin proletar

me egoizmin nacional dhe shovinizmin e shtetit të madh. Bashkimi Sovjetik është bërë sot një fuqi imperialiste që ndjek një politikë agresive. Nga një bazë e revolucionit botëror, Bashkimi Sovjetik është shndërruar në një bazë të kundërrevolucionit.

Të gjitha këto tregojnë se Bashkimi i sotëm Sovjetik nuk mund të quhet më një vend socialist, por një shtet kapitalist e një fuqi imperialiste. Të këqijat e politikës së tij të brendshme dhe të jashtme nuk janë të këqija të socializmit, siç i paraqit ato propaganda borgjeze dhe ata që kanë rënë viktime të saj ose i mbajnë ison asaj. Ato janë të këqija të vetë sistemit kapitalist që është rivendosur në Bashkimin Sovjetik. Ato nuk mund të ndreqen me riparime të pjesshme. Çdo iluzion do të ishte tepër i rrezikshëm. Ato do të zhduken vetëm atëherë kur të jenë përmbysur revizionistët dhe të jetë rivendosur diktatura e proletariatit.

Në situatën e krijuar nga tradhtia e revizionistëve sovjetikë dhe nga propaganda antikomuniste e borgjezisë një reklamë e madhe i bëhet sidomos «sistemit të vetadministrimit» jugosllav si rruga më e mirë e ndërtimit të socializmit. Partizanë të kësaj rruge janë, veçanërisht, shumë revizionistë në vendet kapitaliste perëndimore. Ajo ka simpatizantët e vet edhe në vendet revizioniste të Evropës Lindore. Teoricienët e «socializmit vetadministrues» pretendojnë se shprehin dhe zbatojnë idetë autentike të Marksit e të Leninit mbi socializmin, të shtrembëruara gjoja në praktikën e derisotme nga «stalinizmi». Në të vërtetë ata kanë ringjallur e marrin në mbrojtje teoritë e vjetra anarko-sindikaliste e buhariniste të kritikuara në kohën e vet

nga Marksi e Lenini. Argumentet e tyre teorike janë krejt pa baza, kurse realiteti i sotëm jugosllav është prova më e qartë e dështimit të «sistemit të vetadmirimit».

Baza e teorive të revizionistëve jugosllavë është ideja buhariniste e integritit të kapitalizmit në socializëm. Në arenën ndërkombëtare, sipas tyre, kapitalizmi i pasluftës së Dytë Botërore, krahas me stabilizimin dhe evoluimin e tij në një kapitalizëm shtetëror, po shndërrohet gradualisht në një «socializëm të tipit etatist», duke fshirë kështu kufijtë midis dy sistemeve dhe duke hapur rrugën për një bashkëpunim të gjerë e të gjithanshëm midis tyre, për të minuar në fakt socializmin e vërtetë.

Brenda vendit, revizionistët jugosllavë, si edhe ata gomulkianë, braktisën kolektivizimin e fshatit, i lanë të lirë kulakët të shfrytëzonin e të akumulonin, duke pretenduar se kështu do të integronin ata në socializëm dhe me kapitalet e furnizuara prej tyre do të bënin industrializimin e vendit. Nga ana tjetër, revizionistët jugosllavë copëtuan pronën shtetërore të të gjithë popullit dhe duke e shndërruar atë gjoja në pronë grupi, i hapën rrugën lindjes së një borgjezie të re, e cila mori në dorë frenat e vendit dhe tani sundon mbi klasën punëtore dhe popujt e Jugosllavisë. Njëkohësisht revizionistët blafonin, duke e paraqitur këtë vijë si një proletarizim të regjimit, si luftë kundër formave «burokratike etatiste të socializmit» si një «rrugë të re» për ndërtimin e shoqërisë së vërtetë socialiste. Por gjithë kjo u demaskua dhe jeta vërtetoi kalbësirën.

Për të dalë nga situata e rëndë, nga vështirësitë e kontradiktat e mëdha ekonomike, politike e sociale, pjellë e restaurimit kapitalist, revizionistët jugosllavë, pasi nuk mundën «të ndërtojnë socializmin» me ndihmën e borgjezisë së brendshme e të kapitaleve të saj, u shtrinë dorën imperialistëve amerikanë dhe kapitalistëve të vendeve të tjera. Ata shpikën kështu një «socializëm» të ri, i cili mund të ndërtohet me ndihmën e kredive dhe të investimeve të borgjezisë ndërkombëtare, e në radhë të parë të imperializmit amerikan, armikut më të egër të komunizmit. Fakt është se në Jugosllavinë e sotme vërshimi i kapitaleve dhe investimeve direkte të shteteve e firmave të huaja kapitaliste po pushton kyçet e ekonomisë kombëtare. Një proces i këtillë po zhvillohet edhe në vendet e tjera revizioniste.

Një shfaqje tjetër e këtij kursi në Jugosllavi është edhe fenomeni masiv i emigrimit të forcave të gjalla krijuese: me qindra mijëra punëtorë, teknikë e specialistë janë detyruar të braktisin familjet e atdheun e tyre dhe të shesin fuqinë e krahut e të mendjes te kapitalistët gjermanë, belgë, francezë e të tjerë. Kjo shitje e punonjësve, kjo tregti me njerëzit për të siguruar pak valutë është një nga pamjet më të shëmtuara të realitetit të sotëm jugosllav.

Në Jugosllavi për asnjë integrim të kapitalizmit në socializëm nuk mund të bëhet fjalë. Ajo që ka ndodhur atje dhe që po ndodh edhe në vendet e tjera ku në fuqi janë revizionistët është integrimi i socializmit në kapitalizëm, likuidimi i fitoreve socialiste dhe futja në rrugën kapitaliste.

Revizionistët jugosllavë pretendojnë se në sistemin e tyre afirmohet roli i vërtetë i punonjësit dhe i klasës punëtore në tërësi, e cila gjoja vetadministron mjetet e prodhimit, drejton ekonominë dhe bën shpërndarjen e produktit shoqëror. Në fakt ndodh krejt e kundërta. Copëtimi i pronës shtetërore dhe mohimi i rolit drejtues të shtetit socialist është copëtimi i klasës punëtore, mohim i rolit të saj udhëheqës në jetën e shoqërisë. Praktika jugosllave çon në kundërvënien e interesave të reparteve të ndryshme të klasës punëtore, në konkurrencën dhe luftën midis kolektivave punëtorë. Këtu në plan të parë dalin interesat e ngushtë e të çastit të ndërmarrjes, të komunës ose të republikave të veçanta, të cilat u kundërvihen interesave të përgjithshëm të shoqërisë.

Në këto kushte klasa punëtore nuk vepron dot si klasë, nuk shpreh e nuk mbron dot interesat e saj të përgjithshëm si klasë në fuqi. Në Jugosllavi klasa punëtore e ka humbur prej kohësh rolin e saj hegjemon. Ajo është shndërruar nga një klasë udhëheqëse në fuqi në një klasë që udhëhiqet, shtypet e shfrytëzohet nga borgjezia e re që ka tërë fuqinë në dorë. Partia komuniste e klasës punëtore në Jugosllavi ka degjeneruar plotësisht, ajo është bërë një strehë për shtresat antiproletare që përfaqësojnë e mbrojnë kursin kapitalist.

Jugosllavia e sotme ka të gjitha tiparet e një vendi borgjez dhe vuan po nga ato plagë të rënda e kronike që janë tipike për kapitalizmin, siç janë krizat e thella ekonomike, papunësia, konkurrenca, anarkia e inflacioni, konfliktet e ashpra sociale e politike

dhe grindjet nacionale. Kjo situatë ka çuar në krijimin e forcimin e grupimeve dhe tendencave nacionaliste borgjeze, në acarimin e luftës për hegjemoni midis tyre dhe midis republikave. Në skenën e sotme politike jugosllave zotërojnë klanet «serbomëdha» e «kroatomëdha». Të parëve u kanë vënë etiketën e informbyroistëve, por në fakt ata kanë qenë e janë armiq të betuar të Informbyrosë, aq sa janë edhe vetë udhëheqësit jugosllavë dhe ata hrushovianë sovjetikë.

Revizionistët jugosllavë i kanë vënë popujt e Jugosllavisë dhe klasën punëtore në një darë të fortë, në darën e borgjezisë së brendshme dhe të kapitalizmit të huaj, që po bëhet zot shtëpie. Nga kjo gjendje ata nuk mund t'i shpëtojnë as reformat ekonomike e politike të reklamuar nga revizionistët, as shpresat e iluzionet të këto ose tek ato grupime nacionaliste. E keqja i ka rrënjët të thella dhe ajo mund të shmanget vetëm kur popujt e Jugosllavisë, në rrugën marksiste-leniniste, do ta thyejnë darën që i ka mbërthyer.

Për socializmin sot flitet edhe në disa vende që janë çliruar nga sundimi i vjetër kolonial i imperializmit. Në nocionet «socializëm», «shoqëri socialiste» futen një përmbajtje e ndryshme në vendet e ndryshme. Në këto teori ka shumë gjëra të errëta, konfuze, eklektike, ka një përzierje të parimeve të socializmit me ato të kapitalizmit, të ideologjisë socialiste me ato të ideologjisë borgjeze, nacionaliste e fetare.

Këtyre teorive joshkencore u bëjnë jehonë edhe revizionistët sovjetikë e të tjerë. Ata kanë zbuluar bile edhe një rrugë të re, të ashtuquajturën «rrugë jokapitaliste të zhvillimit» që çon gjoja në socializëm pa ro-

lin udhëheqës të klasës punëtore e të partisë komuniste, pa teorinë marksiste-leniniste, pa revolucionin socialist e diktaturën e proletariatit. Me këto predikime revizionistët hrushovianë e të tjerë çorientojnë tendencat e sinqerta socialiste në këto vende, shtojnë konfuzionin ideologjik dhe paralizojnë luftën e forcave progresive për socializëm. Duke pretenduar se edhe këto vende gjoja kanë hyrë në rrugën e socializmit, revizionistët sovjetikë u japin atyre disa thërrime për t'u marrë shpirtin, për të shtrirë ndikimin e tyre imperialist dhe për t'i tërhequr ata pas qerres së tyre.

Marksistë-leninistët përshëndetin e përkrahin çdo prirje dhe aspiratë të sinqertë drejt socializmit, por në të njëjtën kohë ata theksojnë se socializmi në çdo vend ka fituar dhe mund të fitojë vetëm mbi bazën e marksizëm-leninizmit dhe nën udhëheqjen e klasës punëtore e të partisë së saj të armatosur me botëkuptimin proletar.

Në kohën tonë nuk shtrohet çështja as të kopjohen pseudosocializmat revizionistë, as të shpiken socializmat të rinj. Socializmi ekziston dhe zhvillohet si teori e si praktikë. Ai ka grumbulluar një përvojë të pasur historike, që është sintetizuar në teorinë marksiste-leniniste, e cila është vërtetuar në jetë për vitalitetin e saj. Duke u mbështetur në këtë teori shkencore dhe duke e zbatuar atë në kushtet e çdo vendi, forcat revolucionare do të gjejnë rrugën e drejtë për në socializëm.

Kuptimi i drejtë i socializmit është një çështje e madhe parimore, sepse ai ndihmon që aspiratat dhe lufta e popujve për socializëm të orientohen drejt, të synojnë në një objektiv të qartë. Prandaj për revolu-

cionarët ka rëndësi të veçantë vendosja e një kufiri dhe e një vije të qartë demarkacioni midis vendeve të vërteta socialiste dhe atyre që mbajnë vetëm emrin socialiste, ashtu siç ka rëndësi edhe dallimi midis partive e forcave të vërteta marksiste-leniniste që luftojnë për socializmin dhe atyre partive që mbajnë vetëm tabela komuniste. Kështu revolucionarët do të dinë më mirë se ku duhet të mbështeten dhe kë duhet të përkrahin. Në këtë mënyrë forcohet uniteti i vërtetë i forcave revolucionare dhe lufta për socializëm shkrihet në një rrymë të vetme, mbi bazën e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar.

Në luftën për çështjen e madhe të çlirimit të klasës punëtore e të popujve rriten e forcohen radhët e forcave marksiste-leniniste. Sot, gati kudo ku partitë e vjetra komuniste degjeneruan në revizioniste, janë formuar lëvizje e parti të reja marksiste-leniniste, të cilat kanë marrë në dorë flamurin e revolucionit e të socializmit, të braktisur nga revizionistët modernë.

Pjesëmarrja në Kongresin tonë e një numri kaq të madh delegatësh që përfaqësojnë komunistët e vërtetë revolucionarë nga vendet e Evropës, të Azisë, të Afrikës, të Amerikës Latine dhe të Oqeanisë është dëshmi e gjallë e zhvillimit të hovshëm që ka marrë lëvizja marksiste-leniniste, është një shprehje elokuente e karakterit dhe e unitetit ndërkombëtar të saj.

Rritja e lëvizjes marksiste-leniniste ka ngjallur urrejtjen e tërbuar të reaksionit dhe sidomos të revizionistëve modernë, të cilët shohin në të një armik të

tyre të rrezikshëm. Ata përpiqen ta denigrojnë atë dhe t'i vënë gjithfarë etiketash. Por gjithë kjo fushatë sulmesh e shpifjesh dëshmon se lëvizja marksiste-leniniste është në rrugë të drejtë.

Lëvizja marksiste-leniniste zhvillohet në kushtet e një lufte të ashpër klasore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare. Partitë dhe grupet e reja kanë përballë armiq të shumtë, reaksionin borgjez, tradhtinë revizioniste, reformizmin socialdemokrat, aventurizmin mikroborgjez. Por presioneve, intrigave e provokacioneve të tyre ato u bëjnë ballë me vigjilencë, qartësi ideologjike e vendosmëri revolucionare.

Në këtë luftë ajo që ka rëndësi dhe që përbën tendencën e përgjithshme të zhvillimit është se forcat marksiste-leniniste rriten, kaliten, organizohen dhe afirmohen përditë e më shumë si forca politike revolucionare në jetën e vendit të tyre.

Duke u hedhur në luftën e madhe politike, në aksionet konkrete e në lëvizjet revolucionare të punonjësve, ato po forcojnë lidhjet me masat dhe pasurojnë eksperiencën e tyre. Në zjarrin e betejave të reja klasore ato përsosin format e organizimit leninist të partisë dhe të gjithë veprimtarisë së saj, farkëtojnë unitetin e mendimit e të veprimit, forcojnë kompaktësinë e radhëve të tyre.

Në emër të delegatëve të Kongresit dhe të të gjithë komunistëve shqiptarë ne u shprehim marksistë-leninistëve, gjithë revolucionarëve të vërtetë, kudo që ndodhen, përsëndetjet e zjarra e urimet më të mira për fitore gjithnjë më të mëdha në dobi të çështjes sonë të madhe të përbashkët. Ne i sigurojmë ata se

Partia e Punës e Shqipërisë do të përkrahë e do ta mbështetë me të gjitha forcat e mundësitë e saj lëvizjen marksiste-leniniste, të gjithë ata që luftojnë kundër imperializmit e revizionizmit, për fitoren e revolucionit e të socializmit. Këtë ne e konsiderojmë si një detyrë internacionaliste të dorës së parë, ashtu si çmujmë solidaritetin dhe përkrahjen që u japin Partisë dhe vendit tonë partitë dhe forcat revolucionare si një faktor shumë të rëndësishëm për çështjen e socializmit në Shqipëri.

Shokë e shoqe delegatë,

Në këtë raport Komiteti Qendror i Partisë ju paraqiti një tablo të përgjithshme të asaj veprimtarie të madhe të Partisë dhe të asaj pune heroike e vetëmohuese të popullit tonë të kryer në pesë vjetët e fundit në të gjitha frontet e ndërtimit socialist. Fitoret e arritura na i mbushin zemrat me gëzim dhe na frymëzojnë, na japin forca të reja për të ecur gjithnjë përpara ballëllart e të sigurt në rrugën e drejtë e të ndritur ku na udhëheq Partia.

Detyrat e problemet që kemi për të zgjidhur janë të shumta e të rënda, por ato janë sa fisnike, aq edhe të lavdishme. Ato synojnë të forcojnë edhe më tej çështjen e socializmit në Shqipëri, dhe t'i japin një hov të ri e të fuqishëm ekonomisë, ndërtimit, kulturës e të gjithë sektorëve të tjerë dhe t'i ngrenë në një shkallë më të lartë, të zbukurojnë edhe më tepër jetën e njerëzve tanë, të garantojnë punën paqësore të popullit, lirinë e pavarësinë e atdheut.

Ne jemi entuziastë e optimistë se objektivat e caktuar do t'i arrijmë e do t'i tejkalojmë. Këtë siguri e bindje e gjejmë në popullin tonë të mrckullueshëm, në mençurinë dhe urtësinë e tij të thellë, në frymën revolucionare dhe duart e arta të klasës punëtore, në patriotizmin e fshatarësisë kooperativiste, në devocionin e inteligjencies popullore, në vrullin e papërmbajtur krijues të rinisë, në energjitë e pashtershme të grave të vendit tonë. Këtë siguri e bindje e gjejmë në Partinë tonë heroike, në vijën e saj të drejtë marksist-leniniste, në vendosmërinë e komunistëve shqiptarë, që, për çështjen e popullit e të socializmit, ashtu si gjithnjë, janë të gatshëm të kapërcejnë çdo vështirësi e pengesë, të bëjnë çdo sakrificë.

Përpara, shokë, drejt fitoresh të reja për lumturinë e begatinë e popullit dhe të atdheut tonë socialist!

Rroftë populli ynë heroik, trim e punëtor!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë, udhëheqësja e sprovuar dhe farkëtuesja e të gjitha fitoreve të popullit tonë!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 262 (7239), 2 nëntor 1971

Botohet sipas librit: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. VI, Tiranë, 1978, f. 75

PARTINË TA MBAJMË GJITHMONË TË SHKATHËT, REVOLUCIONARE, ME INICIATIVË

*Fjala në Kongresin e 6-të të PPSH, në emër të
përfaqësisë, për paraqitjen e kandidaturave
për në organet drejtuese të Partisë*

6 nëntor 1971

Shokë dhe shoqe,

Ju na ngarkuat ne të përfaqësisë detyrën e përgatitjes së projektit me kandidaturat për në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Komisionit Qendror të Kontrollit dhe të Revizionimit që do të zgjedhë Kongresi i 6-të i Partisë.

Kjo ishte një detyrë shumë e rëndësishme dhe delikate, prandaj përfaqësia punoi me ndjenjën e përgjegjësisë për të dalë para Kongresit me një përgatitje serioze, duke u mbështetur në orientimet e drejta marksiste-leniniste të Partisë për përbërjen e organeve udhëheqëse të saj, si edhe në orientimet e përgjithshme mbi politikën e kuadrit.

Në sajë të punës së kujdesshme që ka bërë e gjithë Partia, janë rritur e po rriten kudo vazhdimisht një numër i madh kuadros. Pikërisht nga radhët e

kësaj armate të madhe revolucionarësh marksistë-leninistë ne u përpoqëm të zgjidhnim ndër më të përshtatshmit për në Komitetin Qendror. Udhëheqja e Partisë që përpara është ndihmuar në këtë punë nga mendimet e shokëve të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë dhe të kuadrove kryesorë të Partisë në rrethe. Gjithashtu, ne jemi bazuar në gjithë praktikën e punës të organizatave dhe organeve të Partisë që kanë ndjekur udhëheqja dhe aparati i Komitetit Qendror gjatë gjithë jetës së Partisë dhe periudhës midis dy kongreseve. Si rrjedhim, është bërë një punë e madhe paraprake, që e ndihmoi shumë përfaqësinë të hartojë listën me kandidaturat që do t'ju paraqes sot juve për shqyrtim dhe aprovim.

Përfaqësia e gjeti me vend t'i propozojë Kongresit që Plenumi i ardhshëm i Komitetit Qendror të Partisë të përbëhet prej 110 vetash, ndër të cilët 71 anëtarë dhe 39 kandidatë, nga 97 që ka pasur deri sot (61 anëtarë dhe 36 kandidatë).

Në të gjitha kongreset kandidatët e Komitetit Qendror kanë zënë rreth 35 për qind të efektivit të Plenumit. Ky raport mendojmë të mbetet edhe për të ardhmen.

Shifrat për rritjen e numrit të anëtarëve të plenumit janë llogaritur gjithnjë shkencërisht, në bazë të rritjes së efektivit të Partisë, të numrit të kuadrove, të zgjerimit të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, kulturës, shërbimit, ushtrisë etj. Duke studiuar të gjitha të dhënat që nga Kongresi I e deri tani, përfaqësia arriti në përfundimin se rritja e Plenumit, duke përfshirë edhe parashikimin që ju propozova për Plenumin që do

të zgjedhë ky Kongres, është normale dhe plotësisht e justifikuar.

Kaq kisha për numrin.

Tani më lejoni t'ju raportoj edhe për kriteret mbi të cilat ka punuar përfaqësia për hartimin e listës që më ka ngarkuar t'ju paraqes.

Së pari, ashtu si gjithnjë, kriteri më i rëndësishëm nga i cili u udhëhoqëm në këtë punë, sipas mësimeve të Partisë, është besnikëria politike dhe ideologjike e cilitdo kandidat ndaj marksizëm-leninizmit, Partisë sonë të lavdishme dhe çështjes së madhe të popullit. Rruga luftarake nëpër të cilën kanë kaluar Partia dhe kuadrot e saj, i ka kalitur këta, i ka kaluar nëpër shumë prova, i ka pjekur e rritur politikisht dhe ideologjikisht.

Së dyti, ne patëm parasysh mësimet e Partisë për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme përbërjen shoqërore të organeve udhëheqëse të saj. Edhe kjo është një çështje me rëndësi të madhe parimore për partinë e klasës punëtore, siç është Partia jonë. Në raport dhe gjatë diskutimeve doli se ne kemi arritur një sukses të madh në këtë drejtim, në të gjitha organet e Partisë, nga baza në qendër. Suksesi nuk qëndron vetëm në përqindjet e larta që zënë punëtorët në organet udhëheqëse të Partisë, por dhe në atë se këta kuadro i kanë forcuar organet tona udhëheqëse; suksesi qëndron, gjithashtu, në faktin se për këtë domosdoshmëri janë krijuar bindje të thella ideologjike në gjithë Partinë tonë, në të gjithë kuadrot, të vjetër ose të rinj qofshin ata.

Sipas projektit që do t'ju paraqes numri i kuadrove që janë ngritur nga radhët e punëtorëve (me ori-

gjënë, gjendje, që edhe vetë kanë qenë më parë punëtorë) rritet. Është parashikuar që në përbërjen e re të Plenumit të ketë 16 shoqe e shokë të rinj me këtë përbërje, që është barazi me 61,5 për qind e të gjitha kandidaturave të reja që propozohen të zgjidhen në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë.

Së treti, duke marrë parasysh se numri i shoqeve është rritur si në efektivin e Partisë edhe në radhët e kuadrove, kemi parashikuar që në Plenumin e ardhshëm të Komitetit Qendror të rritet akoma numri i shoqeve, nga 11,34 për qind që kemi sot, në 15,4 për qind. Në numrin e kandidaturave të reja që propozohen të zgjidhen në Plenum shoqet zënë rreth 30,8 për qind. Me gjithë këto nuk jemi akoma atje ku synojmë të arrijmë, prandaj Partia duhet të punojë edhe më shumë e më mirë në të ardhmen për të pasur më shumë shoqe në radhët e saj, në organet udhëheqëse të saj të të gjitha instancave dhe të tregojë kujdes të vazhdueshëm për rritjen dhe kalitjen e tyre dhe për t'i ngritur ato në vende me përgjegjësi.

Së katërti, lidhur edhe me detyrat e mëdha që na vihen të kryejmë në të ardhmen, përfaqësia pati parasysh edhe disa kërkesa e nevoja që na diktohen për disa sektorë. Për këtë qëllim pamë, sa na ishte e mundur, shpërndarjen e anëtarëve të Plenumit të Komitetit Qendror sipas sektorëve të punës dhe specialitetit që kanë. U munduam kështu të plotësojmë me anëtarë të udhëheqjes boshllëqet që ekzistojnë akoma në disa sektorë të punës së Partisë e të pushtetit. Kjo siç thashë, lidhet me detyrat e mëdha që kemi përpara në këtë plan pesëvjeçar që porsa aprovoi Kon-

gresi dhe për perspektivën e mëtejshme. Kjo është e nevojshme të bëhet, pasi na duhet që Partisë t'i përgatitim me kohë kuadro të rinj të devotshëm për të udhëhequr në të gjithë sektorët, duke marrë parasysh se udhëheqja nuk zgjidhet për të qëndruar vetëm gjatë periudhës midis dy kongreseve.

Po flas më konkretisht. Përfaqësia ka parashikuar që në Plenumin e ardhshëm të Komitetit Qendror të Partisë të rritet ca më tepër numri i anëtarëve të tij me shokë që punojnë në sektorët e bujqësisë, të zgjidhen, gjithashtu, një numër i domosdoshëm kuadros të kualifikuar nga disa sektorë të rëndësishëm, numri i të cilëve aktualisht nuk është i mjaftueshëm. Ajo u kujdes që në Plenum të mos na vijnë elementë teknokratë, por njerëz partie me profile të caktuara, që janë në gjendje t'i kuptojnë dhe t'i zgjidhin drejt problemet e shumta dhe nga më të ndryshmet që u vihen përpara Partisë dhe udhëheqjes së saj. Të tillë kuadro partie, aktivistë të dalluar shoqërorë, që militojnë në udhëheqje të organizatave të Partisë në rrethe, si dhe në sektorë të ndryshëm, sot ne kemi me shumicë.

Në hartimin e listës u pat parasysh vlerësimi i punës së shokëve dhe shoqeve që zgjodhi Kongresi i 5-të si dhe një numër i madh kandidaturash të reja.

Përfaqësia, ashtu siç ndodhi gjatë gjithë punimeve të Kongresit, e vlerësoi në mënyrë pozitive veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë që nga Kongresi i 5-të në Kongresin e 6-të. Kjo ishte një periudhë tjetër luftarake shumë e lavdishme e veprimtarisë së Partisë sonë, plot me suksese të mrekullueshme në të gjitha fu-

shat e jetës, me një bilanc aktiv dhe të pasur në të gjitha drejtimet. Në gjithë këtë punë të madhe që ka bërë mbarë populli ynë, i udhëhequr nga Partia, edhe Komiteti Qendror ka dhënë kontributin e vet. Përgjithësisht, Komiteti Qendror që zgjodhi Kongresi i 5-të i Partisë, qoftë si tërësi, qoftë edhe çdo anëtar i Plenumit veç e veç, ka luftuar me të gjitha forcat për të zbatuar detyrat e ngarkuara nga Kongresi, vendimet e mëvonshme që janë marrë, si dhe detyrat e reja që kanë dalë kohë pas kohe gjatë punës. Komiteti Qendror dhe çdo anëtar i tij kanë luftuar si revolucionarë për të udhëhequr punën e Partisë në të gjithë sektorët. I frymëzuar nga Partia dhe populli, ai ka luftuar dhe ia ka arritur suksesit për të ruajtur e kalitur në rrugë revolucionare unitetin e çeliktë Parti—popull, për të mbrojtur me besnikëri të madhe vijën politike, ideologjike dhe organizative të Partisë sonë, që është shtylla e të gjitha sukseseve dhe që siguron të ardhmen e atdheut.

Siç u vu në dukje në raportet dhe diskutimet që u bënë në këtë Kongres, në punë ne kemi pasur edhe një sërë të metash në kuptimin që po të ishim më të mobilizuar, po të kishim punuar më mirë të gjithë, po të kishim bërë më shumë përpjekje për t'i kuptuar më mirë dhe në mënyrë më të thellë problemet, po të kishim më shumë iniciativë në drejtim dhe në zbatim, do të vinim me siguri në Kongres me suksese akoma më të mëdha. Pavarësisht nga të metat e dobësitë e vërtetuara te disa, puna e Partisë, rezultatet e arritura, përgjithësisht, janë të shkëlqyera në të gjitha fushat.

Duke u nisur nga ky vlerësim, përfaqësia për asnjë

anëtar të Plenumit aktual nuk gjeti asnjë dobësi me karakter politik, asnjë gabim në vijë. Por në radhët e Plenumit ka shokë që, për arsye të ndryshme, të gjendjes së tyre shëndetësore apo të aftësive të kufizuara etj., nuk janë treguar në lartësinë e detyrës. Në fondin e tyre këta përgjithësisht kanë qenë dhe janë shokë të mirë, të vendosur e besnikë deri në fund për çështjen e Partisë dhe të tillë do të mbeten të tërë, zgjidhen apo nuk zgjidhen në Plenumin e ri të Komitetit Qendror të Partisë.

Siç na kanë vënë detyrë Kongresi i 5-të i Partisë dhe kongreset e mëparshme, gjë që u theksua edhe në këtë Kongres, Partinë duhet ta mbajmë gjithmonë të shkathtët, revolucionare, me iniciativë. Për të qenë e tillë, ajo duhet të jetë gjithmonë e re, në kuptimin që përvoja e kuadrove më të moshuar të gërshetohet me vruillin dhe hovin në punë dhe në luftë të gjakut të ri, që pareshtur del nga gjiri i popullit dhe hyn në Parti, ku tregon një pjekuri dhe vendosmëri të jashtëzakonshme. Këtë rrugë revolucionare ka ndjekur Partia jonë gjatë gjithë jetës së saj 30-vjeçare. Dhe ne mund t'i raportojmë tani Kongresit se në shumicën dërrmuese kuadrot e rinj që janë zgjedhur në Plenumin e Komitetit Qendror, janë rritur. Vetë fakti që përfaqësia mendoit t'i propozojë Kongresit që shumica dërrmuese e anëtarëve të rinj të Komitetit Qendror të ngrihen nga radhët e kandidatëve që kemi sot, është një sukses. Kjo është një rrugë normale, pasi siç e dimë, anëtarët e plenumeve, si rregull i përgjithshëm, duhet të zgjidhen nga radhët e kandidatëve, si në qendër ashtu

edhe në rrethe. Nuk ka kuptim që kandidatët të mbeten gjithnjë kandidatë.

Është për t'u vënë në dukje se gjatë periudhës midis dy kongreseve në Parti është pranuar një kontingjent shumë i madh anëtarësh me origjinë dhe gjendje shoqërore punëtorë dhe nga ata që më parë kanë qenë vetë punëtorë. Në udhëheqje të Partisë, gjithashtu, në organizatat-bazë dhe në komitete janë ngritur mjaft kuadro të rinj me këtë përbërje shoqërore, të cilët, siç e thamë në raport, përbëjnë tani shumicën e efektivit të organeve udhëheqëse të Partisë në rrethe. Në udhëheqje kanë ardhur edhe shokë të rinj nga mosha, por të pjekur nga ana ideologjike e politike dhe me hov të madh në punë.

Prandaj, ashtu si edhe në të kaluarën, përfaqësia u përpoq që kjo gjendje e re e përbërjes së Partisë të reflektohet edhe në Plenumin e Komitetit Qendror që do të zgjedhë Kongresi i 6-të. Kjo është një kërkesë imperative, sepse Partia, si udhëheqëse e vendit, duhet të mendojë për sot, për nesër dhe për një të ardhme më të largët, prandaj në udhëheqje është e domosdoshme të vijnë edhe shoqe e shokë të rinj, që të kaliten e të edukohen dhe udhëheqja të mos lihet të vjetrohet, ashtu siç nuk lëmë të vjetrohet Partia, një pasqyrë e së cilës duhet të jetë edhe Plenumi.

Siç thamë më lart, rritja e Plenumit bëhet në bazë të disa kriterëve të caktuara. Mirëpo kjo rritje ka një kufi deri ku duhet të arrijë, ka disa caqe e përpjesëtime që nuk mund të kalohen. Këto dhe domosdoshmëria që në udhëheqje duhet të vijë gjak i ri, na detyrojnë që disa shokë dhe shoqe të Plenumit aktual.

megjithëse nuk kanë ndonjë gabim politik apo ideologjik, përkundrazi, janë të pastër e të vendosur nga kjo anë, por që gjatë veprimtarisë së tyre nuk kanë qenë shumë të shquar, mund të mbeten jashtë Plenumit të Komitetit Qendror. Sigurisht as kjo nuk është diçka e re që bëhet në këtë Kongres, pasi është një praktikë e njohur dhe e zbatuar në të gjitha kongreset e Partisë sonë.

Këto ishin, shokë edhe shoqe, në mënyrë të përmbledhur, kriteret dhe konsideratat mbi të cilat u mbështet përfaqësia në hartimin e projektit me kandidaturat e mundshme për në Plenumin e ardhshëm të Komitetit Qendror.

Gjithashtu në emër të përfaqësisë, propozoj që Komisioni Qendror i Kontrollit dhe i Revizionimit të Partisë të përbëhet me 21 veta, nga 17 që kemi sot. Kjo rritje shpjegohet me arsyet që përmenda edhe për Plenumin e Komitetit Qendror dhe do të ndihmojë që të shqyrtohen më shpejt apelimet e komunistëve, gjithashtu, të ngrihen më shumë probleme nga jeta e Partisë, në bazë të kompetencave që i janë ngarkuar me Statut edhe këtij organi të Partisë.

Pasi paraqiti kandidaturat për Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe për Komisionin Qendror të Kontrollit e të Revizionimit, shoku Enver vazhdoi:

Në bazë të rregullave të demokracisë së brendshme në Parti të përcaktuara në Statut, le të diskutojmë tani një për një kandidaturat që ju parashtrova. Për secilin nga shokët e propozuar kemi këtu karakteristikat për-

katëse. Kështu, shokët delegatë, mund të gjykojnë sa më mirë e drejt për kandidaturat që ju paraqiten.

Tani do t'i rilexoj emrat një për një me radhë, bashkë me të dhënat e nevojshme për secilin. Shokët të shprehin lirisht vërejtjet dhe mendimet e tyre.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 268 (7245), 8 nëntor 1971

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1970-1971», Tiranë, 1972.
f. 464*

ZGJEDIJA NË UDHËHEQJE ËSHTË NDER I MADH, POR EDHE DETYRË ME PËRGJEGJËSI

Fjala në Plenumin I të KQ të PPSH¹

7 nëntor 1971

Të dashur shokë dhe shoqe,

Kongresi ynë i 6-të i Partisë, që sot është duke mbaruar punimet e tij, ishte një Kongres i mrekullueshëm. Aty u shpreh edhe njëherë, me të gjithë forcën e pamposhtur revolucionare, uniteti i çeliktë i Partisë, që përfaqësohej nga delegatët e zgjedhur dhe u afirmua vija e drejtë e papërkulur e konsekuente marksiste-leniniste, vija politike, ideologjike, ekonomike, kulturore dhe ushtarake e Partisë sonë heroike. Ky Kongres, si gjithë kongreset e tjera, përbën një ngjarje nga më të rëndësishmet në historinë e lavdishme të

1. Mbledhja u zhvillua menjëherë porsa u shpallën rezultatet e votimeve që u bënë në Kongresin e 6-të. Në mbledhje, të cilën e hapi shoku Enver Hoxha, ndodheshin të pranishëm të gjithë anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë.

Partisë dhe të popullit tonë. Vendimet që u morën aty do të jenë një frymëzim i ri për popullin tonë, për klasën punëtore, për fshatarësinë kooperativiste, për intelektualët, për gratë, për të rinjtë, me një fjalë për të gjitha masat punonjëse të popullit, të cilat do të shumëfishojnë forcat dhe energjitë e tyre për të zbatuar deri në fund politikën e drejtë jetëdhënëse të Partisë.

Kongresi i 6-të na zgjodhi ne në udhëheqje të Partisë. Ky është një nder jashtëzakonisht i madh që na bëhet, por njëkohësisht na ngarkon me përgjegjësi e detyra shumë të mëdha, të rëndësishme e fisnike, të cilat ne, si kurdoherë, do t'i mbajmë mbi supet tona sa të kemi jetë, si ushtarë besnikë të Partisë. Ne do të vëmë të gjitha forcat për të kryer me nder detyrat që na janë ngarkuar si ushtarë të thjeshtë, duke u bërë shembull për të gjithë shokët komunistë, kuadrot dhe punonjësit tanë, duke qenë të parët në sakrifica dhe të fundit në pretendime. Titulli i anëtarit të Plenumit kurrë dhe askujt të mos i shërbejë për t'u dukur e për të dalë mbi të tjerët, por vetëm për të kryer detyrat e funksionet me përgjegjësi që na ngarkoi Kongresi.

Të gjithë shokët e zgjedhur në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë nga Kongresi i 6-të janë të pranishëm, prandaj mbledhjen e Plenumit I të Komitetit Qendror të Partisë e konsiderojmë të hapur. Në rendin e ditës, kemi, sipas rregullave, zgjedhjen e Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë.

Në emër të një grupi shokësh më lejoni t'i bëj

tani Plenumit të porsazgjedhur propozimet për të cilat jam ngarkuar.

Siç e dini, Byroja Politike që kishim përbëhej nga 11 anëtarë dhe 5 kandidatë. Mirëpo, duke marrë parasysh zgjerimin e Partisë, dhe si rrjedhim edhe zgjerimin e vetë Plenumit të Komitetit Qendror, ne kemi menduar t'i propozojmë Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë që Byroja e re Politike të përbëhet prej 13 anëtarësh dhe 4 kandidatësh, ndërsa Sekretariati nga 4 sekretarë të Komitetit Qendror, njëri nga të cilët të jetë Sekretar i Parë. Jeni dakord me këtë përbërje?

Të gjithë anëtarët e Plenumit të ri të Komitetit Qendror të Partisë u shprehën njëzëri dakord me propozimin e shokut Enver Hoxha.

Pastaj shoku Enver Hoxha, në emër të një grupi shokësh, propozoi anëtarët dhe kandidatët e Byrosë Politike si dhe Sekretariatit të Komitetit Qendror. Të gjithë shokët u shprehën njëzëri dakord.

Pas kësaj propozohet që Sekretar i Parë i KQ të PPSH të zgjidhet shoku Enver Hoxha.

Të gjithë anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror ngrihen në këmbë dhe me duartrokkitje të zjarra miratojnë njëzëri propozimin.

SHOKU ENVER HOXHA: Në emër të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të Komitetit Qendror siguroj Plenumin se ne do të jemi në radhët e para të luftës, të vendosur deri në vdekje, për t'u shërbyer Partisë dhe popullit me të gjitha forcat tona, me vetëmohim, me guxim e vendosmëri dhe në unitet të plotë.

Me kaq mbledhjen e parë të Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH e deklaroj të mbyllur. Tani do

të kthehemi përsëri në sallën e Kongresit për t'u komunikuar delegatëve rezultatet e zgjedhjeve që bëmë këtu.

Botuar për herë të parë në librin: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. VI, Tiranë, 1978, f. 227

Botohet sipas librit: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. VI, Tiranë, 1978, f. 227

KONGRESI I 6-TË DO TË ZËRË NJË VEND TË RËNDËSISHËM NË JETËN E PARTISË E TË POPULLIT TONË

Nga fjala e mbylljes në Kongresin e 6-të të PPSH

7 nëntor 1971

Shokë delegatë,

Punimet e Kongresit morën fund. Në mbledhjen e tij të parë Plenumi i Komitetit Qendror, i zgjedhur me unanimitet të plotë nga Kongresi, vendosi që Byroja Politike të përbëhet nga 13 anëtarë dhe 4 kandidatë, ndërsa Sekretariati i Komitetit Qendror të përbëhet nga 4 sekretarë, njëri prej të cilëve Sekretar i Parë i Komitetit Qendror.

Pasi paraqiti anëtarët e kandidatët e Byrosë Politike, përbërjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror si dhe kryetarin dhe dy nënkryetarët e Komisionit Qendror të Kontrollit dhe të Revizionimit, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Në emër të Komitetit Qendror të porsazgjedhur, më lejoni t'ju falënderoj për nderin që na bëtë dhe për besimin e madh që na dhatë. Ne sigurojmë Kon-

gresin, Partinë dhe gjithë popullin se të gjitha forcat tona fizike e mendore do t'i vëmë në shërbim të çështjes sonë të lavdishme, ndërtimit të socializmit në Shqipëri, forcimit, lulëzimit dhe mbrojtjes së atdheut tonë socialist, mbrojtjes së marksizëm-leninizmit, fitores së çështjes së komunizmit. Ne jemi plotësisht të ndërgjegjshëm se barrët që na u ngarkuan nuk janë të lehta, por ne kemi sigurinë e plotë se, duke pasur, si gjithnjë, mbështetjen e gjithanshme të Partisë e të popullit, dashurinë dhe besimin e tyre të madh, do t'i kryejmë me sukses detyrat që kemi përpara. Në punën e tij me përgjegjësi Komiteti Qendror do të ketë kurdoherë pranë urtësinë e thellë të popullit tonë të mrekullueshëm dhe eksperiencën e pasur të Partisë sonë heroike. Atë, si deri sot, do ta frymëzojnë dhe do ta udhëheqin mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit dhe lufta e fitoret e Partisë sonë.

Kongresi i 6-të do të zërrë një vend të rëndësishëm në jetën e Partisë dhe të popullit tonë. Punimet e tij u zhvilluan në frymën e principialitetit të lartë komunist, të kritikës dhe të autokritikës parimore. Ai i shtroi dhe i diskutoi të gjitha problemet, duke mbajtur parasysht përgjegjësinë e madhe që ka Partia jonë, si Parti në pushtet, për fatet e popullit të saj, si Parti që qëndron në radhët e para të luftës kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, e revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye. Kjo është një tjetër siguri se Partia jonë do t'i plotësojë me nder detyrat kombëtare e ndërkombëtare që caktoi ky Kongres.

Karakteristikë dalluese e Partisë sonë është uniteti i fuqishëm i radhëve të saj, lidhjet e saj të pathye-

shme me klasën punëtore e masat punonjëse. Ky unitet dhe këto lidhje, që u manifestuan me madhështi edhe në këtë Kongres, kanë qenë dhe mbeten burimi i pashtershëm i të gjitha fitoreve tona, bazë graniti e forcës, vitalitetit dhe kombativitetit të Partisë dhe të popullit, garanci e lirisë dhe e pavarësisë së Shqipërisë së re, e së ardhmes së saj socialiste. Kjo përbën një siguri tjetër se Partia dhe populli ynë do t'i vënë në jetë me sukses vendimet historike të këtij Kongresi.

Përpara nesh qëndron tani një program i madh lufte e pune për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste në Shqipëri. Në dokumentet e Kongresit tonë janë parashtruar objektivat madhështorë drejt të cilëve ne synojmë. Arritja e tyre do t'i ngrejë ekonominë e kulturën kombëtare në një shkallë të re, në të lartë, do të përmirësojë nivelin e jetesës së popullit, do të fuqizojë edhe më shumë vendin tonë. Në tërësi zbatimi i vendimeve të Kongresit të 6-të do t'i përforcojë edhe më shumë pozitën e socializmit në Shqipëri, do ta bëjë atdheun tonë një kështjellë akoma më të fuqishme të revolucionit e të marksizëm-leninizmit.

Tani ajo që mbetet për të bërë është mobilizimi i tërë popullit dhe i Partisë për të zbatuar detyrat që caktoi Kongresi. Është e natyrshme se, në luftën e përditshme për realizimin e planit të pestë pesëvjeçar dhe të detyrave të tjera që shtroi Kongresi, do të ndeshemi edhe me pengesa e vështirësi, që rrjedhin nga përpjesëtimet e mëdha të zhvillimit tonë në gjerësi e thellësi. Por komunistët dhe punonjësit shqiptarë këto nuk i trembin. Duke ruajtur e zhvilluar frymën revolucionare, shpirtin krijues e novator, besimin e patundur

në forcat e veta, ata do të marshojnë me siguri e pa u ndalur kurdoherë përpara.

Shokë,

Kongresi ynë i 6-të është një dëshmi e gjallë e unitetit dhe e solidaritetit proletar internacionalist. Pjesëmarrja e një numri kaq të madh përfaqësuesish të partive marksiste-leniniste dhe fjalët e tyre të ngrohta e të sigjerta në adresë të Partisë e të popullit tonë janë një nder dhe nxitje për të gjithë ne. Më lejoni që në emrin tuaj, të Partisë dhe të gjithë popullit, t'i falënderoj shokët dhe miqtë tanë të dashur për përsëritjet dhe urimet e tyre vëllazërore... Vlerësimi që i bëhet Partisë sonë dhe përkrahja që i jepet luftës së saj për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, janë një inkurajim e frymëzim i madh revolucionar.

Nga ana jonë, ne i sigurojmë edhe një herë partitë motra dhe të gjithë shokët tanë të luftës se Partia e Punës e Shqipërisë do të jetë kurdoherë solidare dhe do të përkrahë pa rezerva luftën e tyre revolucionare, ajo do të mbajë kurdoherë lart flamurin e socializmit e të marksizëm-leninizmit. Si deri tani, edhe në të ardhmen Partia e Punës e Shqipërisë do të ecë krah për krah në një unitet të çeliktë me partitë motra marksiste-leniniste në luftën e përbashkët kundër imperializmit, revizionizmit e reaksionit, do të demaskojë intrigat e komplotet e imperializmit, si dhe përpjekjet e revizionistëve modernë për të përçarë e për të shkatërruar lëvizjen dhe partitë e reja marksiste-leniniste.

Ne, revolucionarët e vërtetë komunistë, nuk do ta pushojmë kurrë polemikën me revizionistët modernë, do të luftojmë deri në fund kundër vijës dhe veprimtarisë së tyre tradhtare, do të mbrojmë me vendosmëri dhe do ta çojmë kurdoherë përpara çështjen e madhe të komunizmit.

Përpara, shokë e shoqe, për të vënë në jetë vendimet e Kongresit të 6-të, për fitore të reja në rrugën e ndritur të socializmit!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë, luftëtarja dhe flamurtarja e paepur e socializmit në Shqipëri!

Rroftë populli ynë trim e punëtor!

Rroftë internacionalizmi proletar!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 268 (7245), 8 nëntor 1971

Botohet me ndonjë shkurtim sipas librit: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1970-1971», Tiranë, 1972, f. 474

PRODHIMET TË MOS MBETEN NË EKSPOZITË, POR TË HIDHEN NË TREG

*Nga bisedat gjatë vizitës në ekspozitën
«Shqipëria 1971»*

7 nëntor 1971

SHOKU ENVER HOXHA: Sa bukur! Ku kemi qenë dhe ku jemi! (*Duke parë disa makineri të naftës.*) Kam dëgjuar se këto tani po prodhohen në vendin tonë.

NJË INXHINIER: Gjysmat e tyre i bëjmë vetë, i projektojnë e i prodhojnë specialistët tanë.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë! Ju uroj suksese të tjera të mëtejshme!

Tani kemi edhe radio e televizorë të montuar në vend. Sa kemi përparuar e sa do të përparojmë akoma në të ardhmen! Kudo punojnë vajza të reja, bile edhe me radiot e televizorët, prodhimin e të cilëve do ta shtojmë shumë këtë pesëvjeçar.

Gjëra të mëdha po bëjmë! Çfarë është ajo atje?

NJË INXHINIER: Është stufë elektrike.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë! Ju uroj suksese të tjera!

Të tëra janë të bukura e të prodhuara me cilësi të lartë nga njerëzit tanë punëtorë e specialistë.

Edhe këpucët e ekspozuara këtu janë të bukura. Tani puna është që të vazhdojnë të bëhen të gjitha kështu, se këto që kenë nxjerrë në vitrinë të marrin në qafë. Po të vihet kudo kontroll i fortë dhe të bëhen përpjekje për një ndërgjegje sa më të lartë në punë s'ka dyshim se çdo gjë do të bëjmë. Është vetëm çështje kohe.

Problemi i konfeksioneve të gatshme e gjysmë të gatshme është një gjë e madhe për ne. Puna tani është të bëhen të mira. Unë jam më shumë me mendimin që t'i prodhojmë gjysmë të gatshme, që blerësi të futet brenda në repart, të bëjë provën, të bëhen rregullimet e nevojshme dhe pastaj të marrë mallin.

Nga prodhimi i tekstileve të Beratit të gjithë janë të kënaqur, pse edhe ato janë të cilësisë së mirë; edhe çmimet janë të arsyeshme. Edhe këto batanie janë shumë të bukura. Prodhimet e peliçerisë, gjithashtu, janë të bukura dhe të punuara artistikisht. Me lëkurë qengji bëhen të gjitha këto?

CICERONI: Po, me lëkurë qengji.

SHOKU ENVER HOXHA: Këto janë me të vërtetë prodhime shumë të bukura, të cilat jo vetëm që po i sjellin vendit të ardhura të mira në valutë, por nga ana tjetër, çdo gjë që eksportojmë, kur është e bukur dhe e fortë, nderon edhe atdheun. Prandaj, të gjithë të synojmë dhe të përpiqemi shumë në këtë drejtim, që gjithçka ta nxjerrim sa më të bukur dhe të qëndrueshme.

Edhe prodhimet e plastikës dhe të qeramikës shu-

më të bukura janë. Puna është që tani të mos mbetën vetëm në ekspozitë, po të prodhohen me shumicë e të hidhen në treg, që populli t'i blejë prodhimet e industrisë sonë, sidomos të porcelanit, për aq sa ka nevojë.

Shumë të bukura qenkan edhe prodhimet prej alumini të uzinës «Partizani».

Nga paraqitja, kutitë e konservave janë shumë të mira, po me se hapen? Ka çelës për këtë punë?

CICERONI: Ato hapen shumë kollaj, qoftë edhe me një monedhë njëlekëshe.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë! Paskan bërë edhe qepujkat turshi në vazo.

Edhe shishet e pijeve paskan ambalazhim të bukur. Po me se i bëjnë?

CICERONI: Me fijet e kashtës së fshesës.

SHOKU ENVER HOXHA: Gjëra të bukura shumë! Ka rëndësi edhe paraqitja, reklama, pse tregon kulturën dhe zhvillimin e punës artistike të dorës. U transmeto shokëve të punës urime nga gjithë shokët e Partisë!

Në sektorin e materialeve të ndërtimit, të kombinatit «Josif Pashko», shoku Enver iu drejtua një inxhinieri:

Ju vetë merreni me prodhimin e këtyre pllakave? Ç'duhet bërë që pllakat e mermerit të mos e ndërrojnë ngjyrën, të mos zbardhen nga shiu e dielli? E them këtë sepse shpesh atyre u del boja, edhe brenda 2-3 muajve. Ka ndonjë llak për t'i lyer që të mos u dalë boja dhe të mbajnë shkëlqim të paktën për 1-2 vjet e pastaj të lyhen përsëri?

INXHINIERI: Përvoja jonë në këtë drejtim është akoma e paktë, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Po qe nevoja, shkoni edhe jashtë se atje merren prej kohësh me këto lloj punësh, prandaj kanë eksperiencë të madhe në këtë drejtim.

Duke kaluar në repartin e prodhimeve bujqësore shoku Enver Hoxha tha:

Të prodhojmë çdo gjë, por që ta realizojmë këtë detyrë duhet t'ua bëjmë të gjitha shërbimet bimëve të ndryshme e bagëtive dhe këtë nevojë të domosdoshme t'ua futim në shpirt kooperativistëve. Kjo është një gjë jashtëzakonisht e rëndësishme, është pasuri e madhe për popullin. Duhet të punohet me pasion në këtë drejtim.

Shumë bukur! Gëzohem shumë për të gjitha!

CICERONI: Ka ca kohë që filluan punimet për ngritjen e një kombinati të madh të pulave e shpendëve.

SHOKU ENVER HOXHA: Ngritja e këtij objekti të bujqësisë ka rëndësi të madhe për ne, se populli do vezë¹. Ju uroj suksese në çdo drejtim! (*Duke parë me vëmendje veglat bujqësore që prodhohen te ne.*) Shikoni sa gjëra të mira bëni ju sot. Përpara bënit pak, ndërsa tani më shumë. Për këtë sukses ju përgëzoj nga zemra! Të fala shumë bëju shokëve punëtorë!

Aq shumë vepra janë ngritur gjer më sot te ne, sa nuk i numërojmë dot, me dhjetëra e qindra. Përpara i numëronim me gisht, thoshim: «Është ngritur kjo këtu, ajo atje», kurse tani u bënë aq shumë, saqë nuk i mbajmë dot mend të tëra një nga një.

1. Kombinati në fjalë filloi nga prodhimi në prill 1973.

Duke vizituar sektorin e kulturës dhe të arsimit:

SHOKU ENVER HOXHA: Në këtë drejtim kemi bërë shumë punë, por duhet akoma më shumë të bëjmë për kalamanët, për brezin e ardhshëm, që ai të përvehtësojë sa më shpejt e sa më thellë dituri të mëdha. Kur isha student, mua më kanë pëlqyer shumë historia e filologjia.

NJË STUDENTE: Edhe mua më pëlqen shumë, prandaj vazhdoj studimet në këtë fakultet.

Të gjitha këto janë punime të bëra nga vetë studentët. Në ekspozitë kemi të sintetizuara të tri aspektet e shkollës sonë: mësim, punë dhe kalitje fizike e ushtarake.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë! U jepni shumë të fala gjithë studentëve e pedagogëve.

Kjo është Shota, Shote Galica, në miniaturë, kurse monumenti origjinal i saj është në Kukës. Kristaq Rama është skulptor i talentuar. Të ekspozojmë edhe nga këto vepra! T'u japim edhe kosovarëve kopje të prodhimeve tona të artit, se janë të interesuar për t'i marrë.

Kjo është një kokë fëmije shumë e bukur!

Libri «Yje të pashuar». Paska dalë vëllimi i dytë i tij? Kjo është gjë shumë interesante e me vlerë.

Në sektorin e shëndetësisë:

SHOKU ENVER HOXHA: Si jeni, si shkon puna për prodhimin e vaksinave?

NJË MJEKË: Shumë mirë, shoku Enver! Ne prodhojmë tani në vend pothuajse të gjitha llojet e vaksinave, me disa përjashtime të vogla, por po bëjmë përpjekje që t'i prodhojmë edhe ato në vend.

SHOKU ENVER HOXHA: Po BSZH¹ prodhoni?

MJEKJA: Po, po, të tëra i bëjmë. Edhe ujin e distiluar e prodhojmë.

Pastaj, duke parë në mur një tablo të madhe me fëmijë të shëndetshëm, biseda vazhdoi:

SHOKU ENVER HOXHA: Të tërë nga ajo fazë kemi kaluar, po me ndryshimin se fëmijët tani janë të lumtur. Koha jonë ishte e mjeruar, kurse koha e sotme është e lumtur për popullin dhe veçanërisht për fëmijët.

Për ambalazhin keni vështirësi?

MJEKJA: Shishet e vogla dhe të gjitha të tjerat si kutitë etj. i bëjmë në vend. Vetëm ampulat nuk i prodhojmë dot akoma.

SHOKU ENVER HOXHA: Do të vijë koha që t'i prodhojmë edhe ato.

Të fala shumë i bëni Elmazit²!

Ju përgëzoj dhe ju uroj suksese të tjera në të ardhmen! Shikoni çfarë njerëz të mrekullueshëm që kemi!

NJË INXHINIER: Në sajën Tuaj dhe të Partisë! Të rroni sa malet!

SHOKU ENVER HOXHA: Të rrojë Partia!

Shumë të bukura janë! I shtoni ato edhe më dhe bëni nga të gjitha të tjerat që na duhen!

Pastaj, shoku Enver Hoxha përgëzoi përfaqësuesit e punonjësve të transportit e të komunikacionit, të pra-

1. Vaksinë kundër tuberkulozit.

2. Elmaz Konjari, në atë kohë punonjës në Ndërmarrjen e Prodhimeve Farmaceutike. Shok fëmijërie i shokut Enver Hoxha

nishëm në ekspozitë, për rimorkiatorin e peshkimit që hodhën në det punëtorët e kantierit detar në prag të Kongresit të 6-të.

Duke dalë nga ekspozita, shoku Enver Hoxha tha:

Do të ndërtojmë shumë vepra e do të prodhojmë plot mallra të tjera të mira, të bukura dhe me leverdi për popullin. Veç duhet të mendojmë shumë për të gjitha këto, që të mos mbeten vetëm në ekspozitë. Prandaj, të bëhen përpjekje të gjithanshme nga të tërë që të prodhojnë me shumicë, që populli jo vetëm t'i shohë, po edhe t'i gëzojë, t'i blejë e të plotësojë nevojat e tij sa më mirë.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura gjatë
kësaj vizite, që gjenden
në AQP*

REVOLUCIONARËT I BËN TË PATHYESHËM BINDJA PËR TË CILËN LUFTOJNË

*Fjala në Pallatin e Brigadave me rastin e mbylljes
së Kongresit të 6-të të PPSH dhe 30-vjetorit
të Themelimit të saj*

7 nëntor 1971

Të dashur shokë e miq,

Jemi mbledhur sonte në këtë darkë vëllazërore komunistë shqiptarë dhe komunistë të partive marksiste-leniniste nga të gjitha kontinentet. Ju erdhët në Shqipërinë socialiste për të marrë pjesë në Kongresin e Partisë sonë, për t'u njohur me jetën dhe veprimtarinë e saj, për të na shprehur solidaritetin tuaj internacionalist, për të na përkrahur në luftën e në punën tonë. Po prania juaj këtu është njëkohësisht shprehje e unitetit të çeliktë që karakterizon marksistë-leninistët e të gjitha vendeve, ushtarët e revolucionit, luftëtarët e zjarrtë kundër imperializmit, revizionizmit e reaksionit.

Në një kohë kur në partitë revizioniste sundon një shturje dhe dekadencë e madhe, fryma e grupa-

zhit, fraksionizmit, karrierizmit, e luftës për pushtet, kur ato kanë humbur çdo pamje proletare e tipar revolucionar, kur marrëdhëniet midis tyre karakterizohen nga diktati e nënshtrimi, nga shovinizmi e nacionalizmi borgjez, uniteti ynë, i forcave marksiste-leniniste, rritet e forcohet gjithnjë e më shumë mbi bazat e shëndosha të ideologjisë revolucionare të klasës punëtore dhe të internacionalizmit proletar.

Uniteti dhe kompaktësia jonë mbështeten në idealin tonë të përbashkët, në luftën që bëjmë ne për kundërshtimin e imperializmit e të revizionizmit, në përpjekjet për mbrojtjen e interesave jetikë të klasës punëtore e të masave punonjëse, në përkrahjen e vendosur që u japim popujve për çlirimin e tyre kombëtar e shoqëror. Rruga jonë e përbashkët është rruga e revolucionit, e socializmit dhe e komunizmit. Flamurin e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, që revizionistët e flakën tej, tani e kanë marrë në duart e tyre partitë e vërteta marksiste-leniniste, të cilave u takon misioni i madh historik të udhëheqin në revolucion klasën punëtore dhe të gjitha masat punonjëse.

Janë të natyrshme dhe të kuptueshme vështirësitë e pengesat me të cilat ndeshet lëvizja marksiste-leniniste. Kundër tyre është vërsulur tani borgjezia me tërë aparatit e saj shtypës e propagandistik, revizionistët e oportunistët e ndryshëm me demagogjinë dhe punën e tyre minuese, pseudorevolucionarët dhe pseudosocialistët. Por s'ka forcë në botë që të ndalë tanimë marshimin fitimtar të marksizëm-leninizmit e të komunizmit. Revolucionarët nuk janë tërhequr kurrë përpara vështirësive e pengesave. Atyre u jep jetë dhe i bën të pa-

thyeshtëm bindja në drejtësinë dhe në fitoren e çështjes për të cilën luftojnë, besimi i patundur në forcat e pashtershme revolucionare të klasës punëtore, besnikëria ndaj parimeve.

Këtë forcë dhe vendosmëri e ndiejnë gjithë Partia dhe populli ynë me pjesëmarrjen tuaj në Kongres dhe në përshëndetjet e zjarra plot frymëzim revolucionar që i sollët Partisë sonë dhe që ishin shprehje e unitetit luftarak internacionalist që na bashkon.

Unitetin e tyre revolucionarët nuk e fshehin kurrë dhe në asnjë rrethanë, por e afirmojnë dhe e çelikosin pa pushim.

Përpara armikut le të qëndrojmë të bashkuar si shkëmb graniti, të shtrëngojmë radhët dhe kështu të bashkuar grusht të marshojmë kurdoherë në luftë drejt fitores së sigurt të çështjes sonë të madhe të për-bashkët.

Përfitoj nga rasti t'ju siguroj se Komiteti i ri Qendror, i zgjedhur nga Kongresi i 6-të i Partisë, do të mbrojë e zbatojë me konsekuencë vijën revolucionare të Partisë sonë. Partia dhe populli shqiptar do të punojnë pa u lodhur për të kryer me nder detyrën e tyre të lartë të ndërtimit të plotë të socializmit në Shqipëri, do të luftojnë pa kursyer forcat që në atdheun tonë të valojë kurdoherë i pamposhtur flamuri i socializmit dhe i marksizëm-leninizmit. Në unitet të plotë me të gjitha partitë dhe forcat marksiste-leniniste, Partia jonë, si deri tani, do të luftojë me vendosmëri kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, dhe kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye. Në komunistët dhe në popullin shqiptar revolucionarët dhe

gjithë luftëtarët e lirisë e të pavarësisë së popujve do të kenë kurdoherë miq besnikë e të pandarë deri në fund, vëllezër të sinqertë si në ditë të mira ashtu edhe në të këqija. Ne luftojmë në të njëjtën barrikadë dhe në solidaritet të plotë do të marshojmë kurdoherë krah për krah drejt fitoresh të reja.

Më lejoni që në këtë darkë shokësh të një ideali e të një fronti, ku mbretëron fryma e internacionalizmit proletar dhe ku rreh një zemër, të përshëndes edhe një herë shokët dhe miqtë tanë të dashur dhe t'i falënderoj për nderin e madh që na bënë dhe kënaqësinë që na dhanë duke ardhur në Shqipëri dhe duke marrë pjesë në punimet e Kongresit. Më lejoni, gjithashtu, që në emër të gjithë Partisë dhe të popullit shqiptar, t'u uroj nga zemra përfaqësuesve të partive motra suksese dhe fitore në luftën e tyre të lavdishme revolucionare.

Ta ngremë këtë doli për shokët dhe miqtë e huaj që janë këtu të pranishëm dhe për partitë e organizatat që ata përfaqësojnë, për unitetin marksist-leninist e solidaritetin proletar!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 268 (7245), 8 nëntor 1971

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1970-1971», Tiranë, 1972,
f. 480*

TË VËMË PLOTËSISHT NË JETË VENDIMET E KONGRESIT TË 6-TË TË PARTISË

*Fjala në mitingun e kryeqytetit me rastin
e mbylljes së Kongresit të 6-të të PPSH
dhe 30-vjetorit të Themelimit të saj*

8 nëntor 1971

Popull shqiptar,
Qytetarë të Tiranës,
Miq të shtrenjtë,

Komunistët dhe gjithë populli ynë kremtojnë sot me gëzim dhe entuziazëm 30-vjetorin e Themelimit të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe përfundimin me sukses të punimeve të Kongresit të 6-të të saj. Më lejoni me këtë rast, t'ju sjell përshëndetjet e zjarra të Kongresit e të Komitetit Qendror të Partisë dhe t'ju siguroj se për komunistët shqiptarë, për Partinë e Punës të Shqipërisë, siç e ka treguar historia e saj 30-vjeçare, nuk ka dhe nuk do të ketë gjë më të shenjtë se çështja e revolucionit dhe e socializmit, e lirisë dhe e lumturisë së popullit. Për këto ideale dhanë jetën bijtë e saj më të mirë, në emër të tyre janë ngritur në këm-

bë anëtarët e saj dhe, pa pyetur për sakrifica e privacione, punojnë pa u lodhur në ballë të masave për ndërtimin e socializmit, vigjilojnë e përgatiten tok me popullin për të mbrojtur atdheun dhe fitoret e arritura.

Në ato ditë të rënda të nëntorit 1941, kur mbarë vendin dhe gjithë Evropën e kishin mbuluar errësira fashiste, terrori dhe vdekja, krijimi i Partisë Komuniste Shqiptare ishte për popullin tonë të shumëvujtur një rreze e fuqishme drite, një shpresë e madhe për realizimin e ëndrrave të tij shekullore. Partia e komunistëve shqiptarë u krijua për të çliruar atdheun, për të ndërtuar Shqipërinë e re demokratike e popullore, për ta bërë popullin zot të fateve të veta, për të ngritur një industri e bujqësi moderne, për ta bërë popullin të shkolluar, për të ndërtuar socializmin.

Duke shikuar rrugën e përshkuar në këta 30 vjet, të gjithë, Parti e popull, kanë të drejtë të krenohen për luftën dhe punën e tyre titanike, për veprën madhështore të socializmit në Shqipëri. Ato që ishin vetëm ëndrra të guximshme më 8 Nëntor 1941, janë bërë sot një realitet madhështor: Shqipëria u çlirua një herë e përgjithmonë jo vetëm nga pushtuesit fashistë, por edhe nga çdo vartësi e huaj. U zhdukën klasat e vjetra sunduese dhe, bashkë me to, shfrytëzimi i njeriut nga njeriu. U ndërtua një industri e re socialiste, që në afro 6 ditë prodhon aq sa prodhohej gjatë tërë vitit 1938. U organizua një bujqësi e madhe kooperativiste, e cila transformoi gjithë jetën e fshatit dhe plotëson përditë e më mirë nevojat e vendit për prodhime bujqësore e blegtorale. Të gjithë qytetarët, pa përjashtim,

burra dhe gra, gëzojnë të drejtën e punës dhe pagë të barabartë për punë të barabartë. Asnjëri në Shqipëri nuk paguan asnjë lloj takse dhe për gjithë punonjësit është siguruar shërbimi shëndetësor falas. Drita elektrike, pa as më të voglin shpenzim nga të ardhurat personale të punonjësve, shkoi deri në fshatin më të largët. Arsimi 8-vjeçar u bë i përgjithshëm në tërë Shqipërinë. Me hapa të shpejtë po zgjerohet edhe arsimi i mesëm. Nga shkollat e larta në një vit dalin gjashtë herë më shumë specialistë nga ç'kishte i tërë vendi në pragun e çlirimit. Si kurrë ndonjëherë është forcuar mbrojtja e lirisë dhe e pavarësisë së atdheut. Shqipëria socialiste, në sajë të politikës së saj revolucionare dhe të qëndrimeve të drejta e parimore, gëzon një respekt të merituar dhe simpati të madhe në të gjithë botën.

Në këto lartësi të mëdha vendin tonë e ngriti Partia. Asaj i takon merita që organizoi e çoi në fitore Luftën Nacionalçlirimtare. Asaj i takon lavdia për organizimin dhe kurorëzimin me sukses të revolucionit socialist në fushën politike dhe ekonomike. Asaj i përket nderi për transformimet madhështore në botën shpirtërore të njerëzve tanë.

Por ç'e bëri Partinë tonë kaq të aftë për ta çuar popullin në këto fitore historike? Kush ia dha asaj gjithë këtë forcë, mençuri, zotësi e guxim?

Burimi i forcës dhe i urtësisë së Partisë sonë ka qenë dhe është besnikëria ndaj mësimëve të marksizëm-leninizmit, zbatimi i tyre në mënyrë krijuese, pasurimi i tyre në praktikën shqiptare. Kjo e ka bërë të aftë Partinë për të parashikuar drejt, për të orga-

nizuar mirë, për të drejtuar e për të çuar në fitore luftën dhe përpjekjet e popullit.

Mbështetja në popull, vënia e interesit të popullit mbi gjithçka, lidhjet e ngushta me masat, besimi reciprok, janë burimi tjetër kryesor i forcës së Partisë sonë. Lidhjet e çeliktë të Partisë me popullin, uniteti i pathyeshëm midis pararojës dhe masave punonjëse, janë garancia e të gjitha fitoreve që kemi korrur e që do të korrim në të ardhmen.

Anëtarët e Partisë së Punës të Shqipërisë janë bijtë më të mirë e besnikë të popullit. Ashtu si në të kaluarën dhe për t'i shërbyer sa më mirë popullit të tyre, ata nuk kursyen asgjë dhe të parët dhanë jetën në lulen e rinisë. Edhe sot e në të ardhmen ata do të ndodhen kurdoherë atje ku puna është më e vështirë, ku kërkohen më shumë sakrifica, ku do ta lypin interesat e popullit dhe të atdheut.

Shokë dhe shoqe,

Kongresi i 6-të i Partisë, i cili ishte një manifestim i shkëlqyer i unitetit të çeliktë të radhëve të Partisë dhe të popullit rreth saj, kurorëzoi një periudhë të rëndësishme në historinë e Partisë dhe të popullit tonë, periudhën e revolucionarizimit të mëtejshëm e të thellë të të gjithë jetës së vendit, të mobilizimit të përgjithshëm plot vrull e entuziazëm, të aksioneve e lëvizjeve të fuqishme revolucionare. Përballë këtij hovi të papërmbajtshëm të masave u përmbysën norma e afate, u shembën koncepte e kanune, u zhdukën kisha e xhamia. Në 4 vjet e 7 muaj u plotësua plani pesë-

vjeçar i prodhimit të përgjithshëm industrial. U rritën në mënyrë të ndjeshme rendimentet e kulturave bujqësore e prodhimet blegtorale. Përmirësime të dukshme u bënë në mirëqenien e masave punonjëse.

Kongresi i 6-të i Partisë nuk bëri vetëm bilancin e sukseseve. Ai u dha Partisë dhe vendit një program të madh pune për të ardhmen. Si çdo kongres, edhe Kongresi i 6-të i hapi popullit tonë perspektiva të shkëlqyera. Plotësimi i detyrave të caktuara nga Kongresi do ta shpjerë atdheun tonë akoma më përpara, në rrugën e transformimit të vendit nga bujqësor-industrial në industrialo-bujqësor, më afër objektivave të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Kongresi i 6-të aprovoi direktivat për planin e pestë pesëvjeçar, në të cilin janë mishëruar edhe mendimet shumë të vlefshme që dhanë gjithë punonjësit gjatë diskutimit popullor. Të mëdha e të guximshme janë detyrat që i ngarkuam vetes me këtë plan të ri. Prodhimi i përgjithshëm industrial do të rritet mbi 50 për qind më shumë nga ç'ishte më 1970. Afërsisht po kaq parashikohet të rritet edhe prodhimi bujqësor e blegtoral. Të gjitha këto do të sigurohen në pjesën më të madhe nga rritja e rendimentit, nga organizimi më i mirë i punës, nga shfrytëzimi më racional i kohës dhe nga rritja e aftësive profesionale të të gjithë punonjësve. Në këtë pesëvjeçar do të ndërtojmë rreth 270 vepra të reja industriale, bujqësore e social-kulturore. Do të ndërtohen gjigantë të tillë si kombinati metalurgjik i Elbasanit dhe hidrocentrali i Fierzës, vlefta e ndërtimit dhe e montimit të të cilëve do të jetë e barabartë, bile dhe pak më e madhe se vlefta

e të gjitha ndërtimeve dhe montimeve të kryera gjatë pesëvjeçarit të dytë 1956-1960. Suksese të reja do të arrihen në përmirësimin e kushteve të jetesës materiale dhe kulturore të punonjësve.

Perspektivat e shkëlqyera, objektivat madhështorë që do të arrijmë në këtë pesëvjeçar, kërkojnë punë të madhe nga të gjithë. Komiteti Qendror i Partisë ka bindjen e plotë se punonjësit e vendit tonë, si deritani, me forca të shumëfishuara e me vrullin revolucionar që i karakterizon, do t'i kryejnë me nder e para kohe të gjitha detyrat që shtron plani i pestë pesëvjeçar, të gjitha vendimet që mori Kongresi i 6-të i Partisë. Le të shërbejnë festimet e 30-vjetorit të Themelimit të Partisë dhe vendimet e Kongresit të 6-të si një frymëzim i fuqishëm për zhvillimin me hov të emulacionit socialist, për tejkalimin e planeve, për organizimin shembullor kudo të punës, për ndërgjegje të lartë socialiste në punë nga të gjithë!

Punonjës të kryeqytetit,

Veprimtaria juaj luan një rol shumë të rëndësishëm në plotësimin me sukses të të gjitha detyrave që shtroi Kongresi i 6-të i Partisë. Tirana ka afërsisht një të dhjetën e popullsisë së vendit, rreth një të gjashtëtën e gjithë komunistëve. Ajo jep një të pestën e prodhimit të përgjithshëm industrial dhe është baza kryesore e përgatitjes së kuadrove të kualifikuar e të specialistëve të lartë. Tirana, si kryeqytet i vendit, ku ndodhet pjesa dërrmuese e të gjitha organeve e organizmave drejtues qendror, ndikon drejtpërdrejt në

tërë punën e Partisë e të shtetit, në të gjithë sektorët e jetës së vendit.

E mbani lart emrin e kryeqytetit të Shqipërisë dhe rolin tuaj pararojë, qëndroni si kurdoherë në ballë të luftës vigane për të vënë plotësisht dhe para kohe në jetë vendimet historike të Kongresit të 6-të të Partisë!

Shokë dhe shoqe,

Republika Popullore e Shqipërisë jeton, zhvillohet e forcohet përditë e më tepër. Nën udhëheqjen e Partisë së Punës, Shqipëria marshon ngadhënjimtare në rrugën e socializmit pa u trembur nga kërcënimet, bllokadat dhe shantazhet e imperialistëve, të revizionistëve dhe të të gjithë reaksionarëve.

Për popullin shqiptar liria, pavarësia, sovraniteti, jeta socialiste që ndërtojmë janë shumë të shtrenjta. Ne i kemi fituar ato me gjak e sakrifica dhe nuk lejojmë kurrë të na i cenojë. Njeriut s'i biem në qafë për asgjë, veç askujt nuk i lejojmë të na prejë, qoftë edhe një grimë. Populli ynë vigjilon dhe qëndron i tëri në këmbë në çdo moment, ushtar i pathyeshëm në mbrojtje të atdheut të vet, në mbrojtje të lirisë dhe të lumturisë që ndërton me duart e veta. Ne e kemi konsideruar dhe e konsiderojmë gjithnjë si detyrën tonë të përhershme luftën e vendosur e të pandërprerë në të dy frontet, kundër imperializmit amerikan dhe revizionizmit sovjetik.

Në luftën për ndërtimin e socializmit, në luftën që bëjmë kundër imperializmit e revizionizmit, Shqipëria

socialiste nuk është e vetme. Populli ynë ka miq të shumtë e të singërtë në të gjithë botën, që e duan dhe i qëndrojnë përkrah në ditë të mira e në ditë të vështira. Solidariteti vëllazëror i partive marksiste-leniniste dhe i popujve miq ndaj Partisë dhe popullit tonë u shpreh edhe një herë me forcë në Kongresin tonë të 6-të. Delegacionet e partive komuniste marksiste-leniniste nga të gjitha kontinentet që morën pjesë në Kongres e që na nderojnë edhe sot me pjesëmarrjen e tyre në këtë miting, u sollën Partisë dhe popullit tonë përkrahjen luftarake dhe miqësinë e ngrohtë të komunistëve dhe të revolucionarëve të vërtetë nga të katër anët e globit. Më lejoni që edhe një herë në emrin tuaj, qytetarë të Tiranës, të Partisë dhe të gjithë popullit, t'u shpreh atyre falënderimet e gjithë popullit shqiptar për solidaritetin e tyre vëllazëror, t'u uroj suksese në punën dhe në luftën e tyre revolucionare dhe t'i siguroj se te Partia e Punës dhe te populli shqiptar ata kanë për të pasur kurdoherë një përkrahës të flaktë e të vendosur të çështjes së tyre të drejtë, një mik të sigurt të popujve të tyre. Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar, ashtu si deri sot, do të qëndrojnë me vendosmëri në ballë të luftës kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, kundër revizionizmit, me atë sovjetik në krye, dhe kundër gjithë reaksionarëve...

Për ne ka qenë kurdoherë e afërt lufta heroike e popullit vëlla vietnamez dhe e gjithë popujve të Indokinës. Duke luftuar kundër armikut më të egër të të gjithë njerëzimit, imperializmit amerikan dhe veglave të tij, populli vietnamez mbron me trimëri e vetëmo-

him çështjen e të gjithë popujve, mbron lirinë dhe pavarësinë e tyre. Gjithë popujt, të mëdhenj e të vegjël, gjejnë në luftën e Vietnamit një mësim e frymëzim të madh. Vietnamezët, kamboxhianët, laosianët luftojnë për një çështje të drejtë, prandaj ata do të fitojnë. Populli shqiptar ka përkrahur dhe do të përkrahë luftën e shenjtë të popullit vietnamez, të të gjithë popujve të Indokinës, deri në fitoren e tyre të plotë.

Një ngjarje me rëndësi shumë të madhe për zhvillimin e luftës çlirimtare të klasës punëtore e revolucionin socialist, për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit dhe për përhapjen e triumfit të tij, është krijimi kudo i partive të reja komuniste, marksist-leniniste. Lufta e tyre e vendosur kundër borgjezisë, kundër oportunitizmit në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, kundër partive revizioniste në vendet e tyre, që janë kthyer në vegla të borgjezisë dhe përpiqen të shuajnë frymën revolucionare të popujve, është një kontribut i shquar që japin ato për triumfin e çështjes sonë të përbashkët. Partitë tona marksist-leniniste punojnë e luftojnë me të gjitha forcat e tyre për unitetin e vërtetë marksist-leninist, pa revizionistët e renegatët dhe në luftë të papajtueshme me veprimtarinë e tyre armiqësore e përçarëse.

Shokë e shoqe,

Dje ishte 7 Nëntori, dita e triumfit të Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, që shënoi fillimin e epokës së re, të epokës së revolucioneve proletare dhe të luftërave çlirimtare të popujve, të ndërtimit të so-

cializmit e të komunizmit. Revizionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, e kanë braktisur rrugën e Tetorit dhe kanë shkallmuar veprën e Leninit e të Stalinit, të të gjithë bolshevikëve. Por, me gjithë tradhtinë revizioniste, çështja e Tetorit është e pavdekshme. Trashëgimtarë të saj janë marksistë-leninistët, të cilët e kanë marrë atë në duart e tyre dhe mbajnë lart flamurin e revolucionit e të socializmit.

Ne ngritëm zërin kundër tradhtisë revizioniste, u çorëm maskën Nikita Hrushovit dhe pasuesve e bashkëpunëtorëve të tij, sepse ata ngritën dorën kundër marksizëm-leninizmit, kundër socializmit, kundër Revolucionit të Tetorit.

Duke përkujtuar sot festën e gjithë proletarëve të botës, 54-vjetorin e Revolucionit Socialist të Tetorit, ne shprehim bindjen se populli sovjetik që bëri këtë revolucion të madh dhe çau i pari rrugën e socializmit, do të gjejë përsëri forca për të flakur tej tradhtinë revizioniste.

Shokë dhe shoqe,

Popull shqiptar,

Ne mbyllim sot një periudhë të lavdishme, mbyllim 30 vjet të jetës sonë me Partinë e nën udhëheqjen e saj. Këto kanë qenë vite heroike dhe më të lavdishmet gjatë gjithë historisë shumëshekullore të popullit tonë.

Me Partinë në krye ne jemi të sigurt se vitet që do të vijnë kanë për të qenë akoma më të lavdishme e më të lumtura.

Përpara, për të vënë në jetë vendimet historike që mori Kongresi i 6-të i Partisë!

Lavdi popullit tonë trim e punëtor!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë, frymëzuesja dhe organizatorja e të gjitha fitoreve tona!

Rrofshin uniteti dhe solidariteti proletar i komunistëve revolucionarë të të gjithë botës!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 269 (7246), 9 nëntor 1971

Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1970-1971», Tiranë, 1972, f. 484

DISIPLINA NDIHMON PËR TA TRANSFORMUAR GATISHMËRINË NË FORCË TË PATHYESHME

*Nga biseda me sekretarin e parë të Komitetit të Partisë
të Rrethit të Skraparit*

23 nëntor 1971

Në fillim shoku Enver Hoxha pyeti se ç'përgatitje bëhen me rezervistët në rrethin e Skraparit si dhe me komandantët e komisarët që merren me stërvitjen e tyre. Pasi dëgjoi sqarimet nga sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Ç'përmbajtje ka puna politike që u bëhet këtyre kuadrove? Mos bëhet ndonjë punë «kashtë»? E them këtë se kur vete për të folur në një kurs ku përgatiten oficerë, duhet të marrësh parasysh çfarë njerëz ke përpara. Kur këta janë instruktorë partie, kryetarë kooperativash bujqësore, shefa repartesh prodhimi etj. duhet pasur patjetër parasysh ngritja ideopolitike e tyre. E kam çështjen këtu që të mos bëhen gjëra të kota, të përsëritura. Për shembull, atje nuk ka përse të flitet gjerësisht e në hollësi për disiplinën, sikur kursantët të mos kishin haber fare. Instruktori i komitetit të Partisë, për këtë problem bazë, di medoemos se ç'është

disiplina e ndërgjegjshme në Parti, në ekonomi, në ushtri, ndryshe nuk mund të jetë instruktor, se ai mëson të tjerët.

Për disiplinën duhet të ketë patjetër njohuri dhe të dijë edhe drejtuesi i brigadës në një kooperativë bujqësore, ndryshe kooperativistët e brigadës së tij i shthuren dhe brigada i shpartallohet. Vetëm puna politike dhe disiplina e ndërgjegjshme e mbajnë kompakte brigadën. Kur brigadieri di ta bëjë mirë punën politike në brigadën e tij me 40-60 veta, ai do ta ketë kompakte brigadën, ashtu siç bën komanda në kohë lufte, dhe do të dijë t'i ndajë si duhet forcat e saj për realizimin e planeve të bujqësisë: një pjesë për të bërë qilizmë, disa për t'u bërë shërbimet e nevojshme bimëve, si: plehërimin, mbjelljen, prashitjen, ujitjen etj. Me një fjalë, ai e ka për detyrë të ndajë racionalisht forcat që të sigurojë realizimin e tejkalimin e normave e të planeve dhe këto nuk janë punë të lehta. Për këtë qëllim ai organizon edhe punën politike që anëtarët e brigadës të mos venë interesin personal mbi atë të kooperativës.

Kur bëhet një punë përgatitore edukative për të kompaktësuar brigadën, për ta ngritur atë lart, politikisht dhe ideologjikisht, për ta bërë çdo anëtar të brigadës të disiplinuar, ashtu siç duhet të jetë ushtari në luftë për të realizuar me përpikëri çdo detyrë në togë apo kompani, atëherë s'ka dyshim që edhe rezultatet do të jenë të mira. Dhe, në këtë drejtim, kuadro tanë kanë tashmë mjaft eksperiencë. Me këtë dua të them se oficerët e këtyre kurseve duhet ta dinë se me kë kanë të bëjnë. Për këtë arsye, qysh më parë, është

e domosdoshme t'u thuhet atyre, në këto raste, që keni të bëni me njerëz partie të përgatitur, të ngritur ideologjikisht dhe politikisht, prandaj kini kujdes, mos u jepni «kashtë» për të ngrënë, po vritni mendjen dhe bëni përpjekje për një bashkim shkencor të diturive të tyre me ato tuajat. U thoni atyre se disiplina që i duhet brigadës së arave apo asaj të bllokut të pemëve frutore të jetë e rreptë si ajo e një reparti në kohë lufte, ku disiplina ndihmon për të transformuar gatishmërinë e togës dhe të kompanisë në forcë të pathyeshme.

Ashtu si disiplina e çeliktë e repartit në kohë lufte, duhet të jetë edhe disiplina në kooperativë, pse çdo thyerje e saj, çdo moskryerje e detyrës rrezikon rendimentin, ashtu si në ushtri mungesa e disiplinës në kohë lufte rrezikon jetën e djemve të popullit. Prandaj, për të siguruar prodhimin, brigadieri i dërgon në kohën e caktuar forcat në punë, siç bën komandanti i repartit ku nevojiten aq ose kaq forca në një sektor të frontit, kurse në tjetrin duhen më pak e të tjera, ndryshe nuk mund të sigurohet sukcesi. Pa bërë një ndarje dhe organizim të mirë pune nuk ka rezultate. Oficerët e këtyre kurseve të mos pandehin sikur kanë të bëjnë me një pyll të virgjër, ku ata vetë janë «përrëndia» përpara kursantëve dhe t'i ngarkojnë këta me njohuri të panevojshme.

Ju, shokët e Partisë, kini kujdes që këto çështje të mos bëhen në mënyrë automatike, të shkëputura e shabllon, që oficerët të mos u thonë kursantëve: «Këtu e kemi ne punën në dorë, prandaj ju duhet të na bindeni verbërisht». Këto punë të bëhen të koordinu-

ara mirë, se shokët e ushtrisë nuk i dinë si ju hallet e rrethit. Përgjegjësi i brigadës së arave, shefi i repartit të prodhimit apo punonjësi i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit e të tjerë, që venë në një kurs në ushtri, nuk rrinë duarlidhur në terren; atje ata janë nga njerëzit më të mirë të punës. Prandaj Partia t'i harmonizojë me kujdes këto gjëra dhe kurset të bëhen të efektshme; të kihet parasysh niveli i clementit rezervist; të shihet çfarë duhet t'u japin shokët e ushtrisë e çfarë duhet të marrin ata në ushtri gjatë ditëve të stërvitjes. Kjo periudhë kohe të shfrytëzohet në mënyrë sa më të frytshme. Për këtë qëllim t'u shtrëngohen mirë rripat shokëve ushtarakë që të mos bëjnë përralla me kursantët, po të zhvillojnë në teori dhe në praktikë mësimet të një niveli të lartë që kuadrot t'i përgatitin mirë. Kjo vë detyrën që ata të mos venë para tyre me një leksion të përgatitur dhjetë vjet përpara, po të plotësuar me gjëra të reja, çdo vit e më mirë. Po të veprohet kështu, kur kuadrot e terrenit të shkëputen nga puna e tyre, do të venë ta bëjnë me qejf stërvitjen ushtarake.

Pastaj, shoku Enver Hoxha u interesua për rezultatet e arritura nga punonjësit e rrethit të Skraparit gjatë vitit 1971, në fronte të ndryshme të punës e të jetës. Duke u ndalur veçanërisht te çështja e ujitjes së tokave e se ç'mund të bëhet më tepër në këtë drejtim, shoku Enver Hoxha tha:

Edhe unë ashtu mendoj, ta shikojmë edhe një herë problemin e ujitjes së tokave për rrethin tuaj, se

ky është atje më i mprehtë¹. Por, veç ujitjes, mos harroni pemëtarinë dhe blegtorinë. Përveç mollëve, qershive e kumbullave, mendoj se mund të mbillni edhe arra, se Skrapari është rreth malor dhe kjo pemë bëhet, vetëm kini parasysh se arra do shumë vjet që të japë prodhim. Veç kësaj, mendoj se nuk duhen përzier shumë lloje pemësh frutore në të njëjtin bllok.

Në vazhdim të bisedës shoku Enver Hoxha u ndal te problemi i arsimit, veçanërisht për numrin e nxënësve e të shkollave të kategorive të ndryshme, të arsimit të përgjithshëm e profesional. Duke u informuar se në këtë rreth akoma nuk qe hapur ndonjë shkollë profesionale pa shkëputje nga puna, përveç disa kurseve, shoku Enver Hoxha tha:

Punë të tilla mos i zvarritni, se nuk presin; shkollat i ngrini sa më shpejt. Juve ju mungojnë shumë sidomos kuadrot me arsim të mesëm dhe në përgjithësi njerëzit e mësuar. Edhe pjesën më të madhe të komunistëve, nga sa jam informuar, ju e keni me fare pak shkollë. Prandaj, siç thamë, shkollat e parashikuara në plan, i hapni sa më parë².

Në Skrapar vihet re se po kthehen mjaft familje që ishin larguar më parë në rrethe të tjera dhe kjo është një gjë e mirë.

Tani, me rastin e festave të 28 dhe 29 Nëntorit.

1. Shoku Enver Hoxha u ndal më konkretisht për këtë problem gjatë vizitës në rrethin e Skraparit. Shih në këtë vëllim, f. 431.

2. Në rrethin e Skraparit u hapën e funksionojnë 14 shkolla të mesme pa shkëputje nga puna, nga të cilat 12 në kooperativa bujqësore.

mendova të vij njëherë në rrethin e Skraparit, rreth malor me një popull trim dhe luftarak, i lidhur me Partinë, për t'u takuar me popullin e për t'u njohur nga afër me problemet që mund të keni¹.

Botohet për herë të parë me ndonjë shkurtim sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

1. Shoku Enver Hoxha e vizitoi rrethin e Skraparit nga data 27 deri 30 nëntor 1971.

POPULLI I SKRAPARIT ËSHTË NJË POPULL TRIM E LUFTARAK, I LIDHUR ME PARTINË

Fjala në mitingun e popullit të Skraparit

28 nëntor 1971

Të dashur shokë dhe shoqe, motra dhe vëllezër të shtrenjtë të rrethit të Skraparit!

Pasi mbaruam me sukses punimet e Kongresit të 6-të, që shënon një ngjarje të rëndësishme në historinë e Partisë sonë të lavdishme dhe të popullit shqiptar, u sugjerova shokëve të shkonim në rrethe për t'i kaluar këto ditë të gëzueshme të festave të 28 e 29 Nëntorit, si kurdoherë, së bashku me popullin, në gjirin e tij.

Çdo vit festat e Nëntorit i kemi pritur me gëzim dhe kemi arsye të jemi të gëzuar, se këto ditë të shënuara i festojmë në atdheun tonë të lirë, të pavarur e sovran, në Shqipërinë tonë socialiste të udhëhequr nga Partia jonë e lavdishme, në atdheun tonë të bukur që e çliruar me gjakun tonë dhe po e ndërtojmë me djer-sën tonë. Por veçanërisht sivjet ne jemi akoma më të gëzuar se çdo herë tjetër, sepse porsa bëmë bilancin e fitoreve në Kongresin e Partisë, ku vendosëm detyrat

që do të kryejmë në pesë vjetët e ardhshëm për të mirën dhe lumturinë e popullit tonë.

Kur vendosëm t'i kalonim festat me popullin, shokët më pyetën se ku do të shkoja. Unë u thashë se kësaj radhe kam zgjedhur Skraparin, se do të vete në gjirin e këtij populli trim dhe heroik, i cili, siç bëjnë trimat, nuk e ka zakon të flasë shumë. Për të flet historia sidomos për kontributin e madh që ka dhënë ai në çlirimin e Shqipërisë.

Jam jashtëzakonisht i prekur nga kjo pritje kaq e përzemërt, e ngrohtë dhe e zjarrtë që po më bëhet nga ana juaj, çka shpreh dashurinë tuaj të pakufishme për Partinë. Më lejoni që me rastin e këtyre tri datave të mëdha të historisë së popullit tonë: jubileut të Themelimit të Partisë, që u kurorëzua me sukses më 8 Nëntor 1941, të cilin e festuam para disa ditësh, ditës së Pavarësisë që u shpall në Vlorë më 28 Nëntor 1912 dhe ditës së Çlirimit që u arrit më 29 Nëntor 1944, t'i sjell popullit heroik të Skraparit përshëndetjet e zjarrta të Komitetit Qendror të Partisë, të të gjithë komunistëve, të Qeverisë dhe të miat personale.

Skrapari dhe ju skraparllinjtë jeni të lidhur si mi-shi me kockën me këto tri data, jo vetëm si besnikë dhe ndjekës të idealeve të larta që frymëzonin ngjarjet e mëdha që përmenda dhe që u kurorëzuan me këto tri fitore të shënuara, për rëndësinë e të cilave historia e Shqipërisë ka shkruar dhe do të vazhdojë të shkruajë, por, skraparllinjtë, si popull dhe si bij të shquar, të dalë, të frymëzuar dhe të mbështetur fuqimisht nga ky popull trim, kanë qenë nga iniciatorët, frymëzuesit, organizatorët dhe mbrojtësit e zjarrtë, me

armë dhe me penë, të këtyre lëvizjeve të mëdha kombëtare, rëndësia historike e të cilave është e njohur mirë jo vetëm nga mbarë populli shqiptar, po bile edhe jashtë kufijve të Shqipërisë.

Dita e 28 Nëntorit 1912 ose dita e ngritjes së flamurit nuk është një datë në vetvete e rënë nga qiejt, si një ngjarje «idealiste», në kuptimin filozofik të fjalës. Kjo ditë nuk është as vepra e konceptuar dhe e zbatuar vetëm nga një ose dy persona, qofshin këta edhe patriotë e mendimtarë të shquar si Ismail Qemali. Shpallja e Pavarësisë sonë Kombëtare aq më pak nuk ishte pjellë e të huajve. Ajo është rezultati logjik revolucionar i përpjekjeve dhe i luftërave të përgjakshme të popullit tonë heroik që ai bënte vazhdimisht, pa pushim me armë, me penë e me diplomaci, brenda dhe jashtë vendit, në mënyrë legale dhe ilegale, kundër pushtuesve otomanë e fuqive të tjera imperialiste të Evropës apo shovinistëve fqinj, që kërkonin dhe zbatonin copëtimin e Shqipërisë, si dhe kundër gjithë bejlerëve e pashallarëve të brendshëm, që bënin lojën e armikut. Pra, 28 Nëntori dhe ngritja e flamurit në Vlorë më 1912 përfaqësonte realizimin, mjerisht të përkohshëm, të vullnetit të çeliktë të popullit tonë, kurorëzimin e luftërave të tij për ta pasur Shqipërinë të lirë dhe të pavarur.

Qeveria e Vlorës dhe populli shqiptar bënë përpjekje të mëdha që Shqipëria të mos copëtohej, që Shqipëria të rronte si shtet i pavarur. Por shpejt ajo u gjend përballë koalicionit të egër të të gjitha fuqive imperialiste të Evropës që po përgatiteshin për luftë dhe njëkohësisht për ripushtimin e atdheut tonë.

Pjesëmarrja dhe kontributi i skraparllinjve në përgatitjen e ngjarjeve historike që do të sillnin ngritjen e flamurit në Vlorë më 1912 ka qenë e madhe dhe e rëndësishme. Ju, vajza dhe djem të rinj, duhet ta njihni historinë e lavdishme të gjyshërve dhe prindërve tuaj skraparllinj dhe të mësoni se lufta e tyre, ashtu si e gjithë pjesës tjetër të popullit tonë, nuk filloi më 1912, por shumë kohë më përpara.

Dihet pjesëmarrja e më shumë se 30-40 vetave nga Skrapari në mbledhjen e Frashërit në vitin 1906, ku u morën vendime luftarake, të diktuar nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, e udhëhequr nga patrioti Abdyl Frashëri dhe nga Komiteti i Manastirit. Të dy këto forume me rëndësi historike kanë ndikuar mjaft në luftën për çlirim të popullit shqiptar. Skraparllinjët morën pjesë edhe me armë në dorë dhe formuan një numër të madh çetash, të cilat, pasi kaluan qafat dhe grykat e këtyre maleve, morën pjesë aktive në ngjarjet që çuan pastaj në ngritjen e flamurit më 1912. Njihet, gjithashtu, kudo pjesëmarrja e përfaqësuesve të popullit të Skraparit në mbledhjen e Vlorës më 28 Nëntor 1912. Ismail Qemali, për të përballuar rrezikun që i kanosej atdheut pas 28 Nëntorit të 1912-s, mendoi t'u drejtohej edhe trimave të Skraparit duke u bërë thirrje të rroknin armët për të mbrojtur Qeverinë e Vlorës. Skrapari i dërgoi luftëtarët e tij trima për t'i ardhur në ndihmë me armë Plakut të Vlorës. Ata shkuan pa vonesë atje ku iu bë thirrja. Në këto beteja, do të merrte pagëzimin e parë luftarak Riza Cerova, i cili më vonë do të bëhej një nga figurat më heroike të kryengritjeve tona të ardhshme popullore, luftëtar dhe

mbrojtës në krye të masave i Qeverisë së Vlorës, i Kongresit të Lushnjës, armik i betuar i esadistëve, armik i regjimit të Zogut, mbrojtës deri në fund i Qeverisë Demokratike të Fan Nolit, mbrojtës i revolucionit bolshevik, paraardhës i komunistëve në Shqipëri, për të cilën ai luftoi ta shihte të lirë dhe socialiste, derisa u vra duke luftuar, si revolucionar që ishte.

Riza Cerova luftoi deri në fund si revolucionar dhe si internacionalist. Ai është dhe do të mbetet një bir i lavdishëm i Skraparit dhe i Shqipërisë, simbol i luftës për liri dhe i një jete më të mirë për popullin e Skraparit, për popullin e vendit të vet dhe për popujt e tjerë. Bijtë e Skraparit nuk u kursyen të shkojnë e të luftojnë deri edhe larg në Persi, të marrin pjesë edhe në luftën e Spanjës. Populli heroik i Skraparit vazhdimisht i frymëzonte, i armatoste dhe i hidhte në luftë bijtë e tij, shumë prej të cilëve bënë fli edhe jetën për kauzën e shenjtë të Shqipërisë.

Por, të dashur shokë dhe shoqe, gjaku i derdhur nga populli shqiptar, në këto luftëra të shumta për liri dhe pavarësi, nuk vajti kot, pse ai çelikosi fort energjitë e popullit. Është e vërtetë, siç e ka provuar jeta, se revolucionet shumë herë fitojnë. Por, në rrugën e tyre ata ndeshen edhe në pengesa të mëdha, prandaj shpesh në histori ngjajnë kthesa e zigzage, bile, nganjëherë, revolucionet dështojnë, megjithatë fitorja, më së fundi, i takon popullit. Kështu ka ndodhur edhe me vendin tonë. Megjithëse pas Shpalljes së Pavarësisë të vitit 1912 Shqipëria kaloi kohë të zeza, populli i saj, si kurdoherë, nuk e përkuli kurrizin, qoftë përpara të huajve, qoftë përpara tiranëve të

vendit. Fatkeqësitë për popullin shqiptar nuk morën fund me fitoren e pavarësisë, pse pas kësaj kohe vendi ynë hyri përsëri në një kaos të madh, ai u okupua nga të huajt. Në mbarim të Luftës së Parë Botërore imperialistët dhe fqinjët grabitqarë filluan përsëri pazarllëqe të tmerrshme në kurriz të tërësisë tokësore të atdheut tonë. Qeveritë shqiptare që erdhën në fuqi pas asaj periudhe nuk ishin popullore. Për këtë arsye në atë kohë u bënë orvatje për përmbysjen e tyre, bile u shkua edhe deri në revolucion nga ana e popullit, i cili solli në fuqi Qeverinë Demokratike-Borgjeze të Fan Nolit, që ishte përparimtare për kohën e vet. Por, mjerisht, ajo i pati ditët të shkurtra, pse nuk mori parasysh dhe nuk realizoi si duhej vullnetin dhe aspiratat e popullit punonjës, që e solli në fuqi. Prandaj pas përmbysjes së qeverisë së Nolit, feudalët morën prapë fuqinë në dorë.

Me bajonetat e të huajve u vendos kështu në vendin tonë regjimi i egër feudal i Ahmet Zogut që për 15 vjet sundimi të rëndë bëri tmerret që njihen: shfrytëzoi, varfëroi, çnderoi, burgosi dhe vrau popullin e më në fund ia shiti atdheun Italisë fashiste.

Re të zeza kaluan përsëri mbi Shqipërinë; kohë të vështira iu desh të kalonte popullit shqiptar, por ai nuk e humbi besimin në forcat e tij. Ashtu siç ishte, pasi mblodhi veten, mobilizoi të gjitha energjitë dhe filloi rezistencën e vendosur kundër pushtuesit. Rezistenca popullore kundër Italisë fashiste dhe shërbëtorëve të saj vendës u përhap e fuqishme në tërë Shqipërinë si një rrufe e tmerrshme dhe mori shpejt përpjesëtimet e një revolucioni të madh popullor.

Këto tipare të lavdishme të luftës së pandërprerë e të gjithanshme kundër armikut, popullit tonë ia dha Partia që u formua më 8 Nëntor të vitit 1941. E re nga mosha ishte Partia Komuniste e Shqipërisë në kohën e luftës, por e pjekur në mendime, e tmerrshme dhe e pamëshirshme për armiqtë, sepse ajo ishte përfaqësuesja e lavdishme e klasës punëtore, e fshatarëve dhe e malësorëve trima, që për shekuj me radhë kanë mbajtur lart emrin e atdheut të tyre të lashtë. Partia, si udhëheqëse e gjithë popullit, e ngriti edhe më lart flamurin që u ngrit në Vlorë, të cilin e kishin hedhur në baltë me përbuzje bejlerët e Ahmet Zogut dhe borjezia e shitur vendëse.

Populli shqiptar, që nga koha e Skënderbeut e deri në ditën e revolucionit të madh popullor, nuk ka luftuar kurrë për bejlerët dhe pashallarët. Trimat e Vërzehës, të Potomit e të të gjitha fshatrave të tjera të Skraparit nuk luftuan për të mbështjellë me flamurin e Vlorës tradhtarët që e shitnin Shqipërinë, pse ky flamur ishte i popullit, ai ishte flamuri ynë dhe ne nuk ishim të shitur si ata.

Ne, komunistët, që u ngritëm në luftë për çlirimin kombëtar e shoqëror, nuk ramë nga qiejt, pse këmbët i kishim mbi tokë. Ne nuk erdhëm nga jashtë për të luajtur kartat e ndokujt, por dolëm nga gjiri i nënave të vuajtura të popullit shqiptar, që na kishin rritur me qumështin e paktë të gjokseve të tyre gati të tharë nga të pangrënët; ne lindëm nga ata baballarë që robëtoheshin së punuari ditë e natë nëpër shkëmbinj të dhe gërxhet e megjithatë nuk siguronin dot as bukën e gojës për të na ushqyer. Por, edhe kur ata arrinin të fi-

tonin një kile misër, fajdexhinjtë ua rrëmbenin pa mëshirë.

Ne, bijtë e popullit të shumëvuajtur, në flamurin e lagur me gjakun e popullit shqiptar, mbi shqiponjën e tij me dy krerë vumë yllin e komunizmit, yllin e popullit që nuk do të shuhet kurrë. Ky yll që u vendos në flamurin e ngritur më 28 Nëntor 1912 përfaqëson dëshirat, vuajtjet, aspiratat dhe të ardhmen e popullit, prandaj ai e ka vendin në krye, mbi shqiponjën e maleve tona. Ylli i kuq me pesë cepa është simboli i komunizmit, ai i ndriçon rrugën atdheut tonë drejt shoqërisë komuniste, drejt jetës më të lumtur e të begatshme për mbarë popullin tonë.

Ju, të dashur shokë dhe shoqe, e dini fare mirë se ç'luftë të rreptë kemi bërë ne me armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm për çështjen e flamurit dhe të komunizmit. Këto ndeshje të forta kanë qenë një shprehje e luftës së ashpër klasore që është zhvilluar aso kohe në vendin tonë. Armiqtë kishin frikë nga komunistët, natyrisht, jo nga numri i tyre që, siç dihet, në fillim ka qenë fare i vogël, po për arsye se mendonin që forcat dhe idetë e komunistëve ishin të mëdha, ishin të tmerrshme për ta, sepse komunistët përfaqësonin dëshirat dhe aspiratat e popullit. Populli i urrente pushuesit dhe tradhtarët, prandaj këta cilindo që ishte me popullin e luftonin. Por, edhe ne, i luftuam ata pa mëshirë deri në fund, deri në shkatërrimin e plotë të tyre. Parti dhe popull, të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, bënë një luftë të madhe në atë kohë kur luhej fati i Shqipërisë, kur çështja shtrohej: ja të vdisnim krenarë, ja të fitonim, që të rronim si njerëz dhe popu-

llin ta çonim në dritë, që ai të mos rronte si skllav.

Partia jonë vërtet ishte e re në moshë, po kishte një pjekuri të madhe, të cilën e gjeti te ju. Ajo kishte pjekurinë e madhe të popullit, u mbështet në historinë e lavdishme dhe në eksperiencën e madhe të tij, në luftërat dhe betejat, në fitoret që kishte korrur dhe në disfatat që kishte pësuar.

Ne, komunistët, ishim bijtë tuaj që shikonim se në ato kohë të vështira luhej fati i Shqipërisë, prandaj nuk mundeshim dhe nuk na lejohej jo vetëm të qëndronim pasivë, po as të bënim gabimin më të vogël, pse një qëndrim i tillë do t'i kushtonte shtrenjtë popullit shqiptar. Për këtë arsye, Partia, që në ditët e para të krijimit të saj, na mësoi ne, komunistët, të mos shkëputeshim nga populli, përkundrazi, ajo na porositi të venim në popull, të mësonim prej tij, të këshilloheshim me të dhe të shkonim në luftë me guxim e me vendosmëri për çështjen e madhe të popullit dhe të atdheut, pse vetëm kështu do të fitonim.

Nuk do të zgjatem më mbi këtë çështje, pse ju të rinjtë e të rejat këto i dini mirë, mbasi keni në duar dokumentet e Partisë. Keni, pastaj, edhe gjithë këtë numër të madh shokësh e patriotësh të moshuar që bënë luftën, të cilët janë kurdoherë në dispozicionin tuaj dhe të gatshëm t'ju tregojnë se lufta dhe vija e Partisë nuk u ndërtuan në një ditë dhe përnjëherësh; ato nuk u realizuan lehtë e pa pengesa, pa sakrificë e pa gjakderdhje. Përkundrazi, për të arritur këtu ku jemi sot, është dashur të na vriteshin qindra e mijëra motra dhe vëllezër, të na digjeshin shtëpitë, të na zhuriteshin krahina të tëra; është dashur të bëhej shumë

punë për të bindur njerëzit, pse e vërteta është që në fillim nuk ishim të tërë në një mendje. Atëherë luanin rol të madh farefisi, krushqia, lidhjet e miqësisë, feja, përçarjet krahinore etj. Partisë i duhej t'i zbërthente të gjitha këto situata që ekzistonin, të gjente rrugët e drejta, t'i thoshte secilit se mbi gjithçka qëndrojnë, në radhë të parë, liria dhe pavarësia e atdheut. Komunistët dhe patriotët punuan me durim të madh në këtë drejtim dhe ua shkëputën tradhtarëve ballistë dhe zogistë të gjithë ata që ishin gënjyer prej tyre, ua hoqën influencën që mund të kishin këta tradhtarë në një pjesë të popullit, i lanë, si të thuash, «lakuriq» dhe më në fund u dhanë dërmën, duke i vënë përpara, si lopët, në luftime.

Disa mendjeshkurtër thonë se luftën që bëmë ne komunistët nëpër male, e kopjuam nga të tjerët. Kjo nuk është e vërtetë. Ne asgjë nuk kemi kopjuar nga të tjerët, pavarësisht se mësojmë dhe kurdoherë do të mësojmë si nga eksperiencia e mirë e të tjerëve, ashtu edhe nga gabimet e tyre, me qëllim që të mos bëjmë gabime vetë. Por sa për luftën partizane, këtë e kemi mësuar nga të parët tanë, nga gjyshërit dhe prindërit që kurrë s'e hoqën pushkën nga krahu. Luftën e tyre ne e ngritëm në një sistem e shkallë më të lartë, sa i tmerruam italianët dhe gjermanët, pavarësisht se oficerët e tyre kishin mbaruar shkolla dhe akademi të larta dhe qenë pajisur gjer në dhëmbë me mitraloza, topa e tanke. Ne i thyem ata sepse mençurinë, zotësinë, gjakftohtësinë dhe trimërinë e baballarëve dhe të gjyshërve tanë ditëm t'i përvetësojmë.

Këto male, shkëmbinj e gërxhe i bëmë kështjella

të pamposhtura ku armiku gjeti vdekjen. E tillë ishte eksperiencia e luftës që trashëguam nga paraardhësit tanë, të cilën Partia, e mbështetur fort në mësimet e marksizëm-leninizmit, e ngriti në një shkallë shumë të lartë. Prandaj edhe çetat partizane të Pezës, Krujës, Matit, Dibrës, Lumës, Korçës, Skraparit, Mallakastrës, Vlorës, Gjirokastrës dhe të gjithë Shqipërisë luftuan me të gjitha forcat, pse ato mbështeteshin në luftërat e të parëve tanë, por udhëhiqeshin nga Partia, frymëzoheshin nga Partia, e cila punonte për t'i bërë partizanët luftëtarë të ndërgjegjshëm e të bashkuar grusht rreth saj; pse vetëm kështu populli do t'i dërrmonte armiqtë dhe tradhtarët dhe do të fitonte mbi ta.

Një gjë e tillë s'ndodhte në të kaluarën, pse me gjithë luftërat heroike që ka bërë populli gjatë shekujve për liri e pavarësi, kur vinte fundi për të bërë llogaritë, luftëtarët shpërndaheshin, pushteti binte përsëri në duart e bejlerëve e të agallarëve që maheshin me gjakun e derdhur. Kjo ndodhte atëherë për arsye se masave të luftëtarëve u mungonte një shtab i fortë që t'i udhëhiqte drejt, t'i mbronte e t'u qëndronte besnik interesave të vegjëlisë. Prandaj them se në luftë ne mësuam si nga të mirat e gjyshërve e prindërve tanë, ashtu edhe nga dobësitë e mungesat e tyre, të cilat i zëvendësuam me gjëra të mira. Kështu, nën udhëheqjen e Partisë, njësitet e vogla dhe çetat i lidhëm dhe i kthyem në batalione, brigada, divizione e korparmata. Partia organizoi Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare që koordinoi veprimet e të gjitha reparteve partizane dhe realizoi me luftë objektivin e saj imediat kryesor që atëherë ishte çlirimi i atdheut.

Populli, me Partinë në krye, e çliroi atdheun jo me fjalë, po me armë, me luftë, me vuajtje e sakrificat. Për këtë arsye, që vuajtjet dhe sakrificat e bëra për arritjen e fitores të mos shkonin dëm, Partia, në krye të popullit, bëri atë që baballarët dhe gjyshërit tanë, për arsye se nuk kishin udhëheqje, nuk kishin një parti të tyren, nuk qenë në gjendje ta bënin: popullin që luftoi ajo e mësoi të mos i lëshonte armët nga dora, që Ushtria Popullore e krijuar gjatë luftës e që është arma kryesore e revolucionit, të qëndronte në këmbë, në mbrojtje të atdheut të çliuar dhe të pushtetit popullor që u vendos.

Në kohën e luftës çështja shtrohej kështu: kush do të sundonte në Shqipëri, populli, apo kapitalistët, bejlerët e agallarët? Populli e bëri luftën dhe fitoi, prandaj ai duhet të sundonte në këtë vend, për këtë ai duhej të vinte në fuqi. Dhe, siç e dini, që në kohën e luftës u krijuan këshillat nacionalçlirimtarë, që u bënë organet e para të pushtetit demokratik. Në to kishte të drejtë të zgjidhej çdo njeri i ndershëm, po ama jo bejlerët, agallarët dhe fajdexhinjtë gjakpirës. Të gjithë ata që kishin vrarë e grabitur popullin, porosiste Partia, të shkojnë në gjyq dhe të dënohen sipas fajit, deri edhe me plumb. Të tjerët, që do të mbeteshin, nuk do të kishin të drejta në demokracinë tonë popullore, para se të lanin fajet që i kishin bërë popullit e para se të jepnin prova të shumta në qëndrime, në punë, në ndershmëri. Dhe vetëm kur të krijohej bindja se ishin ndrequr, atëherë do t'i fitonin të drejtat e do të jetonin si të gjithë.

Politika që ndoqi Partia ndaj armiqve të klasës

ishte e drejtë. Kështu, e drejtë dhe e rreptë ishte ajo edhe kundër armiqve të jashtëm, të cilëve iu bëmë thirrje të mbanin larg duart nga Shqipëria, pse kjo s'ishte më ajo e kohëve të kaluara. Ata u paralajmëruan se, në rast se mendonin si në kohët që kishin përënduar, që të luanin politikën në kurriz të Shqipërisë, duke u orvatur të copëtonin pjesë të territorit të saj për t'ua dhënë, si në të kaluarën, Greqisë, Italisë, apo Jugosllavisë etj., do të fillonte lufta me ta.

Pseudomiqve anglezë dhe amerikanë u janë dhënë nga Partia jonë ultimatumet të vërteta, duke u bërë të qartë se Shqipëria s'ishte më ajo e Zogut, po e popullit, prandaj ose të pranonin të drejtat e saj, ose të qëroheshin që këtej. Dhe ata u qëruan me bisht ndër shalë.

E kaluara e lavdishme e popullit u mbajt gjallë dhe u përtërit shumë më e fuqishme në Luftën Nacionalçlirimtare, e cila në sajë të Partisë sonë heroike Komuniste është epopeja më e lavdishme e historisë së popullit tonë. Partia na mësoi, na edukoi dhe na udhëhoqi drejt në shtigjet më të vështira. Ajo na tregoi rrugën si të punonim dhe ç'rrugë të ndiqnim në ato kohë të rënda; si të silleshim me njerëzit e gabuar për t'i sjellë në rrugë të drejtë e të ishim të matur me ta, kurse me ata që donin të luanin në kurriz të popullit të silleshim rreptë dhe pa mëshirë, duke i goditur rëndë. Partia na dha kështu mësimet e lavdishme për mbrojtjen e interesave të lartë të popullit, prandaj ajo është shkolla më e mbaruar që mund të gjendet, është universiteti më i madh në botë; eksperiencat e saj është më e pasura dhe më e plota, mbasi përfaqëson mençurinë

e pafund të popullit shqiptar, të cilën e ka thithur me etje. Prandaj e fituam në luftën, motra, vëllezër, nëna e baballarë të Skraparit.

Më kujtohet se si në ditët e para të formimit të Partisë, kur ishim akoma pak komunistë, në shtëpinë e vogël në Tiranë na vinin lajme të mira për rezistencën e skraparllinjve. Ne gëzoheshim shumë dhe na dukej sikur kishim fituar qiejt, kur dëgjonim që këto male ishin kthyer në kështjella të pamposhtura të luftës çlirimtare të popullit tonë. Kur bisedonim atëherë i thoshim njëri-tjetrit: «Në Skrapar edhe në kohët e mëparshme ka vluar e furishme lufta e armatosur me armiqtë e atdheut e të popullit».

Kështu ndodhi në fakt edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare: Skrapari rroku armët dhe lufta në rrethin tuaj erdhi duke u zgjeruar nga dita në ditë, ashtu si në të gjithë Shqipërinë. Goditjet që filluan këtu te ju ishin nga të parat në vendin tonë; u krijuan çetat, të cilat u rritën pastaj në batalione e brigada e që luftuan pa mëshirë armiqtë e tradhtarët gjer në çlirimin e plotë të atdheut.

Sukses i madh ka qenë për Luftën tonë Nacionalçlirimtare kur u goditën tradhtarët dhe u çlirua Çorovoda. Traktet e Partisë, nga të katër anët e Shqipërisë, njoftonin se si skraparllinjët, të udhëhequr nga komunistët, çliruan qytetin e tyre, dhe që nga kjo kohë gërxhet, grykat e majat e maleve të Skraparit merrnin frymë lirisht dhe mbroheshin me trimëri nga repartet partizane që ishin ngritur kudo në rrethin tuaj. Komunistët dolën maleve për liri dhe luftuan bashkë me popullin. Vajzat, gratë dhe mëmat tuaja pritnin e për-

cillnin në shtëpi njerëz të luftës, të njohur e të panjohur, sikur të ishin vëllezërit apo bijtë e tyre, pse e dinin që ata luftonin kundër armiqve e tradhtarëve për lirinë e Shqipërisë. I tillë ka qenë patriotizmi dhe zjarrri i atdhedashurisë që ziente në popull, këtu në Skrapar, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare për lirinë e Shqipërisë dhe për Partinë Komuniste të Shqipërisë.

Nga Skrapari dolën komunistë e patriotë të shquar që drejtuan punën e Partisë dhe udhëhoqën çeta, batalione e brigada. Djem dhe vajza heroike të Skraparit lanë nam në luftime anekënd Shqipërisë dhe jashtë kufijve të saj. Midis shumë prej tyre mund të përmendim me këtë rast Kahreman Yllin, Heroin e Popullit Zylyftar Veleshnjën, Mane Nishovën, Pasho Hysin, Neshat Hysin, Myqerem Fugën, Njazi Çepanin, Xhevahir Spatharën, Pertef Therpelin, Asllan Osojën, Sulo Gradecin, Teki Malindin, Xhafer Kuçin e shumë e shumë të tjerë që nderuan atdheun, Partinë dhe Skraparin e që për t'i përmendur të tërë me radhë do të duhej shumë kohë.

Çdo dëllinjë e shkurre në këtë krahinë, në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare, u bë një pusi e tmerrshme për armiqtë pushtues e tradhtarët; çdo qafë e grykë u bë një fushë e ashpër beteje. Çdo pëllëmbë e këtyre maleve është larë me gjakun e dëshmorëve, të cilëve sot u janë ngritur lapidare për t'i bërë të pavdekshëm për tërë jetën. Të shumtë janë dëshmorët e rrethit tuaj që bënë sakrificën më të madhe, që Shqipëria të çlirohej e të bëhej ajo që është sot dhe që nesër do të jetë akoma më e bukur e më e begatshme.

Shoqe dhe shokë të dashur,

Këtu, në Skraparin trim, nga ana e Partisë dhe e Komitetit Qendror të saj, janë marrë vendime të rëndësishme historike për luftë e sulm mbi armiqtë. Këtej janë lëshuar urdhra për batalionet e brigadat partizane, që do të sillnin fitoren mbi armiqtë e huaj italianë e gjermanë dhe mbi tradhtarët e Ballit Kombëtar. Në Helmës është mbledhur Komiteti Qendror i Partisë për të goditur oportunistët e tillë si Ymer Dishnica e Gjin Marku; është marrë vendimi historik që të bëhej Kongresi i Përmetit dhe u punua për hartimin e raportit që u mbajt në atë Kongres.

Në Helmës ne shohim ashpërsimin e kontradiktave parimore me titistët jugosllavë, që aso kohe i konsideronim miq, pse akoma nuk qenë zbuluar haptas si renegatë të marksizëm-leninizmit, por disa shenja që vinim re në veprimet e tyre na tregonin se ata s'ishin në rregull. Për ta vërtetuar këtë po ju tregoj çfarë na ndodhi atje në një rast të shëmtuar nga ana e revizionistëve jugosllavë.

Ne kishim kapur dy tradhtarë me damkë të popullit shqiptar: Gani Kryezinë, një bej nga Kosova; dhe Zai Fundon, një trockist nga Korça. Unë kisha dhënë urdhër që të dy këta tradhtarë të popullit dhe kriminelë, për aktivitetin e tyre armiqtësor ndaj Luftës Nacionalçlirimtare, t'i jepeshin gjyqit partizan për të dhënë llogari dhe, në rast se ai do të vendoste, të pushkatoheshin. I deleguari i Titos erdhi në Helmës në shtëpinë e xha Mehmetit [Myslimit], ku qëndroja unë, dhe më tha: «Ose të lirohen Gani Kryeziu dhe Zai Fun-

doja, ose marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë priten». Unë iu përgjigja se me popujt jugosllavë që luftojnë kundër nazizmit ne nuk i presim marrëdhëniet, prandaj kjo që thua ti është e gabuar. Megjithatë, meqenëse e dashke shumë beun e Kosovës, merreni, goftë juaji, kurse tjetrin që nuk është as nënshtetas, as me banim e me origjinë jugosllave, në rast se gjyqi partizan vendos, ne do ta pushkatojmë qysh sot.

Të nesërmen, sikur të ishin marrë vesh me njëri-tjetrin, i dërguari i Titos me atë të Perandorisë Britanike, më erdhi koloneli anglez dhe m'u lut për të njëjtën gjë. Për të më mbushur mendjen, ai shtoi: «Shoku komisar, i lëshoni ata dhe ne do t'ju ndihmojmë me armë». «Sa për «ndihmat» tuaja, — iu përgjigja unë, — e dimë me kohë që janë të tëra llafe». Tri herë më kishte gënjyer, duke më njoftuar se avionët britanikë do të lëshonin materiale lufte në Staraveckë. Avionët vërtet kalonin, por jo për të na sjellë ndihma; ata fluturonin mbi vendin tonë për qëllime të tjera. Ne i shihnim ata së largu të kalonin përtej kufijve tanë nga ana e Korçës për në Greqi. Herën e parë, kur aeroplanët nuk erdhën, sipas njoftimit që na u bë, anglezi na tha se kishin gjetur rezistencë, prandaj «u detyruan të ndërrojnë rrugë».

Një herë tjetër oficeri anglez më tha se dëshironte të vinte në Mallakastër për t'u pjekur me ballistin kriminel Tefik Cfirin, pasi donte ta dëgjonte se ç'mendonte e çfarë bënte ai. Unë i thashë oficerit anglez: «Shiko more përfaqësues i qeverisë së Ingliterës, tani je në tokat partizane, prandaj zgjidh e merr: ose do të rrish me ne, ose shko te ballisti Tefik Cfiri apo ktheu

nga ke ardhur!». «Kujt i flet kështu?», — më pyeti ai. «Ty të flas, — i thashë unë, — zotër këtu janë Partia dhe populli që ne përfaqësojmë». Ai mbeti i shtangur në vend nga kjo përgjigje që s'e priste.

Pastaj i thashë xha Mehmetit ta zbriste nga shkallët dhe ta shoqëronte gjer në njëfarë vendi, dhe anglezi u largua. Kur po zhvillonte punimet e tij Kongresi i Përmetit, ai erdhi të na takonte përsëri. Mbase ishte koha që po hanim bukë, e ftova të hante dhe i thashë, «Ti sikur nuk do të vije më nga anët tona». «Jo, ndërrova mendje dhe erdha përsëri, por nuk do të marr pjesë në mbledhje», — vazhdoi anglezi. «Si të duash, iu përgjigja unë, po ku ke ndër mend të vesh»? «Do të vete në bregdet, të marr një anije dhe të nisem, prandaj ju lutem më jepni nja dy partizanë si shoqërues», — na tha ai. I dhamë dy partizanë sa të vinte gjer në Poliçanin e Gjirokastrës, mirëpo rrugës e qëlluan gjermanët dhe u vra nga një bombë. Kështu i la kockat atje koloneli i Mbretërisë Britanike. Me këto doja të thosha se Partia ka qenë në luftë të vazhdueshme edhe me pseudoaleatët anglezë dhe amerikanë dhe me misionet e tyre ushtarake në Shqipëri¹.

Në Helmës është bërë dhe Kongresi i Parë i Rinisë, që i dha një hov të madh organizimit luftarak të brezit tonë të ri, i cili me një patriotizëm të flaktë dhe dashuri të madhe për popullin e Partinë bëri heroizma të mëdhenj në luftën për çlirimin e atdheut.

1. Më hollësisht për ngjarjet e treguara këtu, shih: Enver Hoxha, «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë» — Kujtime, f. 210-213 dhe 300-320.

Në të tria datat historike që përmenda, Skrapari ka marrë pjesë gjallërisht, prandaj populli i rrethit tuaj e meriton plotësisht respektin dhe dashurinë që kanë për të Partia dhe gjithë populli ynë për trimërinë, besnikërinë, luftën dhe punën e madhe që ka bërë ai.

Tani ne po hyjmë në vitin e 28-të të Çlirimit. Realizime të mëdha janë arritur në vendin tonë, po të gjitha ato nuk kanë ardhur vetvetiu. Ato janë rezultat i luftës, i gjakut të derdhur e i sakrificave të panumërta që janë bërë, janë rezultat i punës së palodhur të mbarë popullit shqiptar.

Të dashur të rinj e të reja,

Ju jeni ai brez që keni luftuar dhe po luftoni me të gjitha forcat për ndërtimin e veprave të bukura të socializmit që gëzojmë sot. Ju keni qëndruar kurdoherë në ballë të punës dhe të përpjekjeve të mëdha që janë bërë e po bëhen për ndërtimin e së ardhmes suaj të ndritur. Në ditët e para të Çlirimit vendi ynë ka qenë shumë i varfër, i djegur, i këputur nga sëmundjet dhe uria, pa shkolla, pa njerëz të mësuar. Partia atëherë bëri thirrje për ta ndërtuar atdheun me thonj e me dhëmbë dhe populli u ngrit i tëri, punoi pa u lodhur, herë ngrënë e herë pa ngrënë.

Le t'i kalojmë për një çast mendimet në periudhën e disa viteve përpara dhe do të kujtojmë sa herë na kanë munguar buka e deri edhe kripa. Fill pas luftës populli s'kishte as vaj për të ndezur kandilin, bile, nganjëherë, as pishë, lëre pastaj rroba e këpucë. Imperialistët anglezë dërgonin mbi vendin tonë disa nga

avionët e vjetër të luftës për të hedhur ndonjë gjilpërë, ndonjë rrotkë pe, ndonjë veshje të vjetër apo kokërr sheqerke etj., për të mashtruar popullin, sikur gjoja i qanin hallin për t'i ardhur në «ndihmë» në ato kohë të vështira skamjeje. Mirëpo populli ynë që i njihte mirë armiqtë imperialistë dhe e kuptonte qëllimin e «ndihmave» të tyre, i merite ato lecka dhe ua dorëzonte punonjësve të sigurimit të shtetit. Ne i hidhnim ato në koshin e plehrave, pse s'kishim nevojë për «përkrahjen» e tyre. Sado të varfër që ishim, ne vendosëm ta ndërtojmë vetë çdo gjë me thonj dhe me dhëmbë.

Është e vërtetë se Bashkimi Sovjetik na ka ndihmuar në vitet e para pas Çlirimit, por puna e popullit gjithmonë ka qenë kryesorja, ajo ka qenë faktori vendimtar. Programi i Partisë për t'u mbështetur së pari në forcat tona, pastaj edhe në ndihmën e sovjetikëve, ishte i qartë dhe i kuptueshëm për popullin. Kjo ndihmë ishte sidomos për industrinë, të cilën nuk ishim në gjendje ta ndërtonim në atë kohë vetëm me forcat tona. Për zhvillimin e ekonomisë, na vihej detyrë të mëkëmbnim më parë bujqësinë, pastaj artizanatin dhe disa industri të vogla, fort të domosdoshme për nevojat imediate. Pas këtij procesi filloi zhvillimi i disa degëve një çikë më të mëdha të industrisë, e kështu me radhë, nga viti në vit, ka ecur përpara zhvillimi ynë në bujqësi, industri, arsim, kulturë etj.

Ngjitja jonë e përgjithshme ka shkuar vazhdimisht në mënyrë progresive, nga një plan pesëvjeçar në tjetrin, nga një kongres në tjetrin, gjersa arritëm në Kongresin e 6-të të Partisë, ku u aprovua plani i pestë

pesëvjeçar. Tash, duke hedhur një vështrim nëpër rrugën që kemi kaluar, shohim sa e drejtë ka qenë vija e Partisë sonë, në përpunimin e së cilës nuk u gabuam, as në lëmin e bujqësisë, as në atë të industrisë, as në lëmin e arsimit dhe të kulturës.

Për zhvillimin e një bujqësie të përparuar mbi baza socialiste ishte i domosdoshëm kolektivizimi i saj. Fshatari ynë nuk mund të dilte kurrë nga varfëria, në qoftë se do të vazhdonte të kufizohej në pronën e vogël private. Partia e dinte se në fillim ishte ca e zorshme që fshatari individual ta kuptonte përnjëherë nevojën e kolektivizimit, pse ndjenja e pronësisë nuk zhdukej dot me dekrete e urdhra. Prandaj, Partia porosiste që, në këtë drejtim, të punohej me shumë kujdes, në rrugën e bindjes, me durim dhe pa e prishur me fshatarin, që ka qenë një mbështetje e fuqishme për ne në kohën e luftës, duke na mbajtur me bukë dhe duke luftuar krah për krah me partizanët për këtë atdhe. Për këto arsye, s'ishte aq e lehtë të kryhej kolektivizimi pa e bërë më parë të ndërgjegjshëm fshatarin për nevojën e bashkimit të tokave e të bagëtive në kooperativa.

Për ta konkretizuar këtë që po them, po ju tregoj një ngjarje të atyre kohëve. Njëherë, pas Çlirimit, shkova në një kooperativë të Tiranës dhe u futa për të parë një stallë. Pyeta aty një plak kooperativist, që shërbente në stallë, se ku ndodhej atje lopa që kishte pasur vetë në shtëpi, para kolektivizimit. Ai më tregoi vendin ku ishte lopa e tij në stallë, në kohën që po u hidhte bagëtive kashtë për të ngrënë. «Mos i hedh gjë më shumë ish-lopës tënde», — i thashë unë. Ai më shikoi një herë në sy, pastaj më tha: «Po ti, more shoku

Enver, djalit tënd nuk i jep një çikë ushqim më shumë!». Unë qesha dhe i thashë se, patjetër, fëmijët, si të gjithë, edhe unë i dua më shumë, prandaj kur kanë nevojë u jap kafshatën e gojës.

Tani, motra dhe vëllezër, ne shohim se është kuptuar nga të gjithë që kooperativizmi ka qenë dhe mbetet rruga më e përshtatshme e lumturisë dhe e begatisë për mbarë fshatarësinë, pse, në sajë të kolektivizimit zbukuruar fushat. Pushteti popullor vazhdimisht ka marrë masa për zhvillimin e bujqësisë, ka tharë e vazhdon punën për të tharë të tjera toka që kanë mbetur akoma të pakulluara dhe do të vijë koha që në vendin tonë të mos ketë më kënetë. Tani na vihet detyrë t'i sistemojmë si duhet e në mënyrë shkencore tokat bujqësore, t'u bëjmë kanale e t'u sigurojmë ujitjen. Për zonat fushore gjer tani kemi bërë mjaft dhe përsëri do të vazhdojmë të bëjmë akoma, bile ca më shumë në të ardhmen, me qëllim që të arrijmë të marrim rendimente të larta kudo.

Por Kongresi i 6-të i Partisë, siç e keni dëgjuar, ka marrë vendime për të cilat do të mobilizohemi të gjithë për t'i zbatuar me punë të palodhur për të arritur ata objektiva të mëdhenj që janë caktuar, pse asgjë nuk arrihet pa punë dhe pa djersë. Ne duhet të punojmë vazhdimisht që të mundim ta përmirësojmë gjithnjë e më shumë jetën e popullit. Ky është qëllimi kryesor i Partisë, që jeta te ne të bëhet më e kulturuar, më e begatshme, më e lumtur, që të lodhemi gjithnjë e më pak e të krijojmë e të prodhojmë përherë e më shumë, ta bëjmë atdheun më të bukur e më të fuqishëm. Por, vendimet e Kongresit të 6-të i japin rëndësi

në mënyrë të veçantë zhvillimit të rretheve malore, siç është edhe ky juaji. Këtyre rretheve do t'u jepet një ndihmë më e madhe se gjer më sot, sidomos për ujitje, natyrisht pa lënë pas dore hapjen e tokave të reja dhe sistemimin e tyre.

Deri tash ndihma më e madhe për zhvillimin e bujqësisë u është dhënë fushave, pse një gjë e tillë ishte e drejtë dhe buronte nga nevoja për forcimin e potencialit ekonomik të mbarë vendit, për të përmbushur nevojat e mëdha që kishte populli për drithë e prodhime të tjera bujqësore e blegtorale në gjithë Shqipërinë. Në qoftë se në kohët e para nuk do t'u kishim vënë rëndësinë që thashë fushave, plotësimi i këtyre nevojave do të pengohej dhe atëherë do të vuante e gjithë Shqipëria. Prandaj, në kohët e para, vija e Partisë parashikonte që, pa i braktisur malet e kodrat, t'u jepej ndihmë e veçantë fushave për të mirën e gjithë ekonomisë popullore.

Mirëpo me Kongresin e 5-të Partia dha orientimin «T'u qepemi kodrave e maleve, t'i bëjmë ato pjellore si edhe fushat». Ky orientim i drejtë ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Le të marrim Skraparin tuaj. Gjatë periudhës pas Çlirimit ju keni arritur kudo edhe në çdo drejtim suksese të mëdha. Por, sidomos gjatë pesëvjeçarit që kaloi ju arritët të prodhoni bukën. Ky është një sukses i madh, prandaj, në emër të Partisë dhe të Komitetit Qendror ju uroj për të, pse është një gjë e madhe që një rreth malor si Skrapari me tokë të paktë, arriti të plotësojë nevojat për bukën. Në vitet e ardhshme ju me siguri do të prodhoni aq drithë sa t'i siguron bukën edhe popullatës së Poliçanit e të Ço-

rovodës¹, e cila, siç po shoh, është zbukuruar e bërë një qytet i këndshëm me shtëpi banimi, me shkolla, me shtëpi kulture, me muze, me spitale etj. Unë jam i bindur se, kur ta vizitoj një herë tjetër Çorovodën do të shoh këtu ndryshime të tjera më të mëdha. Sigurimi i nevojave për bukën edhe për të dy qytetet e rrethit tuaj, Çorovodën dhe Poliçanin, është një sukses me rëndësi të madhe.

Po a është vallë i mjaftë ky sukses? Jo! S'është i mjaftueshëm, pse Partia nuk lufton vetëm për bukën. Njeriu këtë nuk e ha dot thatë, ai ka nevojë edhe për mish, për vezë, qumësht, djathë, gjalpë dhe për disa ushqime të tjera të domosdoshme, siç janë frutat e zarzavatet. Që t'i konsumojë populli të gjitha këto duhet më parë t'i prodhojmë dhe këto prodhohen duke shtuar tokat, duke i punuar këto akoma më mirë se gjer tani me makina e traktorë, nga të cilët në këtë pesëvjeçar do të kemi edhe më shumë.

Ne do të kemi në sasi më të mëdha prodhime bujqësore e blegtorale, sidomos për arsye se do të ujitim më shumë toka. Sipërfaqet e ujitshme që keni caktuar të rritni këtë pesëvjeçar, si duket, nuk janë të mjafta për Skraparin. Edhe unë jam i mendimit që sidomos për rrethet malore, të mos jemi shumë të shtrënguar në këtë drejtim. Sot, ka ardhur koha që t'ua shtrëngojmë një çikë më shumë fushave, ku me investimet e mëdha të kryera atje gjer tani, janë të gjitha mundë-

1. Për nevojat e kooperativistëve, Skrapari e siguroi bukën që më 1967, ndërsa duke filluar nga viti 1973, edhe për dy qytetet Çorovodë e Poliçan.

sitë që fshatarësia kooperativiste të bëjë më shumë përpjekje për të prodhuar në masë 40-50-55 e deri në 60 kuintalë misër dhe 30-35 kuintalë grurë për hektar, ndërsa nga lopët të marrë 3 000 deri 4 000 litra për kokë, që kështu të ndihmohen malësitë më tepër se ç'i kemi ndihmuar deri më sot.

Detyra juaj tani është të vazhdoni në rrugën që keni filluar, se është e drejtë dhe në fakt ju kështu përceni, nën drejtimin organizatës së Partisë të rrethit tuaj. Këtu te ju ekziston një plan pesëvjeçar për hapje tokash të reja, të cilin duhet të mobilizoheni që ta realizoni sa më parë, pse toka ka rëndësi të madhe. Përs'pate tokë, nuk mund të kesh prodhime bujqësore, drithëra, perime, fruta, bile as bagëti. Vërtet se hapja e tokave është ca e zorshme, por me një mobilizim të përgjithshëm të forcave, me një organizim të mirë, duke ju dhënë edhe shteti ca mekanizma, ju do të arrini t'i hapni sipërfaqet e tokave të parashikuara dhe t'i futni sa më parë në prodhim.

Ju, që jeni malësorë dhe e njihni fare mirë natyrën e vendit, e dini se tokat që hapni në këto shpate kaq të pjerrëta, është e domosdoshme që edhe t'i mbrojnë njëkohësisht, duke u bërë mure, me qëllim që të mos shpëlahen nga shirat dhe të bëhen shterpe. Këtë kurrë të mos e harroni, prandaj me të hapur një sipërfaqe toke, bëni menjëherë mure mbrojtëse e pastaj t'i mbillni.

Këtë porosi ta keni kurdoherë parasysh edhe për ujitjen. Planin për ujitjen ju duhet jo vetëm ta realizoni, po, gjithashtu, edhe ta tejkaloni, pse uji i rezervuarit që do të ndërtohet në Prishtë, është akoma shu-

më pak. Edhe disa rezervuarë të tjerë që i janë caktuar komitetit ekzekutiv për të ndërtuar këtë pesëvjeçar nuk janë të mjaftueshëm. Prandaj, të merren sa më parë masa organizative të atilla që rezervuarët e parashikuar në plan, të ndërtohen përpara afatit të caktuar. Njëkohësisht, të shihet më me kujdes se çfarë mund të bëjmë akoma më shumë për të vënë nën ujë edhe më tepër sipërfaqe toke në rrethin tuaj, sepse ujitje do të thotë prodhim më i madh. Faktet këtë tregojnë. Ja, për shembull, kooperativat e Vërzhezhës, Bargullasit dhe Vendreshës që kanë ujë, marrin në drithë rendimente më të larta se të tjerat. Sidomos farërat «hibride» që do t'i përhapim kudo këtë pesëvjeçar, japin me të vërtetë rendimente të larta, por ato duan edhe ujë më shumë, edhe punën më të kualifikuar. Sado që nuk jam agronom, dëshiroj t'ju këshilloj që, të gjitha tokat që do të arrini t'i vini nën ujë, t'i punoni në mënyrë intensive, për t'u marrë sa më shumë prodhime që të jetë e mundur. Kjo është detyra numër një.

Detyra numër dy është që tokat, të cilat plani parashikon të vihen nën ujë gjatë këtij pesëvjeçari, të merrni masa që të shfrytëzohen sa më parë.

Detyra numër tre është që punimet të mos bëhen me metodat e vjetra të punës. Ju, të dashur vëllezër dhe motra, jeni njerëz përparimtarë edhe i kuptoni drejt këshillat e Partisë. Në rast se gjer tani nuk keni vepruar kështu, fajin nuk e keni ju, kjo ka ardhur nga mosditja, pastaj një çikë faj kanë edhe teknikët. Megjithatë, disa rregulla të reja, të domosdoshme për t'u zbatuar në dobi të bimëve bujqësore dhe të zhvillimit të blegtorisë, sado që mund ta keni pak me zor, duhen

vënë patjetër në jetë, se është për të mirën tuaj dhe të gjithë ekonomisë. Për shembull, patatja është bimë me rëndësi të madhe, ajo është njëkohësisht bukë dhe gjellë. Mirëpo, te ju merren shumë pak, vetëm 30-40 kuintalë për hektar. Ju nuk duhet të kënaqeni me këtë rendiment kaq të ulët, po të punoni për të marrë, po të jetë e mundur, 150 kuintalë, ashtu siç marrin disa nga kooperativat e rrethit të Korçës. Mund të thotë ndonjë se atje tokat i kanë në fusha dhe janë më pjellore. Kjo është e vërtetë, prandaj nuk mund të pretendohet që të merrni edhe ju sa atje, po të paktën 100 kuintalë patate për hektar duhet t'i merrni, fundi 90 kuintalë për hektar, po ama jo 40.

Ose, të marrim lopën. Vërzhezha e Bargullasi jo vetëm kanë prodhuar gjithë sasinë e bukës që u nevojitet, po kanë prodhuar edhe foragjere. Kështu, duke u dhënë ushqime lopëve, atje merren jo si në shumë kooperativa të rrethit tuaj nga 270 litra, po nga 1 200 litra qumësht për kokë, në vit. Është e kuptueshme se lopës ç't'i japësh, atë të jep. Po nuk i dhe të hajë, ajo nuk të jep qumësht. Prandaj ushqimet për blegtorinë i siguron medoemos.

Unë kam bindjen se ju do ta plotësoni këtë detyrë, pse organizatën e Partisë e keni të fortë, bile për sa i përket shtrirjes së Partisë ju jeni më mirë nga të gjitha rrethet e republikës. Komunistët në rrethin tuaj zënë 5,72 për qind të popullsisë, nga 3,48 për qind që është mesatarja në mbarë vendin tonë. Në shkallë republikane komunistët e kooperativave bujqësore zënë 6,49 për qind, në një kohë që në Skrapar ata zënë 11,46 për qind të tyre. Kjo ka rëndësi të madhe.

Megjithatë, organizatës së Partisë në rrethin tuaj i dalin probleme të tjera për të zgjidhur. Për shembull, te ju në Skrapar ka akoma shumë anëtarë partie vetëm me shkollë fillore. Për këtë unë u bëj thirrje komunistëve të Skraparit që t'i shtojnë përpjekjet për të dalë sa më parë nga kjo situatë. E kam fjalën më shumë për ata të moshave të reja, pse nuk mund t'u kërkojmë anëtarëve të Partisë me moshë të vjetër për t'iu futur punës që të mbarojnë shkollën e mesme. Kurse, komunistëve të moshës së re, që kanë vetëm filloren dhe nuk ndjekin 8-vjeçaren dhe të mesmen e përgjithshme e sidomos profesionale, duhet «t'u shkullim veshin» dhe t'u kërkojmë që ta ndjekin medoemos, sepse atdheu ka nevojë të madhe jo vetëm për punë të palodhur, po edhe për mësim të pandërprerë.

Partia kurdoherë na ka porositur të veni në popull dhe të mësojmë nga ai, të mësojmë njëkohësisht edhe nga librat. Kjo punë duhet bërë vazhdimisht nga ne komunistët, tërë jetën, sepse mësimi s'ka fund. Por, këtë dituri ne duhet ta vëmë në shërbim të popullit; atëherë mësimi merr një vlerë të madhe, ndryshe mbetet një stoli pa vlerë.

Shqipëria jonë ka nevojë për njerëz që ta dinë mirë zanatin. Ju, këtu në Skrapar, keni për të zhvilluar akoma më shumë se gjer tani bujqësinë, blegtorinë e pemëtarinë, tri degë të ekonomisë me rëndësi jetike për Skraparin. Prandaj që të gjithë, sidomos të rinjtë e të rejat e rrethit tuaj, t'i futen me zell të madh mësimin në këto degë. Kjo nuk do të thotë që djemtë dhe vajzat e Skraparit të mos bëhen doktorë, inxhinierë apo oficerë (që e keni në gjak dhe, në fakt, nga rrethi juaj sot

kemi plot oficerë të shquar, kemi aviatorë, kapitenë anijesh e të tjerë), ose të mos bëhen ekonomistë, mësues, mekanikë, naftëtarë apo punëtorë të degëve të tjera, pse edhe të tillë do të bëhen nga Skrapari. Po, në asnjë mënyrë të mos neglizhohet nevoja e madhe që ka rrethi juaj për kuadro të mësuar për drithëra, për blegtori, për rrush, për fruta e perime. Në qoftë se do të bëjmë edhe një hop tjetër të madh gjatë pesëvjeçarit të ri, siç bëtë në pesëvjeçarin e kaluar, duke u bazuar në patriotizmin tuaj të lartë dhe në dashurinë e madhe që ushqeni për Partinë (dhe unë kam bindjen se rrethi juaj do ta bëjë medoemos këtë hop), atëherë do të shikojmë se ç'rezultate të mrekullueshme do të arrihen edhe në këtë vend malor.

Organizatës së Partisë i bie detyra ta thellojë më mirë punën politike dhe ideologjike dhe t'ua bëjë të qarta masave të popullit perspektivat e mëdha të zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit, gjatë pesëvjeçarit të ri, duke përfshirë edhe zonat e thella malore. Kryesorja është që të gjithë duhet të punojmë që të prodhohet më shumë, që edhe populli i këtyre anëve sa më shpejt që të jetë e mundur të jetojë, të hajë dhe të pijë njëlloj si ai që jeton në fusha. Prandaj, sa më shumë të rinj dhe të reja të ndjekin për këtë qëllim shkollat bujqësore, që të bëhen njerëz të zotë për bujqësinë, për blegtorinë dhe për pemëtarinë.

Pemëtaria në rrethin tuaj ka një të ardhme të mirë, prandaj mos qëndroni në ato pak pjergulla që na kanë lënë të parët, as në ato që keni mundur të mbillni që nga Çlirimi e gjer tani. Në këtë drejtim mendoj se ju duhet të keni një plan më ambicioz, më

të madh se ai që është aprovuar. Së pari, duhen marrë masa që ta zgjeroni fidanishten tuaj, megjithëse do t'u vëmë detyrë edhe fidanishteve të disa rretheve të tjera fushore që të mbjellin një sasi fidanësh më tepër, për të përballuar edhe nevojat e rrethit tuaj.

Ju duhet të mbillni më shumë mollë, qershi, fiq dhe arra nëpër shpatet e gërxhet ku s'ka ç'të mbillet tjetër. Arrat mbijnë e rriten për mrekulli në tokat malore të Skraparit. Të gjithë këta objektiva që duhet të arrijmë për të ardhmen duhen studiuar një për një, kooperativë më kooperativë. Për këtë specialistët të rishikojnë planet ekzistuese dhe ju vetë të merrni masa për zbatimin e tyre, kurse Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria do të shikojnë nëse mund t'ju ndihmojnë për ato që ju nuk jeni në gjendje t'i realizoni me forcat e rrethit. Është e domosdoshme, pra, të bëhen disa gjëra më shumë se ç'janë caktuar në këtë plan pesëvjeçar për rrethin tuaj.

Për të gjitha këto, pra, del nevoja edhe për më shumë njerëz të mësuar, prandaj mos e varni shpresën vetëm në 3 ose në 30 apo 40 veta që dërgohen sipas planit në shkolla. Është e qartë se ata që mbarojnë shkollat duhet dhe do të jenë bartësit e diturive agroteknike, zooveterinare dhe të eksperiencës më të mirë të masave të popullit. Por, në qoftë se nuk e bëjmë të ndërgjegjshme dhe të aftë për zanatin e saj edhe kooperativisten më të thjeshtë, nuk kemi bërë gjë. Prandaj, çdo njeri që punon dhe kudo që punon, duhet ta nxitim që çdo ditë ta mësojë dhe ta perfeksionojë sa më mirë zanatin dhe të zbatojë me ndërgjegje diturinë dhe eksperiencën e fituar. Për këtë kërkohet që secili të

kuptojë drejt vijën e Partisë në atë zanat dhe ta dojë me pasion atë, të kontrollojë veten dhe të tjerët. Po punuam kështu, atëherë rezultatet do t'i kemi të mëdha, pse asgjë s'ka ç'na pengon. Kështu ne edhe malet «do t'i rrëzojmë» dhe ato që «kemi rrëzuar» gjer tani, do të na duken asgjë.

Deri tashti në rrethin tuaj sapo kemi filluar kërkimet gjeologjike, po kushedi ç'pasuri të mëdha mund të fshihen në këto male.

Kongresi i 6-të i Partisë vendosi që në pesëvjeçarin e pestë industria jonë e rëndë të marrë një zhvillim shumë më të madh nga sa është realizuar gjer tani. Siç e dini, rëndësi të madhe për ekonominë e shëndoshë të një vendi kanë dy gjëra: buka dhe çeliku. Këtyre të dyve u jemi qepur tani si gërthelat dhe kemi arritur suksese. Për bukën jemi në rrugën e sigurimit të saj¹, kështu që çdo vit që kalon, po e sigurojmë gjithnjë e më mirë. Në të ardhmen e afërt edhe çelik do të prodhojmë, për arsye se kemi gjetur në vend burime të mëdha të mineralit të hekurit, në sasi plotësisht të mjaftueshme e për një kohë të gjatë. Ne kemi kohë që po e nxjerrim nga toka jonë këtë mineral të vlefshëm, por gjer tani e kemi eksportuar të papërpunuar dhe jemi detyruar të importojmë hekur të përpunuar dhe çeliqe nga jashtë. Këtë pesëvjeçar ne do të ndërtojmë industrinë tonë metalurgjike, ku do të prodhojmë çelik dhe asortimente të ndryshme hekurash të

1. Buka u siguroa për herë të parë në vend më 1976. (Shih: Enver Hoxha, Raport në Kongresin e 7-të të PPSH, f. 5.)

përpunuar, pa të cilat s'bëjmë dot. Deri tani i kemi sjellë nga jashtë makineritë dhe çelikun. Edhe për veglat e ndërrimit, që sot i prodhojmë në vend, çelikun e sjellim nga jashtë etj. Prandaj, Partia mori masa që për të siguruar gjithë sasinë e çelikut që do të na duhet në të ardhmen në sasi përherë e më të mëdha, në fund të këtij pesëvjeçari dhe në fillim të pesëvjeçarit tjetër, ne të kemi çelikun tonë¹. Pastaj, akoma më tutje, në pesëvjeçarët e mëvonshëm, prodhimi i tij do të dy dhe trefishohet, jo vetëm për plotësimin e nevojave tona, për të prodhuar në vend vegla ndërrimi e makineri, por për t'u shitur edhe të tjerëve. Kjo është një çështje me shumë rëndësi për ekonominë tonë.

Degë tjetër kryesore e industrisë sonë është ajo e naftës, për të cilën vazhdojmë të bëjmë kërkime. Për këtë qëllim kemi përgatitur djem dhe vajza naftëtare të zonjat dhe të mësuara. Specialistët e Hrushovit na sabotuan me të madhe në këtë degë shumë të rëndësishme të ekonomisë. Ata kanë pas gjetur naftë në vendin tonë, po na kanë gënjyer e na e kanë mbajtur fshehur. Atje ku kishin marrë të dhëna, me të cilat vërtetohej se te ne kishte naftë, na thoshin që s'ka. Mirëpo, kur i dëbuam, Partia u ngarkoi detyrën specialistëve tanë të rinj që t'i rishikonin edhe një herë studimet e specialistëve sovjetikë. Kështu ne gjetëm dhe vazhdojmë akoma të zbulojmë naftë. Fushat e naftës në vendin tonë po shtohen dita-ditës. Kjo ka një rëndësi të jashtëzakonshme, pse pa naftë nuk ecin dot as indus-

1. Çeliku i parë i markës shqiptare u derdh më 15 tetor 1976, në Kombinatin Metalurgjik të Elbasanit.

tria, as transporti, as bujqësia dhe asnjë degë tjetër e ekonomisë sonë. Pastaj, me naftë dhe me gaz, në të ardhmen ne mund të prodhojmë artikuj dhe mallra nga më të ndryshmet. Rafineria e madhe që jemi duke ndërtuar në Ballsh do të nxjerrë një seri të madhe vajrash e benzinërash të përpunuara për lloje të ndryshëm motorësh që gjer tani i sillnim nga jashtë.

Shikoni pra ç'bën dituria, motra dhe vëllezër, shikoni ç'bën shkolla, ç'bëjnë kërkimet, shikoni ç'bën vija e drejtë e Partisë dhe forca e popullit, djersa e ballit e njerëzve tanë! Të tëra këto bashkohen dhe bëjnë një forcë të madhe që sjell çdo vit e më shumë begatinë e Shqipërisë.

Tërë kjo industri e madhe që kemi ndërtuar vihet në lëvizje nga energjia elektrike. Me zhvillimin e mëtejshëm të industrisë në të ardhmen, do të duhet akoma më shumë energji elektrike në Shqipëri. Po, edhe në këtë fushë, si ishim përpara dhe si jemi tani! Sot ne jemi nga vendet e para ku çdo shtëpi, edhe ajo më e largëta e vendit tonë, ndriçon nga elektriku. Këtë e realizoi te ne Partia e Punës e Shqipërisë dhe puna e palodhur e popullit trim shqiptar, i udhëhequr prej saj. Gjer tani janë ndërtuar shumë hidrocentrale, megjithatë ditët e fundit u inauguruan punimet në Fierzë ku, gjatë këtij pesëvjeçari, do të ndërtohet një tjetër gjigant energjetik. Kur t'u vemi punimeve nga mesi, do të mendojmë për një ose dy hidrocentrale të tjera të mëdha, pse lumi i Drinit është një burim i madh energjie elektrike për vendin tonë. Do të vijë dita kur i gjithë Drini do të bëhet si një gjerdan i bukur me flori, mbushur plot me hidrocentrale, si i

Skavicös, Fierzës, Komanit, Vaut të Dejës, Bushatit etj. Por, nuk do të jenë këta të vetmet hidrocentrale të vendit tonë. Vjosën, Shkumbinin, lumenjtë e tjerë dhe kudo ku ka burime ujërash në vendin tonë, Partia do t'i shfrytëzojë në interesin e popullit, për zhvillimin e industrisë e të bujqësisë, që, siç na mëson Partia, të ecim drejt me të dyja këmbët, e të mos çalojmë as nga njëra, as nga tjetra.

Ne kemi parasysh që industria jonë të punojë mirë për të ndihmuar bujqësinë, se kjo është baza. Po s'paktëm një bujqësi të përparuar, punëtori s'ka ç'të hajë. Prandaj duhet të bëjmë përpjekje për ta vënë bujqësinë kudo, sa më shpejt, në rrugë. Dihet se fabrikat që kemi ndërtuar duan lëndë të parë, pambuk, fruta, perime, ullinj, mish, peshk etj., etj. Populli ka nevojë të hajë, të vishet e të mbathet. Prandaj duhen bërë të gjitha, gjë që kërkon të zhvillohen njëkohësisht të tëra degët e ekonomisë, në mënyrë të harmonizuar. Këtë e ka bërë dhe më mirë akoma do ta bëjë Partia në të ardhmen, për të plotësuar nevojat e popullit. Gjer më sot sukseset janë të dukshme në të gjitha drejtimet. Këto janë një bazë e fuqishme për të ecur akoma më mirë përpara.

S'ka vend në botë si Shqipëria, nga shumë pikëpamje: nga pikëpamja e demokracisë, nga pikëpamja e revolucionarizimit të ndërgjegjes së masave të popullit, nga pikëpamja e ndershmërisë. Shqipëria është vendi i vetëm pa taksa në botë. Vetëm te ne populli nuk paguan taksa, vetëm në Shqipëri do të vihen së shpejti pensione edhe për fshatarët. Prandaj, ju nëna e baballarë, do të shpëtoni nga hallet. Ja, erdhi ko-

rriku dhe do të hyjë në fuqi ligji mbi pensionet¹. Fshatarët kooperativistë do të gëzojnë këtë të drejtë njëlloj si gjithë punonjësit e tjerë, kur gruaja të mbushë 55 vjeç dhe burri 65. Pastaj, kur t'i bëjë këmba dhe dora, pavarësisht se do të marrë pensionin, po të vazhdojë të punojë akoma (dhe për punë në fshat kemi shumë nevojë), ai do të përfitojë, pa ia prekur pensionin, edhe ditën e punës.

Të gjitha këto të mira për popullin i pruri patllakja, pushka, prandaj atë kurrë të mos e lëshojmë nga duart, sepse armiqtë vringëllojnë armët. Pavarësisht se nganjëherë na buzëqeshin, ata përgatiten dhe mendojnë të hidhen kundër revolucionit dhe socializmit, në rast se do të na gjejnë të dobët dhe në gjumë. Në qoftë se tani na presin duke qeshur, kjo vjen se s'kanë ç'të na bëjnë, ndryshe e dinin ata, prandaj këtë të mos e harrojmë asnjëherë.

Shqipëria socialiste, e udhëhequr nga Partia, është bërë dhe po bëhet çdo ditë e çdo vit që kalon, një vend i fuqishëm dhe i begatshëm, që gëzon respektin e gjithë popujve, të cilët e aprovojnë plotësisht dhe e admirojnë politikën tonë të guximshme dhe të drejtë. Popujt arabë, ata të Amerikës Latine dhe të kontinenteve të tjera, bile edhe shumë nga diplomatët e tyre, na ngrenë kapelën në shqiptarëve, që kemi gjetur shpatën dhe u biem pa u frikësuar, demaskojmë pa mëshirë edhe politikën imperialiste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, edhe atë socialimperialiste të

1. Anëtarët e kooperativave bujqësore përfituan pension duke filluar nga 1 korriku i vitit 1972.

Bashkimit Sovjetik, si dhe të të gjitha vendeve të tjera kapitaliste e revizioniste. Nuk ka vend në botë që ta bëjë një gjë të tillë si ne. Të huajt çuditen e thonë se ku e gjejmë ne gjithë këtë forcë. Po njerëzit tanë u përgjigjen se forca jonë qëndron në popull, prandaj Partia kurdoherë na këshillon të mos ndahemi kurrë nga populli, ndryshe na merr lumi. Kush qëndron me popullin, në unitet të çeliktë me të, ai shkon kurdoherë përpara. Prandaj ne kemi qenë gjithnjë me popullin dhe kemi luftuar e punuar për popullin, tjetër rrugë më të drejtë nuk ka.

Te ne çdo njeri, i madh ose i vogël qoftë, duhet të shohë interesin e popullit, në radhë të parë, kurse interesin personal ta vërë në radhë të dytë. Partia nuk e mohon as e lë pas dore interesin personal të punonjësve, por këshillon që ky të mos vihet kurrë mbi interesin e përgjithshëm, sepse kjo të çon në shumë rrugë të këqija. Kush shikon më parë xhepin e vet, kush harron gjitonin, shokun, miqtë, popullin, gjakun e derdhur lumë për të mirën e të gjithëve, ai nuk është njeri i mirë. Partia na mëson që të mos e harrojmë kurrë interesin e popullit, pse gjaku i derdhur për këtë Shqipëri, për këtë popull trim të mrekullueshëm dhe për këtë truall ku ai jeton, është i shenjtë, përmbi të nuk mund të vihet asgjë.

Është e vërtetë se rrogat kanë dhe do të kenë akoma edhe për një kohë njëfarë ndryshimi. Kjo varet nga puna që bën secili, sa i jep ai shoqërisë; ato kurrë nuk mund të barazohen në socializëm. Ndryshimi në të ardhurat e një punëtori të thjeshtë të pakualifikuar me ato të një specialisti do të ekzistojë edhe në të

ardhmen në socializëm. Por të mos harrojmë se në vendet e tjera, në krahasim me rrogat që jepen te ne, ky ndryshim është 8 herë, 9 bile edhe deri 10 e më shumë herë më i madh se ai i një punëtori, pa llogaritur këtu grabitjet e vjedhjet që bëjnë kuadrot me përgjegjësi; kurse te ne, rroga më e madhe në krahasim me atë më të voglën është deri në 2,5 herë më e lartë. Në luftojmë që ky ndryshim të zbutet akoma duke marrë masa që vlcra e rrogave të ulëta të ngrihet. Kjo do të vijë kur të prodhojmë më shumë, më mirë dhe më lirë, në mënyrë që, me rrogën e tij punëtori i thjeshtë të ketë mundësi të blejë më shumë mallra. Megjithatë, përsëri do të merren masa që edhe rrogat e larta të ulen më tej, që kuadrove të mos u ngrihet hunda. Përkundrazi, Partia i mëson ata të jenë të thjeshtë dhe të lidhur me popullin, se në thjeshtësi nuk zënë kurrë vend sëmundjet e këqija. Këto lindin vetëm tek ata që kanë në gjak fodullëkun, interesat personalë, gënjeshttrat, dallaveret. Prandaj, po t'i lejojmë këto sëmundje, atëherë çështja e popullit mbaroi. Por Partia jonë është e atillë që nuk i lë ato të zënë vend, prandaj i dëgjoni edhe i zbatoni si duhet mësimet e saj. Partia porositi që komunistët të jenë njerëz të pastër, në pasqyrën e popullit. Kush shikon ndonjë komunist që vepron në kundërshtim me mësimet e Partisë dhe me interesat e popullit, ta kritikojë, ndryshe ai dëmton veten, dëmton Partinë, dëmton Shqipërinë, sepse Partia dhe Shqipëria përbëhen nga njerëzit.

Mbrojtja e Partisë nga sëmundjet është si puna e mollës. Në qoftë se në një kokërr molle lihet krimbi

të zhvillohet brenda, atëherë molla mbaroi; i rroftë faqja që përkohësisht e ka të kuqe, kurse brenda është katandisur si krunde. E tillë është partia e Titos dhe ajo e Hrushovit. Ne nuk lejojmë që ta kemi të tillë Partinë tonë, ne duam ta kemi atë kurdoherë të kuqe, brenda dhe jashtë, dhe që ta kemi të fortë, të shëndoshë ajo duhet të mbetet kurdoherë në kontroll të popullit, të punojë për të zbatuar dëshirat e popullit, anëtarët e saj të jenë në ballë të masave të popullit, për realizimin e detyrave dhe në sakrifica, pse kështu populli do t'i dojë, do të ketë besim në ta dhe do t'i ndjekë edhe në kohët më të vështira.

Ju lodha, vëllezër dhe motra, prandaj po e përfundoj fjalën time. Kongresi ynë i 6-të i Partisë na vuri detyra të mëdha për realizimin e të cilave na duhet të bëjmë përpjekje të shumta. Popull e Parti, si kurdoherë gjer më sot, të vazhdojnë të jenë të lidhur ngushtë edhe më fort me njëri-tjetrin, si mishi me kockën.

Detyrat që kemi përpara për të kryer janë të rënda, të mëdha, dhe për këtë të gjithë jemi të qartë se nuk kryhen pa u lodhur, pa punë, pa organizim. Prandaj, metodat dhe format e punës, mendimet dhe gjithë diturinë që kemi fituar, t'i vëmë në zbatim me përpikëri gjatë këtyre pesë vjetëve, t'i dyfishojmë. Të forcojmë disiplinën në punë, të shtojmë përpjekjet për të mësuar, të plotësojmë e të tejkalojmë ditët e punës dhe çdo detyrë tjetër, për të mirën e popullit dhe të atdheut. Të ardhmen ne e shohim me optimizëm të madh, prandaj jam i bindur se të gjithë i kuptojnë drejt këto detyra jetike dhe do të mobilizohen me forca të shumëfishuara për t'i kryer. Vetëm kështu do t'i

realizojmë dhe do t'i tejkalojmë objektivat e pesëvjeçarit të pestë.

Pastaj, ne duhet të mendojmë edhe për kohë të këqija, se rreziku nuk është larguar. Këtë kurrë të mos e harrojmë. Armiqtë tanë, imperialistë e revizionistë, të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, bëjnë një mijë e një dallavere për të na goditur, pse ne jemi pasqyra e së ardhmes, frymëzuesit e përkrahësit e revolucionit dhe të partive të vërteta marksiste-leniniste. Kjo na vë detyrën që atdheun tonë ta forcojmë dita-ditës më shumë ekonomikisht, ushtarakisht, ideologjikisht e politikisht dhe, që ta bëjmë këtë, duhet të punojmë e të luftojmë pa u lodhur për të realizuar vijën e Partisë.

Të gjitha këto që thashë përbëjnë një program të madh pune. Prandaj, le të jenë ato një frymëzim i fuqishëm për gjithë popullin shqiptar dhe veçanërisht për të dashurit shokë, vëllezër e motra të Skraparit, të cilëve, në emër të të gjithë Partisë, në emër të të gjithë popullit, në emër të Qeverisë dhe në emrin tim, unë ju uroj suksese të reja e më të mëdha në të ardhmen.

Të rrojë Partia!

Të rrojë populli heroik i Skraparit!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit, që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

DORËZIMI I DOKUMENTEVE NË MUZE I SHËRBEN EDUKIMIT PATRIOTIK TË POPULLIT

*Nga biseda e zhvilluar gjatë vizitës
në Muzeun e Çorovodës*

29 nëntor 1971

Kam mendimin se ky muze duhet të plotësohet akoma më mirë se gjer më sot, pse lufta e popullit të Skraparit është shumë më e madhe dhe më e gjerë, kurse këtu shoh vetëm disa dokumente fare të pakta që janë ekspozuar. Prandaj, është e domosdoshme të pasqyrohen në këtë muze të gjitha dokumentet që ekzistojnë, vetëm se ato duhen mbledhur dhe sistemuar.

Partia, si kudo, edhe në Skrapar, duhet të punojë që shokët tanë komunistë e patriotë të mos i mbajnë nëpër shtëpitë e tyre këto dokumente të vlefshme. Kuptohet se dokumentet, si edhe kujtimet personale të luftës, shokët i ruajnë edhe vetë me kujdes, por do të jetë më mirë që këto të ruhen në muze sesa në shtëpi. Natyrisht, kjo është një e drejtë e secilit që i disponon dhe i ka ato, por, duke ia dorëzuar ato muzeut, i sillt

një shërbim i madh edukimit patriotik revolucionar të popullit, se këtu vijnë fëmijë, të rinj dhe të reja, punëtorë e kooperativistë, që shikojnë se si kanë luftuar prindërit e gjyshërit e tyre e të tjera. Kurse, duke i mbajtur të mbyllura në shtëpi nuk ka kush i sheh, përveçse një numër shumë i kufizuar i pjesëtarëve të familjes. Kushdo nga shokët që ka të tilla materiale në shtëpi, të jetë i bindur se, kur të mbylli sytë, bashkëshortët apo fëmijët e tij prapë në muze do t'i sjellin. Prandaj, është më mirë t'i sjellin sa më parë, që ato t'i shërbejnë sa më shpejt edukimit të punonjësve tanë.

Ju përgëzoj për gjithçka keni bërë gjer tani, por detyra juaj s'ka mbaruar akoma. Ju duhet të punoni edhe më tepër që ta pasuroni muzeun me më shumë materiale jo vetëm nga të luftës, por edhe të tjera.

CICERONI I MUZEUT: Po, shoku Enver, ka shumë materiale dhe s'kemi vend ku t'i ekspozojmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti që punon këtu je edhe vetë mësues, prandaj punës në muze t'i japësh më shumë rëndësi; jo vetëm duke vajtur për eksperiencë e për të qëmtuar materiale në muzetë e tjera, por edhe për t'u interesuar në mënyrë të veçantë, duke shkuar në njerëz të ndryshëm që kanë dokumente këtu në Skrapar apo edhe gjatë për të biseduar me ta, për t'ua kërkuar ato, duke u shpjeguar atyre vlerën e madhe edukative të atyre dokumenteve të këtij institucioni me rëndësi. Kështu, muzeu do të bëhet një institucion i vërtetë që do të frekuentohet edhe më me ëndje e do të shërbejë për edukimin patriotik dhe ko-

munist të masave tona punonjëse dhe sidomos të rinisë, prandaj të mos lihet në gjendjen që është sot¹.

Ju faleminderit shumë për shpjegimet dhe ju uroj suksese të mëtejshme në punë!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura gjatë
vizitës në muze, që gjenden
në AQP*

1. Për zgjerimin dhe pasurimin e muzeut, shoku Enver Hoxha shkruan edhe në shënimin që la në librin e përshtypjeve, mbas kësaj vizite, ku, midis të tjerash, lexojmë:

«...perspektivat për pasurimin e tij janë të mëdha, për arsye se populli heroik i Skraparit ka luftuar shumë si në të kaluarën e largët, ashtu edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, prandaj është detyrë që në këtë muze të pasqyrohet me tërë madhësinë dhe gjerësinë e saj e gjithë historia dhe jeta materiale kulturore e tij».

Në zbatim të porositë që la shoku Enver Hoxha gjatë kësaj vizite në Çorovodë u ngrit Muzeu Historik i rrethit të Skraparit, që u përrua më 5 shtator 1977.

NXËNËSIT JANË SI FIDANË, SI T'I DREJTOSH ASHTU RRITEN

*Fjala para nxënësve e mësuesve të shkollës së mesme
«Ramiz Aranitasi» të Çorovodës*

29 nëntor 1971

Të dashur fëmijë e shkollarë, të dashur mësues dhe mësuese,

Në ditën e festës sonë të madhe të Çlirimit të Atdheut, ne, që patëm rastin të vijmë këtu në qendër të rrethit të Skraparit, në Çorovodë, jemi veçanërisht të gëzuar sot që marrim pjesë në inaugurimin e kësaj shkolle të mesme kaq të bukur, ku ju do të mësoni dhe do të punoni. Në këtë institucion mësimor ju do të edukoheni me frymën e Partisë, me frymën e patriotizmit të lartë e të kulluar, me dashurinë e pafund për popullin, për atdheun, për socializmin, për çdo gjë të pastër e të ndershme, për çdo gjë të nevojshme për jetën dhe të domosdoshme për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së fituar me gjak e me sakrifica nga populli shqiptar, për çdo gjë që na ndihmon për t'i bërë malet dhe fushat e atdheut sa më të bukura e pjellore.

Gëzimi ynë sot, në ditën e inaugurimit të kësaj shkolle, që mban emrin e Ramiz Aranitasit, është i madh.

Juve ju kanë folur dhe përsëri do t'ju flasin për Ramiz Aranitasin, të cilin e kam njohur dhe e kam pasur shok edhe unë. Kur Ramizi u nis me detyrë për në Skrapar, ishte djalë i ri, i fortë dhe me një vullnet të hekurt. Ai i donte shumë popullin dhe Partinë dhe i zbatonte me përpikëri e deri në fund direktivat e saj. Para se të nisej për këtu i thashë Ramiz Aranitasit se në Skrapar do të vinin atëherë disa elementë të rrezikshëm për Partinë, disa trockistë, që e kishin luftuar komunizmin në vendin tonë, si përpara formimit të Partisë, ashtu edhe gjatë punës përgatitore që po bëhej për formimin e saj. Edhe më vonë, kur u formua Partia, ata tradhtarë vazhduan në mënyrë konsekuente ta luftojnë atë. Këta elementë, i thashë, janë Anastas Lula me shokë. «Shoku Enver, — m'u drejtua menjëherë Ramizi, — Partia dhe Komiteti Qendror të mos shqetësohen fare për këtë çështje, sepse ne do të vigjilojmë ditë e natë dhe armiqtë e Partisë si Anastas Lulën dhe cilindo tjetër këtej nuk do t'i lëmë të kalojnë». Dhe, në fakt, ashtu ndodhi, ata nuk kaluan dot, ata u likuiduan. Ramizi punoi dhe luftoi këtu. Ai vazhdoi luftën e tij heroike në rrugën e Partisë derisa u vra, po ai u bë i pavdekshëm. Partia dhe populli nuk do ta harrojnë kurrë atë. Ja sepse sot shkolla juaj mban emrin e Ramiz Aranitasit, për ta pasur kurdoherë gjallë kujtimin e tij.

Siç ju tha shoku drejtor, siç ju tha edhe shoqja juaj që foli para meje, vini të gjitha forcat për të mësuar, për ta mbajtur kurdoherë lart emrin e shkollës

suaj! Partia ju ka krijuar të gjitha mundësitë dhe të tjera më të mëdha do t'ju krijojë në të ardhmen, që mësimi që merrni në shkollë të bëhet edhe më i thellë, më i kuptueshëm e më i asimilueshëm për ju. Kështu, kur ju të dilni këtej, të bëheni me të vërtetë njerëz të mësuar, djem dhe vajza me mendje të ndritur e me vullnet të hekurt, ashtu siç dëshiron Partia të jeni, pse në të ardhmen do të kemi për të kryer punë të tjera akoma më të mëdha se këto që janë duke u kryer sot.

Atdheu ynë që edhe tani po lulëzon, do të bëhet më vonë akoma më i bukur, më i lulëzuar, më i fuqishëm. Lulëzimi nuk ka fund dhe këtë lulëzim do ta krijojmë ne me duart tona, me mendjen tonë, atë do ta krijoni në të ardhmen ju që jeni shpresa e atdheut dhe e popullit. Prandaj Partia po vë të gjitha forcat që ju të rriteni të lumtur, të gëzuar, të mësuar, që për ju të mos ketë ditë të këqija. Pikërisht për t'ia arritur kësaj dite Partia ju mëson, por edhe ju këshillohet të jeni kurdoherë të guximshëm dhe trima si prindërit, si gjyshërit dhe stërgjyshërit tuaj. Prandaj, ashtu sikurse bëni përpjekje për të mësuar, as pushkën mos e harroni. Detyrat që kanë të bëjnë me përgatitjen tuaj fizike dhe më vonë edhe ushtarake, të mos i harroni, por të vazhdoni në këtë rrugë me këmbëngulje dhe pa u përkulur.

Për mua dhe shokët e mi, luftëtarë të vjetër të Skraparit që ndodhen sot këtu dhe që kanë luftuar jo vetëm në këto male e gërxhe që ju i shihni ditë dhe natë, por në të gjitha malet, kodrat, fushat dhe grykat e Shqipërisë, kudo ku e ka dashur nevoja dhe ku u ka bërë thirrje Partia dhe Shtabi i Përgjithshëm, sot është

një nga ditët më të gëzuara. Në festat e mëdha të 28 dhe 29 Nëntorit gëzon i madh dhe i vogël në tërë Shqipërinë. I njëjti gëzim i madh ndihet nga kushdo edhe këtu në Skrapar.

Përpara këtij takimi ne vizituam varrezat e dëshmorëve, për të nderuar kujtimin e atyre që ranë për lirinë dhe pavarësinë e atdheut, për jetën e lumtur të popullit. Ata nuk janë më fizikisht; megjithatë ata janë kurdoherë në mes nesh, ata s'vdesin kurrë, pse tërë jetën populli do t'i kujtojë. Çdo vit njerëzit tanë do të bëjnë atje me radhë rojë nderi. Atje pamë të bëjnë rojë nderi edhe pionierët, të cilët Partia dëshiron t'i shikojë kurdoherë të gëzuar, dhe ata të gëzuar janë. Dëshmorët që ranë për këto ditë të bardha, të frymëzuar nga mësimet e Partisë, luftuan pikërisht për këtë që populli të punojë e të jetojë i lirë dhe i lumtur, që kudo në Shqipëri të hapeshin shkolla si kjo që po inaugurojmë, që të ngriheshin muze e shtëpi kulture, që fushat e vendit tonë të bëheshin, siç janë bërë, të bukura e pjellore, që të ngriheshin fabrika e uzina etj., për ta bërë më të bukur jetën e njerëzve tanë. Prandaj, të gjithë, le të brohorasim për Partinë tonë të lavdishme, në sajë të së cilës u arritën gjithë këto suksese. Po të mos ishte Partia asgjë nuk do të bëhej në vendin tonë, ashtu siç nuk ishte bërë gjer në kohën kur u çlirua atdheu; populli, ashtu si edhe përpara, do të rronte në mjerimin më të madh, do të vuante në skamje e padituri. Për të gjitha këto, gjëja më e shtrenjtë që ka populli në botë, më e vyerë, për të cilën të tërë jemi gati në çdo kohë të japim

edhe jetën, është Partia. Partia është zemra dhe truri, është çdo gjë e shtrenjtë për popullin. Prandaj ai e do dhe është i lidhur aq ngushtë me Partinë dhe kjo është lidhur aq ngushtë me popullin.

Partia përbëhet nga ne, anëtarët që mbushim radhët e saj sot, kurse nesër, anëtarë të Partisë do të jeni ju. Sot ju jeni fatosa dhe pionierë; nesër do të jeni anëtarë të organizatës së rinisë, kurse pasnesër, më të mirët në mësim, më punëtorët, më luftarakët e më të guximshmit nga ju, do të bëhen anëtarë të Partisë.

Partia këshillon që t'i vihet kujdesi më i madh edukimit të pionierëve dhe gjithë rinisë së vendit tonë. Prandaj, të dashur mësues dhe mësuese, kurrë të mos ju zërë gjumi, po t'i mësoni, t'i edukoni, t'i këshilloni dhe të jeni të durueshëm me të rinjtë e të rejat, me nxënësit e nxënëset, se ata janë si fidanët e njomë, që si t'i drejtosh, ashtu rriten: po i drejtove mirë, ata do të zhvillohen si ato pemët e fuqishme që nuk duan t'ia dinë as nga furtunat më të egra që mund të shpërthejnë në botë.

Për formimin e njeriut të ri roli i mësuesit, na mëson Partia, është nga më të mëdhenjtë. Prandaj, ju nxënës, ta doni dhe ta respektoni mësuesin, sepse atë jua ka caktuar Partia për t'ju brumosur ju, nxënës dhe nxënëse, që nesër të bëheni qytetarë aktivë të republikës dhe anëtarë të denjë të Partisë. Sa më të mësuar e të fortë të bëheni ju, sa më luftarakë, të guximshëm dhe trima të jeni, aq më e fortë do të jetë vetë Partia. Dhe, po të jetë Partia e fortë, atëherë Shqipëria nuk do të vdesë kurrë!

Rroftë Partia!

Rroftë rinia!

Rrofshin pionierët!

Rrofshin mësuesit dhe mësueset!

Pastaj shoku Enver Hoxha vizitoi mjedise të ndryshme të shkollës. Duke u ndalur, së pari, te laboratorit kimisë, ai tha:

Shumë mirë qenka pajisur. Më kujtohet se kur isha student, në Universitetin e Montpeliesë, nuk kishim kaq mjete sa ka ky laborator. Megjithatë, vazhdoni të punoni që të pasurohet akoma. *(Duke iu drejtuar një mësuesi.)* Çfarë shkolle ke mbaruar?

MËSUESI: Kam kryer Fakultetin e Shkencave të Natyrës, degën biologji-kimi në Universitetin e Tiranës.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë! Tani je njeri i mësuar. Si veproni me nxënësit gjatë eksperimenteve? Sigurisht, në fillim, i bën ti ato, nxënësit shikojnë, pastaj punojnë, mbushin epruvetat etj. Shumë mirë!

Si duken nxënësit, kanë zell për mësim, punojnë?

MËSUESI: Në përgjithësi punojnë.

SHOKU ENVER HOXHA: Keni gjetur forma të reja në mënyrë që mësimi të përvetësohet sa më mirë nga nxënësit? Kam parasysh format më të përsosura se ato që përdorshin atëherë në shkollën që kemi bërë ne në kohën tonë. Keni gjetur metoda të reja për një mësim sa më të zhdërvjellët? Mësimi i kimisë është plot formula të ndërlikuara, prandaj ju duhet të men-

doni për të gjetur mënyrën që nxënësit të orientohen sa më mirë dhe sa më drejt për të përvetësuar njohuritë shkencore. Në atë kohë ne nuk kishim gjëkund nga këto gjëra, kurse tani, shiko ç'keni ju këtu!

Të përgëztoj shoku mësues! Nga je?

MËSUESI: Nga Skrapari.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë që qenke nga Skrapari.

Duke kaluar pastaj në laboratorin e fizikës, shoku Enver Hoxha iu drejtua një mësuesi:

Nga je ti, shoku mësues?

MËSUESI: Jam nga Dardha e Korçës.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti, vërtet je nga Dardha, por besoj nuk pret me «sëpatën e dardharit» apo jo, se të ka mësuar Partia ndryshe.

Laboratori qenka shumë i mirë. Shiko, moj Nexhmije ç'ka këtu! E di që me këto pajisje edhe neve sikur na vjen mirë të vazhdojmë shkollën pa shkëputje nga puna, ta bëjmë edhe një herë, se në kohën tonë nuk kishim të tillë laboratorë.

Si mësojnë nxënësit, interesohen për mësimin e fizikës?

MËSUESI: Mirë mësojnë.

SHOKU ENVER HOXHA: Plot aparate keni. Këtu afër, ju keni edhe ndërmarrje e ofiçina që mund t'ju ndihmojnë për të tilla pajisje. Besoj që një pjesë të aparateve ato i prodhojnë për shkollën tuaj.

MËSUESI: Po, na kanë ndihmuar. Shumica e këtyre pajisjeve janë prodhuar në vend, vetëm aparatet matës kanë ardhur nga jashtë.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë.

Ke vajtur ndonjëherë nga Dardha? Të vesh!

Në vazhdim të vizitës, shoku Enver hyri në kabinetin e historisë e të gjeografisë, ku takohet me mësuosen e lëndës.

SHOKU ENVER HOXHA: Si jeni? Gëzohem që jemi kolegë, por ty të ka mësuar Partia. Besoj se jep historinë e Partisë, apo jo?

MËSUESJA: Po.

SHOKU ENVER HOXHA: A është e mjaftueshme koha që keni në dispozicion për përgatitje? Sa orë mësim jep në javë?

MËSUESJA: Për normën e plotë koha është e mjaftueshme.

DREJTORI I SHKOLLËS: Kjo tjetra është sekretarja e rinisë së shkollës. E kemi mësuese po në këtë shkollë.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë! Si jeni? Si duken të rinjtë e të rejat? Keni probleme me ta? I lini të rinjtë e të rejat të «ngatërrohen» në diskutime, të diskutojnë në mënyrë të tillë revolucionare, duke thënë jo pse ai ka këtë mendim, jo pse ai tjetri tha ashtu e të tjera? Çështja është që të krijohet një formë luftarake e diskutimit të problemeve, jo formë e fjetur. Një formë të tillë ne nuk e duam, pse vetëm në diskutimet luftarake dalin mendimet dhe idetë më të drejta. Bile, edhe ata që nuk guxojnë të ngrihen në këmbë duhet ta thonë mendimin e tyre, kurse ata që kanë mendime të gabuara, kur të fillojnë «mitralozat», dua të them diskutimet e shokëve dhe kur këto të jenë të zjarrta e revolucionare, atëherë të gabuarit do të korrigjohen, qoftë edhe në heshtje, duke u futur «nën

bango». Por, në qoftë se do të pushojmë «mitralozat» para kohe, elementi me pikëpamje e qëndrime të gabuara do të dalë mbi ujë. Prandaj, kështu t'i bëni diskutimet, luftarake.

Pasi shoku Enver njihet me mësues të lëndëve të tjera, tha:

Shumë mirë, të tërë universitarë, të gjithë djem dhe vajza xhevahirë, të gjithë kuadro me arsim të lartë.

Pasi vizitoi bibliotekën, shoku Enver Hoxha tha:

Kjo është biblioteka e shkollës. Shumë e mirë, vetëm se duhet të pajiset me më shumë libra.

Të dalim tani me gjithë mësuesit në fotografi. Sulloja [Gradeci] nga Skrapari do të na dhurojë nga një fotografi të gjithëve.

Ju faleminderit shumë dhe ju përgëzoj të gjithëve, suksese në detyrën tuaj të lartë!

Mirupafshim!¹

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

1. Vizita në këtë shkollë i la përshtypje shumë të mira shokut Enver Hoxha. Duke folur në Pogradec më 16 gusht 1975 ai ka thënë:

«Unë kam vizituar shkolla në Skrapar, por kam vizituar shkolla edhe në Pragë. Mund të them me gjithë mend, se nuk kishte asnjë ndryshim shkolla e mesme e përgjithshme «Ramiz Aranitasi», që është ndërtuar në Çorovodë, me shkollat e kësaj kategorie që kam parë unë në Çekosllovakia. Shkolla e mesme e Çorovodës ishte shumë e bukur, me dy-tri kate, e pajisur me laboratorë të pasur e me të gjitha të mirat, por nuk prishej ndonjë punë sikur të ishte pak më e thjeshtë». (Shih: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1974-1975», f. 242.)

UJITJA ËSHTE NJË PROBLEM QË DUHET PARË ME KUJDES

*Nga biseda me një punonjës të Institutit
të Projektimit*

29 nëntor 1971

SHOKU ENVER HOXHA: Si jeni me shëndet shoku inxhinier?

SHOKU ILJAZ CERGA: Faleminderit, mirë, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Në ç'vit keni mbaruar studimet për inxhinieri?

SHOKU ILJAZ CERGA: Më 1953.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë je i vjetër në këtë profesion.

SHOKU ILJAZ CERGA: Pothuaj që kur kam mbaruar studimet.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë!

Pastaj inxhinieri hap mbi tavolinë hartën e sistemit të ujitjes për rrethin e Skraparit.

SHOKU ENVER HOXHA: Përveç hartës së rrethit të Skraparit, për cilin rreth tjetër keni përgatitur të tilla?

SHOKU ILJAZ CERGA: Kemi përgatitur pothuaj për të gjitha rrethet e Shqipërisë së Jugut, si dhe për Matin, Dibërën e Lezhën. Për rrethet e tjera këto harta do t'i përfundojmë gjatë vitit të ardhshëm.

SHOKU ENVER HOXHA: Ka rëndësi të madhe të kesh të tilla harta, pavarësisht se do të duhet kohë derisa të ndërtohen veprat përkatëse. Sipas studimeve tuaja, një pjesë e tyre është bërë, të tjerat do të përfundojnë vitin e ardhshëm.

Unë ju thirra të shikojmë së bashku problemin e ujitjes së tokave të rrethit të Skraparit, sepse shokët e Partisë dhe të pushtetit në rreth kanë paraqitur një plan për këtë pesëvjeçar. Por ky plan, siç bisedova me shokë të Komisionit të Planit të Shtetit, për mungesë të fondit, nuk do të realizohet dot. Megjithatë, unë u thashë atyre që të shikojnë nëse mund të shtojmë ndonjë gjë të re për Skraparin dhe ata më premtuan se do ta shikojnë këtë çështje.

Duke marrë parasysh se rrethi i Skraparit, në krahasim me nevojat që ka vetë dhe me përparimet që janë arritur në rrethet e tjera, është prapa me ujitjen, mbasi toka nën ujë këtu është akoma e paktë, ky problem duhet parë me kujdes. Përprojekjet që bëjnë kooperativat e këtij rrethi për zhvillimin e bujqësisë janë të mëdha dhe jo pa rezultate. Ato kanë mundur tani ta sigurojnë vetë bukën dhe ky përbën një sukses të madh për një rreth si Skrapari. Rendimentet e drithërave që u arritën këtë vit si rreth janë një hap i madh përpara. Por që të sigurohen këto rendimente në mënyrë të qëndrueshme, është e domosdoshme të merret akoma ndonjë masë plus, mbi ato që parashikohen në

pesëvjeçarin e ri. Për këtë arsye ju thirra, të më bëni një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes dhe të më tregoni propozimet që keni bërë dhe nuk ju janë pranuar.

Pasi inxhinieri e njohu me veprat ujitëse të ndërhuara deri në atë kohë në rrethin e Skraparit, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Domethënë deri tani këtu ujitën rreth 1 800 hektarë, kështu që duhet punuar akoma për të vënë më shumë hektarë tokë nën ujë¹.

SHOKU ILJAZ CERGA: Si urdhëron, ashtu është! Deri më sot ne kemi ecur mirë në ndërtimin e veprave ujitëse, për arsye se ato që janë bërë, kanë qenë diçka më të lehta për t'u ndërtuar. Por, nga studimet e bëra në zonat e tjera të rrethit, për arsye të përbërjes gjeologjike dhe topografike të tyre, ndërtimi i veprave të tjera ujitëse në Skrapar është shumë i vështirë, sepse ka formacione që nuk e mbajnë ujin.

SHOKU ENVER HOXHA: Si duket, ju ju frikësuan këto vështirësi e pengesa që ju dolën, prandaj e filluat nga më të lehtat.

SHOKU ILJAZ CERGA: Sigurisht edhe për këtë arsye. Në zonat e tjera të rrethit ne nuk jemi futur për arsye se veprat e ndërtimit janë më të vështira e kushtojnë shumë.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Sa del kostoja e ujitjes së një hektari? Keni bërë ndonjë llogari për këtë?

SHOKU ILJAZ CERGA: Del e lartë. Përveç këtyre veprave që janë parashikuar në skemën e ujitjes

1. Në vitin 1974, në rrethin e Skraparit, sipërfaqja nën ujë arriti në 2 700 hektarë.

ka mundësi që gjatë lumit Osum të vendosen disa stacione pompimi. Me këta mund të vihet nën ujë një sipërfaqe prej rreth 700 hektarësh të tjerë.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë, këto elektropompa ju mendoni t'i sjellim nga jashtë? Po sa të tilla do të duhen?

SHOKU ILJAZ CERGA: Këtë e kam të vështirë ta them, se nuk e di se si mund të kombinohen.

SHOKU ENVER HOXHA: Këtu ju keni vënë koston globale dhe nuk keni përfshirë shpenzimet që do të bëhen me kontributin vullnetar të popullit.

SHOKU ILJAZ CERGA: Jo, ky nuk është përfshirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Sikur të mos i bëjmë të gjitha këto që thatë ju për të siguruar ujitjen e 4 000 hektarëve, por për më pak, cilin variant mendon të zgjedhim?

SHOKU ILJAZ CERGA: Me vendosjen e elektropompave në lumë mund të ujitën rreth 700 hektarë. Kjo mund të kushtojë rreth 5-6 milionë lekë, kështu që gjer në fund të vitit 1975, duke ndërtuar edhe veprat e parashikuara në planin pesëvjeçar, sipërfaqja që do të ujitet shtohet edhe më tepër. Mendoj se kjo është zgjidhja më e mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: I qartë është problemi, do ta bisedoj me shokët dhe do të të themi edhe ty se si do të vendosim.

Ndonjë çështje tjetër, veç kësaj, keni ju? Për shembull, për diçka që nuk ju ecën, ose për ndonjë punim që nuk kryhet. Ku punohet tani me intensitet për ndërtimin e veprave ujitëse?

SHOKU ILJAZ CERGA: Në Mallakastër.

SHOKU ENVER HOXHA: Ka atje vështirësi gjeologjike?

SHOKU ILJAZ CERGA: Jo, nuk ka.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Ju, si institut, këni bërë llogari sa del leverdia për këto punime?

SHOKU ILJAZ CERGA: Në fillim, kur i hymë problemit të bonifikimit, shikonim bashkë me shpenzimet e tjera edhe leverdinë. Tani nuk po e bëjmë më, sepse projektuesve u dalin shumë detyra dhe duhet të merren edhe me probleme të tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Rriten kërkesat, rriten nevojat, prandaj edhe kuadro duhen gjithnjë e më shumë. Andej nga Hasi punohet?

SHOKU ILJAZ CERGA: Punohet, bile mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju falemnderit për të gjitha shpjegimet, ishin shumë të qarta. Ju përgëzoj!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

HELMËSI ËSHTË I VOGËL, POR KA NJË HISTORI TË LAVDISHME

Nga biseda me Gani Bilimani

29 nëntor 1971

SHOKU ENVER HOXHA: Si je me shëndet more Gani, si shkon me punë? Qenke bërë goxha burrë! Më kanë thënë se ke vazhduar Shkollën e Partisë dhe shumë mirë ke bërë.

SHOKU GANI BILIMANI: U rrita dhe po mësoj në sajën Tuaj dhe të Partisë, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju ishit dy vëllezër në kohën e luftës.

SHOKU GANI BILIMANI: Si urdhëron, unë dhe im vëlla më i vogël.

SHOKU ENVER HOXHA: Gëzohem shumë që u takuam bashkë. Me nënën tënde jam takuar nja dy herë, bile ajo më ka ardhur edhe në zyrë. Kur jam pjekur me të, e kam pyetur për ty, por dëshiroja shumë të të takoja vetë, se më kishte marrë malli dhe ja sot, m'u dha rasti. Puna që po bën si instruktor është një detyrë partie me përgjegjësi.

Në kohën e luftës ti ishe i vogël dhe ne të thërrit-

nim «Negus», me emrin e ish-perandorit të Abisinisë, Negus Negestit, se ishte zeshkan. Në atë kohë Abisininë e kishte pushtuar Italia dhe Negusi ishte një nga figurat e njohura antifashiste që vazhdonte luftën kundër pushtuesve italianë.

Unë kam ndenjur në shtëpinë e «Negusit» me xhaxhanë e tij, Novruz Bilimanin, në një barakë që kishin te luadhi. Mëma e tij, Nurihani, një grua shumë e varfër, ishte ngushtë me banesë. Pranë shtëpisë kishte ca mollë, prej të cilave i jepja çdo ditë nga një «Negusit».

Ky donte të bëhej partizan, kërkonte kobure dhe donte të pinte cigare si partizanët. Këto kërkesa m'i përsëriste çdo ditë. «Mirë, — i thashë unë një ditë prej ditësh, — mund të bëhesh partizan, por më parë duhet të kalosh në «provë». Kur të qëlloj unë me kobure, të mos i mbyllësh sytë dhe kur të pish cigare, të mos kollitesh». «Provën» e parë nuk e kaloi mirë, se kur qëllova me kobure, ky lëvizi qepallat. Por ai as të dytën nuk e kaloi dot, se sa filloi të pinte cigare, e zuri kolla.

Fshati Helmës, nga je ti Gani, është i vogël, por ai ka një histori të lavdishme. Ke vajtur atje tani?

SHOKU GANI BILIMANI: Kam vajtur.

SHOKU ENVER HOXHA: Novruzi atje e ka shtëpinë?

SHOKU GANI BILIMANI: Po.

SHOKU ENVER HOXHA: I vogël ishte Helmësi, po me të lidhen shumë kujtime.

Atje kemi pritur për herë të parë misionin ushtarak sovjetik, ardhja e të cilit ishte një gëzim i madh.

për ne. Shtëpia e xha Mehmetit qe pak më lart se juaja. Sipër shtëpisë së xha Mehmetit ishte një tjetër; atje i vendosëm ne sovjetikët. Në mbrëmje na erdhi në shtëpinë tonë Ivanovi¹ për t'u lidhur me Moskën që t'i jepte lajmet e luftës sonë.

Me misionet ushtarake angleze nuk i kishim punët mirë, për arsye se oficerët anglezë ndihmonin tradhtarët e popullit dhe përpiqeshin të na sabotonin Luftën Nacionalçlirimtare, duke ndërhyrë në punët tona të brendshme. Na thoshin se avionët e tyre do të vinin për të na hedhur «ndihma», por ne, meqë ishim mësuar me premtimet e tyre boshe, nuk kishim shpresë se do të na jepnin gjë.

Si veni me punë? Si duken shokët e Skraparit?

SHOKU GANI BILIMANI: Mirë jemi.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Punën si instruktor e keni në ndonjë zonë të rrethit, apo këtu në qytet?

SHOKU GANI BILIMANI: Unë jam ngarkuar si instruktor për ndërmarrjet ekonomike të qytetit.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë, të uroj suksese në detyrë!

Tani të bëjmë një fotografi së bashku, ashtu si në kohën e luftës, kur ty Gani të kemi nxjerrë duke pirë duhan. Edhe tani, ta bëjmë si atëherë: Unë do të të nderz cigaren dhe ti do ta pish. E pi cigaren?

SHOKU GANI BILIMANI: Jo, nuk e pi.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë bën që nuk

1. Ivanov, K.P., shef i misionit ushtarak sovjetik. Më vonë u vërtetua se ishte agent i kundërzbulimit sovjetik. Menjëherë pas Çlirimit rekrutoi në shërbim të agjenturës sovjetike edhe armikun e kamufluar Mehmet Shehu.

e pi, po tani ndize një herë, vetëm sa për të dalë në fotografi, pastaj, po të duash, shuaje prapë.

SHOQJA NEXHMIJE HOXHA: Ti Gani nuk e ke parë, por ajo është një fotografi shumë e lezetshme. Kur të kthehemi në Tiranë do të bëjmë një kopje dhe do të ta dërgojmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Atje ke dalë shumë mirë, cigaren e ke futur në gojë dhe duket sikur e thith me etje të madhe. Duke parë atë fotografi më duket sikur kam përpara xha Novruzin. Kemi shumë kujtime nga Skrapari dhe në mënyrë të veçantë nga Helmesi, ku, siç dihet, janë zhvilluar ngjarje me rëndësi.

Në Helmës kemi kapur me presh në duar, duke bashkëpunuar fshehurazi me anglezët, Mustafa Gjinishin, që ishte një agjent i vjetër i tyre. Ai kishte lidhje me armiqtë. Ne i kishim marrë më përpara lajmet e një emisioni të Radio Londrës, e cila hidhte parulla edhe në drejtim të Shqipërisë. Shokët tanë i regjistronin ato dhe na i dërgonin menjëherë. Ne, pasi i lexonim, mundoheshim t'i interpretonim parullat armiqtëso-re të tyre. Një ndër to, më kujtohet, ishte edhe kjo: «Koha erdhi, u poqën fiqtë». Pikërisht ajo i drejtohej «Tafarit». Unë e dija që ky ishte pseudonimi i Mustafait, me të cilin nuk mund të bashkëpunonim, prandaj na duhej të vepronim me kujdes me të. Disa herë kishim bërë përpjekje për ta kthyer në rrugë të drejtë atë njeri, por në vend që të ndreqej, ai punonte për të na goditur. Me qëllim që t'i hapja rrugë bisedës me Mustafanë për çështjen e anglezëve, i propozova të shkonim bashkë me të për t'i takuar anglezët. Ai pra-

noi¹. Kur vajtëm atje, i thashë gjeneralit anglez që Radio Londra e tyre nuk e kryente mirë detyrën. «Më falni, — tha ai, — po Radio Londra nuk është një institucion shtetëror», duke dashur të thoshte se goja ajo vepronte pa pyetur qeverinë angleze!

Rrugës, kur ktheheshim, Mustafai më thotë: «Këta anglezët qenkan të çuditshëm, ata nuk flasin fare për ne, prandaj do të ishte mirë sikur të dërgonim një delegacion në Londër për ta vënë në vend punën tonë». Unë iu përgjigja që kjo do të jetë e zorshme, sepse nuk kemi kë dërgojmë. «Gjejmë njerëz për këtë punë», — më tha ai. Unë i theksova, se nuk isha i mendimit për të dërguar një delegacion në Angli. Kështu e mbyllëm muhabetin atë ditë.

Pas dy-tri ditësh e pyetëm përsëri për mendimin që kishte shfaqur më parë lidhur me delegacionin dhe i thamë: Nga mendja jote e nxore ti këtë mendim, apo mos ta sugjeroi gjenerali anglez? «Jo, nuk kam biseduar fare me gjeneralin, vetëm me kolonelin»², — tha Mustafai. Në bisedën me Mustafanë i fola për shumë gjëra, e njoftova se për qëndrimin e tij të shtrembër Partia kishte fakte të tjera, po ai nuk nxirrte fjalë nga goja. E pyeta pastaj lidhur me mesazhin që i kishite dërguar Radio Londra «Tafarit» për pjekjen e «fiqve». Ai nuk e mohoi pseudonimin e tij, por shtoi se

1. Është fjala për takimin me kryetarin e misionit anglez, gjeneralin Devis, në Labinot, më 31 tetor 1942. (Shih: Enver Hoxha, «Rrcziku anglo-amerikan për Shqipërinë» — Kujtime, f. 78-114.)

2. Koloneli Nikols, shefi i shtabit të misionit anglez.

nuk dinte asgjë çfarë thoshte Radio Londra. Pasi mori vesh se ne ishim në dijeni edhe për mesazhet e tjera që atij i qenë dërguar nga Londra dhe, pasi u lodh tërë natën, më në fund u zbërthye dhe pohoi se ishin të vërteta, prandaj filloi të tregojë tërë historinë.

Mustafai kishte lidhje me Cungun, një agjent i vjetër anglez, që kishte ardhur nga deti për të rregulluar çështjen e Mehdi Frashërit. Ata, *ipso facto*¹, donin të krijonin një qeveri në mërgim, ku Mehdiu të bëhej kryetar i saj, ndërsa ky anëtar i qeverisë. «Nuk kam gjë tjetër, — tha Mustafa Gjinishi, — le të vendosë Partia për mua, le të më pushkatojë, se unë kam tradhtuar». Ne i thamë se po të hiqte dorë nga veprimtaria e tij armiqësore dhe të na jepte fjalën për këtë, mund ta falnim. «Nuk do të tradhtoj kurrë», m'u përgjigj, prandaj e falëm, duke e paralajmëruar që të mos i përsëriste më fajet, ndryshe e priste dënimi që kërkoi vetë. U betua që nuk do të bënte më veprime të tilla tradhtie.

Kur po bëheshim gati për të shkuar në Kongresin e Përmetit, kishte ardhur aty edhe koloneli anglez për t'u takuar me Mustafanë, për t'i dhënë këtij udhëzime se si të sabotohej Kongresi dhe pastaj të kalonte te ballistët e Tefik Cfitit. Mustafai qëndronte me ne, hiqej si burrë i mirë, sikur nuk kishte më kontakt me anglezët. Para se të niseshim ishim të gjithë në shtëpinë e «Negusit». Kur u bënë gati mushkat për udhë, një pjesë e shokëve u larguan, kurse pjesa tjetër, mi-

1. Latinisht, — sipas vetë faktit, domethënë një gjë e kryer në fakt pavarësisht nga e drejta.

dis të cilëve edhe unë, rrinim te shtëpia e xha Mehmetit për të ngrënë bukën që na gatoi Nurihani. Kur po dilnim nga shtëpia, vumë re se Mustafai që shkëputur pa u dukur nga shokët, duke kujtuar se ishte i fundit e s'kishte më njeri nga pas. Sa e pa anglezi, u nis shpejt drejt tij, i dha një letër dhe iku me vrap. Unë menjëherë nisa mushkën revan dhe pas pak iu gjenda pranë Mustafait. «Medoemos do të ma japësh letrën, — i thashë, — ne duhet të mësojmë patjetër çfarë urdhri të ka dhënë koloneli». «Edhe sikur të vritem, letrën nuk e jap», nguli këmbë tradhtari. Atëherë i fola ashpër duke e sharë që «ti je i poshtër, je spiun, shko përpara, se do ta zgjidhim këtë punë!».

Megjithatë, në Përmet Mustafai filloi nga sabotimi, sipas porosisë së anglezëve. Shokut Myslim Peza i tregova që Mustafa Gjinishi është tradhtar, duke ia shpjeguar të gjitha sa kishin ndodhur. Edhe Myslimi më tregoi se si armët që i kisha premtuar t'ia dërgoja, nuk i kishte marrë. Thirra Mustafanë, që erdhi si pulë e lagur. E pyeta se ku i kishte çuar paratë që kishte marrë për të blerë armët që duhet t'ia dërgonte Myslimit. Ai filloi nga llogaritë: «Kaq i kam dhënë këtij e kaq atij». U mor vesh kështu që armët ai ua kishte shpërndarë njerëzve të tij që ishin kundër nesh dhe jo atyre për të cilët që porositur. Përsëri e demaskova edhe një herë haptas. Myslim Peza më tha atëherë se donte të ishte i pari që ta gjykonte Mustafanë. Ai foli para të gjithëve, prandaj Mustafai mbeti ngushtë dhe u neutralizua. Koloneli anglez, pasi erdhi në Përmet, kur e pa se nuk po i ecte plani djallëzor që kishte kurdisur, më tha se do të ikte.

Kjo është një histori e gjatë¹. Ngjarjet që ju tregova zhvilloheshin në kohën kur «Negusi» i vogël nuk ishte në gjendje t'i kuptonte.

Mund të na thuash Gani, bëjnë përpjekje komunistët për të ngritur nivelin e tyre ideopolitik dhe çfarë tekstesh përdorin për këtë qëllim?

SHOKU GANI BILIMANI: Në format e edukimit ata studiojnë Historinë e Partisë së Punës të Shqipërisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Jeni duke menduar gjë për punimin e materialeve të Kongresit të 6-të të Partisë?

SHOKU GANI BILIMANI: Po mendojmë. Materialet e Kongresit të ne janë lexuar në mënyrë të organizuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Si e bëni këtë lexim në mënyrë të organizuar?

SHOKU GANI BILIMANI: Në skuadrat e punës. Në rast se ka vështirësi për të kuptuar çështjet që ngrihen, bëhet edhe shpjegimi përkatës.

SHOKU ENVER HOXHA: Gjenerali vështirësi në kuptimin e tyre?

SHOKU GANI BILIMANI: Nuk janë shumë të vështira materialet, shoku Enver, se ato janë të zbërthyera mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: Në përgjithësi materialet tona nuk janë të vështira për t'u kuptuar, sepse s'kanë formula abstrakte, ato pasqyrojnë eksperiencën e Partisë sonë, të ngritur në njëfarë niveli.

Programi i ngritjes ideopolitike nuk duhet të jetë

1. Më hollësisht për këto flitet te libri: Enver Hoxha, «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë» — Kujtime, f. 166-215.

përherë po ai, por duhet përpunuar vazhdimisht, pse çdo vit do të sjellë eksperiencë të re, më të pasur në metodën dhe në formën e të studiuarit, për një kuptim më të mirë e më të thellë të problemeve. Me kalimin e kohës punën konkrete do ta pasuronim me eksperiencën që do të fitohet në zbatimin e vijës së Partisë. Format e punës që do të caktoni, do të përpunohen gjatë viteve; ato kurrë nuk mund të jenë statike dhe të prera një herë e përgjithmonë. Gjatë punës që do të zhvillohet në gjashtëmuorin e parë të vitit që vjen, do të konstatojmë, për shembull, që disa gjëra do të jenë të panevojshme, kurse disa të tjera, që vërtetohet se janë më frytdhënëse, mund t'i përdorni më gjerë. Praktika e punës mund të diktojë forma të reja që tani nuk zbatohen.

Çështja është që instruktorët e komitetit të Partisë të ndihmojnë si duhet bazën që kjo të kuptojë drejt dhe të zbatojë me këmbëngulje detyrat ekonomike dhe të gjitha të tjerat.

Që të kryhen me sukses detyrat, procesi i punës duhet parë në mënyrë intensive nga ana politike për çdo problem, sepse secili prej tyre ka, para së gjithash, karakterin e tij politik. Detyrat e vëna që të ngrihet mirëqenia e popullit, që të forcohen më tej Partia dhe atdheu e të tjera, duhen parë nga ana politike. Këtu qëndron një nga karakteristikat më të mira të komunistëve. Për shembull, punimi i tokave dhe shfrytëzimi në maksimum i tyre nuk është një problem i lehtë. Disa fshatarë që janë të plogët në punë duhet të nxiten për të punuar më shumë dhe më mirë; disa njerëz që janë të shthurur në jetë duhen edukuar me durim. Dihet se shokët e terrenit punojnë në kushte të vështira,

prandaj ndihma që u jepet atyre duhet të jetë sa më e kualifikuar. Për të gjitha këto detyra me rëndësi të madhe Partia duhet t'i përgatitë dhe t'i përpunojë njerëzit e saj nga ana politike dhe ideologjike.

Detyra e çdo komunisti nuk është vetëm të vejë një herë në muaj në mbledhjen e organizatës-bazë, por cilido, në skuadër, në brigadë e kudo që punon, të zhvillojë një veprimtari të gjerë e të gjithanshme që çdo problem të kuptohet në radhë të parë nga ana politike. Po të edukohen njerëzit vazhdimisht me një frymë të gjallë revolucionare, atëherë edhe detyrat edhe çdo aksion tjetër ekonomik, politik etj. do t'i kryejmë më së miri. Në këtë drejtim Partia duhet të kujdeset për kombinimin e punës politike me atë teknike dhe profesionale.

Sigurisht, edukimi politik i njerëzve has në vësh-tirësi, se nuk janë të tërë të një niveli politik dhe në të njëjtën shkallë gatishmërie për të punuar. Komunistët, duke e njohur këtë, është e domosdoshme t'i përcaktojnë qartë dhe konkretisht detyrat që duhet të parashikojnë e të zgjidhin çdo ditë, duke qëndruar për-herë në krye të masave për të kalitur frymën e tyre revolucionare.

Komunistët janë edukatorët, komisarët e masave. Këtë cilësim të lartë të anëtarëve të saj Partia nuk e bën kot. Ky vlerësim i Partisë duhet të na ngjallë neve komunistëve ndjenjën e përgjegjësisë. Në qoftë se, për shembull, një komunisti i takon të punojë si edukator me 150 veta, ai duhet të përpiqet pa u lodhur që këta jo t'i heqë zvarrë, por t'i bëjë të ndërgjegjshëm si veten.

Në qoftë se shikojmë që në një organizatë-bazë

partie ka pak komunistë dhe nuk e kryejnë dot detyrën, për arsye se raporti midis tyre dhe masës që udhëheqin ka shpërpjesëtim të madh, të mos dëshpërohemi, por të punojmë pa u lodhur për të përgatitur, ta zëmë, edhe dy të tjerë për në Parti. Radhët e organizatës së Partisë t'i shtojmë me gjak të ri, duke sjellë aty të rinj, dhe të reja që punët të përballohen përherë me sukses.

Ja, pra, se si detyrat e mëdha që kemi përpara shtrojnë nevojën e shtimit të radhëve të Partisë. Kërkesa e Partisë për shtimin e radhëve nuk është një qëllim në vetvete, por synon zmadhimin dhe përtëritjen e organizatës me njerëz të rinj, të mirë, për të vënë në jetë vijën e saj të drejtë. Këtej del se kjo kërkesë duhet zbatuar me tërë seriozitetin që kërkon koha.

Një kujdes të posaçëm duhet të tregojmë për kalitjen dhe edukimin e kandidatëve të Partisë. Instruktori i Partisë me të gjitha forcat duhet të punojë shumë në këtë drejtim, pse kështu ai do të kontribuojë për të përgatitur për Partinë komunistë të mirë e të fortë.

Që puna e Partisë të shkojë mirë është e domosdoshme që çdo normë partie të kuptohet drejt, thellë dhe e lidhur me jetën e jo të zbatohet në mënyrë shabllone. Vetëm në këtë mënyrë do të kryhet me sukses çdo punë.

Më falni se u zgjata një çikë. Meqenëse tash është tamam ora për të vajtur në darkë, po e mbyllim bisedën, se atje na presin me dhjetëra shoqe dhe shokë.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

KUJTIMET NA SHTOJNË FUQITË PËR TË PUNUAR DHE NA BËJNË TË RINJ

*Fjala në darkën e shtruar në Çorovodë
me rastin e 28 dhe 29 Nëntorit*

29 nëntor 1971

Gëzuar festat e Pavarësisë dhe të Çlirimit të At-dheut! Ta ngremë këtë gotë për shëndetin tuaj, të dashur shoqe dhe shokë! Të na rrojë Partia!

Ngjarjet e kaluara i kujtojmë shpesh, sepse ato na zgjojnë forca të mëdha shpirtërore, na shtojnë fuqitë për të punuar dhe na bëjnë të rinj siç kemi qenë. Që të përballojmë me sukses detyrat për ndërtimin e socializmit kemi shumë nevojë për gjallërinë, freskinë dhe vrullin e moshës së re dhe, sido që vitet kalojnë, ne gjithnjë mbetemi të rinj nga zemra.

Sot, pas afro 30 vjetësh, u poqa me Ganiun, të birin e Nurihan Bilimanit, të cilin, në kohën e luftës e kisha lënë fare të vogël, si bobollaqe, që i thonë në Gjirokastrë. Atë e vishnin vetëm me një këmishë të vjetër, pa këpucë e çorape, se prindërit i kishte shumë të varfër. Ruaj disa kujtime të bukura për të dhe më kishte marrë malli ta shikoja, prandaj disa herë i kisha

thënë Nurihanit: Moj, po ku e ke atë djalë që më qepej pas si manar? Ganiu, që ishte me fytyrë të zeshkët, unë e thërrisja «Negus», me emrin e ish-perandorit të Abisinisë, i cili në ato kohë ka qenë antifashist i njohur për arsye se ngriti në këmbë popullin abisinas dhe luftoi me armë në dorë kundër Italisë fashiste për mbrojtjen e pavarësisë së vendit.

Ganiu i vogël, që ishte 4 vjeç në atë kohë, më shprehte vazhdimisht dëshirën të bëhej partizan e më lutej çdo ditë, duke më thënë: «Më bëj partizan, më bëj partizan, më jep kobure dhe cigare», sepse e shihte dhe ai që veç kobures e cigares partizanët s'kishin gjë tjetër.

Kujtimet e atyre kohëve të lavdishme janë shumë të dashura për të gjithë ne, pse na sjellin ndër mend Luftën Nacionalçlirimtare, përpjekjet e shokëve tanë kundër armiqve, kërkesat e larta të atdheut, vendimet e rëndësishme që merreshin, urdhrat që lëshoheshin, lajmet që na vinin nga të katër anët e vendit. Një gjë e vogël e asaj kohe, si ajo që ju tregova, na kujton historitë të tëra, që na mbajnë gjallë dhe na përtërijnë.

Si thua ti nënë Xiko¹, që t'u vranë dy djem në luftë për lirinë e Shqipërisë, është kështu apo jo? Po ti mbahesh e fortë, se bijtë e tu nuk kanë vdekur, ata janë gjallë dhe rrojnë në mendjet e në zemrat tona. Me trimërinë dhe vetëmohimin e tyre ata dhe gjithë dëshmorët e tjerë janë të pavdekshëm. Do të kalojnë vite, breza të tjerë do të vijnë mbi këtë tokën tonë të

1. Xiko Zaimi nga Dobrusha e Skraparit, nënë e dy dëshmorëve.

dashur, po ata nuk do të harrohen, sepse dhanë jetën për atdheun. Kjo është vdekja më e bardhë që mund të bëhet për çdo shqiptar të ndershëm e patriot.

Le ta pimë këtë gotë, shoqe dhe shokë, për festën e madhe të Çlirimit dhe për shëndetin e skraparllinjve!

Takime si këto që po bëjmë janë të këndshme. Sa mirë e ndiejmë veten në një mbrëmje si kjo, ku jemi mbledhur si në familje! Ndoshta do të ishte edhe më mirë po të uleshim këmbëkryq si qëmoti, rreth sofrës. Megjithatë, edhe pse janë vënë tavolinat, prapëseprapë kjo gjendje nuk e ndryshon ambientin familjar.

Pijet alkoolike që prodhojmë sot në vendin tonë, si, për shembull, rakia juaj dhe e Përmetit, vera e Korçës dhe e Durrësit etj., etj., kërkohen shumë jashtë shtetit. Ne kemi leverdi të shesim nga mallrat tona jashtë se sigurojmë valutë, që na duhet për të zhvilluar ekonominë tonë. Pijet tona bëhen thjesht prej rrushi. Në Evropë shumë rrallë mund të gjesh pije si te ne, por edhe sikur të gjesh, ato, siç thotë populli, kushtojnë qimet e kokës. Të huajt i kanë rënë hilesë, prandaj vijnë e na i blejnë pijet që të fitojnë. Natyrisht, edhe ne përpiqemi të ruajmë cilësinë e tyre, të shtojmë gradacionin dhe të sigurojmë të ardhura. Megjithatë, kapitalistët, prapë fitojnë, sepse pijet tona i shtojnë 5-7 fish, duke përdorur shumë marifete dhe hile, siç thotë një shprehje popullore: «një nga dhia, tetë nga vija».

Sot, këtu në Çorovodë, vizitova shkollën tuaj dhe u kënaqa shumë, jo vetëm pse ndërtesa ishte shumë e bukur dhe moderne, gjë që natyrisht ka edhe kjo rëndësinë e vet, por, në radhë të parë, se më pëlqyen ata për të cilët është bërë shkolla, nxënësit dhe nxënëset

e saj, si dhe mësuesit e mësueset, edukatorët e brezit: të ri, që punojnë pa u lodhur për të vënë në jetë mësime e Partisë për revolucionarizimin e shkollës sonë të re. Sytë e të rinjve ndritnin nga gëzimi. Tek ata lexoje të ardhmen e tyre të ndritur, të nesërmen e sigurt të vendit, krenarinë e ligjshme për ndryshimet e mëdha që janë bërë në Shqipërinë socialiste dhe besimin e patundur se atdheu ynë i shtrenjtë do të përparojë me hapa të mëdhenj në të gjitha sferat e jetës. Tek të gjithë ata shikoje dëshirën e zjarrtë për t'u pajisur me sa më shumë dituri e për ta vënë atë në shërbim të masave të gjera të popullit, shikoje, pra, pikërisht ato cilësi që dëshiron të shohë te rinia brezi ynë që bëri revolucionin.

Ne të moshës së kaluar, që kontribuam për çlirimin e Shqipërisë, nuk ishim të mësuar në shkolla. Af-tësitë tona në fushat e ditorisë e të zhvillimit nuk ishin aq të mëdha, jo për fajin tonë, po për arsyt që dihen. Vullneti i çeliktë i njerëzve tanë dhe puna edukative e Partisë bëri që ne të japim çdo gjë për të ngritur këto themele të forta mbi bazën e të cilave do të përparojë, do të forcohet dhe do ta çojë akoma më tej revolucionin brezi ynë i ri. Të rinjtë dhe të rejat tona tash mësohen dhe edukohen me frymën revolucionare të Partisë, me shkencën marksiste-leniniste, që të ngrihen akoma më lart dhe të dinë të punojnë më mirë për ta çuar më përpara jetën e vendit, për zhvillimin e pandërprerë të industrisë, bujqësisë, arsimit, kulturës e të tjera, e sidomos për të ngritur në një shkallë më të lartë ndërgjegjen e njerëzve.

Ngritja e vazhdueshme e ndërgjegjes socialiste të

punonjësve ka rëndësi të jashtëzakonshme për të tashmen dhe të ardhmen e vendit tonë, prandaj pikërisht në këtë drejtim e vë theksin më të madh dhe punoa vazhdimisht Partia jonë. Në qoftë se ne fitojmë mendjet dhe zemrat e njerëzve, në përgjithësi, dhe të të rinjve e të rejave në veçanti, dhe lartësojmë ndërgjegjet e tyre në një shkallë të atillë sa që cilido të mendojë për popullin, «për të mirën e gjithësisë», siç thoshin Naimi i madh dhe Samiu, me siguri ne do të jemi në gjendje të luftojmë me sukses ato «njolla» të errëta që na kanë mbetur nëpër skutat e ndërgjegjes. Kur të arrihet kjo, përparimet do të jenë kolosale.

Ne i shikojmë të rinjtë e të rejat tona që punojnë me vrull të madh në industri e në bujqësi, që mësojnë me zell në shkollat e arsimit të përgjithshëm e profesional, ndërsa ata që mbarojnë studimet e larta, me një aftësi e pjekuri të jashtëzakonshme, shpikin e realizojnë mjaft gjëra. Ja, pra, ç'ndërgjegje të lartë për të mirën e përgjithshme ka kalitur e vazhdon të kalitë Partia në njerëzit tanë. Kur ne të krijojmë mundësi edhe më të mira materiale, njerëzit tanë, me një shpejtësi të madhe dhe në shumë drejtime, do të ecin përpara e do të ndërtojnë të tjera fabrika, makina etj., etj. edhe më të ndërlikuara se këto që kemi realizuar gjer më sot, për të cilat jashtë është dashur një kohë shumë më e gjatë për t'i bërë.

Sukseset që janë arritur dhe do të arrihen nuk vijnë pse ne shqiptarët jemi të rënë nga qiejt, por për arsye të ideve marksiste-leniniste që na frymëzojnë dhe na udhëheqin për formimin e njeriut të ri, për zhdukjen e mbeturinave mikroborgjeze, që ndrydhin

ndërgjegjen e njerëzve dhe pengojnë zhvillimin e hovshëm të mendimit, të përpjekjeve, të shpikjeve e të realizimeve. Mbeturinat mikroborgjeze presin hovin e punës për të bërë atë që është e guximshme, dobësojnë përpjekjet për të mirën e përgjithshme, kurse idetë marksiste-leniniste, të materializuara në çdo hap që bëjmë ne, i luftojnë këto mbeturina. Njeriu ynë, i çliruar prej tyre, sheh qartë horizontet që i hapen dhe rrit aftësitë e veta për të ndërtuar një të ardhme më të bukur.

Nën sundimin e regjimeve të borgjezisë, kapitalizmit dhe imperializmit, njerëzit jetojnë të ndrydhur nga pasiguria që ndiejnë për të nesërmen; ata nuk janë të interesuar për rritjen e prodhimit kapitalist, nga i cili përfitojnë gjakpirësit. Dikush mund të mendojë: «Po si shpjegohet atëherë që atje ka një teknikë të zhvilluar?». Është e vërtetë që në vendet kapitaliste ka përparime në teknikë, por të kemi parasysh e të kuptojmë drejt se teknika atje ka arritur nivelin e sotëm për një kohë mjaft të gjatë, duke përkrahur një proces shumë të ngadalshëm; ajo është zhvilluar në kurrizin e masave të gjera të popujve të vendeve të tyre e të vendeve të tjera, të cilat nuk përfitojnë asgjë prej saj. Pastaj, as kapitalistët, as bijtë e tyre, nuk i kanë realizuar përparimet në teknikë, këto i kanë realizuar masat e shfrytëzuara të popullit, nën kërcënimin e papunësisë, duke shitur si mall forcën e krahut dhe të mendjes së tyre.

Në botën kapitaliste sfera e tregtisë ka përfshirë jo vetëm rakinë e verën, për të cilat fola më parë, por edhe moralin, edhe trurin e njeriut. Imperializmi ame-

rikan sot po bën tregti gjer edhe me mendimin e botës kapitaliste. Në Amerikë, Francë dhe Itali, që hiqen si vendet më të përparuara të botës, kur njerëzit e mësuar vijjnë në një shkallë pjekuric, i marrin dhe, pasi u mbushin duart me dollarë, që është i vetmi mjet nxitës në botën borgjeze, i përdorin për shpikje, që i sjellin fitime kolosale imperializmit, në një kohë kur miliona njerëz mbeten analfabetë dhe pa punë. Për sa u përket vendeve e kontinenteve të Azisë, Afrikës dhe Amerikës Latine gjendja e masave punonjëse është akoma më e mjerueshme dhe më e keqe nga ç'ishte te ne në kohën e Zogut. E tillë është situata atje.

Kurse në rendin socialist gjendja dhe perspektivat e zhvillimit janë krejt ndryshe. Mjetet për zhvillimin e shkencës dhe të teknikës, natyrisht, ne akoma nuk i disponojmë në shkallën e duhur, por aftësitë fillestare ekzistojnë dhe përparimi ecën me ritme të shpejta. Prandaj, ne jo vetëm që do t'i arrijmë brenda një kohe shumë të shkurtër përparimet e tyre, por me siguri edhe do t'i kapërcejmë ato. Fakt është që Shqipëria e vogël ka bërë përparime të mëdha në fushën e teknikës.

Ne ndiejmë një krenari të ligjshme kur shohim ekspozitën e prodhimeve industriale që u hap kohët e fundit në Tiranë. Besoj se ka shokë nga ju që kanë shkuar në Tiranë gjatë këtij muaji dhe, pasi kanë parë ekspozitën, me siguri që janë çuditur nga cilësia dhe llojet e prodhimeve. Jo vetëm ne shqiptarët, por edhe përfaqësuesit e partive dhe grupeve marksiste-leniniste që ishin në Kongresin e 6-të të Partisë sonë u kënaqën pa masë me realizimet tona. Shumë prej tyre, që kanë qenë në vendin tonë një ose disa vjet më parë

për të pasur kontakt me ne, për të parë popullin tonë si punon e mendon dhe për të marrë eksperiencën e punës sonë, kur vizituan ekspozitën, që pasqyron përparimet e shpejta që po bëhen në Shqipërinë socialiste, mbetën me të vërtetë të habitur dhe qenë jashtëzakonisht entuziastë. «Këtu, në vendin tuaj, — thanë ata, — po bindemi akoma më shumë se ç'forcë të madhe transformuese për shoqërinë dhe natyrën kanë idetë e komunizmit, kur zbatohen drejt, në mënyrë krijuese dhe në kushtet konkrete të çdo vendi». Një shok i ardhur në vendin tonë, tha: «Edhe në burgjet më të errëta të Argjentinës ne e kemi ndier forcën e ideve dhe të përparimeve tuaja». Sot në Argjentinë sundon terrori i egër i disa gjeneralëve të shitur, të edukuar e të stërvitur në akademitë ushtarake të Uest-Pointit¹ në Nju-Jork, për të shtypur popujt e Argjentinës dhe të gjithë Amerikës Latine.

Me qindra e mijëra nga shokët komunistë të Argjentinës janë nëpër burgje dhe në pamundësi të mbajnë lidhje me njëri-tjetrin e me masat. Megjithatë, njëri prej tyre gjeti mënyrën si të na dërgonte një letër, ku shkruante: «Shokë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë! Mos u bëni merak për ne, sepse këtu në burg kemi një radiotransistor të vogël dhe, nëpërmjet tij, me valët e shkurtra dëgjojmë çdo mbrëmje Radio Tiranën, nga e cila mësojmë si të punojmë e të organizohemi më mirë në luftën kundër imperializ-

1. Uest-Point (West-Point) — zonë ushtarake në SHBA, pranë Nju-Jorkut, ku qysh më 1802 është ngritur Akademia Ushtarake për përgatitjen e oficerëve amerikanë.

mit». Shikoni, të dashur shoqe dhe shokë, si shprehen komunistët e vërtetë të vendeve të tjera për Partinë dhe atdheun tonë socialist! Vlerësimi i lartë i tyre ne na inkurajon për të punuar akoma më shumë dhe për të arritur fitore më të mëdha.

Siç e dini, në vitet e para të Çlirimit, punën për ndërtimin e fabrikave dhe të punishteve e filluam nga gjërat më të vogla. Veprat që ngriheshin atëherë numëroheshin me gisht, pse ato mundësi kishim. Kurse këto që kemi tash, as unë, as ju nuk i mbajmë mend dhe nuk i dimë të tëra, bile nuk i vizitojmë dot të gjitha. Çdo vit që kalon, sjell objekte të reja më të mëdha se ato që kemi; kudo ndërtohen fabrika, uzina dhe linja të veçanta për prodhimin e sendeve me vlera të mëdha për ekonominë dhe konsumin e popullit.

Kur shkova në ekspozitën që përmenda, t'ju them të drejtën u habita, pse atje u njoha me disa prodhime që nuk i kisha parë. Midis të tjerash, më tërhoqën vëmendjen një sërë makinash të mira që përdoren në mjekësi për të studiuar sëmundjet e organeve të ndryshme të trupit si veshkat e të tjera dhe pyeta për to disa të rinj që qëndronin aty pranë. Kush i ka bërë këto makina, more djem? «Ne i kemi bërë, shoku Enver», — m'u përgjigjën ata me thjeshtësi. I përgëzova me gjithë zemër për suksesin që kishin arritur ata djem me mendje dhe duar të shkathëta. Atje kishte dhe shumë prodhime të tjera që nuk kanë asnjë ndryshim nga makinat dhe aparaturat e importuara.

Këtë pesëvjeçar ne do të shtojmë më tej kapacitetin materialo-teknik të ndërmarreve, që t'u japim mundësi njerëzve tanë, punëtorëve, teknikëve dhe in-

xhinierëve, të prodhojnë vetë gjërat e domosdoshme për vendin, qoftë për industrinë, qoftë për bujqësinë dhe për sektorët e tjerë të ekonomisë e të kulturës. Partia ka besim të plotë se këtij qëllimi do t'ia arrijmë.

Siç thashë, plani pesëvjeçar hap perspektiva të mëdha për vendin tonë. Në këtë drejtim një rëndësi të jashtëzakonshme për industrinë ka metalurgjia e zezë. Kjo vërtet quhet e zezë, por do të na nxjerrë në ditë të bardha. Për nevojat që kemi për zhvillimin e ekonomisë jemi të detyruar të sjellim një sasi të madhe çeliku nga jashtë, por ai na kushton shumë. Pas përfundimit të kombinatit të metalurgjisë, të hollat që tash i shpenzojmë për të blerë çelique do t'i përdorim për të plotësuar nevoja të tjera. Sikur një të pestën, një të gjashtë apo vetëm një të tetën e atyre të hollave ta rezervojmë për konsumin e masave të popullit, ne do t'i mbushim tregjet plot, për vite të tëra. Kështu do të bëhet në të ardhmen!

Veprën e madhe në Elbasan po e bëjnë njerëzit tanë, që punojnë me vrull të madh. Kombinatin e metalurgjisë së zezë do ta përfundojnë djemtë e rinj të ardhur nga të katër anët e Shqipërisë, shokët e atyre që pamë sot në shkollën e qytetit tuaj, që, duke biseduar dhe duke i pyetur nga ishin, njëri thoshte se ishte nga fshatrat e Skraparit, tjetri nga Korça, një i tretë nga Dardha etj.

Të rinjtë e vendit tonë janë të gjallë, të fortë, plot vullnet dhe kanë përveshur llërët që të punojnë për të ngritur hidrocentralin e Fierzës. Ata punojnë kudo dhe, ç'është e vërteta, po i kryejnë shumë mirë detyrat. Ky është brezi i ri që po kalit me kujdes Partia, këta janë «çeqot» e vegjël që po kryejnë punë të vësh-

tira për zbulimin e pasurive të nëntokës, për të cilat njerëzit e Hrushovit na kanë bërë dëme shumë të mëdha, duke mos na treguar të vërtetën.

Sovjetikët i kemi quajtur miq në kohën e Stalinit, pse në atë kohë ata kanë qenë me të vërtetë miq të mirë. Sa ishte Stalini në krye të Partisë dhe të qeverisë sovjetike, mbajti qëndrim parimor e dashamirës ndaj Shqipërisë, pse ishte njeri i madh. Ne kemi në dorë materiale dhe dokumente të pakundërshtueshme që provojnë marrëdhëniet e singerta e të drejta midis vendeve tona për atë periudhë. Çdo gjë që ka bërë Stalini për Shqipërinë dhe çdo gjë që ka thënë për të, provon se ai ishte një marksist i madh. Njerëzit që dërgonte ai këtu kanë punuar mirë, ishin specialistë të zotë dhe të ndershëm. Njëherë, në një takim që kisha me të, Stalini më tha: «Shoku Enver, specialistëve sovjetikë, që vijin për të punuar në Shqipëri, mos u paguani asgjë më tepër se punonjësve shqiptarë dhe, në qoftë se nuk do të punojnë mirë, kthejini menjëherë këtu. Pastaj kini parasysh se ata që po ju dërgojmë në Shqipëri, për t'ju ndihmuar, nuk do t'ju lëmë të qëndrojnë për tërë jetën, po përkohësisht, gjersa ju të përgatitni njerëzit tuaj». Këto fjalë tepër të singerta e të drejta të Stalinit kishin një kuptim të madh marksist-leninist dhe tregonin se ai nuk e konsideronte Shqipërinë si koloni dhe nuk mendonte që, nën maskën e ndihmës, ta mbushte vendin tonë të vogël me sovjetikët, që t'i rrëmbejnë popullit shqiptar bukën e gojës.

Sa e mori fuqinë në dorë, renegati Nikita Hrushov hoqi shumë nga kuadrot e dërguar në Shqipëri në kohën e Stalinit, dhe, gradualisht, i zëvendësoi me njerë-

zit e tij. Ne, në fillim, kujtuam se ishin të mirë si të parët, por ata vetëm llafet kishin «të ëmbla», se veprimet i kishin të hidhura. Kur shkonin gjeologët e Hrushovit për të zbuluar rezervat e kromit, na raportonin se në Bulqizë, në Batër, në Martanesh e në vende të tjera s'ka krom, prandaj vinin kryq në hartë dhe propozonin mbylljen e minierave. Ata raportonin kështu, se ishin porositur të vepronin si armiq e jo si gjeologë. Të dhënat e tyre për pasuritë minerale të nëntokës sonë ne i ruajmë si dokumente në zyrat e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave. Kështu vepruan ata me ne edhe për naftën, asbestin dhe për të gjitha mineralet e tjera, kurse Hrushovit dhe klikës së tij u jepnin raporte të sakta se në Shqipëri ka mjaft rezerva të mineraleve, duke përcaktuar me hollësi edhe vendet përkatëse.

Kur tradhtisë së revizionistëve sovjetikë iu çor maska dhe i doli era dhe u shporrën nga vendi ynë specialistët që na kishin dërguar, Partia, në këto kushte, thirri bijtë e saj e u tha: «Hajdeni o «çeço» se i zoti e nxjerr gomarin nga balta! Pa shkoni një çikë e kërkoni vetë andej-këtej për minerale, se populli dhe atdheu kanë shumë nevojë për to! Qepuni atje ku sovjetikët na kanë thënë se s'ka minerale, shkoni në Batër, se atje me siguri do të ketë shumë mineral kromi». Dhe, me të vërtetë, atje ku specialistët e Hrushovit kishin thënë se nuk ka, ne zbuluam rezerva të mëdha kromi si në Batër, Bulqizë e Martanesh.

Në këto rrethana u nisën për udhë picirukët tanë të vegjël, duke kaluar nëpër shtigje të vështira e nëpër male dhe, pavarësisht nga koha e keqe dhe të ftoh-

tët e madh, ata vazhduan punën. Kur vajta beharin e kaluar në Tropojë, edhe në Valbonë që nxehtë, kurse lart në mal, në Majën e Hekurave, zbardhonte dëbora e përhershme me pesë metra trashësi. Që andej pashë se po zbritnin disa djem. Nga po vini? — i pyeta. «Vijmë nga mali, ku bëjmë kërkime», — m'u përgjigjën. Ndenja gjatë me ta, duke i pyetur se si i kishin kushtet, sidomos për veshmbathje, por nuk donin të më tregonin asgjë për vështirësitë e mungesat që kishin; gjenden ma paraqitën në rregull. Mirëpo unë e dija që ata kishin edhe vështirësi, prandaj ngula këmbë në pyetjet e mia. Më në fund mezi ua nxora si me kanxhë mungesat që kishin për shkak të interesimit të pamjaftueshëm të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave.

Rezervat në minerale që janë zbuluar në Shqipëri ne ua detyrojmë këmbënguljes së madhe të Partisë, si dhe forcës së gjykimit, trimërisë dhe vetëmohimit të djemve e vajzave tona, që kanë mësuar mirë dhe dinë të punojnë heroikisht në kushte të vështira për t'i dhënë atdheut kaq gjëra të mira.

Prandaj, dëshiroj ta ngremë këtë gotë për Partinë, për të rinjtë e të rejtat tona dhe për popullin shqiptar, për të gjithë ju, të dashur skraparlinj!

Sot, nga të gjithë njerëzit, nga mësuesit, nga nxënësit e shkollave, nga prindërit dhe gjyshërit tanë, kudo bëhen përpjekje që të shkruhet për fakte dhe ngjarje që kanë të bëjnë me të kaluarën e popullit, se tërësia e tyre përbën historinë e mrekullueshme të popullit shqiptar. Të rinjtë dhe të rejtat duhet të mbledhin këngët popullore, kujtimet etj., etj., t'i shkruajnë dhe t'i dërgojnë atje ku duhet, që të shfrytëzohen sa

të jetë e mundur më shumë dhe jo të humbasin me kalimin e kohës.

Tani ne kemi edhe mjete që i regjistrojmë dhe i ruajmë këngët dhe vallet. Por, që këto t'u shërbejnë brezave të ardhshëm, duhet të mos i mbajmë të fjetura. Me qindra e mijëra këngë, që i taurin lavdi së kaluarës heroike dhe jetës së tij, këndon populli ynë. Secila prej tyre shpreh ndjenjat e pasura e të holla të masave për luftërat, trimërinë, për bukën, për shtëpinë, dasmën, kurbetin etj. Këngët e popullit janë shumë të vlefshme për edukimin e njerëzve. Disa prej tyre tregojnë se, sido që shqiptari ka jetuar në varfëri, në vuajtje e mjerim, kur kishte ndonjë gëzim, kur martonte birin ose bijën e tij, mblidhte miqtë e shokët në shtëpi dhe, kokë më kokë, ia thoshte këngës, nëpërmjet së cilës nxirrte dufin e madh që i vlonte në gji.

Këngët tona flasin për botën e pasur shpirtërore dhe jetën aq të larmishme të popullit tonë. Ne duhet t'i ruajmë, t'i këndojmë e t'i mbajmë gjallë këto pasuri të paçmueshme që disa të rinj të mos i mbajnë veshët te këngët e huaja, por të dëgjojnë me dëshirë këngët dhe zërin që del nga thellësitë e tokës së shtrenjtë shqiptare. Organizimin e mirë të punës, për të ngjallur e për të kultivuar tek të rinjtë e të rejat tona dashurinë për këngët dhe muzikën e vendit, e kemi në dorën tonë, prandaj na duhet të punojmë shumë në këtë drejtim.

Muzeu juaj që pashë sot, si fillim, mund të thuhet që është i mirë, veç duhet thënë se për Skraparin ky institucion me rëndësi është si një cefël e vogël arre, pse historia e tij është e madhe. Për Riza Cerovën atje

pashë vetëm një pllakatë, mirëpo, për këtë dëshmor dhe për shokët e tij, mund të mbushet një dhomë e tërë me objekte që mbajnë vulën e kohës dhe të veprimtarisë së tyre.

Në muze duhet të mblidhen, të ruhen e të renditen shkencërisht materiale që pasqyrojnë përpjekjet e popullit të Skraparit dhe të çetave të tij në luftën për pavarësi. Është kështu shoku Mane Nishova apo jo? Po ju pyes, se ju jeni një shok jo vetëm i pushkës, por edhe i penës e i merrni vesh këto punë.

Unë e kam lexuar dy herë librin shumë të bukur që shkroi shoku Mane për Riza Cerovën, për jetën dhe figurën e madhe patriotike të tij. Në këtë libër pasqyrohet mirë veprimtaria e Riza Cerovës, që është nga komunistët e parë të shquar të Skraparit dhe të të gjithë Shqipërisë. Shoku Mane ka qenë bashkëpunëtor i tij. Ai, duke e njohur mirë realitetin e kohës, ka përmendur në libër një plejadë të tërë burrash të shquar të Skraparit, të cilët kanë historinë e tyre, prandaj edhe libri i shokut Mane duhet të figurojë në muze.

Në muzeun tuaj duhet të pasqyrohet mirë historia e Luftës Nacionalçlirimtare. Sa e gjerë, e madhe dhe e lavdishme është ajo! Sa njerëz me zjarr në zemër kanë marrë armët, kanë luftuar dhe janë sakrifikuar për qëllimet e larta të asaj lufte! Sa shtëpi janë djegur, sa mëma kanë dhënë gjakun e bijve dhe të bijave të tyre, sa sakrifica kanë bërë ato për strehimin e partizanëve! Të gjitha këto fakte e ngjarje duhet të figurojnë në muzeun tuaj të pasqyruara në shumë dokumente, në të të ketë sa më shumë fotografi e objekte të tjera të personave të njohur.

Marksizëm-leninizmi na mëson se revolucionin nuk e kanë bërë dhe nuk mund ta bëjnë as një, as dy, as dhjetë veta, sado të aftë dhe të shquar të jenë ata; atë e bëjnë masat e popullit të udhëhequra nga Partia. Prandaj, këtë të vërtetë të teorisë sonë duhet ta pasqyrojmë edhe në muze, me qëllim që cilido që ta vizitojë atë të thotë: «Me të vërtetë këtë revolucionin e bëri populli, këtë Shqipëri e çliroi edhe po e zbukuron vetë populli në sajë të luftës së tij të gjatë e të vështirë».

Natyrisht, unë nuk them që ju të futni në muze çfarëdolloj objektesh dhe pa asnjë kriter, se ai është muze historik. Por, duke ruajtur këtë profil, shtoni sallat, hapni dosje për ngjarje të veçanta, mbledhni shkrime për ngjarje të ndryshme, të botuara ose jo, me qëllim që cilido të gjejë dokumentet e nevojshme për ato që interesohet të mësojë.

Është një iniciativë shumë e bukur krijimi i muzeve nëpër fshatra. Të gjithë po interesohen tani që këto muze të mos mbeten vetëm me disa copë fotografi, po të pasurohen vazhdimisht. Unë shpeshherë u kam thënë shokëve që të mos nënvleftësohet asgjë e vjetër, e dobishme. Edhe atë jelekun e vjetër të gjyshes, të cilit i ka dalë boja, pse ka 80 vjet që është qepur, ta ruajmë me kujdes, mbasi është punuar dhe qëndisur shumë vite të shkuara dhe pasqyron shijet artistike të të parëve tanë, kulturën materiale e shpirtërore të tyre e të tjera. Edhe një objekt të tillë ta vendosim në vendin që i përket në muze. Kur nipat tanë t'i vizitojnë këto muze do t'i shohin me kënaqësi objektet e përdorura 100-150 vjet më parë dhe do të mësojnë shumë gjëra prej tyre.

Kur vijnë miqtë tanë në Shqipëri kërkojnë të njihen me shtëpi e dyqane të vjetra që janë monumente kulture të ruajtura nga shteti. Ata i pëlqejnë shumë objektet e vjetra të punuara artistikisht, si ndonjë legen të vjetër prej bakri të punuar me mjeshtëri nga kallajxhinjtë tanë dhe të zbukuruar me lule, me peronka etj. Këto objekte që sot nuk i përdorim, pse nuk na hyjnë më në punë, të huajt i marrin, i lajnë, i pastrojnë e i zverdhin dhe i vënë pastaj në raft si sende antike. Sendet që mbajnë vulën e së kaluarës, si kacitë, parmendat etj., etj. të mos i mbajmë diku në katua, as të mos i hedhim poshtë, por t'i vendosim në muzeun e fshatit apo diku gjetkë, sipas kriterëve të caktuara. Kur vendi ynë të mbushet me traktorë, natyrisht, parmenda nuk hyn më në punë, por në muze ajo ka vlerë të madhe, pse brezat e rinj do të shohin aty si kanë punuar të parët, me sa mundime e kanë nxjerrë ata bukën e gojës! Djali i ri, që nuk lindi në kohën e parmendës, do të thotë: «Ka punuar shumë gjyshi, prandaj unë rroj sot dhe e punoj tokën me traktor». Është kënaqësi kur njeriu i sheh të ruajtura prej kohësh këto xhevahire të popullit tonë!

Unë dëshiroj ta ngre edhe një herë këtë gotë për popullin trim e heroik të Skraparit, për bashkëluftëtarët e mi, partizanët e vjetër që, në kohët më të vështira, tok me Partinë dhe nën drejtimin e saj, të mbështetur fuqimisht nga gjithë populli shqiptar, luftuam për çështjen e atdheut dhe të socializmit!

Na vjen keq që po ikim, nuk po ndahemi dot nga ju. Tri ditë që qëndruam këtu, në gjirin tuaj të ngroh-të e të dashur, na kaluan shpejt e shpejt, si tri orë.

Gjatë takimeve e bisedave që patëm, ju shprehët ndjenjat tuaja të dashurisë aq të thellë e të pastër që ushqeni për Partinë tonë sokoleshë, që na shpëtoi nga mjerimi, që na mbron nga çdo rrezik dhe na prin me urtësi përpara drejt socializmit e komunizmit.

Për mua, për shoqen Nexhmije, për shokun Kahrem Ylli, për shokun Mane Nishova dhe për shokët e tjerë që më shoqërojnë, do të jenë të paharruara, të pashlyeshme nga mendja dhe zemra këto ditë të gëzuara që kaluam me vëllezërit dhe motrat e Skraparit. Gjatë takimeve me ju unë mora forca të reja. Duke vështruar këto male të stolisura nga dora dhe mendja e këtij populli trim dhe të zgjuar, njeriu kujton madhësinë dhe jehonën e pushkëve partizane të Skraparit dhe të gjithë Shqipërisë, nga skaji i Veriut e deri në Jug, ashtu siç bëhej fjalë në këngët që kënduan artistët tuaj popullorë. Duke qëndruar në mes jush, njeriut i forcohet bindja dhe besimi i patundur se kush prek kufijtë e atdheut tonë, gjen vdekjen.

Ç'forca të mëdha kemi në gjirin e këtij populli, ç'dinamizëm revolucionar dhe ç'mbështetje të çeliktë ka Partia në këtë rreth. Unë ju siguroj se të gjithë ne, që Partia dhe populli na kanë zgjedhur në udhëheqje të tyre dhe na kanë ngarkuar me barrë të rënda, do të vëmë të gjitha forcat mendore, shpirtërore e fizike, që ta meritojmë besimin tuaj, të punojmë kurdoherë kokulur dhe të realizojmë plotësisht porositë që ata na kanë dhënë. Ne kemi bindjen e patundur se me këto forca të pamposhtura, me këto aftësi e zgjuarsia të popullit tonë, me urtësinë, tejpamjen, vullnetin dhe vijën kaq të drejtë të Partisë, ne do të kapërcejmë çdo

pengesë që mund të hasim në rrugën për realizimin e planeve të mëdha e të idealeve fisnike. Ne, doemos, do t'i arrijmë caqet e caktuara dhe do të hapim perspektiva akoma më të mëdha për të ardhmen e ndritur të Shqipërisë socialiste.

Më lejoni, të dashur shokë dhe shoqe, vëllezër dhe motra, t'ju falënderoj nga zemra për besnikërinë e madhe dhe dashurinë e pakufishme që shfaqni ju ndaj Partisë. Ju ftoj përsëri të gjithë ta ngremë këtë doli për atë që është i bashkuar me Partinë si mishi me kockën, për popullin tonë të mrekullueshëm! Parti e popull, popull e Parti, janë një tërësi e vetme dhe e pandarë.

Mbetshi me shëndet, shokë dhe shoqe! Urime për suksese të vazhdueshme në realizimin e planeve! Të jemi si kurdoherë të bashkuar grusht me Partinë! Gëzuar festat! Të rrojë populli! Të rrojë Partia! U çoni të gjithë shokëve e shoqeve, nga të katër anët e rrethit të Skraparit, të falat tona më të përzemërta, si dhe dashurinë e respektin e Partisë!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

DITËT E LAVDISHME TË LUFTËS NUK MUND TË HARROJEN KURRË NGA NE QË I KEMI JETUAR

Nga biseda me patriotin Mehmet Myslimi (Helmësi)

30 nëntor 1971

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se të gjeta! Si të kam xha Mehmet?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Mirë se më erdhe! Jam shumë i kënaqur që e mbajte fjalën e dhënë për të më bërë një vizitë në shtëpi.

SHOKU ENVER HOXHA: Përderisa të dhashë fjalën, kur më erdhe në zyrë, atë do ta mbaja patjetër.

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Të faleminderit shumë, të na rrojë Partia, të na rroni Ju shoku Enver, bashkë me shokët e tjerë të udhëheqjes.

SHOKU ENVER HOXHA: U lodhe ndonjë çikë xha Mehmet, kur erdhe në Çorovodë? Shumë mirë i kaluam këto ditë, apo jo?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Shumë mirë i kaluam. U gëzuam shumë që na erdhët në këto anë, prandaj nuk e ndjeva hiç lodhjen.

SHOKU ENVER HOXHA: Si i ke djemtë, nuset, nipërit e mbesat?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Mirë janë, të gjithë u gëzuan shumë kur morën vesh për ardhjen Tënde.

SHOKU ENVER HOXHA: Hajde të dalim një herë në fotografi me gjithë njerëzit e shtëpisë.

Është bërë qytet i bukur Poliçani. Këtu janë bërë ndërtime që nuk na i merrte mendja më përpara. Në Poliçan pamë punëtorët që kanë mësuar të punojnë mirë në makineri të ndryshme.

Helmësi nga je ti, xha Mehmet, është një fshat i vogël, po atje u kryen shumë punë të rëndësishme në kohën e luftës. Ato ditë të lavdishme e të mëdha nuk mund të harrohen kurrë nga ne që i kemi jetuar. Megjithëse e keni kujdes vetë, unë dua t'ju lutem ju djemve dhe sidomos ju nuseve, që ta mbani shumë mirë xha Mehmetin, të cilit i dëshirojmë jetë të gjatë dhe pleqëri të bardhë.

Po sytë si i ke tani xha Mehmet? Bëre ndonjë operacion për të shikuar më mirë?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Jo, nuk bëra. Mjekët i thanë djalit që operacioni është i kotë, se nuk do të sjellë ndonjë përmirësim.

SHOKU ENVER HOXHA: Na shikon dot ne tani?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Nuk ju shikoj mirë, po ashtu si nëpër mjegull.

SHOKU ENVER HOXHA: Po sikur të ketë dritë të fortë, nuk na shikon diçka më mirë?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Kur ka dritë të fortë shikoj. Sidomos kur ka diell shoh më mirë.

SHOKU ENVER HOXHA: E po mirë xha Mehmet,

gëzohem shumë që nuk je fort keq nga të parët. Ky është djali që shkoi ushtar dhe që e martove tani?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Ky është, ndërsa kjo këtu është nusja e tij.

SHOKU ENVER HOXHA: Nga është nusja?

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Nga Zaloshnja.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe këtë prapë nga Skrapari e paske. Po xha Novruzi¹ mbahet mirë me shëndet? Sa vjeç vajti?

*SHOKU HILMI MYSLIMI*²: Mirë është, vajti rreth 70 vjeç.

SHOKU ENVER HOXHA: Po xha Mehmeti sa vjeç është?

SHOKU HILMI MYSLIMI: Ai është 90, kurse babai thotë se është 100 vjeç.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është raki Skrapari, e fortë dhe e mirë.

SHOKU MEHMET MYSLIMI: E mirë është, prandaj shkunde një herë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti, xha Mehmet, thua se nuk shikon mirë nga sytë, kurse gotën time e pe që qenka plot. Këto gjëra i shikon ti, domethënë, sytë i paske mirë.

Unë dua ta ngre këtë gotë si atëherë në kohën e luftës në Helmës. Mirë se të gjeta, xha Mehmet, pleqëri të bardhë, të rrojë Partia, të të rrojnë djemtë, nuset, nipërit e mbesat dhe gjithë të dashurit e zemrës! Për shëndetin tuaj shokë! Gëzuar!

1. Novruz Bilimani, nga Helmësi.

2. Djali i xha Mehmetit.

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Ju faleminderit shumë! Për shëndetin Tuaj, shoku Enver!

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit, gëzuar!

Bashkë me mua kanë ardhur këtu Kahreman Ylli, Mane Nishova dhe shumë shokë të tjerë të nderuar të Skraparit. Para se të nisesha nga Tirana, këta më thanë se donin të vinin të tërë te xha Mehmeti.

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Po Nexhmija pse nuk erdhi këtu?

SHOKU ENVER HOXHA: E mbajtën gratë në Çorovodë, do të kthehet ca më vonë në Berat.

(*Duke iu drejtuar djalit të xha Mehmetit.*) Po ti çfarë kategorie ke marrë në punë?

SHOKU HILMI MYSLIMI: Tani për tani kam marrë kategorinë e tretë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti mund të marrësh shumë mirë edhe të katërtën, bile edhe më lart, se je i ri. Prandaj puno edhe ca më shumë, futu në garë me të tjerët për kualifikimin personal.

SHOKU MEHMET MYSLIMI: Sot do të rrini këtu të hamë drekën së bashku, ashtu partizance si dikur.

SHOKU ENVER HOXHA: Me gjithë qejf xha Mehmet, po sot nuk mundem, se më presin punëtorët e kombinatit në Berat dhe ata të naftës në Qytetin Stalin. Do të vij prapë një herë tjetër. Unë e kuptoj që juve ju vjen mirë të rri, kjo edhe mua më pëlqen, por punëtorët më presin. Kur erdha në Skrapar, u thashë shokëve se nuk do të largohem pa i bërë një vizitë në shtëpi edhe xha Mehmetit, përpara se të shkoj në Berat.

Mirupafshim! Jetë të gjatë e pleqëri të bardhë! Të të rrojnë gjithë të dashurit e zemrës! Të të rrojnë fëmijët! Qofshi mirë dhe mbetshi me shëndet!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim, që gjenden në AQP*

TË PUNOJMË ME KUJDES PËR MË SHUMË NAFTE

*Nga biseda me disa drejtues të sektorit të naftës
në Qytetin Stalin*

30 nëntor 1971

Këto ditë, siç e keni dëgjuar, isha në Skrapar, ku m'u bë një pritje shumë e zjarrtë nga ana e popullit, që shpërtheu në një entuziazëm të madh revolucionar dhe në gëzim të papërshkruar. Meqenëse kalova nga Berati, mendova të ndalesha e të takohesha ca me shokët e sektorit të naftës, se bëhet ç'bëhet, për çdo vepër që ndërtojmë, të gjithë kërkojnë naftë.

Kur bisedova me shokët e Qeverisë, mos kishim tani vonë ndonjë gjë të re në fushën e kërkimeve të naftës e të gazit, ata më thanë se shumë të dhëna të mira ka kohët e fundit për naftën dhe unë besoj se më të mira do të jenë perspektivat e saj. Por çështja është se disa prej këtyre të dhënave nuk janë konkretizuar akoma.

Shokët më gëzuan edhe me lajmin për zbulimin e minierës së kripës, pse kjo ka rëndësi të madhe për zhvillimin e industrisë sonë kimike, po kur më njoftuan për pusin e naftës që doli në Sarandë u gëzova

edhe më shumë. Megjithatë, mua më ka mbetur maraz që s'kemi zbuluar dot naftë andej nga Ardenica. Unë mendoj se atje duhet të ketë, në mos naftë, gaz. Sigurisht, ju i njihni dhe i gjykoni më mirë këto probleme, se jeni specialistë në këtë fushë, prandaj kjo që them unë mbase është vetëm një dëshirë, por më ka mbetur mendja për arsye se shenja nafte aty përreth ka pasur. Shenja kemi pasur edhe në Bubullimë ku na ndodhën avaritë që dimë dhe nuk kemi pasur ndonjë gjë të re. Megjithatë, prapë ka plot vende ku ne duhet të punojmë për të pasur rezultate në këtë fushë të rëndësishme të ekonomisë.

Pasi u vu në dijeni rreth disa të dhënave të reja, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Shfrytëzimin duhet ta bëjmë kurdoherë sa më të bazuar, që naftën të mos e lëmë në shtresa dhe të na ndodhin pastaj gjëra jo të mira. Në shtresat ku ju keni gjetur vetëm mbeturina të naftës, do të thotë se nafta ka ikur. Sipas strukturës së këtyre shtresave, nga mund të ketë ikur nafta, nga lindja apo nga ndonjë drejtim tjetër? Këtë e them duke u nisur nga të dhënat që dëgjojmë, sipas të cilave thuhet se gjatë Adriatikut mund të ketë naftë nën det. Sigurisht këto janë arsyet që kërkojnë në det edhe jugosllavët, edhe italianët. Do të vazhdojmë në të bëjmë studime për zonën e detit? Vazhdojeni punën për shpimin e shtrembër, por krahas kësaj përgatituni edhe për shpimin e drejtë në det. Të ndjekim të dyja rrugët. Këto janë sipërfaqe të sigurta brenda ujërave tona territoriale.

Në qoftë se specialistët tanë arrijnë të zotërojnë mirë gjendjen nga ana gjeologjike, atëherë na mbetet

të vërtetojmë shkallën e perspektivës së këtyre brezave, sepse ky është një studim shumë i avancuar, që do të thotë se kufijtë nuk janë të mbyllur, ata janë të zgjeruar dhe nuk janë në një rrip të ngushtë. Mund të dalin edhe pika të tjera. Sikur të ndeshen të gjitha këto struktura, do të ishte një gjë e madhe. Gjithashtu të kemi parasysh gjatë shfrytëzimit të puseve edhe çështjen e ujërave, që pusët të mos na përmbysten para kohe.

Në Byronë Politike kemi theksuar detyrën që shoqërit e sektorit të naftës ta njohin gjendjen dhe të bëjnë përpjekje për ta shtuar sasinë e naftës, por jo duke i shfrytëzuar pusët në mënyrë joracionale, duke shkaktuar prishjen e shtratimeve. Duhet të keni kujdes që të mos sforcohen vendburimet. Të huajt na thoshin se ka shumë naftë dhe oburra merrni. Ata na dëmtuan rëndë, prandaj ky është një mësim për ne. Në pusët e vjetra që janë këtu, në Qytetin Stalin, a vazhdon të grumbullohet naftë, se, megjithëse janë të vjetra, ato diçka japin. Mua më preokupon shumë çështja e prejardhjes së naftës këtu. Si shpjegohet kjo?

Po me gazin si është puna? Në të ardhmen ne do të kemi nevoja kolosale për të. Tani që i hapen perspektiva të mëdha industrisë sonë dhe rafineria e Ballshit është duke u ndërtuar, duhet të bëjmë përpjekje që të kemi edhe rezerva të vazhdueshme naftë dhe gazi. Pastaj është edhe çështja e zhvillimit të petrokimisë. Këto janë detyra të rëndësishme, pse gazi do të na duhet edhe për industrinë që do të ndërtojmë, për ngrohje e për të gatuar në familje, si dhe për shumë nevoja të tjera. Siç e pranoni dhe vetë, gazi ishte lënë ca pas dore, pse tërë kujdesin ia kishit kushtuar naftës. Do-

methënë, tani, për sa i përket gazit, perspektiva nuk është e keqe. Është e mundur të zbulojmë fusha të tjera gazi?

Eksperimentimet që po bëhen, duhet të japin rezultat, se kur specializohen njerëzit, do të pyesin pse iku e qysh iku nafta, mbasi çdo e dhënë dhe shenjë në gjeologji ka domethënien e vet. Atëherë mund të priten edhe rezultate konkrete. Nevojat që kemi në këtë sektor, i studioni me kujdes që pastaj të gjejmë rrugët për t'i plotësuar ato.

Është arritur të bëhet diçka më mirë se gjer tani transportimi i kullave? Po kuadrot përparojnë në punë? E kam fjalën më shumë për kuadrot e rinj që ju jepen nga universiteti. Janë të mjaftueshëm për ju? Po teknikumet që keni, punojnë mirë? Venë në to djemtë dhe vajzat e punëtorëve? Afërsisht, sa merrni në vit nga ata që mbarojnë shkollat mekanike me shkëputje dhe pa shkëputje nga puna? Po kurset i shkallëzoni ndonjë çikë? Dua të them se me ata që vazhdojnë këtë vit një kurs, vitin tjetër a e organizoni punën në kurse për t'u bërë mësim të tjera të një niveli më të lartë, në mënyrë që të rritet kategoria e kualifikimit të tyre? Nuk e kam fjalën për të rritur kategorinë vetëm si rrogë, por në radhë të parë nga ana e profesionit, që të japin rendiment më të madh në prodhim. Natyrisht, duhet pasur parasysh patjetër edhe stimuli material, por në radhë të parë të bëjmë më shumë për stimulin moral.

Ju dhe tani më folët vetëm për naftën. Natyrisht, keni dijeni edhe për sektorët e tjerë që kanë lidhje me të, po unë mendoj që për gjërat që ju dalin në rrugë,

edhe ju duhet t'u jepni sinjalizim apo ndihmë sektoreve të tjerë.

Duhet ndjekur nga ju edhe simpoziumet ndërkombëtare për naftën dhe temat e ndryshme që zhvillohen në mbledhje të kësaj natyre, se të tjerët nuk kanë fare ide çfarë bëhet në vendin tonë. Sidomos shokët e Institutit të Naftës duhet të jenë të lidhur në këtë mënyrë edhe me studimet, edhe me praktikën.

Shpresat për nxjerrjen e naftës, si për planin pesëvjeçar edhe për një të ardhme më të largët, siç duket, janë të mira. Sigurimi i rezervave tani është kryesorja, pse nafta për ne është një pasuri kolosale. Duhet të mendojmë, shokë, se çfarë do të bënim, sikur të mos kishim naftë. Lidhur me shifrat, qëndroni me ato që janë fiksuar në planin pesëvjeçar të përpiluar më parë, apo keni menduar t'i shtoni ndonjë çikë akoma?

Ne kemi nevoja të mëdha për naftë, sidomos nga kërkesat më të mëdha që do të kemi në sektorin e bujqësisë. Por, këto nevoja duhet t'i plotësojmë në mënyrë të harmonizuar. Të kujdesemi që t'i shfrytëzojmë si duhet rezervat dhe të mos lëmë brenda sasi të konsiderueshme të tyre.

Nevojat tona për naftë, siç e thashë, janë shumë të mëdha, pse të gjitha veprat e reja që ndërtojmë, kërkojnë naftë. Prandaj të punojmë me shumë kujdes në këtë sektor me rëndësi kaq të madhe për ekonominë tonë socialiste.

Mirupafshim!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

PRODHIMET E TEKSTILIT TË JENË TË BUKURA, TË QËNDRUESHME, JOUNIFORME

*Nga biseda me kuadro dhe punëtorë të dalluar
të Kombinatit të Tekstileve në Berat*

1 dhjetor 1971

Jam gëzuar shumë kur dëgjova për sukseset që keni arritur. Erdha edhe këtu te ju se, kur takohemi me shokët e prodhimit dhe dëgjojmë mendimin e klases punëtore, marrim forca të reja për punë. Me këtë rast mund të më bëni një pasqyrë të situatës në kombinat, të përparimeve që janë arritur gjatë këtyre viteve të fundit në ngritjen e nivelit teknik të punëtorëve që reflektohet në shtimin e asortimenteve; si i keni kapërcyer vështirësitë e pengesat e ndryshme që ju kanë dalë përpara në rrugën tuaj; për çështjen e disiplinës në punë; si punon Partia etj.

Pasi drejtuesit e kombinatit e informuan shkurtimisht për gjendjen dhe rezultatet e arritura në punë, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Për sa i përket kualifikimit të punonjësve, me sa po shoh, ju jeni në pararojë dhe kjo më duket mua vjen se këtu ka më shumë gra, gjë që do të thotë se ato punojnë më mirë nga burrat.

*SHOKU GAQO NESHO*¹: Kjo është e vërtetë, gratë e vajzat janë më të kujdesshme se burrat.

SHOKU ENVER HOXHA: Kështu mendoj edhe unë. Edhe në fabrika të tjera ku ka gra dhe që kanë një kohë të gjatë, kështu punojnë. Mbase gaboj, po ky është mendimi im, gratë punojnë më mirë. Le të më korrigjojnë burrat.

*SHOKU KRISTAQ DOLLAKU*²: Këtu ne kemi hapur edhe filialin e universitetit për tekstile, për mekanikë dhe për ekonomi. Vitin e ardhshëm mendojmë të hapim edhe një degë për kimi.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë këtu kemi filialet e tekstitit, të mekanikës, të ekonomikut dhe do të kemi edhe atë të kimisë. Kur hodha para disa kohe një fjalë për këtë çështje, shokët nuk thanë jo, por ngritën supet, domethënë, e aprovuan si me dyshim këtë çështje. Kurse tani, siç po thoni ju, këtë gjë e kërkoi vetë situata. Për të sjellë kuadrot nga Qyteti Stalin, që duan të ndjekin studimet në degët që funksionojnë këtu, rrethi duhet të sigurojë autobusë.

Kur mendoni t'i plotësoni me mekanikë të mesëm të gjitha nevojat tuaja? Shkoni me plan në këtë drejtim?

SHOKU KRISTAQ DOLLAKU: Po, me plan shkojmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ngjyrat e stofrave që prodhoni këtu a janë të qëndrueshme?

SHOKU KRISTAQ DOLLAKU: Ato copa që janë

1. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Beratit.

2. Në atë kohë, drejtor i Kombinatit të Tekstileve në Berat.

me katrore janë të qëndrueshme. Vështirë e kemi më shumë me ato që janë njëngjyrëshe.

SHOKU ENVER HOXHA: A vijnë këtu të punojnë ata që mbarojnë shkollën e arteve?

SHOKU KRISTAQ DOLLAKU: Ndonjëherë, jo gjithmonë. Ne nuk kemi piktorë që të kenë mbaruar shkollën e arteve, por vetëm disa amatorë.

SHOKU ENVER HOXHA: Jo, ju këtu duhet të keni piktorë me shkollë, të cilët të bëjnë piktura të bukura në stofrat që prodhoni.

Po shoh se damasku juaj është shumë i bukur, më i mirë se ai i jashtmi.

Po këto që po shoh këtu, nuk i keni prodhuar akoma?

SHOKU KRISTAQ DOLLAKU: Do t'i prodhojmë vitin që vjen. Janë për bluza grash.

SHOKU ENVER HOXHA: A e merrni opinionin e grave për prodhimet e kombinatit?

SHOKU KRISTAQ DOLLAKU: Janë organizuar konsulta në Tiranë dhe në rrethe të tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Në këtë çështje duhet shumë kujdes, pse është diçka e komplikuar dhe mund të biem në subjektivizëm. Ne duhet të kemi një-rëz specialistë që të dinë t'i zgjedhin mirë gjërat, që çdo prodhim t'i përshtatet gustos së popullit, se ka disa që në kërkesat e tyre nisen nga gustot vetjake. Po të veprohet kështu, duhet të dalim nga çatia; gustot e secilit nuk ka si plotësohen, kjo bile është e pamundur. Për vendin tonë, me popullsi të vogël, nuk është e rekomandueshme që një kombinat të bëjë me qindra e mijëra asortimente. Prodhime të një llojshmë-

rie të madhe mund të bëjnë kombinatet e vendeve të tjera, pse kjo siguron atje evadimin e tyre. Te ne përdorimi i bojërave e i disenjove, sipas një game të madhe, ngre koston e prodhimit, prandaj ne të mos ushqejmë gustot individuale. Prodhimet tona tekstile duhet të jenë të qëndrueshme, masive, të bukura dhe me diversitet, jouniforme. Prandaj, në konsultat që organizohen, natyrisht, ne t'i dëgjojmë edhe ata që kanë gustoto të përparuara, por më shumë të dëgjojmë gratë dhe popullin që do të vishet.

Kombinati juaj luan një rol të rëndësishëm, ashtu si dhe ndërmarrjet e industrisë ushqimore. Ju duhet të krijoni gustoto të shëndosha dhe t'i impononi ato, t'i edukoni njerëzit me frymën e ngjyrave tona, që t'u përshtaten ambientit, gëzimit, entuziazmit dhe pjekurisë së moshave të njerëzve tanë. Dëgjojmë se shumë njerëz nuk i hanë zarzavatet. Atëherë të lidhim duart ne për këtë dhe oburra, makarona dhe oriz? Jo! Përkundrazi, të punojmë që t'i hanë medoemos se ato kanë lëndë ushqimore të domosdoshme për trupin e njeriut. Kështu mund të thuhet edhe për shumë gjëra të tjera, edhe për prodhimet tuaja. Prandaj, të krijojmë gustoto të shëndosha për çdo gjë. Edhe këtu në kombinat duhet të krijojmë gustoto tona, t'i dëgjojmë njerëzit, po t'i mësojmë që të ecin me pikëpamjet përparimtare e jo në mënyrë mekanike, që të realizojnë planin si global, pa le të mbeten prodhimet në raft. Qëllimi kryesor është që ato t'i blejë populli dhe të plotësojë nevojat e veta gjithnjë e më mirë.

SHOKU KRISTAQ DOLLAKU: Lidhur me asortimentet ne duhet të futim në përdorim sa më gjerë

fijet, fibrat sintetike. Tani kemi filluar provat e para dhe janë prodhuar disa mostra.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa është përqindja e fibrës në to?

SHOKU KRISTAQ DOLLAKU: Është 50 për qind. Kemi prodhuar 500 metra dhe presim që njerëzit të na bëjnë vërejtjet e tyre.

SHOKU ENVER HOXHA: Këto janë në bazë celuloze apo në bazë teritali?

SHOKU KRISTAQ DOLLAKU: Këto janë në bazë celuloze.

SHOKU ENVER HOXHA: Kam dëgjuar që teritalin jashtë e gjejmë me zor. Sidoqoftë ai është më me leverdi se pambuku.

Stofrat që sjellim nga jashtë e që janë të përziëra, pambuk e terital ose celulozë, janë më të lira, kur përqindja e pambukut është më e vogël. Kurse ne, po të vëmë, për shembull, 70 për qind pambuk, mendoj se është shumë. Stofrave të jashtme mos u shikoni reklamën kur thonë «puro lana», pse, në fakt, ato janë artificiale. Kuvertat e bukura që prodhoni ju këtu janë qind për qind me pambuk. Po sikur të futni në to edhe ca fije artificiale, sigurisht, që do të dalin më të lira e më të forta; ato edhe të ngrohtët e mbajnë më mirë edhe për të rrojtur rrojnë më shumë. E shihni, pra, se ka shumë arsye ta marrim këtë masë.

SHOKU KRISTAQ DOLLAKU: Krahas rritjes së kolektivit neve na dalin këtu dhe mjaft probleme shoqërore, për jetën e njerëzve etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju e keni fjalën për banesat.

SHOKU KRISTAQ DOLLAKU: Me banesat pak a shumë po rregullohemi, por e kam çështjen më shumë se po shtohen familjet e reja, po lindin fëmijë, numri i të cilëve tani arrin në rreth 400.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është një gjë që duhet t'ju gëzojë shumë.

SHOKU KRISTAQ DOLLAKU: Çështja është se kur fëmijët janë të vegjël deri në 10 muaj punëtoret nuk punojnë dot me turne. Për t'u ardhur në ndihmë grave me fëmijë të vegjël mendojmë ta zgjerojmë repartin ditor që prodhon artikuj të imët me mbeturinat e tekstileve, si veshje për fëmijë etj.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo punë veç duhet të organizohet mirë, që prodhimet të dalin të mira dhe të shiten. Të mos ndodhë si në kombinatin e tekstileve «Stalin» që të tilla prodhime nuk i zinte njeri me dorë dhe mbeteshin stoqe.

SHOKU KRISTAQ DOLLAKU: Kemi pastaj edhe largimet e punëtoreve jashtë rrethit për arsye martesë. Prandaj mendojmë të ndihmohemi për të na u zgjidhur këto dy probleme.

SHOKU ENVER HOXHA: Shih si vjen kjo punë! Kur drejtori juaj punonte në ministri, nuk i aprovonte këto kërkesa. Tani ai thotë se nuk dalim dot po të mos na zgjidhen këto probleme. Ja çfarë do të thotë kur vjen njeriu në bazë dhe e njeh konkretisht situatën.

Pasi këmbyen mendime edhe për probleme të tjera, si për banimin, ngritjen e shoqeve në përgjegjësi e pranimet e tyre në Parti, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Ju e kuptoni rëndësinë e madhe që ka ky kombi-

nat për ekonominë e vendit, në radhë të parë për veshjen e popullit, po edhe për eksport. Prandaj ju duhet të luftoni shumë për cilësinë dhe bukurinë e prodhimeve, e, sa të jetë e mundur, ato të jenë edhe të lira. Kolektivin e keni shumë të mirë. Mbështetuni te gratë, shoqe dhe shokë, jepuni përgjegjësi dhe të jeni të sigurt se ato do t'i kryejnë më së miri detyrat. Në bazë të qëndrimeve e të përpjekjeve të tyre i pranoni edhe në Parti. Partia duhet të bëjë përpjekje edhe për zgjidhjen e detyrave të veçanta që dalin për punëtorët e reja të ardhura në kombinat, që të zgjidhin, sa të jetë e mundur më shpejt e më mirë, nevojat e tyre, që të punojnë, të mësojnë e të jetojnë si duhet. E kuptojmë që ka edhe vështirësi, po duhet të bëhen përpjekje më të mëdha për të përmirësuar disa pika të dobëta që ekzistojnë, siç është çështja e strehimit, çështja e lehtësive në punë të nënave me fëmijë të vegjël dhe të tjerë. Por, nga sa po shoh, edhe me këto po ecet çdo vit e më mirë.

Ju uroj suksese! Të rrojë Partia, të rrojë klasa punëtorë!

Pas këtij takimi, shoku Enver Hoxha vizitoi disa reparte të kombinatit, ku u takua e bisedoi nga afër me punëtorë e punëtorë, për probleme të ndryshme të punës e të jetës së tyre.

Së fundi, duke vizituar repartin ditor që nxjerr prodhime me mbeturinat e tekstileve, shoku Enver Hoxha tha:

Të mira qenkan, po rëndësi ka që të blihen nga populli e të mos na mbeten stoqe. Prandaj të punohet me kujdes, bukur dhe me gusto.

Mirupafshim, shokë të dashur! Ju uroj suksese të mëtejshme në punë për realizimin e detyrave që ju janë ngarkuar!

Të rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
vizitë, që gjenden në AQP*

KOMUNISTËT TË BËJNË DURIM E TË JENË NË BALLE EDHE NË FATKEQËSI

Nga biseda me Heroin e Popullit, Zylyftar Veleshnja

1 dhjetor 1971

SHOKU ENVER HOXHA: Si të kam me shëndet shoku Zylyftar? Jeni të gjithë mirë? Na erdhi shumë keq për atë që ju ndodhi papritur, për vdekjen e djalit.

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: Ai ishte komunist dhe nuk i përkiste vetëm familjes.

SHOKU ENVER HOXHA: Na vjen shumë hidhur kur njerëzit vdesin në moshë kaq të re. Po ju shëndoshë e të rrojnë fëmijët. Kjo është vajza e tij?

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: Po. Ja dhe nusja!

SHOKU ENVER HOXHA: Pa hajde një çikë të xhaxhi Enver! O sa vajzë e mirë qenke ti! Si të quajnë?

VAJZA: Shqiponja.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa emër të bukur që paske, Shqiponja!

Po si ke qenë me shëndet Zylyftar, të nget ndonjë çikë astma?

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: Nuk po më lë të marr frymë. Edhe në gjumë më shqetëson. Kam një vit që nuk lëviz dot.

SHOKU ENVER HOXHA: Të kanë dhënë ndonjë gjë mjekët për të përdorur?

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: Më kanë dhënë kura dhe po i bëj, por nuk shikoj ndonjë përmirësim të madh.

SHOKU ENVER HOXHA: More Zylyftar! U thashë edhe shokëve, po sikur të ngrihesh këtej e të vesh të qëndrosh në Sarandë. Mund të të bëjë mirë.

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: Edhe doktorët më kanë thënë të vete në Vlorë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po mirë, makar në Vlorë, ku të jetë më mirë. Pa bisedo me doktorët qoftë edhe për në Vlorë, por ma ha mendja se do të jetë më mirë për ty Saranda, ku është më nxehtë. Për sa i përket lagështirës bëjmë përpjekje të të gjejmë një apartament larg detit. Mua më duket se është më mirë atje, prandaj shikoje këtë çështje. Edhe Myslimi (Peza) kështu është si ti. Edhe atij i thashë të shkojë në Sarandë, po nuk desh. Unë kështu mendoj, ta shikosh një herë çështjen e Sarandës, këshillohu edhe me mjekët.

Klima e Skraparit nuk është e përshtatshme për ty, prandaj shko një herë nja dy muaj në Sarandë dhe po e pe veten që je më mirë ngul gunën atje. Mund të të gjejmë një shtëpi komode, që të mos ketë shkallë. Edhe për zemrën bën mirë të ecësh nga pak, por jo të ngjitesh shkallëve, të ecësh në shesh¹.

1. Shoku Zylyftar Velešnja e dëgjoi këshillën e shokut

Dalim një herë në fotografi, se nuk të kishim as në Skrapar. Na erdhi keq që nuk munde të vije. Ne i kaluam shumë mirë festat e Nëntorit, në mes të popullit të Skraparit, ku ti je rritur dhe ke luftuar.

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: Popullit i detyrohem, Partisë dhe Juve, shoku Enver.

SHOKU ENVER HOXHA: Populli i Skraparit është popull trim, i thjeshtë dhe i urtë.

Vdekja e djalit na hidhëroi të gjithë shumë, por mos u dëshpëro, se nuk ke ç'bën. Jeta kështu e ka, pastaj ti na ke të gjithë ne djema. Ty të të rrojë vajza, të rroni vetë, të rroni të gjithë ju.

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: Faleminderit. Skrapari shkon mirë tani.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë shkon, brenda pesë vjetëve ka bërë një goxha kërcim përpara, realizoi bukën. Tani do të shikojmë një çikë më mirë çështjen e ujitjes se mos bëjmë ca më shumë nga sa parashikon pesëvjeçari. Siç më shpjeguan shokët, në Tomoricë, Potom dhe në disa kooperativa të tjera, po të kenë ca më shumë ujë, mund të ujitin sipërfaqe toke më të madhe nga ajo e tanishmja. Për Skraparin nuk është detyrë vetëm të bëjë bukën, por të zhvillojë edhe blegtorinë. Kooperativat atje marrin akoma pak qumësht nga lopët, nga 300 litra për kokë. Mirëpo Vërzhezha, që mbjell misër, merr 1 200 litra qumësht në vit nga një lopë. Prandaj del detyrë që të shtohet me doemos ushqimi i kafshëve.

Enver Hoxha dhe në nëntor të vitit 1972 shkoi në qytetin e Vlorës, ku banoi derisa vdiq më 27 gusht 1977.

Edhe pemëtaria duhet të zhvillohet më tej në Skrapar.

Këto janë sektorët kryesorë të ekonomisë që u duhet vënë rëndësi atje: të shtohen drithërat, prodhimet blegtorale dhe pemëtaria. Pastaj, çfarë mund të na nxjerrë nëntoka, është tjetër gjë.

Shqiponjë, do të vish një çikë te xhaxhi Enver! Hajde, ulu këtu në pëqi! O, sa vajzë e mirë që je ti! Dale të të japë xhaxhi Enver një mollë, po ta qërojmë më parë. Kur të vish në Tiranë, mos harro të vish në shtëpinë time.

SHQIPONJA: Nuk harroj, jo.

SHOKU ENVER HOXHA: E do shumë babagjyshin?

SHQIPONJA: E dua.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë! Babagjyshi yt është një nga trimat më të shquar të Shqipërisë dhe të Partisë, prandaj ta duash shumë, pse ashtu e do edhe Partia, shumë. Ashtu vajzë e mirë. Sa vjeç është vajza?

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: 4 vjeç.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë. Mos ik, dale ta hamë një herë të gjithë mollën, pastaj largohu.

Ky është djali i madh?

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: Jo, ky është i dyti, punon arsimtar në Uznovë.

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo duhet të jetë vajza jote e vogël. Ku je ti?

VAJZA: Unë vazhdoj gjimnazin. Jam në vitin e tretë.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë, të zë shko-

lla 12-vjeçare. Përpiquni të jeni, në radhë të parë, në vijën e drejtë të Partisë. Po të jetë njeriu në vijën e drejtë të Partisë, të gjitha të tjerat pastaj shkojnë mirë, mësimi, vullneti, ndershmëria, sjellja, të gjitha. Edhe vështirësitë kapërcehen në mënyrë të shkëlqyer.

Më jepni një fotografi të djalit ta shikoj një çikë. Duhet ta bëjmë zemrën të fortë, ta ruajmë kujtimin e tij dhe të ecim përpara. Jeta i ka këto.

Tani përpjekjet bëhen që njerëzve të mos u ndodhin fatkeqësi të tilla për vete, se për ata që mbeten pas, rrethin, tërë shoqërinë, kujdesi dhe ndihma nuk mungojnë, për të mos e ndier hidhërimin.

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: Partia na i ka siguruar të gjitha.

SHOKU ENVER HOXHA: Ti ke bërë shumë për Partinë, nuk ke kursyer asgjë për të.

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: Edhe djali që vdiq ishte i Partisë, agjitor i saj, me librin e Partisë në dorë shkonte kudo.

SHOKU ENVER HOXHA: Nuk pati mundësi të evitohet fatkeqësia?

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: Korrenti në vendin ku punonte kishte 6 000 volt tension, kurse pinçat, me të cilat ai kapi telin ishin për 500 volt.

SHOKU ENVER HOXHA: Siç shihet në fotografi, ka pasur trup kolosi. Po, të rrojë Partia, të rroni ju me vajzën!

NUSJA: Të rroni Ju sa malet!

SHOKU ENVER HOXHA: Kjo është vajza tjetër? Në ç'klasë është?

VAJZA: Jam maturante.

SHOKU ENVER HOXHA: Qenke si vajza ime.

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: Ju them të gjithë fëmijëve që të bëhen të gjithë me zanate po njëkohësisht edhe agjitorë. Nuk ka zanat pa politikë në vendin tonë.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, ashtu është, siç thotë babai. Po të mos jetë politika e Partisë, nuk kemi gjë dhe mund të shkojmë në rrugë të gabuar. Po të mos jetë politika dhe ideologjia jonë, njerëzit bëhen fodullë, i shikojnë të tjerët nga lart.

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: Kjo tjetra është vajza e madhe, laborante dhe komuniste. Kam gjashtë komunistë në familje.

SHOKU ENVER HOXHA: E paske shtëpinë plot. Të të rrojnë! Ke gjashtë komunistë, domethënë, një celulë në shtëpi. Por, tani ju ndodhi një fatkeqësi. Këtë, si komunistë, duhet ta kapërcejmë, se komunistët janë i atillë brumë që jetën nuk e shohin dhe nuk e bëjnë kurdoherë me lule. Luftë e vështirësi është jeta jonë, ca bien e ca ngrihen, ka edhe ndonjë moment qetësie, po komunistët duhet të jenë kurdoherë në ballë dhe, kur u ndodh ndonjë fatkeqësi, të bëjnë durim. Pa shiko, pra, plot e ke shtëpinë.

Tani më lejoni të shkoj. Jam i lumtur që të takova.

SHOKU ZYLYFTAR VELESHNJA: Pse nuk ma solle Nexhmijen?

SHOKU ENVER HOXHA: Nexhmija më porositi të të kërkoj ndjesë në emër të saj që nuk pati mundësi të vinte dot.

(Duke u përshëndetur me bashkëshorten e djalit të Zylyftarit që vdiq.) Të të rrojnë vëllezërit, nëna, vajza dhe gjithë të afërmit!

Mbetshi me shëndet! Ta kini kujdes Zylyftarin!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP

QËLLIMI YNË: TË MBROJMË INTERESAT E REVOLUCIONIT

*Nga biseda me një delegacion qeveritar ekonomik
të RP të Kinës*

11 dhjetor 1971

Pasi u përshëndet me të gjithë anëtarët e delegacionit, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

U gëzua kur morëm vesh lajmin që ju do të vinit në Shqipëri. Ardhja juaj ndikon në forcimin e marrëdhënieve vëllazërore ndërmjet dy vendeve tona.

Në përgjithësi ndihmën që na është dhënë nga Republika Popullore e Kinës ne e vlerësojmë. Ajo është në interes të të dyja palëve. Ndërtimi i socializmit kërkon që të dy vendet tona të lidhen sa më ngushtë me njëri-tjetrin, sepse kështu do të korrin vazhdimisht fitore. Ne e kemi të qartë se gjatë rrugës për në socializëm kemi hasur dhe do të hasim vështirësi. Kjo është e kuptueshme dhe ndryshe nuk mund të ngjasë. Kush mohon këtë, ai ka mohuar luftën e klasave, e cila do të vazhdojë gjatë. Armiqtë e klasës, qofshin këta të jashtëm apo të brendshëm, do të na nxjerrin patjetër pengesa, por jemi të bindur se, mbi bazën e marksizëm-

-leninizmit, çdo vështirësi e pengesë që të na dalë, do ta kapërcejmë me sukses.

Partia jonë, e udhëhequr nga mësimet e marksizëm-leninizmit, ka arritur të krijojë në njerëzit tanë një botëkuptim të tillë, sipas të cilit problemet e dy vendeve tona, e përgjithësisht të gjitha problemet e revolucionit dhe të socializmit kudo në botë, fitoret dhe dështimet politikisht i konsiderojmë si probleme të përbashkëta. Ky botëkuptim na bën që t'i ndiejmë si tonat hallet e vështirësitë e partive marksiste-leniniste e të lëvizjes revolucionare ndërkombëtare, ashtu siç i ndiejnë edhe ato vështirësitë tona. Kjo ndjenjë që karakterizon partitë marksiste-leniniste, lind vetëm se pikëpamjet e tyre janë të njëjta, ato udhëhiqen nga parimet e marksizëm-leninizmit.

Ne i japim rëndësi të madhe unitetit dhe, në radhë të parë, unitetit politik dhe ideologjik, sepse ai përbën forcën tonë të pamposhtur. Ndihma në e madhe që ne i japim shoku-shokut është lufta politike dhe ideologjike që bëjmë kundër imperializmit, revizionizmit, borgjezisë dhe gjithë reaksionit botëror. Nga ana e Partisë sonë janë vënë të gjitha forcat në këtë drejtim kryesor, vendimtar, por fakt është, dhe këtë nuk e themi për modesti, se pesha e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare për çështjen e revolucionit nuk mund të jetë si ajo e Kinës së madhe.

Ne gëzohemi që potenciali ekonomik dhe ushtarak i Republikës Popullore të Kinës rritet gjithnjë e më shumë, gjë që do të bëjë të shkatërrohen planet e forcave imperialiste, socialimperialiste e reaksionare në arenën ndërkombëtare.

Autoriteti i një shteti si Kina nuk mund të mbahet dhe nuk mund të ushtrojë një influencë të madhe pozitive në botë në qoftë se ajo nuk jep prova, në qoftë se nuk mban një qëndrim konsekuent në favor të revolucionit dhe të luftërave nacionalçlirimtare. Influenca e Kinës do të jetë në rritje vetëm në sajë të luftës së madhe, të ashpër e të vazhdueshme, kurdoherë kreshendo, që duhet të zhvillojë ajo kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye, dhe kundër të gjitha forcave të tjera reaksionare borgjeze në botë. Sa më e fortë të jetë partia, sa më tepër unitet të ketë ajo në radhët e saj, sa më drejt të zbatojë në jetë normat e marksizëm-leninizmit dhe vijën marksiste-leniniste, aq më të fortë janë uniteti i saj me popullin dhe simpatia e respekti që gëzojnë popujt e botës për të dhe aq më e pamposthur bëhet ajo.

Me një impuls të madh vazhdon ndërtimi i socializmit te ne. Në këtë drejtim Shqipëria ka arritur suksese të mëdha në ekonomi, në industri, në modernizimin e bujqësisë socialiste, në mbrojtjen e atdheut, në arsim e në kulturë dhe në të gjitha fushat e tjera të jetës. Ne kemi filluar nga nivele shumë të ulëta të zhvillimit ekonomik e kulturor, kurse sot kemi arritur në nivele mjaft të përparuara, për arsye të asaj force të madhe që i jep hov ndërtimit të jetës së re, ideologjisë marksiste-leniniste, politikës së drejtë të Partisë sonë.

Ne, komunistët dhe populli shqiptar, e ndiejmë me zemër, e kuptojmë dhe e vlerësojmë si një detyrë të madhe revolucionare, internacionaliste ndihmën mate-

riale që Kina, me mundësitë e saj, i jep Shqipërisë. Ajo ndihmon edhe popuj të tjerë të botës, por në mënyrë të veçantë duhet të ndihmojë popullin shqiptar që lufton krah për krah me popullin kinez kundër imperia- lizmit, me atë amerikan në krye, dhe kundër revizio- nizmit modern, me atë sovjetik në krye.

Në këtë kuadër, në prizmin internacionalist, e kup- tojmë ne problemin e ndihmës që na jepni, që ajo t'i shërbejë misionit tonë të përbashkët, fitores së revolu- cionit. Kështu e kuptojnë dhe e ndiejnë këtë ndihmë të Kinës Partia jonë, Qeveria jonë, mbarë populli ynë, prandaj ne luftojmë që ajo të shfrytëzohet mirë dhe deri në fund në interes të revolucionit, të çështjes sonë të përbashkët. Kjo do të thotë se për ndërtimin e kësaj ose asaj vepre në Shqipëri, nga ana jonë duhet të derdhet djersë, duhet punuar me të gjitha forcat dhe me ndërgjegje të lartë. Politikisht dhe ideologjikisht populli dhe Partia jonë të qëndrojnë lart, që radhët tona të jenë në një unitet të çeliktë, që Shqipëria të bëhet një kështjellë e fuqishme e socializmit, sepse ve- tëm kështu do të mund të vazhdojë frontalisht, me rezultate të mëdha, luftën kundër armiqve të përbash- kët të çdo lloji.

Natyrisht, në ndërtimin e socializmit ne jemi për- pjekur dhe kemi pasur suksese, por kemi pasur edhe të meta, të cilat nuk ekskludohen në punë; çështja është t'i zbulojmë dhe t'i luftojmë në kohë. Për këtë çdo gjë që ndërmarrim, qoftë në politikë, qoftë në ekonomi, në industri apo në bujqësi, në arsim e kulturë etj., ne du- het t'ia nënshtrojmë një diskutimi të gjerë në Parti dhe në masat e popullit jo vetëm kur të përfundojë

puna që mendojmë të bëjmë, por që në fillim. Kjo për ne ka rëndësi të jashtëzakonshme.

Çdo objektiv që caktojmë për t'u arritur do ta realizojë populli me punën dhe djersën e tij. Për këtë qëllim komunistët duhet të jenë shembull, në ballë të sakrificave, të shkëlqejnë në të gjitha drejtimet. Në qoftë se komunistët nuk do të jenë të tillë, atëherë na bie për detyrë të reflektojmë thellë, prandaj Partia jonë ua bën të qartë të gjithë komunistëve që për të ndër-tuar socializmin duhet ecur me këmbët e veta.

Kongresi i 6-të i Partisë sonë, që u zhvillua para një muaji, ka krijuar një entuziazëm të papërshkrueshëm politik dhe ideologjik në masat e komunistëve dhe të punonjësve të vendit tonë dhe një bindje të patundur për kryerjen e detyrave, që janë me të vërtetë madhështore dhe të vështira, por plotësisht të realizueshme. Tani varet shumë nga Partia që t'i mbajë të gjalla forcat revolucionare të pashtershme të popullit, që t'i bëjë njerëzit çdo ditë e më shumë të ndërgjegjshëm politikisht, t'i ngrejë ideologjikisht, teknikisht, moralisht dhe t'i hedhë në luftë për realizimin e planit dhe të të gjitha detyrave në kohën e caktuar me një disiplinë komuniste të hekurt. Kjo përbën një detyrë të madhe për ne, udhëheqësit e Partisë, dhe për Partinë në përgjithësi, për udhëheqësit shtetërorë, për planovikët, për drejtorët e ndërmarrjeve, për të gjithë.

Populli shqiptar, Partia, Komiteti Qendror dhe Qeveria jonë do të vënë të gjitha forcat dhe do ta organizojnë punën në mënyrë të tillë që plani ynë pesëvjeçar të realizohet me sukses në të gjithë zërat. Ne do t'u vëmë rëndësi, në radhë të parë, objekteve kryesore, që

ju i dini: Hidrocentralit të Fierzës, kompleksit të metalurgjisë në Elbasan dhe Rafinerisë së Naftës në Ballsh, të cilat janë tri vepra që do të ndihmojnë zhvillimin e mëtejshëm të industrisë në vendin tonë gjatë pesëvjeçarit të ri. Por për ne rëndësi të jashtëzakonshme kanë edhe minierat dhe bujqësia. Për ndërtimin me sukses të objekteve kryesore, pa harruar aspak problemet e tjera anësore, do ta organizojmë punën në mënyrë më të përsosur, sepse këtë e do interesi i socializmit, interesi ynë i përbashkët. Përpyjekjet tona për ndërtimin e socializmit do të shkojnë kreshendo. Edhe lufta politike dhe ideologjike që bëjmë ne kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, dhe kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye, do të shkojnë, gjithashtu, kreshendo. Kështu me përpjekje dhe luftë do të ecim gjer në fitoren përfundimtare mbi të gjithë armiqtë.

Të dyja partitë tona kanë përballë të njëjtët armiq, prandaj duhet të jenë të bashkuara grusht, siç thotë populli ynë, të kenë një politikë e strategji të përbashkët marksiste-leniniste kundër tyre.

Në luftën tonë kundër armiqve të përbashkët do të ketë ngritje, po do të ketë edhe rënie. Luftë është kjo, revolucioni nuk ecën kurdoherë drejt, shpesh ai bën kthesa e zigzage, por në çdo rast të dy vendet tona të shkojnë kurdoherë së bashku. Gjatë luftës ne do të dallojmë edhe miqtë e rremë nga miqtë e vërtetë të popujve.

Tash po bëhet luftë midis Indisë dhe Pakistanit. Këtë luftë ne e kuptojmë drejt, jo si Rumania me Jugosllavinë, për të mos folur pastaj për Bashkimin So-

vjetik, që është luftënxitës, ashtu sikurse janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Po vallë si mendojmë ne shqiptarët, mos ky është një konflikt vetëm indo-pakistanez? Jo! Do të bënim gabim të madh po të mendonim kështu. Konflikti indo-pakistanez shënon përgatitjen e një agresioni të madh nga ana e imperialistëve dhe e socialimperialistëve kundër Kinës. Problemet e brendshme janë çështje që duhet t'i zgjidhin vetë pakistanezët me njëri-tjetrin, India s'ka pse të ndërhyjë, por ne këtë konflikt nuk e shikojmë thjesht vetëm si një grindje midis Pakistanit e Indisë, sepse ai drejtohet edhe kundër Kinës, prandaj na bie detyra që me të gjitha forcat tona politike të demaskojmë këtë komplot.

Titistët dhe gjithë revizionistët e ngjyrave të ndryshme, siç janë rumunët e të tjerë, bërtasin andej-këndej se janë miq me Republikën Popullore të Kinës, por ne kemi besim se ju i njihni mirë çfarë miqsh janë ata. Të gjithë e dinë se Titoja mbështet Indira Gandin edhe në konfliktin e fundit me Pakistanin. Mirëpo kjo politikë e Titos është në kundërshtim me parimet e të ashtuquajturit mosangazhim që mbron ai vetë. Pastaj dihet se Titoja është një agjent i vjetër i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat gjoja mbajnë një qëndrim neutral në konfliktin indo-pakistanez. Edhe Titoja mbase dëshiron të mbajë qëndrim neutral në këtë konflikt, por nuk e bën dot, përkundrazi, ai është i detyruar të mbajë qëndrim të hapët pro indianëve dhe kundër Pakistanit, duke u ardhur në këtë mënyrë në ndihmë sovjetikëve, gjë që është kundër interesave të tij.

Si është e mundur të veprojë Titoja kundër intere-

save të tij? Po ja, është e mundur, për arsye se në mes Jugosllavisë dhe Bullgarisë ekzistojnë kontradikta. Revizionistët bullgarë, të shtyrë nga sovjetikët, kanë pretendime mbi Maqedoninë. Në këtë kuadër, Bullgaria nesër mund të krijojë një Bangladesh maqedonas. Pra, ashtu siç i ndodhi Pakistanit me Indinë, mund t'i ndodhë nesër Titos me Bullgarinë. Pra, vetëm situata e detyron atë të veprojë hapur deri edhe kundër intereseve të tij.

Po Rumania që hiqet sikur është kundër Bashkimit Sovjetik dhe mike e Kinës ç'qëndrim mban? Gjersa ajo sheh se sulmi kundër Pakistanit është i padrejtë, përse nuk e mbron atë dhe të dënojë botërisht Indinë që është hapur kundër Kinës? Përse Rumania «socialiste» nuk e ngre, pra, zërin kundër Indisë? Ajo nuk bën kështu sepse ka frikë nga Bashkimi Sovjetik që mban anën e Indisë. Por, në qoftë se ka frikë, le të hiqet qafe nga radhët tona. Po pse, për kur e duam ne atë kur nuk e kemi për ditë të vështira? Të gjitha këto ne i shikojmë, ashtu siç i shikoni edhe ju. Kjo nuk do të thotë që ne t'i shpallim luftë Rumanisë, por qëndrimet që mban ajo na bëjnë të qartë kush janë ata që udhëheqin sot këtë vend. Në këto situata është detyrë e gjithë njerëzve përparimtarë të botës, kudo ku janë, të mobilizohen kundër reaksionit indian, kundër revizionistëve sovjetikë dhe imperialistëve amerikanë, që po luajnë një lojë djallëzore, të cilën ne dhe gjithë bota e kemi të qartë.

Ne e kuptojmë, kemi dashur dhe dëshirojmë kurdoherë që Kina të luajë një rol të madh në arenën

ndërkombëtare. Kina nuk duhet të heqë dorë nga lufta kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, kundër socialimperializmit sovjetik, kundër gjithë revizionistëve dhe borgjezisë imperialiste reaksionare indiane. Mao Ce Duni ka deklaruar se nuk bën lëshime në parime, prandaj ne shpresojmë se, me gjithë vizitën e Niksonit në Kinë, ju nuk do ta pushoni luftën e vendosur kundër imperialistëve amerikanë.

Ne shikojmë se imperialistët amerikanë gjenden në situata të vështira dhe për t'i mbuluar këto përpiqen të krijojnë situata të reja në Indokinë. Ata do të përpiqen të nxitin edhe kontradiktat në mes Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Popullore të Kinës, bile synojnë dhe dëshirojnë të arrihet deri në luftë të armatosur midis tyre. Por situata e krijuar në konfliktin indo-pakistanez, siç mendojmë ne, është me humbje për imperialistët amerikanë, mbasi pozitat e socialimperialistëve sovjetikë kanë filluar të forcohen në Indi dhe, në rast se indianët do të arrijnë ta pushtojnë Pakistanin Lindor, India do të bëhet dalngadalë një plasdarm dhe koloni sovjetike, së cilës Bashkimi Sovjetik jo vetëm do t'ia thithë pasuritë, por edhe do ta shfrytëzojë për të çuar më tej rrethimin e zjarrit të Kinës. Mirëpo, duke u futur sovjetikët në Industan, pozitat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, influenca e tyre në Indi, do të dobësohen.

Prandaj imperializmi amerikan përpiqet të luajë rolin e primadonës, të pehlivanit që kërcen në litar për të nxitur sa më shumë kontradiktat midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, për të ndezur incidente në kufi,

pastaj konflikte të armatosura që të nxjerrë gështenjat nga zjarri me duart e të tjerëve.

Siç po duket, Bashkimi Sovjetik vazhdon t'i forcojë pozitat mirë në Indi, prandaj na mbetet neve të punojmë për të nxitur kontradiktat sovjeto-amerikane dhe ta ashpërsojmë më shumë luftën tonë kundër revizionizmit sovjetik dhe imperializmit amerikan. Atë që kërkojnë të na bëjnë neve imperialistët amerikanë, dhe socialimperialistët sovjetikë, t'ua bëjmë ne atyre.

Rruga jonë, strategjia jonë, ka qenë dhe mbetet më e sigurt: të japim grushte në të dyja anët, edhe kundër imperialistëve, edhe kundër revizionistëve modernë. Të gjithë popujt shikojnë se sovjetikët, amerikanët dhe të gjithë ata që bëjnë pjesë në forcat e së ashtuquajturës botë e tretë, si Indira Gandhi, Titoja e të tjerë, janë armiq të tyre, prandaj popujt janë me ne, me luftën tonë kundër këtyre armiqve.

Organizata e Kombeve të Bashkuara, ne e kemi të qartë, është si një dansing, ku hedhin valle përfaqësuesit e vendeve borgjeze. Pas tradhtisë së udhëheqjes sovjetike, Shqipëria ishte atje i vetmi vend që luftonte me të vërtetë kundër armiqve të popujve. Ne kemi qenë fare vetëm gjer tani, sepse Kina, duke mos qenë anëtare e OKB-së, luftonte jashtë saj, megjithatë ne nuk pyetnim fare, u binim kokës armiqve, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, revizionistëve sovjetikë, Anglisë, përfaqësuesit të Indisë dhe gjithë të tjerëve, që vepronin në dëm të interesave të popujve. Duke parë politikën tonë përfaqësuesit e vendeve të vogla kanë ushqyer dhe ushqejnë simpati për politikën që ndje-

kim ne duke goditur të gjithë ata që përpiqen të marrin nëpër këmbë të drejtat e shteteve më të dobëta, cilëtdo qofshin dhe sado të mëdhenj e të fuqishëm që të paraqiten. Përfaqësuesit e gjithë këtyre vendeve në OKB nuk flasin dot, por mbyllin gojën, ndërsa veças shprehen se janë dakord me qëndrimet tona.

Tani, lufta jonë e përbashkët, qëndrimet tona parimore, u kanë nxjerrë telashe dhe u kanë krijuar shumë vështirësi revizionistëve sovjetikë dhe imperialistëve amerikanë, të cilët, me kundërpropagandën që zhvillojnë, përpiqen t'i errësojnë, prandaj ne duhet t'i bëjmë vazhdimisht të qarta qëndrimet tona.

Në luftën tonë të përbashkët ka disa çështje taktike që për ne mund të jenë të përshtatshme, ndërsa për ju kinezët mund të mos jenë. Republika Arabe e Egjiptit na ka propozuar të votojmë për rezolutën e tyre, po ne iu përgjigjëm se nuk votojmë, pavarësisht se jemi përkrah popujve arabë në luftën kundër sionizmit dhe imperialistëve amerikanë. Ata i kemi mbrojtur dhe do t'i mbrojmë kurdoherë me të gjitha forcat në luftën e tyre të drejtë, por për një rezolutë «kash-të» ne nuk mund të votojmë. Veç kësaj, ne dimë se në Egjipt kanë dorë revizionistët sovjetikë, që u kanë hipur në qafë dhe u kanë vënë frerin egjiptianëve. Edhe Kina po këtë qëndrim ka mbajtur, prandaj Çiaoja nuk votoi për atë rezolutë, por abstenoj. Mund të mendohet dhe kështu duhet të jetë, që Sadatit i mbeti qejfi, por s'prish punë, popujve arabë nuk u mbetet qejfi nga kjo, as udhëheqësve militantë të palestinezëve që luftojnë me të vërtetë kundër armiqve të popujve. Qëlli-

mi ynë është të mbrojmë interesat e revolucionit, prandaj, kur duhet mbajtur ndonjë qëndrim, shikojmë më parë interesat e popujve dhe nuk bëjmë asgjë që të na çojë në shkeljen e parimeve.

Shqipëria është një vend i vogël, por në luftën e madhe që zhvillon, parimet i ruan. Në luftën tonë ne kemi parasysh edhe mbrojtjen e interesave të Kinës dhe këtë nuk e themi se ju kemi ju këtu, por se kështu veprojmë realisht. Përse jemi ne kundër «sigurimit evropian»? Të tërë përfaqësuesit e shteteve të Evropës çuditen si dalim ne kundër «sigurimit evropian». Ky, sipas tyre, do të thotë të ketë paqe në Evropë, që askush të mos e sulmojë kontinentin tonë. Por ne u shprehim atyre pikëpamjen se «sigurimi evropian» do të thotë që ne, popujt e këtij kontinenti, të mbetemi robër të socialimperialistëve sovjetikë dhe të imperialistëve amerikanë; gjithashtu do të thotë që ne t'u krijojmë këtu qetësi revizionistëve sovjetikë, të cilët ndjekin qëllime agresive, duan t'i kenë të siguruara prapavijat e tyre këtej nga Evropa, duke pasur dorë të lirë edhe kundër Kinës. Ne nuk bëjmë si rumunët që bërtasin: «Oburra të përfundojë sa më parë traktati mbi «sigurimin evropian»!». Pse, kështu duhet menduar? Ç'janë këta «marksistë»?

Ne e përkrahim Kinën me të gjitha forcat dhe mundësitë, sepse sukseset e popullit tuaj në çdo fushë janë edhe tonat. Ne shikojmë me gëzim se qysh tani në shumë drejtime, nga sa mundim të bëjmë krahasime me ato që dimë, teknika juaj në mjaft degë të ndryshme të ekonomisë e të fushave të tjera po ngrihet

lart e dëshirojmë që të arrijë përparime edhe më të mëdha. Dhe kur populli, ky mësues i madh e i zgjuar, që e do punën dhe ka duar të arta, udhëhiqet nga idetë marksiste-leniniste, s'ka objektiv që të mos arrihet.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», Tiranë, 1980, f. 164

Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», Tiranë, 1980, f. 164

RRITJA E RENDIMENTEVE NË BUJQËSI KËRKON RRITJEN E NIVELIT SHKENCOR TË PUNONJËSVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

13 dhjetor 1971

Kisha disa pyetje, për të cilat dëshiroj të kem përgjigje të qarta.

Ndërmarrja Bujqësore e Maliqit në fakt është më e përparuar dhe më solide se ajo e Lushnjës, sepse ka arritur rezultate të mira në të dy pesëvjeçarët e fundit. Organizimi i punëve në të është vënë në rrugë të mirë, po kjo nuk do të thotë se në këtë ndërmarrje nuk ka vështirësi. Meqenëse këtu kemi thirrur edhe shokët e Lushnjës, të cilët çdo herë qahen se janë pak si të shpërndarë dhe nuk e drejtojnë dot punën, mund të na thonë shokët e Maliqit, që janë më pak të shpërndarë, cilat janë vështirësitë e tyre në organizimin dhe

1. Në këtë mbledhje u analizua puna e organizatave të Partisë të NB-ve në Maliq e në Lushnjë për edukimin e komunistëve dhe të punonjësve lidhur me thellimin e masave në fushën e eksperimentimit shkencor dhe për rritjen e rendimenteve të bimëve bujqësore.

në drejtimin e punëve? Ditët e punës të humbura në ndërmarrje ulen çdo vit, prandaj mund të na thuhet se si e keni organizuar ju punën që punonjësit të kuptojnë rëndësinë e pjesëmarrjes në punë e të mos mungojnë pa arsye?

Po gjithë këto shkolla, për të cilat bëni fjalë në relacion, si i keni organizuar ju në një territor kaq të ngushtë? Më 1968, sipas raportit, del se keni pasur tri shkolla të mesme, pesë shkolla 8-vjeçare, ndërsa këtë vit keni gjashtë shkolla të mesme, nga të cilat tri për agronomi, një për zootekni, një për frutikulturë dhe një për mekanikë. Na e shpjegoni pak nevojën e këtyre kurseve e shkollave që mua më duket sikur janë shumë. Këtu kam parasysh që i tërë Maliqi ka gjithsej rreth 4 500 frymë. E kam fjalën për shkollat e ndërmarrjes bujqësore dhe jo për shkollat e arsimit të përgjithshëm të Maliqit.

Kur bëhet plani ju e dini fare mirë që në bujqësi baza është toka. Këtë e vë në dukje, qartë, edhe Lcra e Komitetit Qendror të Partisë për bujqësinë. Tokën, siç është, duhet ta ndajmë në kategori: e dobët, e mesme, e mirë dhe shumë e mirë, sipas gjendjes, dhe ta kullandrisim sipas rëndësisë dhe nevojave të bimëve, sipas interesit dhe leverdishmërisë së tyre, pa lënë mënjani dhe pa favorizuar as njërin dhe as tjetrën bimë, por t'i trajtojmë në mënyrë të balancuar në bazë të kriterëve që thashë.

Në kuadrin e planit të përgjithshëm të ndërmarrjes, për hartimin e të cilit marrin pjesë edhe shefat e sektorëve etj., ju bëni planifikimin për çdo sektor. Pasi aprovohet plani i sektorit, ai duhet të zbatohet në ho-

zrashot, duke marrë përsipër sektori të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë. Në planin e sektorit parashikohen mjetet e punës etj. që do t'i vihen në dispozicion nga ndërmarrja brenda afateve të caktuara, si bie fjala, traktorët, plehu etj. Atëherë sektori ka detyrë të japë gjithë sasinë e planifikuar të prodhimit. Ai duhet të ndihmohet shumë nga ndërmarrja, por jo t'i ndërhyhet në mënyrë arbitrare për t'ia prishur planin.

Dua të di, si e kuptoni dhe si e zbatoni ju hozrashotin në sektor? Për shembull, pse i lejuat ju shokët e sektorit të Sovjanit që vetëm tokat e bregoreve t'i linin për ushqimin e blegtorisë, kurse ato më të mirat i caktuan për panxharin dhe grurin? Ju duhet të ndërhynit për ta ndrequr këtë situatë, që kur u bë planifikimi. E them këtë se lopët nuk duhen nënvleftësuar, ato t'i përtërijmë, prandaj duhet treguar kujdes për to dhe për viçat, pse po nuk u ushqyen si duhet, brezat e ardhshëm do të na vijnë të dobët. Ky është një proces i tërë që ndikon për lopët e ardhshme, pra për remonitin, për mishin dhe për qumështin.

Edhe panxharin, doemos, e kërkon Fabrika e Sheqerit. Në këto kushte një pjesë e tokave duhet planifikuar për bazën ushqimore, kurse pjesa tjetër e tyre për prodhimin e panxharit. Kështu, për shembull, tri të katërtat e tokave të mira ia lëmë panxharit dhe një të katërtën, më pak të mirë, e përdorim për sigurimin e bazës ushqimore. Me një fjalë, kur bëhet plani, duhen parashikuar të gjitha çështjet me kujdes të madh.

Po ngjet që plani i sektorit ndryshohet vetëm për arsye se kështu ia merr mendja drejtorit i cili kur sheh që në këtë sektor patatet fishken, urdhëron që

një sasi e plehut të planifikuar për panxharin në një sektor tjetër, t'u hidhet patateve. Në raste të tilla, a ndodhin kundërshtime nga ana e përgjegjësit të sektorit, të cilit i merret plehu? Atëherë, si zgjidhen këto kundërshtime dhe si veprohet me këto vendime të çastit që merr drejtori për të tërhequr plehun e një sektori që ushtron veprimtarinë mbi bazat e hozrashotit?

Natyrisht, drejtori i ndërmarrjes ka kompetenca, por ato nuk janë të pakufishme. Derisa aprovohat plani i hartuar me pjesëmarrjen e personave të autorizuar ai bëhet ligj. Në qoftë se më vonë për shkaqe objektive dhe të drejta lind nevoja e ndryshimit të një detyre të planit, për këtë duhet të vendoset jo arbitrarisht, por duke diskutuar e arsyetuar së bashku me sektorin.

Unë nuk e kam fjalën për gjërat e vogla, si për shembull për 20 kuintalë pleh, se këtë sasi sektori mund ta japë pa kundërshtuar, pse është në gjendje ta zëvendësojë me pleh organik pa u dëmtuar, por problemin e ngre kur çështja është për një sasi të madhe që sektorit i merret pa pyetur fare dhe e pengon në realizimin e planit. Një gjë e tillë nuk duhet lejuar. Këto çështje kanë rëndësi për zbatimin e detyrave të planit, ndryshe prishet disiplina. Ngjasin shpesh shfaqje si kjo, të kundërligjshme, dhe si luftoni kundër tyre?

Të gjitha studimet dhe eksperimentimet shkencore, që keni bërë dhe vazhdoni të bëni për tokën, për dëmtuesit, për shërbimet, për ushqimet, për plehërimet etj., si ua bëni të njohura konkretisht kooperativave të rrethit dhe ndërmarrjeve bujqësore të republikës? Si i ballafaqoni rezultatet tuaja me ato të të tjerëve?

A ka diskutime midis jush dhe a dilni me orientime të reja ose me rekomandime të veçanta për arsye të kushteve të ndryshme dhe na thoni, me këtë rast, nëse zbatohen orientimet dhe rekomandimet që dalin nga këto ballafaqime?

Për shokët e Lushnjës kam këtë pyetje:

Përse Ndërmarrja Bujqësore e Maliqit ka arritur rezultate më të mira nga tuajat? Maliqi, ashtu si dhe Tërbufi, ka qenë kënetë. Edhe Ndërmarrja e Maliqit nuk na i ka dhënë që në fillim rendimentet e tanishme, por duke i vënë gjoksin punës, ajo ka arritur suksese të kënaqshme. Prodhim kryesor edhe ajo ka drithërat e bukës, por ajo ka edhe panxharin në zverk, ndryshe Fabrika e Sheqerit do të mbetej pa punë dhe, rrjedhimisht, populli pa sheqer. Po të mos ishte kjo ndërmarrje në Korçë, nuk do të kishte sheqer në vendin tonë. Ju mbase nuk e dini që, në vitet e para, pas Çlirimit, kur akoma toka e Maliqit nuk kishte ardhur mirë, fshatarët e Korçës na qaheshin se panxhari nuk u jepte rendiment dhe po i linte pa bukë. Aso kohe ata merrnin me të vërtetë rendimente shumë të vogla, 60-80 kuintalë për hektar. Natyrisht, një rendiment kaq i ulët ishte pa asnjë leverdi. Megjithatë, Partia i këshillonte fshatarët të vazhdonin të punonin, se më vonë, me fitimin e eksperiencës dhe duke siguruar edhe pleh kimik etj., do të merrnin më shumë. Me luftë të për-bashkët, të Partisë e të punonjësve, tani u arritën atje këto rezultate që dimë.

Kur kam ardhur njëherë për vizitë në Ndërmarrjen Bujqësore të Lushnjës, kam parë që gruri humbiste nëpër kallama, ishte rritur e bërë i gjatë. Këto të meta

të kohëve të para të jetës së ndërmarrjes ishin të natyrshme, po që atëherë kanë kaluar shumë vjet dhe tani kallama nuk ka më. Eksperienca jonë në shumë drejtime, deri edhe në përmirësimin e tokave, tani është shumë e madhe. Por, në qoftë se atë nuk e merrni e nuk e shfrytëzoni si duhet, nuk do të keni rendimente të larta në tokat e ndërmarrjes.

Në ndërmarrjen tuaj ju kultivoni pambukun. Mirëpo, këtë bimë ju e trajtoni si të dorës së dytë. Ndërsa Ndërmarrja Bujqësore e Maliqit merr rendimente të larta në drithërat e bukës, por veç këtyre ajo prodhon edhe panxhar, edhe patate, edhe fruta, rrit pula e derrra, merr edhe qumësht, ju, në Lushnjë, nuk keni më shumë lloje bimësh se në Maliq, prandaj s'keni përse të qaheni se u mbytët me shumë lloje bimësh, sa nuk merrni dot frymë. Për të gjitha këto që thashë del se ju keni shumë eksperiencë për të marrë nga shokët tuaj të Maliqit. Këtë eksperiencë e klasifikoni, e merrni me sistem dhe në fillim, jo nga bishti, po nga kryesorja, deri tek ajo më pak e rëndësishmja, sepse ne duhet t'i marrim maksimalen tokës.

Shokët e Partisë të rrethit të Korçës që, natyrisht, kanë edhe ata të meta, në raportin që na kanë paraqitur, vënë në dukje me të drejtë çështjen e të ardhurave dhe të rentabilitetit. Ata mendojnë që Partia dhe shteti kanë investuar me miliarda lekë, të cilat tani duhet t'i kthehen gradualisht popullit, pse ka nevojë dhe dëshiron t'i përdorë për zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë dhe të kulturës. Në këtë drejtim, të tërëve duhet të na vrasë ndërgjegjja. Edhe te ju, gjithashtu, janë derdhur miliarda, prandaj masat e puno-

njësve dhe të specialistëve të ndërmarrjes suaj duhet që jo vetëm ta organizojnë mirë punën, po të marrin edhe eksperiencën e gjallë atje ku është më e mira dhe këtë ta bëjnë jo spontanisht, po në mënyrë sistematike dhe të organizuar.

Unë ngul këmbë që për tokën e Maliqit dhe të Tërbufit, studiues të veçantë të vijnë për të shikuar arkivat tuaja, të cilat, siç thuhet në raport, i keni lënë pak mënjanë. Ju në ndërmarrjet tuaja keni shumë të dhëna dhe dokumentacione për tokën, për bimët etj., prandaj besoj se në Maliq dhe në Tërbuf do t'ju thonë që në këtë ose në atë vit toka ka qenë në këtë gjendje, vitin tjetër u përmirësua me këto masa kështu ose ashtu. Në bazë të të dhënave do të shihni si dilte uji, derisa edhe traktorët nuk punonin etj. Me këtë rast vetë punonjësit do t'ju tregojnë masat që kanë marrë dhe vështirësitë që kanë kapërcyer në kohët e para dhe më vonë. Të gjitha këto të dhëna janë një universitet i tërë për ju, prandaj duhet organizuar mirë marrja e kësaj eksperience.

Prandaj po ju pyes: E keni marrë ju gjithë këtë eksperiencë të madhe të shokëve të Ndërmarrjes Bujqësore të Maliqit për sa u përket përmirësimit të tokës, sistemimit të ujërave, duke pasur parasysh se jeni në kushte të njëllojta? Toka që kanë qenë kënetë keni ju, kanë dhe ata; torfike kanë ata, torfike keni edhe ju; ujë ata, ujë ju; ato vështirësi që kanë gjetur ata, i hasni edhe ju. Për të gjitha këto arsye dëshiroj të di, e keni marrë ju këtë eksperiencë dhe, në rast se po, si e keni marrë?

Këto pyetje kisha unë.

Pasi shokët e rretheve iu përgjigjën pyetjeve që iu bënë, shoku Enver Hoxha, duke iu drejtuar shokëve të NB-së së Lushnjës, vazhdoi:

Ju e pranoni se në ndërmarrjen tuaj nuk e keni pasur bimësinë në numrin e kërkuar për njësinë e sipërfaqes; edhe bimësia e rrallë të jep prodhim, po t'ia bësh të gjitha shërbimet. Në këto kushte, ju keni pasur mundësi që edhe bimësisë së rrallë t'ia bënit shërbimet po aq të mira, njëlloj si pjesës tjetër të sipërfaqes së mbjellë, por ju nuk vepruat kështu. Përveç kësaj, ju nuk i keni lënë pambukut tokat e mira, pa le numrin e bimëve që s'e keni përfillur fare. Këto të meta duhet të njihen nga ju dhe të mos përsëriten më.

Ju na thoni këtu se nuk morët më shumë se 25 kuintalë misër hibrid për hektar, megjithëse dielli ishte, tokën e punuat, ujitjen, prashitjen dhe të gjitha shërbimet e tjera i bëtë krejt në rregull! Të dhënat që misrit iu bënë të gjitha shërbimet, u mboll në toka të përshtatshme etj., specialistët a i japin me shkrim dhe me përgjegjësi të plotë penale? E them këtë sepse duke folur kështu pa përgjegjësi, more shokë, ju na futni në qorrsoqaje të mëdha. Prandaj, unë shtroj pyetjen: do të vazhdojmë ne apo nuk do të vazhdojmë më me farën hibride?

Fara hibride e gjeneracionit të parë arrin të japë gjer në 100 kuintalë për hektar. Ne nuk kërkojmë kaq, por të paktën 50 kuintalë për hektar, mesatarisht, duhet ta marrim. Nga gjeneracioni i dytë, që, në kushtet e reja agroteknike të larta, jep deri 50 kuintalë për hektar, ne përsëri nuk kërkojmë kaq, por të paktën 40 kuintalë për hektar dhe jo 25 kuintalë për hektar, sa

thatë ju. Por kjo sasi është jashtëzakonisht pak, pse ne edhe me farë të vendit marrim aq, jo më me farë hibride që duhet të marrim më shumë. Ne po vazhdojmë tre deri katër vjet që po e prodhojmë farën hibride dhe në qoftë se nuk marrim prodhimin e duhur, kush ka faj atëherë për këtë? Ne apo ju? Për këtë ju duhet të përgjigjeshit qartë!

Me sa doli edhe këtu, ju nuk keni rregull në të gjitha ato drejtime ku me të vërtetë duhet të vendoset rregulli, prandaj merret me mend se edhe në drejtime të tjera nuk keni gjë në vijë. Kur nuk keni mirë këto që janë kryesoret, të tjerat janë vetëm llafe, përralla dhe muhabete që bëjmë me kryetarin e pushtetit dhe me sekretarin e parë. Është e qartë se ju nuk keni vënë rregull në punë, nuk keni punuar si duhet për të vënë në jetë porositë e Letrës së Komitetit Qendror, secili punon si më parë dhe nuk ju kërkon njeri llogari. Këtu është gjithë puna.

Pasi diskutuan edhe shokët e tjerë, në përfundim të mbledhjes, shoku Enver Hoxha tha:

Unë nuk mendoj të zgjatem shumë, për arsye se shokët që folën para meje, i prekën të gjitha çështjet. Doja të theksoja se për të rritur rendimentet e kulturrave bujqësore, duhet t'i kushtojmë rëndësi të veçantë rritjes së përgjithshme të nivelit shkencor në punët e bujqësisë, të grumbullojmë e të përhapim eksperiencën e përparuar si dhe të masivizojmë eksperimentimin shkencor. Materialet që ka botuar dhe shpërndarë Ministria e Bujqësisë, i shërbejnë pikërisht zbatimit të detyrave që shtronte Letra e Komitetit Qendror të Partisë e janarit të vitit 1971 për çështjet e bujqësisë, pa

zbatimin e së cilës nuk mund të kemi rezultatet që parashikojmë, nuk mund të kemi disiplinë shkencore dhe disiplinë ekonomiko-financiare.

Për zbatimin e detyrave të mëdha të planifikimit dhe të perfeksionimit të drejtimit të ndërmarrjeve bujqësore dhe kooperativave bujqësore konstatojmë se është punuar dhe ka filluar të organizohet puna sipas letrës, por në praktikë vihet re se ecet ngadalë, për arsye të rutinës së vjetër, kundër së cilës duhet punuar për ta kapërcyer medoemos. Me këtë dua të them se nuk është aspak e mjaftueshme vetëm të flitet për disiplinën shkencore dhe disiplinën financiare, apo të kufizohemi vetëm në propagandën politike. Edhe kjo, natyrisht, është e domosdoshme të bëhet, që njerëzit ta kuptojnë mirë politikisht dhe ideologjikisht gjithë esencën e disiplinës shkencore dhe të asaj financiaro-ekonomike në ndërmarrje e kooperativa bujqësore, por njëkohësisht duhen marrë masa efikase që këtë detyrë ta realizojmë sa më mirë në praktikë nëpërmjet një pune të vazhdueshme e konkrete. Që t'ia arrijmë kësaj, është e domosdoshme të organizojmë kurse dhe forma të tjera të përshtatshme në të cilat të përfshihen të gjithë ata që janë të interesuar drejtpërdrejt ose tërthorazi për këto çështje, dhe të interesuar janë të tërë punonjësit, duke nisur që nga drejtuesit dhe deri te më i thjeshti, prandaj mendoj se të gjithë jemi dakord për këtë.

Disa nga problemet që ngre Letra e Komitetit Qendror të PPSH si dhe ato që trajtohen në materialet që ka përgatitur Ministria e Bujqësisë, nuk janë të reja, por aty vihen në baza akoma më konkrete. Për disa

të tjerë ato nuk janë të panjohura, vetëm se në të përcaktohen disa gjëra më mirë, por ka edhe njerëz që janë mësuar të ecin havadan, për të cilët ato janë të panjohura fare. Në këto pozita nuk ka vetëm punëtorë, por edhe mjeshtër, edhe teknikë të mesëm, edhe teknikë të lartë. Prandaj na bie detyra të punojmë që t'i bëjmë të gjithë të mendojnë dhe të veprojnë me të vërtetë në mënyrë shkencore dhe me disiplinë të rreptë ekonomiko-financiare.

Për këtë qëllim ne kemi organizuar shkolla të shumëllojshme, po mua më duket se për këto probleme ne lypset të organizojmë shkolla apo kurse të veçanta. Kjo është e nevojshme të bëhet se nuk mund të ketë ekonomi socialiste pa zbatuar me rreptësi këto gjëra, dhe se te ne nuk duhet të ketë asnjë ndërmarrje pa disiplinë financiare e shkencore dhe pa plan, pa rentabilitet etj., etj. Zbatimi i normave teknike dhe i normave të tjera të punës, si dhe i normativave të materialeve, pasja parasysh e leverdishmërisë ekonomike etj. nuk mbahen kudo parasysh si duhet nëpër ndërmarrjet e kooperativat bujqësore. Të gjitha këto çështje duhet t'i dinë të tërë, disa bile me hollësi, kurse disa të tjerëve u takon jo vetëm t'i dinë me hollësi, por edhe t'i mbrojnë, megjithëse ato të gjithë duhet t'i mbrojnë e të luftojnë për t'i zbatuar.

Për këto arsye ju, shokë të rretheve, mendoj të organizoni një aktiv, duke përgatitur më parë disa shokë specialistë, si: agronomë, zooveterinerë, financierë, planovikë e të tjerë për të folur. Në aktiv të flitet mbi rëndësinë e këtyre dokumenteve, natyrisht jo në hava, por duke u bazuar në to, t'u shpjegohet e t'u zërthehet

në detaje pjesëmarrësve përmbajtja e çdo dokumenti, bile deri edhe rëndësia e çdo kolone, në mënyrë që të kuptohet thellë se sa i shërbejnë këto çështje zbatimit të detyrave që shtron Partia për bujqësinë. Kur të bëhet kjo punë të flitet ç'fitime ka nga zbatimi i kërkesave që parashtrihen atje dhe humbjet që do të kemi, në qoftë se ato shkelen e nuk zbatohen; të tregohet se cilat mund të jenë arsyet dhe faktorët që mund të ndikojnë për t'i shkelur dhe puna që duhet bërë me kohë për t'u dalë përpara të papriturave e kështu me radhë për të gjitha çështjet. Në këtë aktiv apo çfarëdo që të quhet, specialistët, në radhë të parë shokët e Partisë në fermë e kudo, pa bërë dallimin kush janë ata, brigadierë, apo të çfarëdo përgjegjësie tjetër, pasi t'u bëhen të qarta dokumentet, të hidhen të tërë në luftë.

Së pari, ata, në bazë të udhëzimeve të komitetit apo të byrosë së komitetit të Partisë, të japin shpjegime në organizatat-bazë përkatëse, pastaj të shkohet në sektor, në brigadë, në skuadër, në ofiçinë e kudo, ku të mbledhin punonjësit dhe t'i sqarojnë sa më mirë. Në qoftë se do të kenë me vete materiale të shtypura, t'u japin nga këto edhe punonjësve të bazës, po në qoftë se nuk kanë, të bëhen përpjekje që të sigurohen, të shtypen, në bazë të dokumenteve kryesore. Prandaj cilitdo që gjykohet se i përket ta ketë një material të këtyllë, t'i jepet.

Po vallë e mbaroi Partia punën e saj me kaq? Jo, puna e Partisë nuk mbaron me kaq. Ajo, me t'u shpjeguar mirë këto çështje, të mobilizojë njerëzit, pastaj të fillojë nga puna për vënien e tyre në jetë,

duke organizuar kontrollin e zbatimit të të gjitha kërkesave gjatë gjithë proceseve të punës. Zbatimi i këtyre kërkesave mund të bëhet mirë, kur të kemi kuptuar drejt përmbajtjen e Letrës së Komitetit Qendror, të janarit 1971, domethënë të fillohet si duhet nga planifikimi, nga një planifikim i drejtë mbi baza hozrashoti, duke marrë parasysh gjithë situatën e ndërmarrjes ose të kooperativës, duke balancuar të gjitha kulturat, të gjitha tokat, të gjitha forcat njerëzore, mekanike etj. duke llogaritur të ardhurat, dëmet e të tjera.

Pasi të bëhen të gjitha këto, pastaj të shkohet në punë, gjatë së cilës është e domosdoshme, siç këshillon letra, të ecet në mënyrë të organizuar dhe të bëhen përpjekje për zbatimin me rreptësi në praktikë të disiplinës shkencore dhe të asaj ekonomiko-financiare. Le të hidhet përpjetë, le të bërtasë sa të dojë, për she mbull kryetari i komitetit ekzekutiv, që kërkon të merren masa të rënda ndaj specialistit, kur ky në bazë të rregullave konstaton shkelje dhe vendos të mos zbatohet një urdhër jo i arsyeshëm që jepet nga eprori.

Kur, në bazë të rregullave të caktuara nga Partia dhe Qeveria, specialisti konstaton se ka shkelje dhe deklarë se veprimi që i imponohet të kryejë nuk përputhet me direktivat, urdhrat apo udhëzimet e organeve më të larta, prandaj edhe nuk mund ta zbatojë, atëherë duhet të mblidhet organizata-bazë e Partisë apo udhëheqja e ndërmarrjes bujqësore, të diskutohet mirë ky veprim, pastaj të vendoset. Megjithatë, edhe në mblidhje, specialisti ka të drejtë të mbrojë mendimin e vet, edhe sikur të jetë kundër të gjithëve në organi-

zatën-bazë të Partisë. Kur ai është i bindur se vepron konform rregullave të aprovuara nga organet më të larta dhe në interes të përgjithshëm, të mos lëkundet, sikur edhe në pakicë të mbetet. As në këtë rast kryetari i pushtetit nuk mund t'i imponohet, por në qoftë se organizata-bazë apo udhëheqja e ndërmarrjes merr vendim, atëherë specialisti është i detyruar ta zbatojë dhe pikëpamja e qëndrimi i tij kundër të gjithëve shënohet në protokoll. Më vonë, në kohën e të korrave dhe të hedhjes së prodhimeve në hambar, po të vërtetohet se veprimi i kryetarit të pushtetit ka qenë i gabuar, atëherë specialisti ka të drejtë të propozojë mbledhjen e organizatës-bazë të Partisë, së cilës t'i kërkohet të shqyrtohet veprimi i gabuar i kryetarit, për dëmin e madh që u ka shkaktuar Partisë, pushtetit dhe ekonomisë dhe të mbahet qëndrim kundër tij. Po të vepohet kështu, atëherë njerëzit do të flasin më me kujdes e më me përgjegjësi. Në të gjitha këto raste gjithçka duhet të jetë e shkruar, e bazuar, e dokumentuar, se fjalët i merr era dhe nuk ka si del përgjegjësia, as si të bëhet kontrolli.

Ju thoni përpara Sekretariatit të Komitetit Qendror që kemi përgjegjësi të tërë për këto mosrealizime që kanë ndodhur dhe këtë e bëni me plot ndërgjegje, se e ndieni veten fajtorë. Natyrisht, edhe mbi ju rëndon faji, sikurse rëndon dhe mbi ne në qendër, por fajin nuk duhet ta shpërndajmë e ta përgjithësojmë, pse kryesisht ai bie më shumë mbi atë që shkel rregullat. Në Ndërmarrjen Bujqësore të Maliqit për helmimin e disa lopëve faj kanë organizata-bazë e Partisë, drejto-

ria, gjithë komunistët dhe kuadrot, po faji kryesor rëndon drejtpërdrejt mbi brigadierin që lëshoi lopët jashtë rregullave në jonxhën e spërkatur me insekticide.

Po përse e bëri brigadieri këtë? Derisa nuk pati asnjë arsye, atëherë u bë shumë mirë që iu dha gjyqit, që të marrë dënimin e merituar sipas ligjit për qëndrim të pakujdesshëm në detyrë. Natyrisht, edhe gjithë të tjerët që përmenda duhet të mbajnë përgjegjësi për dëmin që iu shkaktua ekonomisë, por veç ai që ka faj drejtpërdrejt duhet të përgjigjet edhe penalisht.

Meqë erdhi fjala për brigadierët mendoj se me ata duhet bërë punë politike që të mos kenë frikë nga disa njerëz që ndikojnë për keq në brigadë, siç u tha këtu. Nuk janë ata aq të formuar politikisht dhe ideologjikisht sa në vend që të bëjnë lëshime, t'i përballojnë llafazanët dhe kritizerët e sëmurë?

Brigadierin ta bëjmë që të jetë i aftë sa të fitojë përkrahjen e shumicës së anëtarëve të brigadës, kundër pakicës që përpiqet të krijojë amulli. Nga kjo anë ju duhet të ngulni shumë këmbë që t'i përgatitni. Brigadierët të jenë kurajozë dhe të ndërgjegjshëm se vendimet që marrin dhe urdhrat që japin mbështeten në direktivat e drejta të Partisë, që lypin një disiplinë të fortë; se ata në punën e tyre do të kenë mbështetjen e shumicës së brigadës, prandaj kanë forca t'u imponohen atyre pak njerëzve që merren me fjalë dhe u bëjnë presion brigadierëve.

Të tërë jemi dakord të veprohet kështu, prandaj t'i shikojmë më mirë këto probleme. Me këtë nuk dua të them se gjatë punës kemi pasur vetëm gabime, pse

kudo kemi pasur edhe suksese dhe fakt është që këto suksese janë të mëdha në bujqësi; vetëm tani të përpiqemi që këto t'i thellojmë e t'i përforcojmë akoma, siç theksohet në Letrën e Komitetit Qendror të Partisë që ju është dërguar.

Ndërmarrja Bujqësore e Maliqit, për shembull, ka arritur rezultate të mira në të dy pesëvjeçarët e fundit, prodhimet e saj vazhdimisht kanë ardhur duke u rritur në të gjithë zërat.

Edhe ajo e Lushnjës ka bërë përparime të ndjeshme në disa drejtime, po rendimentet e saj, duke i krahasuar me ato të Maliqit, janë më të ulëta, sidomos në drithëra, ndërsa në pambuk, lule dielli dhe në foragjere janë akoma shumë të ulëta. Me humbje del kjo ndërmarrje, gjithashtu, edhe në mishin e dërrit, në të gjedhit, edhe në shpendë. Mjaft për të dëshiruar është atje eksperimentimi shkencor, ku vërehen qëndrime intelektualiste, specialistët nuk janë të lidhur si duhet me fushën, me praktikën, megjithëse Lushnja është e favorizuar në këtë drejtim, pse atje ka edhe Institutin e Kërkimeve Bujqësore që duhet aktivizuar më tej. Përveç kësaj, mendoj që Ndërmarrja Bujqësore e këtij rrethi të kujdeset për të marrë ca eksperiencë nga simotra e saj e Maliqit në shumë drejtime, në mënyrë të veçantë për edukimin e kuadrit.

Ne ju urojmë suksese të mëtejshme, pse keni korrur suksese, por keni akoma edhe plot të meta, të cilat bëni përpjekje t'i kapërceni, t'i luftoni për t'i realizuar sa më mirë të gjitha detyrat e mëdha që shtroi Kongresi i 6-të i Partisë dhe të plotësojmë krahas tyre boshllëqet jo të vogla që na u krijuan gjatë këtij viti

bujqësor në mënyrë që në vitet e ardhshme të ecim më me mend në zhvillimin e bimëve veç e veç.

Atëherë e mbyllim këtë çështje. Të fala gjithë sho-këve! Dalshi faqebardhë!

*Botuar për herë të parë
me disa shkurtime në li-
brin: Enver Hoxha, «Ra-
porte e fjalime 1970-1971»,
Tiranë, 1972, f. 495*

*Botohet i plotë sipas tekstit të
nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Sekretariatit të
KQ të PPSH, që gjendet
në AQP*

SITUATAT ANALIZOHEN SIPAS KUSHTEVE KONKRETE TË VENDIT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

13 dhjetor 1971

Unë jam dakord me përmbajtjen e këtij informacioni, vetëm të kemi parasysh se jo çdo material i Partisë sonë u intereson partive motra marksiste-leniniste. Këtë ta kemi mirë të qartë dhe të mos shkojmë nga parimi se shokët e partive motra marksiste-leniniste kanë nevojë të këndojnë çdo material të Partisë sonë. Ashtu siç bëjmë ne që nuk i këndojmë të gjitha gazetat dhe materialet e tyre, në të njëjtën mënyrë veprojnë edhe ata me tonat, së pari për arsye se nuk i disponojnë ato, po, të jemi realistë, edhe sikur t'i disponojnë, nuk mund t'i këndojnë të tëra.

Kjo na vë detyrën që, për t'u ardhur në ndihmë shokëve të partive të tjera, të bëjmë një seleksionim të materialeve tona, siç tha shoku Ramiz, por një se-

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për disa probleme lidhur me lëvizjen marksiste-leniniste ndërkombëtare.

leksionim të zgjuar. Për këtë, mundësisht, është mirë të dimë çfarë dhe përse kanë ata nevojë dhe ç'dëshirojnë të përfitojnë nga eksperiencia jonë. Varet pastaj shumë edhe sa do të jemi ne të zotë dhe në gjendje të zgjedhim nga materialet tona ato që u duhen dhe t'i bëjmë të interesohen për to. Ne do t'i ndihmojmë ata të interesohen për materialet tona, kur të njohim sa më afër e më mirë problemet e tyre.

Në këto materiale, për disa probleme që u interesojnë partive motra marksiste-leniniste, mund të gjejmë dhe gjejmë çështje ku mund të kombinohet, fjala vjen, e kaluara me aktualen; t'u jepnim atyre një pasqyrë, të cilën mund të mos e zbatojnë siç kemi vepruar ne, pse situatat nuk janë njëjloj. Por, kur të vihen në dijeni të eksperiencës sonë, kjo ndoshta i ndihmon ata që, duke menduar si marksistë dialektikë, të vlerësojnë drejt situatat e vendeve të tyre dhe të veprjnë sipas kushteve, duke gjetur rrugët më të drejta për zgjidhjen e problemeve që u dalin.

Sigurisht, ne duhet të kemi parasysh për këtë qëllim se situatat në partitë motra nuk zhvillohen në të njëjtat kushte siç janë zhvilluar në vendin tonë, siç është zhvilluar, fjala vjen, Fronti te ne gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ose siç ka organizuar Partia jonë Rininë Komuniste të Shqipërisë dhe si e ka hedhur këtë në luftë. Kushtet në vendet e tjera sot nuk janë të njëjlojta me ato që kemi pasur ne gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Siç e kemi thënë vazhdimisht, Partia Komuniste e Shqipërisë ka qenë e vetmja Parti që themeloi, organizoi e mobilizoi në vendin tonë rininë dhe të gjitha ma-

sat e tjera të popullit, i edukoi këto politikisht e ideologjikisht, pa pasur parti të tjera. Prandaj, ne e kishim më lehtë t'i thoshim atëherë tjetrit të futej në rini ose në Frontin Nacionalçlirimtar.

Ndryshe është gjendja sot në vendet kapitaliste. Punëtorëve atje nuk u thuhet dot aq lehtë që të ecin në rrugën e partive të reja marksiste-leniniste, jo se nuk duan, por se nuk janë të qartë si duhet, dhe se në këtë drejtim hasen shumë pengesa; ndaj tyre vepronë shumë faktorë që i pengojnë e i çoroditin. Në vendet e tyre ka disa parti të borgjezisë; ka sindikata të themeluara prej kohësh, të udhëhequra nga kuadro të regjur e me eksperiencë që i gënjejnë me mjete të shumta propagandistike masat punonjëse, duke i lidhur edhe me interesa të shumëllojshëm ekonomikë e materialë. Megjithatë, edhe atje ka njerëz që e kuptojnë ku është e mira. Shokët e miqtë tanë komunistë, jashtë, natyrisht luftojnë që të futen sa më shumë njerëz në organizatat që krijojnë, po e vërteta është se hasin në shumë vështirësi, për kapërcimin e të cilave u duhet e do t'u duhet të bëjnë përpjekje të mëdha. Prandaj, nuk mund të mos i kemi parasysh vështirësitë e tyre jo të vogla e të shumëllojshme në luftën kundër kapitalizmit, kundër socialdemokracisë, kundër revizionizmit modern, kundër të gjitha partive të kapitalit. Puna e tyre në këto drejtime, në kushtet që jetojnë partitë motra, nuk është aq e lehtë.

Pavarësisht nga kushtet, atyre mund t'u shërbejë eksperiencia jonë në disa drejtime. Për shembull, atyre mund t'u vlejë eksperiencia e Frontit tonë Nacionalçlirimtar, kur ne t'u tregojmë se si orientohet në atë kohë

populli ynë për luftë, i grumbulluar rreth Frontit. Por në kushtet kur në vendet e tyre ka disa parti, rreth të cilave grumbullohen masat, shokët tanë jashtë, natyrisht, mbajnë parasysh se përballë kanë aleanca me parti të vjetra e grupe të fuqishme nga më të ndryshmet, kundër të cilave do t'u duhet të luftojnë. Në këtë kuptim mendoj se atyre mund t'u vlejë disa nga materialet tona.

Për secilin problem që kanë shokët tanë për të zgjidhur, ne e kemi për detyrë t'ua japim eksperiencën tonë, por, siç thashë, duke bërë më parë një punë seleksionuese me mend. Në materialet e Partisë sonë, po të përpiqemi, mund të gjejmë forma politike dhe ideologjike që janë të përshtatshme, ta zëmë, për kushtet e Anglisë; të zgjedhim ndër to ato praktika, atë përvojë që mund të përdoren atje. Po kështu mund të gjenden forma të tjera pune që janë të përshtatshme për shembull, për Afrikën, ku, edhe në qoftë se tani janë organizuar disa parti borgjeze, ato janë akoma të dobëta, të pakonsoliduara, jo në nivelin e tredunioneve e partive të vendeve të zhvilluara kapitaliste. Duke e përpunuar këtë përvojë sipas kushteve të vendit, ata mund të kenë dobi për punën dhe luftën e tyre.

Të njëjtën punë mund të bëjmë për ta edhe me materialet që kanë lidhje me çështjet e luftës sonë, për arsye të kushteve të veçanta që ka në secilin vend, kushte këto që janë krejt të ndryshme nga ato që kanë ekzistuar te ne. Dihet se Lufta jonë Nacionalçlirimtare kundër nazifashizmit ishte e dekluarar. Çlirimi nacional ishte objektivi kryesor që preokuponte në atë kohë mbarë popullin tonë. Ne atëherë ishim në aleancë me

Bashkimin Sovjetik dhe me fuqitë borgjeze kapitaliste, Anglinë, Francën dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që luftonin kundër të njëjtit armik. Kurse krejt ndryshe janë momentet aktuale në vende të ndryshme të botës, të cilat ne i njohim mirë, po ato i njohin akoma më mirë vetë shokët tanë që jetojnë dhe luftojnë në secilin nga këto vende.

Raporti i Kongresit tonë, jashtë, mendoj se ka rëndësi për partitë e reja, pse aty ka shumë probleme korente dhe të perspektivës. Sigurisht, këtë raport ne e përgatitëm për vete, për Partinë tonë, por edhe miqtë e shokët e vendeve të tjera, po të duan, mund të përfitojnë prej tij, sidomos nga kapitulli i parë dhe i gjashtë. Megjithatë, ata mund të përfitojnë edhe nga kapitujt e tjerë të këtij raporti, veçanërisht nga ai që bën fjalë për ndërtimin e Partisë. Unë jam i mendimit që, në rast se partitë motra nuk ndërtohen në baza leniniste-staliniane, siç është ndërtuar Partia jonë, ato nuk do t'u bëjnë dot ballë me sukses armiqve të mëdhenj që kanë përpara në vendet e tyre: kapitalizmit, revizionizmit dhe socialdemokracisë. Kjo do të thotë se disiplina dhe normat e ndërtimit të partive të reja motra duhet të jenë si të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe në këtë drejtim eksperiencia e saj është e pavdekshme. Vetëm këtë fushë po të marrim, ka materiale shumë, bile aq shumë, sa që pa i ndihmuar ne në këtë drejtim, duke bërë seleksionimin në bazë të kriteve që përmenda, ata vetë nuk do të dinë ç'të marrin më përpara e që do t'u vlejë për punën e tyre.

Një material i Partisë sonë që flet, për shembull, për vijën e Guevarës, për kastristët etj., mund t'i bjerë

në dorë një komunisti brazilian. Mirëpo ai mund të vërë re se elementët e grupit guevarist, që vepron në vendin e tij, pikëpamjet antimarksiste nuk i kanë aq të theksuara, siç vihen në dukje në materialet tona. Duke menduar si marksist, në kushtet konkrete të vendit të vet, ai gjykon se me njerëzit e këtij grupi mund të afrohet për t'ia likuiduar pikëpamjet jo të drejta. Jo vetëm kaq, po ai këtë mund ta bëjë edhe me synimin për të shkuar në një front me ta, bile më pas edhe me qëllimin që disa nga elementët më të mirë të këtij grupi që mund të korrigjohen e të bëhen revolucionarë, t'i përgatitë, t'i shkëputë dhe t'i futë në parti. Marksisti duhet t'i shikojë në kompleks dhe t'i analizojë të gjitha situatat në kushtet konkrete të vendit.

Kur ne në raportin e Kongresit flasim, siç thashë, për çështjen e Partisë, ky material i ndihmon ata të shohin konkretisht ç'është socializmi, si ndërtohet ai, ç'do të thotë të jesh parti në fuqi dhe këtej të vënë detyrën se çfarë duhet bërë për të arritur aty ku jemi ne. Kështu u duhet që këtë dokument ta kenë dhe ta studiojnë vetë, që secili të krijojë bindjen ç'sjell socializmi, ç'fiton populli kur është në fuqi një parti e ndërtuar mbi baza leniniste-staliniane, me një vijë të drejtë revolucionare, e papajteshme me armiqtë e klasës, të jashtëm e të brendshëm, me një vijë të drejtë për ndërtimin e ekonomisë socialiste dhe për edukimin e njeriut të ri, me mendime e qëndrime revolucionare etj. Këto materiale u vlejné shokëve të partive të reja marksiste-leniniste, sepse në to ata do të shikojné realitetin tonë dhe perspektivën e tyre, qoftë kjo edhe ca e largët. Partia jonë ka në këtë fushë sa

të duash dokumente, prandaj nuk mund t'ua lëmë atyre t'u futen vetë për të zgjedhur, se do të humbasin shumë kohë. Këtë punë na bie barra ta bëjmë ne, duke u treguar atyre si është organizuar Partia, t'u tregojmë normat e Partisë, disiplinën e Partisë, centralizmin e Partisë e të tjera, e të tjera.

Vetëm për këto çështje e vlen barra qiranë të përgatitim broshura, ku të vihet në dukje eksperiencia e Partisë sonë. Këtë punë ne do ta bëjmë, në radhë të parë, për nevojat tona, për t'u rifreskuar njerëzve tanë, sidomos atyre të moshave të reja, eksperiencën e Partisë. Por, këtë, njëkohësisht mund ta përkthejmë edhe për shokët e partive të tjera në rast se ata do ta dëshirojnë.

Ne nuk pretendojmë t'u zgjidhim shokëve të partive motra të gjitha problemet që u dalin, as mendojmë që ata të gjejnë zgjidhjen e çdo çështjeje që kanë përpara, duke u mbështetur vetëm në eksperiencën e Partisë sonë. Kjo nuk mund të ndodhë, sepse situata në secilin vend të veçantë është ndryshe, shpesh shumë e koklavitur. Megjithatë, me një seleksionim të mirë të materialeve që disponojmë, për të cilat gjukojmë se ata kanë nevojë, ne mund t'u vijmë atyre në ndihmë për mjaft probleme. Pra, është e domosdoshme të bëjmë një punë të diferencuar me materialet që kemi dhe të mos mendojmë t'u japim të tjerëve kallëp eksperiencën e Partisë sonë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

EDHE NORMA TEKNIKE KA DINAMIKËN E SAJ

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

15 dhjetor 1971

Gjatë studimit të raportit më ka dalë një pyetje që dua ta shtroj këtu për diskutim, me qëllim që të dëgjoj mendimet e shokëve dhe të specialistëve.

Eksperienca e punës për zbatimin e detyrave që shtroi Plenumi i 9-të i Komitetit Qendror të Partisë lidhur me normimin teknik të punës, si dhe studimet e bëra për këtë qëllim, mund të na çojnë në konkluzionin për të qenë pak më tepër «mbi tokë», se, meqë, për shkak të vështirësive të hasura, normat teknike nuk po gjejnë atë zgjidhje të shpejtë dhe të plotë që dëshirohet, mos duhet t'i thjeshtojmë pak ato? E kam fjalën nëse mund të krijojmë të atilla norma që të jenë më mirë të realizueshme se norma plotësisht tek-

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit: «Mbi zbatimin e detyrave që shtroi Plenumi i 9-të i KQ të PPSH për kuptimin dhe zbatimin gjerësisht të normimit teknik të punës dhe të materialeve», paraqitur nga Komisioni i Planit të Shtetit.

nike, të fotografuara e të kronometruara me sekonda? Konkretisht, çështjen e shtroj që t'u afrohem i sa të jetë e mundur më shumë normave teknike dhe të heqim dorë nga disa kërkesa që bëjmë për normat eksperimentale-statistikore. Pra, them nëse mund të gjendet një lloj norme e ndërmjetme që të eksperimentohet për njëfarë kohe, me qëllim që njerëzit të mësohen me të, të prodhojnë sipas saj dhe, pastaj, gradualisht, të kalojnë në normat teknike.

Unë e bëj këtë pyetje se kur arsyetojmë për shkaqet e tejkalimit të normave mua më duket se harrojmë të numërojmë edhe disa faktorë të tjerë që kanë ndikuar në këtë drejtim, siç janë: kualifikimi, ngritja e ndërgjegjes, disiplina, organizimi më i mirë i punës nga ana e punëtorit etj. Partia i flet dhe i bën thirrje çdo ditë punëtorit për të përmirësuar cilësinë e punës, për të shfrytëzuar kohën e punës etj. Është e vërtetë se, duke qenë e pastudiuar norma fillestare, ndodh që kur ajo ngrihet pak, punëtori përsëri e tejkalon, por ky nuk është shkak i vetëm.

Pasi shokët iu përgjigjën pyetjeve dhe diskutuan rreth problemit, shoku Enver Hoxha, në përfundim të mbledhjes, tha:

Nuk dëshiroj të zgjatem, se shokët diskutuan dhe i rrahën mendimet nga të katër anët për këtë problem, por dua të vë në dukje se kjo detyrë jo e thjeshtë dhe shumë e rëndësishme, nuk ka arsye të ndërlikohet më tepër se ç'është. Në radhë të parë, nuk mund të kërkojmë që punëtorët të bëhen të tërë shkencëtarë për normimin teknik të punës dhe të materialeve, siç mund të mendojnë një, dy ose dhjetë shkencëtarë që kanë

prirjen të futen në hollësira të mëdha. Këto çështje me karakter tekniko-ekonomik t'ua shpjegojmë punëtorëve në mënyrë të thjeshtë, që të kuptojnë më parë thelbin dhe qëllimin e tyre, pastaj t'i realizojnë me sukses. Ne jemi dakord që njerëzit e mësuar në çështjet ekonomike t'i studiojnë shkencërisht problemet e normimit teknik, me qëllim që të merren vendime të bazuara e të drejta, por, siç thashë, punëtorëve ato duhet t'u shpjegohen në mënyrë të thjeshtë.

Mua më duket se për sa i përket kuptimit të normave, në praktikë ka konfuzion. Termi «normë eksperimentale», siç përdoret sot, nuk duhet të jetë me vend, pse eksperimentale janë edhe normat statistikore, bile edhe vetë normat teknike. Përderisa pranojmë që njerëzit, me kalimin e kohës, rritin kualifikimin dhe perfeksionojnë vazhdimisht shprehjet në punë, që makinat, gjithashtu, perfeksionohen pa pushim dhe japin prodhime më shumë e të cilësisë më të mirë brenda një kohe më të shkurtër, përveç ndryshimeve të vazhdueshme që pësojnë shumë faktorë të tjerë që përbëjnë normën teknike, të gjitha këto na bindin se edhe norma teknike ka dinamikën e saj. Për këtë duhet të tregojmë kujdes që normat të mos qëndrojnë në vend. Të mos na ngjasë, siç u tha këtu, që tërë jetën të qëndrojmë me normat eksperimentale.

Pra, edhe norma teknike nuk mund të jetë statike, e vendosur një herë e përgjithmonë, por në zhvillim; ajo që kemi sot, kur krijohen kushte të reja, ndryshon ncsër e kështu me radhë. Duke e parë në këtë mënyrë çështjen, edhe norma teknike është eksperimentale. Atëherë, pse të quajmë eksperimentale vetëm normën

e thjeshtë e jo edhe të tjerat? Të kuptohemi drejt, nuk e kam fjalën thjesht për emërtimin, por për përshtypjet e gabuara që mund të krijohen në praktikë nga ky emërtim. Cilido duhet t'i kuptojë si proces në lëvizje e transformim të gjitha llojet e normave dhe jo vetëm njëriën prej tyre. Pikërisht, për këtë arsye, mendoj që specialistët të gjejnë një emërtim të përshtatshëm.

Është e qartë që, në kushtet e zhvillimit të industrisë dhe të teknikës në vendin tonë, ne duhet të synojmë te normat teknike, për arsye se ato janë më të mira, më shkencore dhe të domosdoshme për rritjen e rendimentit të punës. Në të njëjtën kohë, bashkë me industrinë dhe teknikën e përparuar që po ngremë, bile para tyre, ne përgatitim e kualifikojmë edhe kuadrot, që do të prodhojnë në to mallra sa më të mira e të lira për popullin, prandaj edhe normat duhet të jenë të lilla që t'i përshtaten zhvillimit tonë socialist pa pasur asnjë cak në përsosjen e vazhdueshme të tyre.

Në të gjitha ndërmarrjet, fabrikat dhe uzinat tona nuk është e njëjta teknikë, nuk janë të njëjtat procese pune dhe njerëzit nuk kanë të njëjtin kualifikim. Diku punohet më mirë dhe qëndrohet në pararojë; diku qëndrohet në mes të rrugës, kurse gjetkë punëtori vazhdon të punojë akoma me normat e thjeshta. Te ne zbatohet parimi socialist: «Secili sipas aftësisë, secilit sipas punës». Kjo do të thotë të punosh sipas aftësisë dhe të paguhesh për aq sa i jep shoqërisë. Kështu, punëtori që punon me norma të përparuara dhe i jep shoqërisë më shumë, duhet të marrë më tepër se ai që nuk punon me norma të tilla, që harxhon më shumë material, që punon më ngadalë, pra, me kosto më të lartë etj.

Jo të tërë punëtorët kanë në përdorim makina moderne, prandaj është e natyrshme që disa prej tyre që punojnë me të tilla makina, për çdo njësi të caktuar kohe, prodhojnë më shumë sende se disa të tjerë që punojnë me makina jo të teknikës së fundit. Në një rast të tillë, shpërblimi i punës nuk llogaritet dhe nuk duhet të llogaritet vetëm mbi bazën e numrit të sendeve të prodhuara, ndryshe dy punëtorë të së njëjtës mjeshtëri dhe me nivel të njëjtë kualifikimi, do të marrin paga të ndryshme: ai që punon me makineri të perfeksionuara do të ishte i favorizuar. Kjo nuk do të ishte e drejtë. Në caktimin e pagës së punëtorit duhet të llogaritet, siç është vepruar gjer tani, edhe aftësia në bazë të kualifikimit të punëtorit. Në këtë mënyrë caktimi i normave dhe shkallëzimi i tyre do të jenë në përputhje me parimin socialist.

Ne nuk mund ta ndryshojmë tani sistemin tarifor të pagave, duke përdorur tarifa të diferencuara për punëtorët që punojnë me norma teknike, siç u tha këtu, për arsye se po t'i futeshim tash kësaj pune, do të nevojitej rishqyrtimi në tërësi edhe i sistemit të pagave. Ne, aktualisht, duhet të nisemi nga parimi që të ruajmë sistemin tarifor të pagave dhe kategorizimet në fuqi.

Programi i zbatimit të normave teknike lidhet ngushtë me kualifikimin e punëtorëve. Punëtorët e dinë dhe e kuptojnë se kur nuk e kanë kategorinë e vendit ku punojnë, por kanë një ose dy katogori më poshtë, do të paguhen më pak, sipas kategorisë. Kështu, punëtorët, duhet të ndjekin kurset për t'u kualifikuar, ndryshe vështirësohet realizimi i normave teknike.

Por, mua më duket se ka ardhur koha që kategoria personale të përputhet me kategorinë e vendit të punës. Mospërputhjen e gjertanishme kemi qenë të detyruar ta pranojmë, për arsye se niveli i punëtorëve ka qenë i ulët, kurse nevojat e shoqërisë ishin të mëdha. Kjo, në shumë raste, ka bërë që punëtori i kategorisë më të ulët të punonte në një vend pune që kërkonte një kategori më të lartë. Tani nuk është më situata kur njerëzve u luteshim të kualifikoheshin në shkolla dhe kurse dhe ata me zor bindeshin. Si rezultat i punës së madhe që kanë bërë Partia dhe organet shtetërore, kualifikimi i punonjësve tanë është rritur, por janë rritur njëkohësisht edhe kërkesat e industrisë sonë për punonjës të kualifikuar. Prandaj, nuk është e drejtë që një punëtor i kategorisë së tretë të punojë në një vend pune të kategorisë së pestë, kurse ai që ka një kategori më të lartë të punojë në një vend me kategori më të ulët.

Këto anomali, që vijnë në kundërshtim me disiplinën e vërtetë socialiste, duhet të eliminohen tash, pavarësisht se mund t'u mbetet hatëri atyre që, me gjithë thirrjet e vazhdueshme që u janë drejtuar dhe mundësitë e krijuara, s'kanë bërë asnjë përpjekje për kualifikim. Është koha që njerëzit, sa të jetë e mundur më shumë, të zënë vendet e tyre sipas shkallës së kualifikimit dhe nuk ka më arsye të bëhen lëshime në këtë drejtim. Për këtë qëllim, para disa kohe, kemi dhënë orientime që Qeveria është duke i studiuar për t'i sanksionuar në rrugë shtetërore.

Është e domosdoshme të rishikojmë të tëra kategoritë që kemi sot, në mënyrë që shpërblimi i punës të bëhet në bazë të asaj kategorie për të cilën punonjësi

është me të vërtetë i aftë. Ne e kemi për detyrë t'i themi punëtorit që, në qoftë se dëshiron të qëndrojë në punën e caktuar dhe të shpërblehet sipas kategorisë së vendit të punës, brenda një ose dy vjetëve, ai duhet të bëjë përpjekje që të perfeksionohet. Por, ama, gjatë kësaj periudhe dhe gjer sa të aftësohet, ta ketë të qartë se nuk do të marrë kaq sa ka përfituar pa të drejtë gjer tani, prandaj në njëfarë mase paga do t'i ulet.

Unë mendoj të mos gjykohet se «ata që punojnë pa norma teknike, po grabitin shtetin»! Natyrisht, akoma nuk janë në nivelin e duhur as punët e administratës, as ndërgjegjja e klasës punëtore, as puna e Partisë, por, veç, nuk duhet ta nxijmë të vërtetën dhe të mbivlerësojmë më shumë sesa është ndonjë gabim që vërtetohet. Një mendim i tillë, i krijuar për ata që nuk punojnë me norma teknike, nuk i përgjigjet realitetit; ai e ka burimin në një koncept të gabuar midis koncepteve të tjera të kësaj natyre.

Po t'i bëhet një analizë e hollësishme punës së punëtorëve që punojnë pa norma teknike, do të dalë se ka shumë midis tyre që janë me ndërgjegje të lartë. Por jemi të bindur se ka të tjerë që nuk e shfrytëzojnë si duhet 8-orëshin e punës, gjë që do të thotë se mungon disiplina proletare në punë. Por, para se të konkludojmë për ndërgjegjen e tyre, duhet të dimë edhe arsyet përse nuk shfrytëzohet koha normale e punës. Ky fenomen shpeshherë ndodh se repartet nuk furnizohen në rregull me ato materiale me të cilat do të punohet. Dobësitë në furnizim nuk rrjedhin gjithmonë për fajin e drejtorit të ndërmarrjes, por edhe për shumë shkaqe të tjera, si për mungesë të automjeteve, për dobësi gja-

të transportimit të materialeve etj. Shpeshherë ndodh të mos ketë qymyr se nuk ka kamionë për ta transportuar, mbasi janë të zënë me shumë ngarkesa. Vërtet transportin ne e kemi të planifikuar, por në praktikë dalin nevoja të paparashikuara që mund të përballohen pa vështirësi, vetëm po të kishim rezerva të mjaftueshme mjjetesh, të cilat tani për tani na mungojnë. Ne që jemi në udhëheqje të Partisë e të shtetit e dimë se ç'vështirësi krijohen gjatë luftës për realizimin e planit dhe çfarë përpjekjesh bëjnë njerëzit tanë për t'i kapërcyer ato.

Me gjithë ekzistencën e disa prej pengesave objektive që përmenda, përsëri punëtorët e tejkalojnë planin. Kjo ndodh, sepse niveli i organizimit dhe ndërgjegjja e klasës nuk janë të ulët, siç mendohet disa herë. Prandaj, jam i mendimit, të mos i dramatizojmë gjërat dhe as të mos vëmë pyetjet: «Si u realizuan këto prodhime», «si u tejkaluan normat» etj. Përpjekjet e punëtorëve që punojnë pa norma teknike janë të mëdha; edhe niveli i kualifikimit të tyre nuk ka mbetur në vend, por ka ecur përpara. Megjithëse shumë prej tyre nuk kanë dhënë provim për të marrë zyrtarisht kategorinë që u përket, ata kanë fituar shprehësi të tilla në punë, sa disa prej tyre, në fakt, e meritojnë t'u jepet menjëherë një kategori më e lartë, se punën që u është ngarkuar e kryejnë me cilësi të mirë.

Kur themi se punëtorët dhe punonjësit përgjithësisht janë të ndërgjegjshëm, bëjnë përpjekje për realizimin e planit etj., kjo nuk do të thotë aspak se ndërgjegjja është krejt e pastër, sa s'ka ku të vejë më, pse ka edhe punëtorë që nuk mendojnë se norma duhet

plotësuar në të gjitha drejtimet që parashikohen. Mungesa e disiplinës, e materialeve etj., reflektohet domos në cilësinë e prodhimeve, që disa herë dalin të dobëta.

Në punë e sipër punëtori, sigurisht, ka parasysh edhe kërkesat e Partisë dhe të popullit për plotësimin e normës me cilësi të lartë, por ai mendon edhe për shpërblimin që do të marrë. E keqja është se ka disa që mendojnë më shumë për të ardhurat që do të marrin vetë sesa për cilësinë e punës që bëjnë, ndryshe s'ka si shpjegohen rastet që u përmendën këtu se në ndërmarrrjet e sharrave në Kukës, të tullave në Lushnjë dhe të komunalet në Dibër, punëtorët, duke «tejkualuar» normat, paguhen shumë më tepër se kategoria e caktuar për ta në librin e kategorizimit dhe arrijnë të barazohen ose bile ta kalojnë shpërblimin e minatorëve të qymyrit, të punëtorëve të naftës dhe të gjeologjisë. Prandaj, në bazë të verifikimeve dhe të kontroleve që janë bërë nga Qeveria, si dhe të vendimeve e urdhërësive që janë nxjerrë, duhet të rregullohet sa më shpejt problemi i normave, se akoma nuk janë prirë mirë «barërat» nën këmbë që i ushqejnë të metat që ekzistojnë. Raportet e vendosura për shpërblimin në sektorët e ndryshëm të ekonomisë të ruhen, edhe sikur t'u mbetet qejfi disa punonjësve në rrethet ku janë bërë këto shkelje. Mua më duket se, duke korigjuar të metat që përmenda, si edhe metodën e punës për kategorizimet, duke parë një çikë më mirë organizimin, disiplinën e të tjera, dhe duke ecur me një perspektivë më të qartë në vendosjen e normave teknike, për aq sa na lejon gjendja dhe jo në mënyrë të ngurtë, pu-

nën që është vënë në rrugë do ta përmirësojmë më tej.

Shoku Pilo Peristeri¹ më tha një ditë kur isha në uzinën «Traktori» se, megjithëse kjo uzinë fonderinë e ka shumë më moderne nga uzinat «Dinamo» e «Partizani», po të vendosen normat teknike, punëtorët e saj, që punojnë në makineri më moderne dhe gjatë tetë orëve prodhojnë më shumë se punëtorët e uzinave të tjera, do të paguheshin më pak se këta të fundit. Për shembull, në qoftë se në uzinën «Traktori» punëtori merr 800 lekë në muaj, në uzinat e tjera do të marrë 1 100 lekë. Unë i thashë që atje duhet të vendosen normat teknike, se në përcaktimin e pagës duhet të merret parasysh jo vetëm makineria, por edhe aftësia e punëtorit, sipas kualifikimit; duhet të merren parasysh, gjithashtu, edhe kushtet e punës etj. Rrogën që merr punëtori i uzinës «Traktori» nuk do ta ngremë, kurse në uzinat e tjera gjendjen e fonderisë, shfrytëzimin e kohës së punës dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për përcaktimin e normës, duhet t'i shikojmë. Në bazë të këtyre kushteve do të përcaktohet diferenca e pagës së punëtorit të uzinës «Traktori» me atë të uzinave «Dinamo», «Partizani» etj. që punojnë me makineri më pak moderne. Ndryshimi i pagave, i rregulluar në këtë mënyrë, nuk ka për të qenë i madh. Pra, një diferencë në shpërblimin e punëtorëve të një uzine më moderne me ata të një tjetre më pak moderne, duhet të ketë.

1. Në atë kohë, kandidat i Byrosë Politike dhe drejtor i uzinës «Traktori».

Nga ana tjetër, duhet të mendojmë si e si të balancohet kjo gjendje dhe të mënjanohen diferencat e padrejta, sepse në fakt punëtorët që punojnë me norma teknike kualifikohen më tepër, prandaj është e kuptueshme që edhe paga duhet të jetë më e madhe. Shoku Pilo të mos druhet se nuk i kthehen më në uzinën «Traktori» punëtorët që shkojnë ushtarë, mbasi këta nuk do të paguhen më mirë në disa ndërmarrje të tjera të kryeqytetit. Ne nuk mund ta rregullojmë çështjen me «shkopin magjik», që, një mëngjes, t'i biem këtij shkopi dhe në gjithë Shqipërinë të vendosen përnjëherësh normat teknike, pa krijuar ndonjë lëvizje në pagat e punëtorëve.

Ne do të kemi norma teknike, norma të përparura, por dhe norma statistikore eksperimentale. Do të kemi, më së fundi, edhe disa procese pune pa norma. Do të ketë rast që ndonjëri të marrë më shumë se të tjerët, gjë që do të vazhdojë të ndodhë dhe këto do të korrigjohen dalngadalë. Por, ndërmarrje pararojë duhet quajtur ajo që zbaton normat teknike. Prandaj, edhe uzina që drejtoni ju, duhet të futet në këtë rrugë, pa u trembur se do t'u ikin punëtorët. Partia të punojë shumë që t'i mbajë punëtorët atje. Ajo është uzinë moderne, prandaj punëtorët s'ka përse të largohen prej saj. Vetëm se duhet bërë një punë më e mirë sqaruese dhe pa formalizëm me të rinjtë, që atyre t'u mbushet mendja që të qëndrojnë në uzinë. Për këtë qëllim punëtorëve të rinj që shkojnë ushtarë, u duhet futur në shpirt dashuria e madhe për uzinën. Mund të ndodhë që edhe pas punës së mirë bindëse të largohen 5 ose 10 punëtorë, por këtë gjë nuk duhet ta përgjithësojmë

e ta ngremë në parim, se në uzinë ka mijëra punëtorë të ndërgjegjshëm. Pa vendosni njëherë pa hezitim normat teknike atje ku ka gjithë ato makineri moderne dhe pastaj do të bindeni që keni vepruar drejt. Natyrisht, disa punëtorëve të uzinave të tjera do t'u ulet paga, po ata duhet ta kuptojnë se kjo është e drejtë. Këtu duhet të ndalemi pak për të parë nëse është norma teknike faktori që ul pagën e punëtorit, apo pamundësia e realizimit të saj.

Në qoftë se norma teknike është e realizueshme dhe realizohet, sigurisht paga nuk ulet, po në qoftë se plotësimi i normës kërkon përpjekje, dituri dhe kapacitet, atëherë duhet të shikohen mundësitë e nxitjes së punëtorit në këto drejtime. Prandaj kjo çështje duhet studiuar. Në qoftë se me zbatimin e normave teknike punëtorëve u rritet kërkesa e prodhimit, atyre edhe pagën duhet t'ua sjellim në një nivel diçka më të lartë se të tjerët që punojnë me norma eksperimentale-statistikore, ndryshe punëtorët nuk nxiten dhe nuk bëjnë përpjekje për të ecur përpara. Pra, që t'u rritet paga, kërkohet që secili të bëjë përpjekje për t'u kualifikuar më tej, të shfrytëzojë më mirë kohën e punës dhe të bëjë gjithçka varet prej tij për të prodhuar më tepër e për të marrë më shumë. Këto janë probleme që zgjidhen në rrugë administrative, prandaj të mos kemi frikë që, atje ku janë kushtet, të vendosim normat teknike mbi baza të studiuara dhe shkencore.

Në çdo rast ne duhet të shkojmë përpara dhe të bëjmë korrigjime. Në qoftë se unifikimi i normave është bërë mbi bazën e mesatares së thjeshtë, siç u tha këtu, të përpigemi ta bëjmë mbi bazën e mesatares së

përparuar. Sigurisht, kjo nuk mund të bëhet kudo, në çdo uzinë, fabrikë etj., por në disa prej tyre, atje ku janë kushtet e përshtatshme, kurse në të tjerat, tani për tani, të vazhdohet puna me normat e thjeshta.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

RENDIMENTI NË PAMBUK VARET NGA SHËRBIMET QË I BËHEN

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

15 dhjetor 1971

Ne e kemi rritur rendimentin në misër, në grurë, duhan etj., kurse në pambuk përkundrazi. Përse në vitet 1964, 1965, 1966, kur kemi pasur po aq sipërfaqe sa kemi edhe sot, kemi marrë rendimente më të larta, megjithëse plehu kimik në ato vite përdorej më pak? Po ashtu agronomë, mekanikë, ujitje dhe insekticide kemi pasur më pak se sot.

Këta tregues vërtetojnë se për pambukun ne kemi pësuar një rënie që buron nga prirja e disa shokëve në rrethe për të mos e mbjellë këtë bimë, duke u justifikuar me mungesën e leverdishmërisë ekonomike, pa marrë parasysh nevojat e vendit. Ky qëndrim bën që ne të jemi keq me pambukun, se nuk i bëhen shërbimet dhe se bima nuk arrin t'i rritë boçat. Natyrisht,

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe rreth një relacioni për bimën e pambukut.

duhet siguruar edhe numri i bimëve, por duhet të jetë në masën e caktuar edhe numri i boçave për çdo bimë. Pra ajo që na thuhet se «s'kemi leverdi që të kultivojmë pambukun», nuk qëndron. Po si do të kemi leverdi kur nuk i bëjmë shërbimet e duhura?

Sipas llogarive të sakta ne e arrijmë bile dhe e kalojmë leverdishmërinë në qoftë se marrim 12 kuintalë për hektar. Unë i thashë edhe sekretarit të Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës që ishte në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror¹, se në fillim edhe kooperativistët e këtij rrethi nuk kishin vërtet leverdi për mbjelljen e panxharit, pse merrnin rendimente të ulëta, kurse tani nuk ankohen më, se Ndërmarrja Bujqësore e Maliqit, kooperativistët e Sovjanit etj., kanë arritur të marrin rekorde botërore, deri në 430 kuintalë panxhar për hektar. Ata nuk thanë kurrë që nuk mund të mbjellin panxhar, kurse nga ju² dëgjojmë kërkesa pas kërkesash që të hiqet pambuku, sepse nuk i vini fare rëndësi pambukut, me pretendimin se keni leverdishmëri më shumë kur mbillni bimë të tjera. Po interesin e blerjes së bezeve, që bëhen krejtësisht me pambuk, çmimi i të cilave po ulet, përse nuk e llogaritni?

Në qoftë se e shikoni çështjen me syrin politik, atëherë tokën e planifikuar për mbjelljen e pambukut do ta gjeni, qarkullime do të bëni, agroteknikën e të tëra shërbimet do t'i zbatoni dhe do të arrini të merrni

1. Shih në këtë vëllim f. 504.

2. U drejtohet shokëve të rretheve Fier e Lushnjë, të pranishëm në këtë mbledhje.

të paktën 12 kuintalë pambuk për hektar. Kooperativa e Maminasit qysh 20 vjet më parë merrte rendimente të larta, deri mbi 20 kuintalë pambuk për hektar në tokat pa ujë dhe në kushte të ndryshme nga ato që kemi aktualisht. Pa mendoni çfarë rezultatesh duhet të kishim tani, po të marrim parasysh përparimet e sotme në mekanikë, në shtimin e sasisë së plehut kimik etj. Edhe po të rritet leverdia për pambukun, kooperativisti prapë mund të mos tregojë kujdes për sipërfaqen e vogël të mbjellë me pambuk, në qoftë se nuk e kupton e nuk bindet për rëndësinë që ka prodhimi i pambukut për shtetin dhe popullin. Ju shokë të Fierit, keni marrë masa për të siguruar zbatimin e agroteknikës për këtë vit, apo keni ecur me mendimin që ta kaloni gjendjen si vitin që shkoi. Konkretisht, çfarë duhet shtuar si kompesim në tokat kripore të Semanit, që t'i mbjellim doemos me pambuk? Të përcaktoni sa, qysh, tek dhe t'ia filloni menjëherë punës. Jo të thoni «si urdhëron» këtu dhe në të vërtetë të mos bëni gjë. Ju vetë thatë se vetëm nga prashitjet dhe shërbimet e tjera që janë bërë me kohë, keni marrë prodhime më shumë, kurse nga vonesat në shërbime keni marrë më pak. A i shikoni dhe a i studioni këto gjëra, që të nxirrni mësim për të ardhmen? Nga sipërfaqja e tokës që dispononi, 7 000 hektarë, për shembull, prej tokave më të mira i lini vetëm për pambukun. Vitin e ardhshëm, këtë bimë do ta mbillni në toka të tjera që të bëhet në këtë mënyrë qarkullimi i koordinuar i bimëve.

Kryesia e kooperativës bujqësore dhe kryetari mbajnë përgjegjësi të plotë për zbatimin e detyrës sipas planit vjetor të prodhimit, të aprovuar nga mble-

dhja e përgjithshme e kooperativës, e cila mbështetet në planet e shtetit dhe në kushtet konkrete të kooperativës. Tokat për të cilat është vendosur që të jenë të destinuara për pambukun, do të përdoren vetëm për këtë qëllim. Asnjë lëshim nuk mund të bëhet në dëm të disiplinës së planit. Në qoftë se është parashikuar dhe vendosur të hidhet 400 kuintalë pleh kimik për pambukun, kjo dozë nuk mund të ndryshohet sipas qejfit të njërit apo të tjetrit, po të merren të gjitha masat që të sigurohet plehu dhe t'i hidhet bimës në kohën e duhur. Kush shkel detyrën dhe për këtë shkak vërtetohen humbje me rëndësi, nuk do të përgjigjet vetëm me një «autokritikë» para mbledhjes së përgjithshme, por edhe penalisht. Ndjenja e përgjegjësisë për realizimin e planit të prodhimit duhet të rritet shumë, pa i kaluar shkeljet lehtë dhe pa përdorur justifikime të tilla si: «Dale se plehun e pambukut ia hodha misrit, shërbimet më të mira ia bëra kësaj bime dhe jo asaj» etj. Po nuk u kuptua dhe po nuk u trajtua kështu përgjegjësia, nuk ka asnjë siguri të plotë për zbatimin e planit.

Atëherë, për këtë çështje të konkludojmë kështu: planit të vendosur nga Kongresi i 6-të të mos i bëhet asnjë lëvizje, ai është i drejtë dhe i realizueshëm. Por, si nga raporti, edhe nga diskutimet që u bënë këtu, del se plani i prodhimit të pambukut nuk u realizua për shumë neglizhenca të dënueshme nga udhëheqjet e Partisë dhe të pushtetit në rrethet ku mbillet kjo bimë, si dhe nga mungesa e mobilizimit të të gjitha forcave dhe mjeteve në kohën e caktuar nga organet përkatëse dhe nga kooperativat. Prandaj, t'u bëhet thirrje Partisë, pushtetit dhe kooperativistëve që, qysh tani, të

fillojnë të mendojnë thellë për t'u përgatitur sa më mirë për këtë problem duke marrë të gjitha masat e domosdoshme që garantojnë prodhimin, që nga mbjellja dhe deri në vjeljen e boçës së fundit të pambukut. Kjo punë duhet marrë nga të gjithë me seriozitetin më të madh dhe me prioritet. Por, një gjë e tillë nuk do të thotë që të neglizhohen bimët e tjera, sepse plani i shtetit që aprovoi Kongresi i 6-të i ka parashikuar drejt të gjitha çështjet që janë studiuar, janë diskutuar dhe vendosur nga baza, prandaj ai duhet të realizohet në të gjitha drejtimet.

Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, bashkë me kryesitë e kooperativave, t'i kushtojnë pambukut një kujdes të posaçëm, duke caktuar që tani për të tokat më të përshtatshme dhe të mos lëvizin nga kjo. Ato të përcaktojnë, gjithashtu, në mënyrë sa më të studiuar kohën e punimeve, farën që do të mbjellin, të gjitha masat agroteknike, të cilat të bëhen në kohën e caktuar.

Unë mendoj se edhe Ministria e Bujqësisë duhet të kontrollojë më me rreptësi zbatimin e këtij projektplanit për çdo rreth, si dhe zbatimin e të gjitha masave organizative që parashikohet të merren. Për sa u përket masave agroteknike që u thanë këtu, veçanërisht për pambukun, ato të merren me përgjegjësi, bile, edhe me firmë. Nga ana e Partisë të hartohet dhe të zbatohet me përpikëri puna politike, e cila të bëhet në shkallë të gjerë kudo në kooperativat bujqësore, duke shpjeguar se interesi ynë, i shtetit, i Partisë dhe i gjithë popullit, është që ne të bëjmë të gjitha përpjekjet për

të prodhuar medoemos gjithë sasinë e parashikuar të pambukut. Të shpjegohet, gjithashtu, se nuk është aspak e vërtetë që pambuku nuk ka leverdi për ne. Kjo të hidhet poshtë si një pikëpamje krejtësisht e gabuar. Por, në qoftë se kultivimin e tij e neglizhojmë, siç është neglizhuar, sigurisht nuk ka leverdi. Bile, atëherë, një gjë e tillë, do të jetë humbje e madhe për kooperativat bujqësore dhe për shtetin, pse, me sipërfaqet që mbjellim me pambuk, zëmë tokat, të cilat, si plan, i llogaritim, po nuk marrim gjë prej tyre, kështu që ato na venë kot. Ekonomia jonë popullore pastaj humbet me miliona lekë valutë, mbasi detyrohet ta blejë jashtë gjithë sasinë e pambukut që nuk arrijmë ta prodhojmë sipas planit; shteti detyrohet kështu t'i subvencionojë tekstilet që populli i blen me çmime të lira. Ne, shokë, i kemi plotësisht mundësitë që, në kushtet tona tokësore dhe klimatike, të marrim 12, 14 dhe më shumë kuintalë për hektar, siç kanë marrë sa e sa brigada të përparuara që përmendët edhe ju këtu.

Problemit të pambukut duhet t'i japim prioritet, por pa lënë pas dore asnjë nga bimët e tjera; të gjitha duhet t'i realizojmë, sepse për të tëra kemi përgjegjësi. Po ta kuptojmë drejt problemin dhe të mobilizohemi seriozisht, kam besim që do të dalim nga kjo situatë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH,
që gjendet në AQP*

E KALOFSHI VITIN E RI PLOT SUKSESE NË PUNË

*Fjala në mbrëmjen e organizuar me rastin e
Vitet të Ri 1972 me punonjësit e aparatit
të KQ të PPSH*

29 dhjetor 1971

Megjithëse ka akoma dhe dy a tri ditë sa të vijë Viti i Ri sonte jemi mbledhur që ta festojmë atë të gëzuar të gjithë bashkë.

Sivjet po shoh që kemi më shumë kalamanë se vitin e kaluar. Vjet, atje lart në skenë, ishte vetëm orkestra, ndërsa sonte shikoni si është mbushur, plot me njerëz të brezit të ri, pa të cilët nuk ka lezet festa. Me kalamanët, të rinjtë e të rejat, mbrëmje të tilla si kjo, bëhen akoma më të gëzuara.

Ju ftoj, me këtë rast, të gjithë të mbushni gotat, kurse ju kalamanët merrni pirunët në dorë dhe futjuni pastave; sonte mos i kurseni hiç nënat e baballarët!

Dy herë e festojmë ne Vitin e Ri, një herë me kolektivin dhe natën duke u gdhirë 1 Janari, që zakonisht e kalojmë në shtëpi së bashku me nënat e baballarët, me gjyshet e gjyshërit. Nganjëherë qëllon që gjyshërit janë të rinj, pa përmendur gjyshet, për të

cilat nuk guxoj të them gjë, se ndoshta dikujt i vjen keq, pasi ato janë më të reja.

Sonte këtu jemi pak njerëz të moshuar dhe, megjithëse dëshirojmë të jemi të rinj, kohën që të bëhemi dhe ne të tjerët gjyshër, si shoku Hysni e shoqja Vito, e presim me gëzim. Do të vijë dita që edhe ne të kemi në familjet tona kalamanë të vegjël.

Le ta ngremë këtë gotë për shëndetin tuaj, të dashur shokë e shoqe! E kalofshi Vitin e Ri plot suksese në punën e madhe dhe me përgjegjësi që ju ka ngarkuar Partia! Qofshi të lumtur e të gëzuar, me gjithë të dashurit e zemrave tuaja, kudo që të jeni!

1972-shi le të jetë një vit plot suksese në politikën e Partisë sonë të lavdishme, në realizimin e të gjitha detyrave të mëdha që caktoi Kongresi i 6-të! Si ushtarë të Partisë që jemi, bashkë me gjithë popullin, kemi bindje të plotë se do t'ua arrijmë caqeve që kemi vënë, bile edhe do t'i kapërcejmë detyrat që na ka ngarkuar Partia.

Prandaj, sonte, në këtë festë shoqërore e familjare, ta ngremë dollinë për lavdinë e Partisë sonë!

Për lumturinë tuaj të dashur shokë e shoqe!

Të rrojë Partia!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë mbrëmje, që gjenden në AQP

TREGUESIT

TREGUESI I LËNDËS

A

Afrika; lëvizjet dhe luftërat çlirimtare e revolucionare të popujve të këtij kontinenti — 120, 133, 139, 151, 308, 314, 329, 453.

Akumulimi; fondi i akumulimit dhe ai i konsumit — 78-79, 185-186, 193-194.

Aleanca dhe rivaliteti sovjet-amerikan — 132-135, 145-147, 499-500.

Amerika Latine; lëvizjet dhe luftërat çlirimtare e revolucionare të popujve të këtij kontinenti — 120, 126, 151, 306, 308, 314-315, 316, 329, 414, 453, 454.

Anglia, imperializmi anglez — veprimtaria armiqësore kundër Shqipërisë — 38, 41, 42, 127, 141, 304, 396-397, 398-399, 438, 439-442, 500.

Arkeologjia; kërkimet dhe zbulimet arkeologjike — 104-105.

Armatimi dhe çarmatimi. Demagogjia e superfuqive për

çarmatimin — 133-134, 144-145.

Arsimi. Politika e Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës — 159-160, 167, 250-253, 356, 365, 422-424, 426-430, 449-450.

Azia; lëvizjet dhe luftërat çlirimtare e revolucionare të popujve të këtij kontinenti — 120, 123, 126, 139, 151, 308, 314, 329, 453.

B

Bashkimi Sovjetik (1917-1953) — 399, 437-438, 457.

Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik. Politika ekspansioniste dhe hegjemoniste e socialimperializmit sovjetik — 37-39, 44-45, 121-122, 128-132, 138, 139, 206, 283, 299-300, 319-320, 499-500;

— *qëndrimi armiqësor kundër PPSH dhe RPSH* — 19, 20, 155-156, 411, 457-458.

Baza materialo-teknike e so-

cializmit — 163-174, 192, 259, 455-456.

Blegtoria — *zhvillimi, modernizimi dhe struktura e blegtorisë* — 26-27, 75-76, 176-177, 179-180, 406.

Bujqësia

— politika e Partisë për zhvillimin dhe intensifikimin e bujqësisë — 15, 74-76, 101-102, 158, 166, 175-184, 355, 364, 400-401, 402;

— organizimi dhe drejtimi shkencor në bujqësi; puna kërkimore-shkencore — 26-27, 178-179, 180-181, 375, 512-513;

— zhvillimi i bujqësisë në zonat malore e kodrinore — 74-75, 158, 177-178, 401-407, 431-435;

— agroteknika, qarkullimi bujqësor, specializimi — 179, 511-512, 542-544, 545;

— hapja e tokave të reja; trajtimi shkencor i tokës — 177-178; 404, 505, 506, 510, 542, 543, 544;

— drithërat e bukës, bimët industriale (pambuku, panxhari i sheqerit) — 102, 176, 402-403, 406, 508, 541-546;

— pemëtaria, fidanet — 177, 408-409;

— ujitja, veprat ujitëse —

166, 403, 404-405, 431-435.

Burokratizmi, teknokratizmi — lufta kundër shfaqjeve të tyre — 204-206, 208-210, 213, 216, 244-245.

D

Demokracia socialiste. Centralizmi demokratik — 197-198, 203-204, 206-209, 215, 216-217, 233-234, 284-285.

Dëshmorët — 425, 448-449.

Diktatura e proletariatit — 203-204, 205-206.

Disiplina proletare — 180, 186, 191-192, 236, 374-377, 513, 533-534;

— disiplina shkencore — 180-181, 186, 513-514, 516-517;

— disiplina financiare dhe ajo e planit — 12-13, 506-507, 513-514, 544.

E

Edukimi komunist dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja — 7-8, 9-15, 219-220, 227-228, 229, 240, 242, 246, 249-250, 275-278, 374-377, 426, 443-446.

Efektiviteti ekonomik — 184-185, 186-187, 514, 546.

Ekonomia popullore; struktura e degëve dhe perspektivat e zhvillimit të saj — 16, 22,

74, 157-164, 168-169, 171-173, 175-176, 185-186, 188-189, 223-224, 399, 410-413;
— organizimi dhe drejtimi shkencor i saj — 5-6, 16, 22, 163, 192, 196-201.

Enver Hoxha — të dhëna autobiografike — 61-71, 80-85, 105-107, 356, 378-379, 381, 393, 395-397, 400-401, 423, 427, 436-440, 447-448, 455, 457, 459, 464, 466, 467, 469, 471; 487-488.

Evropa, «sigurimi evropian» — ndërhyrjet e imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik në këtë kontinent — 38-39, 40-43, 48, 140-144; 329, 502.

F

Familja; demokratizimi i saj — 233-234.

Feja; lufta kundër saj — 230-231.

Folklori; ruajtja dhe pasurimi i tij — 459-460.

Fshati socialist — 182-183, 195, 273.

G

Gruaja shqiptare; politika e Partisë për emancipimin e gruas — 50, 231-233, 274, 336.

GJ

Gjermania. Traktati Sovjeto-Gjerman dhe R. D. Gjermane — 38-39, 42, 140-141.

H

Historia e Shqipërisë (Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë. Qeveria e Vlorës. Revolucioni Demokratiko-Borgjez i vitit 1924. Regjimi feudalo-borgjez i Zogut) — 382-383, 384-385, 387.

I

Ideologjia borgjeze dhe mikroborgjeze, lufta kundër tyre — 21, 229, 235-238, 244, 246-247, 300-301, 322, 451-452.

Imperializmi — lufta e popujve kundër imperializmit, disfatat e tij — 123, 128.

Industria

— politika e Partisë për industrializimin socialist të vendit — 168-174;

— zhvillimi, modernizimi, struktura e industrisë — 15, 27, 102-103, 157-158, 163, 165-166, 169, 352, 364, 410-413;

— industria e naftës dhe e gazit — 76; 411-412, 471-475;

— industria elektrike, elek-

- trifikimi i vendit — 160, 170-171, 412-413;
- industria metalurgjike (metalurgjia e zezë) — 169, 410-411, 456;
 - industria minerale, gjeologjia — 19-20, 76, 169-170, 457-459;
 - industria mekanike, prodhimi i makinave — 171-172, 455;
 - industria e material-ndërtimit — 187, 354-355;
 - industria e lehtë dhe ushqimore — 173-174, 352-354, 449, 477-478, 481-482.

Iniciativat, lëvizjet dhe akcionet revolucionare të masave — 161-163, 173-174, 189-190, 230, 279-282.

Interesi i përgjithshëm dhe interesi vetjak — 236-237, 415.

Internacionalizmi proletar — 109-111, 360-331, 350-351, 362, 370-371, 493-494.

Investimet — politika e Partisë në fushën e investimeve.

Efektiviteti i investimeve — 15-16, 167, 184-186, 509-510.

Inteligjencia — 4, 241-242.

J

Jugosllavia, revizionizmi jugosllav — 19, 43, 73, 147, 324-327, 395-396, 497-498.

K

Kapitalizmi — 19, 122-123, 304-305, 452-453, 523.

Kina; politika proimperialiste e saj — 40-41, 72-73, 86-91, 492-493, 493-499, 501.

Klasa punëtore — roli udhëheqës; edukimi ideologjik, kulturor e tekniko-profesional i saj — 3, 209-212, 239-241, 271-273, 474, 476, 482, 532-540.

Komunisti — cilësitë, detyrat; edukimi i tij — 4-5, 31-33, 266, 267, 268-269, 275-278, 281-282, 366, 416-417, 445-446, 489.

Kontradiktat, kriza në botën kapitaliste dhe revizioniste — 35-37, 41-45, 117-125, 298, 319.

Kontrolli i klasës punëtore dhe i masave punonjëse në shoqërinë tonë socialiste — 14, 204, 209-212.

Kooperativat bujqësore. Organizimi dhe drejtimi shkencor i punës në to. Kooperativat e tipit të lartë — 178-183, 400-401.

Kritika dhe autokritika — 77-78, 429-430.

Kuadrot; politika dhe puna e Partisë me kuadrin — 181, 204, 213-215, 262, 290-295, 407-408, 409, 474, 477, 478-480, 516-517, 518.

Kultura fizike dhe sportet — 253.

Kultura; zhvillimi i saj dhe ngritja e nivelit kulturor të masave — 253-255.

Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë; domosdoshmëria e hartimit të Kushtetutës së re — 222-223, 225-226.

L

Legjislacioni socialist, përsosja e tij. Njohja, mbrojtja dhe zbatimi i ligjeve — 10-15, 221-222, 223, 225.

Lenin, Vladimir Iliç — 208-209, 218, 237, 302, 304, 307, 309, 311, 316.

Letërsia dhe artet — zhvillimi; roli i tyre në edukimin e masave — 255-257, 356.

Lëvizja marksiste-leniniste ndërkombëtare — zgjerimi dhe konsolidimi i saj. Forcimi i unitetit të partive marksiste-leniniste — 109-111, 121, 329-331, 350-351, 359-362, 370, 371, 491-492, 496, 521-527.

Lëvizjet nacionalçlirimtare të popujve — 120-121, 136-140, 364.

Lufta e klasave. Lufta e klasave në fushën ideologjike — 117-125, 203-206, 227, 228-230, 238-239, 246-247, 301-302, 312, 330, 491.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar; roli udhëheqës i Partisë në këtë luftë — 60-61, 63-71, 385-398, 437-438, 439-443, 447-449, 461, 522-523, 524-525.

M

Marksizëm-leninizmi — përvetësimi, mbrojtja dhe zbatimi i tij — 114, 246-249, 277, 312, 319, 365, 451-452, 454, 462, 492, 522, 526.

Marks, Karl — 19, 25, 208, 312.

Marrëdhëniet socialiste në prodhim; përsosja e vazhdueshme e tyre — 23, 158-159, 182, 224.

Mbrojtja e atdheut — përgatitja e ushtrisë dhe e popullit për mbrojtje — 217-221, 374-377.

Mekanizimi i proceseve të punës; roli i tij për rritjen e prodhimit — 8-9, 178, 190-191.

Metoda dhe stili në punë — 5-8, 24-25, 199-200, 220, 249-250, 269-270, 289-290, 293-295, 405-406, 427-428, 444-445.

Ministritë

— *Ministria e Bujqësisë* — 513, 545;

— *Ministria e Industrisë dhe e Minierave* — 459;

— Ministria e Komunika-
cioneve — 187.

*Mirëqenia materiale dhe ngri-
tja e nivelit kulturor të ma-
save* — 159, 167, 182-183, 193-
196.

*Monumentet e kulturës; ru-
ajtja dhe mirëmbajtja e tyre*
— 103-105.

Muzeumet; pasurimi i tyre —
— 419-421, 460-463.

N

*Ndërgjegjja socialiste; forcimi
i saj* — 23, 237, 450-452, 534,
535-536.

*Ndërmarrjet ekonomike —
përsosja e organizimit dhe e
drejtimit të tyre* — 199-200,
514;

— ndërmarrjet bujqësore —
organizimi dhe drejtimi
i punës në to — 178-179,
504-508, 512-513.

*Ndërtimet. Organizimi dhe
drejtimi i punës* — 186-187,
355.

*Ndërtimi i socializmit në
Shqipëri. Roli vendimtar i
masave në ndërtimin socialist
të vendit* — 17-18, 49-50, 63-
64, 71-72, 74, 76-77, 112-116,
160-163, 175, 206-207, 209-
210, 212-213, 222-224, 265,
331-332, 363-366, 369-370,
380-381, 395-399, 413-414, 453-
454, 491-492, 493-496;

— kalimi në etapën e ndër-
timit të plotë të shoqë-
risë socialiste — 157, 163-
164, 201-202, 224-226,
349-350, 361.

*Ngushtimi i dallimeve midis
fshatit dhe qytetit* — 181, 183.

Normimi i punës, normat —
180-181, 192, 523-540.

O

*Organet e Ministrisë së Pu-
nëve të Brendshme* — 221.

*Organizata-bazë e Partisë —
roli udhëheqës; gjallërimi dhe
revolucionarizimi i saj* — 5-7,
8, 12, 13, 14-15, 31, 269-
270, 279-282, 286-287, 516-
517.

*Organizatat e masave; roli
udhëheqës i Partisë në to* —
288-290.

P

*Pagat — politika e Partisë
në fushën e pagave. Shpër-
blimi i punës në socializëm*
— 181, 182, 192, 415-416,
531-534, 536-540.

Partia e Punës e Shqipërisë
— vija politike; vendimet
direktivat, dokumentet e
Partisë; njohja dhe zba-
timi i tyre — 10-11, 31-
33, 53-54, 58-59, 73-79,
112-116, 198, 205, 294,

- 399-400, 443-444, 514-517;
- karakteristikat revolucionare marksiste-leniniste të saj — 53-54, 115, 263-264, 279, 339, 348-349, 365-366, 425-426;
 - roli udhëheqës i Partisë — 263-270, 348, 364, 365, 425-426;
 - parimet dhe normat e Partisë, iniciativa dhe vetëveprimi — 6, 282-287;
 - zgjedhjet në Parti — 2-3, 6-7, 54-57, 333-342, 344-345;
 - pranimet në Parti — 272-273, 274, 275, 446;
 - përbërja, shtrirja dhe moshja e efektivit të Partisë — 53-57, 270-275;
 - Letra e Komitetit Qendror për Bujqësinë (janar 1971) — 2, 178, 505, 512-519;
 - solidariteti dhe përkrahja internacionaliste për lëvizjen marksiste-leniniste — 350-351, 361-362, 370, 492, 521-527;
 - lufta kundër revizionizmit — 296, 297-298, 350-351,
- Partia e Punës e Shqipërisë*
- organet udhëheqëse të saj
 - Kongresi i 5-të i PPSH — 2, 3, 52, 53, 115, 118, 157,
 - 158, 210, 221, 224, 263, 339, 402;
 - Kongresi i 6-të i PPSH — 52-53, 54, 58, 59, 86, 92, 94, 95-96, 97, 98, 99, 109, 110, 112-116, 333-342, 343-344, 347-351, 366-367, 368, 401-402, 417, 525, 544-545;
 - Plenumi i parë i KQ të PPSH (7 nëntor 1971) — 343-346, 347;
 - Plenumi i 3-të i KQ të PPSH (13-14 tetor 1967) — 172, 190;
 - Plenumi i 9-të i KQ të PPSH (26-27 dhjetor 1969) — 2, 5, 190, 528;
 - Plenumi i 10-të i KQ të PPSH (25-26 qershor 1970) — 2, 5, 197;
 - Plenumi i 13-të i KQ të PPSH (12 tetor 1971) — 52-59;
 - Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretariati i Komitetit Qendror — 53-58, 59, 225, 263, 273, 331, 333-342, 344, 345, 347-348, 361, 368, 473;
 - Komisioni Qendror i Kontrollit dhe i Revizionimit të Partisë — 333, 341;
 - Organizata dhe Komiteti i Partisë i rrethit të Skraparit — 404, 406-408;

— Konferenca e 18-të e Partisë e rrethit të Tiranës — 1-39;

Partia e Punës e Shqipërisë
— përvoja dhe masat e saj për t'i prerë rrugën revizionizmit dhe për të siguruar çuarjen përpara të revolucionit dhe të ndërtimit të socializmit — 115-116, 203-217, 263-264, 272, 275-276, 283-284, 287.

Pensionet në kooperativat bujqësore — 183, 414.

Planifikimi

— karakteri shkencor dhe metodologjia e planifikimit — 199, 505-508, 513-514, 516, 544, 545-546;

— hartimi i planeve, lufta për realizimin e tyre. Planet prognozë — 199, 543-546;

— plani i katërt pesëvjeçar (1966-1970) — 157-163, 175-176, 188-189, 366-367;

— plani i pestë pesëvjeçar (1971-1975) — 4, 15-16, 57-58, 164-174, 176-178, 184-186, 187, 189, 193-194, 195-196, 201-202, 367-368, 455-456, 475, 495-496;

— pjesëmarrja e masave në planifikim — 164-165.

Politika dhe ideologjia. Politika në plan të parë — 444-

-445, 489.

Politika e jashtme e RPSH

— parimet themelore të politikës së jashtme — 149-154;

— rritja e prestigjit dhe e autoritetit të PPSH dhe RPSH në botë — 34, 72-73, 147-148, 156, 414-415;

— qëndrimi parimor marksist-leninist ndaj problemeve ndërkombëtare. Lufta kundër imperializmit dhe revizionizmit — 34-37, 41-43, 125-135, 138, 140, 143-144, 148-149, 330-331, 496-501, 502;

— marrëdhëniet me Kinën — 40, 45-46, 47-48, 50-51, 86-88, 91-100, 101, 102, 107, 110-111, 491-494, 496, 502-503;

— marrëdhëniet me vendet fqinje — 152-154;

— marrëdhëniet me vendet arabe — 140, 151, 501-502;

— marrëdhëniet me Vietnamin dhe Korenë — 138, 150, 370-371;

— marrëdhëniet me vendet e Evropës Lindore — 155-156.

Populli shqiptar

— luftërat e tij për liri, pavarësi e përparim shoqëror — 19-20, 386-387;

- roli dhe pjesëmarrja e tij në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin socialist të vendit — 20-21, 60-72, 106-107, 161-163, 222, 369.
- Prodhimi i mallrave. Përputhja e prodhimit të mallrave të përdorimit të gjerë me juqinë blerëse të popullsisë* — 173-174, 194-195, 358, 478-479.
- Prodhimi material — shtimi i pandërprerë dhe rritja e cilësisë së tij* — 168-173, 188-192, 200-201, 246, 477-482.
- Prona e grupit dhe shndërrimi i saj në pronë të të gjithë popullit. Qëndrimi socialist ndaj pronës* — 11-15, 181-182.
- Puna — organizimi i saj. Qëndrimi socialist ndaj punës* — 191-192, 533-534.
- Pushteti Popullor, karakteri demokratik i tij* — 206-209; — organet e zgjedhura dhe ato ekzekutive — 204, 215-216.
- R**
- Regjimi i kursimit* — 184-185, 186.
- Rendimenti i punës — rrugët për rritjen e tij* — 16, 188-192, 511-512.
- Revizionizmi modern — kontradiktat, kriza, disfatat. Lufta kundër tij* — 123-124, 296-298, 299-300, 305-306, 313-314, 359-360.
- Revolucioni demokratiko-borgjez* — 308-309, 385.
- Revolucioni ideologjik dhe kulturor* — 227-262.
- Revolucioni socialist — përmbajtja dhe zhvillimi i tij. Faktorët objektivë dhe subjektivë* — 33-35, 118-122, 135-136, 203-204, 298-299, 313-318, 384; — forcat lëvizëse; udhëheqja e partisë marksist-leniniste dhe roli hegemon i klasës punëtore — 298, 302-313, 317.
- Revolucioni tekniko-shkencor* — 17, 18-19, 189-190, 241.
- Rinia dhe BRPSH. Edukimi komunist i rinisë* — 242, 243-245, 424, 429-430, 450-451, 456-457, 458-460.
- Rinia në vendet borgjeze dhe revizioniste* — 119, 242-243, 306.
- S**
- Socializmi* — 194, 196, 228-229, 318-329, 526.
- Stalin, Josif Visarionoviç* — 9, 457.
- Strehimi i popullsisë, ndërtimi i banesave* — 160, 167, 195-196.
- Studimi, studimi individual* — 24-25.

SII

Shëndetësia; kujdesi i Partisë për shëndetin e popullit —

356-357, 484-485, 487-488.

Shkenca dhe teknika — 18, 189-190, 191, 453;

— organizmat shkencorë dhe punonjësit e tyre — 22-23, 28-31, 261-262;

— puna kërkimore shkencore, studimet shkencore. Organizimi dhe drejtimi i tyre; lidhja e shkencës me prodhimin — 21-22, 25-30, 258-262;

— roli i masave në zhvillimin e shkencës dhe të teknikës — 20-22, 259-260.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës — gjendja e brendshme dhe politika e jashtme; kriza dhe disfatat e imperializmit amerikan — 35-37, 43, 119, 125-127, 136-140, 499-500.

Shtypi; roli dhe detyrat e tij — 212-213.

T

Teoritë borgjezo-revizioniste; lufta kundër tyre — 130-131, 135, 137-138, 197;

— për revolucionin, socializmin dhe revolucionin tekniko-shkencor — 18-19, 241, 299-301, 313-318, 323-324, 327-328;

— për misionin historik të klasës punëtore dhe rolin udhëheqës të partisë marksiste-leniniste — 302-313.

Të huajt për Shqipërinë — 453-455, 463.

Transporti; organizimi dhe zhvillimi i tij — 187.

Tregtia e brendshme dhe tregtia e jashtme — 194-195, 449.

U

Unileti Parti-popull — 66, 80, 343-349, 366, 416-417, 425-426, 464-465.

Ushtria Popullore — roli udhëheqës i Partisë dhe revolucionarizimi i saj — 218-221, 374-377.

V

Veteranët — 60-71, 80-85, 105-106.

Vietnami; lufta e popullit vietnamez kundër agresorëve amerikanë — 44, 90, 120, 126, 137-138, 142, 146, 150, 371.

Vija e masave — 58, 200-201, 206-208, 212-213, 285-290.

ZH

Zhvillimi dialektik i shoqërisë. Lufta e të kundërtave — burim zhvillimi — 208-209, 244, 245-247, 256, 269, 284, 294-295, 452-453.

TREGUESI I EMRAVE

A

- Alia, Ramiz — 521.
Agolli, Adivije — 66, 80.
Aranitasi, Ramiz — 423.

B

- Beluli, Arif — 82.
Bicaç, Belul — 82.
Bilimani, Gani («Negus») —
69-70, 436-437, 438, 441, 443,
447-448.
Bilimani, Novruz — 69, 70,
437, 439, 468.
Bilimani, Nuri — 69.
Bilimani, Nurihan — 69, 70,
81, 437, 442, 447, 448.
Boduri, Dhimitër — 81.
Boduri, Muço — 81.
Bozhiqi, Veli — 84.
Brand, Vili — 38.
Brezhnjev, Leonid — 38, 44.
Bruçaj, Ismet Sali — 161.

C

- Cerga, Iljaz — 431, 433, 434,
435.

- Cerova, Riza — 383-384, 460-
-461.
Cfiri, Tefik — 396, 441.
Coha, Hurma — 81, 82.
Coha, Ymer — 81-82.
Cungu, Ali — 441.

Ç

- Çan Kai Shi — 91.
Çan Pao Y — 28, 45.
Çaushesku, Nikolae — 42, 94.
Çeka, Ramë — 68.
Çeka, Selime — 84.
Çeka, Sherif — 68, 83.
Çen Po Ta — 88.
Çepani, Njazi — 394.
Çiao Kuan Hua — 501.
Çollaku, Muharrem — 70.
Çollaku, Reshit — 70, 71.
Çu En Lai — 87, 88, 89, 91,
92.

D

- Dashi, Riza — 66.
Dedja, Katerina — 82.
Disha, Abaz — 67, 68, 84, 106.
Disha, Kadife — 67, 68, 84.

- Disha, Zenel — 67. 435, 438, 439, 464, 469, 489.
- Dishnica, Ymer — 395.
- Deivis, Edmund — 440.
- Dollaku, Kristaq — 477, 478, 479, 480, 481.
- Dyrmishi, Tare — 67, 69.
- E**
- Elezi, Agron — 161.
- F**
- Farka, Hatixhe (Ije) — 66.
- Frashëri, Abdyl — 383.
- Frashëri, Naim — 451.
- Frashëri, Mehdi — 441.
- Frashëri, Sami — 451.
- Fuga, Myqerem — 394.
- Fundo, Zai — 395.
- G**
- Gabrani, Sabaudin — 66.
- Galica, Shote — 356.
- Gandi, Indira — 497, 500.
- Gradeci, Sulo — 394, 430.
- GJ**
- Gjinishi, Mustafa («Tafari») — 439-442.
- Gjoni, Liko — 70.
- Gjura, Ali — 67, 84, 85.
- H**
- Hoxha, Nexhmije — 428, 433, 435, 438, 439, 464, 469, 489.
- Hasani, Sherif — 65, 82.
- Hoxha, Myftar — 68.
- Hrushov, Nikita — 372, 457-458.
- Hysi, Neshat — 394.
- Hysi, Pasho — 70, 394.
- I**
- Ivanov, K. P. — 438.
- K**
- Kapo, Hysni — 65, 68, 82, 548.
- Kapo, Vito — 548.
- Kaçorri, Frrok Kolë — 28.
- Kalivaçi, Zyko — 70-71.
- Kan Shen — 88.
- Karagjozi, Hasan — 85.
- Karagjozi, Ramë — 62-63.
- Koçi, Beqir — 105.
- Koçi, Zyhra — 67-68, 81, 105-106.
- Konjari, Elmaz — 357.
- Kosigin, Aleksei — 44.
- Kryeziu, Gani — 395.
- Kuçi, Xhafer — 394.
- Kushi, Vojo — 66.
- Kyri, Mari — 25.
- Kyri, Pier — 25.
- L**
- Lin Biao — 87, 88, 91, 98, 99.
- Liu Shao Çi — 87.
- Longo, Luixhi — 94.
- Lula, Anastas — 423.

M

- Myftiu, Manush — 1.
 Malindi, Teki — 394.
 Mao Ce Dun — 87, 90, 94,
 499.
 Marku, Gjin — 395.
 Markuze, Herbert — 303.
 Martini, Xhoxhi — 66.
 Mikojan, Anastas — 97.
 Moisiu, Spiro — 67, 68, 82.
 Musai, File — 67, 69, 83.
 Musai, Kadri — 83.
 Myftiu, Ali — 67.
 Myslimi, Hilmi — 468, 469.
 Myslimi, Mehmet — 69, 82-
 -83, 395, 397, 438, 442, 466,
 467, 468, 469.

N

- Nushi, Gogo — 66.
 Negesti, Negus — 437, 443.
 Nesho, Gaço — 477.
 Nikols (koloneli) — 440, 441,
 442.
 Nikson, Riçard — 43, 89, 92,
 95, 122, 137, 138, 499.
 Nishova, Mane — 394, 461,
 464, 469.
 Noli, Fan — 385.

O

- Osmani, Sabrie — 85.
 Osoja, Asllan — 394.

P

- Peristeri, Pilo — 537, 538.

- Peza, Myslim — 442, 485.
 Pin De Hua — 87.
 Premtja, Sadik — 65.
 Podgorni, Nikollai — 44.

Q

- Qemali, Ismail — 382, 383.

R

- Rama, Kristaq — 356.
 Reka, Adem — 161.

S

- Stafa, Qemal — 66.
 Sadat, Anvar el — 501.
 Spathara, Xhevahir — 394.
 Stavaleci, Sadik — 66.

SH

- Shchu, Muhamet — 161.
 Shyri, Myslim — 66.

T

- Tito, Josip Broz — 42, 73;
 94, 497-498, 500.

TH

- Therepeli, Pertef — 394.

V

- Vata, Shkurte Pal — 161.

Veleshnja, Shqiponja — 484,
487.

Veleshnja, Zylyftar — 394,
484-490.

Veshi, Nimete — 65, 79.

Vokshi, Asim — 64.

Vokshi, Bije — 64-65, 73.

Y

Ylli, Kahreman — 394, 404,
469.

Z

Zaimi, Xiko — 448.

Zaloshnja, Hysen — 70.

TREGUESI' GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

Adriatik (deti ~) — 472.
Ansamblu i Këngëve dhe i
Valleve Popullore — 49.
Ardenicë (Lushnjë) — 472.
Argjentinë — 120, 454.
Asambleja Kushtetuese — 222.

B

Ballkan — 152, 153-154.
Batër (Mat) — 458.
Berat — 103, 471.
Berlin — 38, 141.
Birmani — 120.
Bolivi — 120.
Brazil — 120.
Bubullimë (Lushnjë) — 472.
Bulqizë (Dibër) — 458.
Bullgari — 44, 130, 146, 147,
493.

Ç

Çekosllovakia — 130, 142, 146,
147, 314.
Çeta partizane
— e Dibrës — 390.

— e Gjirokastrës — 390.
— e Korçës — 390.
— e Krujës — 390.
— e Lumës — 390.
— e Mallakastrës — 390.
— e Matit — 390.
— e Pezës — 390.
— e Skraparit — 390.
— e Vlorës — 390.
Çorovodë — 393, 402-403, 422,
449-450, 466 469.

D

Dardhë (Korçë) — 428.
Delhi — 44.
Dibër — 160, 432.
Dizhon (Francë) — 49.
Drin (lumi ~) — 412.
Durrës — 105, 449.

E

Egjipt — 151, 501.
Elbasan — 67, 101.
Ekspozita «Shqipëria 1971» —
352-358, 455.

F

- Fabrika e Sheqerit — Maliq-Korçë — 506, 508.
 Fabrika e Sodës Kaustike — Vlorë — 103.
 Francë — 38, 41, 42, 141, 304, 306, 453.

G

- Greqi — 152, 396.
 Guine — 126.
 Guomindan (partia ~) — 91.

GJ

- Gjirokastër — 103.

H

- Has (Kukës) — 435.
 Hekurudha Elbasan-Përrenjas — 62.
 Hekurudha Rrogozhinë-Fier — 157.
 Helmës (Skrapar) — 69, 395, 397, 437-438, 439, 467, 468.
 Hidrocentrali i Bushatit — 413.
 Hidrocentrali i Fierzës — 166, 167, 367, 412, 413, 456, 496.
 Hidrocentrali i Komanit — 413.
 Hidrocentrali i Skavicës — 413.
 Hidrocentrali i Vaut të Dejës — 157, 162, 413.
 Hungari — 138, 146, 147.

I

- Indokinë — 45, 120, 126, 137, 138, 371, 499.
 Indi — 37, 496, 497, 498, 499, 500.
 Indonezi — 120.
 Industan (Indi) — 499.
 Instituti i Kërkimeve Bujqësore — Lushnjë — 519.
 Instituti i Naftës — 475.
 Instituti i Projektimit — Tiranë — 431-435.
 Irak — 45.
 Itali — 20, 43, 304-305, 306, 385, 453.
 Izrael — 126.

J

- Japoni — 37, 123, 127, 306.

K

- Kamboxhia — 126, 137.
 Kili — 120.
 «Kodeks purpureus Beratinus» (dokumenti ~) — 104.
 Kolumbi — 120.
 Kombinati i Tekstileve — Berat — 353, 469, 476-482.
 Kombinati i tekstileve «Stalin» — Tiranë — 481.
 Kombinati Metalurgjik — Elbasan — 102, 167, 169, 367, 456, 496.
 Komiteti «Për lirinë e Shqipërisë» — Manastir (nëntor

1905) — 383.
 Kongo — 126.
 Kongresi i Parë i Rinisë —
 Helmës (3-17 gusht 1944) —
 397.
 Kongresi i Përmetit (24 maj
 1944) — 395, 397, 441.
 Kooperativa Bujqësore e Bar-
 gullasit — Skrapar — 405, 406.
 Kooperativa Bujqësore e Ma-
 minasit — Durrës — 543.
 Kooperativa Bujqësore e Po-
 tomit — Skrapar — 486.
 Kooperativa Bujqësore e So-
 vjanit — Korçë — 542.
 Kooperativa Bujqësore e To-
 moricës — Skrapar — 486.
 Kooperativa Bujqësore e Ven-
 dredhës — Skrapar — 405.
 Kooperativa Bujqësore e Vër-
 zhezhës — Skrapar — 405,
 406.
 Korçë — 70, 396, 406, 449.
 Koreja e Veriut (Republika
 Demokratike Popullore e Ko-
 resë) — 150.
 Krujë — 103.
 Kukës — 356.

L

Labinot (Elbasan) — 106.
 Laos — 126, 137.
 Lezhë — 432.
 Libi — 45, 126.
 Librazhd — 63.
 Lidhja Shqiptare e Prizrenit

(1878-1881) — 383.
 Lindja e Largët — 45.
 Lindja e Mesme — 37, 133,
 139, 142.
 Lufta e Dytë Botërore — 140.
 Lushnjë — 519.

M

Malezi — 120.
 Maliq (këneta ~, Korçë) —
 508, 510.
 Mallakastër — 396.
 Maja e Hekurave (Tropojë)
 — 459.
 Maqedoni — 498.
 Marok — 45.
 Martanesh — 458.
 Mat — 432.
 Mazhar, Qafa e Mazharit
 (Vlorë) — 65, 82.
 Mbledhja e Frashërit (1906)
 — 383.
 Mesdhe (deti ~) — 37, 143-
 -144.
 Mokër (Pogradec) — 70.
 Mongoli — 130.
 Muzeu i Çorovodës — 419-
 -421.

N

NATO — 123, 141, 142, 145-
 -147.
 Ndërmarrja Bujqësore — Lu-
 shnjë — 504, 508-512, 519.
 Ndërmarrja Bujqësore — Ma-

liq — Korçë — 504-508, 509,
510, 517-518, 542.
Ndërmarrja e Sharrave —
— Kukës — 536.
Ndërmarrja e Tullave — Lu-
shnjë — 536.
Ndërmarrja Komunale — Di-
bër — 536.

NJ

Nju-Jork — 133, 454.

O

OKB — 72-73, 133, 500-501.
Oqeania — 329.
Oqeani Indian — 133.

P

Pakistan — 496-498.
Palestinë — 139-140.
Peru — 120.
Përmet — 442, 449.
Pogradec — 70-71, 105.
Poliçan (Gjirokastrë) — 397,
402-403, 467.
Poloni — 124, 130, 146, 314.
Potom (Skrapar) — 386, 486.
Prishtë (Skrapar) — 404.

Q

Qafa e Koshovicës (Vlorë) —
65.
Qyteti Stalin — 469, 471-475.

R

Radio Londra — 439, 440-441.
Rafineria e Naftës — Ballsh
— 412, 473, 496.
Rangun — 44.
Revolucioni i Madh Socialist
i Tetorit — 318, 371-372.
Rumani — 147, 152, 496, 498.

RR

«Rreziku anglo-amerikan për
Shqipërinë» (Vepra ~,
Enver Hoxha) — 397, 443.

S

Sarandë — 471, 485.
Seman (Fier) — 543.
Skrapar — 403, 431, 432-434,
469, 471, 486.
Somali — 126.
Sovjan (Korçë) — 506.
Spanjë — 306.
Staraveckë (Skrapar) — 396.

SH

«Shënime për Kinën», vëll. I
(Vepra ~, Enver Hoxha) —
111.
Shkolla e mesme «Ramiz
Aranitasi» — Çorovodë —
Skrapar — 422-424, 427, 449-
450.
Shkumbin (lumi ~) — 413.
Shmil (Elbasan) — 62, 67.

T

- Tajlandë — 120.
 Tepelenë — 160.
 Tërbuf (këneta ~, Fier) — 508, 510.
 Tiranë — 2-4, 66, 157, 368-369, 393, 400, 453.
 Tragjas (Vlorë) — 65-66.
 Traktati i Varshavës — 142-143, 145-147, 155.
 Tregu i Përbashkët Evropian — 123.
 Turqi — 152.

U

- Uashington — 43.
 Uest-Point (zona ushtarake ~, SHBA) — 454.
 Universiteti i Montpeliesë

- (Francë) — 427.
 Uzina «Dinamo» — 537.
 Uzina «Partizani» — 354, 537.
 Uzina e Polivinilkloridit — Vlorë — 102-103.
 Uzina «Traktori» (kombinati i autotraktorëve «Enver Hoxha») — 537-538.

V

- Vërzhezhë (Skrapar) — 386, 405, 486.
 Vjosë (lumi ~) — 413.
 Vlorë — 65, 66, 68, 485.

Y

- «Yje të pashuar», vëll. II (libri ~) — 356.

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 47-TË	V—IX
TË ZHVILLOJMË MË GJERË REVOLUCIONIN TEKNIKO-SHKENCOR NË VENDIN TONË — Fjala në Konferencën e 18-të të Partisë të rrethit të Tira- nës (29 shtator 1971)	1—39
GJENDJA NË ARENËN NDËRKOMBËTARE PO BËHET MË E FAVORSHME PËR REVOLUCIONIN — Nga biseda në pritjen e dhënë nga ambasadori i RP të Kinës në Tiranë (30 shtator 1971)	40—46
SHKËMBIMET NË FUSHËN E ARTIT DHE TË KULTURËS I SHËRBEJNË FORCIMIT TË MIQË- SISË NDËRMJET POPUJVE — Nga biseda me tru- pën e baletit të RP të Kinës (2 tetor 1971)	47—51
UDHËHEQJA DUHET T'U PËRSHTATET NEVOJA- VE OBJEKTIVE TË PARTISË E ZHVILLIMIT TË VENDIT — Nga fjala në Plenumin e 13-të të KQ të PPSH (12 tetor 1971)	52—59
KASOLLET DHE SHTËPITË TUAJA TË VARFRA U BËNË PISHTARË TË LUFTËS PËR LIRI — Nga biseda me një grup veteranësh dhe pjesëtarë të fa- miljeve që kanë qenë baza strehimi gjatë Luftës Na- cionalçlirimtare (13 tetor 1971)	60—85

MOSDËRGIMI I DELEGACIONIT TË PKK — KON- SEKUENCË E VIJËS REVIZIONISTE KINEZE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 tetor 1971)	86—100
HISTORIA E POPULLIT ËSHTË HISTORI E MA- DHE — Nga biseda me ambasadorin e RP të Kinës në Tiranë (16 tetor 1971)	101—103
PËR PARTITË TONA UNITETI MARKSIST-LENI- NIST ËSHTË JETIK — Fjala para delegacioneve të huaja të ftuara në Kongresin e 6-të të PPSH (31 te- tor 1971)	109—111
MBI VEPRIMTARINË E KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË — Ra- port në Kongresin e 6-të të PPSH (1 nëntor 1971)	112—332

I

GJENDJA NDËRKOMBËTARE DHE POLITIKA E JASHTME E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQI- PËRISË	117—156
Tendenca e zhvillimit të sotëm botëror është revolucioni dhe fitorja e socializmit	118
Paqja e vërtetë dhe sigurimi i popujve arrihen me luftë kundër imperializmit ame- rikan e socialimperializmit sovjetik	136
Politika e jashtme e Republikës Popullore të Shqipërisë është një politikë konsekuente e parimore në të gjitha drejtimet e saj	147

II

ZHVILLIMI I EKONOMISË DHE DETYRAT E PAR- TISË	157—202
--	---------

Të përmirësohet struktura e prodhimit industrial dhe të fuqizohet baza materialo- -teknike e tij	168
Drejtimet kryesore të politikës së Partisë për zhvillimin e bujqësisë	175
Të rritim efektivitetin e investimeve dhe të ndërtimeve kapitale	184
Të rritet pa ndërprerje e me ritme më të larta rendimenti i punës	188
Të ngrihet në mënyrë të vazhdueshme mi- rëqenia e popullit	193
Të përmirësojmë më tej drejtimin e eko- nomisë	196

III

FORCIMI I DIKTATURËS SË PROLETARIATIT DHE ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I DEMOKRACI- SË SOCIALISTE	203—226
--	---------

IV

LUFTA IDEOLOGJIKE DHE EDUKIMI I NJERIUT TË RI	227—262
Të forcojmë më tej ndërgjegjen socialiste të masave punonjëse në luftë me të gjitha mbeturinat dhe ndikimet e ideologjive të huaja	228
T'i vëmë gjithnjë më mirë arsimin, kulturën dhe artin në shërbim të socializmit e të popullit	250

Të zgjerojmë punën shkencore, të ngremë nivelin e organizimit e të drejtimit të saj	258
---	-----

V

TË FORCOJMË E TË REVOLUCIONARIZOJMË PARESHTUR PARTINË	263—295
---	---------

Roli udhëheqës i Partisë sigurohet nëpërmjet veprimtarisë së gjithë komunistëve dhe shembullit të tyre pararojë	265
Përbërja proletare dhe cilësia e komunistëve — kusht themelor që Partia të mbetet gjithnjë revolucionare	270
Të gjallërojmë jetën e brendshme dhe të rritim iniciativën e vetëveprimin e organizatave të Partisë	279
Disa çështje të politikës së kuadrit dhe të metodës e stilit në punë	290

VI

MARKSIZËM-LENINIZMI — DOKTRINË GJITHMONË E RE DHE 'SHKENCORE	296—332
--	---------

Udhëheqja e klasës punëtore dhe e partisë së saj marksiste-leniniste — kusht themelor për mposhtjen e borgjezisë dhe të imperializmit	302
Revolucioni — rruga e çlirimit të njerëzimit	313
Socializmi mund të ndërtohet vetëm mbi bazën e teorisë marksiste-leniniste	318

- PARTINË TA MBAJMË GJITHMONË TË SHKATHËT, REVOLUCIONARE, ME INICIATIVË — Fjala në Kongresin e 6-të të PPSH, në emër të përfaqësisë, për paraqitjen e kandidaturave për në organet drejtuese të Partisë (6 nëntor 1971) 333—342
- ZGJEDHJA NË UDHËHEQJE ËSHTËNDER I MADH, POR EDHE DETYRË ME PËRGJEGJËSI — Fjala në Plenumin I të KQ të PPSH (7 nëntor 1971) 343—346
- KONGRESI I 6-TË DO TË ZËRË NJË VEND TË RËNDËSISHËM NË JETËN E PARTISË E TË POPULLIT TONË — Nga fjala e mbylljes në Kongresin e 6-të të PPSH (7 nëntor 1971) 347—351
- PRODHIMET TË MOS MBETEN NË EKSPOZITË, POR TË HIDHEN NË TREG — Nga bisedat gjatë vizitës në ekspozitën «Shqipëria 1971» (7 nëntor 1971) 352—358
- REVOLUCIONARËT I BËN TË PATHYESHËM BIN-DJA PËR TË CILËN LUFTOJNË — Fjala në Pallatin e Brigadave me rastin e mbylljes së Kongresit të 6-të të PPSH dhe 30-vjetorit të Themelimit të saj (7 nëntor 1971) 359—362
- TË VËMË PLOTËSISHT NË JETË VENDIMET E KONGRESIT TË 6-TË TË PARTISË — Fjala në mi-tingun e kryeqytetit me rastin e mbylljes së Kongresit të 6-të të PPSH dhe 30-vjetorit të Themelimit të saj (8 nëntor 1971) 363—373
- DISIPLINA NDIHMON PËR TA TRANSFORMUAR GATISHMËRINË NË FORCË TË PATHYESHME — Nga biseda me sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të Rrethit të Skraparit (23 nëntor 1971) 374—379

- POPULLI I SKRAPARIT ËSHTË NJË POPULL TRIM E LUFTARAK, I LIDHUR ME PARTINË — Fjala në mitingun e popullit të Skraparit (28 nëntor 1971) 380—413
- DORËZIMI I DOKUMENTEVE NË MUZE I SHËRBEN EDUKIMIT PATRIOTIK TË POPULLIT — Nga biseda e zhvilluar gjatë vizitës në Muzeun e Çorovodës (29 nëntor 1971) 419—421
- NXËNËSIT JANË SI FIDANË, SI T'I DREJTOSH, ASHTU RRITEN — Fjala para nxënësve e mësuesve të shkollës së mesme «Ramiz Aranitasi» të Çorovodës (29 nëntor 1971) 422—430
- UJITJA ËSHTË NJË PROBLEM QË DUHET PARË ME KUJDES — Nga biseda me një punonjës të Institutit të Projektimit (29 nëntor 1971) 431—435
- HELMËSI ËSHTË I VOGËL, POR KA NJË HISTORI TË LAVDISHME — Nga biseda me Gani Bilimanin (29 nëntor 1971) 436—446
- KUJTIMET NA SHTOJNË FUQITË PËR TË PUNUAR DHE NA BËJNË TË RINJ — Fjala në darkën e shtruar në Çorovodë me rastin e 28 dhe 29 Nëntorit (29 nëntor 1971) 447—465
- DITËT E LAVDISHME TË LUFTËS NUK MUND TË HARROHEN KURRË NGA NE QË I KEMI JETUAR — Nga biseda me patriotin Mehmet Myslimi (Helmësi) (30 nëntor 1971) 466—470

- TË PUNOJMË ME KUJDES PËR MË SHUMË NAF-
TË — Nga biseda me disa drejtues të sektorit të
naftës në Qytetin Stalin (30 nëntor 1971) 471—475
- PRODHIMET E TEKSTILIT TË JENË TË BUKU-
RA, TË QËNDRUESHME, JOUNIFORME — Nga
biseda me kuadro dhe punëtorë të dalluar të Ko-
mbinatit të Tekstileve në Berat (1 dhjetor 1971) 476—483
- KOMUNISTËT TË BËJNË DURIM E TË JENË NË
BALLË EDHE NË FATKEQËSI — Nga biseda me
Heroin e Popullit Zylyftar Veleshnja (1 dhjetor 1971) 484—490
- QËLLIMI YNË: TË MBROJMË INTERESAT E RE-
VOLUCIONIT — Nga biseda me një delegacion qe-
veritar ekonomik të RP të Kinës (11 dhjetor 1971) 491—503
- RRITJA E RENDIMENTEVE NË BUJQËSI KËRKON
RRITJEN E NIVELIT SHKENCOR TË PUNONJËS-
VE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ
të PPSH (13 dhjetor 1971) 504—520
- SITUATAT ANALIZOHEN SIPAS KUSHTEVE KON-
KRETE TË VENDIT — Diskutim në mbledhjen e
Sekretariatit të KQ të PPSH (13 dhjetor 1971) 521—527
- EDHE NORMA TEKNIKE KA DINAMIKËN E SAJ
— Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ
të PPSH (15 dhjetor 1971) 528—540
- RENDIMENTI NË PAMBUK VARET NGA SHËR-
BIMET QË I BËHEN — Diskutim në mbledhjen e
Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 dhjetor 1971) 541—546
- E KALOFSHI VITIN E RI PLOT SUKSESE NË
PUNË — Fjala në mbrëmjen e organizuar me rastin
e Vitit të Ri 1972 me punonjësit e aparatit të KQ
të PPSH (29 dhjetor 1971) 547—548

TREGUESI I LËNDËS	551
TREGUESI I EMRAVE	561
TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA	565

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1985